KODI CIVIL

I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994;
ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999;
nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012;
121/2013, datë 18.4.2013

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Dhjetor 2014

© I Qendrës së Botimeve Zyrtare

ISBN 978-9928-01-028-5

PËRMBAJTJA

	Faqe	Neni
PJESA I	9	1-140
PJESA E PËRGJITHSHME	9	
TITULLI I		1-63
SUBJEKTET E SË DREJTËS CIVILE	11	
KREU I		1-23
PERSONAT FIZIKË		
A. Zotësia juridike	9	1-4
B. E drejta e emrit	9	5
C. Zotësia për të vepruar	10	6-11
Ç. Banimi dhe qëndrimi	11	12-14
D. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi	11	15-23
KREU II		24-63
PERSONAT JURIDIKË	12	
A. Dispozita të përgjithshme	12	24-38
B. Shoqatat	14	39-53
C. Fondacionet	17	54-63
TITULLI II		64-78
PËRFAQËSIMI	19	
KREU I		64-78
KUPTIMI DHE LLOJET E PËRFAQËSIMIT	19	
TITULI III		78-111
VEPRIMET JURIDIKE	22	
KREU I		79-91
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	22	
KREU II		92-111
PAVLEFSHMËRIA E VEPRIMEVE JURIDIKE	23	
TITULLI IV		112-140
PARASHKRIMI I PADISË DHE DEKADENCA E TË DREJTAVE	27	
KREU I		112-128
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	27	
KREU II		129-136
PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT	29	
A. Pezullimi i parashkrimit	29	129-130
B. Ndërprerja e parashkrimit	30	131-136
KREU III		137-140
PREKLUZIVITETI (DEKADENCA)	31	
PJESA II	31	141-315
SENDET DHE PRONËSIA	31	
TITULLI I		141-148
SENDET	31	

	Faqe	Neni
TITULLI II		149-198
PRONËSIA	33	
KREU I		149-161
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	33	
KREU II		162-191
FITIMI DHE HUMBJA E PRONËSISË	35	
KREU III		192-198
REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME	40	
TITULLI III		199-231
BASHKËPRONËSIA	41	
KREU I		199-208
BASHKËPRONËSIA NË PJESË	41	
KREU II		209-231
BASHKËPRONËSIA NË TËRËSI	43	
A. Bashkëpronësia e detyrueshme	43	209-241
B. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore	46	223-230
C. Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve	47	231
TITULLI IV		232-258
UZUFRUKTI	47	
KREU I		232-236
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	47	
KREU II		237-245
TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI	48	
KREU III		246-254
DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI	50	
KREU IV		255-258
MBARIMI I UZUFRUKTIT	52	
TITULLI V		259-260
PËRDORIMI E BANIMI	52	
TITULLI VI		261-295
SERVITUTET	53	
KREU I		261-264
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	53	
KREU II		265-280
SERVITUTET DETYRUESE	53	
KREU III		281-284
SERVITUTET VULLNETARE	56	
KREU IV		285-292
MËNYRAT E USHTRIMIT TË SERVITUTEVE	56	
KREU V		293-295
SHUARJA E SERVITUTEVE	57	
TITULLI VII		296-303

	Faqe	Neni
MBROJTJA E PRONËSISË	58	
TITULLI VIII		304-315
POSEDIMI	60	
KREU I		304-309
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	60	
KREU II		310-315
MBROJTJA E POSEDIMIT DHE E MBAJTJE	61	
PJESA III	62	316-418
TITULLI I		316-359
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	62	
TITULLI II		360-371
TRASHËGIMIA ME LIGJ	69	
TITULLI III		372-418
TRASHËGIMIA ME TESTAMENT	71	
PJESA IV	77	419-658
DETYRIMET	77	
TITULLI I		419-454
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	77	
KREU I		419-422
KUPTIMI DHE LINDJA E DETYRIMEVE	77	
KREU II		423-435
DETYRIMET SOLIDARE	78	
KREU III		436-441
DETYRIMET ALTERNATIVE	80	
KREU IV		442-444
DETYRIME TË PJESËTUESHME E TË PAPJESËTUESHME	81	
KREU V		445-454
DETYRIMET MONETARE	82	
TITULLI II		455-529
EKZEKUTIMI DHE SHUARJA E DETYRIMEVE	83	
KREU I		455-475
EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE	83	
KREU II		476-495
EFEKTET E MOSEKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE	86	
KREU III		496-507
ZËVENDËSIMI DHE KALIMI I KREDISË	89	
KREU IV		508-529
SHUARJA E DETYRIMEVE	91	
TITULLI III		530-607
MJETET PËR TË SIGURUAR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE	94	
KREU I		530-540
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	94	

	Faqe	Neni
KREU II		542-545
KUSHTI PENAL	96	
KREU III		546-549
PENGU	96	
KREU IV		560-584
HIPOTEKA	99	
KREU V		585-600
DORËZANIA	102	
KREU VI		601-607
KAPARI DHE PRIVILEGJET	105	
A. Kapari	105	601-602
B. Preferimet (privilegjet)	105	603-607
TITULLI IV		608-652
DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT	107	
KREU I		608-627
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	107	
KREU II		628-639
PËRGJEGJËSIA QË RRJEDH NGA PRODUKTET	110	
A. Përgjegjësia e prodhuesit	110	628-634
B. Publikimi mashtrues	111	635-637
C. Konkurrenca e pandershme	112	638-639
KREU III		640-647
SHPËRBLIMI I DËMIT	112	
TITULLI V		648-652
GJERIMI I PUNËVE TË TË TJERËVE	114	
TITULLI VI		653-654
PAGIMI I PADETYRUAR	115	
TITULLI VII		655-658
BEGATIMI PA SHKAK	115	
PJESA V	116	659-1168
KONTRATAT	116	
TITULLI I		659-704
KONTRATAT NË PËRGJITHËSI	116	
KREU I		659-680
DISPOZITA PARAPRAKE	116	
KREU II		681-689
INTERPRETIMI I KONTRATËS	119	
KREU III		690-704
EFEKTET E KONTRATAVE	120	
TITULLI II		705-1161
KONTRATAT E VEÇANTA	122	
KREU I		705-756

	Faqe	Neni
SHITJA	122	
KREU II		757-760
SHKËMBIMI	132	
KREU III		761-771
DHURIMI	132	
KREU IV		772-783
FURNIZIMI	134	
KREU V		784-800
ENFITEOZA	136	
KREU VI		801-849
QIRAJA	138	
A. Qiraja në pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore	142	826-840
B. Qiraja e sendeve prodhuese	144	841-848
C. Qiraja financiare (leasing)	145	849
KREU VII		850-876
SIPËRMARRJA	145	
KREU VIII		877-900
TRANSPORTI	150	
A. Transporti i personave	150	877-879
B. Transporti i sendeve	150	880-900
KREU IX		901-912
HUAPËRDORJA	154	
KREU X		930-934
POROSIA	155	
KREU XI		935-944
KOMISIONI	158	
KREU XII		945-949
SPEDICIONI (DËRGESA)	160	
KREU XIII		950-961
AGJENCIA	161	
KREU XIV		962-972
KALIMI I PASURISË KREDITORËVE	164	
KREU XV		973-981
NDËRMJETËSIMI	166	
KREU XVI		982-1012
DEPOZITA	167	
A. Depozita në magazinat e përgjithshme	169	1000-1003
B. Depozita në hotel	170	1004-1012
KREU XVII		1013-1323
LLOGARIA RRJEDHËSE	172	
KREU XVIII		1024-1049
KONTRATAT BANKARE	173	

	Faqe	Neni
A. Depozitat bankare	173	1024-1027
B. Shërbimi bankar dhe kasetat e sigurimit	174	1028-1030
C. Hapja (çelja) e kredisë bankare	174	1031-1034
Ç. Paradhënia bankare	175	1035-1040
D. Veprimet bankare me llogari rrjedhëse	176	1041-1046
E. Skontoja bankare	177	1047-1049
KREU XIX		1050-1055
HUAJA	177	
KREU XX		1056-1064
FRANCHISING	178	
KREU XXI		1065-1073
RENTA JETORE	180	
KREU XXII		1074-1112
SHOQËRIA E THJESHTË	181	
KREU XXIII		1113-1161
SIGURIMI	187	
TITULLI III		1162-1168
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT	195	

LIGJ
Nr.7850, datë 29.7.1994

PËR KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I

PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I
SUBJEKTET E SË DREJTËS CIVILE

KREU I
PERSONAT FIZIKË

A. Zotësia juridike
Neni 1

Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

Neni 2

Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies.

Neni 3

Të huajt gëzojnë po ato të drejta e detyrime që u njihen shtetasve shqiptarë, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.

Neni 4

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.
Veprimi juridik që kufizon zotësinë juridike të një personi fizik, është i pavlefshëm.

B. E drejta e emrit
Neni 5

Çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit. Personi, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cënohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë

padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe nga persona që, ndonëse nuk mbajnë emrin ose mbiemrin e cenuar, apo të përdorur padrejtësisht, kanë interesa familjare të denja për t' u mbrojtur.

Gjykata kur pranon padinë urdhëron botimin e vendimit në Fletoren Zyrtare. Me kërkesën e paditësit gjykata mund të urdhërojë botimin e vendimit të saj edhe në gazeta të tjera. Pseudonimi i përdorur nga personi fizik gëzon të njëjtën mbrojtje.

C. Zotësia për të vepruar

Neni 6

Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Neni 7

I mituri, që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita.

Neni 8

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor.

Neni 9

I mituri me moshë katërmbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psiqike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 10

Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psiqike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.

Neni 11

Veprimi juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

Ç. Banimi dhe qëndrimi

Neni 12

Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit.

Neni 13

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij.

Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërmbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton.

Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 14

Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

D. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi

Neni 15

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës.

Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm.

Neni 16

Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar.

Vendimi i gjykatës, me të cilin një person është shpallur i zhdukur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 17

Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.

Neni 18

Personi që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se kanë kaluar pa patur lajme dy vjet, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes ose tre vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur.

Neni 19

Personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur.

Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dy vjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasëm.

Neni 20

Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë.

Neni 21

Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi.

Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.

Neni 22

Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë.

Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 23

Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi prishet nga gjykata që e ka dhënë.

Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes.

KREU II
PERSONAT JURIDIKË

A. Dispozita të përgjithshme

Përmbajtja e personit juridik

Neni 24

Personat juridikë janë publikë dhe privatë.

Neni 25

Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik.

Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen.

Neni 26

Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Emri i personit juridik

Neni 27

Personi juridik ka emrin e tij të plotë dhe të shkurtuar. Emri i çdo shoqërie ose organizate tjetër që zhvillon veprimtari ekonomike është firma e saj, e cila duhet të shprehë sidomos qëllimin e kësaj veprimtarie.

Qendra e personit juridik

Neni 28

Personi juridik ka qendrën atje ku ndodhet organi drejtues i tij, përveç kur në statut ose në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Zotësia e personit juridik

Neni 29

Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i krijimit të tij dhe, kur ligji parashikon se duhet të regjistrohet, që nga çasti i regjistrimit.

Neni 30

Personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit ose në statut.

Neni 31

Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.

Përgjegjësia e personit juridik

Neni 32

Personi juridik është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Personi juridik përgjigjet për detyrimet e tij brenda kufijve të pasurisë së tij. Personat që kanë vepruar me cilësinë e organit të personit juridik, kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre.

Neni 33

Shteti dhe personat juridikë shtetërorë nuk përgjigjen për detyrimet e njëri-tjetrit, përveç kur kjo është pranuar prej tyre ose është parashikuar shprehimisht në ligj.

Mbarimi i personit juridik

Neni 34

Personi juridik mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut ose në ligj.

Neni 35

Me mbarimin, personi juridik pushon veprimtarinë e tij dhe vihet në likuidim.

Neni 36

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve në rast mbarimi të personit juridik, për të cilin kërkohet regjistrimi, sjell pasoja nga koha e regjistrimit.

Kur nuk kërkohet regjistrimi, kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve në rastet e parashikuara nga paragrafi i mësipërm, sjell pasoja nga koha e miratimit të bilancit përkatës, në mënyrën që parashikohet në ligj, nga organi përkatës që e ka krijuar ose në statut.

Likuidimi i personit juridik

Neni 37

Likuidimi i personit juridik që ka mbaruar bëhet me realizimin e të drejtave dhe pagimin e detyrimeve nga likuidatorë të caktuar nga organi që ka vendosur mbarimin e tij.

Komisioni bën likuidimin sipas dispozitave ligjore përkatëse, statutit ose aktit të themelimit.

Neni 38

Kur personi juridik mbaron për shkak se ka zhvilluar veprimtari të kundërligjshme, pasuria e mbetur pas likuidimit i kalon shtetit.

Likuidimi i personit juridik që falimenton rregullohet me ligj.

B. Shoqatat

Krijimi i shoqatave

Neni 39

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 1)

Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.

Neni 39/1

(Shtuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 neni 2)

Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në

përputhje me ligjin dhe me qëllimin e objektin e veprimtarisë së shoqatës, të parashikuar në statutin e saj.

Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj.

Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse.

Neni 40

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 3)

Akti për krijimin e shoqatës, me kërkesë të themeluesve të saj, regjistrohet në gjykatë.

Rregullat për organizimin e funksionimin e shoqatës përcaktohen në statutin e saj, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:

a) emrin dhe qëllimin e shoqatës, qëndrën e saj dhe territorin në të cilin do të zhvillojë veprimtarinë e vet;

b) kushtet e pranimit dhe të largimit të anëtarëve, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre;

c) organet drejtuese të shoqatës, mënyrën e formimit dhe kompetencat e tyre;

ç) afatet, mënyrën e thirrjes dhe kompetencat e mbledhjeve të përgjithshme dhe të delegatëve;

d) burimin e mjeteve materiale të saj, si dhe kontributet apo kuotat që duhet të japë çdo anëtar;

dh) mënyrën e ndryshimit të statutit dhe të mbarimit të shoqatës.

Neni 41

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 4)

Shoqata themelohet nga mbledhja e themeluesve, në të cilën miratohet statuti dhe zgjidhen organet drejtuese të saj. Shoqata, me kërkesën e saj, regjistrohet në gjykatë sipas mënyrës së parashikuar në ligj.

Gjykata kontrollon pajtueshmërinë e statutit me ligjin.

Neni 42

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 5)

Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj.

Neni 43

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 6)

Shoqata ka të drejtë të themelojë degë të saj kudo ku ajo e çmon të arsyeshme, për të realizuar qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqatës.

Neni 43/1

(Shtuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 7)

Rastet dhe mënyrat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqatave nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.

Organizimi i shoqatës

Neni 44

Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve ose e përfaqësuesve të tyre, është organi më i lartë i shoqatës.

Ajo thirret nga organi drejtues, sipas dispozitave përkatëse të statutit, si dhe kur e kërkon një e pesta e anëtarëve.

Neni 45

Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e anëtarëve dhe për çdo çështje tjetër, që nuk është lënë në kompetencën e ndonjë organi tjetër të shoqatës.

Ajo ushtron posaçërisht mbikëqyrjen mbi të ardhurat dhe veprimet e shoqatës, si dhe mbi objektet pasurore të saj.

Neni 46

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 8)

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë vote të barabartë në mbledhjen e përgjithshme.

Anëtari i shoqatës nuk merr pjesë në diskutim dhe votim në rastet kur vetë ose bashkëshorti, fëmijët, gjinia a krushqia e tij janë në konflikt interesash me shoqatën, lidhur me një çështje të rendit të ditës.

Miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të shoqatës vendimet për ndryshimin e statutit dhe për shpërndarjen e shoqatës, përveç kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë votimi.

Neni 47

Organi drejtues ka të drejtën dhe detyrën të kujdeset për interesat e shoqatës, t'i mbrojë ato, si dhe të përfaqësojë shoqatën sipas kompetencave që i janë dhënë nga statuti.

Antarësia në shoqatë

Neni 48

Pranimi i anëtarëve të rinj, që përmbushin kushtet e nevojshme, mund të lejohet në çdo kohë.

E drejta për të dhënë dorëheqjen është e garantuar, por me kusht që të jetë paraqitur së paku gjashtë muaj para mbarimit të vitit kalendarik ose brenda afatit të parashikuar në statut.

Neni 49

E drejta e anëtarësisë në shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë trashëgimie.

Neni 50

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 9)

Anëtari, që largohet ose përjashtohet nga shoqata, përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve deri në çastin e largimit të tij dhe nuk ka të drejta mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj.

Ata kanë detyrën të derdhin kuotat për kohën gjatë së cilës kanë bërë pjesë në shoqatë.

Neni 51

Çdo anëtar ka të drejtë të kundërshtojë në gjykatën kompetente vendimet e shoqatës që vijnë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

Ky kundërshtim mund të bëhet brenda një muaji nga dita kur anëtari ka marrë njoftimin për atë vendim.

Shpërndarja

Neni 52

(riformuluar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 10)

Shpërndarja e shoqatës bëhet:

a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;

b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në këtë Kod ose në statut;

c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;

ç) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;

d) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e shoqatës, me kërkesë të çdo anëtari të shoqatës, të organeve vendimmarrëse të saj, si dhe të organeve kompetente shtetërore.

Neni 53

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 11)

Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe çregjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj.

Neni 53/1

(Shtuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 12)

Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e shoqatës, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar shoqata.

C. Fondacionet

Mënyra e krijimit

Neni 54

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 13)

Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut.

Neni 55

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 14)

Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt notetial ose me testament. Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë.

Në aktin e krijimit përcaktohen sidomos emrat e themeluesve, qëllimi i fondacionit, përbërësit e pasurisë (para, letra me vlerë, ose sende të luajtshme dhe të paluajtshme), burimet dhe mënyra e financimit, organet drejtuese, kompetencat e tyre, si dhe emrat e anëtarëve të administratës.

Neni 56
(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 15)

Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e fondacionit ose ekzekutori i testamentit mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e tij.

Neni 56/1
(Shtuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 16)

Fondacioni ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektin e veprimtarive të parashikuara në statutin e fondacionit.

Të ardhurat e realizuara nga fondacioni duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e tij.

Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse.

Neni 57

Akti për krijimin e fondacionit mund të shfuqizohet nga themeluesit para regjistrimit ose kur ende nuk ka filluar veprimtarinë përkatëse.

Akti i krijimit të fondacionit mund të kundërshtohet nga trashëgimtarët ose nga kreditorët e themeluesit.

Ushtrimi i veprimtarisë të fondacionit
Neni 58

Organet e fondacionit, mënyra e formimit dhe kompetencat e tyre caktohen nga akti i krijimit.

Çdo fondacion kryen veprimtarinë e vet në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe të aktit të themelimit të tij.

Neni 59
(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 17)

Rastet dhe mënyra e mbikëqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.

Neni 60
(Shfuqizuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 18)

Neni 61

Mosmarrëveshjet pasurore, në të cilat fondacioni është palë, zgjidhen nga gjykata kompetente.

Neni 62
(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 19)

Shpërndarja e fondacionit bëhet:

a) me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;

b) kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;

c) kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;

ç) në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Gjykata, në rastet e parashikuara me ligj, mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të fondacionit, si dhe të organeve kompetente shtetërore.

Neni 63
(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 20)

Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e fondacionit, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së tij, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar fondacioni.

TITULLI II
PËRFAQËSIMI

KREU I
KUPTIMI DHE LLOJET E PËRFAQËSIMIT

Kuptimi i përfaqësimit
Neni 64

Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuari).

Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi.

Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.

Kufijtë dhe pasojat e përfaqësimit
Neni 65

Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë.

Tagret e përfaqësuesit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse.

Neni 66

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda tagreve që i janë dhënë, krijojnë pasoja drejtëpërdrejt për të përfaqësuarin.

Neni 67

Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuari e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij.

Neni 68

Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe.

Neni 69

Përfaqësuesi detyrohet të veprojë personalisht dhe nuk mund të emërojë zëvendës të tij, përveç kur është lejuar nga i përfaqësuari, kur pasuria që përmendet në prokurë ndodhet jashtë territorit të rrethit ku banon përfaqësuesi, si dhe kur caktimi i zëvendësit çmohet i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit.

Përfaqësuesi duhet të njoftojë menjëherë të përfaqësuarin për zëvendësin që ka caktuar, përndryshe ai përgjigjet për veprimet e zëvendësit.

Zëvendësi mund të hiqet në çdo kohë nga i përfaqësuari ose nga përfaqësuesi që e ka caktuar.

Përfaqësimi me prokurë

Neni 70

Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.

Neni 71

Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht.

Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.

Neni 72

Prokura bëhet gjithmonë me shkresë.

Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë.

Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mud të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial.

Neni 73

Prokura për të tërhequr dërgesa postare ose para nga zyrat postare apo nga bankat deri në një shumë të caktuar prej tyre, prokura për të terhequr paga dhe shpërblime të tjera që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, si dhe prokura për të tërhequr pensione, ndihma e bursa, mund të vërtetohen edhe nga:

a) administratori i lagjes së qytetit ose kryeplaku i fshatit;

b) drejtuesi i personit juridik apo i degës së tij, ku i përfaqësuari është në marrëdhënie pune ose ndjek shkollën;

c) drejtuesi i institucionit shëndetësor ku i përfaqësuari është shtruar për mjekim;
ç) komanda e repartit ushtarak ku shërben i përfaqësuari;
d) drejtuesi i institucionit ku i përfaqësuari mbahet i arrestuar ose vuan dënimin me heqje të lirisë.

Neni 74

Ndryshimet në prokurë duhet t'u bëhen të njohura të tretëve me mjete të përshtatshme. Në mungesë të njoftimeve të tilla, këto ndryshime nuk mund t'u kundrejtohen të tretëve, përveç kur provohet që këta i dinin ndryshimet në prokurë në kohën kur është kryer veprimi juridik.

Neni 75

I përfaqësuari mund të shfuqizojë prokurën dhe përfaqësuesi të heqë dorë prej saj në çdo kohë. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Mbarimi i prokurës
Neni 76

Prokura mbaron kur:
a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë;
b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë;
c) kur ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar;
ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar;
d) kur i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës perfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës.

Përfaqësimi pas ndryshimeve ose mbarimit të prokurës
Neni 77

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, pas ndryshimeve të bëra në prokurë ose pas mbarimit të saj, janë të detyrueshme për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e tij, në rast se personat e tretë, me të cilët janë kryer ato veprime juridike, nuk kanë patur dijeni për ndryshimet ose për mbarimin e prokurës.

Përfaqësimi pa tagre
Neni 78

Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e patur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagret që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë.

Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi.

TITULLI III
VEPRIMET JURIDIKE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përkufizimi i veprimit juridik
Neni 79

Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.
Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.

Format e veprimit juridik
Neni 80

Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.
Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial.

Neni 81

Veprimi juridik me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.

Neni 82

Personi që nuk di, ose që për shkak sëmundje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, ngarkon një person tjetër për këtë qëllim.
Nënshkrimi i këtij personi duhet të vërtetohet nga noteri, duke u treguar shkaku për të cilin personi që ka kryer veprimin juridik nuk ka mundur ta nënshkruajë vetë.
Për veprimet që kryhen në bankat dhe në institucionet e tjera të kreditit, në zyrat postare apo doganore, nënshkrimi i këtij personi vërtetohet nga një nëpunës i autorizuar i këtyre nstitucioneve.

Neni 83

Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.
Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë.

Veprimet juridike me kusht
Neni 84

Veprimi juridik është me kusht kur lindja ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në të, varen nga një ngjarje e cila nuk dihet në se do të ndodhë.

Neni 85

Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet lindin po të ndodhë ngjarja.

Kushti është zgjidhës kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja.

Neni 86

Kur vërtetimi i kushtit është ndaluar me keqbesim nga pala që do të perfitonte nga mos vërtetimi i tij, kushti quhet se është vërtetuar.

Kur vërtetimi i kushtit është shkaktuar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga vërtetimi i tij, kushti quhet se nuk është vërtetuar.

Neni 87

Kur e drejta që varet nga vërtetimi i kushtit cenohet ose humbet nga veprimet e palës së detyruar me kusht, kjo duhet të shpërblejë dëmin e shkaktuar në rast se kushti vërtetohet.

Neni 88

Pasojat që lidhen me vërtetimin e kushtit fillojnë nga çasti që është vërtetuar kushti, përveç kur nga përmbajtja e veprimit juridik del se këto pasoja duhet të fillojnë në një kohë të mëparshme.

Veprimet juridike me afat

Neni 89

Afati i veprimit juridik është çasti i caktuar, nga i cili fillon ose pushon fuqia juridike ose disa nga efektet e tij.

Neni 90

Afati është pezullues kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij fillojnë nga një kohë e caktuar.

Afati është zgjidhës kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij pushojnë në një kohë të caktuar.

Llogaritja e afateve të veprimeve juridike

Neni 91

Kur afati është caktuar me ditë, nuk llogaritet dita në të cilën ndodh ngjarja ose koha nga e cila ai duhet të fillojë.

Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite, mbaron, me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ai ka filluar. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit.

KREU II
PAVLEFSHMËRIA E VEPRIMEVE JURIDIKE

Veprime juridike të pavlefshme

Neni 92

Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:

a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;
b) kryhen për të mashtruar ligjin;
c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç;
ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara).

Neni 93

Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij.
Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.

Veprime juridike që shpallen të pavlefshme

Neni 94

Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga:
a) të miturit mbi katërmbëdhjetë vjeç, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit;
b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit;
c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar;
ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qënë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe.
Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohet edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar.

Neni 95

Mashtrimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur gënjeshtra e përdorur nga njëra palë, për ta shpënë në gabim palën tjetër, është e tillë që pa atë pala nuk do ta kishte kryer veprimin juridik.
Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërise së veprimit juridik vetëm kur në kohën e kryerjes së tij pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin.

Neni 96

Kanosja mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur është e tillë sa të friksojë personin se ai vetë, bashkëshorti, pasardhësit ose paraardhësit e tij do të pësojnë një dëm fizik ose material të padrejtë dhe të rëndë.
Kanosja mund të kryhet edhe nga një person i tretë që nuk merr pjesë në veprimin juridik.

Neni 97

Lajthimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm vetëm në qoftë se lidhet me cilësinë e sendit, me identitetin ose cilësitë e personit tjetër, apo me rrethana aq thelbësore sa që pa ato, pala nuk do të kishte kryer veprimin juridik.

Neni 98

Lajthimi në llogaritje nuk sjell shpalljen e veprimit juridik si të pavlefshëm, por vetëm korregjimin e tij, përveç kur gabimi në sasi ka qenë përcaktues për marrëveshjen.

Neni 99

Veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm në rastin kur për shkak të nevojës së madhe, detyrimet e marra nga njëra palë janë krejt të papërfillshme në krahasim me përfitimet që nxjerr pala tjetër nga veprimi juridik.

Neni 100

Veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e të përfaqësuarit, kur vullneti i përfaqësuesit është me ves.

Kur vesi ka të bëjë me elemente të përcaktuara nga i përfaqësuari, veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm, vetëm në qoftë se ishte i vesuar vullneti i këtij të fundit.

Neni 101

Kur në veprimin jurdik ka rëndësi përcaktimi i mirëbesimit ose i keqbesimit, i dijenisë ose i mosdijenisë së rrethanave të caktuara, që përbëjnë kushte përcaktuese të vlefshme ose të pavlefshme të veprimit juridik, mbahet parasysh personi i përfaqësuesit, përveç kur bëhet fjalë për rrethana të përcaktuara nga i përfaqësuari.

I përfaqësuari që është në keqbesim nuk mund të përfitojë në asnjë rast nga mosdijenia ose mirëbesimi i përfaqësuesit.

Neni 102

Veprimi juridik i kryer në dëm të të përfaqësuarit për shkak marrëveshjeje me keqbesim midis përfaqësuesit dhe personit të tretë, mund të shpallet i pavlefshëm për të përfaqësuarin.

Afati i parashkrimit të padisë

Neni 103

Padia për të kërkuar që një veprim juridik të shpallet i pavlefshëm, parashkruhet brenda pesë vjetëve.

Neni 104

Afati për ngritjen e padisë fillon:

a) për veprime juridike të kryera nga persona që u është hequr ose kanë patur zotësi juridike të kufizuar për të vepruar, që nga dita që janë bërë madhorë ose që u është kthyer zotësia për të vepruar;

b) për veprime juridike të kryera me mashtrim, kanosje ose lajthim, nga dita që mashtrimi ose lajthimi janë zbuluar, ose kanosja ka pushuar, por në çdo rast, jo më shumë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik;

c) në raste të tjera, që nga dita që është kryer veprimi juridik.

Neni 105

Veprimi jurdik që shpallet i pavlefshëm quhet i tillë që nga çasti kur është kryer.

Pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik

Neni 106

Kur veprimi juridik është i pavlefshëm për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin, ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlefta e saj.

Kur njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet kësaj dhe kur nuk është e mundur kthimi i po kësaj gjëje, i paguhet vlefta e saj.

Neni 107

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është bërë me mashtrim, kanosje, nga nevoja e madhe ose sepse mungon forma e kërkuar nga ligji, secila nga palët duhet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthehet po ajo gjë, t'i paguhet vlefta e saj.

Neni 108

Kur veprimi juridik konstatohet se është i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose shpallet i pavlefshëm se është kryer nga një i mitur që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, por pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e mundur të kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t'i shperblejë të miturit dëmin që ky ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm.

Neni 109

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një person, të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar ose për arsye se është kryer nga një person të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar e pa patur pëlqimin e kujdestarit të tij, ose për arsye se është kryer nga një person i cili në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka patur zotësinë për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që kjo palë ka pësuar për shkak të veprimit juridik që është shpallur i pavlefshëm, në rast se dinte ose duhet të dinte se pala tjetër nuk ka patur zotësi për të vepruar ose nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të saj.

Neni 110

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se njëra nga palët ka qenë në lajthim, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka kërkuar të shpallet i pavlefshëm veprimi juridik detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që ajo ka pësuar për shkak se veprimi juridik është shpallur i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur ajo provon se nuk ka faj që ka rënë në lajthim ose se pala tjetër ka ditur ose duhet të dinte lajthimin.

Neni 111

Kur shkaku i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik.

TITULLI IV
PARASHKRIMI I PADISË DHE DEKADENCA E TË DREJTAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja
Neni 112

E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.

Paditë që nuk parashkruhen
Neni 113

Nuk parashkruhen:
a) padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj;
b) paditë e njohjes;
c) padia e pjestimit midis bashkëpronarëve;
ç) padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë;
d) paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta.
Nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi.

Afatet e parashkrimit
Neni 114

Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.

Neni 115
(Shtuar germa e me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012, neni 1)

Parashkruhen brenda afateve prej:
a) gjashtë muaj paditë për pagimin e kushteve penale vlerësuese;
b) një viti paditë e rrjedhura nga kontratat e spedicionit;
c) gjashtë muaj paditë që rrjedhin nga transportimet e drejtpërdrejta të mallrave dhe të udhëtarëve me anë të hekurudhës, automjeteve ose avionëve dhe prej një viti për të njëjtat padi që rrjedhin nga transportimet detare ose të përziera;
ç) dy vjetëve paditë për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit dhe risigurimit, si edhe të shumës përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm;
d) tre vjetëve paditë për pagimin e qirave të banesave, dyqaneve, lokaleve dhe pasurive të tjera të paluajtshme;

dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jo kontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.

e) një vit paditë për shpërblimin e dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit.

Paditë e tjera parashkruhen brenda afateve të posaçme të caktuara në këtë Kod ose në ligje të tjera.

Neni 116

Është e pavlefshme marrëveshja e palëve për ndryshimin e afateve të parashkrimit dhe e çdo dispozite të këtij kreu.

Neni 117

Afati i parashkrimit fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë.

Neni 118

Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat.

Kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon në mënyrë të veçantë.

Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi.

Neni 119

Për kërkimin e sendit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenuesin e së drejtës së tij.

Neni 120

Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.

Neni 121

Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës.

Neni 122

Për kërkimin e trashëgimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita e çeljes së trashëgimisë.

Neni 123

Për paditë e kthimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur paditësi ka paguar vullnetarisht, në bazë të një detyrimi ligjor ose kontraktor, personit të tretë, për fajin e të padituri, shumën e parave apo sendin që kërkohet me anë të kësaj padie, ose nga dita kur është dhënë vendimi i gjykatës ose arbitrazhit përkatës nga i cili ka lindur padia e regresit.

Neni 124

Parashkrimi i padisë për kërkesën kryesore shkakton që të parashkruhen edhe paditë për kërkesat e rrjedhura prej saj, pavarësisht se për këto nuk është plotësuar ende afati përkatës.

Kërkesa e palës së interesuar

Neni 125

Parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar.

Heqia dorë nga parashkrimi

Neni 126

Heqja dorë nga parashkrimi lejohet vetëm pasi të jetë plotësuar afati i tij.

Neni 127

Pretendimi se afati i parashkrimit është plotësuar mund të ushtrohet edhe nga kreditorët dhe nga kushdo që ka interes, në rastet kur pala përkatëse e ka ushtruar vetë.

Përmbushja e detyrimit pas plotësimit të afatit

Neni 128

Debitori që ka përmbushur detyrimin e tij pas plotësimit të parashkrimit, nuk mund të kërkojë kthimin e shumës së parave ose të sendit, që ka dhënë vullnetarisht, edhe sikur të mos dinte se ishte plotësuar afati i parashkrimit.

KREU II
PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT

A. Pezullimi i parashkrimit

Neni 129

Parashkrimi pezullohet:

a) midis bashkëshortëve deri në ditën kur ka marrë formë të prerë vendimi gjyqësor me të cilin është zgjidhur martesa;

b) midis fëmijëve dhe prindërve gjersa këta ushtrojnë të drejtën prindërore;

c) midis personave që ndodhen nën kujdestari dhe kujdestarëve të tyre gjersa vazhdon kujdestaria;

ç) për paditë e personave, pasuria e të cilëve është vënë në administrim, kundër administruesve përkatës të caktuar nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent shtetëror, gjersa të jetë miratuar raporti përfundimtar i llogarive;

d) për paditë e të miturve dhe personave të tjerë, që nuk kanë zotësi për të vepruar gjersa t'u emërohet përfaqësuesi ose të fitojnë këtë zotësi, si edhe për gjashtë muaj pasi është emëruar përfaqësuesi ose pasi kanë fituar zotësinë për të vepruar;

dh) për paditë e personit juridik kundër administratorëve të vet, gjersa këta vazhdojnë këtë detyrë pranë tij;

e) për paditë me objekt shpërblimin përkatës, të rrjedhura nga dëmtimi i shëndetit ose nga shkaktimi i vdekjes, pezullimi i parashkrimit vazhdon nga dita kur i është paraqitur kërkesa organit të

sigurimeve shoqërore shtetërore dhe deri në ditën kur është caktuar pensioni ose është refuzuar ajo kërkesë;

ë) kur ka forcë madhore.

Neni 130

Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatin e parashkrimit. Kur pas zhdukjes së shkakut pezullues, koha që mbetet për t'u plotësuar parashkrimi është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj.

B. Ndërprerja e parashkrimit

Neni 131

Parashkrimi ndërpritet:

a) me çdo veprim të personit fizik ose juridik të detyruar, që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës të kreditorit;

b) me paraqitjen e padisë, të kundërpadisë ose të prapësimit, qoftë edhe në një gjykatë ose arbitrazh që nuk është kompetent nga pikëpamja tokësore ose lëndore për shqyrtimin e çështjes;

c) me çdo veprim që e vë debitorin në vonesë;

ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër.

Neni 132

Parashkrimi i ndërprerë kundër njërit prej debitorëve solidarë ose njërit prej bashkëshortëve të një detyrimi të papjestueshëm, shtrihet edhe ndaj secilit nga këta debitorë të tjerë.

Neni 133

Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzënësit përkatës.

Neni 134

Koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat parashkrimi i ri.

Neni 135

Kur parashkrimi është ndërprerë për shkak të paraqitjes së padisë ose të kundërpadisë, afati i ri i parashkrimit fillon nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi me të cilin është zgjidhur çështja në themel.

Kur është vendosur rrëzimi i padisë pa u zgjidhur çështja në themel, ose pushimi i gjykimit të çështjes, parashkrimi nuk quhet i ndërprerë.

Llogaritja e afateve të parashkrimit

Neni 136

Afati i parashkrimit të padisë, që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit apo të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës në të cilën ka filluar afati dhe, kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e afatit të parashkrimit bie në një ditë pushimi, quhet si e fundit ajo ditë pune që vjen pas asaj të pushimit.

KREU III
PREKLUZIVITETI (Dekadenca)

Neni 137

Kur një e drejtë duhet të ushtrohet brenda një afati prekluziv, nuk zbatohen dispozitat që rregullojnë ndërprerjen e parashkrimit. Gjithashtu, nuk zbatohen shkaqet pezulluese, përveç rasteve përjashtimore, kur vetë ligji lejon pezullimin e afatit prekluziv.

Neni 138

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën janë caktuar afate prekluzive, që e bëjnë tejet të vështirë për njërën nga palët ushtrimin e së drejtës përkatëse.

Neni 139

Palët nuk mund të ndryshojnë urdhërimet ligjore që rregullojnë prekluzivitetin, dhe as mund të heqin dorë nga afati prekluziv i plotësuar kur ky afat është caktuar me dispozita ligjore të veçanta.

Neni 140

Afati prekluziv i plotësuar merret parasysh nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.

PJESA II
SENDET DHE PRONËSIA

TITULLI I
SENDET

Neni 141
Kuptimi juridik i sendit

Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale.

Llojet e sendeve
Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 143

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për të drejtat reale që kanë si objekt sende të paluajtshme, si dhe për paditë përkatëse, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e luajtshme zbatohen për të gjitha të drejtat e tjera.

Regjistrimi i sendeve

Neni 144

Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Regjistrohen edhe ato sende të luajtshme, për të cilat kërkohet shprehimisht nga ligji.

Frutat e sendit

Neni 145

Frutat natyrore të një sendi janë produktet që nxirren prej tij.

Derisa nuk janë ndarë nga sendi, ato janë pjesë përbërëse e tij.

Frutat civile nxirren nga sendet si rrjedhojë e gëzimit të të drejtave që kanë personat mbi to.

Frutat civile fitohen në bazë të kohëzgjatjes së të drejtave dhe kur këto janë bërë të kërkueshme.

Pjesët përbërëse të sendit

Neni 146

Është pjesë përbërëse e një sendi çdo gjë që është bashkuar me të dhe nuk mund të ndahet prej tij pa iu shkaktuar një dëm thelbësor.

Sendet aksesore

Neni 147

Aksesorë janë ato sende të luajtshme që janë destinuar për t'i shërbyer në mënyrë të vazhdueshme një sendi kryesor ose për ta zbukuruar atë.

Ky destinim bëhet nga pronari i sendit kryesor ose nga personi që ka një të drejtë reale mbi atë.

Neni 148

Çdo disponim i sendit kryesor përfshin edhe aksesorët e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe.

Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë.

Aksesori nuk e humbet këtë cilësi të tij në rastet kur është ndarë përkohësisht nga sendi kryesor.

TITULLI II
PRONËSIA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e pronësisë

Neni 149

Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Pronësia mbi pjesët përbërëse të sendit
Neni 150

Pronarit të sendit i takon pronësia edhe mbi pjesët përbërëse të tij.

Pronësia mbi frutat e sendit
Neni 151

Pronarit të sendit i takojnë frutat natyrore që prodhon sendi, përveç kur pronësia e tyre u është kaluar të tjerëve. Në këtë rast pronësia fitohet pasi të jenë ndarë nga sendi.

Personi që merr frutat duhet që brenda vleftës së tyre të shpërblejë shpenzimet e bëra për prodhimin dhe vjeljen e tyre.

Përkatësia e sendeve
Neni 152

Sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit.

Llojet e pasurisë publike caktohen me ligj.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarit
Neni 153
(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 21)

Askush nuk mund të shpronësohet ose t'i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publike dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë.

Neni 154

E drejta e pronësisë mbi tokën shtrihet gjer në lartësinë dhe thellësinë që është e dobishme për ushtrimin e saj, në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 155

Pronari i një toke, pasi më parë t'i ketë kërkuar fqinjit që të presë degët e pemëve dhe rrënjët që i futen në tokën e tij, ka të drejtë t'i presë vetë ato, në rast se i sjellin dëm, si dhe të vjelë frutat dhe t'i perdorë ato për vete.

Frutat që bien nga pemët mbi tokë, i përkasin pronarit të tokës ku ato kanë rënë.

Neni 156

Pronari i një toke që ndodhet buzë një rrjedhe uji ose burimi publik, ka të drejtë t'i përdorë ato deri në masën që nuk dëmton interesat e pronarëve të tokave të tjera, përveç kur përdorimi rregullohet me dispozita të veçanta.

Neni 157

Pronari i një toke mund t'i kërkojë në çdo kohë pronarit të tokës fqinje, që me shpenzime të përbashkëta, të vendosen në kufijtë e tokave të tyre shenja të dukshme dallimi ose t'i ndreqin ato kur janë të dëmtuara.

Kur kufiri ndërmjet dy tokave është i paqartë dhe pronarët nuk e përcaktojnë vetë atë, secili prej tyre mund të kërkojë saktësimin e tij nga gjykata.

Neni 158

Kur mbillen drurë e shkurre në kufijtë e pronave, pronarët janë të detyruar të mbajnë largësitë e caktuara me dispozita të veçanta e kur nuk ka të tilla, nga zakonet e vendit, përveç kur pronari fqinjë ka lejuar vetë ose kur kufiri është në një rrugë ose rrjedhë uji publike.

Në mungesë të këtyre rregullave, largësitë janë: tre metra për drurët me trup të lartë dhe dy metra për drurët e tjerë.

Këto largësi nuk zbatohen për drurët e shkurret, lartësia e të cilëve nuk e kalon murin ndarës të pronave.

Neni 159

Pronari është i lirë në përdorimin e sendit, pa dëmtuar të drejtat e personave të tjerë dhe brenda kufijve që caktohen nga ligji ose nga zakonet e mira. Ai nuk mund t'u krijojë fqinjëve shqetësime të tilla si zhurma, dridhje, futje të tymit, nxehtësive, avujve ose përhapje të tjera të ngjashme, të pengojë gëzimin e pronave të tyre, duke ndryshuar rrjedhat, prurjet ose cilësinë e ujërave që rrjedhin në tokën e tij ose të ujërave nëntokësorë, si dhe të përdorë ujërat që komunikojnë lirisht me ato të tokës së tjetrit, përveç kur këto shqetësime nuk kalojnë shkallën e zakonshme të tyre.

Pronari gjatë ushtrimit të të drejtave të tij, detyrohet të marrë masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit për rreth.

Neni 160

Pronarët duhet t'u përmbahen rregullave të caktuara në planet rregulluese ose në dispozita të veçanta, për ngritjen e ndërtesave të reja, për rindërtimin ose ndryshimin e tyre, për largësitë ndërmjet ndërtesave, për çeljen e dritareve, puseve, gropave e të punimeve të tjera të kësaj natyre.

Neni 161

Pronari është i detyruar të mbledhë ujërat që rrjedhin nga strehët e ndërtesave të tij, në mënyrë që ato të mos pikojnë mbi tokën e tjetrit.

Derdhja e tyre në një rrjedhë publike mund të bëhet kur nuk ndalohet nga rregullat që kanë caktuar organet kompetente.

Pronari është i detyruar të kujdeset që ujërat dhe mbeturinat që vijnë nga toka e tij të mos derdhen në kanalin ose në tokën e tjetrit, përveç kur ndërmjet tyre ka marrëveshje të kundërt.

KREU II
FITIMI DHE HUMBJA E PRONËSISË

Kalimi i pronësisë

Neni 162

E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.

Mënyra e fitimit të pronësisë
Neni 163

Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë.

Fitimi i pronësisë me kontratë
Neni 164

Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre.

Fitimi i pronësisë me trashëgim
Neni 165

Fitimi i pronësisë me trashëgim kryhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e pjesës së tretë të këtij Kodi.

Fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme
Neni 166

Personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij.

Megjithatë fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur.

Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë tek prurësi, edhe sikur këto t'i jenë vjedhur ose t'i kenë humbur pronarit ose personit juridik publik.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për sendet e luajtshme që janë të shënuara në regjistrat publike.

Prona fitohet e lirë nga të drejtat e tjetrit mbi sendin, në rast se këto të drejta nuk rrjedhin nga titulli dhe nga mirëbesimi i fituesit.

Neni 167

Në rast se pronësia mbi një send të luajtshëm u kalon me anë kontratash disa personave, bëhet pronar ai që ka fituar posedimin e sendit me mirëbesim, edhe sikur kontrata të jetë e një date të mëvonshme.

Parashkrimi fitues
Neni 168

Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi, pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm.

Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër.

Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme.

Neni 169

Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzetë vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj.

Regjistrimi i sendit të fituar me parashkrim

Neni 170

Personi që ka fituar me parashkrim një send të paluajtshëm ka të drejtë të paraqesë padi kundër personit të mëparshëm ose trashëgimtarëve të tij për njohjen e pronësisë së vet dhe, në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, të kërkojë që të kryhet regjistrimi i sendit nga organi kompetent shtetëror.

Pezullimi e ndërprerja e parashkrimit fitues

Neni 171

Dispozitat për pezullimin dhe ndërprerjen e parashkrimit të padisë zbatohen edhe për parashkrimin fitues.

Parashkrimi fitues ndërpritet me humbjen e posedimit. Nuk quhet ndërprerje kur poseduesi hyn përsëri në posedimin brenda gjashtë muajve ose edhe më vonë me anë padie të ngritur brenda gjashtë muajve.

Sendet pa zot

Neni 172

Sendet pa zot janë ato që nuk kanë pronar ose pronari i të cilave ka hequr dorë nga pronësia.

Sendet që nuk kanë zot i takojnë shtetit. Kalimi i tyre në pronësi të shtetit bëhet me vendim të gjykatës kompetente.

Fitimi i pronësisë me bashkim e përzierje

Neni 173

Mbjelljet, si dhe ndërtesat e çdo vepër tjetër që ndodhen mbi ose nën sipërfaqen e tokës, i përkasin pronarit të saj, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kod e në dispozita të tjera ligjore.

Neni 174

Pronari i tokës që ka bërë ndërtime e vepra të tjera dhe mbjellje me material të huaj, detyrohet të paguajë vleftën e tyre, në rast se nuk kërkohet ndarja e kthimi i tyre dhe kur kjo mund të kryhet pa u shkaktuar një dëm thelbësor ndërtimeve ose mbjelljeve të kryera.

Kur ndarja e materialeve është e mundshme dhe pronari i tokës ka vepruar me keqbesim, duhet t'i shpërblejë pronarit të materialeve dëmin e pësuar.

Neni 175

Kur ndërtesat e veprat e tjera dhe mbjelljet janë bërë nga një person i tretë me materialet e veta në tokën e tjetrit, pronari përkatës ka të drejtë t'i mbajë ato ose të kërkojë detyrimin e atij që i ka bërë t'i heqë ato me shpenzimet e tij, dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin.

Kur pronari i tokës pranon t'i mbajë, detyrohet të paguajë vleftën e matarialeve dhe të krahut të punës ose rritjen e vleftës që i është bërë pronës.

Pronari i tokës nuk mund t'i kërkojë heqjen e ndërtimeve e të mbjelljeve të kryera kur ato janë bërë me dijeninë e tij, ose me mirëbesim nga personi i tretë, si dhe kur kanë kaluar gjashtë muaj që nga dita kur pronari ka marrë njoftim për këto ndërtime e mbjellje.

Kur me mirëbesim është ngritur një ndërtesë në tokën e huaj dhe vlefta e saj është më e madhe se vlefta e tokës, personi që ka ngritur ndërtesën mund të njihet pronar edhe i tokës, me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 176

Kur dy ose më shumë sende të luajtshme që u përkasin pronarëve të ndryshëm janë bashkuar ose përzier në një send të vetëm e që nuk mund të ndahen pa u shkaktuar një dëm thelbësor njëri-tjetrit, ose kur ndarja kërkon punë e shpenzime të tepëruara, pronarët e secilit send bëhen bashkëpronarë të sendit të ri, në përpjestim me vleftën që pjesët e sendit kishin në momentin e bashkimit apo të përzjerjes së tyre.

Kur një send i luajtshëm është bashkuar ose përzier me një tjetër në mënyrë të tillë sa duket se është pjesë aksesore e tij, sendi i ri i përket pronarit të pjesës kryesore, i cili detyrohet të paguajë vleftën përkatëse, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Fitimi i pronësisë me përpunim

Neni 177

Personi që me punën e tij ka krijuar një send të ri të luajtshëm duke përdorur lëndën në pronësi të një personi tjetër, pavarësisht se lënda mund ose jo të marrë formën e saj të parë, bëhet pronar i sendit të ri në rast se vlefta e punës është më e madhe se ajo e lëndës, me kusht që të paguajë vleftën e saj.

Në rast të kundërt sendi i ri fitohet nga pronari i lëndës, duke paguar vleftën e punës.

Kur përpunuesi ka vepruar me keqbesim, me vendim të gjykatës sendi i ri i kalon pronarit të lëndës edhe në rast se vlefta e punës është më e madhe se ajo e lëndës, por duke paguar vleftën e kësaj të fundit.

Bashkimet e tokave nga aluvionet

Neni 178

Mbushjet me dhe të tokave e shtesat e tokës që formohen në mënyrë të natyrshme gjatë brigjeve të lumenjve a të përrenjve, i përkasin pronarit të tokës, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Tokat e liruara nga rrjedhat e ujit

Neni 179

Toka që lirohet nga një rrjedhë uji, e cila tërhiqet në mënyrë të natyrshme nga njëri breg dhe shkon në bregun tjetër, i përket pronarit të tokës nga e cila është larguar rrjedha.

Tokat e krijuara në shtratet e lumenjve

Neni 180

Ishujt dhe mbushjet me dhe që krijohen në shtratet e lumenjve janë pronë publike.

Neni 181

Kur një lum ose përrua ndërron shtrat duke e lënë të vjetrin, toka që lirohet është në pronësi të pronarëve kufitarë të dy anëve (buzëve) të lumit apo të përroit, të cilët e ndajnë atë deri në mesin e shtratit të lënë sipas gjatësisë së tij.

SENDET E HUMBURA OSE TË GJETURA

Njoftimi për gjetjen
Neni 182

Personi që ka gjetur një send të humbur, duke përfshirë edhe gjënë e gjallë të shkëputur nga tufa, është i detyruar të lajmërojë menjëherë pronarin ose personin që i ka humbur dhe kur ky nuk njihet, ta dorëzojë atë në bashkinë apo komunën, në territorin e së cilës është gjetur sendi.

Bashkia ose komuna është e detyruar të shpallë menjëherë gjetjen e sendit.

Marrja e sendit dhe pagimi i shpenzimeve
Neni 183

Pronari ose personi, të cilit i ka humbur sendi, ka të drejtë ta kërkojë atë brenda gjashtë muajve nga dita që është shpallur gjetja në bashkinë apo komunën përkatëse, pasi të ketë paguar shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit dhe një shpërblim për personin që ka gjetur sendin në masën 10% të vleftës së sendit, ose të çmimit të marrë, kur sipas rrethanave të paraqitura, shitja e tij ka qenë e domosdoshme.

Kur ka kundërshtime për vleftën e sendit, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Bashkia ose komuna mund të lejojë mbajtjen përkohësisht të sendit nga personi që e ka gjetur, të cilit i paguhen dhe shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit.

Sendet e humbura duhen të ruhen dhe të mirëmbahen me kujdesin e duhur.

Fitimi i pronësisë nga personi që ka gjetur sendin
Neni 184

Kur pronari ose personi që e ka humbur sendin nuk paraqiten për ta marrë atë brenda afatit të caktuar në nenin 183, sendi ose çmimi i shitjes i kalon në pronësi personit që e ka gjetur, i cili paguan shpenzimet e mbajtjes.

Sendet e gjetura në lokal
Neni 185

Sendet e gjetura në lokalet publike e private e në mjetet e transportit, duhen t'i dorëzohen menjëherë administratës së lokalit ku janë gjetur, e cila i ruan ato tri ditë. Kur nuk paraqitet pronari ose personi që i ka humbur, administrata i dorëzon ato në bashki apo në komunën përkatëse.

Thesari
Neni 186

Quhet thesar çdo send i çmueshëm, i cili duket me saktësi se ka qenë në tokë ose i fshehur prej shumë kohësh dhe që nuk mund t'i gjendet pronari.

Thesari i përket pronarit të sendit të luajtshëm apo të paluajtshëm ku është gjetur, përveç rasteve të sendeve me vlerë shkencore, kulturore, arkeologjike etj., të parashikuara nga neni 187 i këtij Kodi.

Personi që zbulon thesarin ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm që nuk duhet të kalojë gjysmën e vlerës së tij.

Pronësia e shtetit mbi një kategori sendesh të luajtshme
Neni 187

Sendet e luajtshme, me vlerë kulturore, historike, arkeologjike, etnografike, si dhe sendet natyrore të rralla me rëndësi shkencore që zbulohen, shkëputen ose nxirren nga toka ose uji, kalojnë në pronësi të shtetit.

Pronari, në pronën e të cilit janë zbuluar sende të tilla, është i detyruar të lejojë kryerjen e gërmimeve, duke u shpërblyer dëmet e pësuara.

Personi që ka zbuluar ose ka gjetur sende të tilla, ka të drejtë të marrë nga shteti një shpërblim të arsyeshëm.

Fitimi i pronësisë me anë pushtimi
Neni 188

Pronësia mbi sendet e luajtshme të abandonuara, si dhe mbi kafshët e egra, shpendët, peshqit, frutat e egra dhe mbi sendet e tjera të luajtshme të natyrës, fitohet me anë pushtimi, në kushte të caktuara me ligj ose në dispozita të veçanta.

Tufa e bletëve
Neni 189

Pronari i një tufe bletësh ka të drejtë ta ndjekë e ta marrë atë në tokën e tjetrit, duke shpërblyer dëmin e shkaktuar.

Kur pronari i bletës së ikur nuk e ka ndjekur atë brenda tri ditëve, ose kur ajo ka hyrë në një zgjua bletësh tjetër, pronësia mbi atë i kalon përkatësisht pronarit të tokës ku ka qëndruar bleta ose pronarit të zgjoit.

Fitimi i pronësisë me anë shpronësimi
Neni 190
(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 22)

Sendet mund të shpronësohen vetëm për interesa publike të njohur me ligj dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë. Ato kalojnë në pronësi të shtetit ose të enteve të tjera publike, në favor të të cilave është bërë shpronësimi.

Humbja e pronësisë
Neni 191

Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj.

Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet.

KREU III
REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 192

Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjëndjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtëshme.

Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjestimin vullnetar të tyre;

b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufrukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;

c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;

ç) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit dhe fitohet pasuria e trashëguar;

d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;

dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjestimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankant të tyre.

Vërtetimi gjyqësor i faktit të pronësisë nuk regjistrohet.

Neni 194

Në kontratën e dhurimit të pasurisë së paluajtshme, regjistrimi merr datën në të cilën regjistrohet pranimi, në rast se ky përmbahet në një akt të veçantë.

Neni 195

Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publike.

Neni 196

Gjykatat, noterët, përmbaruesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë.

Neni 197

Duhen të regjistrohen gjithashtu:

a) kontratat e qiradhënies së sendeve të paluajtshme për një kohë mbi nëntë vjet;

b) kërkesë-paditë për fitimin, njohjen, ndryshimin ose pushimin e të drejtave të pronësisë ose të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme;

c) kërkesë-paditë për pjestimin e pasurisë së paluajtshme të përbashkët.

Neni 198

Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrit publik për pasuritë e paluajtshme.

Kushtet, mënyra e regjistrimit dhe e organizimit, si dhe çdo procedurë që ka lidhje me këtë veprimtari, rregullohet me ligj të veçantë.

TITULLI III
BASHKËPRONËSIA

KREU I
BASHKËPRONËSIA NË PJESË

Përkufizimi dhe përmbajtja
Neni 199

Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave.

Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta.

Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjestim me pjesët përkatëse.

Të drejtat e bashkëpronarëve
Neni 200

Çdo bashkëpronar ka këto të drejta:

a) të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjestim me pjesën e tij;

b) të përdorë sendin e përbashkët sipas qëllimit të përcaktuar dhe në mënyrë që të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë të përdorin atë sipas të drejtave të tyre;

c) të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë sipas nenit 204 të këtij Kodi;

ç) të kërkojë pjestimin e sendit të përbashkët edhe sikur të ketë një marrëveshje të kundërt, përveç kur ky pjestim dëmton së tepërmi qëllimin përkatës ose është ndaluar me ligj;

d) të kërkojë kthimin jo vetëm të pjesës së tij, por të gjithë sendit të përbashkët, me kusht që ky t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Detyrimet e bashkëpronarit
Neni 201

Çdo bashkëpronar është i detyruar që në përpjestim me pjesën e vet, të paguajë shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe gëzimin e sendit të përbashkët.

Neni 202

Kur sendin e përbashkët e përdorin për vete një ose disa bashkëpronarë, këta detyrohen t'u paguajnë bashkëpronarëve të tjerë shpërblimin për përdorimin e pjesëve të tyre nga dita kur u është njoftuar me shkrim kërkesa e këtij shpërblimi ose nga data e paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente.

Administrimi i sendit të përbashkët
Neni 203

Të gjithë bashkëpronarët, pavarësisht nga vlera e pjesës përkatëse, kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e sendit të përbashkët.

Sendi i përbashkët administrohet sipas mënyrës së miratuar me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve dhe kur kjo nuk është arritur, sipas mënyrës së caktuar me vendim tee bashkëpronarëve që

kanë më shumë se gjysmën e vleftës së tij. Vendimi i shumicës është i detyrueshëm edhe për bashkëpronarët që kanë mbetur në pakicë.

Kjo shumicë mund të vendosë që të vihet hipotekë ose peng mbi sendin e përbashkët, kur kjo është e domosdoshme për të siguruar kthimin e shumave të marra hua për mirëmbajtjen ose rindërtimin e tij.

Kur nuk është arritur kjo shumicë ose kur vendimi i saj është i dëmshëm për sendin e përbashkët, gjykata kompetente, me kërkesën e çdo bashkëpronari, vendos masat që i çmon të nevojshme dhe, sipas rastit, emëron një kujdestar për administrimin e sendit.

E drejta e parablerjes

Neni 204

Bashkëpronari, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda tre muajve se dëshërojnë të blejnë pjesën, bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë.

Ai duhet t'ua bëjë të njohur bashkëpronarëve të tjerë bashkëpronarin e ri.

E drejta e kreditorit mbi pjesën e bashkëpronarit

Neni 205

Çdo kreditor ka të drejtë të realizojë kredinë e vet mbi pjesën që i takon bashkëpronarit debitor në sendin e përbashkët.

Neni 206

Kreditorët dhe trashëgimtarët e ndonjë bashkëpronari mund të ndërhyjnë në pjesëtim, me shpenzimet e tyre, por nuk mund të kundërshtojnë pjesëtimin e bërë më parë, përveç kur kanë njoftuar kundërshtimin e tyre para pjesëtimit.

Në pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, njoftimi për kundërshtimet e përmendura në paragrafin e mësipërm, duhet të regjistrohet përpara regjistrimit të kërkesës për pjesëtim. Gjithashtu, në një pjesëtim të tillë duhet të thirren të gjithë kreditorët që kanë regjistruar kërkesat e tyre ose që kanë fituar të drejta mbi pasurinë që pjestohet, përpara regjistrimit të aktit të pjesëtimit ose të regjistrimit të kërkesës për pjesëtim.

Pjesëtimi i sendit të përbashkët

Neni 207

Pjesëtimi i sendit të përbashkët kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve. Kur sendi është i paluajtshëm marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial. Kur kjo marrëveshje nuk është arritur, pjesëtimi i sendit kryhet me anë të gjykatës, duke u thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët. Pjesëtimi i sendit të përbashkët bëhet me ndarjen e tij në natyrë sipas pjesëve që kanë bashkëpronarët, në qoftë se kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin përkatës të sendit. Pabarazia e pjesëve, që rezulton nga ndarja në natyrë kompensohet me një shpërblim në para.

Kur sendi i përbashkët nuk mund të ndahet në natyrë gjykata urdhëron që ai të shitet në ankand dhe vlefta e tij të ndahet ndërmjet bashkëpronarëve, sipas pjesëve përkatëse, duke llogaritur edhe shumat që ata duhet t'i paguajnë njëri-tjetrit për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë.

Megjithatë, në vend të shitjes në ankand, gjykata, kur disa nga bashkëpronarët e kërkojnë, mund të urdhërojë që sendi t'u lihet këtyre, duke i detyruar që t'i paguajnë bashkëpronarit, i cili kërkon pjesëtimin, vleftën e pjesës së tij, sipas mënyrës dhe brenda afateve të caktuara në vendimin gjyqësor.

Kur sendi që nuk mund të ndahet në natyrë, është shtëpi banimi, gjykata ia lë në pjesë, në kushtet e sipërtreguara, atij nga bashkëpronarët që banon në atë shtëpi ose ka nevojë më shumë se të tjerët për atë sipërfaqe banimi.

Tjetërsimi i sendit të përbashkët
Neni 208

Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.

KREU II
BASHKËPRONËSIA NË TËRËSI

A. Bashkëpronësia e detyrueshme

Objektet e përbashkëta të ndërtesave
Neni 209

Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:

a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;

b) puset, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësive të ndara të kateve.

Neni 210

E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe.

Heqia dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk e liron bashkëpronarin nga detyrimi për të kontribuar në shpenzimet për mbajtjen e tyre.

Pandashmëria e objekteve të përbashkëta
Neni 211

Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Përbërja e asamblesë dhe zgjedhja e kryesisë
Neni 212

Asambleja përbëhet nga pronarët e secilit kat ose njësie të ndarë të çdo kati, të cilët kanë në bashkëpronësi objektet e përbashkëta të ndërtesës.

Në mbledhjen e parë të asamblesë anëtarët e saj zgjedhin, nga gjiri i tyre, kryesinë, e cila ngarkohet të kryejë, në emër e për llogari të tyre të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve të përbashkëta, përveç atyre veprimeve që janë në kompetencë vetëm të asamblesë, si dhe të përfaqësojë në instancat gjyqësore kompetente dhe në arbitrazh.

Mbledhjet e asamblesë dhe vlefshmëria e vendimeve
Neni 213

Pas mbledhjes së parë organizuese, mbledhjet e asamblesë thirren një herë në vit. Mbledhje të tjera të asamblesë mund të thirren nga kryesia e saj ose me nismën e jo më pak se 20% të anëtarëve të saj.

Asambleja mund të çelet dhe të marrë vendime kur janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, të cilët kanë të paktën dy të tretat e tërësisë së kuotave. Kur ky numër nuk është i pranishëm, mbledhja shtyhet dhe mbledhja pasardhëse zhvillohet në rast se merr pjesë shumica e zakonshme e bashkëpronarëve.

Vendimet e asamblesë merren me shumicë të thjeshtë votash të bashkëpronarëve, përveç rasteve kur në dispozitat e këtij kreu ose me dispozita të veçanta kërkohet një shumicë e cilësuar. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Kompetencat kryesore të asamblesë
Neni 214

Asambleja ka edhe këto kompetenca kryesore:

1. Miraton rregulloren për administrimin e banesës, e cila hartohet sipas rregullores tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Krijon fondin rezervë për shpenzimet e përbashkëta, duke caktuar edhe shumën vjetore të tij.

3. Miraton preventivat e shpenzimeve që ka vendosur të kryhen gjatë vitit, si dhe ndarjen e shumës së tyre midis bashkëpronarëve.

Shpenzimet e përbashkëta për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme të këtyre objekteve miratohen nga asambleja me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa shpenzimet për përmirësime të mëdha ose rinësime cilësore vendosen me shumicë të cilësuar të bashkëpronarëve që arrijnë të paktën 75% të kuotave përkatëse.

4. Emëron, kur çmohet e domosdoshme, kujdestarin e ndërtesës, duke caktuar kompetencat dhe pagën e tij.

5. Autorizon kryesinë që të sigurojë, brenda kufijve të arsyeshme, objektet që janë pronë e përbashkët, si dhe të lidhë kontrata të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme, ose, sipas rastit, për përmirësime të mëdha apo rinësime të këtyre objekteve.

Neni 215

Vendimet e marra nga asambleja sipas dispozitave të mësipërme janë të detyrueshme për të gjithë bashkëpronarët.

Padia kundër vendimeve të asamblesë
Neni 216

Kur një vendim i asamblesë është i paligjshëm ose cenon interesat e ndonjërit nga bashkëpronarët e këtyre objekteve, çdo bashkëpronar ka të drejtë të paraqesë në gjykatën kompetente padi për pavlefshmërinë e atij vendimi, brenda tridhjetë ditëve nga data e dhënies së tij. Paraqitja e kërkesë-padisë nuk pezullon zbatimin e vendimit të asamblesë, përveç kur gjykata ka vendosur ndryshe.

Detyrimet e bashkëpronarëve
Neni 217

Çdo bashkëpronar ka këto detyrime:

1. Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve, në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Për sendet që u shërbejnë bashkëpronarëve në masë të ndryshme, shpenzimet përballohen në përpjesëtim me përdorimin që mund t'u bëjë atyre secili.

Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve në përpjesëtim me vleftën e pjesës të secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

2. Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t' u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës.

3. Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimin e tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj, cilitdo objekti të përbashkët.

4. Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të cenojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.

Shtesa të reja mbi katin e fundit

Neni 218

Ndërtimi mbi katin e fundit të një ndërtese, të kateve ose veprave të tjera, mund të realizohet me vendimin e shumicës prej 3/4 të bashkëpronarëve të ndërtesës.

Neni 219

Ndalohet dhënia e lejes për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit në qoftë se kushtet statike të ndërtesës nuk e lejojnë.

Bashkëpronarët mund të kundërshtojnë lejen e dhënë nga organi kompetent shtetëror për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit dhe kur provohet se ato pakësojnë ajrin apo dritën për katet e mëposhtme ose cenojnë pamjen arkitektonike të ndërtesës.

Neni 220

Ata që janë lejuar të bëjnë shtesa ose vepra të tjera në katin e fundit detyrohen të rindërtojnë taracën, të cilën të gjithë ose një pjesë e bashkëpronarëve kishin të drejtë ta përdornin.

Shëmbja tërësore ose pjesore e ndërtesës

Neni 221

Kur ndërtesa shëmbet tërësisht ose në një pjesë që përbën jo më pak se tre të katërtat e vlerës së saj, secili bashkëpronar mund të kërkojë që të shiten në ankand trualli dhe materialet, përveç kur është vendosur ndryshe.

Kur ndërtesa është dëmtuar në një përmasë më të vogël, asambleja vendos për rindërtimin e objekteve të përbashkëta të ndërtesës dhe secili bashkëpronar i tyre detyrohet të kontribuojë në përpjesëtim me të drejtat e tij në ato objekte.

Bashëpronari që nuk dëshiron të marrë pjesë në rindërtimin e ndërtesës, duhet t'u shesë bashkëpronarëve të tjerë ose ndonjërit prej tyre edhe objektet, të cilët janë pronë vetëm e tij, sipas vlerësimit që do të bëhet.

B. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore

Neni 222

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 223

Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martese, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

Neni 224

Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj.

Neni 225

Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim.

Neni 226

Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj.

Neni 227

Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

a) pasurinë që i përket tërë familjes;

b) numrin e anëtarëve të familjes;

c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 228

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në nenin 207 të këtij Kodi.

Kur kërkohet pjesa nga anëtarë të veçantë të saj, ajo vlerësohet dhe i jepet në para.

Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit.

Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore, që është e nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse.

Neni 229

Familja bujqësore përgjigjet për veprimet e paligjshme të kryera nga anëtarët e saj, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore.

Neni 230

Familja bujqësore nuk përgjigjet për detyrimet ekonomike vetjake të anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e saj. Kreditorët kanë të drejtë të paguhen nga pjesa që i takon anëtarit debitor në të ardhurat e familjes bujqësore dhe nga pjesa që i takon atij në pasurinë e familjes bujqësore.

C. Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve

Neni 231

Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes.

TITULLI IV
UZUFRUKTI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e uzufruktit
Neni 232

Uzufrukti është e drejta e një personi (uzufruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.

Mënyra e krijimit të uzufruktit
Neni 233

Uzufrukti krijohet me ligj ose me një veprim juridik. Ai mund të fitohet edhe me parashkrimin fitues.

Kohëzgjatja e uzufruktit
Neni 234

Uzufrukti mund të jetë me ose pa afat, por në çdo rast nuk mund të kalojë jetën e uzufruktarit.

Kur e drejta e uzufruktit gëzohet nga një person juridik, nuk mund të zgjasë më shumë se tridhjetë vjet.

Mënyra e krijimit
Neni 235

Uzufrukti që krijohet me veprim juridik duhet të bëhet me akt noterial, ndërsa kur fitohet me testament veprohet sipas dispozitave përkatëse.

Uzufrukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Bashkuzufrukti
Neni 236

Uzufrukti mund të jetë në favor të më shumë se një personi. Kur e drejta e njërit prej tyre shuhet, ajo u kalon uzufruktarëve që mbeten, në përpjesëtim me pjesët. Në këtë mënyrë veprohet deri në shuarjen e së drejtës së uzufruktarit të fundit që mbetet.

KREU II
TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI

Kufijtë e gëzimit të sendit në uzufrukt
Neni 237

Uzufruktari gëzon sendin e vënë në uzufrukt, por nuk mund të ndryshojë destinimin ekonomik që ka patur ai në fillim të uzufruktit, pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, kur pronari dhe uzufruktari nuk merren vesh.

Gjatë vazhdimit të uzufruktit ose në mbarimin e tij, uzufruktari mund të heqë shtesat që i janë bërë sendit, në kushtet e paragrafit të parë të këtij neni, që mund të shkëputen pa e dëmtuar atë, duke e kthyer në gjendjen e tij fillestare, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Përmirësimet e sendit në uzufrukt
Neni 238

Uzufruktari në mbarim të uzufruktit nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për përmirësimet e bëra në send gjatë përdorimit edhe sikur të jetë shtuar vlefta e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të uzufruktit.

Shtesa e vleftës mund të kompensohet me dëmet që mund t'i jenë shkaktuar sendit pa fajin e uzufruktarit.

Kur nuk ka vend për kompensim, uzufruktari mund të heqë shtesat e bëra, pa u dëmtuar sendi, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre, si të ishin të ndara nga sendi.

Përkatësia e frutave
Neni 239

Uzufruktarit i takojnë frutat natyrore dhe ato civile që prodhon sendi gjatë kohëvazhdimit të uzufruktit.

Frutat natyrore që nuk janë ndarë nga sendi në kohën e fillimit të uzufruktit, i përkasin uzufruktarit dhe anasjelltas, kur ato nuk janë ndarë nga sendi kur mbaron uzufrukti, i përkasin pronarit.

Kalimi i së drejtës së uzufruktit
Neni 240

Uzufruktari mund t'ia kalojë një tjetri këtë të drejtë për një kohë ose për gjithë kohën e qënies së saj, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Kalimi duhet t'i njoftohet me shkrim pronarit, përndryshe uzufruktari i mëparshëm dhe personi që ka fituar një të drejtë të tillë përgjigjen solidarisht ndaj pronarit.

E drejta e tjetërsimit
Neni 241

Uzufruktari ka të drejtë të tjetërsojë sendet objekt uzufrukti në masën që ato destinohen të tjetërsohen dhe në përputhje me natyrën e tyre.

Në raste të tjera uzufruktari nuk mund të tjetërsojë sendet në uzufrukt pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Autorizimi nuk duhet të jepet kur preken interesat e pronarit, uzufruktarit ose të personave të tretë.

Zëvendësimi i sendit në uzufrukt
Neni 242

Kur sendet në uzufrukt janë tjetërsuar ose janë zëvendësuar me sende të tjera, këto i përkasin pronarit dhe njëkohësisht janë objekt i uzufruktit.

Rregulli i mësipërm vlen për gjithçka që sigurohet nga vjelja e detyrimeve objekt uzufrukti, nga kompensimi për shpërblimin e dëmeve ose nga zhvleftësimi i pasurisë, kur zëvendësojnë ose përmirësojnë sendet objekt uzufrukti.

Janë gjithashtu objekt uzufrukti, sendet që vilen nga përfitimet e tjera që jep uzufrukti, por që nuk janë fruta.

Investimet
Neni 243

Pronari dhe uzufruktari duhet të merren vesh që paratë objekt uzufrukti të investohen në mënyrë frutdhënëse ose të shpenzohen në interes të pasurisë tjetër në uzufrukt.

Dhënia me qira
Neni 244

Uzufruktari ka të drejtë të japë me qira sendet në uzufrukt përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të tij.

Kur mbaron uzufrukti, pronari duhet të respektojë qiranë e filluar normalisht më parë, përveç kur zgjatja e afatit të saj është bërë pa pëlqimin e tij. Kur uzufruktari ose qiramarrësi i kanë kërkuar pëlqimin pronarit për qiradhënien dhe ky nuk është përgjigjur në afatin e caktuar, quhet se pëlqimi është dhënë.

Kur pushon uzufrukti, qiradhëniet për një afat mbi pesë vjet, kanë vlerë vetëm për pesë vjet nga dita që ka filluar qiradhënia.

Gëzimi i servituteve
Neni 245

Uzufruktari gëzon të drejtat e servituteve të lidhura me pronën mbi të cilën ka uzufruktin dhe të drejtat e tjera reale që do t'i gëzonte vetë pronari, përveç kufizimeve të parashikuara në aktin e krijimit apo në ligj.

KREU III
DETYRIME QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI

Zëvendësimi i dëmeve
Neni 246

Uzufruktari detyrohet të shpërblejë vleftën e sendit të humbur ose të dëmtimit të tij, përveç kur provon se nuk janë shkaktuar për fajin e tij.

Ai detyrohet të zëvendësojë sendet që, sipas uzufruktit, nuk kishte të drejtë t'i konsumonte.

Inventaret
Neni 247

Uzufruktari merr në dorëzim sendet në gjëndjen që ndodhen para fillimit të uzufruktit.

Sendet në uzufrukt merren në dorëzim me inventar të bërë me akt noterial, në prani të pronarit, pasi të jetë njoftuar në një afat të përshtatshëm. Është e drejtë e palëve që në inventar të shënohen të gjitha hollësitë që kanë lidhje me përcaktimin dhe gjëndjen e sendeve që merren në uzufrukt.

Inventari mund të kryhet edhe me akt privat, kur bien në marrëveshje të dy palët, që janë të pranishëm gjatë kryerjes së tij. Shpenzimet për kryerjen e inventarit janë në ngarkim të uzufruktarit, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Njoftimet periodike
Neni 248

Uzufruktari detyrohet t'i dërgojë pronarit në fund të çdo viti një njoftim të hollësishëm me shkrim të nënshkruar prej tij, për sendet që nuk ekzistojnë më ose për sendet që i kanë zëvendësuar ato, si dhe përfitimet e tjera nga sendet në uzufrukt, që nuk hyjnë në kategorinë e frutave.

Shpenzimet për kryerjen e detës vjetore, janë në ngarkim të uzufruktarit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Dhënia e garancisë
Neni 249

Uzufruktari detyrohet t'i japë pronarit një garanci me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga uzufrukti, përveç kur në aktin e krijimit është shkarkuar nga një detyrim i tillë ose kur interesat e pronarit mbi sendet në uzufrukt janë siguruar në mënyrë të mjaftueshme nga një institut i ngarkuar me këtë punë.

Prindërit që kanë uzufruktin ligjor mbi sendet në pronësi të fëmijëve të tyre, përjashtohen nga dhënia e një garancie të tillë.

Kur uzufruktari është shkarkuar nga detyrimi për dhënien e garancisë, pronarit i lind e drejta të kërkojë prej tij që t'i tregohen çdo vit sendet që i janë dhënë në uzufrukt ose të njihet me njoftimin e një institucioni krediti për paratë apo letrat me vlerë të depozituara.

Uzufruktari nuk mund të fitojë posedimin e sendeve të vëna në uzufrukt, pa plotësuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen.

Pasojat e mosdhënies së garancisë
Neni 250

Kur uzufruktari nuk jep garanci, merren masa për administrimin e sendeve në uzufrukt. Sendet e paluajtshme jepen me qira ose i besohen një administratori të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet

pronarit e administratorit dhe kur nuk arrihet një marrëveshje e tillë, administratori caktohet nga gjykata e rrethit.

Uzufruktari ka të drejtë të mbajë për banim të tij dhe të familjes së tij, një banesë që përfshihet në uzufrukt.

Paratë që përfshihen në uzufrukt investohen me kamatë.

Sendet e luajtshme që vjetërohen ose dëmtohen nga përdorimi ose sendet ushqimore që rrezikohen të prishen, shiten dhe vlefta e tyre jepet me kamatë ose përdoret për sendet në uzufrukt.

Uzufruktari mund të kërkojë t'i lihen sende të luajtshme të mjaftueshme për përdorim vetjak.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

Neni 251

Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sendit janë në ngarkim të uzufruktarit. Janë gjithashtu në ngarkim të tij edhe shpenzimet për ndreqjet jo të zakonshme, kur ato janë rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të tij ndaj sendit në uzufrukt.

Riparimet e jashtëzakonshme janë në ngarkim të pronarit. Kur pronari refuzon t'i kryejë ato ose të tjerat që i janë ngarkuar atij, ose vonon pa arsye kryerjen e tyre, uzufruktari i kryen vetë me shpenzimet e tij, të cilat shlyhen deri në përfundimin e uzufruktit. Uzufruktari ka të drejtë të mbajë sendin e ndrequr deri në shlyerjen e shpenzimeve.

Sigurimi i uzufruktit

Neni 252

Uzufruktari duhet të sigurojë sendet në uzufrukt në favor të pronarit për rreziqet që zakonisht ato duhet të sigurohen ose që janë të detyrueshme nga ligji. Në rast dëmtimi uzufrukti shtrihet mbi shpërblimin e paguar.

Kur uzufrukti nuk përmbush një detyrim të tillë, pronari ka të drejtë të bëjë vetë sigurimin e pronës dhe uzufruktari detyrohet t'i paguajë shpenzimet përkatëse.

Shpronësimi i sendeve në uzufrukt

Neni 253

Kur sendi shpronësohet për interesa publike, uzufrukti kalon mbi shpërblimin përkatës.

Pagimi i taksave dhe i detyrimeve të tjera

Neni 254

Tatimet, taksat, shpëblimet, rentat tokësore dhe detyrimet e tjera vjetore që kanë lidhje me të ardhurat gjatë uzufruktit janë në ngarkim të uzufruktarit.

Tatimet, taksat e detyrimet e tjera në ngarkim të pronës gjatë uzufruktit, janë në ngarkim të pronarit.

KREU IV
MBARIMI I UZUFRUKTIT

Neni 255

Uzufrukti mbaron:

- me vdekjen e uzufruktarit ose me mbarimin e personit juridik uzufruktar;
- me mbarimin e afatit të caktuar në aktin e krijimit;

- me bashkimin e cilësive të pronarit e të uzufruktarit në një person të vetëm;
- me shkatërrimin tërësisht ose humbjen e sendit të dhënë në uzufrukt;
- me mospërdorimin e uzufruktit radhazi për njëzetë vjet.

Pushimi i uzufruktit
Neni 256

Uzufrukti mund të pushojë kur uzufruktari shpërdoron të drejtat ose nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzufrukti.

Megjithatë gjykata, sipas rrethanave që do të rezultojnë mund të urdhërojë që uzufruktari t'i japë garanci, në rast se ka qënë shkarkuar nga një detyrim i tillë, ose me kërkesën e pronarit t'i lihet atij administrimi i sendit në uzufrukt ose një personi tjetër ose dhe dhënia me qira e sendit.

Heqja dorë nga uzufrukti
Neni 257

Uzufruktari mund të kërkojë që, me shpenzimet e tij, të heqë dorë nga uzufrukti për shkak të barrëve e detyrimeve që rrjedhin prej tij.

Kthimi i sendeve në uzufrukt
Neni 258

Kur mbaron uzufrukti, uzufruktari ose trashëgimtarët e tij detyrohen të vënë në dispozicion të pronarit sendet e vëna në uzufrukt.

TITULLI V
PËRDORIMI E BANIMI

Neni 259

Personi që ka një të drejtë thjesht përdorimi mbi një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij.

Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë.

Neni 260

Dispozitat që kanë lidhje me uzufruktin zbatohen dhe për të drejtën e përdorimit dhe të banimit, për aq sa përputhen me këto të drejta.

TITULLI VI
SERVITUTET

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 261

Servituti është barra që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një prone të një pronari tjetër.

Neni 262

Servituti vendoset me ligj ose me vullnetin e njeriut.

Neni 263

Pronari i pronës shërbyese nuk është i detyruar të kryejë ndonjë veprim për të bërë të mundur ushtrimin e servitutit, përveç kur në ligj ose nga titulli, parashikohet ndryshe.

Neni 264

Pronari, në favor të të cilit është vënë servituti, detyrohet t'i shpërblejë pronarit të pronës shërbyese dëmin që i shkaktohet nga krijimi i servitutit.

KREU II
SERVITUTET DETYRUESE

Neni 265

Pronari i një prone që, në bazë të ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga pronari i një prone tjetër krijimin e një servituti, në mungesë të një marrëveshjeje, mund t'i drejtohet gjykatës.

Servituti detyrues mund të krijohet edhe me akt të organit shtetëror, në rastet e parashikuara me ligj.

Vendimi duhet të përcaktojë rregullat e ushtrimit të servitutit dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Rrjedhja e ujërave

Neni 266

Pronari është i detyruar të pranojë në tokën e tij ujërat e shiut, të borës ose të burimeve të pashfrytëzuara, që rrjedhin natyrshëm nga një tokë me nivel më të lartë. Pronari nuk mund të ndryshojë këtë rrjedhë natyrore në dëm të një tjetri.

Uji që rrjedh mbi një tokë të mëposhtme mund të mbahet nga pronari i tokës së mësipërme, vetëm në masën që është e domosdoshme për atë tokë.

Neni 267

Në rastet kur anëbrigjet dhe shpatet e një prone që shërbenin për të ndaluar ujërat, janë shkatërruar ose dëmtuar, si dhe kur del e nevojshme që nga shkaku i ujërave të ndërtohen mbrojtësa

dhe pronari i asaj prone nuk pranon t'i ndërtojë ose t'i riparojë, pronarët e dëmtuar ose që rrezikohen të dëmtohen, mundet që me shpenzimet e tyre t'i ndërtojnë ose t'i riparojnë ato.

Këto ndërtime e riparime duhet të kryhen pa iu shkaktuar pronarit të pronës shërbyese ndonjë dëm, duke respektuar rregullat e posaçme, kur ka të tilla. Kur pronari i pronës shërbyese ka kundërshtime, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Neni 268

Dispozitat e nenit të mësipërm zbatohen edhe kur del e nevojshme të hiqet një pengesë lëndësh të formuara në një pronë tjetër ose në një hendek, rrjedhë uji ose vijë kulluese, të cilat dëmtojnë pronat fqinje.

Neni 269

Pronari që ka një burim uji në pronën e vet është i lirë në përdorimin e tij, por pa cenuar të drejtat që mund të ketë fituar pronari i pronës më të ulët në bazë të një titulli ose me parashkrim.

Neni 270

Në rast se një rrjedhë uji u ndalon pronarëve të pronave ngjitur, hyrjen në këto ose vazhdimin e vaditjes apo të kullimit të ujërave, ata që përdorin këtë rrjedhë, detyrohen që në proporcion me përfitimin që nxirret prej tij (ujit) të ndërtojnë e të mirëmbajnë urat e mjetet e tjera të kalimit, në mënyrë të volitshme e të sigurt, si dhe gypat e nëndheshëm ose vepra të tjera të kësaj natyre për vazhdimin e ujitjes e të kullimit.

Neni 271

Pronari i një toke detyrohet të pranojë pa shpërblim ujërat që vijnë nga drenazhimi i një toke të mësipërme, kur ato rrjedhin natyrshëm në tokën e tij.

Kur nga kjo rrjedhë i shkaktohet dëm, ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe marrjen e masave për mënjanimin në të ardhmen.

Servitutet që rrjedhin nga ndërtimet

Neni 272

Rregullat për ndërtimin e banesave e të ndërtimeve të tjera, largësia ndërmjet tyre, marrja e dritës dhe e pamjes, nxjerrja e ballkoneve e ndërtime të tjera të kësaj natyre, rregullohen me ligj të veçantë duke respektuar të drejtat e pronarit të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Servitutet që rrjedhin nga marrja e ujit

Neni 273

Kalimi i ujërave nëpër pronën e tjetrit duhet të kryhet në mënyrën më të volitshme e më të përshtatshme me më pak dëme, por pa penguar ushtrimin normal të servitutit.

Neni 274

Kur kalimi i ujërave kërkohet për një kohë jo më të gjatë se nëntë vjet, pagimi i vleftës dhe i shpërblimit të dëmeve të përmendura në dispozitën e mësipërme bëhet në gjysmën e kësaj vlefte, me detyrimin që me mbarimin e afatit të rivihet gjithçka në gjendjen e mëparshme.

Ky servitut mund të bëhet i përhershëm kur kjo kërkohet para mbarimit të afatit, nëpërmjet pagimit të gjysmës tjetër, të vleftës së bashku me kamatat ligjore, nga data që ka filluar kalimi.

Kur kërkesa bëhet pas mbarimit të afatit, nuk merren parasysh pagesat për dhënien përkohësisht të kësaj të drejte.

Neni 275

Kur kalimi i ujërave duhet të kryhet duke përshkuar rrugë publike ose lumenj e ndërtime të tjera publike, zbatohen rregullat e parashikuara në dispozita të veçanta.

Neni 276

Kur në një shtëpi ose në mjediset e tjera të saj mungon uji i nevojshëm për jetesën e njerëzve ose të kafshëve dhe nuk mund të sigurohet ndryshe, ose nevojiten shpenzime të mëdha, pronari i tokës fqinje duhet të lejojë që një sasi uji tepricë të përdoret në masën e domosdoshme për nevojat e mësipërme, duke përballuar pala tjetër vleftën e ujit që kërkohet dhe shpenzimet që duhet të kryhen për këtë qëllim, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin që mund të shkaktohet.

Servituti i kalimit

Neni 277

Pronari që nuk ka dalje në rrugën publike dhe nuk mund ta sigurojë atë përveç se me shpenzime të mëdha e me vështirësi, ka të drejtë të ketë rrugë kalimi nga toka fqinje, për përdorimin e përshtatshëm të pronës së vet.

Kalimi duhet të përbëjë rrugën më të shkurtër për në rrugën publike dhe me më pak dëme për pronën shërbyese.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur pronari, që i është njohur e drejta e kalimit në pronën e tjetrit, kërkon zgjerimin e arsyeshëm të rrugë-kalimit për mjete, duke përfshirë edhe kalimin e mjeteve mekanike.

Neni 278

Pronari duhet të lejojë fqinjin të hyjë e të kalojë në tokën e tij sa herë ka nevojë të ndërtojë ose të ndreqë një mur apo një vepër tjetër. Ai duhet të lejojë personin që të kërkojë e të marrë gjënë e gjallë e çdo send tjetër të tij, që ndodhen aty rastësisht ose si rrjedhim i erës, ujit, orteqeve dhe forcave të tjera madhore, ndodhen në tokën e tij apo janë bashkuar me sende të tij.

Pronari mund të mos lejojë hyrjen kur merr përsipër të dorëzojë vetë sendin e ndodhur në tokën e tij. Kur është rasti pronari i tokës shpërblehet për dëmin e shkaktuar.

Neni 279

Personi që do të kalojë në tokën e tjetrit, duhet të paguajë vleftën e tokës që zihet, pa zbritur tatimet e barrët e tjera që lidhen me tokën, si dhe shpërblimin për dëmin që shkaktohet duke përfshirë edhe dëmin që vjen nga ndërprerja e tokës, nga mospërdorimi i saj, nga depozitimi i lëndëve të nxjerra e hedhja e mbeturinave. Pronari i tokës shërbyese ka të drejtë të largojë këto të fundit dhe ta përdorë sipërfaqen e tokës, por gjithnjë pa dëmtuar ushtrimin normal të servitutit.

Servituti për vendosjen e gypave, kabllove e telave

Neni 280

Pronari duhet të lejojë persona të tjerë që të ndërtojnë në pronën e tij të paluajtshme kanale ose të vendosin gypa për kalimin e ujit ose të gazit, si dhe kabllo e tela telegrafikë ose elektrikë dhe instalime të tjera të kësaj natyre, por vetëm kur këto vepra nuk kanë mundësi të kryhen ndryshe ose pa u bërë shpenzime të mëdha. Pronari, kur i shkaktohet dëm, ka të drejtë të shpërblehet.

KREU III
SERVITUTET VULLNETARE

Neni 281

Pronari mund të krijojë mbi pronat e veta ose në dobi të tyre, çdo lloj servituti, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik.

Servitutet vullnetare krijohen me kontratë ose me testament.

Neni 282

Servitutet janë vijuese kur ushtrimi i tyre bëhet pa qenë nevoja për veprime të herëpasherëshme të njeriut, siç janë vijat e ujit, pikat e strehëve e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet janë jo vijuese, kur në ushtrimin e tyre kërkohet kryerja e veprimeve të tashme të njeriut, siç janë e drejta për të marrë ujë, për kullotjen e bagëtive e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet mund të jenë të dukshme e të padukshme.

Të padukshme janë servitutet për të cilat nuk nevojiten punime të dukshme ose të përhershme, që janë të nevojshme për ushtrimin e tyre.

Neni 283

Servitutet vijuese e të dukshme krijohen me titull ose me parashkrimin dhjetë vjeçar.

Servitutet vijuese të padukshme dhe servitutet jo vijuese, të dukshme ose jo, nuk mund të krijohen veçse me titull.

Neni 284

Kur dy prona pushojnë së qëni në pronësinë e një personi, servituti konsiderohet se ekziston në mënyrë aktive apo pasive në dobi ose kundër secilës nga pronat e veçuara, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

KREU IV
MËNYRAT E USHTRIMIT TË SERVITUTEVE

Neni 285

E drejta e servitutit përfshin çdo gjë që është e nevojshme për ta përdorur atë.

Neni 286

Pronari, pa pëlqimin e uzufruktarit, nuk mund të ngarkojë pronën me servitute që cenojnë të drejtat e uzufruktarit.

Neni 287

Servituti mbi një pronë që u përket disa personave në bashkëpronësi mund të krijohet vetëm me miratimin e gjithë bashkëpronarëve. Servituti i krijuar nga vetëm një ose disa bashkëpronarë, hyn në fuqi kur bashkëpronarët e tjerë bashkarisht apo veçmas, kanë dhënë miratimin për krijimin e tij.

Neni 288

Personi që ka një të drejtë servituti, duhet ta përdorë atë sipas titullit të tij ose të posedimit të tij. Kur ka dyshime rreth shtrirjes dhe mënyrës së ushtrimit të tij, quhet se servituti është krijuar në mënyrë të tillë që të plotësojë nevojat e pronës dominuese, duke rënduar sa më pak pronën shërbyese.

Neni 289

E drejta e servitutit duhet të ushtrohet në kohën dhe në mënyrën që sjell më pak vështirësi e shqetësime për pronarin e pronës shërbyese.

Neni 290

Kur prona në dobi të së cilës është krijuar një servitut pjestohet, servituti do t'i shërbejë secilës pjesë, me kusht që barra e pronës shërbyese të mos rëndohet.

Neni 291

Pronari nuk duhet që me veprimet ose mosveprimet e tij të pakësojë përdorimin e servitutit ose ta bëjë atë më të vështirë.

Megjithë këtë, në qoftë se kanë ndryshuar kushtet dhe pronari i pronës shërbyese rëndohet ose pengohet në ushtrimin e të drejtave të pronësisë, mund t'i kërkojë pronarit, në dobi të të cilit është vënë servituti, ndërrimin e vendit të servitutit.

Këtë të drejtë e ka edhe pronari i pronës tjetër, kur provohet se ky ndërrim sjell dobi dhe nuk dëmton pronën shërbyese.

Mbrojtja e servitutit

Neni 292

Personi që ushtron një servitut, ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht nga kushdo që kundërshton këtë të drejtë, duke kërkuar sipas rastit rivendosjen e plotë të saj, pushimin e cenimit që i bëhet si edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

KREU V
SHUARJA E SERVITUTEVE

Neni 293

Servitutet shuhen:

a) Kur në një person të vetëm bashkohet pronësia e pronës mbizotëruese me atë të pronës shërbyese.

b) Kur nuk përdoret për më shumë se dhjetë vjet.

Afati i parashkrimit për servitutet jo vijuese fillon të ecë nga dita kur servituti ka pushuar së përdoruri, ndërsa për servitutet vijuese nga dita kur është kryer një vepër ose është vërtetuar një fakt që

pengon ushtrimin e servitutit. Për efekt të shuarjes së servitutit, llogaritet edhe koha që ai është ushtruar nga titullari i mëparshëm.

c) Kur sendet dëmtohen ose konsumohen deri në një shkallë sa nuk mund të përdoren për qëllimin e tyre.

Rikthimi në një gjendje që mund të përdoren sjell si rrjedhim edhe rivendosjen e servituteve, përveç kur kjo e drejtë është parashkruar.

Neni 294

Kur prona mbizotëruese është në bashkëpronësi, përdorimi i servitutit nga njëri prej bashkëpronarëve, ndërpret parashkrimin edhe ndaj bashkëpronarëve të tjerë.

Neni 295

Pezullimi ose ndërprerja e parashkrimit në favor të njërit nga bashkëpronarët, ka efekt edhe në favor të të tjerëve.

TITULLI VII
MBROJTJA E PRONËSISË

Padia për kërkimin e sendit

Neni 296

Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Të drejtat e poseduesit për të ardhurat

Neni 297

Poseduesit me mirëbesim i takojnë frutat natyrore të veçuara dhe frutat civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dijeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ai nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelur, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij.

Neni 298

Poseduesi me keqbesim për gjithë kohën e posedimit të tij, detyrohet t'i kthejë pronarit bashkë me sendin edhe frutat natyrore të veçuara e frutat civile të vjela ose që janë bërë të kërkueshme, dhe të ardhurat e tjera që duhej të vilte, si dhe të shpërblejë pronarin për përdorimin e sendit dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit qoftë dhe pa fajin e tij.

Ai shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se dëmi do të shkaktohej edhe sikur të kishte dorëzuar sendin në kohën e duhur, përveç kur ai është marrë me anë vepre penale.

E drejta e poseduesit për shpenzimet

Neni 299

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të nevojshme që kanë bërë për sendin dhe shpenzimet e dobishme, në masën që këto i kanë shtuar vleftën, në qoftë se kjo vazhdon të jetë në kohën e kthimit të sendit.

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të zbresë nga të ardhurat e sendit, shpenzimet që i njihen sipas kësaj dispozite. Ai ka të drejtë të mbajë sendin, gjersa t'i paguhen shpenzimet e nevojshme të dobishme.

Neni 300

Poseduesi me keqbesim ka të drejtë të kërkojë vetëm pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.

Neni 301

Poseduesi me mirëbesim dhe ai me keqbesim, përveç shpenzimeve që u njihen sipas neneve të këtij Kodi, nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagimin e shpenzimeve të tjera të bëra për sendin, por vetëm kanë të drejtë të heqin nga sendi atë që kanë bashkuar dhe që mund të ndahet pa dëm, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre.

Padia mohuese

Neni 302

Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar.

Kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm

Neni 303

Pronari, personi që gëzon një të drejtë tjetër reale ose poseduesi, të cilët kanë arsye të shqetësohen se nga një punim i ri i filluar prej të tjerëve në tokën e tyre ose të tjetërkujt, mund t'i vijë dëm sendit në pronësi ose në posedimin e tij, mund t'i drejtohet gjykatës me kusht që ky punim të mos ketë përfunduar ose të mos ketë kaluar një vit nga fillimi i tij.

Gjykata sipas rastit vendos ndalimin e punimit, shëmbjen ose pakësimin e tij dhe kur është rasti edhe shpërblimin e dëmit ose rrëzon padinë duke urdhëruar shpërblimin e dëmit kur rezulton se punimi ka qënë ndaluar padrejtësisht.

TITULLI VIII
POSEDIMI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i posedimit
Neni 304

Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.

Llojet e posedimit
Neni 305

Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm.

Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.

Në të gjitha rastet e tjera posedimi është i paligjshëm.

Neni 306

Posedimi i paligjshëm mund të jetë me mirëbesim ose me keqbesim.

Posedimi është me mirëbesim kur poseduesi nuk ka ditur ose nuk ishte i detyruar të dinte se posedimi i tij është i paligjshëm.

Mirëbesimi prezumohet dhe mjafton të ketë qënë në kohën e fitimit të posedimit.

Prezumime mbi posedimin
Neni 307

Poseduesi i tanishëm që ka poseduar në një kohë të mëparshme, prezumohet se ka poseduar edhe në kohën e ndërmjetme.

Neni 308

Posedimi i tanishëm nuk prezumon posedimin e mëparshëm, përveç kur poseduesi ka një titull që përbën bazën e posedimit të tij.

Në këtë rast poseduesi prezumohet që të ketë qënë poseduar që nga data e titullit.

Mënyrat e fitimit të posedimit
Neni 309

Posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim.

Ai që ka fituar posedimin me mirëbesim, mund të bashkojë në posedimin e vet, edhe kohën e posedimit me mirëbesim të personit nga i cili ka fituar sendin.

KREU II
MBROJTJA E POSEDIMIT DHE E MBAJTJES

Mbrojtja e atëçastme
Neni 310

Poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër, por duke evituar veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes.

Neni 311

E drejta për të mbrojtur posedimin i njihet edhe mbajtësit të sendit, kundër çdo personi tjetër, përveç ndaj atij nga i cili i vijnë këto të drejta.

Pushimi i cenimit të posedimit
Neni 312

Personi, që cenohet në posedimin e një sendi, mund të kërkojë brenda gjashtë muajve, pushimin e cenimit të posedimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen.

Kur posedimi është fituar me dhunë ose fshehurazi, padia mund të ngrihet brenda gjashtë muajve nga dita kur dhuna ose fshehtësia kanë pushuar.

Pushimi i cenimit të posedimit nuk mund të kërkohet nga personi që ka fituar posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Rivendosja në posedim
Neni 313

Poseduesi, që në mënyrë të paligjshme është zhveshur nga posedimi, ka të drejtë të kërkojë brenda gjashtë muajve, rivendosjen e tij në posedim.

Këtë të drejtë nuk e ka poseduesi që ka marrë posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Kur zhveshja është e fshehtë, afati për të kërkuar rivendosjen e posedimit fillon nga dita e zbulimit të zhveshjes.

Neni 314

Rivendosja mund të kërkohet edhe kundër atij që e ka fituar posedimin nëpërmjet një titulli, por që ka patur dijeni për zhveshjen e ndodhur.

Neni 315

Gjatë gjykimit të padisë për pushimin e cenimit ose rivendosjen në posedim, i padituri nuk mund të pretendojë se është vetë pronar ose ka një të drejtë më të fortë se ajo e poseduesit.

PJESA III
TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i trashëgimit
Neni 316

Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 317

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Neni 318
Koha e çeljes së trashëgimisë
(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 1)

Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi.
Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur.

Neni 318/1
Vendi i çeljes së trashëgimisë
(Shtuar me ligjin nr. 121/2013, neni 2)

Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Neni 318/2
Ligji i zbatueshëm
(Shtuar me ligjin nr. 121/2013, neni 2)

Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur.

Neni 319

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën disponohen ose përdorohen të drejta që rrjedhin nga një trashëgim ende i paçelur.

Zotësia për të trashëguar
Neni 320

Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë.
Prezumohet se ka qënë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.

Neni 321

Kur dy ose më shumë persona thirren për të trashëguar njëri tjetrin dhe nuk vërtetohet se cili prej tyre ka vdekur më parë, prezumohet se të gjithë kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe nuk kalon ndonjë e drejtë nga njëri tek tjetri.

Padenjësia

Neni 322

Nuk mund të trashëgojë si i padenjë:

- ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
- ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal;
- ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
- ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.

Neni 323

Padenjësia e prindit ose e të paralindurit, nuk përjashton fëmijët ose të paslindurit e këtij, si kur trashëgojnë vetë, ashtu dhe kur vijnë në trashëgim me zëvendësim. Në një rast të tillë, prindi i padenjë, në pjesën trashëgimore që u vjen fëmijëve të tij nuk mund të gëzojë të drejtat e uzufruktit dhe të administrimit, që ligji u njeh prindërve mbi pasuritë e fëmijëve të tyre.

Falja e padenjësisë

Neni 324

Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me akt noterial ose me testament, ose kur falja, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë e megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.

Detyrimet e trashëgimtarit të padenjë

Neni 325

Personi i përjashtuar nga trashëgimi si i padenjë detyrohet të kthejë frutat dhe çdo të ardhur tjetër që ka marrë nga pasuria në trashëgim pas çeljes së trashëgimisë.

Zëvendësimi

Neni 326

Zëvendësimi lejon vënien e zëvendësuesve në vendin, shkallën dhe në të drejtat e atij që zëvendësojnë.

Neni 327

Zëvendësimi në vijë të drejtë i të paslindurve, bëhet pa kufi dhe në të gjitha rastet, qoftë kur fëmija e trashëgimlënësit të konkurrojë me të paslindurit e një fëmije tjetër të paravdekur, qoftë dhe kur fëmijët e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij dhe të paslindurit e këtyre janë ose jo në shkallë të njëjta, ose të numrit të tyre sipas barqeve.

Neni 328

Për të paralindurit në vijë të drejtë nuk ka zëvendësim; më i afërti përjashton të tjerët.

Neni 329

Në vijë të tërthortë, zëvendësimi pranohet në favor të fëmijëve e të paslindurve, të vëllezërve e motrave të trashëgimlënësit, edhe sikur këta të konkurrojnë me ungjët apo emtat e tyre apo me të paslindurit e tyre në shkallë të njëjtë ose jo.

Fitimi i trashëgimit

Neni 330

Trashëgimi fitohet me vdekjen e trashëgimlënësit.

Neni 331

Me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë.

Neni 332

Trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar apo një të drejtë tjetër pasurore.

Neni 333

Heqja dorë nga trashëgimia

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 3)

Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri.

Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme.

Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

Neni 334

Ai që ka hequr dorë nga trashëgimi, quhet se nuk është thirrur ndonjëherë në trashëgim. Heqja dorë nga trashëgimi nuk përjashton trashëgimtarin nga e drejta për të kërkuar legët.

Neni 335

Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.

Për trashëgimtarin që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati i heqjes dorë nga trashëgimi fillon nga dita e lindjes.

Afati i heqjes dorë nga trashëgimi pezullohet për shkaqet që vlejnë për parashkrimin e padies.

Neni 336
(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 4)

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë, ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ta, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, cakton një afat, jo më pak se gjashtë muaj nga çelja e trashëgimisë, brenda të cilit ata duhet të deklarojnë në se heqin dorë nga trashëgimi. Në qoftë se brenda këtij afati nuk bëhet ndonjë deklarim i tillë, prezumohet se trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë.

Neni 337

Heqja dorë nga trashëgimi, e bërë para çeljes së trashëgimisë, ose kur bëhet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit, apo në dobi të njërit nga trashëgimtarët e tjerë, është e pavlefshme.

Neni 338

Nuk mund të hiqet dorë nga trashëgimi, kur gjatë afatit tremujor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar.

Veprimet që kryhen vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, nuk konsiderohen si sjellje prej trashëgimtari.

Trashëgimtarët që kanë hequr ose fshehur sende nga trashëgimi, humbasin të drejtën e heqjes dorë dhe mbeten trashëgimtarë edhe sikur të kenë deklaruar heqjen dorë nga trashëgimi.

Neni 339

Trashëgimtari që ka deklaruar rregullisht heqjen dorë ose jo nga trashëgimi, nuk mund ta shfuqizojë më pas këtë deklarim.

Neni 340

Kur trashëgimtari vdes para se të kalojë afati për heqjen dorë nga trashëgimi, e drejta për heqjen dorë u kalon trashëgimtarëve të tij.

Pagimi i detyrimeve

Neni 341

Trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë.

Quhen detyrime që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ato të trashëgimlënësit, shpenzimet e varrimit të tij dhe shpenzimet që nevojiten për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë trashgimore, deri sa ajo t'u kalojë trashëgimtarëve përkatës.

Neni 342

Kur në një trashëgim, një ose disa prona të paluajtshme janë të rënduara me hipotekë, secili trashëgimtar ka të drejtë të kërkojë që këto prona të lirohen nga hipoteka para se të bëhet formimi i pjesëve trashëgimore.

Megjithëkëtë, trashëgimtari që e ka shlyer detyrimin që rrjedh nga hipoteka e vënë mbi një send të paluajtshëm në pjesën trashëgimore të tij, ka të drejtën e kthimit ndaj trashëgimtarëve të tjerë, në proporcion me pjesët e tyre.

Neni 343

Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 5)

Kur shihet e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, të personave që mund të përfitojnë nga disponimet me testament, të kreditorëve të trashëgimlënësit ose të shtetit, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht, ose me kërkesën e çdo të interesuari, bën inventarin e pasurisë trashëgimore.

Noteri që bën inventarin mund të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore.

Derisa të mos jenë hequr masat e mësipërme, trashëgimtari që mund të ketë filluar nga administrimi i pasurisë trashëgimore, nuk mund ta tjetërsojë atë veçse me lejen e gjykatës.

Neni 344

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 6)

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ata ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentorë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimi, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit.

Shkurtimi i aktit noterial të emërimit të kujdestarit shpallet në Fletoren Zyrtare.

Neni 345

Kujdestari kërkon kryerjen e inventarit të pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe u përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgim ose që rrjedhin prej tij, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit.

Neni 346

Me miratimin e gjykatës kujdestari paguan detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ekzekuton detyrimet në lidhje me leget dhe barrët dhe, kur shihet e nevojshme tjetërson edhe pasuri trashëgimore.

Neni 347

Detyra e kujdestarit pushon me paraqitjen e treshëgimtarit.

Neni 348

Dëshmia e trashëgimisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 7)

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm. Në rast se i njëjti trashëgimlënës ka lënë më shumë se një testament, dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar apo depozituar për ruajtje testamenti i fundit.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë redaktohet në numër të barabartë me trashëgimtarët e përcaktuar në të. Noteri, në momentin e redaktimit, lëshon dëshminë e trashëgimisë në numër të barabartë me kërkuesit, ndërsa kopjet e tjera të redaktuara ruhen nga noteri dhe mund të tërhiqen nga trashëgimtarët e tjerë, sipas kërkesës së tyre.

Rregullat e hollësishme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe për regjistrimin e testamenteve përcaktohen nga ligji për noterinë.

Padia për kërkimin e trashëgimit

Neni 349

Trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon tërësisht ose pjesërisht pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, sipas rregullave mbi posedimin me mirëbesim dhe me keqbesim.

Neni 350

Padia për kërkimin e trashëgimit mund të ngrihet edhe kundër personit që mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi, qoftë dhe kur ky është shteti. Personi që ka fituar me mirëbesim ndonjë send të pasurisë trashëgimore nga një trashëgimtar i tillë, nuk është i detyruar të kthejë sendin edhe sikur të jetë fituar me kundërshpërblim.

Poseduesi me mirëbesim që ka tjetërsuar po në mirëbesim sende nga pasuria trashëgimore, është vetëm i detyruar që t'i kthejë trashëgimtarit paditës çmimin e sendit të shoqëruar me faturën përkatëse. Kur këto të fundit nuk janë shlyer, këtij i kalon e drejta për të kërkuar shlyerjen e tyre.

Neni 351

Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara.

Neni 352

Dispozitat që kanë lidhje me posedimin, zbatohen edhe për posedimin e sendeve në trashëgim, përsa i përket kërkimit të frutave, të shpenzimeve të kryera ose për përmirësimet dhe shtesat e bëra.

Pjesëtimi i trashëgimit

Neni 353

Cilido nga bashkëtrashëgimtarët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e pasurisë trashëgimore edhe sikur trashëgimlënësi të ketë urdhëruar ndryshe.

Neni 354

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 8)

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet me marrëveshje midis trashëgimtarëve, e cila miratohet me akt noterial.

Nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, noteri, mbi bazën e parimit të paanësisë, si dhe duke mbajtur në konsideratë rregullat e pjesëtimit të pasurisë, sipas këtij Kodi, i ofron trashëgimtarëve mundësitë ligjore për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore dhe arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Në këtë rast noteri i sqaron ata për të drejtat dhe detyrat, si dhe i paralajmëron për pasojat që vijnë nga nënshkrimi i marrëveshjes, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenia e ligjit.

Kur trashëgimtarët nuk bien dakord edhe me zgjidhjet e ofruara nga noteri, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet nga gjykata kompetente për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia.

Neni 355

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 207 të këtij Kodi dhe në dispozitat e tjera të këtij kreu.

Neni 356

Në formimin e pjesëve takuese duhet që, sa të jetë e mundur, në secilën prej tyre të bëjnë pjesë nga po ajo sasi sendesh të luajtshme ose të paluajtshme, të drejtash reale ose kredish, që kanë natyrë e vleftë të njëjtë.

Neni 357

Kur kreditorët kanë vënë sekuestro mbi sendet e luajtshme të pasurisë trashëgimore, ose kanë kundërshtuar pjesëtimin sipas nenit 206 të këtij Kodi, ose shumica e bashkëtrashëgimtarëve e shohin të nevojshme pagimin e detyrimeve që rëndojnë mbi trashëgimin, sendet e luajtshme shiten në ankand.

Neni 358

Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës.

Bashkëtrashëgimtarët, që me punën ose të ardhurat e tyre kanë ndihmuar në shtimin e pasurisë së lënë në trashëgim, kanë të drejtë të kërkojnë pjesën e tyre në pasurinë e sipërme të shtuar, sipas kontributit të dhënë.

Neni 359

Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore.

Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

TITULLI II
TRASHËGIMIA ME LIGJ

Neni 360

Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod.

Neni 361
(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 23)

Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.

Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.

Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi.

Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit.

Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimi i mbetet bashkëshortit pasjetues.

Neni 362
(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 24)

Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa.

I birësuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

Neni 363

Në radhë te dytë thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij.

Neni 364

Në radhë të tretë thirren në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit që përmenden në nenin 363 të këtij Kodi, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë, gjyshi e

gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur. Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve e motrave të një ati ose vetëm të një nëne, ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana a babës ose e nënës.

Neni 365

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmve më të afërt të tij, pa bërë dallim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e gjashtë.

Neni 366

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

Neni 367

Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e trashëgimlënësit tej vleftës së pasurisë të fituar.

E drejta e shtimit për sendet shtëpiake

Neni 368

Trashëgimtarët që bashkëjetonin me trashëgimlënësin në kohën e vdekjes së tij, kur thirren në trashëgim, marrin tej pjesës që u takon në pasurinë trashëgimore sendet shtëpiake të përdorimit të zakonshëm, përveç kur trashëgimlënësi ka disponuar ndryshe në testament.

Trashëgimia sipas radhëve

Neni 369

Trashëgimtarët e një radhe të mëpasme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparëshme ose kur këta të gjithë janë bërë të padenjë ose kanë hequr dorë nga trashëgimi ose janë përjashtuar nga trashëgimi, përveç kur nga trashëgimtarët e radhës së dytë mbetet trashëgimtari i paaftë për punë dhe ka trashëgimtarë të radhës së tretë.

E drejta e shtimit

Neni 370

Kur një nga bashkëtrashëgimtarët që thirret në trashëgim ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është përjashtuar nga trashëgimi dhe nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të asaj radhe.

Trashëgimtari i paaftë për punë

Neni 371

Trashëgimtarë të paaftë për punë janë ata që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç si dhe, pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë.

TITULLI III
TRASHËGIMIA ME TESTAMENT

Kuptimi i testamentit
Neni 372

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes.

Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke.

Zotësia për të disponuar me testament
Neni 373

Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar.

I mituri nga 14 gjer në 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij.

Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e bërjes së testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Zotësia për të fituar me testament
Neni 374

Janë të pazotë për të fituar me testament ata që janë të pazotë për të trashëguar me ligj me përjashtim të fëmijëve të pandërmjetshëm të një personi të caktuar dhe të gjallë në kohën e vdekjes së testatorit edhe sikur ata fëmijë të mos jenë zënë ende.

Neni 375

Kujdestari nuk mundet në asnjë rast të përfitojë nga disponimet testamentare të personit në kujdestari kur ato janë bërë para miratimit të llogarisë përfundimtare, edhe sikur testatori të ketë vdekur pas miratimit të llogarisë.

Janë të vlefshme disponimet e bëra në favorin e kujdestarit, kur ky është i paralindur, i paslindur, vëlla, motër ose, bashkëshorti i testatorit.

Neni 376

Disponimi testamentar në favor të personave të pazotë që përmenden në nenet 374 e 375 të këtij Kodi, është i pavlefshëm edhe sikur të jetë fshehur nën formën e një kontrate me shpërblim ose të jetë bërë nën emrin e një personi të ndërvënë.

Quhen persona të ndërvënë: i ati, e ëma, të paslindurit dhe bashkëshorti i personit të pazot.

Caktimi i trashëgimtarit
Neni 377

Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik.

Përjashtimi nga trashëgimia
Neni 378

Trashëgimlënësi edhe pa caktuar trashëgimtarë në testament mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore një ose më shumë trashëgimtarë të tij.

Rezervë ligjore
Neni 379

Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

Neni 380

Kur testatori disponon me testament një uzufrukt ose një rentë jetësore, të ardhurat e të cilave kalojnë ato të pjesës së disponueshme, trashëgimtarët që kanë të drejtë në rezervën ligjore munden të ekzekutojnë këtë disponim ose të heqin dorë nga të drejtat mbi pjesën e disponueshme.

Po këtë të drejtë zgjedhjeje e kanë edhe personat që përfitojnë nga rezerva ligjore në rast se testatori ka disponuar pronësinë e zhveshur të një pjese që kalon masën e disponueshme.

Zëvendësimi
Neni 381

Trashëgimlënësi mund të caktojë në testament që në rast se trashëgimtari vdes para tij ose bëhet i padenjë, ose heq dorë nga trashëgimi, ta marrë trashëgimin një nga trashëgimtarët e tjerë që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, dhe kur nuk ka asnjë nga këta, ta marrë një njeri tjetër.

Por trashëgimlënësi nuk mund të detyrojë trashëgimtarin që të ruajë dhe, pas vdekjes së tij t'ia dorëzojë një personi tjetër të gjithë ose një pjesë të trashëgimit që ka marrë.

E drejta e shtimit
Neni 382

Kur trashëgimlënësi ua ka lënë të gjithë pasurinë e tij trashëgimtarëve të caktuar në testament dhe një nga këta trashëgimtarë ka vdekur para tij, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar për këto raste një trashëgimtar tjetër në vend të tij, si dhe kur një trashëgimtar është përjashtuar nga trashëgimi, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkë-trashëgimtarëve të tjerë të caktuar në testament në përpjestim me pjesët e tyre trashëgimore.

Në qoftë se disa nga trashëgimtarët janë caktuar së bashku në një pjesë të pasurisë, shtimi bëhet vetëm midis këtyre bashkëtrashë-gimtarëve.

Neni 383

Kur trashëgimlënësi ka lënë me testament vetëm një pjesë të pasurisë së tij, edhe sikur në këtë pjesë të ketë caktuar së bashku shumë trashëgimtarë, pjesa e atij që për shkaqet e treguara në nenin e sipërm nuk mund ose nuk do të jetë trashëgimtar, u kalon trashëgimtarëve ligjore të trashëgimlënësit.

Legu dhe barra

Neni 384

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament, nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, që t'u japin një ose më shumë trashëgimtarëve ligjorë një përfitim pasuror nga trashëgimi, pa i bërë këta trashëgimtarë (legu).

Kur trashëgimlënësi, që nuk ka trashëgimtarë nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364, ka caktuar në testament si trashëgimtarë persona të tjerë, mund t'i ngarkojë këta me lege në dobi të çdo njeriu.

Dispozitat e zotësisë për të trashëguar vlejnë edhe për personin që i është lënë legu.

Neni 385

Legatari ka të drejtë të kërkojë frutat ose kamatat që rrjedhin nga legu, nga dita që i është caktuar dorëzimi i legut dhe në mungesë të saj, nga dita e njoftimit të kërkesë-padisë.

Ato mund të kërkohen nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kur trashëgimlënësi ka disponuar shprehimisht ose kur legu është një depozitë në para.

Neni 386

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që të kryejnë ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë ose ndonjë veprim tjetër, pa i dhënë të drejtë një personi të caktuar mbi këtë veprim (barrë).

Kur trashëgimlënësi i lë me testament pasurinë shtetit, organeve të tij, ose enteve të ndryshëm, ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

Neni 387

Kur trashëgimtari i ngarkuar me legun ose barrën ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një trashëgimtar tjetër në vend të tij, për ekzekutimin e detyrimeve në lidhje me legun ose me barrën ngarkohen bashkëtrashëgimtarët ose trashëgimtarët ligjorë, të cilëve u shtohet ose u kalon pjesa e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar.

Në qoftë se ekzekutimi i detyrimeve në lidhje me legun ose barrën është lidhur ngushtë me personin e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar, legu ose barra mbetet pa fuqi.

Neni 388

Në rast se ndërmjet trashëgimtarëve, asnjëri prej tyre nuk është ngarkuar nga trashëgimlënësi testamentar për të shlyer legun, secili trashëgimtar detyrohet të kontribuojë për shlyerjen e tij sipas pjesës takuese.

Neni 389

Kur sendi i dhënë në leg është treguar vetëm si lloj ose si masë, e drejta e zgjedhjes i takon trashëgimtarit, por sendi nuk mund të jetë nën kualitetin mesatar.

Neni 390

Kur personi, të cilit i është lënë legu, ka vdekur para trashëgimlënësit ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga legu dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një person tjetër në vend të tij, legu shkon në dobi të trashëgimtarit të ngarkuar me atë leg.

Por në qoftë se legu u është lënë shumë personave së bashku, pjesa e atij që nuk mund ose nuk do të marrë legun u shtohet bashkëpjesëtarëve të tij në përpjesëtim me pjesët e tyre.

Neni 391

Personi, të cilit i është lënë legu, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtari i ngarkuar ekzekutimin e detyrimit në lidhje me legun.

Ekzekutimi i detyrimit të trashëgimtarit në lidhje me barrën mund të kërkohet nga ekzekutori i testamentit, nga bashkëtrashëgimtarët, nga organizatat përkatëse shtetërore ose private.

Detyrimet në lidhje me legun dhe barrën ekzekutohen pas detyrimeve që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore.

Format e testamentit

Neni 392

Testamenti bëhet në dy forma: ollograf dhe me akt noterial.

Testamenti ollograf

Neni 393

Testamenti ollograf shkruhet tërësisht me dorën e testatorit duke vënë datën dhe nënshkrimin e vet.

Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin.

Nënshkrimi vihet në fund të disponimeve.

Neni 394

Personi që nuk është i zoti të lexojë dorëshkrimin e vet nuk mund të bëjë testament ollograf.

Neni 395

Personat që nuk dëgjojnë (shurdhë) ose që nuk dëgjojnë e nuk flasin (shurdhëmemecë), mund të disponojnë me testament ollograf ose me testament të marrë nga noteri, sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për noterinë".

Neni 396

Testamenti ollograf mund të depozitohet tek noteri për ruajtje sipas dispozitave për depozitimin e dokumenteve në noteri.

Testamenti me akt noterial

Neni 397

Testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit.

Kur trashëgimlënësi nuk di, ose për shkak sëmundjeje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, testamenti nënshkruhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për noterinë".

Testamente të posaçme

Neni 398

(Shfuqizuar fjalët "ose sekretari" me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001, neni 25)

Në vendet ku nuk ka noter, testamenti mund të vërtetohet nga kryetari i bashkisë ose i komunës.

Neni 399

Testamenti i një personi që ndodhet në shërbim ushtarak, mund të vërtetohet nga komandanti i njësisë ushtarake në të cilën ai bën pjesë dhe kur është shtruar në spital për mjekim nga drejtori i spitalit.

Neni 400

Testamenti i një personi që ndodhet në një anije shqiptare në lundrim ose që ka qëndruar në një liman të huaj, mund të vërtetohet nga kapiteni i anijes.

Neni 401

Disponimi me testament i bërë me kusht pezullues, mbetet pa efekt kur personi në favor të cilit është bërë, vdes para trashëgimlënësit.

Revokimi i testamentit

Neni 402

Testamenti me një datë të mëvonshme lë pa fuqi atë me datë të mëparëshme në tërësi ose vetëm për pjesën që nuk pajtohet me testamentin e ri.

Testamenti mbetet pa fuqi edhe me anë të një deklarate të bërë nga trashëgimlënësi në noteri.

Pavlefshmëria e testamentit

Neni 403

Testamenti është i pavlefshëm kur bëhet nga një person që nuk mund të bëjë testament (neni 373).

Neni 404

Testamenti është i pavlefshëm kur nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 405

Testamenti është i pavlefshëm kur disponohet me testament në dobi të personave që nuk mund të trashëgojnë (nenet 374, 375).

Neni 406

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është në kundërshtim me nenet 377 e 384 të këtij Kodi.

Neni 407

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament i trashëgimlënësit, i përjashton nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore.

Neni 408

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë në kundërshtim me ligjin ose në mashtrim të ligjit.

Neni 409

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë me ndikimin e mashtrimit, kanosjes ose dhunës, ose për shkak të një lajthimi, pa të cilën trashëgimlënësi nuk do kishte bërë këtë disponim.

Neni 410

Kur testamenti deklarohet nga gjykata i pavlefshëm, në trashëgim thirren trashëgimtarët ligjorë, përveç kur është rasti i shtimit në dobi të trashëgimtarëve të caktuar në testament sipas nenit 381.

Kur deklarohen të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, disponimet e tjera mbeten në fuqi.

Neni 411

Padia për pavlefshmërinë e testamentit ose të disponimit me testament mund të ngrihet nga trashëgimtari dhe nga çdo tjetër person i interesuar brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë.

Neni 412

Kur disponimi me testament është i pavlefshëm për shkak se disponimi nga trashëgimlënësi ka përjashtuar nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore (neni 407), trashëgimtari, i përjashtuar nga trashëgimi ose të cilit i është cenuar pjesa ligjore, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtarët e tjerë, sipas rastit, dorëzimin ose plotësimin e pjesës që i takon atij në bazë të trashëgimisë ligjore.

Neni 413

Për caktimin e kësaj pjese bashkohet e gjithë pasuria që kishte trashëgimlënësi në kohën e vdekjes së tij, duke u zbritur detyrimet që rëndojnë mbi trashëgiminë dhe pjesëtohet me numrin e trashëgimtarëve që do të thirreshin në trashëgim në qoftë se trashëgimlënësi nuk do kishte bërë testament.

Ekzekutori i testamentit

Neni 414

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë një ose më shumë persona për të ekzekutuar testamentin.

Caktimi si ekzekutor duhet të pranohet prej këtij në vetë testamentin ose me një deklaratë të veçantë që i bashkohet testamentit.

Në qoftë se trashëgimlënësi nuk cakton ekzekutor të testamentit, ekzekutimi i këtij u ngarkohet trashëgimtarëve të caktuar në të.

Neni 415

Ekzekutori i testamentit duhet të bëjë inventarin e pasurisë trashëgimore, duke ftuar të marrin pjesë trashëgimtarët dhe personat e tjerë që përfitojnë nga testamenti.

Ekzekutori i testamentit administron pasurinë trashëgimore, duke kryer veprimet që janë të nevojshme për ekzekutimin e disponimeve të testamentit, por nuk mund të tjetërsojë pasurinë trashëgimore, përveç kur shfaqet nevoja dhe me lejen e gjykatës, e cila vendos pasi më parë të dëgjojë trashëgimtarët.

Neni 416

Gjykata e rrethit, me kërkesën e trashëgimtarëve ose të personave që kanë interes, mund të shkarkojë nga detyra ekzekutorin e testamentit për shkelje të rënda të detyrës së tij ose për pazotësi në administrimin e pasurisë trashëgimore.

Neni 417

Tagret e ekzekutorit testamentar nuk transmetohen në trashëgimtarët e tij.

Neni 418

Kur janë shumë ekzekutorë testamentarë, në mungesën e të tjerëve mund të veprojë edhe njëri prej tyre, por të gjithë ata janë përgjegjës solidarë për sendet që u janë besuar, përveç kur testatori u ka ndarë detyrat.

PJESA IV
DETYRIMET

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHME

KREU I
KUPTIMI DHE LINDJA E DETYRIMEVE

Kuptimi i detyrimit

Neni 419

Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditori), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

Lindja e detyrimeve

Neni 420

Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji.

Natyra ekonomike e detyrimit
Neni 421

Objekt i detyrimit duhet të ketë një vlerësim ekonomik dhe t'i përgjigjet interesave qoftë dhe jopasurore të kreditorit.

Korrektesa e pjesëmarrësve në detyrim
Neni 422

Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes.

KREU II
DETYRIMET SOLIDARE

Neni 423

Detyrimi është solidar kur kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e të njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu dhe nga secili prej tyre veç e veç.

Neni 424

Detyrimi është solidar kur del nga vullneti i palëve ose është parashikuar me ligj.

Neni 425

Detyrimi është solidar edhe kur debitorët të jenë detyruar secili në mënyrë të ndryshme ose dhe kur debitori i përbashkët të jetë detyruar në mënyrë të ndryshme ndaj secilit kreditor.

Neni 426

Ekzekutimi i detyrimit nga njëri prej debitorëve solidarë i shkarkon të gjithë debitorët e tjerë.

Debitorët solidarë shkarkohen nga detyrimi edhe nëpërmjet dhënies së një sendi në ekzekutim të detyrimit apo të kompensimit të kredisë nga njëri prej debitorëve solidarë ndaj kreditorit.

Neni 427

Qenia në vonesë e kreditorit ndaj njërit nga debitorët solidarë e shtrin efektin ndaj të gjithë debitorëve të tjerë.

Debitori solidar nuk mund të kompensojë detyrimin e tij me kreditë që kanë debitorët e tjerë ndaj kreditorit.

Debitori solidar nuk mund t'i kundrejtojë kreditorit prapsimet personale të debitorëve të tjerë.

Çdo njëri nga debitorët solidarë nuk duhet që me veprimet e tij të rëndojë pozitën e të tjerëve, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 428

Debitori ka të drejtë të zgjedhë për të paguar njërin apo tjetrin kreditor solidar, përveç kur është penguar më parë me anë të një njoftimi me shkrim prej ndonjërit prej tyre.

Kreditorët janë solidarë kur secili prej tyre ka të drejtën të kërkojë pagimin e gjithë detyrimit dhe pagimi i bërë njërit prej tyre, liron debitorin ndaj gjithë kreditorëve.

Neni 429

Përtëritja e detyrimit që bën debitori me njërin nga kreditorët, shkarkon të gjithë debitorët e tjerë, përveç kur kreditori i ka ruajtur të drejtat ndaj tyre.

Falja e detyrimit të bërë njërit prej debitorëve solidarë,shkarkon të gjithë debitorët e tjerë. Kur falet vetëm pjesa e një debitori, detyrimi i debitorëve të tjerë pakësohet për aq sa është pjesa e falur.

Bashkimi i cilësive të kreditorit me atë të debitorit solidar në një person të vetëm, shuan detyrimin e debitorëve të tjerë, për pjesën e këtij debitori.

Neni 430

Në marrëdhëniet ndërmjet tyre debitorët solidarë marrin pjesë në shlyerjen e detyrimit secili sipas pjesës së vet.

Debitori që ka ekzekutuar një detyrim solidar, ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë pagimin në pjesë të barabarta të detyrimit të ekzekutuar prej tij, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe.

Kur debitori solidar, që ka ekzekutuar detyrimin, nuk ka mundur të nxjerrë nga një debitor pjesën e tij të detyrimit, ajo ndahet sipas rastit në pjesë të barabarta ose proporcionalisht ndërmjet debitorëve të tjerë, duke përfshirë edhe atë.

Neni 431

Debitorët solidarë janë të detyruar të përballojnë në proporcion me pjesët e tyre të gjitha shpenzimet që vërtetohen se kanë qenë të nevojshme të kryhen nga debitorët që kanë ekzekutuar detyrimin.

Neni 432

Debitori solidar që ekzekuton detyrimin duhet t'i kundrejtojë kreditorit prapsimet e përbashkëta për të gjithë debitorët, përndryshe i humb e drejta të kërkojë nga debitorët e tjerë pjesën që atyre u takon për shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu, ai e humbet këtë të drejtë edhe kur nuk ka njoftuar debitorët e tjerë se ka ekzekutuar detyrimin dhe, si rrjedhim njëri nga debitorët e tjerë ka ekzekutuar veçmas atë.

Neni 433

Ndërprerja e parashkrimit me veprimet e kreditorit ndaj njërit prej debitorëve solidarë, si dhe ndërprerja e parashkrimit nga njëri prej kreditorëve solidarë ndaj debitorit të përbashkët, ka efekt si ndaj debitorëve të tjerë ashtu edhe ndaj kreditorëve të tjerë.

Pezullimi i parashkrimit ndaj njërit debitor ose ndaj njërit kreditor solidar, nuk ka efekt ndaj të tjerëve.

Heqja dorë nga parashkrimi në përputhje me nenin 126 të këtij Kodi e bërë nga njëri prej debitorëve solidarë, nuk ka efekt ndaj të tjerëve, ndërsa heqja dorë nga parashkrimi nga njëri prej kreditorëve solidarë, ka efekt ndaj të tjerëve.

Neni 434

Debitori solidar të cilit i kërkohet pagimi i pjesës së tij nga detyrimi, nuk mund t'i kundrejtojë debitorit, që ka paguar atë, parashkrimin e padisë së kreditorit, përveç kur ai vetë dhe debitori që kërkon pjesën kanë patur mundësinë që t'i kundrejtonin parashkrimin e plotësuar.

Ky paragraf nuk zbatohet kur me marrëveshje debitorët solidarë kanë vendosur ndryshe.

Neni 435

Në rast se ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur, për fajin ose gjatë vazhdimit të vonesës së njërit ose disa debitorëve solidarë, debitorë të tjerë nuk shkarkohen nga detyrimi për plotësimin e tij.

Kreditori mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar për një shkak të tillë, vetëm nga debitorët solidarë ose nga secili prej tyre, për fajin e të cilëve është bërë i pamundur ekzekutimi i detyrimit ose që kanë qenë me vonesë. Debitorët e tjerë mbetën solidarë vetëm për detyrimin e parë.

Vonesa e njërit nga debitorët solidarë nuk sjell ndonjë pasojë juridike për debitorët e tjerë.

KREU III
DETYRIMET ALTERNATIVE

Neni 436

Detyrimi është alternativ kur debitori shkarkohet prej tij, duke përmbushur njërin nga llojet e tij të përmendura veç e veç sipas dëshirës së tij, ose të kreditorit apo të një të treti. Debitori nuk mund të kërkojë nga kreditori të pranojë përmbushjen e detyrimit pjesërisht nga njëri lloj e pjesërisht nga lloji tjetër i tij.

Neni 437

E drejta e zgjedhjes i takon debitorit, përveç kur është parashikuar nga ligji apo nga kontrata që t'i lihet kreditorit apo një të treti.

Zgjedhja bëhet e parevokueshme me përmbushjen e njërit nga llojet e detyrimit, ose me njoftimin e deklaratës së zgjedhjes palës tjetër ose të dy palëve, kur e drejta e zgjedhjes i takon një të treti.

Kur e drejta e zgjedhjes u takon shumë personave dhe ata nuk merren vesh, gjykata u cakton atyre një afat. Kur zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, atë e bën gjykata.

Neni 438

Kur në një detyrim alternativ, debitori nuk ekzekuton ndonjërin nga llojet e detyrimeve në afatin e caktuar, e drejta e zgjedhjes i kalon kreditorit.

Në rast se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit dhe ky nuk e ka ushtruar në afatin e caktuar në marrëveshje ose të caktuar nga debitori, zgjedhja i kalon këtij të fundit.

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë një të treti dhe ai nuk e ushtron në afatin e caktuar, zgjedhja bëhet nga gjykata.

Kur kjo e drejtë u është lënë disa personave, gjykata u cakton atyre një afat. Në rast se zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, ajo bëhet nga gjykata.

Neni 439

Detyrimi alternativ është i thjeshtë kur njëri nga të dy llojet e detyrimit nuk mund të bëhet objekt detyrimi, ose kur përmbushja e tij është bërë e pamundur pa fajin e asnjërës palë.

Neni 440

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë debitorit, detyrimi alternativ bëhet i thjeshtë në rast se njëri nga të dy llojet e detyrimit bëhet i pamundur dhe për fajin e tij. Në rast se kjo pamundësi ndodh për fajin e kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur ai nuk pranon të zbatohet detyrimi tjetër dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Kur zgjedhja i është lënë kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur pamundësia e përmbushjes së njërit nga të dy llojet e detyrimit ka ndodhur për faj të kreditorit dhe ky nuk pranon të ekzekutohet lloji tjetër i detyrimit dhe të kërkojë të shpërblehet dëmi. Në rast se zgjedhja i është lënë kreditorit dhe pamundësia i ngarkohet debitorit, kreditori mund të zgjedhë detyrimin tjetër ose të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 441

Kur të dy llojet e detyrimit janë bërë të pamundura dhe debitori duhet të përgjigjet për njërin prej tyre, ai duhet të paguajë vleftën e detyrimit që është bërë i pamundur i fundit, në qoftë se zgjedhja i është lënë atij.

Në qoftë se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit, ky ka të drejtë të kërkojë vleftën e njërit ose tjetrit lloj detyrimi.

KREU IV
DETYRIME TË PJESËTUESHME E TË PAPJESËTUESHME

Detyrime të pjesëtueshme
Neni 442

Kur shumë debitorë ose kreditorë marrin pjesë në të njëjtin detyrim dhe ky është i pjesëtueshëm, secili debitor është i detyruar të ekzekutojë dhe secili kreditor ka të drejtë të kërkojë një pjesë të barabartë të detyrimit, përveç kur në kontratë ose në ligj është parashikuar ndryshe.

Detyrime të papjesëtueshme
Neni 443

Kur janë shumë debitorë në të njëjtin detyrim, që është i papjesëtueshëm, të gjithë debitorët quhen debitorë solidarë.

Detyrimi është i papjesëtueshëm nga vetë natyra e tij si i tillë dhe nga qëllimi i palëve në kontratë. Në të tilla raste detyrimi mbetet i papjesëtueshëm edhe për trashëgimtarët e debitorëve.

Neni 444

Detyrimet e papjesëtueshme rregullohen nga dispozita që kanë lidhje me detyrimet solidare, përveç sa parashikohet në këtë kre.

KREU V
DETYRIMET MONETARE

Neni 445

Detyrimi për të paguar një shumë parash shlyhet me vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

Neni 446

Detyrimi monetar përmbushet me monedhën që është në qarkullim në shtetin ku bëhet pagimi ose me monedhën e pranuar në kontratë.

Neni 447

Kur kreditori ka një llogari rrjedhëse në shtetin ku duhet ose mund të bëhet pagesa, debitori mund të përmbushë detyrimin duke kredituar në këtë llogari shumën përkatëse, përveç kur kreditori e ka përjashtuar pagesën në këtë llogari.

Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari.

Neni 448

Pagesa kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit.

Neni 449

Në rast se pagimi duhet të kryhet në një vend tjetër nga vendbanimi i kreditorit në kohën e lindjes së detyrimit dhe përmbushja e këtij detyrimi do të vështirësohej së tepërmi debitori mund të pezullojë pagimin derisa kreditori të ketë caktuar një vend tjetër i cili do të mënjanonte shpenzimet e tepërta.

Neni 450

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, me monedhën zyrtare të vendit ku bëhet pagimi. Përqindja e kamatës caktohet me ligj.

Në mbarim të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës së detyruar mbi bazën e të cilës është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori të provojë ndonjë dëm. Kur kreditori provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori detyrohet t'i paguajë atij pjesën tjetër të dëmit.

Neni 451

Kur detyrimi lidhet me pagesen e një shume parash në monedhë që nuk ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin në monedhën që ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, përveç kur në ligj ose në kontratë parashikohet ndryshe.

Neni 452

Kur detyrimi lidhet me pagesën e një shume parash në monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku duhet të kryhet pagesa dhe debitori pretendon se nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin në këtë monedhë, kreditori mund të pranojë shlyerjen në monedhën e vendit të kryerjes së pagesës.

Rregulli i mësipërm zbatohet edhe kur debitori detyrohet të bëjë pagesën me monedhën e pranuar në fillim.

Neni 453

Kur detyrimi duhet të ekzekutohet me një monedhë të ndryshme nga ajo e pranuar në fillim, konvertimi duhet të bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të ditës së pagimit.

Neni 454

Neni 450 i këtij Kodi nuk i heq të drejtën kreditorit që të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga fakti që nga dita e vënies në vonesë të debitorit ka pësuar ndryshime kursi i këmbimit të monedhës që përcaktohet në detyrim.

TITULLI II
EKZEKUTIMI DHE SHUARJA E DETYRIMEVE

KREU I
EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE

Neni 455

Debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij.

Neni 456

Detyrimi për dorëzimin e një sendi të caktuar përmban edhe kujdesin që duhet të tregohet për ruajtjen e tij në dorëzim.

Neni 457

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i sendeve të përcaktuara vetëm në lloj, ato nuk mund të jenë me cilësi më të dobët se sa cilësia mesatare.

Neni 458

Dorëzimi i sendeve bëhet sipas mënyrës së caktuar në kontratë dhe kur kjo nuk është caktuar bëhet:

a) me dhënien e tyre në dorë personit që ka fituar pronësinë e tyre ose personit që heq të drejta prej tij;

b) me dhënien transportuesit ose postës për t'ia dorëzuar fituesit, në vendin e treguar prej tij;

c) me dhënien fituesit në dorë ose dërgim nëpërmjet postës të dokumenteve (fletë ngarkese, dëshmi depozitimi) që i japin të drejtën e disponimit të mallit.

Neni 459

Debitori nuk mund të ekzekutojë detyrimin pjesë-pjesë edhe sikur ai të jetë i pjesëtueshëm, pa pëlqimin e kreditorit.

Neni 460

Detyrimi mund të ekzekutohet edhe nga një person i tretë, që nuk është debitor, përveç kur kreditori është i interesuar që ekzekutimi të bëhet nga debitori, ose kur kreditorit i është njoftuar kundërshtimi i debitorit.

Vendi i ekzekutimit të detyruar

Neni 461

Në rast se vendi ku duhet të ekzekutohet detyrimi nuk caktohet në kontratë, nga ligji ose nuk kuptohet nga vetë natyra e detyrimit, ekzekutimi bëhet:

a) për dorëzimin e një sendi të paluajtshëm, në vendin ku ndodhet ai;

b) për sendet që janë të përcaktuara në mënyrë individuale, në vendin ku ndodheshin kur lindi detyrimi;

c) për dorëzimin e një sendi të përcaktuar në lloj dhe në sasi, në vendin ku debitori ushtron veprimtarinë e tij profesionale ose në vendbanimin e tij;

ç) për detyrimet në para, sipas rregullave të përcaktuara në kreun V të pjesës IV të këtij Kodi.

Neni 462

Kreditori nuk mund të detyrohet të pranojë një gjë të ndryshme nga sa është përcaktuar në objektin e detyrimit edhe sikur vlefta e gjësë së ofruar të jetë më e madhe.

Afati i ekzekutimit të detyrimit

Neni 463

Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërkimit.

Neni 464

Afati i caktuar në kontratë prezumohet se është caktuar në dobi të debitorit, përveç kur nga vullneti i palëve ose natyra e detyrimit del ndryshe. Ekzekutimi i detyrimit para mbarimit të afatit nuk quhet i pavlefshëm, përveç kur afati është caktuar në dobi të kreditorit.

Neni 465

Debitori nuk mund të pretendojë të drejtën e afatit kur:

a) ka falimentuar;

b) nuk ka dhënë garancitë e premtuara;

c) garancitë që sigurojnë kredinë janë pakësuar për fajin e tij, përveç kur ato mbeten, përbëjnë ende një siguri të mjaftueshme për ekzekutimin e detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit
Neni 466

Ekzekutimi i detyrimit duhet t'i bëhet vetë kreditorit ose përfaqësuesit të vet, ose një personi të autorizuar nga kreditori, nga ligji ose nga gjykata.

Ekzekutimi i detyrimit që i bëhet një personi që nuk është autorizuar për ta pranuar, e shkarkon debitorin vetëm në rast se kreditori ka pranuar më vonë ekzekutimin, ose vërtetohet se ka përfituar prej tij.

Ekzekutimi ndaj një të treti
Neni 467

Debitori që ekzekuton një detyrim ndaj një personi, i cili sipas rrethanave të padyshimta duket se është i autorizuar ta pranojë atë, shkarkohet nga detyrimi në qoftë se provon se ka qënë në mirëbesim.

Personi që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, është i detyruar t'i kthejë kreditorit të vërtetë, atë që ka marrë nga ekzekutimi i detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit të pazotë për të vepruar
Neni 468

Kur ekzekutimi i detyrimit i është bërë një kreditori që nuk ka zotësi për të vepruar, shkarkon debitorin po aq sa ka vajtur në dobi të këtij kreditori, ose të përfaqësuesit të tij ligjor.

Ekzekutimi për llogari të shumë detyrimeve
Neni 469

Kur ekzekutimi kryhet për llogari të shumë detyrimeve dhe ndaj të njëjtit kreditor, debitori mund të përcaktojë në kohën e ekzekutimit se cilin detyrim po ekzekuton.

Kur nuk ekziston një përcaktim i debitorit për rradhën e ekzekutimit, në fillim ekzekutohet detyrimi që i ka kaluar afati, nëse ekzistojnë më shumë të tillë, ekzekutimi fillon nga detyrimi me vlerë dhe në rast se janë disa të tillë, fillon nga më i vjetri dhe kur këta kanë të njëjtën vjetërsi, ekzekutimi bëhet proporcionalisht.

Neni 470

Ekzekutimi në para për llogari të një detyrimi të caktuar, përmban në fillim shlyerjen e shpenzimeve, pastaj atë të kamatave të arrira dhe pastaj të vetë detyrimit e të kamatave të zakonshme ndaj tij.

Kreditori mund të refuzojë pagesën, në rast se debitori gjatë ekzekutimit cakton një renditje tjetër ose mund të mos pranojë shlyerjen e plotë të vleftës së detyrimit; pa marrë edhe kamatat e arrira, ato në vazhdimësi si dhe shpenzimet përkatëse.

Neni 471

Kreditori mund të mos pranojë ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të ndryshëm nga ai që është përcaktuar në kontratë edhe sikur vlefta e sendit të ofruar të jetë e barabartë apo më e madhe.

Shpenzimet e ekzekutimit, dëftesat përkatëse

Neni 472

Shpenzimet janë në ngarkim të atij që ekzekuton detyrimin, ndërsa shpenzimet e dëftesës janë në ngarkim të atij, në favor të të cilit ajo është lëshuar.

Neni 473

Për çdo pagesë të kryer në ekzekutim të detyrimit kreditori jep një dëftesë, përveç kur rezulton ndryshe nga kontrata.

Në rast se kreditori disponon një dokument nga përmbajtja e të cilit rezulton detyrimi, debitori që e ka ekzekutuar atë mund të kërkojë kthimin ose prishjen e dokumentit, përveç kur kreditori ka interesa të arsyeshme për ruajtjen e tij dhe me kusht që ai të shënojë në dokument ekzekutimin e detyrimit.

Kur kreditori refuzon të zbatojë detyrimin sipas paragrafit të mësipërm, debitori mund të pezullojë ekzekutimin e detyrimit. Kur kreditori pretendon se ka humbur dokumnetin detyrohet t'i japë debitorit një deklaratë me shkrim ku të pranohet ekzekutimi i detyrimit. Deklarata duhet të jetë noteriale kur kërkohet nga ligji.

Neni 474

Kur pagesat e njëllojta për shlyerjen e detyrimit duhet të bëhen në mënyrë periodike, dëftesat e lëshuara për dy pagesa rradhazi prezumojnë kryerjen edhe të pagesave të mëparëshme.

Dëftesa e lëshuar nga kreditori për detyrimin kryesor, prezumon se janë shlyer gjithashtu edhe kamatat e shpenzimet e këtij detyrimi.

Lirimi i sendeve nga garancitë

Neni 475

Kreditori që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, duhet të lirojë sendet nga garancitë reale që janë dhënë për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit edhe nga çdo ndalim tjetër që mund të kufizojë përdorimin e pasurisë.

KREU II

EFEKTET E MOSEKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 476

Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveç kur ai provon se mospërmbushja nuk ka ndodhur për fajin e tij.

Në këtë rast kreditori ka të drejtë:

a) të kërkojë ekzekutimin në natyrë të detyrimit, veçanërisht dorëzimin e sendit ose kryerjen e punimeve, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit; ose

b) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit.

Neni 477

Debitori që në ekzekutimin e detyrimit përdor punën e të tretëve përgjigjet për veprimet e tyre, të kryera me faj, si të ishin të vetat.

Neni 478

Kur detyrimi ka lidhje me veprime që mund të kryhen edhe nga persona të tjerë dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin, kreditori ka të drejtë të kërkojë t'i kryejë ai vetë për llogari të debitorit.

Neni 479

Çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon palët nga përgjegjësia për mosekzekutimin e detyrimeve është e pavlefshme.

Neni 480

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur për fajin e debitorit, kreditori ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Debitori është me faj kur, me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që e kanë bërë të pamundur ekzekutimin ose kur nuk ka marrë masa për ta ndaluar atë.

Vonesa e debitorit

Neni 481

Debitori që nuk përmbush një detyrim të kërkueshëm në afatin e caktuar, quhet se është në vonesë (morë), përveç kur mosekzekutimi është rrjedhim i rrethanave që nuk kanë lidhje me fajin e debitorit.

Debitori vihet në vonesë me anë të një njoftimi me shkrim.

Nuk është e nevojshme vënia në vonesë kur:

a) debitori ka deklaruar me shkrim se nuk dëshiron të ekzekutojë detyrimin;

b) ka kaluar afati brenda të cilit do të ekzekutohej detyrimi.

Kur debitori vdes dhe afati i caktuar për ekzekutimin e detyrimit mbaron pas vdekjes së tij, trashëgimtarët e tij quhen se janë në vonesë me mbarimin e 15 ditëve nga dita e njoftimit me shkrim nga kreditori.

c) Kur detyrimi rrjedh nga një akt i paligjshëm.

Neni 482

Debitori që është në vonesë nuk çlirohet nga pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit, edhe sikur kjo të jetë shkaktuar pa fajin e tij e të kreditorit, përveç kur provon se objekti i detyrimit do të ishte shkatëruar apo dëmtuar edhe sikur të ishte nën kujdesin e kreditorit.

Humbja ose dëmtimi i një sendi të marrë në menyrë të paligjshme, nuk e shkarkon personin që e ka marrë atë nga detyrimi për të rikthyer vleftën e tij.

Neni 483

Dispozitat mbi vonesën nuk zbatohen për detyrimet që përmbajnë mosveprime. Çdo veprim i kundërt përbën mospërmbushje të detyrimit.

Neni 484

Kreditori mund të mos pranojë ofertën e debitorit që është me vonesë për ekzekutimin e detyrimit, në rast se ajo nuk përmban edhe shpërblimin e dëmit të pësuar dhe shpenzimet e bëra gjatë vonesës, ose kur kreditori për shkak të vonesës së debitorit nuk ka interes për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 485

Debitori që ka një kredi të kërkueshme ndaj kreditorit të tij, mund të pezullojë zbatimin e detyrimit deri në pagesën e kredisë, me kusht që ndërmjet kredisë dhe detyrimit të ketë lidhje të mjaftueshme, siç mund të jetë ndër të tjera, qënia e një raporti të vetëm juridik ose të marrëdhënieve që palët kanë patur rregullisht.

Pezullimi i ekzekutimit të detyrimit nuk mund të kërkohet kur:

a) ekzekutimi i detyrimit nga pala tjetër bëhet i pamundur për shkak të vonesës së kreditorit, ose është i pamundur në mënyrë të përhershme;

b) kredia e palës tjetër është e pasekuestrueshme.

Neni 486

Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për mosekzekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuara nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi që mund të nxirrej në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar). Bëjnë pjesë në shpërblimin për riparimin e dëmit edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, që kanë lidhje me rrethanat mbi të cilat bazohet përgjegjësia e palës, shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të përcaktuar dëmin dhe përgjegjësinë, si dhe ato që janë nevojitur për të gjetur një zgjidhje jashtë gjyqësore të përmbushjes së detyrimit.

Neni 487

Në kontratë me detyrime të dyanshme, palët duhet të ekzekutojnë detyrimin e tyre në të njëjtën kohë, përveç kur nga kontrata ose nga natyra e detyrimit del se njëra palë duhet të ekzekutojë detyrimin e saj më parë se tjetra.

Neni 488

Kur në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të një pale është bërë i pamundur pa fajin e asnjërës palë, secila prej tyre nuk ka të drejtë të kërkojë nga tjetra ekzekutimin e detyrimit ose shpërblimin e dëmit, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që t'i kthejë atë që është dhënë për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 489

Në qoftë se në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të njërës palë është bërë i pamundur, për shkak se pala tjetër ka rënë në paaftësi paguese, ose ka falimentuar ose për ndonjë rrethanë tjetër të ndodhur për faj të saj, pala tjetër ka të drejtë të mos zbatojë detyrimet e veta, derisa t'i garantohet ekzekutimi i detyrimit në dobi të saj, ose të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës.

Neni 490

Kur është vendosur që kreditorit t'i paguhet shpërblimi për mosekzekutimin e detyrimit ose për ekzekutimin me vonesë të tij, gjykata duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit, mund të caktojë një afat tjetër për pagimin e këtij shpërblimi, ose të lejojë që të paguhet me këste.

Vonesa e kreditorit

Neni 491

Kreditori është në vonesë kur pa ndonjë shkak të ligjshëm nuk pranon ekzekutimin e detyrimit nga ana e debitorit, ose që për shkak të rrethanave të krijuara me faj prej tij, nuk përmbush detyrimin ndaj debitorit, pa të cilin ky nuk mund të ekzekutojë detyrimin e tij.

Neni 492

Kur kreditori është në vonesë, debitori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar prej saj dhe lirohet nga përgjegjësia në rast se më vonë ekzekutimi i detyrimit të tij bëhet i pamundur, përveç kur pamundësia e ekzekutimit ndodh për fajin e tij.

Në detyrimet në para, kur kreditori është në vonesë, debitori nuk paguan kamatë.

Neni 493

Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.

Neni 494

Kreditori gjatë vonesës së tij nuk mund të kërkojë marrjen e masave për një ekzekutim të detyruar.

Neni 495

Kur kreditori është në vonesë ose nuk gjendet, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin duke e depozituar sendin në një person që ushtron veprimtari depozitimi ose në një vend që caktohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit të detyrimit. Kur objekt i detyrimit janë para, letra ose dokumente me vleftë ose sende të çmueshme, depozitohen në bankë.

Me depozitimin ndërpritet kamata.

Në rastet kur depozitimi kërkon shpenzime të mëdha, bëhet me vështirësi ose sendi që vihet në depozitë prishet shpejt ose për vetë natyrën e tij, nuk mund të lihet në depozitë, debitori, pasi të ketë lajmëruar kreditorin, kërkon nga gjykata që të lejohet të shesë sendin e mësipërm dhe vleftën e nxjerrë nga shitja ta depozitojë në bankën e shtetit në emër të kreditorit.

Kur debitori tërheq sendin e depozituar para se të jetë pranuar nga kreditori, depozitimi quhet se nuk është bërë.

Depozituesi i dorëzon sendin kreditorit vetëm pasi ky të ketë shlyer të gjitha shpenzimet për ekzekutimin e detyrimit.

KREU III

ZËVENDËSIMI DHE KALIMI I KREDISË

Zëvendësimi i debitorit

Neni 496

Zëvëndësimi i debitorit me një person tjetër, i cili merr përsipër detyrimin, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit. Debitori i zëvendësuar shkarkohet nga detyrimi i tij ndaj kreditorit.

Garancitë e dhëna nga persona të tretë për detyrimin shuhen, në rast se këta nuk kanë dhënë pëlqimin që ato të mbeten edhe për debitorin e ri. Pengu ose hipoteka e dhënë nga debitori i mëparshëm mbeten në fuqi.

Neni 497

Kreditorit mund t'i kundrejtohen nga debitori i ri të gjitha prapsimet që rrjedhin nga detyrimi që ai ka marrë përsipër dhe që mund t'i kundrejtonte edhe debitori i mëparshëm, përveç atyre që lidhen me personin e këtij të fundit.

Neni 498

Marrëvështja sipas të cilës debitori dhe një person i tretë bëhen bashkëdebitorë në një detyrim, kur është marrë pëlqimi i kreditorit, nuk mund të prishet ose të ndryshohet, pa pëlqimin e kreditorit. Të dy bashkëdebitorët përgjigjen ndaj tij solidarisht.

Kalimi i kredive

Neni 499

(Shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999 neni 1)

Kreditori mund t'ia kalojë kredinë e vet një personi tjetër edhe pa miratimin e debitorit, me kusht që kredia të mos ketë karakter të ngushtë personal dhe kalimi të mos jetë ndalur nga ligji. Veçanërisht nuk lejohet kalimi i kredisë një personi tjetër, kur rrjedh nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit, si dhe i kredive që nuk mund të sekuestrohen.

Palët në një marrëveshje mund të përjashtojnë kalimin e kredisë, por marrëveshja nuk mund t'i kundrejtohet atij që i kalon kredia po të mos provohet se ai e njihte atë në momentin e kalimit.

Dispozitat për kalimin e kredisë nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 500

Kredia kalon së bashku me privilegjet, garancitë dhe aksesorët e tjerë, duke përfshirë edhe kamatat për kohën e kaluar, përveç kur në kontratë parashikohet ndryshe.

Personi që bën kalimin e kredisë nuk mund t'i kalojë personit tjetër posedimin e sendit të marrë peng pa miratimin e palës tjetër (pengdhënësit). Në të kundërtën kreditori mbetet ruajtës i pengut.

Neni 501

Kalimi i kredisë duhet të bëhet me shkresë, ndryshe nuk është i vlefshëm.

Neni 502

Kalimi kredisë ka efekt ndaj debitorit dhe ndaj personave të tretë, nga dita që debitori e ka pranuar ose i është njoftuar nga kreditori i mëparshëm ose nga kreditori i ri.

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin e tij, përpara se të ishte njoftuar për kalimin e kredisë, shkarkohet nga detyrimi.

Neni 503

Kur kredia u është kaluar disa personave të veçantë, preferohet në shlyerje kalimi që i është njoftuar më përpara debitorit, ose që është pranuar më parë nga debitori, me një dokument (shkresë) me datë të saktë edhe sikur data të jetë e mëvonshme.

Neni 504

Kalimi i kredisë nuk cenon mjetet mbrojtëse të debitorit.

Debitori mund t'i kundrejtojë kreditorit të ri prapësimet që mund t'i drejtonte kreditorit të mëparshëm, në kohën që i është njoftuar kalimi i kredisë.

Ai mund të kërkojë t'i bëhet kompensimi i një kredie ndaj kreditorit të parë, qoftë dhe ende e pa kërkueshme në atë kohë, me kusht që të mos jetë bërë e kërkueshme mbas cedimit të kredisë.

Neni 505

Kur kalimi i kredisë bëhet me titull barësor kreditori është garant për ekzistencën e kredisë në kohën e kalimit të saj.

Kur kalimi bëhet falas, kreditori nuk është garant për ekzistencën e kredisë.

Neni 506

Kreditori që kalon kredinë nuk përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, përveç kur ka marrë përsipër garancinë.

Në këtë rast përgjigjet për aq sa ka marrë. Veç kësaj duhet të përgjigjet për kamatat, për shpenzimet e kalimit, dhe ato që personi që i ka kaluar kredia ka bërë për ndjekjet ligjore ndaj debitorit dhe të shpërblejë dëmin.

Marrëveshja që synon të rëndojë përgjegjësinë e personit që kalon kredinë, është e pavlefshme. Kur kreditori që kalon kredinë ka garantuar aftësinë paguese të debitorit, garancia pushon, në qoftë se mosekzekutimi i kredisë për paaftësi paguese të debitorit ka ardhur nga pakujdesia e kreditorit të ri për të ndjekur çështjen ndaj debitorit.

Neni 507

Kreditori që bën kalimin e kredisë duhet t'i dorëzojë kreditorit tjetër dokumentet që provojnë kredinë, të cilat janë në posedimin e tij.

Kur është kaluar vetëm një pjesë e kredisë, kreditori detyrohet t'i dorëzojë kreditorit tjetër një kopje autentike të dokumenteve.

KREU IV
SHUARJA E DETYRIMEVE

Përtëritja

Neni 508

Detyrimet shuhen me përtëritje, kur palët me marrëveshje zëvendësojnë detyrimin fillestar, me një detyrim tjetër të ndryshëm nga i pari.

Neni 509

Dorëzania, pengu dhe hipoteka e kredisë fillestare shuhen përveç kur palët janë marrë vesh shprehimisht që ato të ruhen edhe për kredinë e re.

Neni 510

Përtëritja është e pavlefshme në rast se detyrimi fillestar është i pavlefshëm.

Kur detyrimi fillestar rrjedh nga një titull i anulueshëm, përtëritja është e vlefshme në rast se debitori ka marrë përsipër detyrimin e ri, duke njohur vesin e titullit fillestar.

Falja e detyrimit

Neni 511

Deklarata me shkrim e kreditorit për faljen e detyrimit, e shuan atë kur i njoftohet debitorit, përveç kur ky i fundit deklaron brenda një afati të caktuar se nuk dëshiron të përfitojë nga falja.

Neni 512

Kur debitori ka në dorë dokumentin privat që provon detyrimin, prezumohet se ky është shuar me falje, përveç kur provohet se dokumenti nuk i është kthyer nga kreditori me dashje.

Neni 513

Heqja e garancisë ndaj detyrimit, nuk prezumon faljen e tij.

Kompensimi

Neni 514

Kur dy persona i detyrohen njëri tjetrit në para ose në sende të një lloji e të zëvendësueshme dhe detyrimet e tyre janë të kërkueshme, të sakta e të caktuara në shumë ose në sasi, detyrimet e të dy palëve shuhen, duke bërë kompensimin ndërmjet tyre. Detyrimet shuhen deri në shumën ose sasinë e detyrimit më të vogël.

Neni 515

Kompensimi shuan të dy detyrimet nga data e bashkimit të tyre.

Kur për njërën nga kreditë ose mbi të dyja janë paguar kamata, kompensimi bëhet deri në afatin e fundit në të cilën janë paguar kamatat.

Parashkrimi nuk e ndalon kompensimin, në rast se nuk është plotësuar në ditën kur është bërë bashkimi i të dy detyrimeve.

Neni 516

Kompensimi bëhet me anë të një deklarate që njëra palë i dërgon palës tjetër.

Deklarata nuk mund të bëhet me afat ose me kusht.

Kur kompensimi nuk mbulon gjithë kredinë ose kur kreditori ka nevojë të mbajë titullin e kredisë për të ushtruar të drejtat e tjera të tij, mund ta mbajë atë me kusht që të shënojë në titull përmbajtjen e deklaratës dhe t'i japë palës tjetër një kopje të titullit të kredisë.

Neni 517

Kur deklarata për kompensimin e dhënë nga njëra palë, nuk pranohet nga pala tjetër, ajo detyrohet të njoftojë menjëherë palën që ka dërguar deklaratën, duke parashtruar shkaqet e mospranimit.

Neni 518

Nuk mund të kompensohen pa pëlqimin e kreditorit:
a) kreditë që rrjedhin nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit;
b) kreditë që nuk mund të sekuestrohen;
c) kreditë që rrjedhin nga tatimet dhe taksat.

Neni 519

Kompensimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufrukti ose pengu mbi kredinë.

Neni 520

Dorëzanësi mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj debitorit kryesor. Debitori kryesor nuk mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj dorëzënësit.

Neni 521

Kur dy detyrime nuk janë të pagueshme në një vend, nuk mund të bëhet kompensimi i tyre, veçse duke llogaritur shpenzimet e nevojshme për transferimin e tyre në vendin e ekzekutimit.

Neni 522

Kur kreditë dhe detyrimet monetare përfshihen në një llogari të vetme, ato kompensohen menjëherë, sipas renditjes që palët kanë pranuar në marrëveshje dhe në mungesë të saj sipas rregullave të parashikuara në nenet 469 dhe 470 të këtij Kodi.

Pala që administron llogarinë, pasi e mbyll atë me kompensimin e bërë, i njofton palës tjetër se cila është mbetja, datën e saktë të llogaritjes, si dhe zërat që përbëjnë llogarinë dhe që nuk i janë komunikuar ende palës tjetër.

Në qoftë se pala tjetër nuk kundërshton atë në një afat të arsyeshëm, mbetja e njoftuar konsiderohet si e pranuar nga palët.

Neni 523

Kur në një deklaratë kompensimi nuk tregohen në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e përfshira në kompensim, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 470 të këtij Kodi.

Secila palë mund të kundërshtojë menjëherë kompensimin e bërë, në rast se llogaritja e detyrimit, e shpenzimeve dhe e interesave nuk është kryer sipas rregullave të sipërpërmendura.

Bashkimi i cilësive të kreditorit dhe debitorit në një të vetëm

Neni 524

Detyrimi shuhet kur cilësitë e kreditorit dhe të debitorit bashkohen në një person të vetëm.

Kur ky bashkim merr fund, detyrimi lind përsëri.

Neni 525

Bashkimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufrukti ose pengu mbi kredinë.

Shuarja për shkak pamundësie ekzekutimi

Neni 526

Detyrimi shuhet kur ekzekutimi i tij bëhet i pamundur pa fajin e debitorit dhe para se ky të jetë vënë në vonesë.

Detyrimi shuhet edhe kur debitori ndonëse është në vonesë, provon se pamundësia do të ekzistonte edhe sikur të ishte kreditori në vendin e tij.

Në këto raste, debitori duhet t'i kthejë kreditorit atë që ka fituar pa shkak.

Neni 527

Kur pamundësia për ekzekutimin e detyrimit është e përkohshme, debitori nuk është përgjegjës për vonesën e ekzekutimit për kohën që ajo zgjat.

Por, detyrimi shuhet edhe kur pamundësia zgjat për aq kohe sa sipas titullit të detyrimit dhe natyrës së tij, debitori nuk mund të detyrohet më ta kryejë atë ose kreditori nuk ka më interes.

Neni 528

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur vetëm pjesërisht, detyrimi ekzekutohet në pjesën që mund të ekzekutohet.

Neni 529

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i një sendi dhe ky dëmtohet tërësisht, ose humbet pa fajin e debitorit dhe para se ky të vihet në vonesë, kreditori hyn në të drejtat e debitorit lidhur me këtë send, në varësi të faktit që ka shkaktuar pamundësinë e ekzekutimit të detyrimit. Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë ç'ka ka marrë si rrjedhojë e shpërblimit të dëmeve.

TITULLI III
MJETET PËR TË SIGURUAR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 530

Kreditori mund të shpërblehet me të gjithë pasurinë e tashme dhe të ardhshme të debitorit të tij, përveç rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe.

Një pronë mund të rëndohet nga pronari i saj, me qëllim që të sigurohet pagimi i një detyrimi.

Neni 531

Kreditorët kanë të drejta të barabarta për t'u shpërblyer me pasurinë e debitorit, përveç shkaqeve të ligjshme të preferimit.

Janë shkaqe të ligjshme të preferimit privilegjet, pengu dhe hipoteka.

Neni 532

Pengu dhe hipoteka mund të vihen vetëm për një detyrim efektiv.

Pengu dhe hipoteka mund të vihen si për një detyrim të pronarit të sendit të lënë peng ose hipotekë, ashtu dhe për një detyrim të një personi tjetër.

Neni 533

Pengu ose hipoteka mund të garantojë një kredi ekzistuese ose një kredi të ardhshme. Kredia për të cilën jepet garancia duhet të jetë e përcaktuar qartë.

Pengu ose hipoteka mund të vihet edhe për një detyrim me kusht.

Neni 534

Pengu ose hipoteka shtrihen përkatësisht mbi të gjitha punimet që përmirësojnë vleftën e pronës, kreditë dhe shpërblimet që u shtohen ose që zëvendësojnë pasurinë e rënduar, duke përfshirë edhe atë që kompensohet nga zhvleftësimi.

Neni 535

Në qoftë se sendet e lëna peng ose hipotekë humbasin ose zhvleftësohen, pagesa e shumave, për të cilat detyrohen siguruesit ose të tretët që përgjigjen për zhdëmtimin, nxirren nga pagesa e kredive që lidhen me pengun ose hipotekën, përveç rastit kur ato përdoren për të ndrequr humbjen ose zhvleftësimin e sendeve.

Neni 536

Në qoftë se sendi i dhënë në peng ose i lëshuar në hipotekë humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast fator, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e kreditorit, ky i fundit mund të kërkojë që t'i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të kredisë së tij.

Neni 537

Pengu dhe hipoteka janë të papjesëtueshme edhe sikur detyrimi të jetë i pjesëtueshëm.

Neni 538

Kur pengu ose hipoteka janë vënë për të siguruar një detyrim të një personi tjetër, pronari i sendit të lënë peng ose hipotekë mund t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapsimet që mund t'i kundrejtonte debitori dhe të kërkojë kompensimin e detyrimit me kreditë që ka debitori ndaj kreditorit.

Neni 539

Kur kreditori nuk paguhet tërësisht nga sendi i lënë peng ose hipotekë, ka të drejtë që pjesën e kredisë së papaguar ta nxjerrë nga çdo pasuri tjetër e debitorit, por pa patur të drejtën e preferimit ndaj kreditorëve të tjerë, siç e kishte për sendin e lënë peng, ose hipotekë.

Neni 540

Është e pavlefshme marrëveshja sipas së cilës përcaktohet se në mungesë të pagesës së kredisë në afatin e caktuar, pronësia mbi sendin e hipotekuar ose të dhënë peng i kalon kreditorit.

KREU II
KUSHTI PENAL

Neni 541

Për mosekzekutimin ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimeve, palët mund të parashikojnë në kontratë pagimin e një shume të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër, për riparimin e dëmit ose për të nxitur ekzekutimin e detyrimit.

Neni 542

Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit.

Neni 543

Kur kushti penal është caktuar për rastin e mosekzekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Neni 544

Kur kushti penal është tepër i madh në krahasim me dëmin e pësuar nga kreditori, gjykata me kërkesën e debitorit mund të pakësojë kushtin disiplinor deri në nivelin e dëmit të pësuar.

Neni 545

Marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkresë, pavarësisht nga madhësia e tij dhe nga forma që kërkohet për kontratën kryesore.

KREU III
PENGU

Përkufizimi

Neni 546

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999, neni 2;
Shtuar fjali në fund të paragrafit të dytë, me ligjin nr. 121/2013, neni 9)

Pengu vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufruktin e kësaj pasurie ose të drejte. Pengu krijohet duke vendosur pasurinë ose titullin në posedim të kreditorit ose të një të treti të caktuar me marrëveshje midis palëve.

Dispozitat për pengun nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë. Dispozitat për pengun nuk zbatohen edhe në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Forma e kontratës
Neni 547

Kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose tek noteri, ndryshe është e pavlefshme. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu një përshkrim të pronës së lënë peng. Në rastin e pengut të pjesëve, pengu duhet të regjistrohet në librin e anëtarëve të shoqërisë. Në rastin e pengut të aksioneve, pengu duhet të regjistrohet në librin e aksionerëve, në aksionet e lëna peng.

Mund të lihet peng e gjitha ose një pjesë e pronave të përdorura në një ndërmarrje që vepron si një koncern veprues. Në një rast të tillë pengu është efektiv kur pronat i besohen një pale të tretë ose një kreditori, i cili nga ana e tij, do t'i menaxhojë ato si një koncern veprues i pandashëm.

Mbrojtja e kreditorit
Neni 548

Kreditori që ka humbur posedimin e sendit të marrë peng, përveç padisë posedimore mund të ushtrojë edhe padinë e rivendikimit, në qoftë se kjo i takon pengdhënësit.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 549

Kreditori detyrohet ta ruajë sendin e marrë në peng dhe përgjigjet, sipas rregullave të përgjithshme, për humbjen dhe dëmtimin e tij.

Personi që ka dhënë pengun detyrohet të paguajë shpenzimet e kryera për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sendit.

Neni 550

Në qoftë se sendi i dhënë peng sjell fryte ose të ardhura, kreditori ka të drejtë t'i bëjë ato të vetat, duke i përdorur së pari për shpenzimet dhe kamatat dhe pastaj për kredinë, përveç kur është parashikuar ndryshe në kontratë.

Neni 551

Kreditori nuk mund të përdorë sendin e dhënë peng pa patur pëlqimin e pengdhënësit, përveç kur përdorimi është i nevojshëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

Ai nuk mund ta japë sendin në peng ose t'ua lërë të tjerëve në përdorim.

Neni 552

Në qoftë se kreditori shpërdoron sendin e dhënë në peng, pengdhënësi mund të kërkojë vënien e sendit në sekuestro.

Neni 553

Personi që ka dhënë pengun nuk mund të kërkojë kthimin e sendit, në qoftë se nuk janë paguar tërësisht kredia, kamatat, si dhe shpenzimet që kanë lidhje me detyrimin dhe me pengun.

Në qoftë se pengu është dhënë nga një debitor, i cili ka ndaj të njëjtit kreditor një detyrim tjetër të lindur pas vënies së pengut dhe që është bërë i kërkueshëm përpara detyrimit të mëparshëm, kreditori ka vetëm të drejtën të mbajë sendin deri sa të paguhen plotësisht të dy kreditë.

Neni 554

Në rast se sendi i dhënë në peng cenohet ose i pakësohet vlefta në mënyrë të tillë që dyshohet nëse do të jetë i mjaftueshëm për sigurimin e kreditorit, ky i fundit, pasi të njoftojë pengdhënësin, mund të kërkojë prej gjykatës autorizimin për të shitur sendin.

Gjykata kur jep autorizim për shitje vendos edhe për depozitimin e çmimit të blerjes për të garantuar kredinë.

Pengdhënësi mund të shmangë shitjen dhe të kërkojë prej gjykatës kthimin e pengut, duke ofruar një garanci tjetër reale, të cilën gjykata e çmon të mjaftueshme.

Në rast cenimi ose pakësimi të vleftës së sendit të dhënë peng, pengdhënësi mund të kërkojë prej gjykatës autorizim për të shitur sendin, në qoftë se atij i paraqitet një rast i favorshëm.

Gjykata, kur jep autorizimin për shitje, vendos edhe për kushtet e shitjes dhe të depozitimit të çmimit të blerjes.

Neni 555

Kur sendet e lëna peng prishen, dëmtohen ose shpronësohen për interesa publike, kreditorët që janë të siguruar me peng, kanë të drejtë të paguhen me preferim, sipas rradhës së preferimit që kanë patur kreditë e tyre, nga shuma e shpërblimit të sendit ose nga çmimi i shpronësimit të tij.

Procedura e shitjes

Neni 556

Përpara se të procedohet për shitjen kreditori, me anë të gjykatës, i paraqet debitorit kërkesën për të paguar detyrimin dhe aksesorët e tij duke e paralajmëruar atë se në rast të kundërt do të kryhet shitja. Ky njoftim i duhet bërë edhe palës së tretë që ka dhënë pengun, në rastet kur kjo palë ekziston.

Në qoftë se kërkesa nuk kundërshtohet brenda pesë ditësh, kreditori mund ta shesë sendin në ankand ose, po qe se sendi ka një çmim tregu, mund ta shesë atë edhe me këtë çmim, me anë të një personi të autorizuar për shitje të tilla.

Kur pengu përfshin shumë sende, gjykata, e mbështetur në kundërshtimin e pengdhënësit, kufizon shitjen vetëm për sendin, vlefta e të cilit në lidhje me sendet e tjera, mjafton për të paguar debinë.

Për shitjen e sendit të dhënë peng palët mund të merren vesh për të përdorur edhe forma të tjera.

Neni 557

Kreditori pengmarrës, në mbarim të afatit detyrohet të vjelë të drejtat që rrjedhin nga kredia e marrë peng dhe kur kjo ka për objekt para ose sende të tjera të barazvlershme, vetë ose me kërkesën e debitorit duhet t'i depozitojë ato në vendin e caktuar në marrëveshje dhe, në mungesë të saj, në vendin e caktuar nga gjykata. Kur afati i kredisë i garantuar me pengun ka mbaruar, kreditori mban nga shuma e marrë aq sa nevojiten për përmbushjen e të drejtave të tij dhe mbetjen ia kthen pengdhënësit.

Neni 558

Kreditori mund të kërkojë nga gjykata që sendi t'i lihet atij me pagesë deri në shlyerjen e detyrimit, sipas vlerësimit të bërë nga ekspertë ose sipas çmimit të tregut, në qoftë se sendi ka një çmim tregu.

Neni 559

Në qoftë se kredia e dhënë në peng rezulton nga një dokument, pengdhënësi detyrohet t'ia japë këtë dokument kreditorit.

KREU IV
HIPOTEKA

Përkufizimi i hipotekës
Neni 560

Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi.

Sendet e hipotekueshme
Neni 561

Janë të hipotekueshme:
1. Sendet e paluajtshme.
2. Uzufruktet e këtyre sendeve përveç uzufruktit ligjor të prindërve, si dhe të drejtat enfiteotike mbi këto sende.

Llojet e hipotekave
Neni 562

Hipoteka vihet në bazë të kontratës ose të ligjit dhe me regjistrimin e saj. Kontrata duhet të bëhet me akt noterial.

Hipoteka ligjore
Neni 563

Kanë hipotekë në bazë të ligjit:
a) shitësi e çdo tjetërsues tjetër mbi sendet e paluajtshme të tjetërsuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga tjetërsimi;
b) bashkëtrashëgimtarët, anëtarët e shoqërive me aktivitet ekonomik e bashkëpjesëtarët e tjerë mbi sendet e paluajtshme të përbashkëta, në pjesët që u kanë takuar atyre për pagimin e shumave të caktuara për barazimin dhe plotësimin e pjesëve.

Neni 564

Servitutet që janë regjistruar pas regjistrimit të një hipoteke, nuk mund t'i kundrejtohen kreditorit hipotekar.
Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe për të drejtën e uzufruktit, të përdorimit dhe të banimit.

Hipoteka gjyqësore
Neni 565

Vendimi i gjykatës për pagimin e një shume parash, për përmbushjen e detyrimeve të vlerësuara apo për shpërblimin e dëmeve që do të rrjedhin më pas, përbën titull për vënien e hipotekës tek pasuria e debitorit.
Hipotekë mund të vihet edhe në bazë të një vendimi arbitrazhi që përbën titull ekzekutiv.

Neni 566

Kur hipoteka jepet nga një person që nuk është pronar i sendit, regjistrimi i saj quhet i vlefshëm vetëm kur sendi fitohet prej tij.

Hipoteka mbi sendet e ardhshme
Neni 567

Hipoteka mbi një send të ardhshëm, mund të regjistrohet vetëm kur të ekzistojë sendi.

Shtrirja e hipotekës
Neni 568

Hipoteka siguron kredinë për aq sa kjo do të jetë në kohën e shlyerjes së saj, duke përfshirë edhe kamatat, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e bëra për nxjerrjen e kredisë.

Neni 569

Hipoteka e vënë mbi pjesën e vet nga njëri prej pjesëtarëve në bashkëpronësi sjell efekt në lidhje me atë send ose me atë pjesë të sendit që do t'i jepet atij pas ndarjes.

Në qoftë se gjatë ndarjes njërit pjesëtar i jepet një send tjetër dhe i pahipotekuar prej tij, hipoteka kalon mbi këtë send me të njëjtën shkallë regjistrimi sikurse origjinali dhe brenda kufijve të vleftës së sendit të hipotekuar më përpara, me kusht që hipoteka të regjistrohet përsëri brenda 90 ditëve nga regjistrimi i së njëjtës ndarje.

Vendi i regjistrimit
Neni 570

Hipoteka regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme të vendit ku ndodhet kjo pasuri.

Neni 571

Detyrimet që rrjedhin nga titujt me urdhër ose tek prurësi mund të garantohen me hipotekë.

Efektet e pasaktësive të aktit
Neni 572

Hipoteka është e pavlefshme, kur në kontratën e hipotekës, ose në aktin bazë për vënien e hipotekës, apo në kërkesën për vënien e saj, në bazë të ligjit, ka pasaktësi për personin e kreditorit, të debitorit, të pronarit të sendit të lënë në hipotekë, për vetë sendin ose për shumën e kredisë të siguruar me hipotekë.

Shpenzimet e regjistrimit
Neni 573

Shpenzimet e regjistrimit të hipotekës janë në ngarkim të debitorit, përveç kur është parashikuar ndryshe, por ato duhet të parapaguhen nga kërkuesi.

Radha e hipotekave
Neni 574

Hipoteka sjell efekt dhe zë radhë nga data e regjistrimit të saj edhe kur titulli është për një kredi të ardhshme ose të kushtëzuar.

Neni 575

Numri rendor i regjistrimeve përcakton rradhën e tyre.

Kur në të njëjtën kohë shumë persona paraqesin kërkesë për të regjistruar në hipotekë ndaj të njëjtit person dhe po mbi ato prona, regjistrimi bëhet me të njëjtin numër dhe ky fakt shënohet në dëftesën që regjistruesi i jep secilit prej kërkuesve.

Neni 576

Hipotekat e regjistruara me të njëjtin numër dhe po mbi ato prona, konkurrojnë me njëra-tjetrën, në përpjesëtim me vleftën e tyre përkatëse.

Neni 577

Regjistrimi i një kredie shërben për të vënë në po atë radhë shpenzimet e aktit, të regjistrimit e të përtëritjes, si dhe shpenzime të tjera që nevojiten për procedurat ekzekutive.

Regjistrimi i një kredie në para që sjell kamatë, bën që kamata të qëndrojë në të njëjtën radhë përparësie me atë, me kusht që kamata të jetë përcaktuar në regjistrim.

Kamata në këtë rast kufizohet në dy vitet paraardhëse, si dhe në vitin në vazhdim në ditën që është vënë dorë e deri në ditën e mbylljes së procedimit të zbatimit forcërisht.

Efektet e hipotekës

Neni 578

Regjistrimi i hipotekës ka efekt për një periudhë prej 20 vjetësh nga data e kryerjes së tij. Efekti pushon në qoftë se nuk përtërihet përpara mbarimit të këtij afati. Pas mbarimit të afatit të treguar më sipër, kreditori mund të kryejë një regjistrim të ri, por në këtë rast hipoteka zë radhë dhe ka efekt kundrejt palëve të treta sipas datës së regjistrimit të ri.

Neni 579

Kalimi i kredisë së siguruar me hipotekë një personi tjetër dhe vënia e sekuestros mbi këtë kredi ka efekt pasi të jetë bërë shënimi përkatës në regjistrimin e hipotekës.

Neni 580

Në qoftë se kreditori që ka hipotekë mbi një ose më shumë prona del i dëmtuar për shkak se me çmimin e tyre është paguar tërësisht ose pjesërisht një kreditor i mëparshëm, hipoteka e të cilit shtrihej mbi prona të tjera të të njëjtit debitor, mund të nënvendësohet në hipotekën e regjistruar në favor të kreditorit të paguar, me qëllim që të ushtrojë padinë hipotekore mbi ato prona, duke u parapëlqyer ndaj kreditorëve të tjerë që vijnë pas tij në regjistrim. Po këtë të drejtë kanë edhe kreditorët që dëmtohen për shkak të nënvendësimit të sipërpërmendur.

Zbritja e hipotekës

Neni 581

Zbritja e hipotekave bëhet duke e kufizuar vetëm në një pjesë të pasurisë së treguar në regjistrim ose duke pakësuar shumën për të cilën është vënë regjistrimi.

Neni 582

Kërkesa për zbritjen e hipotekave sipas nenit të mësipërm nuk pranohet, në qoftë se sasia e pasurisë apo shuma ka qenë caktuar me marrëveshje ose me vendim gjykate.

Megjithatë, kur janë bërë pagesa të pjesshme, që shuajnë të paktën një të pestën e detyrimit fillestar, mund të kërkohet një pakësim përpjesëtimor i shumës.

Kur është vënë hipotekë mbi një ndërtesë, hipotekuesi që pas regjistrimit ka bërë mbindërtime, mund të kërkojë që hipoteka të pakësohet, në mënyrë që mbindërtimet të përjashtohen.

Shuarja e hipotekës

Neni 583

Hipoteka shuhet:

a) me shuarjen e detyrimit;

b) me humbjen e sendit të lënë në hipotekë, duke respektuar të drejtat e parashikuara prej nenit 536 të këtij Kodi;

c) me heqjen dorë të kreditorit;

ç) me pagimin e çmimit të shitjes me anë të ekzekutimit të detyrueshëm, kreditorëve të siguruar me hipotekë, sipas radhës së regjistrimit të tyre;

d) me kalimin e afatit për të cilin ishte kufizuar hipoteka.

Fshirja e regjistrimit të hipotekës

Neni 584

Regjistrimi i hipotekës fshihet:

a) me pëlqimin e kreditorit të dhënë me akt-noterial;

b) me vendim të formës së prerë të gjykatës që urdhëron fshirjen.

Fshirja e regjistrimit shuan hipotekën. Kur shkaku i shuarjes së detyrimit deklarohet i pavlefshëm, hipoteka lind dhe regjistrohet përsëri, por regjistrimi merr numër rendor të ri.

KREU V
DORËZANIA

Përmbajtja

Neni 585

Dorëzania është një veprim juridik me të cilën një person (dorëzënësi), detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor).

Dorëzania është e vlefshme edhe kur debitori nuk ka dijeni për atë.

Neni 586

Dorëzania qëndron vetëm për një detyrim efektiv.

Dorëzania mund të jepet si për një detyrim të ardhshëm, ashtu dhe për një detyrim me kusht.

Forma dhe vlefshmëria

Neni 587

Dorëzania duhet të bëhet me shkresë.

Neni 588

Dorëzania nuk është e vlefshme në qoftë se nuk është i vlefshëm detyrimi kryesor. Ajo mund të jepet si për debitorin kryesor, ashtu dhe për dorëzanësin e tij.

Efektet e dorëzanisë dhe detyrimet e palëve

Neni 589

Dorëzanësi përgjigjet për aq sa detyrohet debitori kryesor, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera që ka bërë kontraktori për të nxjerrë kredinë e tij, përveç kur në marrëveshje pranohet që dorëzania të jepet edhe për një pjesë të detyrimit, ose me kushte më të lehta ose më të pakta se detyrimi kryesor.

Dorëzania që kalon detyrimin ose që jepet në kushte më të rënda se detyrimi kryesor, është e vlefshme vetëm deri në kufijtë e këtij të fundit.

Neni 590

Dorëzanësi është i detyruar solidarisht mbi debitorin kryesor për ekzekutimin e detyrimit, përveç kur është parashikuar ndryshe me marrëveshje.

Palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos jetë i detyruar të paguajë para kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme,që detyrojnë debitorin të paguajë detyrimin. Në rast se dorëzanësi paditet dhe kërkon të përdorë një të drejtë të tillë, ai duhet të tregojë pasurinë e debitorit kryesor që do t'i nënshtrohet ekzekutimit. Dorëzanësi është i detyruar të parapaguajë shpenzimet e nevojshme, në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

Neni 591

Kur disa persona janë bërë dorëzanës për të njëjtin debitor, për të siguruar të njëjtin detyrim, secili prej tyre përgjigjet për të gjithë detyrimin, përveç kur ka marrëveshje për ndarjen e tij.

Neni 592

Dorëzanësi ka të drejtë t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundrejtonte këtij debitori dhe të kërkojë kompensimin e asaj që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur ky të ketë hequr dorë nga këto të drejta ose të ketë pranuar detyrimin.

Neni 593

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin në vend të debitorit, zë vendin e kreditorit në të gjitha të drejtat e tij ndaj debitorit.

Neni 594

Kur janë shumë debitorë kryesorë të detyruar solidarisht për të njëjtin detyrim, dorëzanësi që ka dhënë garanci për të gjithë ata, ka të drejtën e padisë së kthimit nga secili prej tyre për të marrë shumën që ka paguar.

Neni 595

Kur dorëzanësi ka ekzekutuar detyrimin e debitorit pa u paditur në gjyq dhe pa lajmëruar debitorin kryesor, ky mund t'i kundrejtojë dorëzanësit të gjitha prapsimet që do të mund t'i kundrejtonte kreditorit në kohën e ekzekutimit të detyrimit.

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit nuk ka të drejtë të kërkojë me padi nga debitori atë që ka ekzekutuar për të, në rast se edhe debitori ka ekzekutuar detyrimin e tij për shkak se dorëzanësi nuk e ka lajmëruar për ekzekutimin e detyrimit që ka bërë ai vetë.

Në të dy rastet, dorëzanësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër kreditorit dhe të kërkojë atë që ka ekzekutuar për debitorin kryesor.

Neni 596

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin duhet të lajmërojë menjëherë dorëzanësin. Në rast të kundërt, dorëzanësi, që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit, nuk e humbet të drejtën që të kërkojë nga debitori atë që ka ekzekutuar për të. Debitori, në këtë rast, është i detyruar të ekzekutojë për të dytën herë detyrimin, por ka të drejtë që të ngrejë padi kundër kreditorit për atë që ky ka fituar pa shkak.

Shuarja e dorëzanisë

Neni 597

Dorëzania shuhet me shuarjen e detyrimit kryesor.

Neni 598

Dorëzanësi shkarkohet nga detyrimi i tij në rast se kreditori ka hequr dorë nga privilegjet, pengu dhe hipoteka që i siguronin kredinë dhe për këtë shkak dorëzanësi nuk mund të zerë vendin e tij në këto të drejta.

Neni 599

Kur kreditori pranon vullnetarisht një pasuri, ose çdo gjë tjetër për pagimin e detyrimit kryesor, dorëzanësi lirohet nga detyrimi i tij edhe sikur kreditorit t'i rezultojë më pas një shkak evinksioni.

Neni 600

Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit.

Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë, as në një marrëveshje tjetër, dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.

KREU VI
KAPARI DHE PRIVILEGJET

A. Kapari

Përmbajtja
Neni 601

Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.

Efektet juridike
Neni 602

Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kapar, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për mosekzekutimin e kontratës është e detyruar t'i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

B. Preferimet (privilegjet)

Neni 603

Preferimi është një e drejtë, të cilën ligji e jep duke patur parasysh shkakun e kredisë.

Kreditë që caktohen si të preferuara, kanë përparësi nga gjithë kreditë e tjera.

Midis shumë kredive të preferuara, përparësia në ekzekutim përcaktohet nga ligji, sipas llojit të preferimit.

Neni 604

Kreditë që janë një lloj të preferuara, konkurrojnë ndërmjet tyre në proporcion me shumën e secilës kredi.

Radha e preferimit
Neni 605
(Ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999, neni 3)

Paguhen me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:

a) kreditë që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguruese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë;

b) kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj;

c) kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësuara nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;

ç) keditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;

d) kreditë e autorëve dhe të trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;

dh) kreditë e shtetit, që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme, të përcaktuara me ligj;

e) kreditë, që rrjedhin nga transaksionet financiare, të siguruara me barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj;

ë) kreditë, që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim tej kufirit të caktuar në shkronjën "b" të këtij neni;

f) shpërblimi i ndërmjetësimit që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të fundit të shpërblimit;

g) kreditë e siguruara me hipotekë ose me peng që nuk krijojnë barrë siguruese, sipas ligjit, nga vlefta e sendeve në hipotekë ose të lëna peng;

gj) kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vlefta e shitjes së sendeve;

h) kreditë e dhëna nga bankat, të cilat nuk përfshihen në shkronjën "e" dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;

i) kreditë për furnizimin me farëra, plehra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frutet) bujqësor të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kur ka disa kredi sipas shkronjës "a" dhe shkronjës "e" të këtij neni, rradha e preferimit, përcaktohet sipas kritereve të përcaktuar me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredie sipas shkronjës "a" preferim mbi kreditë sipas shkronjës "e", kredia sipas shkronjës "a" do të preferohet sipas shkronjës "e".

Përjashtohen nga radha e preferimit sipas këtij neni kreditë sipas shkronjës "e", që janë dhënë aktualisht, të cilat do të preferohen përpara kredive sipas shkronjës "dh" në rastet që vijojnë:

- kredia sipas shkronjës "e" është regjistruar sipas ligjit, ndërsa kredia sipas shkronjës "dh" nuk është regjistruar;

- kredia sipas shkronjës "e" është regjistruar sipas ligjit, përpara regjistrimit të kredisë sipas shkronjës "dh".

Neni 606

Kreditori mund ta mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mund ta shesë atë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit

Neni 607

Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik.

Kur veprimi juridik është bërë me kundërshpërblim, duhet që edhe personi, me të cilin debitori ka kryer këtë veprim, të ketë patur dijeni për qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por kur ky person është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë e fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit prezumohet, gjersa të provohet e kundërta.

Me deklarimin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk cënohen të drejtat që kanë fituar me kundërshpërblim personat e tretë me mirëbesim para ngritjes së padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik.

TITULLI IV
DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit
Neni 608

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

Neni 610

Është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj.

Neni 611

Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti.

Neni 612

Personi që ka shkaktuar dëmin duke qënë i shtrënguar nga nevoja për të shpetuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qënë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit.

Dëmi nga të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar
Neni 613

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.

Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijve nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 614

I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.

Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Dëmi nga personat nën mbikëqyrje

Neni 615

Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qënë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 616

Për dëmin përgjjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij.

Gjykata, mund të ulë masën e dëmshpërblimit, duke marrë parasysh moshën, shkallën e ndërgjegjes për veprimet e kryera, si dhe kushtet ekonomike të palëve, përveç kur për fajin e tij ka sjellë veten në këtë gjendje.

Publikimet mashtruese ose të pasakta

Neni 617

Kur vërtetohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota ose mashtruese, gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin tjetër që të publikojë një përgënjeshtrim, në mënyrën që ajo do ta quante të përshtatshme.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e përgënjeshtrimit edhe kur vërtetohet se publikimi i të dhënave nuk është i paligjshëm dhe i kryer me faj, se autori i tyre nuk kishte dijeni për karakterin e pasaktë ose të paplotë të këtyre të dhënave.

Përgjegjësia e punëdhënësit

Neni 618

Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij.

Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 619

Në qoftë se një person që ushtron veprimtari në kuadrin e detyrës të një tjetri dhe sipas udhëzimeve të tij, pa qenë punonjës i tij, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar gjatë kësaj veprimtarie ndaj të tretit.

Personi tjetër është gjithashtu përgjegjës ndaj të tretit.

Përgjegjësia e përfaqësuesit
Neni 620

Në qoftë se veprimtaria e përfaqësuesit në ushtrimin e pushteteve që i janë caktuar, sjell një përgjegjësi me faj ndaj një të treti, i përfaqësuari është gjithashtu përgjegjës ndaj këtij personi.

Përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve
Neni 621

Pronari i një kafshe ose ai që e përdor atë është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç kur provon se ka patur kontrollin e sjelljes së kafshës nga e cila është shkaktuar dëmi dhe nuk ka mundur ta mënjanonte atë.

Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme
Neni 622

Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.

Neni 623

Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre.

Por pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t'u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar.

Përgjegjësia për mjedisin
Neni 624

Personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Përgjegjësia për dëmin jopasuror
Neni 625
(Ndryshuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012, neni 2)

Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:

a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;

b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;

c) është cenuar e drejta e emrit;

ç) është cenuar respektimi i jetës private;

d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Përgjegjësia solidare
Neni 626

Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht.

Padia e kthimit

Neni 627

Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë.

Prindërit ose kujdestarët që kanë paguar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të miturit ose nga personat të cilëve u është hequr krejt zotësia për të vepruar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga këta kthimin e shpërblimit të dëmit që kanë paguar.

KREU II
PËRGJEGJËSIA QË RRJEDH NGA PRODUKTET

A. Përgjegjësia e prodhuesit

Neni 628

Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e produkteve të tij, përveç kur:

a) prodhuesi nuk ka vënë në qarkullim produktet;

b) sipas rrethanave të vërtetuara, vlerësohet se të metat që kanë shkaktuar dëmin nuk ekzistonin në kohën e vënies në qarkullim të produktit, ose ato kanë lindur më vonë;

c) produkti nuk ka qenë prodhuar për shitje ose ndonjë formë tjetër shpërndarje, me qëllim të caktuar ekonomik të prodhuesit, as edhe i prodhuar ose i shpërndarë në kuadrin e një ndërmarrjeje ose veprimtarie profesionale;

d) të metat janë rrjedhim i faktit se produkti ka qenë nëpërputhje me rregullat e vëna nga organet publike;

e) njohuritë shkencore e teknike nuk kanë mundur të zbulojnë të metat në kohën e vënies në qarkullim të produktit;

ë) është fjala për prodhimin e një lënde të parë ose fabrikimin e një pjese përbërëse të produktit, të cilat në formimin e produktit rezultojnë me të meta, ose si rrjedhojë e udhëzimeve të gabuara të dhëna nga prodhuesi i produktit.

Neni 629

Përgjegjësia e prodhuesit pakësohet ose hiqet kur, sipas rrethanave, dëmi është shkaktuar si nga të metat e produktit, ashtu edhe nga faji i personit të dëmtuar ose të një personi, për të cilin personi i dëmtuar është përgjegjës.

Përgjegjësia e prodhuesit nuk pakësohet kur dëmi është rrjedhim i përbashkët i të metave të produktit dhe sjelljes së një të treti.

Neni 630

Një send quhet se është me të meta kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke patur parasysh gjithë rrethanat e në veçanti:

a) paraqitjen e produktit;

b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;

c) kohën e vënies në qarkullim të produktit.

Produkti nuk mund të quhet se është me të meta duke u nisur nga fakti se një produkt më i perfeksionuar është vënë në qarkullim me vonë se ai.

Neni 631

"Produkt" në kuptim të këtij Kodi quhet një send i luajtshëm edhe sikur ai të jetë trupëzuar në një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, si dhe elektriciteti, duke përjashtuar produktet bujqësore dhe produktet e rrjedhura nga gjuetia.

Me produkte bujqësore kuptohen prodhimet e tokës, të blegtorisë dhe të peshkimit, përveç kur këto kanë pësuar një përpunim të parë.

"Prodhues" në kuptimin e këtij Kodi quhet prodhuesi i një produkti të përfunduar, të një lënde të parë ose fabrikuesi i një pjese përbërëse të produktit, si dhe çdo person tjetër që paraqitet si i tillë (prodhues), duke vënë mbi produktin emrin e tij, markën ose një shënjë tjetër dalluese.

Pa mënjanuar përgjegjësinë e prodhuesit, quhet si "prodhues" çdo person që importon një produkt me qëllim shitjeje, dhënieje me qira, leasingu, ose një formë tjetër shpërndarjeje, në kuadrin e veprimtarisë së tij tregtare. Në këtë rast, përgjegjësia e tij është e njëjtë me atë të prodhuesit.

Neni 632

Kur prodhuesi nuk mund të identifikohet, çdo furnizues do të konsiderohet si prodhues, përveç kur brenda një afati të arsyeshëm, ai i tregon personit të dëmtuar identitetin e prodhuesit ose të personit që ka furnizuar produktin.

Neni 633

Kur, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shumë persona janë përgjegjës për të njëjtin dëm, secili prej tyre është përgjegjës për të gjithë dëmin.

Neni 634

1. Padia për shpërblimin e dëmit e ngritur kundër prodhuesit, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, parashkruhet me kalimin e tre vjetëve duke filluar nga dita që personi i dëmtuar ka patur ose duhej të kishte patur dijeni për dëmin, të metat dhe identitetin e prodhuesit.

2. E drejta e personit të dëmtuar kundër prodhuesit për shpërblimin e dëmit, sipas paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shuhet me kalimin e dhjetë vjetëve, nga dita që prodhuesi ka vënë në qarkullim produktin që ka shkaktuar dëmin.

B. Publikimi mashtrues

Neni 635

Personi që publikon ose shkakton bërjen publike të një njoftimi lidhur me produktet ose shërbimet, që ofron vetë në rastin e një veprimtarie profesionale, ose të një ndërmarrjeje, ose të një personi për të cilin ai vepron, kryen një veprim të paligjshëm në qoftë se njoftimi është mashtrues në një ose disa drejtime të mëposhtme:

a) natyra, përbërja, sasia, cilësia, karakteristikat ose përdorimet e mundshme;

b) origjina, mënyra ose data e prodhimit;

c) madhësia e prodhimit stok të tij;

ç) çmimi ose metoda e llogaritjes së tij;

d) arsyeja ose qëllimi i ofertës speciale;

dh) cilësitë e atribuara, dëshmitë ose vlerësime të tjera të bëra nga të tretët, ose deklarata të lëshuara prej tyre, terminologjia shkencore ose profesionale e përdorur, të dhënat teknike ose statistikore;

e) kushtet e livrimit të produkteve, të ushtrimit të shërbimeve ose të kryerjes së pagesës;

f) shtrirja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e garancisë;

g) identiteti, cilësitë, kompetencat ose tagret e atij që fabrikon ose ka fabrikuar produktet, që ofron ato ose të atij që kryen shërbim, që drejton, mbikëqyr ose ndihmon në këto veprimtari;

gj) krahason me produkte dhe shërbime të tjera.

Neni 636

Personi që ka vepruar në mënyrë të paligjshme sipas dispozitës së sipërme, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se nuk ka faj për ardhjen e tij.

Neni 637

Kur publikimi mashtrues, i parashikuar prej nenit 635 të këtij Kodi, i ka shkaktuar ose rrezikon t'i shkaktojë dëm një tjetri, me kërkesën e tij, gjykata urdhëron ndalimin e menjëhershëm të tij dhe detyrimin e personit përgjegjës për të kryer një përgënjeshtrim publik, në mënyrën që gjykata do ta gjejë të përshtatshme.

C. Konkurrenca e pandershme

Neni 638

Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:

l. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;

2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;

3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Neni 639

Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.

Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

KREU III
SHPËRBLIMI I DËMIT

Neni 640

Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.

Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Neni 641

Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Neni 642

Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo rëndimit të shëndetit ose të shtimit apo pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit, në krahasim me kohën e caktimit të shpërblimit dhe të ndryshimeve që mund të ketë pësuar paga e të dëmtuarit.

Neni 643

Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga:

a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;

b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.

Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundrejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundrejtonte të vdekurit.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.

Neni 644

Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin.

Neni 645

Kur shkaktohet vdekja ose dëmtimi i shëndetit të një personi që fiton nga sigurimet shoqërore, dëmi shpërblehet në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 646

Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, caktohet nga gjykata në bazë të pagës që merr një punonjës i asaj kategorie me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari.

Neni 647

I mituri i dëmtuar, kur mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kritereve të nenit 646 të këtij Kodi.

Me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.

Neni 647/a

Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror

(Shtuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012, neni 3)

Shpërblimi i dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të personit, synon rivendosjen e të drejtës së shkelur, në mënyrë proporcionale me dëmin e pësuar dhe caktohet në bazë të rrethanave të çështjes. Për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata mban parasysh edhe:

a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;

b) shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;

c) format dhe shkallën e fajësisë;

ç) faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;

d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;

dh) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;

e) faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;

ë) faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje;

f) kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtrimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;

g) faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;

gj) faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit.

TITULLI V
GJERIMI I PUNËVE TË TË TJERËVE

Neni 648

Personi që, pa qënë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë.

Neni 649

Personi i interesuar duhet të përmbushë detyrimet që gjeruesi ka marrë përsipër në emër të tij, të përjashtojë gjeruesin nga detyrimet që ka marrë në emër të vet dhe t'i paguajë atij shpenzimet e nevojshme e të dobishme që nga dita që janë bërë dhe, kur është rasti, t'i shpërblejë edhe dëmin që mund të ketë pësuar si rrjedhim i gjerimit, por me kusht që veprimet e kryera nga gjeruesi, të mos kenë qenë ndaluar nga personi i interesuar.

Kur gjeruesit, përveç gjerimit të punëve, i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion, ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifat e caktuara për aktivitete të tilla.

Neni 650

Gjeruesi ka të drejtë të kryejë veprime juridike në emër të personit të interesuar, në masën që interesi i këtij të fundi plotësohet në mënyrë të përshtatshme.

Neni 651

Gjeruesi u nënshtrohet detyrimeve të njëjta që rrjedhin nga një kontratë porosie.

Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar tek gjeruesi për të marrë përsipër gjerimin, mund të pakësojë dëmshpërblimin për dëmin që është shkaktuar për faj të tij.

Neni 652

Personi i interesuar, me anë miratimi të veprimtarisë të gjeruesit, mund të tërheqë të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblim nga gjeruesi, sipas dispozitës së mësipërme. Për këtë qëllim personit të interesuar duhet t'i jepet një afat i arsyeshëm.

TITULLI VI
PAGIMI I PADETYRUAR

Neni 653

Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim.

Neni 654

Personit që ka paguar detyrimin e një tjetri duke besuar se ishte debitor, në bazë të një lajthitjeje të kryer pa faj, mund t'i kthehet ajo që ka paguar, me kusht që kreditori të mos jetë privuar në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë.

Kthimi i pagesës duhet të shoqërohet me frytet dhe kamatat, në kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme.

TITULLI VII
BEGATIMI PA SHKAK

Neni 655

Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit.

Neni 656

Kur begatimi pa ndonjë shkak të ligjshëm ka për objekt një send të caktuar, personi që e ka marrë atë, duhet ta kthejë në natyrë, së bashku me të ardhurat që ka nxjerrë ose duhet të nxirrte dhe ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë, sipas dispozitave për kërkimin e sendit nga poseduesi i paligjshëm.

Neni 657

Nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që personi ka dhënë vullnetarisht për ekzekutimin e një detyrimi, i cili, megjithëse i pakërkueshëm, nuk është i pavlefshëm.

Neni 658

Padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.

PJESA V
KONTRATAT

TITULLI I
KONTRATAT NË PËRGJITHËSI

KREU I
DISPOZITA PARAPRAKE

Përmbajtja e kontratës

Neni 659

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Neni 660

Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.

Kontrata me detyrime të njëanshme e të dyanshme

Neni 661

Kontrata është me detyrim të njëanshëm, kur njëra palë merr përsipër detyrime ndaj palës tjetër pa patur kjo e fundit ndonjë detyrim ndaj saj.

Neni 662

Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës.

Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës

Neni 663

Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Lidhja e kontratës

Neni 664

Kur kontrata përmban vetëm detyrimin e propozuesit, pritësi mund ta refuzojë propozimin brenda afatit të caktuar, ose që rrjedh nga natyra e marrëveshjes. Në mungesë të një refuzimi të tillë, kontrata quhet e lidhur.

Neni 665

Personi që propozon përfundimin e një kontrate është i lidhur me propozimin, përveç kur kjo lidhje është përjashtuar. Kur propozimi refuzohet ose nuk pranohet në afatin e caktuar, quhet i rënë.

Kur nuk është caktuar afat, propozuesi është i lidhur me propozimin e bërë, gjer në kohën që zakonisht apo sipas rrethanave, është e nevojshme që këtij t'i arrijë përgjigjja e palës tjetër.

Neni 666

Propozimi për të lidhur një kontratë, që i bëhet një personi të pranishëm, pa iu caktuar një afat për pranimin, e humbet fuqinë e tij, në qoftë se personi i pranishëm nuk e pranon propozimin menjëherë.

Neni 667

Kur propozuesi ka caktuar një afat për pranimin, është e nevojshme që përgjigjja të vijë brenda afatit.

Propozuesi mund ta quajë të vlefshëm pranimin e vonuar, por duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër.

Kur pranimi është dërguar në kohë, por i ka mbrritur propozuesit me vonesë dhe ky nuk dëshiron të jetë i lidhur me atë, duhet të njoftojë në çast pranuesin.

Neni 668

Propozimi për të lidhur një kontratë e humbet fuqinë e tij, në qoftë se propozuesi njofton palën tjetër, para se asaj t'i ketë arritur propozimi, se e ka tërhequr atë.

Ky rregull vlen edhe për tërheqjen e pranimit nga pala tjetër.

Neni 669

Kur me kërkesën e propozuesit, ose duke marrë parasysh natyrën e marrëveshjes e rrethanat që kanë lidhje me atë, rezulton që nuk ish e nevojshme pritja e pranimit të shprehur të propozimit, ose detyrimi do të kryhej pa marrë një përgjigje paraprake, kontrata quhet e lidhur, në kohën e në vendin ku ka filluar zbatimi i saj.

Pala që zbaton detyrimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër për fillimin e ekzekutimit të kontratës, përndryshe detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 670

Pranimi i propozimit që nuk përputhet me përmbajtjen e tij, quhet mospranim dhe njëkohësisht si një propozim i ri.

Neni 671

Oferta vlen si propozim, kur përmban elementet thelbësore të kontratës, që kërkohet të përfundohet, përveç kur rezulton ndryshe nga rrethanat e çështjes.

Neni 672

Pala kontraktuese mund të heqë dorë nga kontrata, brenda shtatë ditëve nga përfundimi i saj, pa treguar arsyet, kur:

- kontrata është përfunduar në vendin e punës ose të banimit të njërës palë, gjatë një eskursioni të organizuar në një mjedis publik, ose në kushte të tilla, që nuk i korrespondon një situate normale bisedimesh;
- në kontratën që ka për objekt dhënien e një kredie për të blerë një send konsumi, shitësi duhet të njoftojë me shkrim blerësin për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata e lidhur në kushtet e sipërme, për ndryshe afati i heqjes dorë është një vit.

Neni 673

Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontraktojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare.

Përfundimi i një kontrate, nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme.

Neni 674

Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës.

Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës.

Neni 675

Në rast se një palë kontraktuese disponon njohuri profesionale dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, e para ka detyrim t'i japë asaj me mirëbesim, informata e udhëzime.

Neni 676

Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.

Shkaku i paligjshëm

Neni 677

Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme.

Objekti i kontratës

Neni 678

Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet.

Neni 679

Kontrata e bërë me kusht pezullues ose me afat, është e vlefshme në rast se detyrimi, që fillimisht është i pamundur, bëhet i mundshëm përpara përmbushjes së kushtit ose mbarimit të afatit.

Neni 680

Kontrata mund të përmbajë kryerjen e veprimeve për sende në të ardhmen, përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji.

KREU II
INTERPRETIMI I KONTRATËS

Neni 681

Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

Neni 682

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit.

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

Neni 683

Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Neni 684

Kushtet e kontratës, që mund të merren me dy kuptime, interpretohen sipas praktikës së vendit ku është përfunduar kontrata.

Kur njëra nga palët është sipërmarrëse, kushtet me dy kuptime interpretohen sipas praktikës së vendit ku ndodhet selia e ndërmarrjes.

Neni 685

Fjalët dhe shprehjet që mund të kenë dy kuptime, duhet të merren në kuptimin më të përshtatshëm me natyrën e kontratës.

Kushtet e përgjithshme

Neni 686

Kushtet e përgjithshme të kontratës, të përgatitura prej njërës palë kontraktuese, kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t'i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme.

Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.

Nuk krijojnë efekte juridike ato kushte të cilat vendosin në dobi të atij që i ka përgatitur ato më përpara, kufizime për përgjegjësinë, mundësinë për t'u tërhequr nga kontrata, për të pezulluar zbatimin e saj, ose që caktojnë ndaj palës tjetër afate dekadence, ose kufizime ndaj së drejtës për të bërë prapësime, ndaj lirisë kontraktore, në marrëdhenie me të tretët, kushteve të arbitrazhit ose shmangies nga kompetencat e organeve gjyqësore, përveç kur janë miratuar veçmas me shkrim nga pala tjetër.

Neni 687

Në kontratat e përfunduara duke nënshkruar modularë ose formularë, që synojnë të disiplinojnë në mënyrë uniforme marrëdhënie kontraktore të caktuara, kushtet e shtuara tek këta modularë ose formularë kanë përparësi ndaj kushteve fillestare të modularëve e formularëve të sipërpërmendur, sa kohë që nuk përputhen me ato, edhe pse nuk kanë qënë shfuqizuar.

Neni 688

Në çdo rast, kushtet e përfshira në kushtet e përgjithshme të kontratës apo në modularë e formularë, që kanë qenë dhënë prej njërës nga palët kontraktuese, kur ka dyshim, interpretohet në dobi të palës tjetër.

Neni 689

Kur, me gjithë zbatimin e normave të parashikuara në këtë kre, kontrata mbetet e errët, kjo duhet të merret në kuptimin më pak të rënduar për të detyruarin, po qe se është pa shpërblim, dhe në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, po qe se është me shpërblim.

KREU III
EFEKTET E KONTRATAVE

Neni 690

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Neni 691

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 692

Efektet juridike të kontratës shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 693

Kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Kontrata në dobi të një të treti

Neni 694

Kontrata në dobi të një personi të tretë është e vlefshme kur personi që e lidh ka interes për atë.

Personi që ka pranuar premtimin në dobi të të tretit ose ky i fundit, apo personat që heqin të drejta prej tij, kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e kontratës, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Kontrata nuk mund të prishet ose të ndryshohet pas momentit që personi i tretë ka deklaruar se pranon të përfitojë nga lidhja e saj, përveç kur propozuesi e ka rezervuar këtë të drejtë.

Në rast revokimi të lidhjes së kontratës, ose të refuzimit të personit të tretë për të përfituar prej saj, detyrimi mbetet në dobi të propozuesit, përveç kur rezulton ndryshe nga vullneti i palëve ose nga natyra e kontratës.

Neni 695

Pala që ka bërë premtimin në dobi të personit të tretë, mund t'i kundrejtojë këtij prapsimet që rrjedhin nga kontrata, por jo ato që rrjedhin nga marrëdheniet me palën tjetër.

E drejta për t'u tërhequr nga kontrata

Neni 696

Në rast se njërës nga palët i është dhënë e drejta për t'u tërhequr nga kontrata, kjo e drejtë mund të ushtrohet për sa kohë që kontrata nuk ka filluar të zbatohet.

Në kontratat me zbatim të vazhdueshëm ose periodik, kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe më tej, por tërheqja nuk ka efekte për ekzekutimet e kryera ose që janë në kryerje e sipër.

Kur në kontratë është parashikuar pagimi i një kompensimi për tërheqjen, kjo ka efekt kur është kryer pagimi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Premtimi për kryerjen e një detyrimi

Neni 697

Personi që i ka premtuar një tjetri se një person i tretë do të ekzekutojë një detyrim, ose do të kryejë një veprim në dobi të tij, është i detyruar të shpërblejë palën tjetër, në qoftë se personi i tretë nuk pranon të ekzekutojë detyrimin ose të kryejë veprimin e premtuar.

Zgjidhja e kontratës

Neni 698

Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 699

Kontrata nuk mund të zgjidhet në qoftë se mospërmbushja e detyrimit prej njërës nga palët ka rëndësi të pakët për interesat e palës tjetër.

Neni 700

Pala kontraktuese mund të njoftojë me shkrim palën tjetër që nuk ka përmbushur detyrimin, që ta përmbushë atë në një afat të përshtatshëm, duke deklaruar se, po qe se pas këtij afati kontrata nuk ekzekutohet, ajo do të quhet patjetër e zgjidhur.

Neni 701

Në qoftë se afati i caktuar për kryerjen e detyrimit të njërës nga palët duhet quajtur thelbësor për interesin e palës tjetër, kjo e fundit kur dëshiron të kërkojë zbatimin pavarësisht nga mbarimi i afatit, duhet t'i bëjë njoftimin palës tjetër brenda tri ditëve, përveç marrëveshjes së kundërt.

Neni 702

Palët mund të parashikojnë në kontratë që ajo të zgjidhet kur një detyrim i caktuar nuk përmbushet sipas kushteve të parashikuara.

Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës.

Neni 703

Zgjidhja e kontratës për mospërmbushje të detyrimeve ka efekt prapaveprues midis palëve, përveç kontratave me ekzekutim të vazhduar ose periodik për të cilat efekti i zgjidhjes nuk shtrihet në veprimet e kryera më parë.

Zgjidhja e kontratës, qoftë edhe me marrëveshje të palëve, nuk paragjykon të drejtat e fituara nga të tretët, me përjashtim të efekteve të regjistrimit të kërkesës për zgjidhjen e kontratës.

Neni 704

Për zgjidhjen e kontratës zbatohen edhe dispozitat e pjesës së përgjithëshme të detyrimeve përveç dispozitave që rregullojnë kontratat e veçanta.

TITULLI II
KONTRATAT E VEÇANTA

KREU I
SHITJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 705

Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.

Neni 706

Në shitjen që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, fitimi i pronësisë bëhet sapo sendi ose e drejta pranohet se ekzistojnë.

Përveç kur palët kanë dashur të përfundojnë një kontratë me kusht pezullues, shitja është e paefektshme në qoftë se sendi nuk pranohet se ekziston.

Neni 707

Në qoftë se palët nuk e kanë caktuar çmimin, as nuk janë marrë vesh për mënyrën e caktimit të tij, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente publike, prezumohet se palët kanë dashur t'i referohen çmimit të zbatuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Kur është fjala për sende që kanë çmim burse apo tregu, çmimi caktohet në bazë të listave të tregut të vendit ku do të bëhet dorëzimi, ose nga ato të vendit që është më afër tij.

Në qoftë se çmimi është caktuar mbi bazën e peshës së sendeve, në rast dyshimi ai duhet të caktohet në bazë të peshës neto.

Palët mund t'ia besojnë caktimin e çmimit një të treti, të emëruar në kontratë ose që mund të emërohet më vonë.

Neni 708

Shpenzimet e kontratës së shitjes dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të blerësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Ndalime të veçanta të blerjes

Neni 709

Nuk mund të blejnë drejtpërdrejt, me anë të një tjetri, ose në ankand:

a) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, sendet që administrojnë ose ruajnë;

b) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, sendet që këta shesin;

c) gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi ato.

Detyrime të shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme

Neni 710

Detyrimet kryesore të shitësit janë:

1. t'i dorëzojë sendin blerësit;

2. kur fitimi i pronësisë mbi sendin, ose i të drejtave reale mbi të, nuk është pasojë e menjëhershme e kontratës, duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet përkatëse për fitimin e pronësisë së tyre, sipas kushteve të parashikuara nga kontrata apo nga ligji;

3. të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën.

Neni 711

Sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës. Sendet duhet të dorëzohen së bashku me aksesorët, shtesat dhe frytat që nga dita e përfundimit të kontratës, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.

Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.

Në rast se kontrata nuk përfshin transportin e sendeve dhe u referohet sendeve të caktuara individualisht, ose në lloj apo sasi, që duhen tërhequr nga një sasi e caktuar ose që duhet të fabrikohen ose të prodhohen dhe në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës, palët e dinin që sendet ndodheshin ose duhet të fabrikoheshin apo të prodhoheshin në një vend të caktuar, shitësi detyrohet t'i verë sendet në dispozicion të blerësit në atë vend.

Në rastet e tjera, shitësi është i detyruar që t'i verë sendet në dispozicion të blerësit, në vendin ku sendet ndodheshin në kohën e shitjes ose, kur një vend i tillë nuk mund të përcaktohet, në vendin ku shitësi kishte banimin e tij ose qendrën e veprimtarisë se vet.

Neni 712

Shitësi duhet të dorëzojë sendet:

1. në datën e caktuar në kontratë ose që është e përcaktueshme në bazë të kontratës;
2. në çdo moment të periudhës së kohës që është caktuar ose që është e caktueshme sipas kontratës, përveç kur del nga rrethanat se i është lënë blerësit të zgjedhë datën;
3. në çdo rast tjetër brenda një afati të arsyeshëm që nga përfundimi i kontratës.

Neni 713

Kur shitësi detyrohet të lëshojë dokumentet lidhur me sendet, ato lëshohen në kohën, në vendin dhe në formën e parashikuar në kontratë. Në qoftë se dokumentet i ka lëshuar përpara këtij momenti, ai mund të rregullojë çdo defekt të tyre deri në momentin e parashikuar për lëshimin e tyre, në qoftë se ushtrimi i një të drejte të tillë nuk i sjell blerësit shqetësime ose një shpenzim të paarsyeshëm. Në këto raste ai ruan të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 714

Në shitjen me dokumente, shitësi shkarkohet nga detyrimi i dorëzimit të sendeve të shitura, duke i dhënë blerësit dokumentin e shitjes dhe dokumentet e tjera të caktuara në kontratë ose në ligj.

Neni 715

Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.

Quhet se sendet nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm, të përcaktuar nga kontrata, përveç kur ka marrëveshje të kundërt. Kur një përcaktim i tillë nuk është i mundur, sendet quhet se nuk janë në përputhje me kontratën, në qoftë se nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sende të të njëjtit lloj.

Në qoftë se shitja është bërë mbi bazën e një modeli ose kampioni, shitësi duhet të dorëzojë sende që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose të kampionit.

Në qoftë se kontrata nuk përmend rregullat e vendosjes apo të ambalazhimit të sendeve, quhet se këto sende nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të vendosura ose të ambalazhuara sipas mënyrës së zakonshme për sende të të njëjtit lloj ose, në mungesë të një mënyre të tillë të zakonshme, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për të ruajtur dhe për të mbrojtur sendet.

Shitësi nuk është përgjegjës për të metat e sendeve të cilat, në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë dijeni për fajin e vet, përveç kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet të kishin pasur sipas kontratës ose sipas njoftimit të shitësit.

Neni 716

Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërputhje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut tek blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti.

Shitësi është përgjegjës edhe për mospërputhjen që vërtetohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm e që vjen nga mospërmbushja e një detyrimi çfarëdo të tij, duke përfshirë edhe garancinë sipas së cilës, për një periudhë të caktuar kohe sendet do të mbeten të përshtatshme për përdorimin e tyre normal ose për ndonjë përdorim të posaçëm, ose do të ruajnë cilësinë dhe karakteristikat e caktuara.

Neni 717

Blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk denoncon tek shitësi, duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi, përveç kur palët ose ligji kanë caktuar një afat tjetër.

Në çdo rast blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në qoftë se nuk e ushtron këtë të drejtë brenda dy vjetëve nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk është në kundërshtim me kohëzgjatjen e një garancie kontraktore.

Neni 718

Shitësi nuk mund të përfitojë nga rregullat e parashikuara në nenin e mësipërm, në qoftë se të metat kanë të bëjnë me fakte për të cilat ka dijeni ose që nuk mund të mos i dinte dhe nuk ia ka bërë të ditur blerësit.

Neni 719

Shitësi duhet të dorëzojë sendet, të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 720

Blerësi duhet t'i bëjë të ditur shitësit të drejtat apo pretendimin e të tretëve mbi sendin duke specifikuar natyrën e tyre, brenda një afati të arsyeshëm nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të merrte dijeni për to, ndryshe humb të drejtat e parashikuara nga neni i mësipërm.

Shitësi gjithashtu nuk mund të përdorë dispozitat e paragrafit të mësipërm po qe se ishte në dijeni të të drejtave apo të pretendimeve të të tretëve, apo të natyrës së tyre.

Neni 721

Blerësi mund të pezullojë pagimin e çmimit kur ka arsye të druhet se sendi ose një pjesë e tij mund të rivendikohen nga të tretë, përveç kur shitësi jep garancinë përkatëse.

Pagesa nuk mund të pezullohet në qoftë se rreziku njihej nga blerësi në momentin e shitjes.

Neni 722

Në rastin kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën nje mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore, blerësi ka të drejtë të kerkojë:

1. në momentin e denoncimit, të parashikuar në nenin 717 të këtij Kodi ose brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ai denoncim, dorëzimin e sendeve si shtesë apo zëvendësim;

2. eliminimin e të metave me anë të ndreqjes, kur kjo është e arsyeshme të merret parasysh në gjithë rrethanat konkrete. Kërkesa për ndreqjen duhet të bëhet në momentin e denoncimit të parashikuar në nenin 717 apo brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ky denoncim;

3. të kërkojë uljen e çmimit;

4. të deklarojë zgjidhjen e kontratës.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit blerësi nuk mund të përdorë asnjë mjet juridik për mospërmbushjen, përveç kur është njoftuar nga shitësi se ky i fundit nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Në çdo rast blerësi nuk humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 723

Kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën një mospërmbushje të parëndësishme të kontratës, blerësi mund të kërkojë:

1. heqjen ose ndreqjen e të metave të sendeve të dorëzuara, ose

2. uljen e çmimit.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit, blerësi nuk mund të shfrytëzojë asnjë mjet juridik për këtë mospërmbushje, përveç rastit kur është njoftuar nga shitësi se ky nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Kur shitësi nuk plotëson kërkesën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni brenda afatit të caktuar nga blerësi, ky i fundit mund të kërkojë uljen e çmimit të sendeve të sipërme.

Në çdo rast blerësi nuk e humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 724

Përveç zgjidhjes nga ligji të kontratës si rrjedhim i qenies të afatit si kusht thelbësor, kur nuk është bërë dorëzimi i sendit, blerësi mund ta deklarojë të zgjidhur kontratën në qoftë se shitësi nuk i dorëzon sendet brenda afatit shtesë të caktuar nga blerësi ose në qoftë se deklaron se nuk do të bëjë dorëzimin brenda këtij afati.

Neni 725

Në qoftë se shitësi i ka dorëzuar sendet, blerësi e humb të drejtën të shpallë të zgjidhur kontratën kur:

1. në rastin e dorëzimit të vonuar blerësi nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë nga momenti kur ka marrë dijeni se dorëzimi është kryer;

2. në rast mospërmbushje të ndryshme nga dorëzimi i vonuar, brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë:

a) nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të kishte dijeni për mospërmbushje;

b) pas mbarimit të afatit shtesë eventualisht të caktuar prej tij sipas nenit 717 të këtij Kodi.

Neni 726

Në qoftë se shitësi dorëzon vetëm një pjesë të sendeve, apo në qoftë se vetëm një pjesë e sendeve të dorëzuara është në përputhje me kontratën, zbatohen nenet 717, 720 lidhur me pjesën që mungon ose nuk përputhet.

Blerësi mund të shpallë kontratën tërësisht të zgjidhur vetëm në qoftë se dorëzimi i pjesshëm ose jo në përputhje me kushtet e saj, përbën një mospërmbushje të rëndësisë së veçantë ose thelbësore.

Neni 727

Në rastin kur blerësit i është marrë sendi si pasojë e të drejtave që një i tretë ka paraqitur mbi të, shitësi është i detyruar të shpërblejë dëmin sipas nenit 744.

Në rastin kur blerësit i është marrë pjesërisht sendi dhe se në bazë të rrethanave ai nuk do të përfundonte kontratën, zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 728

Blerësi, i paditur nga një i tretë që pretendon se ka të drejta mbi sendin e shitur, duhet ta thërasë shitësin në çështje. Kur nuk e bën këtë dhe në dëm të tij është dhënë një vendim i formës së prerë, humbet të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se shitësi provon se ekzistonin arsye të mjaftueshme për të refuzuar kërkesën.

Blerësi që ka njohur vullnetarisht të drejtën e të tretit, e humb të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se nuk provon se nuk ekzistonin arsye të mjaftueshme për të penguar marrjen e sendit.

Neni 729

Në qoftë se blerësi ka shmangur marrjen e sendit me anën e pagimit të një shume parash, shitësi mund të shkarkohet duke kthyer shumën e paguar, interesat e saj, si dhe të gjitha shpenzimet.

Detyrimet e blerësit në shitjen e pasurisë së luajtshme

Neni 730

Detyrimi i blerësit për të paguar çmimin përfshin marrjen e masave dhe respektimin e formaliteteve të kërkuara nga kontrata ose nga dispozita të veçanta për kryerjen e pagimit.

Neni 731

Në rast se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një vend tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë në vendbanimin ose qendrën zyrtare të shitësit ose, kur pagimi duhet të bëhet në kohën e dorëzimit të sendeve ose dokumenteve, në vendin e dorëzimit.

Neni 732

Në qoftë se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një moment tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë kur shitësi vë në dispozicion të tij sendet apo dokumentet që i përfaqësojnë. Në qoflë se kontrata përfshin transportin e sendeve, shitësi mund të kryejë spedicionin me kusht që sendet ose dokumentet, që i përfaqësojnë ata, t'i dorëzohen blerësit para pagimit të çmimit.

Neni 733

Blerësi duhet të paguajë çmimin në datën e caktuar ose të përcaktueshme në bazë të kontratës ose ligjit, pa qenë nevojë e kërkesës së shitësit.

Neni 734

Detyrimi i blerësit për marrjen në dorëzim është kryerja e çdo veprimi që mund të pritet prej tij në mënyrë të arsyeshme, për t'i lejuar shitësit të bëjë dorëzimin dhe blerësi të tërheqë sendet.

Neni 735

Në qoftë se në kontratë parashikohet se blerësi duhet të përcaktojë formën, madhësinë ose karakteristika të tjera të sendeve, dhe në qoftë se ky nuk e bën këtë përcaktim në datën e caktuar ose brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së kërkesës së shitësit, ky mund ta kryejë vetë këtë përcaktim në përputhje me kërkesat e blerësit, për të cilat mund të jetë në dijeni.

Në qoftë se shitësi e bën vetë përcaktimin, duhet të njoftojë blerësin për rregullat e këtij përcaktimi dhe të vendosë një afat të arsyeshëm brenda të cilit blerësi mund të kryejë një përcaktim tjetër. Në qoftë se pasi të ketë marrë këtë njoftim, blerësi nuk e përdor këtë mundësi brenda afatit të vendosur, përcaktimi i bërë nga shitësi është i detyrueshëm.

Neni 736

Shitësi mund t'i caktojë blerësit një afat shtesë të arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve të veta. Me përjashtim të rastit kur shitësi nuk ka marrë njoftim nga blerësi se ky nuk do ta përmbushë detyrimin brenda afatit të caktuar, gjatë kësaj periudhe, shitësi nuk mund të përdorë asnjë mjet ligjor për përmbushjen e detyrimeve. Gjithsesi shitësi nuk humbet të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit për vonesën në përmbushje.

Neni 737

Shitësi mund ta deklarojë kontratën të zgjidhur:

1. në qoftë se mospërmbushja nga ana e blerësit e një detyrimi që rrjedh nga kontrata ose nga ligji përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë ose thelbësore;

2. në qoftë se blerësi nuk përmbush detyrimet e tij për të paguar çmimin ose për të marrë në dorëzim sendet në afatin shtesë të caktuar nga shitësi, ose deklaron se nuk do ta bëjë brenda këtij afati.

Në qoftë se blerësi ka paguar çmimin, shitësi humb të drejtën të shpallë kontratën të zgjidhur po qe se këtë nuk e kërkon:

1. në rastin e përmbushjes së vonuar të detyrimeve të blerësit, para se të marrë dijeni për ekzekutimin e detyrimit;

2. në rastin e një mospërmbushjeje tjetër të ndryshme nga mospërmbushja e vonuar, brenda një kohe të arsyeshme:

a) që nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për një mospërmbushje të tillë;

b) pas mbarimit të afatit shtesë të caktuar prej tij, ose pasi blerësi të ketë deklaruar se nuk do të përmbushë detyrimet e veta brenda këtij afati shtesë.

Neni 738

Përveç marrëveshjeve ose zakoneve tregtare të kundërta, në qoftë se sendet e shitura duhet të transportohen nga një vend në tjetrin, dhe shitësi nuk është i detyruar të bëjë dorëzimin në një vend të caktuar në kontratë, rreziku i kalon blerësit kur sendi i dorëzohet transportuesit të parë për t'ia dërguar blerësit, edhe sikur sendet të jenë të ngarkuara në mënyrë të paambalazhuar.

Në qoftë se shitësi detyrohet t'ia dorëzojë sendet transportuesit në një vend të caktuar në kontratë, rreziku kalon tek blerësi vetëm kur sendet i dorëzohen transportuesit në vendin e përmendur. Fakti që shitësi është i autorizuar të mbajë dokumentet përfaqësuese të sendeve, nuk ndikon në kalimin e rrezikut.

Neni 739

Në qoftë se shitësi ka kryer një mospërmbushje thelbësore të kontratës, dispozitat e nenit të mëparshëm nuk privojnë mjetet juridike që blerësi ka në dorë ndaj mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Dispozita të përbashkëta për detyrimet e shitësit dhe të blerësit

Neni 740

Njëra palë mund të pezullojë përmbushjen e detyrimeve të veta në qoftë se, pas përfundimit të kontratës, del qartë se pala tjetër nuk do të përmbushë pjesën thelbësore të detyrimeve të saj si rrjedhim:

1. të një pamundësie të rëndë në aftësinë e vet për ta përmbushur ose në aftësinë e vet paguese;
2. të mënyrës në të cilën përgatitet për të filluar ose vazhduar zbatimin e kontratës.

Në qoftë se shitësi i ka shitur sendet, para se të shfaqeshin kushtet e përmendura në paragrafin e mësipërm, ai mund të kundërshtojë dorëzimin e sendeve blerësit edhe sikur ky të zotërojë një dokument që e legjitimon atë për t'i marrë.

Një kundërshtim i tillë ka efekt ekskluzivisht në marrëdhëniet midis blerësit dhe shitësit.

Pala që pezullon zbatimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe duhet të vazhdojë përmbushjen në qoftë se pala tjetër jep garanci të përshtatshme lidhur me përmbushjen e detyrimeve të saj.

Neni 741

Në rastin e një kontrate shitjeje me dorëzime të pjesshme, kur mospërmbushja nga ana e njërës palë kontraktuese ndaj njërit prej detyrimeve të saj lidhur me një dorëzim, përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë të kontratës që lidhet me këtë dorëzim, pala tjetër mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për sa i takon këtij dorëzimi.

Në qoftë se mospërmbushja nga ana e njërës palë kontraktuese e detyrimeve të veta lidhur me një dorëzim, i jep palës tjetër arsye të bazuara për të gjykuar se do të ndodhë një mospërmbushje thelbësore lidhur me dorëzimet e ardhshme, kjo mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për të ardhmen, mjafton që këtë ta bëjë brenda një kohe të arsyeshme.

Blerësi që e shpall kontratën të zgjidhur për sa i takon një dorëzimi mundet, në të njëjtën kohë, të shpallë zgjidhjen për dorëzimet e bëra më parë ose për dorëzimet e ardhshme në qoftë se për shkak të ndërvarësisë së tyre këto dorëzime nuk do të mund të përdoreshin për qëllimin e caktuar nga palët në kontratë.

Neni 742

Në rastin e zgjidhjes së kontratës, shitësi duhet të kthejë çmimin dhe t'i paguajë blerësit shpenzimet dhe pagimet e bëra ligjërisht.

Blerësi duhet të kthejë sendin, në qoftë se ky nuk ka humbur ose është shkatërruar si rrjedhim i veseve të tij.

Neni 743

Në qoftë se njëra palë vonon të paguajë çmimin ose çdo shumë tjetër, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë kamatat për këto shuma pa cenuar shpërblimin e dëmit.

Neni 744

Shitësi duhet t'i kthejë blerësit çmimin e paguar, edhe sikur sendit t'i jetë pakësuar vlefta ose të jetë dëmtuar. Në qoftë se ulja e vleftës ose dëmtimi vijnë si pasojë e një veprimi të blerësit, nga shuma e mësipërme duhet zbritur përfitimi që ka nxjerrë blerësi, përveç sa parashikohet në nenin 640.

Neni 745

Në qoftë se kontrata është zgjidhur dhe po qe se, në mënyrë të arsyeshme dhe brenda një afati të arsyeshëm pas zgjidhjes, blerësi ka kryer një blerje për të zëvendësuar ose shitësi i ka rishitur sendet, pala që kërkon dëmshpërblimin mund të marrë diferencën midis çmimit të parashikuar në kontratë dhe çmimit të shitblerjes zëvendësuese, si dhe çdo shpërblim tjetër që mund të kërkohet në bazë të nenit të mësipërm.

Shitja me rezervë e pronës

Neni 746

Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë.

Neni 747

Kalimi i pronësisë sipas dispozitës së mësipërme, mund t'u kundrejtohet kreditorëve të blerësit, kur rrjedh nga një akt i shkruar në datë të saktë përpara masës për sigurimin e kredisë.

Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin.

Neni 748

Mospagimi vetëm i një kësti, që nuk kalon një të tetën e çmimit, nuk sjell zgjidhjen e kontratës, dhe blerësi ruan të drejtën e afatit lidhur me këstet e mëvonëshme, pavarësisht nga ndonjë marrëveshje e kundërt.

Neni 749

Kur zgjidhja e kontratës është rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të blerësit, shitësi duhet të kthejë pagesat e bëra, përpos të drejtës për një shpërblim për përdorimin e sendit, apo shpërblimit të dëmit.

Kur në kontratë është parashikuar që pagesat e bëra t'i mbetë, shitësit me titull dëmshpërblimi, gjykata sipas rrethanave të çështjes mund të pakësojë këtë dëmshpërblim.

Neni 749/a

(Shtuar me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999, neni 4)

Rregullat e parashikuara nga nenet 746, 747, 748 dhe 749 nuk zbatohen për shitjet me rezervë të pronës, lidhur me transaksione financiare me barrë siguruese, për të cilat zbatohen rregullat e përcaktuara me ligj të veçantë.

Shitja e sendeve të paluajtshme

Neni 750

Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 751

Shitja me kusht e sendeve të paluajtshme regjistrohet në regjistrat e pasurisë së paluajtshme pasi të jetë vërtetuar kushti.

Neni 752

Kur një send i paluajtshëm i caktuar shitet, duke treguar përmasat dhe me një çmim të vendosur mbi bazën e një pagese për çdo njësi matëse, blerësi ka të drejtë për një zbritje të çmimit, në qoftë se madhësia efektive e sendit të paluajtshëm është më e vogël se ajo e treguar në kontratë.

Në qoftë se përmasat e sendit rezultojnë më të mëdha se ato që tregohen në kontratë, blerësi duhet të paguajë shtesën e çmimit, por ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata kur teprica tejkalon një të njëzetën pjesë të madhësisë së deklaruar.

Neni 753

Në rastin kur çmimi përcaktohet në lidhje me vetë sendin e paluajtshëm dhe jo me madhësinë e tij, edhe pse kjo është dhënë, nuk bëhet ulje ose ngritje çmimi, përveç kur madhësia reale është më e vogël ose më e madhe se një e njëzeta pjesë e asaj të treguar në kontratë.

Në rastin kur duhet paguar një çmim shtesë, blerësi mund të zgjedhë ose heqjen dorë nga kontrata ose nga pagimi i shtesës.

Neni 754

Në qoftë se dy ose më shumë sende të paluajtshme janë shitur me të njëjtën kontratë për një çmim të vetëm dhe të njëjtë, duke treguar madhësinë e secilit prej tyre, dhe del se sasia është më e vogël tek njëri dhe më e madhe tek tjetri, bëhet kompensimi deri në sasinë e duhur; e drejta për shtesën ose për pakësimin e çmimeve bëhet në përputhje me dispozitat e caktuara më sipër.

Neni 755

E drejta e shitësit për shtesën dhe e blerësit për pakësimin e çmimit ose për heqjen dorë nga kontrata parashkruhet dy vjet pas dorëzimit të sendit të paluajtshëm.

Neni 756

E drejta e blerësit për të kundërshtuar të metat e sendit të paluajtshëm, parashkruhet me kalimin e pesë vjetëve nga momenti i dorëzimit të sendit.

KREU II
SHKËMBIMI

Neni 757

Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri.

Neni 758

Shkëmbyesi, në rast se ka pësuar marrjen e sendit dhe nuk ka ndërmend ta rimarrë atë, ka të drejtë të marrë vleftën e tij, sipas dispozitave të caktuara për shitjen, si dhe shpërblimin e dëmit.

Neni 759

Shpenzimet e shkëmbimit dhe shpenzime të tjera shtesë janë në ngarkim të të dy palëve në pjesë të barabarta, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 760

Rregullat e caktuara për kontratën e shitjes zbatohen edhe për kontratën e shkëmbimit, për aq sa janë në pajtim me atë.

KREU III
DHURIMI

Neni 761

Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon.

Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi.

Neni 762

Dhurimi nuk mund të përmbajë veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm përsa i takon kësaj.

Neni 763

Dhurimi, që ka për objekt detyrimet periodike, shuhet me vdekjen e dhuruesit, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 764

Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.

Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm. Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimit i është njoftuar dhuruesit.

Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit.

Kontrata quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit.

Përpara se kontrata të jetë lidhur, dhuruesi ose pranuesi i dhurimit mund të revokojnë deklaratën e tyre.

Neni 765

Dhurimi mund të kundërshtohet për lajthitje të shkakut, kur ky lidhet me faktin ose me të drejtën, po qe se shkaku rrjedh nga akti dhe ka shtyrë dhuruesin të bëjë dhurimin.

Neni 766

Dhuruesi për mospërmbushjen ose vonesën në dhurim, është përgjegjës vetëm për qëndrime të kryera me dashje ose me pakujdesi të rëndë.

Neni 767

Dhuruesi mund të vërë si kusht kthimin e sendeve të dhuruara, si për shkak të vdekjes së përparshme të pranuesit të dhurimit, ashtu edhe të vdekjes së përparshme të pasardhësve të tij.

Kthimi mund të ndodhë vetëm në favor të dhuruesit.

Marrëveshja në favor të të tjerëve konsiderohet si e palidhur.

Neni 768

Dhurimi mund të rëndohet me kusht ose me barrë. Dhuruesi është i detyruar të përmbushë barrën brenda kufijve të vleftës së sendit të dhuruar.

Për të përmbushur barrën mund të veprojë, përveç dhuruesit dhe çdokush i interesuar.

Zgjidhja e kontratës së dhurimit për mospërmbushje të barrës mund të kërkohet nga dhuruesi ose trashëgimtarët e tij, në qoftë se është parashikuar në aktin e dhurimit.

Barra e paligjshme ose e pamundur quhet e paqenë, ajo gjithsesi e bën të paqenë dhurimin në qoftë se ka përbërë të vetmin shkak përcaktues të kontratës.

Neni 769

Dhuruesi detyrohet t'i japë garanci pranuesit të dhurimit për përkatësinë e sendit të dhuruar dhe zhveshjen që mund të pësojë nga të tjerët për sendet e dhuruara, në këto raste:

1. në qoftë se ka premtuar shprehimisht garancinë;
2. në qoftë se marrja e sendit varet nga mashtrimi e nga qëndrime personale të tij;
3. në qoftë se dhurimi i ngarkon barrë pranuesit të dhurimit ose dhurimi është për shkak shpërblimi, raste në të cilat garancia vihet deri në vleftën e barrës ose të tërësisë së premtimeve të marra nga dhuruesi.

Neni 770

Garancia e dhuruesit nuk shtrihet në të metat e asaj çka është dhuruar, përveç kur dhuruesi ka vepruar me mashtrim, si dhe kur ka marrëveshje të posaçme.

Neni 771

Dhuruesi, për dhurimet që nuk janë të zakonshme ose që nuk janë bërë për shpërblim, mund të kërkojë revokimin e dhurimit kur ai që ka marrë dhurimin:

a) me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët, ose prindërit e tij;

b) pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim kur është i detyruar sipas ligjit.

Padia për revokimin e dhurimit duhet të ngrihet brenda një viti nga dita që dhuruesi ka marrë njoftim për shkaqet që i japin të drejtë që të kërkojë revokimin e dhurimit.

Padia e filluar mund të vazhdohet edhe nga trashëgimtarët e dhuruesit ose mund të ngrihet nga vetë këta, në rast se dhuruesi ka vdekur brenda vitit, nga dita që ka lindur shkaku për të ngritur padinë.

Heqja dorë që më parë nga padia është e pavlefshme.

Revokimi i dhurimit nuk cenon të drejtat që kanë fituar të tretët mbi sendin e dhuruar para se të ngrihet padia.

KREU IV
FURNIZIMI

Neni 772

Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve.

Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti.

Neni 773

Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës.

Në qoftë se palët kanë vendosur vetëm kufirin maksimal dhe minimal për furnizimin ose për shërbimet e veçanta, i takon atij që ka të drejtën e furnizimit të vendosë brenda kufijve të mësipërm për sasinë e duhur.

Në qoftë se sasia e furnizimit duhet të përcaktohet sipas nevojave mbi një sasi minimale të caktuar në kontratë, pala që furnizohet përgjigjet për sasinë përkatëse sipas nevojave në rast se tejkalohet sasia minimale.

Neni 774

Në furnizimin me karakter periodik, në qoftë se çmimi do të përcaktohet sipas nenit 707 të këtij Kodi, merret parasysh koha e mbarimit të furnizimeve të veçanta dhe vendi ku këto duhet të kryhen.

Neni 775

Në furnizimin me karakter periodik, çmimi përkon me dokumentin e furnizimeve të veçanta.

Në furnizimin me karakter të vazhdueshëm çmimi paguhet sipas afateve të zakonshme.

Neni 776

Afati i caktuar në kontratë për furnizime të veçanta prezumohet si i vendosur në dobi të dy palëve.

Në qoftë se palës që furnizohet i është dhënë e drejta të caktojë afatin e furnizimeve të veçanta, ajo duhet t'i njoftojë datën furnizuesit me anë të një paralajmërimi në një kohë të arsyeshme.

Neni 777

Në rast mospërmbushjeje prej njërës nga palët të detyrimeve të veçanta, pala tjetër mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se mospërmbushja ka një rëndësi të veçantë dhe është e tillë sa që dëmton besimin në sigurinë e përmbushjeve të mëpasshme.

Neni 778

Në qoftë se pala që ka të drejtë për t'u furnizuar nuk e ka përmbushur detyrimin dhe mospërmbushja është me pak rëndësi, furnizuesi nuk mund të pezullojë zbatimin e kontratës pa bërë më parë një paralajmërim të arsyeshëm.

Neni 779

Në rast se në kontratë është vendosur kushti i ekskluzivitetit në favor të furnizuesit, pala tjetër nuk mund të përfitojë furnizime të të njëjtit lloj nga të tretët dhe as mund të realizojë, me mjetet e veta, prodhimin e sendeve që formojnë objektin e kontratës, në qoftë se për këtë nuk ka marrëveshje të kundërt ose kur në ligj disponohet ndryshe.

Neni 780

Në qoftë se kushti i ekskluzivitetit është vendosur në dobi të palës që ka të drejtë për t'u furnizuar, furnizuesi nuk mund të bëjë as drejtpërdrejt dhe as tërthorazi furnizime të të njëjtit lloj e që formojnë objektin e kontratës, në zonën për të cilën është dhënë ekskluziviteti dhe brenda afatit të kontratës.

Kushti i ekskluzivitetit, që përmbahet në një kontratë furnizimi, përbën një kusht barrësor që kërkon miratim të posaçëm me shkrim.

Neni 781

Pala që ka të drejtën për t'u furnizuar, kur merr përsipër detyrimin për të shtuar shitjen e sendeve për të cilat ka ekskluzivitet, në zonën që i është caktuar, përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga mospërmbushja e këtij detyrimi, edhe në qoftë se kontratën e ka zbatuar për sasinë minimale që është caktuar.

Neni 782

Në qoftë se kohëzgjatja e furnizimit nuk është vendosur, secila nga palët mund të tërhiqet nga kontrata, duke njoftuar paraprakisht furnizuesin brenda afatit të vendosur prej tyre dhe, në mungesë të tij, brenda një afati të arsyeshëm, duke marrë parasysh edhe natyrën e furnizimit.

Neni 783

Në kontratën e furnizimit zbatohen edhe dispozitat që rregullojnë kontratën për furnizimet e veçanta, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat e mësipërme.

KREU V
ENFITEOZA

Kuptimi i enfiteozës
Neni 784

Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorojë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë.

Neni 785

Kohëzgjatja e enfiteozës caktohet në kontratë.

Neni 786

Kontrata e enfiteozës duhet të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Të drejtat e detyrimet e pronarit dhe të enfiteozëmarrësit
Neni 787

Enfiteozëmarrësi e gëzon sendin sikurse dhe pronari, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në kontratën për krijimin e enfiteozës.

Megjithatë ai nuk mundet që, pa pëlqimin e pronarit, të përdorë sendin në një destinacion tjetër.

Neni 788

Enfiteozëmarrësit i përkasin frytet natyrore të ndara, frytet civile që janë bërë të kërkueshme gjatë enfiteozës dhe të drejtat e përdorimit të nëntokës në kufijtë e parashikuar me ligj, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 789

Kur prona në enfiteozë humbet tërësisht, enfiteoza shuhet dhe enfiteozëmarrësi shkarkohet nga detyrimi përkatës për të ardhmen.

Kur prona humbet ose dëmtohet në pjesë të dukshme e të rëndësishme të saj, aq sa nuk mund të sigurohen të ardhura sa të shlyhet shpërblimi i caktuar në kontratë, mund të kërkohet një ulje e tij ose prishja e kontratës, duke shlyer palët detyrimet reciproke.

Kërkesa duhet të bëhet brenda një viti nga dita që ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës në enfiteozë.

Enfiteozëmarrësi nuk mund të kërkojë shkarkimin nga detyrimi për pagimin e shpërblimit ose uljen e tij, për shkak mosprodhimi ose humbje të fryteve, qoftë edhe për rast fator.

Neni 790

Dhënia e pronës në nënenfiteozë nuk lejohet.

Neni 791

Enfiteozëmarrësi mund të kërkojë në çdo kohë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Enfiteozëdhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, kur enfiteozëmarrësi nuk ka shlyer detyrimin përkatës për dy periudha rresht, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson pronën e nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Neni 792

Tatimet dhe detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pronën janë në ngarkim të enfiteozëmarrësit, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Kur në kontratë këto detyrime janë lënë në ngarkim të pronarit, ato nuk mund të kalojnë shpërblimin e caktuar për enfiteozën.

Neni 793

Në rast tjetërsimi të enfiteozës, enfiteozëmarrësi i ri dhe ai përpara tij, detyrohen solidarisht për shpërblimin e papaguar të enfiteozës, përveç kur enfiteozëmarrësit të mëparshëm i është njoftuar akti i tjetërsimit prej enfiteozëdhënësit.

Në rast tjetërsimi të një të drejte të tillë prej pronarit, fituesi nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve nga enfiteozëmarrësi përpara se atij t'i njoftohet akti i tjetërsimit.

Neni 794

Kur në kontratë nuk parashikohet ndryshe, enfiteozëmarrësi gjatë vazhdimit të enfiteozës ose kur ajo pushon, ka të drejtë t'i heqë ndërtimet, punimet e tjera e mbjelljet e kryera jashtë kushteve të enfiteozës ose që i janë blerë pronarit, por gjithnjë pa dëmtuar pronën e duke kthyer atë në gjendjen e mëparshme.

Neni 795

Kur zgjidhet kontrata, enfiteozëmarrësit i takon vlefta e përmirësimeve të kryera në masën që është rritur vlefta e pronës, kur ajo ekziston në kohën e kthimit të saj.

Neni 796

Enfiteozëmarrësi ka të drejtë të mbajë sendin e dhënë në enfiteozë, deri në shlyerjen e kredive që rrjedhin prej saj. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Pronari ka të drejtë të mbajë sendet që i takojnë enfiteozëmarrësit deri në shlyerjen e detyrimeve ndaj tij.

Neni 797

Kur lind nevoja të bëhen ndreqje të jashtëzakonshme në pronën e dhënë në enfiteozë, enfiteozëmarrësi është i detyruar të njoftojë pronarin dhe t'i japë atij mundësi për t'i kryer ato.

Enfiteozëdhënësi nuk është i detyruar të kryejë ndonjë riparimt ë zakonshëm.

Neni 798

Personat që gëzojnë bashkërisht një të drejtë enfiteotike përgjigjen solidarisht për pagimin e shpërblimit për enfiteozën.

Kur prona e dhënë në enfiteozë ndahet dhe ata gëzojnë pjesë të saj, secili përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga enfiteoza, proporcionalisht me vleftën e pjesës që gëzon.

Neni 799

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe kur enfiteoza gëzohet nga një ose disa persona juridikë, përveç kur ajo ndalohet nga ligji.

Neni 800

Enfiteozëmarrësi mund të fitojë në dobi të pronës servitute aktive dhe ta ngarkojë atë me servitute pasive, për një kohë sa parashikohet në kontratë, gjithnjë duke njoftuar enfiteozëdhënësin me shkresë.

KREU VI
QIRAJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, nëgëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 802

Qiradhënësi duhet:

1. t'i dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh;
2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje;
3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

Neni 803

Qiraja nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se tridhjetë vjet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji. Në qoftë se ajo është lidhur për një periudhë kohe më të gjatë ose pa afat, ka fuqi vetëm për afatin e sipërm.

Për ndërtesat që përdoren për banim, kontrata e qirasë nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet.

Për sende të luajtshme të dhëna për pajisjen e një sendi të paluajtshëm, afati është baraz me kohëzgjatjen e qirasë së këtij të fundit.

Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

Neni 804

Qiramarrësi, që ka ekzekutuar në rregull detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata, ka të drejtën që të preferohet ndaj personave të tjerë në rast se, me mbarimin e kohës së qerasë, do të lidhet kontrata e re.

Të drejta e detyrime të qiradhënësit

Neni 805

Qiradhënësi duhet të kryejë, gjatë periudhës së qirasë, të gjitha riparimet, me përjashtim të punimeve për mirëmbajtjen e përditshme që janë në ngarkim të qiramarrësit.

Për sende të luajtshme, shpenzimet për ruajtjen e për mirëmbajtjen e zakonshme janë në ngarkim të qiramarrësit, përveçse kur me marrëveshje parashikohet ndryshe.

Kur sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime, që nuk janë në ngarkim të qiramarrësit, ky është i detyruar të njoftojë qiradhënësin.

Në rast riparimesh urgjente qiramarrësi mund t'i kryejë ato drejtpërdrejt, kundrejt kthimit të shpenzimeve, me kushte që të njoftojë menjëherë qiramarrësin.

Neni 806

Në qoftë se në kohën e dorëzimit, sendi i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ose zbritjen e çmimit të qerasë, përveç kur ai ka patur dijeni për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme.

Qiradhënësi është i detyruar t'i paguajë qiramarrësit dëmet e ardhura nga veset e sendit, në qoftë se nuk provon se, pa patur faj, nuk ka patur dijeni për këto vese në momentin e dorëzimit.

Në qoftë se veset e sendit vënë para një rreziku të madh shëndetin e qiramarrësit ose të familjes apo të vartësve të tij, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës edhe po qe se veset njiheshin prej tij.

Neni 807

Marrëveshja, me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e qiradhënësit për veset e sendit, nuk ka efekt në qoftë se qiradhënësi ia ka fshehur me keqbesim qiramarrësit ato, ose kur veset janë të tilla që të pengojnë gëzimin e sendit.

Neni 808

Dispozitat e neneve të mësipërme janë të zbatueshme edhe në rastet e veseve të sendit të ndodhura gjatë qirasë.

Neni 809

Në qoftë se gjatë qirasë sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime urgjente, qiramarrësi duhet të lejojë kryerjen e tyre. Në qoftë se sendi nuk riparohet brenda një kohe të arsyeshme, qiramarrësi ka të drejtë për një ulje përpjesëtimore të qirasë.

Neni 810

Qiradhënësi detyrohet të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet që pakësojnë vlerën e përdorimit dhe të gëzimit të sendit, të shkaktuara nga të tretët që pretendojnë se kanë të drejta mbi të njëjtin send.

Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi sendin. Në këtë rast qiramarrësi ruan të drejtën të ngrejë padi kundër të tretëve në emrin e tij.

Neni 811

Në qoftë se të tretët që krijojnë shqetësime pretendojnë se kanë të drejta mbi sendin e dhënë me qira, qiramarrësi është i detyruar ta njoftojë menjëherë qiradhënësin, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Në qoftë se të tretët veprojnë në rrugë gjyqësore, qirradhënësi është i detyruar të marrë pjesë në proces, po qe se thirret.

Të drejta e detyrime të qiramarrësit

Neni 812

Qiramarrësi duhet:

1. të marrë në dorëzim sendin dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë dhe, kur nuk është parashikuar, sipas qëllimit që del nga natyra e sendit;
2. të kryejë pagesën në afatet e caktuara.

Neni 813

Qiramarrësi përgjigjet për humbjen dhe dëmtimin e sendit të cilat ndodhin gjatë kontratës së qirasë.

Neni 814

Qiramarrësi duhet t'ia kthejë qiradhënësit sendin në të njëjtën gjendje që e ka marrë, në përputhje me përshkrimin e bërë nga palët në kontratë, përveç dëmtimit ose konsumimit të zakonshëm nga përdorimi i sendit në përputhje me kontratën.

Në mungesë të përshkrimit në kontratë prezumohet se qiramarrësi e ka marrë sendin në gjëndje të mirë përdorimi.

Qiramarrësi nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar si pasojë e vjetërsisë. Sendet e luajtshme duhet të kthehen në vendin ku janë marrë në dorëzim.

Neni 815

Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t'i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës.

Neni 816

Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, qiramarrësi nuk ka të drejtë të shpërblehet për përmirësimet e bëra sendit të marrë me qira. Por në qoftë se ka patur pëlqimin e qiradhënësit, ky është i detyruar t'i paguajë një kompensim që i korrespondon shumës më të vogël midis shumës së shpenzimeve dhe vleftës së rezultatit të dobishëm në kohën e dorëzimit. Kur qiramarrësi nuk ka të drejtë kompensimi, vlefta e përmirësimeve mund të kompensojë dëmtimet që kanë ndodhur për pakujdesinë e rëndë të qiramarrësit.

Neni 817

Qiramarrësi që ka bërë shtesa në sendin e marrë me qira, ka të drejtë t'i heqë ato në mbarim të qirasë, kur kjo mund të kryhet pa dëmtuar sendin, përveç kur pronari pranon t'i mbajë vetë shtesat. Në këtë rast ky duhet t'i paguajë qiramarrësit një kompensim të barabartë me shumën më të vogël midis shpenzimeve dhe vleftës të shtesave në kohën e ridorëzimit.

Në qoftë se shtesat nuk mund të ndahen pa dëmtuar sendin dhe përbëjnë një përmirësim të tij, zbatohen rregullat e parashikuara nga neni 810.

Neni 818

Qiramarrësi, veç marrëveshjes së kundërt, ka të drejtë të japë me nënqira sendin që ka marrë me qira, por nuk mund t'ia kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit.

Për sende të luajtshme dhënia me nënqira bëhet me pëlqimin e qiradhënësit.

Neni 819

Qiradhënësi, pa cenuar të drejtat e tij ndaj qiramarrësit, mund të ngrejë padi kundër nënqiramarrësit për të kërkuar çmimin e nënqirasë për të cilën ky i fundit është ende debitor në momentin e ngritjes së padisë dhe për ta detyruar atë të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e nënqirasë.

Shpallja e pavlefshme e kontratës së qirasë ose zgjidhja e saj ka efekt edhe ndaj nënqiramarrësit, dhe vendimi i marrë midis qiradhënësit dhe qiramarrësit ka efekt edhe ndaj tij.

Mbarimi i kontratës së qirasë

Neni 820

Qiraja me afat të caktuar nga palët, pushon me mbarimin e afatit, pa qënë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.

Qiraja në të cilën nuk caktohet afat nuk pushon, në qoftë se përpara afatit të vendosur sipas nenit 803 të këtij Kodi njëra nga palët njofton palën tjetër se heq dorë nga qiraja.

Përsëritja e kontratës së qirasë

Neni 821

Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit.

Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.

Marrëdhëniet me të tretët

Neni 822

Kontrata e qirasë mund t'i kundrejtohet të tretit që ka fituar sendin e dhënë me qira, me kusht që kontrata të ketë një datë të saktë para tjetërsimit të sendit.

Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen për qiranë e sendeve të luajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, në qoftë se fituesi ka siguruar posedimin me mirëbesim.

Qiraja e sendeve të paluajtshme të paregjistruara nuk i kundrejtohet fituesit të tretë, veç brenda afatit të 9 vjetëve nga fillimi qirasë.

Fituesi duhet të respektojë qiranë në çdo rast në qoftë se ka marrë përsipër detyrimin ndaj tjetërsuesit.

Neni 823

Në qoftë se qiraja nuk ka datë të saktë, por mbajtja e saj prej qiramarrësit si datë është përpara kalimit të pronësisë, fituesi nuk është i detyruar të respektojë qiranë, veçse për kohëzgjatjen që përkon me atë të vendosur për qiratë me afat të pacaktuar.

Neni 824

Në qoftë se qiramarrësi është përjashtuar nga fituesi, sepse kontrata e qirasë nuk kishte një datë të saktë përpara kalimit të pronësisë, qiradhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 825

Fituesi është i detyruar të respektojë kontratën e qirasë qysh nga dita e fitimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qirasë.

A. Qiraja për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 826

Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Neni 827

Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. E drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu.

Neni 828

Qiradhënësi përballon detyrimet dhe taksat financiare që rëndojnë mbi pasurinë e paluajtshme.

Neni 829

Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.

Neni 830

Qiramarrësi shlyen çmimin e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë. Çmimi i qirasë mund të jetë në natyrë dhe në të holla.

E drejta e kultivimit

Neni 831

E drejta e kultivimit nënkupton të drejtën e njërës nga palët kontraktuese që të vendosë se çfarë do të kultivohet nga një periudhë në tjetrën. Kjo e drejtë rregullohet me marrëveshje të palëve.

Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose kryesisht me prodhime bujqësore nga produktet që kultivohen në pasurinë e paluajtshme të dhënë me qira, e drejta e kultivimit i takon qiradhënësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonit të vendit, nuk parashikohet ndryshe.

Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose pjesërisht nga një shumë parash që i jepet qiradhënësit, e drejta e kultivimit i takon qiramarrësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonit të vendit, nuk parashikohet ndryshe.

Neni 832

Pala që ka të drejtën e kultivimit, kur nuk i njofton palës tjetër planin e kultivimit në kohën e duhur dhe kur pritja e mëtejshme e këtij njoftimi mund të sjellë pasoja serioze në kultivimin bujqësor, kjo e drejtë i kalon palës tjetër.

Koha dhe shpenzimet e kultivimit

Neni 833

Qiramarrësi vendos me përgjegjësinë e tij për kohën kur do të kryejë veprimet e kultivimit dhe për mënyrat dhe të rejat agroteknike që do të zbatojë. Qiramarrësi në këtë drejtim mund të bëjë vetëm rekomandime.

Neni 834

Shpenzimet që nevojiten për kultivimin përballohen nga qiramarrësi. Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht apo kryesisht nga produkti që kultivohet, qiradhënësi i parapaguan pa kamatë qiramarrësit ato shpenzime që mund të kërkohen për kultivimin, në rast se ky i fundit nuk mundet t'i përballojë vetë.

Parapagimi i dhënë i kthehet qiradhënësit nga prodhimi i të korrave të ardhshme

Shlyerja e çmimit të qirasë

Neni 835

Çmimi i qirasë shlyhet sipas afateve të caktuara në kontratë. Në mungesë të një caktimi të tillë, shlyhet në fund të çdo viti të kontratës, kur çmimi është caktuar në para.

Viti i kontratës së qirasë fillon ditën kur qiramarrësit i dorëzohet pasuria e marrë me qira.

Neni 836

Kur çmimi i qirasë përbëhet nga një pjesë e prodhimit bujqësor ose në raport me atë, qiradhënësit i dorëzohet pjesa që i takon sipas kërkesës së tij, pasi të jenë mbledhur të korrat.

Në mungesë të marrëveshjes respektohet zakoni i vendit.

Neni 837

Qiramarrësi mund të kërkojë uljen e çmimit të qirasë ose shtyrjen e pagimit të saj, kur rrethana të paparashikuara ose ngjarje të jashtëzakonshme e kanë ulur prodhimtarinë e një viti në të paktën gjysmën në krahasim me prodhimtarinë normale.

Neni 838

Qiramarrësi mund të kërkojë që të rishikohet çmimi i qirasë në favorin e tij, duke patur parasysh prodhimtarinë e zakonshme, rëndësinë e humbjes së pësuar, fitimet që ka patur ai vitet e mëparshme dhe ato që mund të sigurojë gjatë kohës që kontrata është në fuqi.

Neni 839

Në rast zgjidhje të kontratës, qiramarrësi nuk është i detyruar të lërë farërat për të mbjellat e ardhshme, përveç kur në kontratë ose nga zakoni i vendit parashikohet ndryshe.

Neni 840

Qiramarrësi nuk gëzon të drejtën e marrjes së frutave, të cilat në kohën e përfundimit të kontratës, ende nuk ishin vjelë. Por gjykata mund të pranojë që qiramarrësit t'i paguhen shpenzimet që mund të ketë bërë për kultivimin e frutave. Gjithësesi ky shpërblim nuk mund të kalojë vlerën e frutave që përfiton qiramarrësi.

B. Qiraja e sendeve prodhuese

Neni 841

Kur qiraja ka për objekt gëzimin e një sendi prodhues, të luajtshëm ose të paluajtshëm, qiramarrësi duhet të përkujdeset për administrimin e tij në përputhje me destinimin ekonomik të sendit.

Neni 842

Në qoftë se palët nuk e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qirasë, secila prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata duke e njoftuar tjetrën qysh më përpara në një kohë të përshtatshme.

Neni 843

Qiradhënësi duhet:

1. të dorëzojë sendin me aksesorët e vet në gjendje të përshtatshme për përdorimin dhe prodhimin për të cilin është destinuar;
2. të kryejë me shpenzimet e veta riparimet e jashtëzakonshme për të cilat sendi ka nevojë gjatë kohës së qirasë.

Neni 844

Qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se qiramarrësi nuk vë në shërbim të sendit mjetet e nevojshme për administrimin e tij, në qoftë se nuk zbaton rregullat teknike dhe në qoftë se ndryshon në mënyrë të qëndrueshme destinimin ekonomik të sendit.

Neni 845

Qiramarrësi mund të ndërmarrë nisma për rritjen e prodhimtarisë së sendit të marrë me qira, mjafton që ato të mos sjellin detyrime për qiradhënësin, ose të mos i shkaktojnë cenime të të drejtave të tij.

Neni 846

Në qoftë se si pasojë e një ligji ose e një vendimi të detyrueshëm për administrimin prodhues të sendit, raporti kontraktor rezulton i ndryshuar dukshëm, në mënyrë të tillë që njëra palë të humbasë dhe tjetra të fitojë, mund të kërkohet një shtesë apo një zbritje e çmimit të qirasë, ose sipas rrethanave, zgjidhja e kontratës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 847

Qiramarrësi nuk mund ta lëshojë sendin me nënqira pa lejen e qiradhënësit.

Kur qiramarrësi shkel një detyrim të tillë, qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

E drejta për të kaluar kontratën e qirasë një tjetri përfshin dhe nënqiranë, përveç kur palët kanë disponuar ndryshe në kontratë.

Neni 848

Dispozitat e kontratës së qirasë zbatohen edhe për qiranë e sendeve prodhuese, në masën që pajtohen me to.

C. Qiraja financiare (leasing)

Neni 849

Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve.

Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshkrimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar.

Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit, si dhe për të metat e sendit.

Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.

KREU VII
SIPËRMARRJA

Përmbajtja
Neni 850

Sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.

Caktimi i çmimit
Neni 851

Kur palët nuk e kanë caktuar çmimin e sipërmarrjes dhe as nuk kanë vendosur mënyrën për ta përcaktuar atë, ai llogaritet në bazë të tarifave ekzistuese ose në bazë të zakonit të vendit. Në rast mosmarrëveshjeje, caktohet nga gjykata.

Sigurimi i materialeve
Neni 852

Materialet e nevojshme për kryerjen e veprës duhet të sigurohen nga sipërmarrësi, në qoftë se marrëveshja nuk parashikon ndryshe.

Të drejta e detyrime të sipërmarrësit
Neni 853

Sipërmarrësi duhet të paralajmërojë në kohën e duhur porositësin:
a) kur materiali i dhënë nga porositësi për veprën është me cilësi jo të mirë, kur kjo zbulohet gjatë punimeve dhe dëmton cilësinë e veprës;
b) kur udhëzimet e porositësit nuk mund të zbatohen ose kur zbatimi i tyre bën që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme;
c) kur ka rrethana, që nuk varen nga sipërmarrësi, të cilat ndikojnë që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme.
Sipërmarrësi përgjigjet për dëmin që pëson porositësi, po qe se nuk e paralajmëron atë përsa më sipër.

Neni 854

Sipërmarrësi ka të drejtë që të heqë dorë nga zbatimi i kontratës dhe të kërkojë që të shpërblehet për dëmin që ka pësuar kur porositësi nuk zëvendëson materialin me cilësi jo të mirë ose të papërshtatshëm, ose kur nuk ndryshon udhëzimet për kryerjen e veprës, megjithëse është paralajmëruar në kohën e duhur prej tij.

Neni 855

Sipërmarrësi përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e materialit që i është dhënë nga porositësi, përveç kur provohet se humbja ose dëmtimi i tij ka ndodhur për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 856

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë t'i paguhet puna e kryer prej tij, kur vepra, para se t'i dorëzohet porositësit, humbet ose dëmtohet për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 857

Sipërmarrësi nuk mund të japë me nënsipërmarrje kryerjen e veprës ose kryerjen e shërbimeve, pa u marrë pëlqimi nga porositësi.

Neni 858

Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë mënyrat e caktuara në kontratë për kryerjen e veprës, pa pëlqimin me shkrim të porositësit.

Edhe kur është dhënë pëlqimi, sipërmarrësi, po qe se çmimi i plotë i veprës është caktuar në total, nuk ka të drejtë të kompensohet për ndryshimet ose për shtesat, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 859

Në qoftë se për kryerjen e veprës sipas standardeve është e nevojshme që projekti të ndryshohet dhe për këtë gjë palët nuk merren vesh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Në qoftë se ndryshimet në çmimet tejkalojnë një të gjashtën e madhësisë së çmimit të caktuar, sipërmarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe sipas rrethanave, një shpërblim të përshtatshëm të dëmeve.

Në qoftë se ndryshimet janë të konsiderueshme, porositësi mund të tërhiqet nga kontrata duke paguar një dëmshpërblim të përshtatshëm.

Të drejta e detyrime të porositësit

Neni 860

Porositësi mund të bëje ndryshime në projekt, me kusht që madhësia e tyre të mos kalojë një të gjashtën e çmimit të përgjithshëm të caktuar. Sipërmarrësi ka të drejtë të kompensohet për punimet kryesore të kryera, edhe pse çmimi i veprës është caktuar në total.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për ndryshimet në projekt që, megjithëse u përmbahen caqeve të lartpërmendura, sjellin ndryshime të konsiderueshme në natyrën e veprës ose në anën sasiore të kategorive të veçanta të punimeve të parashikuara në kontratë për kryerjen e së njëjtës vepër.

Neni 861

Porositësi ka të drejtë të kontrollojë kryerjen e punimeve dhe gjendjen e tyre me shpenzimet e veta.

Kur, gjatë punimeve, zbulohet se kryerja e tyre nuk vazhdon sipas kushteve të caktuara në kontratë dhe sipas standardeve, porositësi mund të caktojë një afat të arsyeshëm brenda të cilit sipërmarrësi duhet të pajtohet me ato kushte. Kur afati i caktuar ka kaluar pa sjellë ndonjë dobi, kontrata zgjidhet, pa cenuar të drejtën e porositësit për shpërblimin e dëmeve.

Neni 862

Në qoftë se si rrjedhim i rrethanave të paparashikuara, kanë ndodhur rritje ose ulje të kostos së materialeve ose të krahut të punës, që përcaktojnë një rritje ose një zbritje në një masë më të madhe se një e dhjeta e çmimit të përgjithshëm të caktuar, sipërmarrësi ose porositësi mund të kërkojnë rishikimin e çmimit. Ky rishikim mund të caktohet vetëm për masën e diferencës që tejkalon një të dhjetën. Kur gjatë punimeve hasen vështirësi të karakterit gjeologjik, hidrik dhe të tjera të ngjashme me to, të paparashikuara nga palët, të cilat e bëjnë mjaft më të vështirë detyrën e sipërmarrësit, ky ka të drejtë për një kompensim të përshtatshëm.

Neni 863

Porositësi, përpara se të marrë në dorëzim veprën e mbaruar, ka të drejtë ta kontrollojë atë.

Kontrolli duhet të kryhet nga porositësi, sapo sipërmarrësi të krijojë kushtet e duhura për kontrollin. Në qoftë se, megjithë ftesën e bërë prej sipërmarrësit, porositësi nuk e kryen kontrollin pa patur arsye të bazuara, ose kur nuk njofton rezultatin e kontrollit brenda një afati të shkurtër, vepra konsiderohet e pranuar.

Në qoftë se porositësi merr në dorëzim veprën pa paraqitur ndonjë rezervë, ajo konsiderohet e pranuar edhe pse nuk është kryer kontrolli.

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë të paguhet me vleftën e caktuar kur vepra pranohet nga porositësi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Garancia dhe denoncimi i të metave të veprës

Neni 864

Sipërmarrësi detyrohet të japë garanci për deformimet dhe veset e veprës. Garancia nuk kërkohet kur porositësi e ka pranuar veprën dhe deformimet ose veset njiheshin prej tij ose ishin të dallueshme, përveç kur ato janë fshehur me keqbesim nga sipërmarrësi.

Porositësi duhet t'i njoftojë sipërmarrësit deformimet ose veset brenda 60 ditëve nga zbulimi i tyre me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte. Njoftimi nuk është i domosdoshëm kur sipërmarrësi i ka njohur e pranuar deformimet dhe veset ose kur i ka fshehur ato.

Padia kundër sipërmarrësit parashkruhet brenda dy vjetëve nga data e dorëzimit të veprës. Porositësi i paditur për pagim mund të zbatojë gjithmonë garancinë, me kusht që deformimet dhe veset të njoftohen brenda 60 ditëve nga data e zbulimit dhe para se të kenë kaluar dy vjet nga data e dorëzimit.

Neni 865

Porositësi mund të kërkojë që deformimet ose veset të eliminohen me shpenzimet e sipërmarrësit, ose që çmimi të zbritet përpjesëtimisht, duke ruajtur të drejtën e shpërblimit të dëmit në rast se sipërmarrësi ka faj.

Por, në qoftë se deformimi ose cenet e veprës janë të tilla sa e bëjnë atë krejt të papërshtatshme për destinimin e saj, porositësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 866

Kur sipërmarrja ka për objekt ndërtesa ose sende të tjera të paluajtshme të cilat, për nga natyra e tyre, kanë destinim afatgjatë, po qe se, gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh nga përfundimi, vepra, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, shëmbet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shëmbjeje ose defekte të tjera të rënda, sipërmarrësi përgjegjet kundrejt porositësit dhe palëve që fitojnë të drejta prej tij, me kusht që denoncimi i tyre të bëhet brenda një viti nga zbulimi.

E drejta e porositësit parashkruhet brenda një viti nga kallëzimi.

Neni 867

Sipërmarrësi, për të ushtruar të drejtën e padisë së kthimit kundrejt nënsipërmarrësve, duhet që t'i njoftojë ata për denoncimin brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja dijeni me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte.

Zgjidhja e kontratës dhe pasojat juridike

Neni 868

Porositësi mund të tërhiqet nga kontrata, edhe kur ka filluar zbatimi i veprës ose kryerja e shërbimit, me kusht që ta kompensojë sipërmarrësin për shpenzimet e kryera, për punimet e bëra dhe për fitimin e munguar.

Neni 869

Kur kontrata zgjidhet sepse zbatimi i veprës është bërë i pamundur si pasojë i një shkaku që nuk mund t'i atribuohet asnjërës palë, porositësi paguan pjesën e veprës së kryer në kufijtë brenda të cilëve është e dobishme për të, në përpjesëtim me çmimin e caktuar për të gjithë veprën.

Neni 870

Kur materiali që i është dhënë sipërmarrësit nga porositësi, ose kur vepra e përgatitur me këtë material humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i veprës bëhet i pamundshëm pa fajin e asnjërit prej tyre, por në çdo rast pasi sipërmarrësi të jetë në vonesë për dorëzimin e veprës, ky është i detyruar t'i shpërblejë porositësit vleftën e materialit dhe nuk ka të drejtë të kërkojë prej tij që t'i paguajë punën e kryer.

Neni 871

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm para se të ketë mbaruar afati për dorëzimin e veprës, por në çdo rast pa fajin e asnjërit prej tyre, sipërmarrësi nuk ka të drejtë t'i kërkojë porositësit që t'i paguajë vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 872

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm pa fajin e sipërmarrësit ose të porositësit, por pasi porositësi është në vonesë për marrjen e veprës në dorëzim, ky detyrohet t'i paguajë sipërmarrësit vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 873

Kontrata e sipërmarrjes nuk zgjidhet me vdekjen e sipërmarrësit, përveç kur personi i sipërmarrësit konsiderohej i domosdoshëm për kryerjen e veprës. Porositësi mundet gjithmonë të tërhiqet nga kontrata, po qe se trashëgimtarëve të sipërmarrësit, nuk mund t'u besohet për kryerjen e mirë të veprës ose të shërbimit.

Neni 874

Në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkak të vdekjes së sipërmarrësit, porositësi detyrohet t'u paguajë trashëgimtarëve vleftën e veprës së kryer, duke u mbështetur në çmimin e caktuar, si dhe shpenzimet e kryera për ekzekutimin e pjesës së mbetur, por vetëm brenda kufijve në të cilët vepra e kryer dhe shpenzimet e bëra janë të dobishme për të.

Porositësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin, kundrejt një kompensimi të përshtatshëm, të vleftës së materialeve të përgatitura dhe planeve në zbatim e sipër, për aq sa lejojnë normat për mbrojtjen e shpikjeve dhe të pronësisë intelektuale.

Neni 875

Personat të cilët, duke qënë në varësi të sipërmarrësit, kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për zbatimin e veprës ose kryerjen e shërbimit, mund të ngrejnë padi drejtpërdrejt kundër porositësit për të marrë atë çka u takon deri në plotësimin e detyrës që porositësi ka ndaj sipërmarrësit në kohën kur ata ngrejnë padinë.

Dispozitë referuese
Neni 876

Kur sipërmarrja ka për objekt kryerje shërbimesh të vazhdueshme ose periodike, zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, normat e këtij titulli dhe ato lidhur me kontratën e furnizimit.

KREU VIII
TRANSPORTI

A. Transporti i personave

Neni 877

Me kontratën e transportit të personave, transportuesi merr përsipër të transportojë persona nga njëri vend në një vend tjetër.

Neni 878

Përveç përgjegjësisë për vonesën dhe për mospërmbushjen në kryerjen e transportit, transportuesi përgjigjet për fatkeqesitë që godasin personin udhëtar gjatë udhëtimit dhe për humbjen ose për dëmtimin e sendeve që udhëtari merr me vete, në qoftë se nuk provon se ka marrë të gjitha masat e përshtatshme për shmangien e dëmit, dhe në lidhje me rethanat e posaçme të rastit.

Janë të pavlefshme kushtet që kufizojnë përgjegjësinë e transportuesit për rreziqet që godasin udhëtarin.

Kjo dispozitë zbatohet edhe në kontratat e transportit falas.

Neni 879

Në transportin me itinerare që lidhen njëri me tjetrin, çdo transportues përgjigjet për udhëtimin e vet.

Megjithatë, dëmi për vonesën ose për ndërprerjen e udhëtimit llogaritet duke pasur parasysh të gjithë rrugën.

B. Transporti i sendeve

Neni 880

Me kontratën e transportit të sendeve, transportuesi merr përsipër të transportojë sende nga një vend në një vend tjetër.

Neni 881

Transportuesi duhet t'i vërë sendet e transportuara në dispozicion të marrësit në vendin, në afatin dhe nëpërmjet mënyrave të treguara në kontratë.

Në qoftë se dorëzimi nuk duhet të kryhet pranë marrësit, transportuesi duhet ta njoftojë atë menjëherë për mbërritjen e sendeve të transportuara.

Në qoftë se nga dërguesi është lëshuar një fletë shoqërimi, transportuesi duhet t'ia tregojë atë marrësit.

Neni 882

Dërguesi duhet t'i tregojë transportuesit me saktësi emrin e marrësit dhe vendin e destinimit, llojin, peshën, sasinë dhe numrin e sendeve për t'u transportuar dhe të dhëna të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit.

Në qoftë se për kryerjen e transportit nevojiten dokumente të posaçme, dërguesi duhet t'ia japë ato transportuesit në momentin kur dorëzon sendet per t'u transportuar.

Janë në ngarkim të dërguesit dëmet që rrjedhin nga mungesa ose pasaktësia e të dhënave ose nga mosdorëzimi apo parregullsia e dokumenteve.

Neni 883

Me kërkesën e transportuesit, dorëzuesi lëshon një fletë shoqërimi me nënshkrimin e vet, e cila përmban emrin e vet, vendqëndrimin ose qendrën e punës, vendin dhe datën e lëshimit, të dhënat e paraqitura në nenin e mësipërm dhe kushtet e caktuara për transportin.

Kur fletëshoqërimi jepet në disa kopje, numri i kopjeve duhet të tregohet në çdo ekzemplar. Kopjet e mbetura humbasin vlerën pasi sendet i dorëzohen mbajtësit të titullit.

Këto të dhëna janë të besueshme, derisa të mos jetë provuar e kundërta kundrejt transportuesit, i cili ka për detyrë t'i verifikojë ato, duke zbatuar përkujdesjen profesionale.

Me kërkesën e dërguesit, transportuesi lëshon një dublikatë të fletës të shoqërimit me nënshkrimin e vet ose, në qoftë se nuk i është lëshuar fleta e shoqërimit, një fletë marrje në dorëzim, që të përmbajë të njëjtat të dhëna.

Neni 884

Kontrata e transportit quhet e lidhur nga çasti që është bërë dokumenti i transportimit dhe dërguesi i mallrave ka bërë pagesën e transportimit, përveç kur në kontratë ose në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 885

Në qoftë se fillimi ose vazhdimi i transportit pengohen ose vonohen së tepërmi për shkaqe që nuk mund t'i ngarkohen transportuesit, ky menjëherë duhet t'i kërkojë udhëzime dërguesit, duke marrë masa për ruajtjen e sendeve që i janë dorëzuar atij.

Transportuesi ruan të drejtën e ripagimit të shpenzimeve.

Në qofte se transporti ka filluar, ai ka të drejta edhe për pagimin e çmimit në përpjestim me rrugën që ka kryer, përveç rastit kur ndërprerja e transportit ka ndodhur për shkak të humbjes së plotë të sendeve si pasojë e rastit fator.

Po qe se rrethanat e bëjnë të pamundur marrjen e udhëzimeve nga dërguesi, ose në qoftë se udhëzimet nuk janë të zbatueshme, transportuesi mund t'i depozitojë sendet ose, po qe se rrezikohen të dëmtohen, ose përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e vendeve ku janë ruajtur, ai mund të marrë masa për shitjen e tyre me çmimin më të mirë.

Transportuesi duhet të njoftojë menjëherë dërguesin për depozitimin ose shitjen.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe në rastin kur pritësi nuk gjendet ose refuzon apo vonon të kërkojë marrjen në dorëzim të sendeve, edhe në rastin kur lind mosmarrëveshje midis disa marrësve ose për të drejtën e marrësit për marrjen në dorëzim apo për ekzekutimin e saj.

Neni 886

Dërguesi mund të pezullojë transportimin dhe të kërkojë kthimin e sendeve, ose të urdhërojë dorëzimin tek një marrës tjetër i ndryshëm nga ai i treguar në fillim ose mund të vendosë ndryshe, gjithmonë duke ruajtur detyrimin për të riparuar shpenzimet dhe për të shpërblyer dëmet që rrjedhin nga urdhri i dytë.

Kur nga ana e transportuesit i është lëshuar dërguesit një dublikatë e fletës së shoqërimit ose e fletë ngarkesës, dorëzuesi nuk mund të disponojë sendet e dorëzuara për transport po qe se nuk i paraqet transportuesit dublikatën ose faturën për të treguar të dhënat e reja. Këto duhet të nënshkruhen edhe nga transportuesi.

Dërguesi nuk mund të disponojë sende të transportuara qysh prej momentit kur ato kanë kaluar në dispozicion të pritësit.

Neni 887

Të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit ndaj transportuesit i kalojnë pritësit nga momenti kur, pasi sendet kanë mbërritur në destinacion ose ka skaduar afati në të cilin duhet të kishin mbërritur. Pritësi kërkon marrjen në dorëzim nga transportuesi, pritësi nuk mund të ushtrojë të drejtat që lindin nga kontrata, përveç se duke i paguar transportuesit kreditë që rrjedhin nga transporti dhe faturat që shoqërojnë sendet e transportuara. Kur ka mosmarrëveshje për shumën e detyruar, marrësi duhet të depozitojë diferencën e vënë në dyshim pranë një të treti.

Neni 888

Transportuesi që i dorëzon pritësit sendet pa mbledhur kreditë e veta ose faturat që shoqërojnë sendet e transportuara, ose pa kërkuar depozitimin e shumës së diskutueshme, është përgjegjës ndaj dërguesit për vleftën që i detyrohet atij dhe nuk mund t'i kërkojë këtij të fundit pagimin e kredive të veta. Megjithatë e drejta për të paditur pritësin nuk cenohet.

Përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin e sendeve gjatë transportimit

Neni 889

Transportuesi është përgjegjës për humbjen dhe dëmtimin e sendeve të dorëzuara atij qysh nga momenti kur i merr, deri në momentin kur ia dorëzon pritësit, po qe se nuk provon që humbja ose dëmtimi janë pasojë e rastit fator, e veprimit të dërguesit, të pritësit ose të pronarit të sendeve të dërguara, nga firot ose nga lloji e nga veset e vetë sendeve.

Në qoftë se transportuesi i pranon sendet për transportim pa rezervë, prezumohet se sendet nuk paraqesin të meta të dukshme ambalazhi.

Transportuesi, me kërkesën e pritësit, detyrohet të mbajë procesverbal për humbjen ose dëmtimin e sendeve të dorëzuara për transportim.

Neni 890

Transportuesi duhet të njoftojë pritësin pa vonesë dhe përpara dorëzimit të sendeve, për dëmet që sendet mund të kenë pësuar.

Neni 891

Në qoftë se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar, dëmi llogaritet, përveç marrëveshjes së kundërt, sipas çmimit të tyre në kohën e ngarkimit nga ana e transportuesit. Po qe se sendet dëmtohen,

transportuesi duhet të shpërblejë dëmin në masën e diferencës midis vleftës së sendeve në momentin e ngarkimit dhe vleftës në momentin e dorëzimit.

Neni 892

Pritësi ka të drejtë të sigurohet, me shpenzimet e veta, përpara marrjes në dorëzim, për identitetin dhe gjendjen e sendeve të transportuara.

Neni 893

Marrja në dorëzim pa rezervë e sendeve të transportuara duke paguar transportuesin për aq sa i takon, heq mundësinë për ngritje të padisë që rrjedh nga kontrata, përveç rastit të mashtrimit ose të pakujdesisë së rëndë të transportuesit. Nuk cenohen të drejtat për të kërkuar humbjen e pjesshme ose për dëmtime të tilla që nuk mund të dallohen në momentin e marrjes në dorëzim, me kusht që transportuesi të njoftohet menjëherë sa të zbulohet dëmi dhe jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes në dorëzim.

Neni 894

Kur transportuesi detyrohet t'i përcjellë sendet e transportuara përtej linjave të tij, nëpërmjet transportuesish të tjerë, pa marrë nga dorëzuesi një fletë shoqërimi të drejtpërdrejtë për në vendin e destinimit, prezumohet që ai merr, për transportin përtej linjave të veta, detyrimet e një spedicioneri.

Transportimi i kryer nga disa transportues

Neni 895

Në transportin e sendeve që kryhet bashkërisht nga disa transportues të njëpasnjëshëm me një kontratë të vetme, transportuesit përgjigjen solidarisht për përmbushjen e kontratës nga vendi fillestar i nisjes deri në vendin e destinimit.

Transportuesi që paditet për një veprim për të cilin nuk ka përgjegjësi, ka të drejtën e padisë kundrejt transportuesve të tjerë, qoftë veç e veç, qoftë bashkërisht. Po qe se del se veprimi që ka sjellë dëmtimin ka ndodhur në rrugën e njërit prej transportuesve, ky detyrohet të bëjë shpërblimin e plotë të dëmit; në rast të kundërt, detyrohen të shpërblejnë transportuesit përpjestimisht me rrugët e tyre, duke përjashtuar ata transportues që provojnë se dëmi nuk ka ndodhur në rrugën e vet.

Neni 896

Transportuesit e njëpasnjëshëm kanë të drejtë të deklarojnë, në fletëshoqërimin ose në një akt të veçantë, gjendjen e sendeve për t'u transportuar në momentin kur u janë dorëzuar atyre. Në mungesë të deklaratës, prezumohet se i kanë marrë në gjendje të mirë dhe në përputhje me fletë shoqërimin.

Përgjegjësia e dërguesit dhe e transportuesit për vonesën

Neni 897

Kur dorëzimi i sendeve për transportim ose dorëzimi i sendeve pritësit nuk bëhet në afatet e caktuara në kontratë, pala që është në vonesë shpërblen dëmin përkatës.

Neni 898

Kreditë që rrjedhin nga transporti kanë prvilegj mbi sendet e transportuara deri sa këto të mbeten pranë transportuesit. Transportuesi mund të mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit deri sa të shpërblehet kredia e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Përgjegjësia e transportuesit të fundit

Neni 899

Transportuesi i fundit përfaqëson transportuesit e mëparshëm për mbledhjen e kredive përkatëse që lindin nga kontrata e transportit dhe për ushtrimin e privilegjit mbi sendet e transportuara. Në qoftë se ai nuk i mbledh kreditë ose nuk ushtron privilegjin, përgjigjet para kreditorëve paraardhës për shumat e detyruara, përveç të drejtës së padisë kundrejt pritësit.

Dispozitë referuese

Neni 900

Për transportimet me rrugë ujore, ajrore dhe për ato hekurudhore e postare, kur mungon legjislacioni i posaçëm, zbatohen dispozitat e kësaj kontrate.

KREU IX
HUAPËRDORJA

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Neni 903

Huamarrësi detyrohet ta mbajë dhe ta ruajë sendin me përkujdesje. Ai nuk mund ta përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në kontratë ose nga natyra e sendit. Huamarrësi nuk mund t'ia japë një të treti sendin për përdorim pa pëlqimin e huadhënësit.

Kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 904

Huamarrësi është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e sendit, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se do të ishte dhënë në huapërdorje.

Neni 905

Në qoftë se huamarrësi e përdor sendin ndryshe nga sa është caktuar në kontratë ose nga natyra e tij dhe për një kohë më të gjatë se sa duhej, përgjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti fator,

përveç kur provon se sendi do të humbiste njëlloj, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në kontratë.

Neni 906

Huamarrësi nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.

Neni 907

Në qoftë se gjatë afatit të caktuar, ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin sipas kontratës, huadhënësi ndodhet përpara një nevoje të ngutshme dhe të paparashikuar të sendit, ai mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 908

Në rast vdekjeje të huamarrësit, huadhënësi, edhe po të jetë caktuar një afat, mund të kërkojë nga trashëgimtarët kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 909

Huamarrësi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të sendit të dhënë në huapërdorje, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe, ndërsa ndreqjet e tjera bëhen nga huadhënësi.

Neni 910

Po qe se gjatë huapërdorjes huamarrësi është detyruar, për të ruajtur sendin, që të kryejë shpenzime të jashtëzakonshme, të nevojshme dhe të ngutshme dhe se për këto nuk ka patur mundësi të njoftonte huadhënësin, ky duhet t'ia paguajë huamarrësit.

Neni 911

Po qe se sendi i huapërdorur ka patur të meta të tilla që dëmtojnë atë që e përdor, huadhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin sa kohë që, duke i ditur të metat e sendit, nuk ka njoftuar huamarrësin.

Neni 912

Kur mbaron afati i kontratës së huapërdorjes, ose kur kontrata zgjidhet para këtij afati, huamarrësi është i detyruar t'i kthejë huadhënësit sendin po në atë gjendje në të cilën e mori me ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tij, ose në gjendjen e parashikuar në kontratë. Gjersa nuk provohet e kundërta prezumohet se sendi është marrë në gjendje të mirë.

KREU X
POROSIA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 913

Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër.

Neni 914

Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin.

Neni 915

I porosituri që vepron në emrin e vet fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet e kryera me të tretët, edhe po qe se këta kanë patur dijeni për porosinë.

Të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Megjithatë porositësi, duke zënë vendin e të porositurit, mund të ushtrojë të drejtat e kredisë që rrjedhin nga zbatimi i porosisë, përveç kur mund të cenojë të drejtat që gëzon i porosituri në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Neni 916

I porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositësit. Ai mund të largohet nga këto udhëzime vetëm kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesat e porositësit dhe nuk ka mundësi që të merret vesh më parë me të.

Neni 917

Porosia përfshin jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre.

Porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës, po qe se nuk cilësohen shprehimisht.

Neni 918

Porositësi mund të rivendikojë sendet e luajtshme të fituara për llogari të vet nga i porosituri që ka vepruar në emrin e vet, pa cenuar të drejtat e fituara nga të tretët për efektet e posedimit me mirëbesim.

Po qe se sendet e fituara nga i porosituri janë pasuri e paluajtshme ose pasuri e luajtshme të regjistruara në regjistrat publike, i porosituri është i detyruar t'ia rikthejë porositësit.

Neni 919

Kreditorët e palës së porositur nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre mbi sendet që gjatë ekzekutimit të porosisë, i porosituri i ka vetësuar me emrin e vet, me kusht që kur është fjala për pasuri të luajtshme ose për kredi, porosia të vërtetohet nga një provë me shkrim që përmban datë të saktë përpara vënies dorë ose, kur është fjala për pasuri të paluajtshme ose për pasuri të luajtshme të regjistruara në regjistrat publike, regjistrimi i aktit të rikthimit ose i kërkesës gjyqësore që synon të përfitojë kthimin e përmendur të përmbajë një datë përpara vehtësimit.

Neni 920

Porosia prezumohet se është me shpërblim. Masa e shpërblimit, kur nuk caktohet nga palët, përcaktohet në bazë të tarifave profesionale ose zakonit dhe në mungesë të tyre nga gjykata.

Neni 921

I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj.

I porosituri detyrohet gjithashtu që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është autorizuar t'ia kalojë një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit.

Neni 922

I porosituri duhet të marrë masa për ruajtjen e sendeve që janë dërguar për llogari të porositësit dhe të mbrojë të drejtat e këtij të fundit kundrejt transportuesit, po qe se sendet paraqesin shenja dëmtimi ose kur kanë mbërritur me vonesë.

Neni 923

Porositësi, përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, detyrohet të furnizojë të porositurin me mjetet e nevojshme për kryerjen e porosisë dhe për përmbushjen e detyrimeve që me atë synim i porosituri i ka marrë përsipër në emrin e vet.

Neni 924

I porosituri është i detyruar t'i japë porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.

Neni 925

Porositësi duhet të paguajë të porositurin për parapagesat, së bashku me kamatat ligjore qysh nga dita kur janë kryer si dhe t'i paguajë shpërblimin që i takon.

Porositësi duhet gjithashtu të shpërblejë dëmet që i porosituri ka pësuar për shkak tee detyrës.

Neni 926

Kreditë në para të rrjedhura nga punët e veprimet që i porosituri ka kryer, kanë përparësi ndaj porositësit dhe ndaj kreditorëve të tij.

Shuarja e porosisë

Neni 927

Porosia shuhet me vdekjen, pazotësinë për të vepruar ose falimentimin e porositësit ose të të porositurit, përveç marrëveshjes tjetër ose kur rezulton ndryshe nga natyra e rrethanave të krijuara.

Megjithatë, kur shuarja e porosisë mund të cenojë interesat e porositësit, i porosituri, trashëgimtarët ose përfaqësuesit detyrohen të vazhdojnë administrimin deri kur porositësi, trashëgimtarët e tij ose përfaqësuesit e vet, të jenë në gjëndje të merren vetë drejtpërdrejt me çështjen.

Heqja dorë nga porosia dhe efektet juridike

Neni 928

I porosituri mund të heqë dorë nga kontrata por, po qe se në marrëveshje është parashikuar e kundërta, ai përgjigjet për dëmet, përveç kur heqja dorë bëhet për një shkak të drejtë.

Porosia e dhënë në interes të të porositurit ose të tretëve nuk shuhet me revokim nga ana e porositësit, përveç kur është vendosur ndryshe në kontratë ose ajo bëhet për një shkak të drejtë, por nuk shuhet për shkak të vdekjes ose për pazotësinë për të vepruar që i ndodh porositësit.

Neni 929

Emërimi i një të porosituri të ri për të njëjtën marrëveshje ose kryerja e kësaj nga ana e porositësit sjell heqjen e porosisë, dhe ka efekt qysh nga dita kur i janë njoftuar të porositurit.

Neni 930

Heqja dorë nga porosia me shpërblim dhe për një kohë të caktuar ose për një punë të caktuar, detyron porositësin të shpërblejë dëmet, po qe se është bërë përpara mbarimit të afatit apo të kryerjes së punës, përveç kur ekziston një shkak i drejtë.

Kur porosia është me afat të pacaktuar, heqja dorë detyron porositësin për shpërblimin e dëmit, po qe se nuk është bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për revokim.

Neni 931

I porosituri që heq dorë nga porosia pa ndonjë shkak të drejtë duhet t'i shpërblejë dëmet porositësit. Kur porosia është me afat të pacaktuar, i porosituri që heq dorë pa ndonjë shkak të drejtë detyrohet të shpërblejë dëmin po qe se nuk ka bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme.

Në çdo rast, heqja dorë duhet bërë në një mënyrë dhe në një kohë të tillë që porositësi të marrë masa për të vepruar ndryshe, përveç rastit të një vështirësie të madhe nga ana e të porositurit.

Neni 932

Në qoftë se porosia është dhënë nga disa persona me një akt të vetëm dhe për një çështje me interes të përbashkët, heqja dorë nuk ka efekt kur nuk është bërë nga të gjithë të porositurit, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për heqjen dorë.

Neni 933

Aktet që i porosituri ka kryer përpara se të marrë vesh shuarjen e porosisë janë të vlefshme kundrejt porositësit dhe trashëgimtarëve të tij.

Neni 934

Porosia e dhënë disa personave që mendohet të punojnë bashkërisht shuhet edhe po qe se shkaku i shuarjes ka të bëjë vetëm me njërin prej të porositurve, përveç kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe.

KREU XI
KOMISIONI

Përmbajtja
Neni 935

Kontrata e komisionit është një porosi që ka për objekt blerjen dhe shitjen e sendeve për llogari të porositësit dhe në emër të komisionerit.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 936

Porositësi është i detyruar t'i paguajë komisionerit të gjitha shpenzimet që ka bërë për kryerjen e porosisë dhe shpërblimin që parashikohet në kontratën e komisionit, si dhe ta shkarkojë nga çdo detyrim që komisioneri ka marrë ndaj të tjerëve për kryerjen e komisionit.

Neni 937

Komisioneri prezumohet se është i autorizuar që të lejojë vonesa në pagim, në përputhje me zakonin e vendit ku kryen veprimin, në qoftë se kur porositësi nuk ka vendosur ndryshe.

Në qoftë se i porosituri lejon vonesa në pagim, pavarësisht nga ndalimi i porositësit ose nga zakoni i vendit, porositësi mund të kërkojë nga ai pagimin e menjëhershëm, përveç të drejtës së komisionerit për të përfituar avantazhet e ardhura nga vonesa në pagim.

Komisioneri që ka lejuar vonesën në pagim duhet t'i tregojë porositësit se cila ishte pala e kontraktuar dhe afati i dhënë, përndryshe veprimi quhet se është kryer pa u lejuar vonesë dhe zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 938

Komisioneri nuk përgjigjet për ekzekutimin nga ana e personit të tretë të kontratës së lidhur nga komisioneri me të, për llogari të porositësit, përveç kur në kontratën e komisionit parashikohet ndryshe.

Neni 939

Kur komisioneri ka kryer veprimin juridik në kushte më të dobishme nga ato të udhëzimeve që i kishte dhënë porositësi, gjithçka që komisioneri ka fituar në këtë rast kalon në dobi të porositësit.

Neni 940

Komisioneri ka të drejtë të largohet nga udhëzimet që i ka dhënë porositësi vetëm kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, një largim i tillë bëhet i nevojshëm për interesat e porositësit, dhe komisioneri nuk mund të merret vesh më parë me porositësin ose, kur, megjithëse e ka pyetur, nuk ka marrë përgjigje në kohën e duhur.

Neni 941

Komisioneri është i detyruar të lidhë kontratë sigurimi për sendet e porositësit që ndodhen pranë tij, vetëm po të jetë parashikuar në kontratën e komisionit, ose po të jetë sigurimi i detyrueshëm në bazë të ligjit.

Neni 942

Porositësi mund të ndryshojë rradhën e përfundimit të marrëveshjes sa kohë që komisioneri nuk e ka përfunduar. Në këtë rast i takon komisionerit një pjesë e shpërblimit për ndërmjetësim që përcaktohet duke u mbajtur parasysh shpenzimet e kryera dhe puna e bërë.

Neni 943

Në komisionin për shitjen dhe blerjen e mallrave, titujve, valutave dhe vlerave të tjera që kanë një çmim liste ose një çmim të caktuar nga organet shtetërore, po qe se porositësi nuk ka vendosur ndryshe, komisioneri mund të përfshijë në të njëjtin çmim, të fiksuar në momentin e ekzekutimit të

porosisë, sendet që duhet të blejë, ose të blejë për vetë sendet që duhet të shesë, duke ruajtur të drejtën për shpërblimin për ndërmjetësim.

Dispozitë referuese
Neni 944

Dispozitat mbi porosinë zbatohen edhe për komisionin gjersa nuk parashikohen ndryshe në këtë kre.

KREU XII
SPEDICIONI (DËRGESA)

Përmbajtja
Neni 945

Kontrata e spedicionit (dërgesës) është një porosi me të cilën spedicioneri merr përsipër detyrimin për të lidhur në emër dhe për llogari të porositësit, një kontratë transporti dhe për të kryer të gjitha veprimet ndihmëse.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 946

Deri sa spedicioneri nuk ka lidhur kontratën e transportit me transportuesin, dërguesi mund të revokojë urdhërin e dërgesës, duke i paguar spedicionerit shpenzimet e kryera dhe duke i dhënë atij një shpërblim të përshtatshëm për shërbimin e kryer.

Neni 947

Në zgjedhjen e rrugës, mjetit dhe mënyrave të transportit të mallit, spedicioneri detyrohet të zbatojë udhëzimet e porositësit dhe, në mungesë të tyre, të veprojë sipas interesit më të mirë të tij.

Shpërblimet, zbritjet nga çmimi dhe përfitimet tarifore të realizuara nga spedicioneri duhet t'i kreditohen porositësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 948

Masa e shpërblimit që i takon spedicionerit për kryerjen e detyrës përcaktohet, kur nuk ka marrëveshje për të, sipas tarifave profesionale ose, kur këto mungojnë, sipas zakoneve të vendit ku kryhet dërgesa.

Parapagesat dhe kompensimet për shërbimet ndihmëse të kryera nga spedicioneri, likuidohen në bazë të dokumenteve justifikuese, veç në qoftë se ripagimi dhe kompensimet janë përcaktuar paraprakisht me një shumë të përgjithshme totale.

Neni 949

Spedicioneri, i cili me mjetet e veta ose të tjetërkujt, merr përsipër kryerjen e transportit tërësisht ose pjesërisht, ka të drejtat dhe detyrimet e transportuesit.

KREU XIII
AGJENCIA
(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 10)

Neni 950
Dispozita të përgjithshme

Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.

Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.

Neni 951
Ekskluziviteti

Pala porositëse nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një agjent në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë.

Gjithashtu, agjenti nuk mund të trajtojë njëkohësisht, në të njëjtën zonë apo për të njëjtën grup klientësh dhe për të njëjtën fushë, kontratat e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Agjenti tregtar, në ushtrimin e aktiviteteve të tij, duhet të kujdeset për interesat e porositësit dhe të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Agjenti tregtar duhet në veçanti:

a) të përpiqet për të negociuar dhe, kur është rasti, të lidhë kontratat për të cilat është ngarkuar;

b) t'i njoftojë porositësit çdo informacion të nevojshëm që ai disponon;

c) të zbatojë udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga porositësi.

Porositësi, në marrëdhëniet e tij me agjentin tregtar, duhet të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Porositësi duhet në veçanti:

a) të vërë në dispozicion të agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me kontratat në fjalë;

b) t'i sigurojë agjentit tregtar informacionet e nevojshme për përmbushjen e kontratës së agjencisë, veçanërisht të njoftojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, sapo ai parashikon që volumi i kontratave do të jetë në mënyrë të dukshme më i ulët se ai, të cilin agjenti tregtar do të priste normalisht.

Porositësi, gjithashtu, duhet të informojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, për pranimin, refuzimin ose mosekzekutimin e një kontrate që agjenti tregtar ka siguruar për porositësin.

Palët nuk mund të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 953
Shpërblimi i agjentit tregtar

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë, të caktuar për kontratat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, përfitojnë zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e kontratës.

Konsiderohen si shpërblim i agjentit të gjitha elementet e pagesës që përfiton ai dhe që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare.

Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm, që merr parasysh të gjitha elementet që kanë të bëjnë me veprimin.

Neni 954

Agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit për kontratat e përfunduara gjatë periudhës së kontratës së agjencisë:

a) nëse kontrata është përfunduar si rezultat i veprimit të tij;

b) nëse kontrata është përfunduar me një të tretë, të cilin ai kishte fituar më parë si klient për kontrata të të njëjtit lloj;

c) nëse ai ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike të caktuar ose një grupi klientësh dhe kontrata është kryer me një klient që i përket kësaj zone dhe/ose këtij grupi.

Për një kontratë të përfunduar pas përfundimit të kontratës së agjencisë, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit:

a) nëse kontrata i detyrohet kryesisht përpjekjeve të tij të kryera gjatë kontratës së agjencisë, pavarësisht se kontratat janë përfunduar në një afat kohor të arsyeshëm, pas mbarimit të kontratës së agjencisë; ose

b) nëse porosia e një të treti ka qenë marrë nga porositësi ose nga agjenti tregtar para mbarimit të kontratës së agjencisë.

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e shpërblimit nëse ai i detyrohet agjentit tregtar paraardhës, përveç kur nuk rezulton nga rrethanat që është e drejtë që shpërblimi të ndahet mes agjentëve tregtarë.

Shpërblimi bëhet i pagueshëm në momentin dhe në masën kur paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) pala porositëse ka ekzekutuar kontratën;

b) pala porositëse duhej të kishte ekzekutuar kontratën, në përputhje me marrëveshjen e lidhur me palën e tretë;

c) pala e tretë ka ekzekutuar kontratën.

Shpërblimi merret më vonë kur një i tretë ka ekzekutuar pjesën e tij të kontratës apo do të duhej ta kishte ekzekutuar, nëse pala porositëse do të kishte ekzekutuar pjesën e tij të kontratës.

Shpërblimi paguhet jo më vonë se dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i kërkueshëm.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 955

E drejta për shpërblim mund të shuhet vetëm në qoftë se dhe në masën në të cilën:

a) vendoset se kontrata ndërmjet të tretit dhe porositësit nuk do të ekzekutohet; dhe

b) mosekzekutimi nuk i detyrohet rrethanave që i ngarkohen porositësit.

Agjenti tregtar duhet të rikthejë shpërblimin që ka marrë nëse e drejta për marrjen e tij nuk ekziston më.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 956

Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të shpërblimeve që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i pagueshëm. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elementet thelbësore, në bazë të të cilave është kryer përllogaritja e shpërblimeve.

Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave kontabël, që janë në dispozicion të porositësit, të nevojshme për të verifikuar shumën e shpërblimeve të paguara.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 957

Mbarimi dhe zgjidhja e kontratës së agjencisë

Kontrata e agjencisë me kohë të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të kohës, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Nëse kontrata e agjencisë është me kohë të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati të caktuar.

Afati i njoftimit paraprak nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, 4 muaj për vitin e katërt, 5 muaj për vitin e pestë dhe 6 muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjitha vitet në vazhdim. Nëse palët merren vesh për afate paralajmërimi më të gjata, afati i paralajmërimit që duhet të respektojë pala porositëse nuk duhet të jetë më i shkurtër se afati që duhet të respektojë agjenti. Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të paralajmërimit duhet të përkojë me ditën e fundit të muajit kalendarik. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe për kontratën e agjencisë me kohë të përcaktuar, të shndërruar në kontratë me kohë të papërcaktuar, me kushtin që në llogaritjen e afatit të paralajmërimit duhet të mbahet parasysh afati i mëparshëm.

Në mbarim të kontratës së agjencisë, porositësi detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe nëse:

a) agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm kontratat me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga kontratat me këta klientë;

b) pagesa e këtij shpërblimi është e drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sidomos shpërblimin që agjenti tregtar humbet dhe që rezultojnë nga veprimet me këta klientë, si dhe nga kufizimi i aktiviteteve të tij profesionale që i detyrohen ekzistencës së një klauzole të moskonkurrencës.

Shuma e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një vlerë të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur nga mesatarja vjetore e shpërblimeve të marra nga agjenti tregtar gjatë pesë viteve të fundit. Nëse kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e periudhës së kontratës. Përfitimi i shpërblimit nuk e përjashton agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti tregtar ka të drejtë për shpërblimin e dëmit që ka pësuar si rezultat i përfundimit të marrëdhënieve me palën porositëse.

Ky dëm rezulton veçanërisht kur mbarimi i kontratës ka ndodhur në kushte:

a) të cilat shmangin agjentin tregtar nga shpërblimi që mund të kishte fituar me përmbushjen në mënyrën e duhur të kontratës, duke i siguruar në të njëjtën kohë porositësit përfitime të konsiderueshme të lidhura me veprimtarinë e agjentit tregtar; dhe/ose

b) të cilat nuk i kanë mundësuar agjentit që të rimbursojë kostot dhe shpenzimet që ka bërë për përmbushjen e kontratës, sipas udhëzimeve të porositësit.

E drejta për shpërblim lind, gjithashtu, edhe kur kontrata e agjencisë përfundon si rezultat i vdekjes së agjentit tregtar dhe mund të kërkohet nga trashëgimtarët e tij. Agjenti tregtar humbet të drejtën për shpërblim nëse, brenda një viti nga mbarimi i kontratës, nuk i komunikon porositësit qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tij.

Neni 958

Nuk paguhet shpërblim kur:

a) pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila justifikon një zgjidhje të menjëhershme të kontratës;

b) agjenti zgjidh kontratën, përveç rastit kur përfundimi justifikohet nga rrethanat që i atribuohen porositësit, ose për shkak të moshës, paaftësisë ose sëmundjes së agjentit tregtar, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;

c) agjenti nuk përmbush personalisht të drejtat dhe detyrimet që ai ka në bazë të kontratës së agjencisë, por ia kalon ato një pale të tretë.

Neni 959

Palët nuk mund të shmangin, para mbarimit të kontratës, zbatimin e neneve 957 dhe 958 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 960

Marrëveshja që parashikon një kufizim të aktiviteteve profesionale të agjentit tregtar pas përfundimit të kontratës quhet klauzolë e moskonkurrencës.

Marrëveshja e moskonkurrencës është e vlefshme kur bëhet me shkrim. Ajo duhet t'i përkasë një zone gjeografike ose grupi të klientëve, të besuar agjentit tregtar, si dhe llojin e kontratave, për të cilat agjenti tregtar kishte përfaqësimin, sipas kontratës së agjencisë.

Klauzola e moskonkurrencës është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 2 vjet nga dita e përfundimit të kontratës.

Neni 961
Marrëveshja e garancisë së nënshkruar nga agjenti

Një marrëveshje, me anë të së cilës agjenti garanton që një klient do të paguajë çmimin e mallrave që përbëjnë objektin e kontratës, të cilën e ka negociuar apo përfunduar ai, është e vlefshme vetëm nëse dhe për aq sa ajo është bërë me shkrim, mbulon vetëm kontratat e specifikuara shprehimisht në marrëveshje dhe është e arsyeshme për sa i përket interesave të palëve, sidomos për sa i përket shumës së shpërblimit që përfiton agjenti. Në çdo rast shuma e vendosur si garanci nuk mund të jetë më e madhe se shpërblimi që agjenti do të përfitonte prej kësaj kontrate.

KREU XIV
KALIMI I PASURISË KREDITORËVE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 962

Kalimi i pasurisë është kontrata me të cilën debitori ngarkon kreditorët e vet ose disa prej tyre për të likuiduar të gjitha ose disa veprimtari të tij për t'i shpërndarë midis tyre fitimet e nxjerra në përmbushje të kredive të tyre.

Neni 963

Kalimi i pasurisë duhet bërë me shkrim, ndryshe është i pavlefshëm.

Në qoftë se midis pasurive të ceduara ka edhe kredi, atëherë zbatohen dispozitat e neneve 502 e 503 të këtij Kodi.

Neni 964

Administrimi i pasurisë së kaluar u takon kreditorëve përkatës. Ata mund të ngrejnë padi për të gjitha çështjet pasurore që lidhen me atë pasuri, përfshirë edhe paditë për mbrojtjen e posedimit.

Neni 965

Debitori nuk mund të disponojë sendet e kaluara kreditorëve.

Kreditorët, kreditë e të cilëve ekzistonin përpara kalimit të pasurisë dhe që nuk kanë ndërhyrë, mund të kërkojnë ekzekutimin mbi gjithë këtë pasuri.

Kreditorëve, që u ka kaluar pasuria, në rast se kalimi ka për objekt vetëm disa veprimtari të debitorit, nuk mund të kërkojnë ekzekutimin për veprimtari të tjera, para shlyerjes së atyre që janë lidhur me kalimin e pasurisë.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 966

Kreditorët që kanë lidhur kontratën ose kanë aderuar në të, duhet të parapaguajnë shpenzimet e nevojshme për likuidimin dhe kanë të drejtë të marrin shumën nga të ardhurat prej likuidimit.

Neni 967

Kreditorët duhet t'i ndajnë midis tyre shumat e nxjerra në përpjesëtim me kreditë përkatëse, përveç rasteve të preferimeve. Mbetja i takon debitorit.

Neni 968

Debitori ka të drejtë të kontrollojë administrimin dhe të marrë një raportim mbi gjendjen financiare në fund të likuidimit, ose në fund të çdo viti po qe se administrimi zgjat më shumë se një vit.

Po qe se është emëruar një likuidues, ai duhet t'ia japë raportimin edhe debitorit.

Neni 969

Debitori shkarkohet ndaj kreditorëve vetëm nga dita kur ata marrin pjesën që u takon nga të ardhurat prej likuidimit dhe vetëm në kufijtë e shumës që kanë marrë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 970

Debitori mund të tërhiqet nga kontrata duke ofruar t'u paguajë detyrimet dhe interesat atyre me të cilët ka kontraktuar ose që janë bashkuar në këtë kontratë. Tërheqja ka efekt nga dita e pagimit.

Debitori detyrohet të paguajë shpenzimet e gjërimit.

Zgjidhja e kontratës

Neni 971

Kontrata mund të zgjidhet po qe se debitori, pasi ka deklaruar se e kalon të gjithë pasurinë e vet, ka fshehur një pjesë të konsiderueshme të saj, ose po që se ka fshehur humbjet apo ka paraqitur humbje që nuk ekzistonin.

Neni 972

Kontrata mund të zgjidhet për shkak mospërmbushjeje sipas rregullave të përgjithshme.

KREU XV
NDËRMJETËSIMI

Përmbajtja
Neni 973

Ndërmjetës është ai që vë në lidhje dy ose më shumë palë për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi.

Shpërblimi
Neni 974

Kur nuk ka marrëveshje, ose kur tarifat profesionale, ose zakonet nuk japin ndonjë përcaktim, madhësia e shpërblimit dhe përpjesëtimi në të cilin ky rëndon mbi secilën nga palët, caktohet nga gjykata.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 975

E drejta e ndërmjetësit për shpërblim lind kur kontrata e ndërmjetësimit i sjell efektet e veta dhe pavarësisht nga ndodhitë e mëvonshme të saj.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet kur kontrata e ndërmjetësimit mund të shpallet e pavlefshme, nga që ndërmjetësi kishte dijeni për arësyen e pavlefshmërisë.

Neni 976

Ndërmjetësi ka të drejtë të paguhet për shpenzimet prej personit për të cilin janë kryer shpenzimet edhe kur marrëveshja nuk është përfunduar, përveç kur është zgjidhur ndryshe me marrëveshje ose nga zakonet.

Neni 977

Në qoftë se marrëveshja është përfunduar me ndërhyrjen e disa ndërmjetësve, secili prej tyre ka të drejtë për një kuotë shpërblimi.

Neni 978

Ndërmjetësi duhet t'u njoftojë palëve rrethanat për të cilat ai ka dijeni e që kanë të bëjnë me vleresimin dhe me sigurinë e marrëveshjes, të cilat mund të ndikojnë në përfundimin e saj.

Ndërmjetësi përgjigjet për vërtetësinë e nënshkrimit në dokumentet dhe për xhirimet e fundit të titujve të transmetuara nëpërmjet tij.

Neni 979

Detyrat e ndërmjetësuesit profesionist në marrëveshje për mallra ose për tituj janë:

1. të ruajë kampionet e mallrave të shitura me anë kampionesh, derisa të ekzistojë mundësia e mosmarrëveshjeve për identitetin e mallit;

2. t'i japë blerësit një listë të nënshkruar të titujve për të cilët është biseduar duke treguar serinë dhe numrin;

3. të shënojë në librin përkatës të dhënat kryesore të kontratës që lidhet me ndërhyrjen e tij dhe t'u japë palëve kopjen e çdo shënimi të tillë të nënshkruar prej tij.

Neni 980

Ndërmjetësi mund të ngarkohet nga njëra prej palëve për ta përfaqësuar në veprimet lidhur me zbatimin e kontratës së lidhur me ndërhyrjen e tij.

Neni 981

Ndërmjetësi, që nuk i tregon njërit kontraktues emrin e kontraktuesit tjetër, përgjigjet për zbatimin e kontratës dhe, kur e ka zbatuar atë, merr të drejtat ndaj kontraktuesit të patreguar.

Në qoftë se, pas lidhjes së kontratës, kontraktuesi i patreguar shfaqet para palës tjetër ose tregohet nga ndërmjetësi, secili nga kontraktuesit mund të ngrejë padi drejtpërdrejt kundër tjetrit, por pa cenuar përgjegjësinë e ndërmjetësit.

KREU XVI
DEPOZITA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 982

Depozita është kontrata me të cilën njëra palë merr nga tjetra një send të luajtshëm me detyrimin për ta ruajtur dhe për ta kthyer në natyrë.

Neni 983

Kontrata e depozitës quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi për ruajtje.

Neni 984

Depozita prezumohet se është me shpërblim, përveç kur nga cilësia profesionale e depozitarit ose nga rrethanat e tjera kuptohet një vullnet i ndryshëm i palëve.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 985

Depozitari duhet të ruajë sendin me kujdes. Ai nuk mund ta përdorë atë vetë dhe as t'ua japë në depozitë të tjerëve, pa pëlqimin e depozituesit. Në qoftë se sendin e përdor pa pëlqimin e depozituesit, depozitari është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e tij deri në shkakun fator.

Po ta kërkojnë rrethanat e ngutshme, depozitari mund të ushtrojë ruajtjen në një mënyrë të ndryshme nga marrëveshja, duke njoftuar depozituesin menjëherë sapo të jetë krijuar mundësia.

Neni 986

Depozitari është i detyruar të kthejë sendin e lënë depozitë në çdo kohë që e kërkon depozituesi edhe sikur të jetë caktuar një afat për kthimin e tij, përveç kur afati është caktuar në interes të depozitarit.

Kthimi i sendit të lënë depozitë bëhet në vendin ku sendi duhej të ruhej, përveç përmbushjes së palëve kthimi bëhet me shpenzimet e depozituesit.

Neni 987

Në qoftë se depozita është pa shpërblim, gjykata mund të ulë masën e shpërblimit të dëmit.

Neni 988

Depozituesi është i detyruar t'i paguajë depozitarit shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit, në qoftë se nuk janë përfshirë në shpërblim.

Neni 989

Kur nuk është caktuar një afat për kthimin e sendit të lënë depozitë, depozitari ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë që të shkarkohet nga detyrimi i tij për ruajtjen e sendit, duke lajmëruar depozituesin që të marrë prapë sendin brenda një afati të mjaftueshëm që i cakton vetë.

Neni 990

Depozituesi është i detyruar të shpërblejë dëmin që i është shkaktuar depozitarit nga të metat e fshehta të sendit, në qoftë se, duke i ditur këto, nuk ia ka njoftuar depozitarit.

Neni 991

Kur depozituesit e një sendi janë më shumë se një dhe ata nuk merren vesh lidhur me kthimin e tij, vendos gjykata.

Kështu veprohet edhe kur një depozitues i vetëm ka lënë disa trashëgimtarë, po qe se sendi nuk është i ndashëm.

Kur depozitëmarrësit janë më shumë se një, depozituesi ka të drejtë të kërkojë kthimin nga personi që mban sendin, i cili duhet të njoftojë menjëherë të tjerët.

Neni 992

Në qoftë se sendi është depozituar edhe në interes të një të treti dhe ky i fundit u ka njoftuar depozituesit dhe depozitëmarrësit pranimin e tij, depozitëmarrësi nuk mund të shkarkohet duke ia kthyer sendin depozituesit, pa miratimin e të tretit.

Neni 993

Depozitëmarrësi është i detyruar të kthejë frytet e sendit të cilat ai i ka vjelë.

Neni 994

Trashëgimtari i depozitëmarrësit që ka tjetërsuar sendin në mirëbesim, duke mos ditur se mbahej në depozitë, detyrohet vetëm të kthejë shpërblimin e marrë.

Në qoftë se ky nuk është paguar ende, depozituesi merr të drejtat e tjetërsuesit.

Neni 995

Depozitëmarrësi duhet t'i kthejë sendin depozituesit ose personit të caktuar për ta marrë, pa qenë nevoja që depozituesi të provojë se është pronar.

Në qoftë se depozitëmarrësi paditet nga një person që rivendikon pronësinë e sendit ose pretendon se ka të drejta mbi të, depozitëmarrësi duhet të denoncojë mosmarrëveshjen tek depozituesi dhe të kërkojë të përjashtohet nga gjykimi duke treguar vetë personin, përndryshe duhet të shpërblejë dëmet. Në këtë rast ai mund të shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, duke e depozituar atë sipas mënyrave të caktuara nga gjykata, me shpenzimet e depozituesit.

Neni 996

Në qoftë se ruajtja e sendit i hiqet depozitarit si rrjedhim i një fakti për të cilin ai nuk është fajtor, ai shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, por duhet t'i njoftojë menjëherë depozitarit faktin për të cilin ka humbur mbajtjen e sendit, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Depozituesi ka të drejtë të marrë atë që, si pasojë e vetë faktit, depozitari ka siguruar dhe merr të drejtat që i takojnë këtij të fundit.

Neni 997

Kreditë që rrjedhin nga depozita në dobi të depozitarit kanë privilegj mbi sendin e dhënë në depozitë. Depozitari mund të mbajë sendin që është në privilegj derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas dispozitave për pengun.

Neni 998

Kur sendi i lënë depozitë nuk është tërhequr në afatin e caktuar në kontratë ose pas lajmërimit që i ka bërë depozitari, ky nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit që ngjan pas kalimit të afatit, përveç kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e tij.

Në rastet e sipërme, depozitari ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që të lejojë shitjen e sendit të lënë në depozitë sipas rregullave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Shumat e nxjerra nga shitja e sendit, pasi të zbriten shumat që ka për të marrë depozitari, i jepen depozituesit ose depozitohen në bankë në emër të tij.

Dispozitë referuese

Neni 999

Në qoftë se depozita ka për objekt një sasi të hollash ose sendesh të tjera të barasndërrueshme, dhe depozitari ka të drejtën t'i përdorë, ky fiton pronësinë dhe detyrohet të kthejë po të njëjtën sasi nga i njëjti lloj dhe me të njëjtën cilësi.

Në raste të tilla zbatohen dispozitat lidhur me huanë, kur nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë depozitën.

A. Depozita në magazinat e përgjithshme

Neni 1000

Magazinat (depot) e përgjithshme që veprojnë si depozitare janë përgjegjëse për ruajtjen e sendeve të depozituara, përveç kur provohet se dëmi ka ardhur nga rasti fator, nga natyra e sendeve ose nga defekte të sendeve ose të ambalazhit.

Depozitari duhet në çdo rast të ushtrojë veprimtaritë e nevojshme për të kufizuar dëmin.

Neni 1001

Magazinat depozitare duhet të ruajnë sendet e depozituara veçmas njëra nga tjetra, gjithashtu duhet t'i pajisin me shenja dalluese që të tregojnë përkatësinë e sendit ndaj depozituesit.

Përveç pëlqimit të shprehur të depozituesit, ata nuk mund të përziejnë midis tyre sende të barasndërrueshme të të njëjtit lloj e cilësi.

Depozituesi ka të drejtë të inspektojë sendet e depozituara dhe të tërheqë kampionet e përdorimit.

Neni 1002

Kur depot e përgjithshme kanë lëshuar një titull përfaqësimi të sendeve të depozituara, depozitari duhet t'ia kthejë sendet vetëm kreditorit që është legjitimuar nga titulli.

Neni 1003

Depot e përgjithshme pasi njoftojnë depozituesin, mund të fillojnë shitjen me çmim më të lartë të sendeve kur, në mbarim të kontratës sendet nuk janë tërhequr, ose depozita nuk është përtërirë, dhe në çdo rast, kur sendet rrezikohen të humbasin ose përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë e vendeve ku janë depozituar.

Të ardhurat nga shitja, pasi zbritet kostoja dhe shpenzimet e mbetura të depozitës, duhet t'i dorëzohen depozituesit pa vonesë.

B. Depozita në hotel

Neni 1004

Hotelierët janë përgjegjës për dëmtimin, shkatërrimin ose humbjen e sendeve që klientët kanë sjellë në hotel.

Konsiderohen të sjella në hotel:

1. sendet që ndodhen gjatë kohës në të cilën klienti strehohet aty;

2. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë, jashtë hotelit, gjatë periudhës së kohës në të cilën klienti ndodhet i strehuar;

3. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë qoftë në hotel, qoftë jashtë tij, për një kohë të arsyeshme, para ose pasi klienti të ketë bujtur.

Përgjegjësia që përmend ky nen kufizohet në vleftën e asaj që është vjedhur, dëmtuar ose humbur deri në ekuivalentin e njëqindfshit të çmimit të qirasë së banimit për një ditë.

Neni 1005

Përgjegjësia e hotelierit është e pakufizuar:

1. kur sendet janë dorëzuar për ruajtje;

2. kur ka refuzuar të marrë në ruajtje sende të cilat kishte detyrë t'i pranonte. Hotelieri ka për detyrë të pranojë letrat me vlerë, paratë dhe sendet me vlerë; ai mund të mos pranojë t'i marrë kur bëhet fjalë për objekte të rrezikshme ose që, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kushtet e administrimit të hotelit, kanë vlerë të rëndësishme ose përmasa shumë të mëdha.

Hotelieri mund të kërkojë që sendi i dorëzuar të jetë i vendosur në një mbështjellje të mbyllur ose të vulosur.

Neni l006

Hotelieri nuk është përgjegjës kur vjedhja, dëmtimi ose humbja vijnë:
1. nga klienti, nga personat që e shoqërojnë, që janë në shërbim të tij, ose që e vizitojnë;
2. nga forca madhore;
3. nga natyra e sendeve.

Neni 1007

Hotelieri është përgjegjës, pa mundur të invokojë kufijtë e parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 1004, kur vjedhja, dëmtimi ose humbja e sendeve të sjella nga klienti në hotel janë shkaktuar për faj të tij, të anëtarëve të familjes së tij ose të ndihmësave të tij.

Neni 1008

Përveç rastit të parashikuar në nenin 985, klienti nuk mund të përdorë dispozitat e mësipërme po qe se, pasi të ketë konstatuar vjedhjen, dëmtimin ose humbjen, denoncon faktin tek hotelieri me një vonesë të pajustifikueshme.

Neni 1009

Janë të pavlefshme marrëveshjet ose deklaratat që synojnë të përjashtojnë ose të kufizojnë paraprakisht përgjegjësinë e hotelierit.

Neni 1010

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për automjetet, për sendet e lëna në to dhe as për kafshët e gjalla.

Neni 1011

Për vlerësimin e përgjegjësisë, ose për të caktuar kufirin e shpërblimit, dispozitat për depozitat në hotel zbatohen edhe ndaj sipërmarrësve të klinikave shëndetësore publike dhe private, institucioneve për shfaqje publike, shtëpive të pushimit, hotel- pensioneve, restoranteve dhe për të gjitha rastet në të cilat, nga vetë veprimtaria e posaçme e zhvilluar nga sipërmarrësi, klienti nuk mund të kujdeset personalisht për ruajtjen e sendeve.

Neni 1012

Kreditë e hotelierit, për shpërblimet e kryera ndaj personave bujtës, kanë privilegj mbi sendet e sjella prej tyre në hotel e nëvartësitë e tij dhe që vazhdojnë të ndodhen aty.

Privilegji ka efekt edhe në dëm të të tretëve, që kanë të drejta mbi vetë këto sende, me kusht që hotelieri të jetë në dijeni për këto të drejta në kohën kur sendet janë sjellë në hotel.

KREU XVII
LLOGARIA RRJEDHËSE

Neni 1013

Llogaria rrjedhëse është një kontratë me të cilën palët detyrohen të regjistrojnë në një llogari kreditimet reciproke, duke e konsideruar të padisponueshme dhe të pakthyeshme deri në mbylljen e llogarisë.

Teprica e llogarisë është e kthyeshme me mbarimin e afatit. Në qoftë se nuk është kërkuar pagimi, teprica konsiderohet e rinovuar për një kohë të pacaktuar.

Neni 1014

Përjashtohen nga llogaria rrjedhëse, kreditë që nuk mund të kompensohen.

Kur kontrata vepron ndërmjet sipërmarrësve, përjashtohen nga llogaria kreditë e huaja për ndërmarrjet përkatëse.

Neni 1015

Mbi gjendjen përfitohet kamata në masën e vendosur në kontratë dhe në mungesë të këtyre nga ligji, por gjithnjë brenda kufijve të caktuara prej tij.

Neni 1016

Për llogarinë rrjedhëse paguhet komisioni si dhe shpenzimet që janë dashur për veprimet që kanë lidhje me derdhjet. Këto të drejta nuk bëjnë pjesë në llogari, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 1017

Përfshirja e një kredie në llogarinë rrjedhëse, nuk përjashton ushtrimin e të drejtës së padisë dhe e të drejtave të tjera, lidhur me aktin nga i cili rrjedh kredia.

Kur akti i mësipërm është i pavlefshëm, ose shpallet si i tillë, ose i zgjidhur, pjesa përkatëse e parave përjashtohet nga llogaria rrjedhëse.

Neni 1018

Kur kredia e përfshirë në llogari është e siguruar me një garanci reale ose personale, klienti ka të drejtë të përdorë këtë garanci për tepricën ekzistuese në favor të tij nga mbyllja e llogarisë e deri në arkëtimin e kredisë së garantuar.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe në qoftë se për kredinë ekziston një bashkëdetyrim solidar.

Neni 1019

Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë, përfshirja në llogarinë rrjedhëse e një kredie ndaj një të treti, prezumohet si e bërë me kushtin që të paguhet. Në rastin kur kredia nuk përmbushet, marrësi ka të drejtën të veprojë për mbledhjen, marrjen e shumës së parave nga llogaria, duke riintegruar atë që ka bërë derdhjen. Mund të merret kjo shumë parash nga llogaria edhe pasi ushtron pa rezultat të drejtat e tij kundrejt debitorit.

Neni 1020

Në rast se kreditori i një klienti ka sekuestruar mbetjen eventuale të llogarisë që i takon debitorit të tij, klienti tjetër nuk mundet, me derdhje të reja të cenojë të drejtat e kreditorit. Nuk konsiderohen si derdhje të reja ato që janë bërë në vartësi nga të drejtat e rrjedhura para sekuestrimit.

Klienti ndaj të cilit është bërë sekuestrimi ose është vënë pengu duhet të njoftojë anën tjetër. Secili prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata.

Neni 1021

Mbyllja e llogarisë me likudimin e tepricës bëhet me mbarimin e afateve të përcaktuara në kontratë dhe në mungesë të tyre, në përfundim të çdo 6/mujori të llogaritur që nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 1022

Kalimi i veprimeve në llogari nga një klient në një tjetër nënkuptohet i pranuar në qoftë se nuk është kundërshtuar në afatin e caktuar prej palëve ose në afatin që mund të konsiderohet i përshtatshëm sipas rrethanave.

Pranimi i veprimit nuk përfshin të drejtën për ta kundërshtuar për gabime shkrimi ose llogaritjeje, për mosveprim ose dublime.

Kundërshtimi duhet të bëhet brenda 6 muajve nga data e kalimit të llogarisë, lidhur me likuidimin e mbylljen, e cila duhet të dërgohet rekomande. Rivendosje në afat nuk lejohet.

Neni 1023

Kur kontrata është lidhur për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata në çdo mbyllje të llogarisë, duke njoftuar të paktën 10 ditë përpara.

Në rastin e një ndalimi të ushtrimit të këtij aktiviteti, të paaftësisë për të vepruar, të paaftësisë paguese ose vdekjes së njërës prej palëve, secila prej tyre, ose trashëgimtarët e tyre, kanë të drejtën të tërhiqen nga kontrata.

Zgjidhja e kontratës ndalon përfshirjen në llogari të shumave të reja, por pagimi i mbetjes nuk mund të kërkohet vetëm pas skadimit të periudhës së përcaktuar në nenin 1021.

KREU XVIII
KONTRATAT BANKARE

A. Depozitat bankare

Neni 1024

Kur depozitohet një shumë parash pranë një banke, kjo fiton pronësinë dhe është e detyruar t'i kthejë në të njëjtën lloj monedhe, me skadimin e afatit të përcaktuar ose me kërkesën e depozituesit, duke patur parasysh periudhën e lajmërimit të përcaktuar nga palët ose nga zakoni bankar.

Neni 1025

Në rast se banka lëshon një librezë depozite kursimi, derdhjet dhe tërheqjet duhet të shënohen në librezë.

Shënimet mbi librezë të firmosura nga nëpunësi i bankës, që është i caktuar për këtë shërbim, përbëjnë provë të plotë midis bankës dhe depozituesit.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje e kundërt.

Neni 1026

Në qoftë se libreza e kursimit është e pagueshme tek prurësi, banka që padashje dhe pa faj të rëndë kryen shërbimin përballë poseduesit, nuk përgjigjet edhe në qoftë se ky nuk është depozituesi.

E njëjta dispozitë zbatohet në rastin kur libreza e depozitës e pagueshme tek prurësi të jetë lëshuar në emër të një personi të caktuar.

Janë të përjashtuara dispozitat e ligjeve të veçanta.

Neni 1027

Banka që merr dhe pranon depozitat e titujve në administrim duhet t'i ruajë titujt duke marrë interesat ose dividentet, të verifikojë tregtimin për çmimin ose për ripagimin e kapitalit, duke treguar kujdes për grumbullimin e të ardhurave për llogarinë e depozituesit, dhe në përgjithësi të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave që kanë të bëjnë me titullin. Shumat e grumbulluara duhet të jenë të kredituara në llogarinë e depozituesit.

Në qoftë se për titujt e depozituar duhet të ushtrohet një e drejtë zgjedhjeje, banka duhet të kërkojë në kohë udhëzimet e nevojshme nga depozituesit dhe t'i realizojë ato, në qoftë se në rast nevoje ka marrë fonde të nevojshme. Në mungesë të këtyre udhëzimeve, të drejtat e zgjedhjeve duhet të shiten për llogari të depozituesit nëpërmjet agjentëve të këmbimit.

Bankës i takon një kompensim në masën e përcaktuar nga marrëveshja e palëve ose ajo që përdoret zakonisht, përveç pagimit të shpenzimeve të bëra prej saj.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën përjashtohet banka nga ruajtja dhe administrimi i titujve me një kujdesje të zakonshme.

B. Shërbimi bankar dhe kasetat e sigurimit

Neni 1028

Banka, për shërbimin e kasetave të sigurimit, përgjigjet kundrejt përdoruesit për aftësinë paguese, ruajtjen e lokalit dhe për paprekshmërinë e kasetës, përveç ndonjë rasti fator.

Neni 1029

Kur kaseta është në emër të disa personave, hapja e saj i njihet secilit prej tyre, përveç ndonjë marrëveshjeje të kundërt.

Në rast vdekje të mbajtësit të vetëm ose të njërit të këtyre mbajtësve, banka që ka marrë njoftimin mund të lejojë hapjen e kasetës me marrëveshjen e të gjithë atyre që e kanë të drejtë, ose sipas mënyrës së përcaktuar nga gjykata.

Neni 1030

Kur afati i kontratës ka mbaruar, banka mbas një lajmërimi të mbajtësit ose me kalimin e gjashtë muajve nga data e mbarimit, mund t'i kërkojë gjykatës autorizimin për hapjen e kasetës. Lajmërimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës rekomande të konfirmuar.

Hapja kryhet në praninë e një noteri duke patur parasysh edhe masat që gjykata i quan të nevojshme. Gjykata mund të urdhërojë marrjen e masave të nevojshme për ruajtjen e objekteve të gjetura duke përfshirë edhe shitjen e një pjese të tyre, që është e nevojshme për të plotësuar shpenzimet e bëra nga banka.

C. Hapja (çelja) e kredisë bankare

Përkufizimi
Neni 1031

Hapja e kredisë bankare është një kontratë me të cilën banka detyrohet të mbajë në dispozicion të palës tjetër një shumë parash, për një periudhë të caktuar kohe ose për një kohë të pacaktuar.

Neni 1032

Përveç kur ka marrëveshje tjetër, në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe, kredimarrësi mund ta përdorë disa herë kredinë, sipas formave të përdorimit, dhe mundet që me derdhjet e mëtejshme të rivendosë disponibilitetin e tij.

Derdhjet dhe tërheqjet realizohen pranë bankës ku ka lindur kjo marrëdhënie, përveç kur është parashikuar ndryshe nga palët.

Neni 1033

Në qoftë se për hapjen e kredisë është dhënë një garanci reale ose personale, kjo nuk shuhet për faktin se kredimarrësi, në momentin e mbarimit të kësaj marrëdhënieje, pushon së qëni debitor i bankës. Kur garancia bëhet e pamjaftueshme, banka mund të kërkojë një garanci suplementare ose zëvendësimin e garantit.

Kur kredimarrësi nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka pakëson kredinë në mënyrë proporcionale me pakësimin e vlerës së garancisë ose mund të heqë dorë nga kontrata.

Neni 1034

Banka nuk mund të tërhiqet nga kontrata përpara mbarimit të afatit të kontratës, përveç rasteve të arsyeshme, ose kur ka marrëveshje tjetër. Heqja dorë ndërpret menjëherë përdorimin e kredisë, por banka duhet të caktojë një afat të paktën prej pesëmbëdhjetë ditësh për kthimin e shumave të përdorura dhe ato plotësuese.

Kur dhënia e kredisë është në një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata nëpërmjet lajmërimit në afatin e caktuar në kontratë, që përdoret zakonisht ose, në mungesë të tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Ç. Paradhënia bankare

Disponim i sendeve të dhëna peng
Neni 1035

Në paradhënien bankare me pengun mbi titujt ose mbi mallrat, banka nuk mund të disponojë mbi sendet për të cilat është vënë pengu, në qoftë se ka lëshuar një dokument në të cilin këto sende janë individualizuar.

Marrëveshja e kundërt duhet të provohet me shkresë.

Neni 1036

Banka duhet të kujdeset për llogari të kontraktuesit për sigurimin e mallrave të lëna peng nëqoftëse, për nga vetë natyra, vlera dhe vendndodhja e tyre sigurimi i përgjigjet përkujdesjeve të zakonshme.

Neni 1037

Banka, përveç detyrimeve që i takojnë, ka të drejtën që t'i paguhen shpenzimet që ka bërë për ruajtjen e mallrave dhe të titujve, përveç kur e ka marrë përsipër një gjë të tillë.

Neni 1038

Kontraktuesi, edhe përpara mbarimit të afatit të kontratës, mund të tërheqë titujt ose mallrat e lëna peng, duke bërë më parë një pagesë proporcionale ndërmjet shumave të marra paradhënie dhe të shumave të tjera që i përkasin bankës sipas nenit të mësipërm, në qoftë se teprica e kredisë rezulton e pagarantuar në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 1039

Në qoftë se vlera e garancisë pakësohet të paktën në një të dhjetën në krahasim me vlerën e saj në kohën e lidhjes së kontratës, banka mund t'i kërkojë debitorit një garanci plotësuese, me paralajmërimin se në mungesë të saj do të veprohet për shitjen e këtyre mallrave ose titujve të dhëna peng. Në qoftë se debitori nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka mund të veprojë për shitjen e tyre në bazë të dispozitave për pengun.

Banka ka të drejtën e pagimit të menjëhershëm të tepricës të llogarisë që nuk është përmbushur plotësisht nga shumat e rezultuara nga shitja

Neni 1040

Në qoftë se me garancitë e një ose më shumë kredive janë bllokuar depozita në para, mallra ose tituj që nuk kanë qenë të individualizuar ose për të cilat i është lënë bankës mundësia për t'i disponuar, banka duhet të kthejë vetëm shumën ose një pjesë të mallrave ose të titujve që tejkalojnë shumën e kredive të garantuara. Ky tejkalim përcaktohet në lidhje me vlerën e mallrave ose të titujve në kohën e mbarimit të kredive.

D. Veprimet bankare me llogari rrjedhëse

Neni 1041

Kur depozita, çelja e kredisë ose veprimet e tjera bankare janë rregulluar në llogarinë rrjedhëse, klienti mund të disponojë në çdo kohë shumat që rezultojnë në kredinë e tij, përveç kur rezerva e afatit, është parashikuar në marrëveshje.

Neni 1042

Në rast se midis bankës dhe klientit ekzistojnë disa marrëdhënie ose disa llogari, edhe në monedha të ndryshme, teprica aktive dhe pasive kompensohen në mënyrë reciproke, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1043

Në rastin kur llogaria likujduese është në emër të disa personave, me të drejtën për të kryer veprime edhe në mënyrë individuale, këta persona quhen kreditorë ose debitorë solidarë të tepricave të llogarisë.

Neni 1044

Në rast se veprimet në llogarinë rrjedhëse janë për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata, duke lajmëruar palën tjetër brenda afatit të caktuar në kontratë ose në mungesë të tij, brenda 15 ditëve.

Neni 1045

Banka përgjigjet sipas dispozitave që rregullojnë kontratën e porosisë për ekzekutimin e detyrimeve të marra nga depozituesi ose nga një klient tjetër.

Në qoftë se ky detyrim duhet të kryhet aty ku nuk ekzistojnë degë të bankës, kjo mund të ngarkojë për ekzekutim një bankë tjetër.

Neni 1046

Për llogarinë rrjedhëse zbatohen edhe nenet 1016,1019,1022.

E. Skontoja bankare

Përkufizimi

Neni 1047

Skontoja është kontrata me anë të së cilës banka, duke zbatuar kamatën i jep klientit vleftën e një kredie ndaj të tretëve, që nuk ka mbaruar akoma, nëpërmjet cedimit.

Skontoja e kambialeve

Neni 1048

Në qoftë se skontoja bëhet nëpërmjet xhirimit të kambialit ose të çekut bankar, banka në rast se nuk kryhet pagimi, përveç të drejtave të rrjedhura nga titulli, gëzon edhe të drejtën e kthimit të paradhënies.

Ruhen dispozitat e ligjeve të veçanta lidhur me çekun dhe kambialin.

Neni 1049

Banka që ka skontuar kambialet e dokumentuara, gëzon mbi mallin të njëjtin privilegj qe ka edhe i porosituri, deri sa titulli përfaqësues është në posedimin e tij.

KREU XIX
HUAJA

Neni 1050

Me kontratën e huasë njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit.

Neni 1051

Përveç kur me marrëveshje të palëve është parashkuar ndryshe, huamarrësi duhet t'i paguajë huadhënësit kamatat.

Kamatat, për të cilat është rënë dakord, paguhen çdo vit, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe.

Mospagimi i kamatave përbën mospërmbushje thelbësore të detyrimit.

Neni 1052

Në rast se palët janë marrë vesh për kthimin me këste të parave ose të sendeve dhe huamarrësi nuk përmbush detyrimin e pagimit të dy kësteve ose nuk përmbush, me një vonesë prej më shumë se tre muaj, pagimin e vetëm një kësti, huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të parave ose të sendeve të dhënë hua.

Neni 1053

Kur kthimi i sendeve të dhëna hua është bërë i pamundur ose tepër i vështirë pa fajin e debitorit, ky është i detyruar të paguajë vleftën e tyre, duke marrë parasysh kohën dhe vendin në të cilën do të bëhej kthimi.

Neni 1054

Huadhënësi është përgjegjës për dëmin që i ka shkaktuar huamarrësit, për të metat e sendeve të dhëna hua, në qoftë se nuk provon se nuk ishte faji i tij që nuk kishte dijeni për ato.

Në qoftë se huaja është pa shpërblim, huamarrësi është përgjegjës vetëm në rastin kur, duke i ditur cenet, nuk e ka njoftuar huadhënësin për to.

Neni 1055

Kush ka premtuar të japë hua, mund të refuzojë të përmbushë detyrimin, po qe se kushtet pasurore të palës tjetër janë në gjëndje të tillë sa e bëjnë tepër të vështirë kthimin dhe huadhënësit nuk i janë ofruar garanci të përshtatshme.

KREU XX
FRANCHISING

Përkufizimi

Neni 1056

Kontrata franchising përmban një raport detyrimesh të vazhdueshme me të cilin ndërmarrje të pavarura detyrohen ndërmjet njëra-tjetrës që të nxisin e të zhvillojnë bashkërisht tregtinë dhe kryerjen e shërbimeve, në zbatim të detyrimeve të veçanta.

Detyrimet e franchisor-it

Neni 1057

Franchisor-i (franshizdhënësi) ka detyrimin të vërë në dispozicion të franchizee-së (franshizmarrësit) një tërësi të standardizuar të drejtash jo materiale, modelesh, skicash, idesh fitimi, tregtimi dhe organizimi e njohuri të tjera të përshtatshme për zhvillimin e tregtisë.

Ndërkaq ai është i detyruar të ruajë gjithë këtë program detyrimesh nga cenimi prej të tretëve, ta zhvillojë atë vazhdimisht dhe të mbështesë zbatimin e tij nga franshizmarrësi me udhëzime, informacione e perfeksionime.

Marrëdhëniet parakontraktore
Neni 1058

Në bisedimet për përfundimin e kontratës palët duhet t'i tregojnë njëra-tjetrës gjendjen e punëve tregtare që kanë të bëjnë me kontratën franchise dhe veçanërisht programin e detyrimeve franchise, si dhe të informojnë njëri-tjetrin sipas parimeve të mirëbesimit. Ata janë të detyruar të ruajnë sekretin e informatave konfidenciale, edhe po të mos përfundohet kontrata.

Kush shkel këtë detyrim, detyrohet të shpërblejë dëmin. Kjo e drejtë parashkruhet me kalimin e tre vjetëve nga dita e pushimit të bisedimeve.

Pala që ka marrë pjesë në bisedime mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve të bëra me besim të ligjshëm në përfundimin e kontratës, e cila nuk u përfundua për shkak të një sjelljeje të qëllimshme të palës tjetër.

Forma e kontratës
Neni 1059

Kontrata franchising duhet të bëhet me shkresë duke përcaktuar ndër të tjera një përkufizim të njëzëshëm të detyrimeve të ndërsjella të palëve, kohëzgjatjen e kontratës dhe të elementeve të tjera thelbësore të saj. Teksti i kontratës duhet të përmbajë një përshkrim të plotë të programit e të detyrimeve franchising.

Heqja dorë nga kontrata
Neni 1060

Kohëzgjatja e kontratës vendoset me marrëveshje të palëve, duke respektuar kërkesat e diktuara nga tregtia dhe shërbimet përkatëse.

Kur në kontratë nuk është përcaktuar afat, ose afati është më tepër se dhjetë vjet, secila palë ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar palën tjetër një vit më parë.

Në rast pushimi të kontratës si rrjedhim i plotësimit të afatit ose heqjes dorë prej saj dhe përpara paraqitjes aktuale të raportit të punëve, palët, të udhëhequra nga parimet e mirëbesimit, bëjnë një përpjekje për të rënë dakord për ripërtëritjen e kontratës në kushte të njëjta ose të ndryshuara.

Ndalimi i konkurrencës
Neni 1061

Edhe pas pushimit të marrëdhënieve kontraktore palët kanë reciprokisht detyrimin për një konkurencë të ndershme.

Mbi këtë bazë, franchismarrësit mund t'i imponohet një ndalim i konkurencës lokale për një kohë deri në një vit.

Në qoftë se nga ndalimi i konkurrencës rezulton një pakësim i veprimtarisë së tij profesionale, franchismarrësit i jepet një kompensim financiar i barasvlershëm, pa marrë parasysh pushimin e kontratës.

Përgjegjësia e franchismarrësit
Neni 1062

Franchisdhënësi përgjigjet për qenien e të drejtave dhe të njohurive të programit të detyrimeve franchise. Në rast se të drejtat nuk do të ekzistonin ose në qoftë se franchisdhënësi do të shkelte të tjera detyrime kontraktore me mënyrë të fajshme, franchismarrësi ka të drejtë të pakësojë shpërblimin. Shuma e pakësuar duhet të vendoset me kompetencë me anën e një eksperti të paanshëm. Franchismarrësi mund të kërkojë shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga mosqënia e elementeve të programit të detyrimeve ose nga shkelja me faj e kontratës nga ana e franchisdhënësit.

Neni 1063

Franchisdhënësi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelja me faj e kontratës, në veçanti nga zbatimi i pamjaftueshëm i programit të detyrimeve franchise, nga ana e franchismarrësit.

Heqja dorë
Neni 1064

Në rast shkelje detyrimesh kontraktore që vënë seriozisht në rrezik qëllimin për zhvillimin e tregtisë, pala kontraktuese ka të drejtën të heqë dorë nga kontrata, pa iu referuar afatit.

KREU XXI
KONTRATA E RENTËS JETORE

Neni 1065

Renta jetore mund të krijohet kundrejt shpërblimit (me titull barrësor) nëpërmjet tjetërsimit të një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose të një shume parash.

Renta jetore mund të krijohet edhe me anë dhurimi ose me testament, duke respektuar kërkesat e ligjit për veprime juridike të tilla.

Neni 1066

Renta jetore mund të jepet për të gjithë jetën e përfituesit ose të një personi tjetër. Ajo mund të formohet edhe për gjithë jetën e një ose disa personave.

Neni 1067

Kur renta është formuar në favor të shumë personave, pjesa e një përfituesi të vdekur më parë, rritet në favor të të tjerëve, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1068

Kontrata e rentës jetore e krijuar në favorin e një personi, i cili në kohën e kontratës kishte vdekur, është e pavlefshme.

Efektet e kontratës së rentës jetore

Neni 1069

Personi në dobi të të cilit është krijuar renta jetore, me titull barrësor, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se personi që jep rentën nuk jep garancitë ose ul garancitë e dhëna në marrëveshje.

Neni 1070

Mospagimi i kësteve të arrira të rentës jetore nuk i jep të drejtën personit, në favor të të cilit është krijuar renta, që të kërkojë zgjidhjen e kontratës; por vetëm mund të kërkojë që të sekuestrohen e të shiten pasuritë e debitorit të tij dhe nga të ardhurat e shitjes të përdoret një shumë e mjaftueshme për të siguruar pagimin e rentës.

Neni 1071

Debitori i rentës nuk mund të shkarkohet nga detyrimi për pagimin e saj edhe sikur të ofrojë pagimin e shumës së parave ose të gjësë së marrë, qoftë dhe duke hequr dorë nga pagimi i kësteve të shlyera.

I sipërmi është i detyruar të paguajë rentën për të gjithë kohën që është krijuar, sado i rëndë që të jetë bërë detyrimi i rentës, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1072

Renta jetore i jepet personit, në favor të të cilit është krijuar, në proporcion me numrin e ditëve që ka jetuar. Në rast se në marrëveshje është parashikuar që të parapaguhet me këste, secili prej tyre fitohet nga dita që plotësohet afati i pagimit.

Neni 1073

Në rast se renta jetore është krijuar mbi bazën e një titulli pa shpërblim, mund të parashikohet (ose të vendoset) që kjo të jetë e pasekuestrueshme.

KREU XXII
SHOQËRIA E THJESHTË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1074

Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime.

Neni 1075

Në shoqërinë e thjeshtë kontrata nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, përveç kur kërkohet nga natyra e sendeve të bashkuara.

Shoqëria është e thjeshtë, kur nuk paraqet cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare të rregulluara në Kodin Tregtar.

Marrëdhëniet midis anëtarëve

Neni 1076

Anëtari është i detyruar të paguajë kontributet e caktuara në kontratën e shoqërisë. Prezumohet se anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë, në pjesë të barabarta midis tyre, sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1077

Kontrata e shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të gjithë ortakëve, në qoftë se në marrëveshje nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 1078

Për sendet e dhëna në pronësi, garancia e kërkuar nga anëtari dhe kalimi i rreziqeve rregullohen nga dispozitat mbi shitjen.

Neni 1079

Anëtari që ka kontribuar në kredi, përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, brenda caqeve të treguara në nenin 506 të këtij Kodi për rastin e marrjes me marrëveshje të garancisë.

Neni 1080

Përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, administrimi i shoqërisë i takon secilit prej anëtarëve veçmas nga të tjerët.

Po qe se administrimi u takon veçmas disa anëtarëve, secili prej tyre ka të drejtë të kundërshtojë veprimin që dëshiron të kryejë një tjetër, përpara se ky të kryhet.

Shumica e anëtarëve, e përcaktuar sipas pjesës së çdo anëtari në fitim, zgjidh mosmarrëveshjen.

Neni 1081

Në qoftë se administrimi u takon në mënyrë të përbashkët disa anëtarëve, është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë ortakëve administratorë për kryerjen e veprimeve të shoqërisë.

Në qoftë se është vendosur që për administrimin ose për veprime të caktuara të jetë i nevojshëm miratimi i shumicës, kjo përcaktohet sipas paragrafit të fundit të nenit 1080 të këtij Kodi.

Në rastet e parashikuara në këtë nen, administratorët e veçantë nuk mund të kryejnë të vetëm ndonjë veprim, veç në raste të ngutshme, kur duhet shmangur një dëm që i kanoset shoqërisë.

Neni 1082

Heqja e administratorit të emëruar në kontratën e shoqërisë mund të bëhet për një shkak të drejtë.

Administratori i emëruar me një akt të veçantë mund të hiqet sipas dispozitave të kontratës së porosisë. Në një rast të tillë heqja e tij mund të kërkohet edhe në rrugë gjyqësore nga çdo anëtar.

Neni 1083

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve rregullohen me dispozitat mbi porosinë. Administratorët janë përgjegjës solidarisht ndaj shoqërisë për përmbushjen e detyrimeve që u janë ngarkuar me ligj ose nga kontrata e shoqërisë, përveç kur provojnë se nuk kanë faj.

Neni 1084

Anëtarët që nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë që të marrin njoftim nga administratorët për ecurinë e punëve të shoqërisë, të konsultohen me dokumentet që lidhen me administrimin dhe të marrin një raport kur të jenë kryer punët për të cilat është krijuar shoqëria.

Në qoftë se kryerja e punëve të shoqërisë zgjat më shumë se një vit, anëtarët kanë të drejtë të marrin raportin e administratës në fund të çdo viti, përveç rastit kur kontrata parashikon një afat tjetër.

Neni 1085

Përveç marrëveshjes së kundërt, çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të fitimeve pas miratimit të raportit.

Neni 1086

Pjesët që u takojnë anëtarëve në fitimet ose në humbjet prezumohen në përpjesëtim me kuotat e kontribuara. Në qoftë se vlera e kontributeve nuk përcaktohet nga kontrata, caktohet nga gjykata. Në qoftë se kontrata përcakton vetëm pjesën e çdo anëtari në fitimet, në të njëjtën masë prezumohet se duhet të përcaktohet edhe pjesëmarrja në humbjet.

Neni 1087

Çdo marrëveshje që përjashton një ose më shumë anëtarë nga pjesëmarrja në fitimet ose humbjet, është e pavlefshme.

Marrëdhënie me të tretët

Neni 1088

Shoqëria fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime me anë të anëtarëve që kanë të drejtën për ta përfaqësuar.

Në mungesë të dispozitave të tjera në kontratë, përfaqësimi i takon çdo anëtari administrator dhe shtrihet për të gjitha aktet që përfshihen në objektin e shoqërisë. Ndryshimet dhe shuarja e tagrave të përfaqësimit rregullohen me dispozitat për përfaqësimin.

Neni 1089

Kreditorët e shoqërisë mund të kërkojnë të drejtat e tyre mbi pasurinë e shoqërisë. Për detyrimet e shoqërisë gjithashtu përgjigjen personalisht ose solidarisht anëtarët që kanë vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe, po të ketë marrëveshje tjetër, edhe anëtarët e tjerë.

Marrëveshja duhet t'u bëhet e ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, në mungesë të marrjes dijeni, kufizimi i përgjegjësisë ose përjashtimi nga përgjegjësia solidare nuk mund t'u kundrejtohet atyre që nuk kanë patur dijeni për të.

Neni 1090

Anëtari, të cilit i kërkohet pagimi i detyrimeve të shoqërisë, mund të kërkojë, edhe kur shoqëria është në likuidim, ekzekutimin paraprak ndaj pasurisë së shoqërisë, duke treguar sendet mbi të cilat kreditori mund të shpërblehet më së miri.

Neni 1091

Ai që bëhet anëtar në një shoqëri të krijuar më parë, përgjigjet së bashku me anëtarët e tjerë për detyrimet e shoqërisë përpara se ta ketë fituar cilësinë e anëtarit.

Neni 1092

Kreditori i veçantë i anëtarit, deri sa zgjat shoqëria, mund të kërkojë të drejtat e tij mbi fitimet që i takojnë debitorit, si dhe marrjen e masave ruajtëse (konservative) mbi kuotën që i takon këtij të fundit në likuidim.

Në qoftë se sende të tjera të debitorit janë të pamjaftueshme për të shpërblyer kreditë e tij, kreditori i veçantë i anëtarit mund të kërkojë, veç kësaj, në çdo kohë likuidimin e kuotës së debitorit të tij. Kuota duhet të likuidohet brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, përveç kur është vendosur shpërndarja e shoqërisë.

Neni 1093

Nuk pranohet kompensimi midis detyrimit që një i tretë ka ndaj shoqërisë dhe kredisë që ky ka ndaj një anëtari.

Shpërndarja e shoqërisë

Neni 1094

Shoqëria shpërndahet:
1. me mbarimin e afatit;
2. me realizimin e objektit të shoqërisë ose për pamundësinë e realizimit të tij;
3. me vullnetin e të gjithë anëtarëve;
4. për shkaqe të tjera të parashikuara në kontratën e shoqërisë.

Neni 1095

Kontrata e shoqërisë zgjatet në heshtje për një kohë të pacaktuar kur, sadoqë ka kaluar afati i parashikuar në kontratë, anëtarët vazhdojnë të kryejnë veprime të shoqërisë.

Neni 1096

Pas shpërndarjes së shoqërisë anëtarët administrues ruajnë pushtetin e administrimit vetëm për çështjet e ngutshme, derisa të ndërmerren veprimet e nevojshme për likuidimin.

Neni 1097

Në qoftë se kontrata nuk parashikon mënyrën e likuidimit të pasurisë dhe anëtarët nuk janë në një mendje për ta përcaktuar atë, likuidimi bëhet nga një ose disa likuidues, të emëruar me pëlqimin e të gjithë ortakëve ose, në rast mosmarrëveshjeje, nga gjykata.

Likuiduesit mund të revokohen me vullnetin e të gjithë ortakëve dhe në çdo rast nga gjykata me kërkesën e arsyetuar të njërit ose të disa anëtarëve.

Neni 1098

Detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesve rregullohen sipas rregullave të vendosura nga administratorët, përderisa nuk parashikohet ndryshe nga dispozitat e mëposhtme ose nga kontrata e shoqërisë.

Neni 1099

Administratorët duhet t'u dorëzojnë likuiduesve sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe t'u paraqesin atyre llogarinë e administrimit për periudhën pas raportimit të fundit.

Likuiduesit duhet të marrin në dorëzim sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe të hartojnë, së bashku me administratorët, inventarin nga ku të rezultojë gjendja aktive dhe pasive e pasurisë së shoqërisë. Inventari duhet të nënshkruhet nga administratorët dhe nga likuiduesit.

Neni 1100

Likuiduesit mund të kryejnë aktet e nevojshme për likuidim dhe, po qe se anëtarët nuk kanë parashikuar ndryshe, mund të shesin edhe në bllok pasurinë e shoqërisë dhe të bëjnë marrëveshje e kompromise.

Ata përfaqësojnë shoqërinë edhe në gjykim.

Neni 1101

Likuiduesit nuk mund të ndërmarrin veprime të reja. Në rast të kundërt ata përgjigjen personalisht dhe solidarisht për punët e filluara.

Neni 1102

Likuiduesit nuk mund të ndajnë midis anëtarëve, qoftë edhe pjesërisht, pasurinë e shoqërisë, derisa të mos jenë paguar kreditorët e shoqërisë, ose të mos jenë vënë mënjanë shumat e nevojshme për të paguar ata.

Në qoftë se fondet në dispozicion janë të pamjaftueshme për pagimin e detyrimeve të shoqërisë, likuiduesit mund t'u kërkojnë anëtarëve derdhjet për të cilat ata ende detyrohen në kuotat përkatëse dhe, po të jetë nevoja, shumat e nevojshme në kufijtë e përgjegjësisë përkatëse dhe në përpjesëtim me pjesën e secilit në humbjet. Në të njëjtin përpjesëtim pjesëtohet midis anëtarëve detyrimi i anëtarit me paaftësi për të paguar.

Neni 1103

Anëtarët që kanë kontribuar me pasuri për t'u përdorur, kanë të drejtë ta marrin atë përsëri në gjendjen në të cilën ndodhet. Po qe se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar për shkaqe që mund t'u ngarkohen administratorëve, anëtarët kanë të drejtë për shpërblimin e dëmit në ngarkim të pasurisë së shoqërisë, përveç rastit kur mund të ngrihet padi kundër administratorëve.

Neni 1104

Pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, aktivi i mbetur destinohet për pagimin e kuotave të kontributeve. Teprica e mundshme ndahet midis anëtarëve në përpjesëtim me pjesën e secilit në fitim.

Vlefta e kuotave të kontributeve që nuk kanë për objekt shuma parash, përcaktohet sipas vlerësimit që është bërë në kontratë ose, në mungesë të tij, sipas vleftës që ata kanë patur në momentin kur janë dhënë.

Neni 1105

Në qoftë se në marrëveshje është parashkuar që ndarja e sendeve të bëhet në natyrë, zbatohen dispozitat mbi ndarjen e sendeve të përbashkëta.

Zgjidhja e marrëdhënies së një anëtari me shoqërinë

Neni 1106

Çdo anëtar mund të tërhiqet nga shoqëria kur ajo është formuar për një kohë të pacaktuar ose për gjithë jetën e njërit prej anëtarëve.

Veç kësaj mund të tërhiqet në rastet e parashikuara në kontratën e shoqërisë ose kur ekziston një shkak i drejtë.

Në rastet e parashikuara në paragrafin e parë, tërheqja duhet t'u komunikohet anëtarëve të tjerë të paktën tre muaj përpara.

Neni 1107

Përveç kur në kontratën e shoqërisë është parashikuar ndryshe, në rast vdekjeje të njërit prej anëtarëve, të tjerët duhet të likuidojnë kuotën në favor të trashëgimtarëve, veç kur preferojnë të shpërndajnë shoqërinë ose ta vazhdojnë më vete trashëgimtarët, dhe këta japin pëlqimin.

Neni 1108

Përjashtimi i një anëtari mund të ndodhë për shkak mospërmbushjeje të rëndësishme të detyrimeve që rrjedhin nga ligji ose nga kontrata e shoqërisë, si dhe për ndalimin, pazotësinë ose për dënimin e tij me një masë që përfshin edhe ndalimin, qoftë edhe të përkohshëm, nga detyrat zyrtare.

Anëtari që ka dhënë si kontribut në shoqëri veprën e vet ose gëzimin e një sendi, mundet gjithashtu të përjashtohet për shkak të papërshtatshmërisë së menjëhershme për të kryer veprën e dhënë ose për humbjen e sendit, që ka ndodhur për shkaqe që nuk mund t'u ngarkohen administratorëve.

Gjithashtu, mund të përjashtohet anëtari që ka kontribuar me anë të transferimit të pronësisë së një sendi, në qoftë se ky humbet përpara se sendi të fitohet nga shoqëria.

Neni 1109

Përjashtimi vendoset nga shumica e anëtarëve, duke mos përfshirë në numrin e tyre anëtarin për t'u përjashtuar dhe ka efekt pas 30 ditëve nga data kur i është bërë njoftimi anëtarit të përjashtuar.

Brenda këtij afati ortaku i përjashtuar mund të paraqesë kundërshtim përpara gjykatës, e cila mund të pezullojë zbatimin e vendimit.

Po qe se shoqëria përbëhet nga dy anëtarë, përjashtimi i njërit bëhet nga gjykata me kërkesën e tjetrit.

Neni 1110

Përjashtohen nga shoqëria edhe:

a) anëtari që është deklaruar i falimentuar;

b) anëtari ndaj të cilit një kreditor i tij i caktuar ka arritur të ketë të drejtën e likuidimit të kuotës sipas nenit 1092 të këtij Kodi.

Përjashtimi i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni nuk zbatohet në rastet kur falimentimi i anëtarit është pasojë e falimentimit të shoqërisë.

Neni 1111

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky dhe trashëgimtarët e tij kanë të drejtë vetëm për një shumë të hollash që përfaqësojnë vlerën e kuotës.

Likuidimi i kuotës bëhet në bazë të gjendjes pasurore të shoqërisë ditën kur ndodh largimi i anëtarit.

Në qoftë se ka aktivitete në vazhdim, anëtari dhe trashëgimtarët e tij kanë pjesë në fitimet dhe humbjet që kanë të bëjnë me këto aktivitete. Përveç sa parashikohet në nenin 1092, pagimi kuotës që i takon ortakut duhet bërë brenda 6 muajve nga dita e largimit të tij.

Neni 1112

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky ose trashëgimtarët e tij janë përgjegjës ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë deri në ditën kur ai është larguar.

Largimi duhet t'u bëhet i ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, përndryshe, ajo nuk mund t'u kundrejtohet të tretëve që, jo për fajin e tyre, nuk e kanë ditur.

KREU XXIII
SIGURIMI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1113

Me kontratën e sigurimit, njëra palë (siguruesi), në qoftë se vërtetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet:

a) në rastin e sigurimit të pasurisë t'i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë;

b) në rastin e sigurimit të personit t'i paguajë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, shumën e sigurimit që është parashikuar në kontratë.

I siguruari detyrohet të paguajë primin (çmimin e sigurimit) të caktuar në kontratë.

Siguruesi mund të jetë person publik ose privat.

Neni 1114

Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që siguruesi i lëshon të siguruarit, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 1115

Në dëshminë e sigurimit të tregohen sidomos:

a) emri i siguruesit;

b) emri i personit të siguruar, në rastin e sigurimit të personit, pasuria e siguruar dhe vendi ku ndodhet kjo pasuri në rastin e sigurimit të pasurisë;

c) ngjarja me vërtetimin e së cilës siguruesi të përmbushë detyrimin që ka marrë në kontratë;

ç) fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit (afati i sigurimit);

d) koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguruesit;

e) vlerësimi i pasurisë në ato raste që kjo gjë kërkohet për një lloj të caktuar sigurimi;

ë) primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre.

Kur sipas ligjit ose sipas kontratës shpërblimi i sigurimit ose shumat e sigurimit duhet t'i paguhen jo vetëm të siguruarit, por edhe një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata. Ky kusht duhet të tregohet në dëshminë e sigurimit.

Neni 1116

Kur humbet dëshmia e sigurimit, siguruesi, me kërkesën dhe shpenzimet e të siguruarit, duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

Neni 1117

I siguruari duhet t'i njoftojë siguruesit, me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut.

Quhet se kanë rëndësi thelbësore të gjitha rrethanat për të cilat siguruesi ka pyetur me shkresë të siguruarin.

Kontrata e sigurimit e lidhur pa u marrë përgjigja në ndonjë nga këto pyetje, nuk mund të jetë, për këtë shkak, e pavlefshme.

Neni 1118

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i siguruari duke ditur ka dhënë informata jo të sakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura prej tij dhe në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, siguruesi brenda tre muajve nga marrja dijeni ka të drejtë:

a) të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit;

b) të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla, që po t'i dinte siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën. Në këtë rast, primet e sigurimit deri në kohën që kërkohet prishja e kontratës, e në çdo rast primi i sigurimit për t'u paguar në vitin e parë të kontratës, nuk i kthehen të siguruarit.

Në qoftë se vërtetohet ngjarja e sigurimit përpara se të fillojë afati i treguar në paragrafin e mësipërm, siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shumën e sigurimit.

Kur kontrata e sigurimit është lidhur për më shumë se një person ose sende, ajo mbetet e vlefshme për ata persona ose sende, të cilëve nuk u referohen deklarimet e pasakta apo heshtja.

Neni 1119

Dhënia e informatave të pasakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura, në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, ose lënia në harresë e informatave kur vërtetohet se nuk janë bërë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, por siguruesi mund të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar të siguruarin me shkrim, brenda 3 muajve nga marrja dijeni e tyre.

Në qoftë se ngjarja e sigurimit vërtetohet përpara se pasaktësitë e informatave ose lënia në harresë e tyre, të njihen nga siguruesi, ose përpara se të jetë deklaruar heqja dorë nga kontrata, shuma e detyruar ulet në proporcion me diferencën midis shumës së caktuar në kontratë dhe asaj që do të ishte zbatuar, në se do të njihej gjendja e vërtetë e fakteve.

Neni 1120

Kur kontrata e sigurimit lidhet në emër e për llogari të të tretëve dhe këta janë në dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose të harresave në lidhje me rrezikun (rastin e sigurimit), në favor të siguruesit zbatohen dispozitat e neneve 1118, 1119 të këtij Kodi.

Neni 1121

Kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar asnjëherë ose ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës.

Neni 1122

Kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së qeni pas përfundimit të kontratës, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primeve, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit t'i jetë njoftuar ose t'i jetë bërë e ditur në një mënyrë tjetër.

Neni 1123

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi detyrohet t'i njoftojë siguruesit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijeni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që mund të influencojë mbi shtimin e rrezikut.

Në qoftë se i siguruari nuk bën njoftimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë, që nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit ose të zgjidhë kontratën.

Kur i siguruari nuk pranon ndryshimin ose zgjidhjen e kontratës, ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës.

Neni 1124

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përfundimit të kontratës dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të kohëzgjatjes së kontratës.

Kur afati i kontratës është mbi 10 vjet, palët me kalimin e këtij afati dhe në rast se nuk kanë ndonjë marrëveshje të kundërt, kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata, duke bërë një paralajmërim 6 muaj më parë.

Kontrata mund të zgjatet heshtazi një ose disa herë, por në çdo rast jo më shumë se për dy vjet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për kontratën e sigurimit të jetës.

Neni 1125

Kontraktuesi detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet.

Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 1126

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të njoftojë siguruesin brenda afatit të parashikuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk bën këtë njoftim, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1127

I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në sigurimin e pasurisë të provojë edhe sasinë e dëmit, si dhe t'i njoftojë siguruesit, sipas kërkesës së këtij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vërtetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor.

Kur nuk përmbushen detyrimet e sipërme, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1128

Shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguruarit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet për borxhet e të siguruarit.

Siguruesi ka të drejtë të ndalojë nga shpërblimi i sigurimit ose nga shuma e sigurimit atë që ka për të marrë i siguruari nga e njëjta kontratë e sigurimit (primin etj.).

Neni 1129

Siguruesi mund t'i kundrejtojë personit, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, të gjitha prapësimet që ai mund t'i kundrejtojë të siguruarit nga e njëjta kontratë sigurimi.

Neni 1130

Kur një person lidh një kontratë sigurimi në emër të një tjetri, pa patur një tagër të tillë prej tij, ky i fundit mund të pranojë kontratën e lidhur edhe pas vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.

Personi që ka lidhur kontratën është i detyruar të zbatojë vetë detyrimet që rrjedhin nga kontrata, deri në momentin kur siguruesi ka marrë njoftim për pranimin ose jo të saj, nga personi në emër të të cilit është lidhur kontrata.

Çmimi i sigurimit i paguhet siguruesit nga kontraktuesi i mësipërm, për të gjithë periudhën deri në momentin kur siguruesi ka marrë dijeni për mospranimin e kontratës.

Neni 1131

Siguruesi nuk është përgjegjës kur vdekja ose humbja e aftësisë për punë të të siguruarit, si dhe kur humbja ose dëmtimi i pasurisë janë shkaktuar drejt për drejt nga veprime lufte, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Neni 1132

Kushtet për llojet e ndryshme të sigurimit vullnetar të pasurisë dhe të personit caktohen në kontratë.

Neni 1133

Dispozitat e këtij kreu nuk shtrihen mbi sigurimin e detyrueshëm, i cili rregullohet nga dispozita të veçanta.

Sigurimi në lundrimin detar rregullohet nga Kodi i Lundrimit Detar.

Sigurimi i pasurisë

Neni 1134

Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme.

Neni 1135

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit pushon interesi pasuror i të siguruarit, ose i personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, kjo quhet e zgjidhur.

Neni 1136

Shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefta e pasurisë. Kjo vleftë, për disa lloje sigurimi, mund të jetë e përcaktuar në kontratën e sigurimit edhe me anë vleftësimi të pasurisë.

Me vleftë duhet të kuptohet vlera më e madhe që ka patur pasuria në kohën e vërtetimit të rastit fator.

Në sigurimin e prodhimeve të tokës, dëmi përcaktohet në raport me vlerën që do të kishin prodhimet në kohën e pjekjes së tyre, ose kur mblidheshin zakonisht.

Kur është siguruar vetëm një pjesë e vleftës së pasurisë, shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefta e pjesës së pasurisë të siguruar.

Kur shkelen kushtet e sipërme, kontrata e sigurimit është e vlefshme, sipas rastit, për një shumë të barabartë me vleftën ose me pjesën e vleftës së pasurisë të siguruar.

Neni 1137

Kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet, shpërblehet, sipas rastit, vlefta e saj brenda kufijve të shumës së sigurimit ose pakësimi i vleftës së pasurisë, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Siguruesi përgjigjet për fitimin e munguar, vetëm në qoftë se është parashikuar shprehimisht në kontratë.

Neni 1138

Kur pasuria e siguruar ka humbur pjesërisht ose është dëmtuar dhe për këtë është paguar shuma jo e plotë e sigurimit, pasuria që ka mbetur quhet e siguruar gjer në fund të afatit të caktuar në kontratë për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe shpërblimit që është paguar.

Neni 1139

Kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vlefta e pasurisë së siguruar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjesëtim me raportin midis shumës së sigurimit dhe vleftës së pasurisë të siguruar, përveç kur në kontratë parashikohen ndryshe.

Neni 1140

I siguruari detyrohet të ruajë me kujdes pasurinë e siguruar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe veterinare. Siguruesi ka të drejtë të kontrollojë pasurinë e siguruar dhe të kërkojë nga i siguruari që të marrë masa për ruajtjen e mirë të pasurisë dhe për zhdukjen e çrregullimeve që janë konstatuar. Kur i siguruari shkel detyrimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit.

Neni 1141

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të marrë të gjitha masat që varen nga ai për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar me qëllim që të ndalohet ose pakësohet dëmi.

Siguruesi nuk detyrohet të paguajë shpërblim për atë pjesë të dëmit që u shkaktua nga mosmarrja prej të siguruarit të masave që mund të merreshin prej tij për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar.

Siguruesi detyrohet të paguajë shpenzimet për masat e nevojshme që janë marrë për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar, pavarësisht nëse është arritur ose jo qëllimi, përveç kur siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra, janë përdorur ose janë bërë pa kujdes. Siguruesi përgjigjet për dëmet materiale të shkaktuara mbi sendet e siguruara nga mjetet e përdorura nga i siguruari për të shmangur ose zvogëluar dëmet e ndodhura në ngjarjen e sigurimit, përveç kur provon që mjetet e tilla janë përdorur pa kujdes dhe pa qenë të domosdoshme.

Neni 1142

Siguruesi që ka paguar shpërblimin e sigurimit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Neni 1143

Siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose e personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit.

Në sigurimin e pasurisë së personave, siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të siguruarit.

Neni 1144

Kur pasuria e siguruar kalon në pronësinë e një personi tjetër, kontrata e sigurimt quhet e zgjidhur. Në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjesëtim me kohën që mbetet gjer në mbarimin e afatit të kontratës së sigurimit.

Neni 1145

Kur për të njëjtin rrezik sigurimi janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigurues të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigurues, për të gjitha sigurimet.

Kur i siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, siguruesit nuk janë të detyruar të paguajnë shpërblimin e dëmit.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë të gjithë siguruesit, duke i treguar secilit emërtimin e të tjerëvesigurues.

I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga secili sigurues shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, por gjithsesi shumat e shlyera së bashku nuk duhet të kalojnë shumën e dëmit.

Neni 1146

Siguruesi që ka paguar shumën e dëmit ka të drejtën e regresit ndaj siguruesve të tjerë për ndarjen e shumës së detyruar sipas kontratave përkatëse.

Kur një sigurues është me paaftësi paguese, pjesa e tij ndahet ndërmjet siguruesve të tjerë.

Neni 1147

Sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportimit tokësor, ujor të brendshëm dhe ajror përfshin të gjitha dëmet që mund të pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, përveç kur është caktuar ndryshe nga ligji.

Neni 1148

Kontrata e sigurimit të mallrave kundër rreziqeve të transportimit hyn në fuqi që nga çasti që mallrat i janë dorëzuar transportuesit dhe vazhdon gjer sa këto t'i dorëzohen pritësit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1149

Kur mallrat e transportuara merren në dorëzim nga pritësit pa u mbajtur në këtë rast procesverbal, siguruesi nuk përgjigjet për dëmtimin ose mungesën e mallrave, përveç kur është parashikuar ndryshe me ligj.

Sigurimi i personit

Neni 1150

Kontrata e sigurimit të personit mund të lidhet për rastin e vërtetimit të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguruarit.

Neni 1151

Në kontratën e sigurimit të personit shuma e sigurimit caktohet me marrëveshje të palëve dhe sipas dispozitave të tjera mbi sigurimet.

Neni 1152

Kontrata e sigurimit është e vlefshme edhe kur sigurohet jeta e një të treti. Caktimi i personit bëhet në kontratën e sigurimit, ose me deklaratë me shkrim të mëvonshme, që i njoftohet siguruesit, ose me testament.

Neni 1153

I siguruari mund të caktojë në kontratën e sigurimit që, në rast se ai vdes, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtari të familjes së tij, një personi tjetër, shtetit, ose një personi tjetër juridik publik.

Neni 1154

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, ka të drejtë që të zëvendësojë me një tjetër personin që ka caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Për këtë i siguruari detyrohet të njoftojë me shkresë siguruesin dhe të paraqesë dëshminë e sigurimit për të bërë në të shënimet e nevojshme.

Neni 1155

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi mund të revokohet nga kontraktuesi në formën dhe mënyrën që përdoret për caktimin e tij.

Revokimi nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët pas vdekjes së kontraktuesit, pasi të jetë vërtetuar ngjarja e sigurimit e personi ka deklaruar se e dëshiron këtë përfitim.

Heqja dorë e kontraktuesit dhe deklarata e përfituesit duhet t'i njoftohen me shkrim siguruesit.

Neni 1156

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi, dhe pse mund të jetë i parevokueshëm, nuk ka efekt kur është rasti i parashikuar në shkronjën "a" të nenit 771 të këtij Kodi.

Neni 1157

Kur në dëshminë e sigurimit nuk është treguar personi që mund të marrë shumën e sigurimit, si dhe kur personi i treguar ka vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar me një person tjetër, ose kur ai me dashje ka vrarë, ose ka tentuar të vrasë të siguruarin, shuma e sigurimit i paguhet të siguruarit, dhe në qoftë se ky ka vdekur, trashëgimtarëve të tij ligjorë ose me testament.

Neni 1158

Kur për të marrë shumën e sigurimit janë caktuar më shumë persona dhe disa prej tyre kanë vdekur para të siguruarit, ose disa prej tyre me dashje kanë vrarë ose kanë tentuar të vrasin të siguruarin, pjesët që u takojnë këtyre ndahen midis personave të tjerë të caktuar për të marrë shumën e sigurimit në përpjesëtim me pjesën që i është caktuar secilit prej tyre.

Në rast se në kontratë nuk përmenden pjesët e personave të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, prezumohet se ato janë të barabarta

Neni 1159

Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit kur sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato nuk rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur atë.

Në rast se ndryshimet janë të një natyre të tillë që, gjendja e re edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë, pagimi i shumës së sigurimit pakësohet në përpjesëtim me çmimin më të ulët, të caktuar në raport me atë çmim që ka qenë përcaktuar në fillim.

Në qoftë se i siguruari njofton për ndryshimet e mësipërme siguruesin, ky, brenda 15 ditëve, duhet të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën apo të pakësojë shumën e sigurimit ose të ngrejë çmimin.

I siguruari, brenda 15 ditëve duhet të deklarojë nëse pranon ndryshimet e sipërme në kontratë.

Në qoftë se i siguruari deklaron se nuk i pranon ato, kontrata zgjidhet.

Neni 1160

Shuma e sigurimit, që pas vdekjes së të siguruarit është caktuar t'i paguhet personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, nuk përfshihet në pasurinë trashëgimore të të siguruarit.

Neni 1161

Shumat e sigurimit që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të personit, paguhen pavarësisht nga shumat që mund të paguhen nga sigurimet shoqërore.

TITULLI III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 1162

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1163

Për parashkrimin e padisë dhe parashkrimin fitues, që kanë filluar të ecin para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mëparshme, do të zbatohen këto të fundit.

Neni 1164

Dispozitat e këtij Kodi lidhur me posedimin, zbatohen edhe për posedimet që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1165

Rregullimi juridik i afatit dhe i çmimit të qirasë në kontratën e qirasë së banesave, do të vazhdojë të bëhet sipas dispozitave të mëparëshme, deri në liberalizimin e plotë të kësaj kontrate me dispozita të veçanta.

Neni 1166

Kontratat e veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të tij dhe që vazhdojnë të zbatohen, do të rregullohen sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 1167

Ligji nr.6340, datë 26.6.1981 "Për Kodin Civil", përveç dispozitave për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, ligji nr. 2362, datë 16.11.1956 "Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike", ligji nr.7688, datë 13.3.1993 "Për bashkëpronësinë në banesa", ligji nr. 7695, datë 7.4.1993 "Për fondacionet" nenet 1-15, dekreti nr.600, datë 22.7.1993 "Për pengun dhe hipotekën", miratuar me ndryshime me ligjin nr.7753, datë 30.9.1993, shfuqizohen.

Neni 1168

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë hyn në fuqi më 1 nëntor 1994.

Dispozitë e parashikuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012

Për çështjet civile me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror ndaj reputacionit, që janë ende në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohet legjislacioni civil në fuqi, në kohën e ngritjes së padive për shpërblimin e dëmit jopasuror.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 121/2013, neni 11)

Dispozitat për trashëgiminë janë të zbatueshme vetëm për kërkesat për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, të bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çështjet gjyqësore me objekt "kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë" do të vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata kompetente, sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesës.

Dispozitat mbi agjencinë janë të zbatueshme për kontratat e agjencisë, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

TREGUESI ALFABETIK I KODIT CIVIL

- A -

ADMINISTRIMI
- i shoqërisë, 1080, 1081, 1084, 1096

ADMINISTRIMI I SENDIT TË PËRBASHKËT
- nga të gjithë pronarët, 203

AFATI
- në veprimet juridike, 89
- pezullues në veprimet juridike, 90/1
- zgjidhës në veprimet juridike, 90/11
- llogaritja, 91
- afati i parashkrimit të padisë, 103
- afati për ngritje të padisë, 104
- i parashkrimit të së drejtës së padisë, 114
- i shkurtër i parashkrimit të së drejtës së padisë, 115
- i ndryshimit, pavleshmëria e marrëveshjes, 116
- kur fillon në parashkrimin e së drejtës së padisë, 117
- i parashkrimit në detyrimet kontraktore, 118
- i parashkrimit në kërkimin e sendit, 119
- i parashkrimit të padisë për kthimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, 120
- i parashkrimit për begatimin pa shkak, 121
- i parashkrimit për kërkimin e trashëgimit, 122
- i parashkrimit të padive të kthimit, 123
- heqja dorë nga parashkrimi pas plotësimit të afatit, 126
- e drejta e pretendimit të kreditorëve se afati parashkrimit është plotësur, 127
- përmbushja e detyrimit pas plotësimit të afatit të parashkrimit, 128
- llogaritja e kohës së pezullimit në raport me parashkrimin, 130
- rrethanat e përcaktimit të afatit të ri të parashkrimit, 135
- llogaritja në parashkrimin e së drejtës së padisë, 136
- prekluziv, kuptimi, 137
- prekluziv, pasojat, 138-140
- i uzufruktit, 234
- rivendosja në posedim, 313
- i heqjes dorë nga trashëgimi, 335, 336, 338, 340
- i pushimit të detyrës së kujdestarit, 347
- i kërkimit të legatarit për të kërkuar frutet ose kamatën, 385
- për kërkimin e pavlefshmërisë së testamentit, 411
- i ekzekutimit të detyrimit, 463-464
- prezumimi në dobi të debitorit dhe pengesa e prezumimit, 464- 465
- kur debitori është në vonesë në përmbushjen e detyrimit, 481
- shtyrja për ekzekutimin e detyrimit, 490
- i shuarjes së detyrimit me kompensim, 515
- i shtrirjes së hipotekës dhe efektet, 569

- efektet dhe rradha e hipotekës nga data e regjistrimit, 574
- i efekteve të hipotekës, 578
- i shuarjes së dorëzanisë, 600
- i parashkrimit të padisë kundër prodhuesit, 634
- në kontratat (kohëzgjatja) e veçanta, shih kontratat përkatëse

AGJENCIA, 950-961
- shih kontratat e veçanta

(E) ARDHURA
- të drejtat e poseduesit me mirëbesim ose me keqbesim, 297-298

AKTI NOTERIAL
- mënyra e përpilimit të prokurës, 72
- forma e veprimit juridik, 80
- nënshkrimi i një personi tjetër, 82
- veprimi juridik lidhur me pronë të paluajtshme, 83
- rrethanat kur humbet pronësia, 191
- rrethanat dhe procedurat e kryerjes së pjestimit të sendit të përbashkët, 207
- llojet e veprimit juridik për krijimin e uzufruktit, 235
- marrja e sendit objekt uzufrukti me inventar, 247
- e drejta e trashëgimlënësit për të falur, 324
- format e testamentit, 392
- si mund të disponojnë personat shurdhë ose shurdhë-memecë, 395
- testamenti me akt noterial, 397

ANKANDI
- rrethanat e organizimit, 357
- personat e përjashtuar nga, 709

ANKIMI
- i vendimit të shoqërisë, 51

ARBITRAZHI
- vendosja e hipotekës, 565

ASAMBLEJA
- organi administrues i objekteve të përbashkëta, 212
- mënyra e organizimit, 213
- kompetencat, 214
- vendime të detyrueshme, 215
- padia kundër vendimeve, 216

- B -

BANIMI, 12
- i të miturve, 13
- i personit të pazotë për të vepruar dhe i atij në kujdestari, 13
- Zbatim i uzufruktit mbi të drejtën e përdorimit dhe të banimit, 260

BARRA
- në trashëgimin me testament, 384-391
- dhurimi i rënduar dhe detyrimet e dhuruesit, 768
- kur dhuruesi duhet të jap garanci, 769

BASHKËPRONARI
- pezullim ose ndërprerje e parashkrimit në favor të, 295

BASHKËPRONËSIA
- përkufizimi, 199/1
- në pjesë përkufizimi, 199/2
- të drejtat e detyrimet e bashkëpronarëve, 199-202
- administrimi, 203
- e drejta e parablerjes, 204
- e drejta e kreditorit mbi pjesën, 205-206
- pjesëtimi, 207
- tjetërsimi, 208
- pëlqimi për krijimin e servitudeve, 287
- e detyrueshme
- në ndërtesa, 209
- madhësia e pjesës, 210/1
- pasojat e heqjes dorë, 210/2
- pandashmëria, 211
- administrimi, 212-216
- detyrimet e bashkëpronarëve, 217
- shtesa në katin e fundit, 218-220
- shembja tërësore ose pjesore, 221
- në familjen bujqësore (në tërësi)
- përkatësia, 222, 225
- përbërja dhe përfaqësimi i familjes bujqësore 223-224
- kushtet për tjetërsimin e pjesës , 226
- pjesëtimi, 227-228
- ndërmjet bashkëshortëve, 231, 358, 361
- pëlqimi për krijimin e servitudeve, 287

BASHKIA
- detyrimi i personit që ka gjetur një send të humbur, 182-183, 195

BEGATIMI PA SHKAK 655-658

(I) BIRËSUARI
- e drejta për t'u thirrur në trashëgimi, 362/2

BLETË
- tufa e ikur, pronësia, 189

BLERËSI
- në kontratën e shitjes (shih kontratat e veçanta, shitja)

BURIMI I UJIT
- e drejta e pronarit të tokës për të përdorur, 156

- C -

CAKTIMI I TRASHËGIMTARIT
- e drejta e trashëgimlënësit për të caktuar, 377

CEDIMI
- kompensimi i kredisë pas cedimit, 504
- skontoja bankare nëpërmjet, 1047

- Ç -

ÇEKU BANKAR
- të drejtat e bankës kur skontoja bëhet me kambial ose çek, 1048

ÇMIMI
- caktimi i çmimit të sipërmarrjes, 851, 862

- D -

DEBITORI
- marrdhëniet debitor kreditor, 422

DEKADENCA
- afati, kuptimi, 137
- pasojat, 138-140

DEPOZITA, 982-999
- bankare, 1024-1027 (shih kontratat e veçanta)
- në hotel, 1004-1012

DETYRIMET
- që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, kuptimi 341/2
- të trashëgimtarëve, 341/1-342
- në marrdhënie kontraktore, (kuptimi 419)
- lindja, 420
- natyra ekonomike, 421
- të pjesëtueshme, 442
- të papjesëtueshme, 443-444
- ekzekutimi, parime të përgjithshme, 455-457
- ekzekutimi për dorëzim sendesh, mënyrat, 458
- ekzekutimi pjesë-pjesë dhe nga një person i tretë, 459-460
- vendi i ekzekutimit, 461
- afati i ekzekutimit, 463
- prezumimi i afatit në favor të debitorit, 464
- pengesat për zbatimin e këtij prezumimi, 465
- ekzekutimi ndaj kreditorit, 466
- ekzekutimi ndaj një të treti, 467

- ekzekutimi ndaj kreditorit të pazot, 468
- ekzekutimi për llogari të shumë detyrimeve, 469
- radha e ekzekutimit, 470
- të drejtat e kreditorit në ekzekutim, 462, 471
- shpenzimet e ekzekutimit, dëftesat perkatëse, 472-474
- ekzekutimi dhe lirimi i sendeve nga garancia, 475
- që kryhen me punën e të tretëve, 477-478
- detyrimet solidare
- detyrimet alternative
- detyrimet monetare nr.5, 6,7
- detyrimet solidare
- kuptimi dhe rastet, 423, 425
- nga rrjedh, 424
- ekzekutimi nga debitorët solidarë, 426-427
- qënia me vonesë e kreditorit pasojat, 427/1
- e drejta e zgjedhjes e debitorit, 428
- kuptimi i kreditorit solidar, 428/2
- përsëritja e detyrimit nga debitori, pasojat tek të tjerët, 429/1
- falja ndaj një debitori i cilësive të debitorit dhe kreditorit, pasoja, 429/2, 3
- shlyerja dhe marrëdhëniet ndërmjet debitorëve solidarë, 430, 432
- shlyerja e shpenzimeve të ekzekutimit, 431
- efektet e ndërprerjes e të pezullimit të parashkrimit, 433-434
- pamundësia e ekzekutimit, pasojat, 435
- detyrimet alternative
- kuptimi, 436
- e drejta e zgjedhjes e debitoritdhe e kreditorit, 437-438
- i thjeshtë 439-440
- detyrimet monetare
- kuptimi, 445
- përmbushja me monedhën e vendit, 446
- përdorimi i llogarisë rrjedhëse të debitorit, 447
- vendi i pagesës, 448-449
- dëmi nga vonesa e pagimit të një shume, 450
- monedha pa kurs zyrtar, 451
- shlyerja me monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku do të paguhej ose e parashikuar në kontratë, 453-454
- efektet e mosekzekutimit
- përgjegjësia, të drejtat e kreditorit, 476
- pavlefshmëria e marrëveshjes që kufizon përgjegjësinë, 479
- pamundësia për fajin e debitorit, 480
- vonesa e debitorit, përkufizimi, 481
- pamundësia e papritur e përmbushjes, 482
- pasojat e vonesës, 484, 486, 488-489
- kur përmbajnë mosveprime, 483
- kredi e kërkueshme e debitorit, pezullimi i ekzekutimit, 485
- vonesa e kreditorit, 491-495
- zëvendësimi i debitorit, 496-498
- kalimi i kredive, 499-507
- shuarja
- me përtëritje, 508-510

- me falje, 511-513
- me kompesim, 514-523
- me bashkim të cilësive kreditore e debitore, 524-525
- për shkak pamundësie ekzekutimi, 526-529
- mjetet për të siguruar ekzekutimin
- dispozita të përgjithëshme, 530-531
- pengu, hipoteka, dorëzania, privilegjet, kushti penal (shih emërtimin përkatës)
- nga shkaktimi i dëmit, shih dëmi
- premtimi për kryerjen e një detyrimi ose një veprimi, 697

DETYRIMI CIVIL
- i çdo personi, 1
- i një të huaji, 3

DËFTESA
- për shpenzimet e ekzekutimit, 472-474

DËMI
- shpërblimi për sendet e marra në uzufrukt, 246
- shpërblimi kur vendoset një servitud, 264
- nga vonesa e shlyerjes së një detyrimi në para, 450
- nga ndryshimi i kursit të këmbimit, 454
- nga moekzekutimi i detyrimit prej debitorit, 486
- nga fajësia e përbashkër kreditor-debitor, 493
- jashtë kontratës, përkufizimi, 608-609
- pavlefshmëria e marrëveshjes që përjashton ose kufizon përgjegjësinë, 610
- mbrojtja e nevojshme, efektet, 611
- përgjegjësia e personit që shkakton dëm për të shpëtuar veten, 612
- nga të miturit e personat e pazotë për të vepruar, 613-614
- nga personat nën mbikëqyrje , 615-616
- nga publikimet mashtruese ose të pasakta, 617
- përgjegjësia e punëdhënësit, 618-619
- përgjegjësia e përfaqësuesit, 620
- që rrjedh nga përdorimi i kafshëve, 621
- që rrjedh nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikëshme, 622-623
- nga cenimi i mjedisit, 624
- jo pasuror përgjegjësia, 625
- dhe përgjegjësia solidare, 626
- i shpërblyer, padia për kthimin e shpërblimit të paguar, 627
- dhe përgjegjësia nga produktet, 628-634
- shpërblimi
- përmbajtja, 640
- në shëndetin e personelit, 641
- ndryshimi i masës, sipas rrethanave, 642
- kur shkaktohet vdekja e personit, 643
- shpërblimi, kur personi që ka shkaktuar atë ka pasur përfitime, 644
- kur shkaktohet vdekja e personit siguruar në sigurimet shoqërore, 645

- kur i dëmtuari nuk ka qënë i siguruar në sigurimet shoqërore, 646
- shkaktuar shëndetit të të miturit, 647
- Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile
  dhe të masës së dëmit jopasuror, 647/a

DËRGUESI
- në kontratën e transportimit, 882, 886
- përgjegjësia për vonesën, 897-8
- përgjegjësia kur janë disa dorëzanësa, 591
- të drejtat ndaj kreditorit, 592-593
- detyrimet ndaj debitorit kur ekzekutohet
- detyrimi nga dorëzanësi, 595-596
- e drejta e padisë së kthimit kur janë disa debitorë kryesorë, 593-594
- shuarja 597-600

DORËZANËSI
- raportet me debitorët dhe kreditorët në kompensim, 520

(E) DREJTA REALE
- janë të zbatueshme dispozitat për sendet, 142-143
- janë të transferueshme, 162
- mbi pasuri të paluajtshme, regjistrimi, 192-194
- nuk mund të tjetërsohen pa u regjistruar, 195

(E) DREJTA E
- emrit, 5
- pronarit që ushtron një servitut, 292
-pronarit të ngrejë padi për sendin e tij, 296
- pronarit të pushojë cenimin e pronës së tij, 302
- zëvendësuesve për të përfaqësuar, 326
- trashëgimtarit për të poseduar pasuri, 331-332
- kujdestarit të trashëgimit, 345, 346
- bashkëshortit për të kërkuar pjesën e krijuar nga puna e tij, 358
- detyrimi palëve për sendin e lënë peng, 549-555

- DH -

DHURIMI 761-771
- shih kontratat e veçanta

-E-

EKSKLUZIVITETI
- në kontratën e furnizimit, 779-781

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT
- ekzekutimet e detyrimeve, 455-495, 528-543

EKZEKUTORI I TESTSMENTIT
- Çaktimi, 414

- Detyrat, 415
- Shkarkimi, 416
- Tagret nuk trashëgohen, 417
- Përgjegjësia, 418

EMRI
- i personit fizik, 5
- i personit juridik, 27

EVINKSIONI
- kur shuhet dorëzania, 599
- pasojat kur blerësi i paditur nuk thërret shitësin në çështje, 728

-F-

FALJA
- e detyrimeve, 511-513

FALIMENTIMI
- kur shuhet porosia dhe pasojat, 927
- kategori anëtarësh që përjashtohen nga shoqëria, 1110

FAMILJA BUJQËSORE
- përkatësia e pronësisë, 222, 225
- përbërja, 223
- përfaqësimi i saj, 224
- përgjegjësia, 229-230
- e drejta e trashëgimtarit për të trashëguar pjesën e anëtarit që vdes, 359

FËMIJA
- zotësia juridike, 2
- i mitur, banimi, 13
- i lindur jashtë martese, të drejtat trashgimore, 362/1
- i birësuar, të drejtat trashëgimore, 362/2
- i mitur, zotësia për të vepruar, 7-9
- rradha e thirrjes në trashëgimi, 361

FONDACIONI
- Kuptimi dhe objekti, 54
- mënyra e krijimit, 55
- fillimi si person juridik, 56
- të drejtat pasurore, 56/1
- shfuqizimi i aktit të krijimit, 57
- rregullimi i veprimtarisë, 58, 61
- mbikëqyrja e veprimtarisë, 59
- zgjidhja e mosmarrëveshjeve pasurore, 61
- rastet e shpërndarjes, 62
- pasuria pas shpërndarjes, 63

FORMA
- e prokurës (akt), 72
- e veprimit juridik, 80-82
- e veprimit juridik për kalimin e pronësisë së paluajtshme dhe e të drejtave reale mbi to, 83
- e aktit për krijimin e uzufruktit, 235
- për kontratat (shih kontratat e veçanta)

FRANCHISING 1056-1064
- shih kontratat e veçanta

FRUTAT
- e sendit, lloji dhe përkatësia, 145, 151
- e sendit në uzufrukt, përkatësia, 239

FURNIZIMI 772-783
- shih kontratat e veçanta

- G -

GARANCIA
- për sendet e dhëna në uzufrukt, 249-250
- hiqet kur kreditori pranon ekzekutimin, 475
- kur duhet dhënë nga dhuruesi, 769-770
- dhe denoncimi i të metave të veprës në sipërmarrje, 864-867
- e drejta e klientit të përdorë, 1018
- shuarja e, 1033
- kur banka kërkon, 1039-1040

- GJ-

GJENDJA CIVILE
- pasojat juridike të caktimit të vdekjes, 22

GJERIMI I PUNËVE
- të tjetrit, 648
- përmbushja e detyrimeve të gjeruesit nga personi i interesuar, 649
- të drejtat e gjeruesit, 650-652
- miratimi i veprimeve të gjeruesit, 652
- pagesa e shpenzimeve të, 970

GJYKATA
- regjistrimi i shoqatave, 41-42
- regjistrimi i fondacioneve, 55

- H -

HIPOTEKA
- administrimi i sendit të përbashkët në marrëveshje, 203
- e drejta e trashëgimtarit për të liruar pronën nga, 342

- zëvëndësimi i debitorit me pëlqim të kreditorit dhe garancitë, 496
- mjetet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve, 531
- vendosja e, 532-536
- papjesëtueshmëria e, 537-540
- përkufizimi, 560
- e drejta e trashëgimtarëve për të kërkuar heqjen, 342
- si mjet për ekzekutimin e detyrimeve, kushtet, 532-533
- dhe pengu, shtrirja e tyre, 534
- rrjedhojat e humbjes e të zhveftësimit të sendeve, 535-536
- dhe pengu janë të papjesëtueshëm, 537
- dhe pengu që përmbushin pjesërisht detyrimin, pasojat, 539
- rasti i pavlefshmërisë së marrëveshjes, 540
- sende të hipotekueshme, 561
- llojet, 562
- ligjore, 563-564
- gjyqësore, 565-566
- mbi sendet e ardhshme, 567
- shtrirja, 568-569
- vendi i regjistrimit, 570-571
- pasaktësitë e aktit, pasojat, 572
- shpenzimet e regjistrimit, 573
- rradha dhe efektet e saj, 574-577
- efektet juridike në tërësi, 578-580
- zbritja, 581-582
- shuarja, 583
- fshirja e regjistrimit, 584
- shuarja e dorëzanisë, 598

(I) HUAJI
- zotësia juridike, 3

HUAJA 1050-1055
- shih kontratat e veçanta

HUAPËRDORJA 901-912
- shih kontratat e veçanta

HYRJA NË FUQI
- e kontratës së sigurimit, 1124
- e kontratës së sigurimit për mallra që transportohen, 1148
- e zbatimit të Kodit Civil, 1162
- e zbatimit të dispozitave të kodit për posedimin, 1164
- e kontratave të veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të kodit, 1166
- e Kodit Civil, 1168

- I -

INVENTARI
- i sendeve të marra në uzufrukt, 247
- për sigurimin e pasurisë trashëgimore, 343

- dorëzimi i pasurisë së paluajtshme me, 827
- marrja e dokumenteve dhe sendeve të shoqërisë nga likuiduesi me, 1099

- K -

KAFSHA
- përgjegjësia nga përdorimi, 621

KALIM KREDIE
- kushtet e kalimit të, 499-507

KALIM PRONËSIE
- e drejta e pronës dhe të drejtave të tjera mbi sendet, 162
- rrethanat kur mund t'u kundrejtohet kreditorëve, 747

KALLËZIMI I RREMË
- kush nuk mund të trashëgojë si padenjë , 322

KAMATA
- përqindja caktohet me ligj, 450/1
- rradha e pagesës, 470
- rrethanat kur prezumohet pagesa për shlyerje detyrimesh, 474
- e drejta e debitorit kur kreditori është në vonesë, 492, 495
- rradha e përparësisë, 577
- detyrimet e debitorit kryesor, 589
- në kontratën e shitjes, 743
- në llogarinë likuiduese, 1015
- në kontratën e huasë, 1051
- në kontratat bankare (shih kontratat e veçanta)

KANOSJA
- dhe rrethanat kur veprimi juridik bëhet i pavlefshëm, 96
- pasojat e veprimit juridik të pavlefshëm për shkak të , 107
- kush nuk mund të trashëgojë si i padenjë, 322
- kur testamenti është i pavlefshëm, 409

KAPARI
- përkufizimi, 601
- efektet juridike, 602

KASETAT E SIGURIMIT, 1028-1030
- shih kontratën bankare

KËSTI
- pronësia e sendeve të blera me, 746
- kur vjen zgjidhja e kontratës për mos pagesë të, 748
- kur huadhënësi kërkon kthim të menjëhershëm të parave ose të sendeve, 1052

KOHA
- e çeljes së trashëgimit, 318

KOMISIONI 935-944
- shih kontratat e veçanta

KOMPENSIMI
- i detyrimeve, 514-523

KONKURRENCA
- e pandershme, 638-639
- ndalimi i konkurrencës franchismarrësit, 1061

KONTRATA
- fitimi i pronësisë me, 164
- regjistrimi në regjistrin e pasurisë së patundshme, 193
- krijimi i servitutit vullnetar, 281
- lind detyrimi, 420
- zbatimi i dyanshëm nga palët, 487
- të drejtat e palëve, 488-489
- forma e kontratës për pengun, 547
- vënia e hipotekës me, 562
- efektet juridike të mosekzekutimit, 602
- përmbajtja, 659-660
- me detyrime të njëanëshme dhe të dyanëshme, 487-489, 661-663
- lidhja, 664-667
- propozimi për lidhjen, 665-671
- heqja dorë, 672, 696
- detyrimi i ndërmarrjes dominuese në treg për të lidhur kontrata, 673
- sjellja e palëve gjatë lidhjes, 674-675
- kur quhet e lidhur, 676
- shkaku i paligjshëm, 677
- objekti, 678-680
- interpretimi, 681-685
- kushtet e përgjithshme, 686-689
- efektet, 690-693
- efektet ndaj të tretëve, 691
- efektet ndaj trashëgimtarëve, 692
- në dobi të një të treti, 694
- premtimi për kryerjen e një detyrimi, 697
- zgjidhja, rregulla të përgjithshme, 698-704
- përmbajtja e shkëmbimit, 757

KONTRATA TË VEÇANTA

AGJENCIA
- përmbajtja, 950
- dispozita të përgjithshme, 951-953

- të drejtat e detyrimet e palëve, 954-960
- dispozitë referuese, 961

BANKARE, DEPOZITAT
- përmbajtja, 1024
- veprimet në librezë, 1025-1026
- të drejtat dhe detyrimet e bankës, 1027

BANKAR, SHËRBIMI DHE KASETAT E SIGURIMIT
- detyrimet e bankës, 1028-1030

BANKARE, ÇELJE KREDIE
- përkufizimi, përdorimi, garancia dhe tërheqja nga kontrata, 1031-1034

BANKARE, PARADHËNIE
- detyrimet e bankës, 1035-1040

BANKARE, VEPRIME ME LLOGARI RRJEDHËSE
- kudhtet e veprimit me llogari rrjedhëse të klientit, 1041-1046

BANKARE, SKONTOJA
- përkufizim gëzimi i të drejtave të bankës, 1047-1049

DEPOZITA
- përmbajtja 982
- momenti i lidhjes, 983
- prezumimi i shërbimit, 984
- të drejtat e detyrimet e palëve, 985- 998
- dispozitë referuese, 999
- në magazinat 1000-1003
- në hotel
- përgjegjësia e hotelierit, 1004-1005, 1007
- kur nuk përgjigjet hotelieri, 1006
- përgjegjësia e klientit, 1008
- pavlefshmëria e marrëveshjes për përgjegjësinë e hotelierit, 1009
- përjashtime nga zbatimi i këtyre dispozitave, 1010
- në ambjente e veprimtari të tjera, 1011
- privilegji (preferimi) mbi kreditë e hotelierit, 1012

DHURIMI
- përmbajtja, 761-762
- me detyrimet periodike, 763
- forma, vlefshmëria, momenti i lidhjes, 764
- rastet e kundërshtimit, 765
- përgjegjësia për mospërmbushjen ose vonesën, 766
- me kusht kthimit të sendeve dhe me barrë, 767, 768
- garancia e dhuruesit, 769-770
- rastet për revokimin, 771

ENFITEOZA
- përmbajtja, 784
- kohëzgjatja dhe forma, 785-786
- të drejtat dhe detyrimet e palëve, 787-799
- nën enfiteoza nuk lejohet, 790
- zgjidhja e kontratës, 791
- tatimet dhe detyrimet mbi enfiteozëmarrësin, 792
- pasojat e tjetërsimit të, 793
- dorëzimi i pronës nga, 794
- e drejta e, 795-796
- detyrimi dhe përgjegjësia solidare, 797-798
- dispozitat e kreut të pestë zbatohen edhe për, 799
- krijimi i servituteve në këto prona, 800

FRANCHIZING
- përmbajtja, 1056
- detyrimet e franchizorit, 1057, 1063
- marrëdhëniet parakontraktore, 1058
- forma e kontratës , 1059
- heqja dorë, 1060, 1064
- ndalimi i konkurrencës pas zgjidhjes së kontratës, 1061
- detyrimet e franchizmarresit, 1062
- kur kërkohet shpërblimi i dëmit, 1063
- kur pala kontraktuese heq dorë nga kontrata para afatit, 1064

FURNIZIMI
- përmbajtja, 772
- përcaktimi i sasisë së mallit kur nuk është përcaktuar në marrëveshje, 773
- me karakter periodik, përcaktimi i çmimit të furnizimit, 774
- me karakter të vazhdueshëm, 775/II
- afatet, prezumimet, 776
- të drejtat e detyrimet e palëve, ekskluziviteti, 779-782
- dispozitë referuese, 783
- për sipërmarrje shërbimesh zbatohen normat e titullit të, 876

HUAJA
- përmbajtja, 1050
- pagimi i kamatave, 1051
- të drejtat e detyrimet e palëve, 1052-1055

HUAPËRDORJA
- përmbajtja, 901
- çasti i lidhjes, 902
- përgjegjësia për humbjen e sendit dhe për përdorimin e tij jo sipas kontratës , 904-905
- të drejtat e detyrimet e tjera të palëve, 906-912

KALIMI I PASURISË KREDITORËVE
- përmbajtja, 962
- forma për vlefshmëri, 963
- e drejta e administrimit dhe e ngritjes së padisë, 964
- të drejtat që lidhen me momentin e kalimit, 965
- të drejtat e detyrimet e palëve, 966-970
- zgjidhja e kontratës, 971-972

KOMISIONI
- përmbajtja, 935
- të drejtat e detyrimet e palëve, 936-943
- dispozitë referuese, 944

KOMISIONERI
- shih kontrata e komisionit, 935

KREDIA
- zëvendësimi e kalimi, 496-507
- zëvëndësimi i debitorit, 496
- prapësimet e debitorit ndaj kreditit, 497
- marrëveshja e debitorit me një të tretë për përmbushjen e detyrimit, 498
- kushtet e kalimit të kredisë, 499
- privilegjet, garancitë, kamatat në kalimin e kredisë, 500
- forma e kalimit, 501
- efektet e kalimit, 502-504
- kalimi me titull barësor dhe falas, 505
- dorëzimi i dokumenteve që provojnë kalimin e kredisë, 507
- bankare (shih kontratat e veçanta), 1031-1034

LLOGARIA RRJEDHËSE
- përmbajtja e kontratës, 1013
- kreditë që përjashtohen nga llogaria rrjedhëse, 1014
- llogaritja e kamatës, 1015
- komisioni, llogaritja, 1016
- të drejtat e detyrimet e tjera të palëve, 1017-1020
- mbyllja e llogarisë dhe kalimi i saj një klienti tjetër, 1021-1022
- tërheqja nga kontrata dhe efektet, 1023

NDËRMJETËSIMI
- detyrat e ndërmjetësimit profesionist, 97
- përmbajtja, 973
- mënyra e shpërblimit të ndërmjetësit, 974
- të drejtat e detyrimet e palëve, 975-981

POROSIA
- përmbajtja, 913
- dhe përfaqësimi, 914
- i porosituri që vepron në emrin e vet dhe personat e tretë, 915
- detyrat e të drejtat e të porositurit, 916, 921-924

- detyrat dhe të drejtat e porositësit, 918, 923, 925
- shtrihet edhe mbi aktet e domosdoshme për kryerjen e saj, 917
- kreditorët e palës së porositur, 919
- dhe shpërblimi, 920
- përparësia e kredive të të porositurit, 926
- shuarja, 927
- heqja dorë, efektet juridike, 928, 930-931
- emërimi i një të porosituri të ri, efektet, 929
- e dhënë nga disa persona, 932, 934
- vlefshmëria e akte vetë kryera përpara vënies në dijeni, 932, 934
- dispozitat për porosinë zbatohen edhe për komisionin, 944

QIRAJA
- përmbajtja, 801
- afatet (kohëzgjatja), 803
- preferenca për qiramarrësin, 804
- të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit, 802, 805-811
- të drejtat e detyrimet e qiramarrësit, 812-817
- mbarimi, 820
- përsëritja, 821
- marrëdhëniet me të tretët kur kalon kontrata, 822-825

QIRAJA PËR PASURITË E PALUAJTSHME
a. me natyrë bujqësore
- kushtet për vlefshmërinë, 826
- të drejtat e detyrimet e palëve, 827-830, 839-840
- e drejta e kultivimit, 831
- koha dhe shpenëzimet e kultivimit, 833-834
- çështjet e çmimit të qirasë dhe të mënyrës së shlyerjes, 835-838
b. qiraja e sendeve prodhuese
- objekti, 841
- kohëzgjatja, 842
- të drejtat e detyrat e palëve, 843-847
- dispozitë referuese, 848
c. qiraja financiare (leasing) *849*

RENTA JETORE
- përmbajtja, 1065
- në favor të disa personave, 1066-1067
- rasti i pavefshmërisë, 1068
- efektet e kontratës, 1069-1073

SIGURIMI
- përmbajtja, 1113
- forma, 1114-1116
- detyrimi i të siguruarit për të njoftuar sigurimet, 1117
- rrethanat thelbësore që lidhen me rrezikun, pasojat 1117-1119
- për llogari të të tretëve, 1120
- kur është e pavlefshme, 1121
- ç'bëhet kur rreziku pushon,1122

- detyrimi për t'i njoftuar siguruesit të gjitha ndryshimet
  e rrethanave që kanë lidhje me rrezikun, 1123
- primi i sigurimit, 1125
- momenti i hyrjes në fuqi, 1124
- dispozita të tjera të përgjithshme, 1126-1133
- i pasurisë
- kushti i interesit pasuror, 1134-1135
- shuma e sigurimit, madjesia, 1136
- shpërblimi kur humbet ose dëmtohet pasuria, 1137-1139
- sigurimi i mallrave nga rreziqet e transportit, 1147-1149
- dispozita të tjera të përgjithshme, 1140-1148
- i personit
- përmbajtja, 1150
- caktimi i shumës së sigurimit, 1151
- sigurimi i jetës së një të treti, 1152, 1153
- zvëndësimi i personit të caktuar për të marrë shumën
  e sigurimit, mundësia e revokimit, 1154-1157
- dispozita të tjera të përgjithshme, 1158-1161

SIPËRMARRJA
- përmbajtja, 850
- caktimi i çmimit, 851
- sigurimi i materialeve, 852
- të drejtat e detyrimet e sipërmarrësit, 853-859
- të drejtat e detyrimet e porositësit, 860-863
- garancia dhe denoncimi i të metave, 864-867
- zgjidhja dhe pasojat juridike, 868-875
- dispozitë referuese, 876

SPEDICIONI (DËRGESA)
- përmbajtja, 945
- të drejtat e detyrimet e palëve, 946-949

SHITJA
- objekti, 705-707
- shpenzimet për lidhjen, 708
- ndalimet e veçanta, 709
- të drejtat dhe detyrimet e shitësit, 710-729
- dorëzimi i sendeve të shitura, gjendja e tyre, 711, 719
- afati i dorëzimit, 712
- lëshimi i dokumentit, 713-714
- cilësia, sasia, lloji i sendeve e ambalazhimi i tyre, 715
- përgjegjësia për të metat e sendit, 716, 718
- e drejta për të shtyrë afatin e dorëzimit të sendit, 736
- e drejta për të kërkuar zgjidhjen e kontratës, 737
- të drejtat dhe detyrimet e blerësit
- pezullimi i pagimit të çmimit, 721
- kur sendet dorëzohen me të meta, 722-723
- dorëzimi në afat i sendeve si kusht thelbësor i kontratës, 724
- humbja e së drejtës për të zgjidhur kontratën nga blerësi

për sendet e dorëzuara, 725
- blerësi dhe personi i tretë për sendin e shitur, 727-729
- pagimi i çmimit, 730
- vendi i pagimit të çmimit, 731
- koha e pagimit të çmimit, 732-733
- marrja në dorëzim e sendeve, 734-735
- shtimi i afatit të dorëzimit të sendeve nga shitësi, 736
- dispozita të përbashkëta shitës blerës, 740-745
- kushtet e pezullimit të përmbushjes së detyrimeve, 740
- raste të veçanta të zgjidhjes së kontratës, 741-742, 745
- e drejta për të kërkuar kamatat, 743
- shitja me rezervë, 746,749
- shitja e sendeve të paluajtshme, 750-756
- mënyra e kryerjes, 750
- shitja me kusht e sendeve, 751
- përcaktimi i çmimit sipas përmasave dhe madhësisë së sendit, 752-753
- e dy sendeve me një çmim në një kontratë, 754
- parashkrimi i së drejtës së kërkimit të shtesës ose të pakësimit të çmimit, 755
- parashkrimi i padisë për të metat e sendit të paluajtshëm të blerë, 756

SHKËMBIMI
- kuptimi, 757
- të drejtat e detyrimet e palëve, 758-760

SHOQËRIA E THJESHTË
- përmbajtja, 1074
- dallimi me shoqëritë tregtare, 1075
- marrëdhëniet midus anëtarëve, administrimi, 1076-1087
- marrëdhëniet me të tretët, 1088-1093
- shpërndarja e likuidimi, 1094-1105
- zgjatja në heshtje e kontratës, 1095
- marrëdhëniet me një anëtar,
- (tërheqja, vdekja e anëtarit, përjashtimi), 1106-1112

TRANSPORTI
- i personave, përmbajtja, 877
- përgjegjësia e transportuesit, 878-879
- i sendeve, përmbajtja, 880
- momenti i lidhjes, 884
- të drejtat e detyrimet e transportuesit, 881, 885, 888
- fletëshoqërimi i mallit, lëshimi i dublikatës, 883
- të drejtat e detyrimet e dërguesit, 882, 886
- përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin, 889-894
- nga disa transportues, 895-896
- përgjegjësia për vonesën, 897- 898
- përgjegjësia e transportuesit të fundit, 899
- dispozitë referuese, 900

KREDITORËT
- e drejta mbi pjesën në sendin në bashkëpronësi, 205-206
- ekzekutimi i detyrimit ndaj tij, 466
- i pazotë për të vepruar, 468
- të drejtat që rrjedhin nga mosegzekutimi i detyrimit, 476, 478, 480
- vonesa, kuptimi i përmbajtjes, 491
- në vonesë, të drejtat e debitorit, 492, 494-495
- dhe debitori me fajësi të përbashkët në mosekzekutimin e detyrimit, 493
- e të porositurit në kontratën e porosisë, të drejtat e tyre, 919, 926
- kontratat e kalimit të pasurisë 962-972 (shih kontratat e veçanta)

KUFI TOKE
- përcaktimi dhe mirëmbajtja e shenjave, 159

KUJDESTARI
- për pasurinë trashëgimore, emërimi, 344
- detyrat, 345-346
- mbarimi i detyrës, 347
- kushtet për të përfituar nga testamenti, 375

KUSHTI
- veprime juridike, 84-88
- pezullues e zgjidhës, 85
- dhe keqbesimi, 86
- pasojat e vërtetimit, 87-88
- penal si mjet për ekzekutimin e detyrimeve, 541-545
- dhurimi i rënduar me, 768

KUSHT DEKADENCE
- garancia dhe denoncimi, 864
- kushtet që sipërmarrësi të ushtrojë të drejtë, 867

- L -

LAJTHIMI
- dhe rrethanat kur veprimi juridik bëhet i pavleshëm, 97-98, 110, 409

LEGU DHE BARRA
- në testament, 384-391
- e drejta e zgjedhjes, 389

LEGATARI
- e drejta e, 385

- LIBREZË DEPOZITE KURSIMI
- funksionet dhe përgjegjësia e bankës, 1025-1026

LIKUIDIMI
- i personit juridik, 37-38

- kur nuk është parashikuar në kontratë, detyrimet dhe dokumentet, 1097-1099

- LL -

LLOGARIA RRJEDHËSE 1013-1023
- shih kontratat e veçanta,
- me veprimet bankare, 1041-1045

- M-

MARRËDHËNIA ME TË TRETËT
- tagri përgjegjësia, 1088-1093
- përgjegjësia e anëtarit ose trashëgimtarëve ndaj, 1112
- informacioni në policën e sigurimit, 1115
- detyrimi i përsonit që lidh kontratë sigurimi, 1128

MARRËVESHJA
- pavlefshmëria nga një trashëgimi e paçelur, 319
- pavlefshmëria e. 479

MARRJA E UJIT
- servitute detyruese që rrjeshin nga marrja e ujit, 273-276

MASHTRIMI
- kur shkakton pavlefshmëri veprimi juridik, 95, 107, 322, 409

MBAJTËSI
- i sendit në posedim, mbrojtja, 311

MBARIMI
- i personit juridik, 34-36
- i kontratave (shih kontratat)

MBIEMRI
- për personin fizik, 5

MBROJTJA
- e servituteve, 292
- e pronësisë, kërkimi i sendit, 296
- e pronësisë, padia mohuese, 302
- e atëçastme e posedimit, 310
- e posedimit, pushimi i cenimit, 312
- e posedimit, rivendosja, 313
- e posedimit, rregulla të gjykimit, 314-315

(I) MITURI
- deri në katërmbëdhjetë vjeç, statusi juridik, 8
- katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, statusi juridik, 7
- kur fitohet madhoria, 6

MJEDISI
- përgjegjësia për cenim, 624

- N -

NDARJE SENDIT TË PËRBASHKËT
- si kryhet, 1105

NDËRMJETËSIMI 973-981
- shih kontatat e veçanta

NDËRPRERJA
- e parashkrimit, 131
- e parashkrimit, pasojat, 132-135
- e parashkrimit kur prona dominuese në servitut është në bashkëpronësi, 294-295
- e parashkrimit në detyrimet solidare, 433

NDËRTESA
- në bashkëpronësi, shtesë në katin e fundit, 218-220
- në bashkëpronësi, shëmbja pjesore ose tërësore, 221
- objektet e përbashkëta, 209

NDËRTIMI
- përcaktimi i rregullave, 160
- detyrimi i pronarit të tokës, 174-175
- vendimi për shtesë kati, maszbatimi, detyrimet e personave, 218-221
- përgjegjësia për dëmet e shkaktuara, 623

NËNQIRAJA
- edrejta e qiramarrësit për të dhënë, 818
- e drejta e qiradhënësit për të paditur, 819
- qiramarrësi nuk mund të lëshojë sendin, 847

- P -

PAAFTËSIA PAGUESE
- përgjegjësitë e kreditorit që kalon kredinë

PAAFTËSIA PËR TË VEPRUAR
- çon në zgjidhje të kontratës ose tërheqje prej saj, 1023

PADIA
- afati i parashkrimit dhe ngritjes së, 103-104
- shuarja e të drejtës dhe paditë që nuk parashkruhen, 112-113
- kundër vendimeve të asamblesë, 216
- e drejta e pronarit të ngrejë, 296
- për kallzimin e një punimi të ri e të dëmit të mundshëm, 303
- pushim i cedimit të posedimit, 312

- rivendosja në posedim me, 315
- pezullimi i afatit për parashkrim, 335
- e drejta e trashëgimtarit për, 349-351
- kur një testament është i pavlefshëm, 411
- mbrojtja e kreditorit me 548,
- e kthimit, 627
- parashkrimi i padisë kundër prodhuesit, 634
- rrethanat për padinë për begatimin pa shkak, 658
- e drejta e qiradhënësit për të paditur, 819
- kushtet që sipërmarrësi të ushtrojë të drejtën e, 867
- kundër porositësit, 875
- kur hiqet mundësia e, 893
- e drejta e kreditorëve të ngrenë, 964

PADENJËSIA
- në trashëgim, 322-323
- falja, 324

PAGESA
- detyrimet, koha, vendi i, 730-733
- detyrimi i porositësit, 925

PAGESA SHPENZIMESH
- raporte të poseduesit në mirëbesim, keqbesim për, 299-301

PAGIMI I PADETYRUAR 653-654

PARABLERJA
- e drejta, 204

PARADHËNIA BANKARE (kontratë) 1035-1040

PARASHKRIMI
- për veprimet juridike që shpallen të pavlefshme, 103-104
- i së drejtës së padisë, 112, 114
- paditë që nuk parashkruhen, 113
- afatet e shkurtra, 115
- fillimi i afateve, 117-123
- për kërkesat kryesore, pasojat, 124
- dhe kërkesa e palës së interesuar, 125
- heqja dorë, 126
- afati i plotësuar dhe përmbushja e detyrimit, 128
- pezullimi, 129-130
- ndërprerja, 131-135
- llogaritja, 136
- raportet e afatit prekluziv dhe, 137
- fitues për sendet, 168
- fitues njëzet vjeçar, 169
- fitues, pezullimi dhe ndërprerja, 171
- ndërprerja, kur prona dominuese në servitud është

në bashkëpronësi, 294-295
- pezullimi i afatit për parashkrimin e padisë, 335
- padia për kërkimin e trashëgimit nuk, 351
- ndërprerja në detyrimet solidare, 433, 434
- afatet e shuarjes së detyrimit me kompensim, 515
- i padisë për dëmin e shkaktuar nga prodhuesi, 634
- i të drejtave të shitësit dhe blerësit për çmimin, 755
- i padisë për të metat e sendit të paluajshëm të blerë, 756
- përgjegjësia e sipërmarrësit nëse vepra shembet, 866
- marrëdhëniet parakontraktore, 1058
- kur zbatohen dispozitat e këtij kodi për, 1163

(I) PASLINDURI
- si bëhet zëvëndësimi në vijë të drejtë, 327, 329

PASOJA
- fillimi i, 88
- pasoja e pavlefshmërisë së një veprimi, 106-111
- e parashkrimit të padisë për kërkesën kryesore, 124

PASOJA JURIDIKE
- veprimet juridike dhe, 92-93

PAVLEFSHMËRIA
- e veprimit juridik që kufizon zotësinë juridike e zotësinë për të vepruar, 4, 11
- e veprimeve juridike, 92-93
- e veprimeve juridike që shpallen, 94-101
- e shpallur, çasti, 105
- e shpallur, ngritja e padisë, 103-104
- e shpallur, pasojat, 106, 111
- e marrëveshjes që ndryshon afatet e parashkrimit, 116
- e marrëveshjes për një trashëgim ende të paçelur, 319
- e marrëveshjes që kufizon përgjegjësinë për mosekzekutim, 479
- e marrëveshjes që kufizon përgjegjësinë për dëmin, 610
- e marrëveshjes për kalimin e pronësisë në peng ose në hipotekë, 540
- e kontratës për kalimin e pasurisë kreditorit, 963
- e marrëveshjes për përgjegjësinë e hotelierit, 1009
- e kontratës së sigurimit, 1121

PAZOTËSIA PËR TË VEPRUAR
- masa e shkarkimit nga detyrimi në rast, 468
- kur shuhet porosia dhe pasojat, 927-928

PENGU
- përkufizim, 546
- dhe hipoteka, kushtet e vënies, 532-533
- dhe hipoteka, shtrirja e tyre, 534
- humbja ose zhvleftësimi i sendeve, 535-536
- dhe hipoteka janë të papjesëtueshme, 537
- përmbushja e pjesëshme e detyrimit me peng, 539

- rasti i pavlefshmërisë së marrëveshjes, 540
- forma e kontratës, 547
- mbrojtja e kreditorit kur humbet sendi në peng, 548
- të drejtat e detyrimet e palëve, 549-555
- procedura e shitjes, 556-559
- të drejtat e kreditorit ndaj sendit që i nënshtrohet preferimit, 606
- kur banka mund të disponojë mbi sendet, 1035-1039

PERSONI FIZIK
- zotësia juridike, 1
- kufizimi i të drejtave civile, 4
- e drejta për emër e mbiemër, 5
- zotësia për të vepruar, 6
- i mitur, zotësia për të vepruar, 7-9
- madhor, me sëmundje psiqike, 10
- e drejta e banimit, 12-13
- shpallja i zhdukur, 15-16
- shpallja i vdekur, 18-19
- shpallja e vdekjes për disa persona njëherësh, 20
- pasojat e shpalljes si i vdekur dhe e anulimit të shpalljes, 22-23
- që nuk mund të nënshkruaj, 82
- që ka shkaktuar dëm jashtëkontraktor, përgjegjësia (shih dëmi)

PERSONI JURIDIK
- llojet, 24
- publik, 25
- privat, 26
- emri, 27
- qendra, 28
- zotësia për të vepruar, 29-30
- veprimtaria e organeve, 31
- përgjegjësia, 32
- dhe shteti, 33
- mbarimi, 34-36
- likuidimi, 37-38
- shoqata, 41

PEZULLIMI
- i parashkrimit, 129-130
- i parashkrimit në favor të një bashkëpronari, të sendit me servitut, pasojat, 295
- i parashkrimit ndaj njërit debitor ose kreditor solidar, 433/2

PËRFAQËSIMI
- kuptimi, 64
- ligjor, 65
- pasojat juridike, 66
- ndalimet për kryerjen e veprimeve juridike, 67
- nga më shumë se dy përfaqësues, 68
- me prokurë, 70-72

- me prokurë, ndryshimet, 74
- shfuqizimi, 75
- mbarimi, 76
- pas ndryshimeve ose mbarimit të prokurës, 77
- pa tagër, 78
- me keqbesim, 101/2-102
- i familjes bujqësore, 224
- kur zbatohen dispozitat për, 914
- tagri i përfaqësimit në shoqërinë e thjeshtë, 1088, 1089

PËRFAQËSUESI
- përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, 620

PËRTËRITJA
- e detyrimit, 508-510
- e kontratës së qirasë, 821

PJESËTIMI
- i sendeve në bashkëpronësi, (shih bashkëpronësia)
- i trashëgimit, (shih trashëgimi)

POSEDIMI
- kuptimi, 304
- llojet, 303-306
- prezumime, 307-308
- mënyra e fitimit, 309
- mbrojtja e atëçastme, 310
- mbajtës i sendit, 311
- pushimi i cenimit, 312
- rivendosja, 313-314
- rregulla të gjykimit të padisë së posedimit, 315
- e drejta për të ardhurat e sendit, 297-298
- e drejta për shpenzimet, 299-301

POROSIA 913-934
- shih kontratat e veçanta

PREFERIMET (PRIVILEGJET)
- përmbajtja 603
- konkurrimi i kredive, 604
- radha, 605
- e drejta e kreditorit për të mbajtur sendin, 606
- ndaj kredive që rrjedhin nga depozita, 997
- ndaj kredive të hotelierit, 1012

PREKLUZIVITETI
- kuptimi, 137-140

PREZUMIMI
- mbi posedimin, 307-308

- person që ka zotësi për të trashëguar, 320-321
- afati për deklarimin e heqjes dorë nga trashëgimia, 336
- rrethanat kur prezumohet pagesa për shlyerje detyrimi, 474

PRINDI
- përgjegjësia për të miturit, 613-614

PRODUKTI
- kuptimi, 631
- përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, 628
- përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga fajësia e përbashkët, 629
- me të meta, 630
- përgjegjësia e përbashkët e disa prodhuesve, 633
- padia për shpërblimin e dëmit nga produktet, 634
- përgënjeshtrimi publik, 637

PRODHUESI
- përkufizimi, 631
- mosidentifikimi, 632
- përgjegjësia, 628
- përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga fajësia e përbashkët, 629
- përgjegjësia e disa prodhuesve, 633
- përgjegjësia nga publikimi mashtrues i prodhuesve, 625, 636
- përgjegjësia nga konkurrenca e pandershme, 638-639

PROKURA 70
- e përgjithshme dhe ajo e posaçme, 71
- forma, 72/1
- në emër të personave juridikë, 72/2
- për tërheqjen e dërgesave postare, parave etj., 73
- ndryshimet duhen të bëhen të njohura, 74
- shfuqizimi, 75
- mbarimi, 76-77

PRONARI
- të drejtat e detyrimet, kufizimet, 153
- shtrirja e të drejtave mbi tokën, 154
- të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga fqinjësia, 155-161
- i pronës shërbyese në servitud, 263
- i pronës në favor të së cilës vihet servitudi, 264

PRONËSIA
- përmbajtja, 149
- mbi pjesët e sendit, 150
- mbi frutat e sendit, 151
- të drejtat e detyrimet e pronarit, kufizimi, 153
- mbi tokën, shtrirja e së drejtës, 154
- të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga fqinjësia, 155-161
- e të drejtat e tjera reale janë të transferueshme, 162
- fitimi me anë kontrate, 164

- fitimi me trashëgim, 165
- fitimi mbi sendet e luajtshme me mirëbesim, 166-167
- fitimi me parashkrim fitues, 168
- fitimi për sendet e paluajtshme me afat parashkrimi 20-vjeçar, 169
- regjistrimi për sendet e paluajtshme të fituara me parashkrim fitues, 170
- mbi sendet pa zot, 172
- fitimi me bashkim e përzierje, 173, 176
- fitimi me përpunim, 177
- fitimi nga mbushja e tokave, ndërrimi i shtrateve të lumenjëve, krijimi i ishujve, etj., 178-181
- fitimi nga sendet e humbura ose të gjetura, 182-186
- mbi thesarin, 186
- e shtetit mbi një kategori sendesh të luajtshme, 187
- fitimi me anë pushtimi, 188
- mbi tufën e bletëve, 189
- fitimi me anë shpronësimi, 190
- humbja, 191
- e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, regjistrimi, 192-194, 197
- e paluajtshme nuk mund të tjetërsohet pa u regjistruar, 195
- mbrojtja, kërkimi i sendit, 296
- mbrojtja, padia mohuese, 302
- mbrojtja, kallëzimi i një punimi të ri dhe dëmit të mundshëm, 303

PUBLIKIMET MASHTRUESE OSE TË PASAKTA
- përgënjeshtrim, 617
- kuptimi dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, 635-637

PUNËDHËNËSI
- përgjegjësia për dëmin nga faji i punonjësve, 618-619

- Q -

QËNDRIMI (VENDQËNDRIMI)
- i personit fizik, 14

QIRAJA
- kur regjistrohet kjo kontratë, 197
- e uzufruktit, 244
- e sendeve, 821-825 (shih kontratat e veçanta)

- R -

REGJISTRIMI
- i pasurive të paluajtshme dhe i të drejtave reale mbi to, 192-194
- pamundësia e tjetërsimit, për pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, 195
- i kontratave të qirasë dhe i disa kërkesë padive, 197
- administrimi nga Ministria e Drejtësisë, 198
- i uzufruktit mbi një pasuri të paluajtshme, 235/2

RENTA JETORE 1065-1073
- shih kontratat e veçanta

REVOKIMI
- kur dhuruesi kërkon, 771
- i kontratës së porosisë dhe efektet, 928
- kur dërguesi mund të revokojë urdhërin e dërgesës, 946
- kush mund të revokojë personin që merr shumën e sigurimit, 1155

REZERVA LIGJORE
- në testament, 379-380

RIVENDIKIMI
- i pasurisë, 918
- detyrimi i depozitëmarrësit, 995

- S -

SENDI
- kuptimi, 141
- llojet, 142, 143
- regjistrimi, 144
- frutat, llojet e frutave, pronësia mbi to, 145
- pjesët përbërëse e pronësia mbi to, 146, 150
- aksesorët, 147-148
- kryesor, disponimi i tij e pasojat, 148
- përkatësia, 152
- pa zot, 172
- i humbur ose i gjetur, fitimi i pronësisë, 182-185
- i luajtshëm, kategori e veçantë në pronësi të shtetit, 187
- i luajtshëm dhe disa të drejta reale mbi të, regjistrimi, 192, 197
- në bashkëpronësi, 199/1
- në bashkëpronësi në pjesë, 199/2
- në bashkëpronësi, të drejtat e detyrimet, 200-201
- në bashkëpronësi, administrimi, 203
- në bashkëpronësi, parablerja, 204
- e drejta e kreditorit mbi pjesën, 205-206
- në pjesë- pjesëtimi, 207
- i përbashkët, tjetërsimi, 208
- në bashkëpronësi të detyrueshme, 209
- madhësia e pjesës takuese, 210/1
- pasojat e heqjes dorë nga kjo e drejtë, 210/2
- pandashmëria, 211
- administrimi, 213-216
- detyrimet e bashkëpronarëve, 217
- shtesat në katin e fundit, 218-220
- shëmbja pjesore ose tërësore, 221
- në bashkëpronësi në familjen bujqësore, 222
- kushtet për tjetërsimin e pjesës, 226
- pjesëtimi, 227-228

- në bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve, 231
- në uzufrukt, (shih uzufruktin), 232
- mbrojtja e pronësisë, 296, 302-303
- lirimi nga garancitë e vëna mbi të, 475

SERVITUTI
- kuptimi, 261
- krijimi, 262
- detyrimet e pronarit të pronës shërbyese e dominuese, 263-264
- servitutet detyruese, kuptimi dhe mënyrar e krijimit, 265
- rrjedhja e ujërave, 267-271
- nga ndërtimet, 272
- marrja e ujit, 273-276
- i kalimit, 277-279
- vendosja e gypave, kabllove e telave, 280
- servitutet vullnetare
- kuptimi, mënyra e krijimit, 281
- vijuese e jovijuese, 282
- të dukshme e të padukshme, mënyrat e krijimit, 282/3-283
- kur tjetërsohen pronat mbi të cilat janë vendosur, 284
- mënyra e ushtrimit
- gjerësia e ushtrimit të së drejtës, 285, 288-289, 291
- pëlqimi i bashkëpronarëve për krijimin, 287
- pasojat, kur pjesëtohet prona, 290
- mbrojtja, 292
- shuarja, 293

SKONTOJA BANKARE
- shih kontratat e veçanta

SIGURIMI
- i uzufruktit nga rreziqet, 252
- gjyqësor i pasurisë trashëgimore (inventaret), 343-347
- i pasurisë e i personit, (shih kontratat e veçanta)

SPEDICIONI 945-949
- shih kontratat e veçanta

- SH -

SHËRBIMI BANKAR 1028-1030
- kontratat, (shih kontratat e veçanta)

SHITJA 705-756
- kuptimi i kontratës 705-708
- kufizime e detyrime 709-745
- me rezervë e pronës 746-749
- e sendeve të paluajtshme 750-756

SHKËMBIMI 757-760
- shih kontratat e veçanta

SHOQATAT
- përkufizimi, 39
- të drejtat, 39/1
- mënyra e krijimit, 40,41
- regjistrimi në gjykatë, 41
- si person juridik, 42
- degët e saj, 43
- organizimi, 44-47
- vendimmarrja, 46
- anëtarësia, 48
- anëtarësia nuk tjetërsohet, 49
- detyrimet e të larguarit ose të përjashtuarit, 50
- kundërshtimi i vendimeve, 51
- rastet e shpërndarjes, 52
- likuidimi e çrregjistrimi, 53
- destinimi i pasurisë pas shpërndarjes 53/1

SHOQËRIA E THJESHTË 1074-1112
- shih kontratat e veçanta

SHPENZIMET
- e bashkëpronarit për sendin e përbashkët, 201
- e mirëmbajtjes për sendin në uzufrukt, 251
- të drejtat e poseduesit (me mirëbesim e keqbesim), 299-301
- për ekzekutimet e detyrimit, dëftesa, 472-474
- për lidhjen e kontratës së shitjes, 708

SHPËRBLIMI
- për përdorimin e sendit të përbashkët, 202
- i dëmit, kuptimi, 640
- i dëmit në shëndetin e personit, 641
- ndryshimi i masës, 642
- kur shkaktohet vdekja e personit, 643
- i dëmit kur dëmtuesi ka pasur përfitime, 644
- i dëmit të të dëmtuarit të siguruar, 645
- i dëmit të të dëmtuarit të pasiguruar, 646
- i dëmit shkaktuar të miturit, 647

SHPRONËSIMI
- si mënyrë fitimi e pronësisë, 190
- i sendeve në uzufrukt, 253

SHTESA
- mbi katin e fundit, 218-220

SHTETI
- dhe personi juridik, përgjegjësia, 33

- pronësia mbi një kategori sendesh të luajtshme, 187
- e thirrjes në trashëgimi, 366

SHUARJA
- e detyrimit, 508-510, 513-514, 524, 526-528
- e të drejtës, 634
- e pronësisë, 927, 933-934
- e servitutit, 293

- T -

TAGER-TAGRET
- e përfaqësimit, 65-66
- përfaqësimi pa, 78
- e ekzekutorit testamendar, 471

TAKSA
- për sendin në uzufrukt, 254

TESTAMENTI
- kuptimi, 372
- zotësia për të disponuar, 373
- zotësia për të fituar me, 374
- përfitimi i kujdestarit dhe pengesat ligjore, 375
- disponimi në favor të të pazotëve, 376
- caktimi i trashëgimtarit, 377
- përjashtimi, 378
- rezerva ligjore, 379-380
- zëvëndësimi, 381
- e drejta e shtimit, 382-383
- legu e barra, 384-391
- e drejta e zgjedhjes për legun, 389
- format, 392
- ollograf, 393-396
- me akt noterial, 397
- të posaçme, 398-401
- revokimi, 402
- i pavlefshëm, 403-409
- i pavlefshëm, pasojat juridike, 410, 412
- padia për deklarimin e pavlefshëm, afati, 411
- caktimi i ekzekutorit, 414
- ekzekutimi ku nuk është caktuar ekzekutori, 414/3
- detyrat e ekzekutorit, 415
- shkarkimi i ekzekutorit, 416
- përgjegjësia solidare e ekzekutorëve, 418

TRASHËGIMI
- kuptimi, 316
- me ligj, zbatimi, 317
- koha e çeljes, 318-319

- vendi i çeljes 318/1
- padenjësia, 322-323
- falja e padenjësisë, 324
- zëvëndësimi, 326-329
- fitimi, 330-331
- heqja dorë, mënyra si bëhet dhe pasojat, 333-334
- afati për heqje dorë, 335-336
- heqja dorë, pavlefshmëria, 337
- pengesat për heqjen dorë, 338-339
- masat për sigurimin, 343-347
- lëshimi i dëshmisë, 348
- padia për kërkimin, 349, 352
- e drejta për të kërkuar pjesëtimin, 353
- pjesëtimi me marrëveshje ose me vendim gjykate, 354
- rregullat që zbatohen në pjesëtim, 355-357
- pjesa e bashkëshortit, 358
- në familjen bujqësore, 359
- i fëmijëve jashtë martese dhe të birësuar, 362
- i radhës së dytë, 363
-i radhës së tretë, 364
-i të afërmve deri në shkallë të gjashtë, 365,
- i shtetit, 366
- sipas rradhëve, 369
- e drejta e shtimit, 368
- me testament, (shih testament)

TRASHËGIMTARI
- zotësia për të trashëguar, 320-321
- i padenjë, 322-323
- i padenjë, falja, 324
- i padenjë, detyrimet, 325
- që zëvëndësohet, 326-329
- që ka hequr dorë, pasojat, 334
- pagimi i detyrimeve, 341-342
- bashkëshorti pasjetues e pasuria e përbashkët, 358
- në familjen bujqësore, kalimi i pjesës së trashëgimtarit që vdes, 359
- ligjor, rrethi, 360
- ligjor, i rradhës së parë, 361
- me zëvendësim, 361/2
- i birësuari si trashëgimtar, 362/2
- fëmija jashtë martese si trashëgimtar, 362/1
- ligjor i rradhës së dytë, 363
- ligjor i rradhës së tretë, 364
- të tjerë, 365
- shteti si trashëgimtar, 366
- thirrja sipas rradhës, 369
- i paaftë për punë, 371
- caktimi me anë testamenti, 377
- me testament, përjashtimi, 378
- ndalesat nga përjashtimi, (rezerva ligjore) 379-380

- me anë zëvendësimi, 381
- shtimi i pjesës(e drejta e shtimit), 381-382
- legu dhe barra, 384-391
- e drejta e zgjedhjes së legut, 389

TRANSPORTI
- i personave, përmbajtja e kontratës, 877
- i personave, përgjegjësia, 878-879
- i sendeve, përmbajtja e kontratës, 880
- të drejtat e detyrimet, 881, 885, 888
- përgjegjësia, 889-894
- përgjegjësia për vonesën, 897-898
- i fundit, përgjegjësia, 899

- TH -

THESARI 186

- U -

UJËRAT
- krijimi i servituteve nga rrjedhja e ujërave, 266-271
- krijimi i servituteve nga marrja e ujërave, 273-276

UZUFRUKTI
- përmbajtja e mënyra e krijimit, 232-233
- kohëzgjatja, 234
- forma për krijimin, 235
- në favor të disa personave (bashkëuzufrukti), 236
- kufijtë e gëzimit, 237
- përmirësimet e bëra sendit, 238
- përkatësia e frutave të sendit, 239
- kalimi i së drejtës, 240
- e drejta e tjetërsimit, 241
- zëvendësimi, 242
- investimet e kryera mbi të, 243
- dhënia me qira, 244
- kufijtë e gëzimit të servituteve, 245
- zëvendësimi i dëmeve, 246
- marrja në dorëzim e inventarit, 247-248
- dhënia e garancisë, 249-250
- shpenzimet e mirëmbajtjes, 251
- sigurimi nga rreziqet, 252
- pasojat e shpronësimit, 253
- pagimi i taksave, 254

- V -

VDEKJA
- shpallja, 17-19, 21
- e më shumë se e dy personave, 20
- pasojat juridike të shpalljes, 22-23
- e njëkohëshme e personave të thirrur në trashëgim, 321
- dëmi që shpërblehet, 643
- shuhet dhurimi që ka për objekt detyrimet periodike, 763
- vihet kushti i kthimit të sendit të dhuruar, 767
- zgjidhja e kontratës me vdekjen e sipërmarrësit, detyrimet 873-874
- kthimi i sendit me vdekjen e huamarrësit, 908
- shuhet porosia dhe pasojat, dhe heqja dorë nga kontata e porosisë, 927-928
- zgjidhja e kontratës, 1023
- hapja e kasetës së sigurimit pas, 1029
- rritja e pjesës së një përftuesi të, 1067
- pavlefshmëria e kontratës së rentës jetore kur, 1068
- rastet kur njëri nga anëtarët e shoqërisë, 1107
- kur siguruesi është përgjegjës për, 1131
- pagimi i shumës së sigurimit në rast, 1153
- kur shuma e sigurimit nuk përfitohet nga personi i caktuar, 1157
- procedura kur shumën e sigurimit e përftojnë disa persona, 1158

VENDI
- i çeljes së trashëgimit, 318
- i ekzekutimit të detyruar, 461

VEPRIMI JURIDIK
- përkufizimi, 79
- nënshkrimi, 80, 81
- nënshkrimi nga personi që nuk di shkrim, 82
- për kalimin e pronësisë të sendeve të paluajtshme, 83/1
- pavlefshmëria kur mungon forma, 83/II
- me kusht, 84
- me kusht pezullues ose zgjedhës, 85
- me kusht dhe keqbesim, 86
- pasojat juridike, 87-88
- në afat, 89
- afati pezullues, 90/1
- afati zgjidhës, 90/2
- llogaritja e afateve, 91
- i pavlefshëm, 92-93
- që shpallet i pavlefshëm, 94-101
- që shpallet i pavlefshëm, afati, 103-104
- pasojat e pavlefshmërisë, 106
- pasojat nga shpallja i pavlefshëm, 107-110
- pjesërisht i pavlefshëm, pasojat, 111
- mënyra e krijimit të uzufruktit, 233
- mënyra e fitimit të posedimit me, 309

- përkufizimi i testamentit si, 372
- përmbajtja e dorëzanisë, 585
- të kryera nga debitori, kundërshtimi nga kreditori, 607
- të kryer nga gjeruesi në emër të personit të interesuar, 650
- përmbajtja e kontratës, 659
- përmbajtja e kontratës së porosisë, 913

VËRTETIMI
- kur kushti quhet i, 86
- të drejtës së zhdëmtimit, 87
- fillimi i pasojave lidhur me vërtetitmin e kushtit, 88

VESI
- rrethanat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, 100

VONESA
- e debitorit, përmbajtja, 481
- e debitorit dhe pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit, 482
- e debitorit dhe detyrimet që përmbajnë mosveprime, 483
- e debitorit dhe oferta për kreditorin, 484
- e debitorit, pasojat e tjera, 486-489
- e kreditorit, përkufizimi, 491
- e kreditorit, të drejtat e debitorit, 492, 494-495
- e kreditorit dhe e debitorit, pasojat, 493
- në pagim e komisionerit, 936

- Z -

ZËVENDËSIMI
- e drejta, kryerja në vijë të drejtë e të tërthortë, 326-329
- i trashëgimtarit, 381
- i debitorit, 496-498
- i kreditorit, 499

ZGJIDHJA E KONTRATËS
- pasojat, rrethanat, njoftimi, parashkrimi, efektet, 698-704
- humbja e të drejtës për shpallje, pasojat rrethanat, 724-737
- rrethanat kur njëra palë mund të zgjidhë kontratë shitjeje, 741-742
- kur mospagimi i kështit nuk sjell, pasojat e, 748-749
- kur palët kanë të drejtë të kërkojnë, 777
- së enfiteozës, 791
- rrethanat kur qiramarrësi kërkon, 806, 839, 844
- rregullimi i raportit kontraktor të ndryshuar me ligj, 846
- kur sipërmarrësi ka të drejtë, 859
- kur porositësi ka të drejtë të, 865, 868-874
- kur huadhënësi mund të kërkojë, 907
- detyrimet e huamarrësit kur, 912
- së porosisë dhe efektet juridike, 928-932
- së agjencisë me afat të pacaktuar, 958

- kufizimi i konkurrencës së agjentit pas, 960
- së kalimit të pasurisë, 971
- shkaku i, 972
- kushtet që çojnë në dhe efektet, 1023
- kur banka mund të, 1034
- kushtet kur palët mund të zgjidhin kontratën franchising, 1060
- kur pala heq dorë nga kontrata para afatit, 1064
- kur personi në dobi të të cilit krijohet renta jetore kërkon, 1069
- efektet e mospagimit të këste ve të rentës jetore, 1070
- e drejta e një anëtari të shoqërisë së thjeshtë, 1106,1112
- e sigurimit, 1122-1123
- kur kontrata e sigurimit të pasurisë quhet e, 1135, 1144

ZOTËSIA
- për të trashëguar, 320-321
- për të disponuar me testament, 373
- për të fituar me testament, 374

ZOTËSIA JURIDIKE
- e personit fizik, 1
- fillimi, 2
- fëmijës, 2
- e të huajve, 3
- kufizimi dhe pavlefshmëria e veprimit juridik, 4

ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR
- e personit fizik, 6
- e të miturve, 7-9
- e personit madhor, kufizimi, 10
- pavlefshmëria e veprimit juridik dhe që kufizon zotësinë për të vepruar, 11
- personit juridik, 29-30

FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BOTIM I KUVENDIT POPULLOR

Nr.11	1994	Gusht

PËRMBAJTJA

Ligj nr.7850 datë 29.7.1994 — ***KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (1)***

LIGJ
Nr.7850, datë 29.7.1994

PËR KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I
SUBJEKTET E SË DREJTËS CIVILE

KREU I
PERSONAT FIZIKË

A. ZOTËSIA JURIDIKE

Neni 1

Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

Neni 2

Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies.

Neni 3

Të huajt gëzojnë po ato të drejta e detyrime që u njihen shtetasve shqiptarë, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.

Neni 4

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.
Veprimi juridik që kufizon zotësinë juridike të një personi fizik, është i pavlefshëm.

B. E DREJTA E EMRIT

Neni 5

Çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit. Personi, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cënohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë

padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe nga persona që, ndonëse nuk mbajnë emrin ose mbiemrin e cenuar, apo të përdorur padrejtësisht, kanë interesa familjare të denja për t' u mbrojtur.

Gjykata kur pranon padinë urdhëron botimin e vendimit në Fletoren Zyrtare. Me kërkesën e paditësit gjykata mund të urdhërojë botimin e vendimit të saj edhe në gazeta të tjera. Pseudonimi i përdorur nga personi fizik gëzon të njëjtën mbrojtje.

C. ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR

Neni 6

Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Neni 7

I mituri, që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita.

Neni 8

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor.

Neni 9

Të miturit me moshë katërmbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetëvjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psiqike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 10

Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psiqike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.

Neni 11

Veprimi juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

Ç. BANIMI DHE QËNDRIMI

Neni 12

Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit.

Neni 13

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij.

Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërmbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton.

Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 14

Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

D. SHPALLJA E ZHDUKJES DHE E VDEKJES SË NJË PERSONI

Neni 15

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës.

Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm.

Neni 16

Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar.

Vendimi i gjykatës, me të cilin një person është shpallur i zhdukur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 17

Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.

Neni 18

Personi që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se kanë kaluar pa patur lajme dy vjet, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes

ose tre vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur.

Neni 19

Personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur.

Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dy vjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasëm.

Neni 20

Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë.

Neni 21

Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi.

Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.

Neni 22

Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë.

Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 23

Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi prishet nga gjykata që e ka dhënë.

Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes.

KREU II
PERSONAT JURIDIKË

A. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e personit juridik

Neni 24

Personat juridikë janë publikë dhe privatë.

Neni 25

Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik.

Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen.

Neni 26

Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Emri i personit juridik

Neni 27

Personi juridik ka emrin e tij të plotë dhe të shkurtuar. Emri i çdo shoqërie ose organizate tjetër që zhvillon veprimtari ekonomike është firma e saj, e cila duhet të shprehë sidomos qëllimin e kësaj veprimtarie.

Qendra e personit juridik

Neni 28

Personi juridik ka qendrën atje ku ndodhet organi drejtues i tij, përveç kur në statut ose në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Zotësia e personit juridik

Neni 29

Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i krijimit të tij dhe, kur ligji parashikon se duhet të regjistrohet, që nga çasti i regjistrimit.

Neni 30

Personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit ose në statut.

Neni 31

Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.

Përgjegjësia e personit juridik

Neni 32

Personi juridik është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Personi juridik përgjigjet për detyrimet e tij brenda kufijve të pasurisë së tij. Personat që kanë vepruar me cilësinë e organit të personit juridik, kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre.

Neni 33

Shteti dhe personat juridikë shtetërorë nuk përgjigjen për detyrimet e njëri-tjetrit, përveç kur kjo është pranuar prej tyre ose është parashikuar shprehimisht në ligj.

Mbarimi i personit juridik

Neni 34

Personi juridik mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut ose në ligj.

Neni 35

Me mbarimin, personi juridik pushon veprimtarinë e tij dhe vihet në likuidim.

Neni 36

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve në rast mbarimi të personit juridik, për të cilin kërkohet regjistrimi, sjell pasoja nga koha e regjistrimit.

Kur nuk kërkohet regjistrimi, kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve në rastet e parashikuara nga paragrafi i mësipërm, sjell pasoja nga koha e miratimit të bilancit përkatës, në mënyrën që parashikohet në ligj, nga organi përkatës që e ka krijuar ose në statut.

Likuidimi i personit juridik

Neni 37

Likuidimi i personit juridik që ka mbaruar bëhet me realizimin e të drejtave dhe pagimin e detyrimeve nga likuidatorë të caktuar nga organi që ka vendosur mbarimin e tij.

Komisioni bën likuidimin sipas dispozitave ligjore përkatëse, statutit ose aktit të themelimit.

Neni 38

Kur personi juridik mbaron për shkak se ka zhvilluar veprimtari të kundërligjshme, pasuria e mbetur pas likuidimit i kalon shtetit.

Likuidimi i personit juridik që falimenton rregullohet me ligj.

B. SHOQATAT

Krijimi i shoqatave

Neni 39

Shoqatat janë organizata shoqërore që ndjekin një qëllim politik, shkencor, kulturor, sportiv, fetar, bamirës ose ndonjë qëllim tjetër joekonomik.

Neni 40

Vullneti i anëtarëve për krijimin e shoqatës përcaktohet në statutin përkatës, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:

a) emrin dhe qëllimin e shoqatës, qendrën e saj dhe territorin në të cilin do të zhvillojë veprimtarinë e vet;

b) kushtet e pranimit dhe të largimit të anëtarëve, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre;

c) organet drejtuese të shoqatës, mënyrën e formimit dhe kompetencat e tyre;
ç) afatet, mënyrën e thirrjes dhe kompetencat e mbledhjeve të përgjithshme dhe të delegatëve;
d) burimin e mjeteve materiale të saj, si dhe kontributet apo kuotat që duhet të japë çdo anëtar;
dh) mënyrën e ndryshimit të statutit dhe të mbarimit të shoqatës.

Neni 41

Pasi mbledhja e themeluesve të ketë miratuar statutin dhe formuar organin drejtues të saj, duhet të paraqitet kërkesa për regjistrimin e shoqatës në gjykatën e rrethit ku ka qendrën e veprimtarisë së saj.
Gjykata kontrollon pajtueshmërinë e statutit me ligjin.

Neni 42

Shoqata njihet si person juridik që nga dita kur gjykata kompetente e ka miratuar atë dhe e ka regjistruar. Deri në këtë datë themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë sidomos thirrja dhe zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese.

Neni 43

Shoqata mund të ketë degë të veta në ato rrethe, qytete e komuna ku ka numrin e anëtarëve të parashikuar në statutin e saj.

Organizimi i shoqatës

Neni 44

Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve ose e përfaqësuesve të tyre, është organi më i lartë i shoqatës.
Ajo thirret nga organi drejtues, sipas dispozitave përkatëse të statutit, si dhe kur e kërkon një e pesta e anëtarëve.

Neni 45

Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e anëtarëve dhe për çdo çështje tjetër, që nuk është lënë në kompetencën e ndonjë organi tjetër të shoqatës.
Ajo ushtron posaçërisht mbikëqyrjen mbi të ardhurat dhe veprimet e shoqatës, si dhe mbi objektet pasurore të saj.

Neni 46

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë vote të barabartë në mbledhjen e përgjithshme.
Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje. Për ndryshimin e statutit, për përjashtimin e një anëtari dhe për shpërndarjen e shoqatës, kur nuk është parashikuar ndryshe, duhet të jenë të pranishëm të paktën 3/4 e anëtarëve.

Neni 47

Organi drejtues ka të drejtën dhe detyrën të kujdeset për interesat e shoqatës, t'i mbrojë ato, si dhe të përfaqësojë shoqatën sipas kompetencave që i janë dhënë nga statuti.

Antarësia në shoqatë
Neni 48

Pranimi i anëtarëve të rinj, që përmbushin kushtet e nevojshme, mund të lejohet në çdo kohë.
E drejta për të dhënë dorëheqjen është e garantuar, por me kusht që të jetë paraqitur së paku gjashtë muaj para mbarimit të vitit kalendarik ose brenda afatit të parashikuar në statut.

Neni 49

E drejta e anëtarësisë në shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë trashëgimie.

Neni 50

Anëtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose që janë përjashtuar nga shoqata, nuk kanë të drejtë në kapitalin apo pasurinë themelore të shoqatës.
Ata kanë detyrën të derdhin kuotat për kohën gjatë së cilës kanë bërë pjesë në shoqatë.

Neni 51

Çdo anëtar ka të drejtë të kundërshtojë në gjykatën kompetente vendimet e shoqatës që vijnë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.
Ky kundërshtim mund të bëhet brenda një muaji nga dita kur anëtari ka marrë njoftimin për atë vendim.

Shpërndarja
Neni 52

Shpërndarja e shoqatës bëhet:
a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur posaçërisht;
b) kur numri i anëtarëve të saj ka mbërritur nën numrin e caktuar në statut, ose kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet;
c) kur ajo ka humbur aftësinë paguese;
ç) me vendim të gjykatës kompetente kur shoqata është larguar nga qëllimi i caktuar në statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjshme.

Neni 53

Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo çregjistrohet, pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit, i cili formohet dhe vepron sipas rregullave përkatëse në fuqi.

C. FONDACIONET

Mënyra e krijimit
Neni 54

Fondacioni krijohet për arritjen e një qëllimi të posaçëm me dobi shoqërore. Fondacionet krijohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj. Ato krijohen me akt publik ose me testament.

Neni 55

Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesën e themeluesve, regjistrohet në gjykatën e rrethit, ku fondacioni ka q,ndrën e vet.

Në aktin e krijimit përcaktohen sidomos emrat e themeluesve, qëllimi i fondacionit, përbërësit e pasurisë (para, letra me vlerë, ose sende të luajtshme dhe të paluajtshme), burimet dhe mënyra e financimit, organet drejtuese, kompetencat e tyre, si dhe emrat e anëtarëve të administratës.

Neni 56

Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga data e regjistrimit të tij. Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse.

Neni 57

Akti për krijimin e fondacionit mund të shfuqizohet nga themeluesit para regjistrimit ose kur ende nuk ka filluar veprimtarinë përkatëse.

Akti i krijimit të fondacionit mund të kundërshtohet nga trashëgimtarët ose nga kreditorët e themeluesit.

Ushtrimi i veprimtarisë të fondacionit

Neni 58

Organet e fondacionit, mënyra e formimit dhe kompetencat e tyre caktohen nga akti i krijimit.

Çdo fondacion kryen veprimtarinë e vet në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe të aktit të themelimit të tij.

Neni 59

Fondacionet mbikqyren nga institucionet shtetërore me të cilët lidhet drejtpërdrejt qëllimi i veprimtarisë së tyre.

Këto institucione mbikqyrin posaçërisht që fondet monetare dhe pasuritë e tjera të fondacionit të përdoren në përputhje me qëllimin e tij.

Neni 60

Drejtuesi i institucionit mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë nga gjykata kompetente anulimin e vendimit të organit të fondacionit kur vjen në kundërshtim të hapur me qëllimin përkatës, me dispozitat ligjore apo me aktin e krijimit.

Gjykata mund të pezullojë zbatimin e këtij vendimi deri në dhënien e vendimit përfundimtar të saj.

Neni 61

Mosmarrëveshjet pasurore, në të cilat fondacioni është palë, zgjidhen nga gjykata kompetente.

Neni 62

Fondacioni shpërndahet:

a) në bazë të ligjit, kur është përmbushur qëllimi për të cilin u krijua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;

b) me vendim të gjykatës kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të paligjshme ose jo morale.

Shpërndarja e fondacionit mund të kërkohet nga drejtuesi i institucionit mbikqyrës ose nga çdo subjekt i interesuar.

Neni 63

Për pasuritë që mbeten pas shpërndarjes së fondacionit, me kërkesën e drejtuesit të institucionit mbikqyrës ose të çdo personi të interesuar, gjykata vendos duke patur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është krijuar fondacioni.

TITULLI II
PËRFAQËSIMI

KREU I
KUPTIMI DHE LLOJET E PËRFAQËSIMIT

Kuptimi i përfaqësimit

Neni 64

Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuari).

Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi.

Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.

Kufijtë dhe pasojat e përfaqësimit

Neni 65

Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë.

Tagret e përfaqësuesit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse.

Neni 66

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda tagreve që i janë dhënë, krijojnë pasoja drejtëpërdrejt për të përfaqësuarin.

Neni 67

Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuari e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij.

Neni 68

Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe.

Neni 69

Përfaqësuesi detyrohet të veprojë personalisht dhe nuk mund të emërojë zëvendës të tij, përveç kur është lejuar nga i përfaqësuari, kur pasuria që përmendet në prokurë ndodhet jashtë territorit të rrethit ku banon përfaqësuesi, si dhe kur caktimi i zëvendësit çmohet i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit.

Përfaqësuesi duhet të njoftojë menjëherë të përfaqësuarin për zëvendësin që ka caktuar, përndryshe ai përgjigjet për veprimet e zëvendësit.

Zëvendësi mund të hiqet në çdo kohë nga i përfaqësuari ose nga përfaqësuesi që e ka caktuar.

Përfaqësimi me prokurë

Neni 70

Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.

Neni 71

Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht.

Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.

Neni 72

Prokura bëhet gjithmonë me shkresë.

Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë.

Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mud të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial.

Neni 73

Prokura për të tërhequr dërgesa postare ose para nga zyrat postare apo nga bankat deri në një shumë të caktuar prej tyre, prokura për të terhequr paga dhe shpërblime të tjera që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, si dhe prokura për të tërhequr pensione, ndihma e bursa, mund të vërtetohen edhe nga:

a) administratori i lagjes së qytetit ose kryeplaku i fshatit;

b) drejtuesi i personit juridik apo i degës së tij, ku i përfaqësuari është në marrëdhënie pune ose ndjek shkollën;

c) drejtuesi i institucionit shëndetësor ku i përfaqësuari është shtruar për mjekim;

ç) komanda e repartit ushtarak ku shërben i përfaqësuari;

d) drejtuesi i institucionit ku i përfaqësuari mbahet i arrestuar ose vuan dënimin me heqje të lirisë.

Neni 74

Ndryshimet në prokurë duhet t'u bëhen të njohura të tretëve me mjete të përshtatshme. Në mungesë të njoftimeve të tilla, këto ndryshime nuk mund t'u kundrejtohen të tretëve, përveç kur provohet që këta i dinin ndryshimet në prokurë në kohën kur është kryer veprimi juridik.

Neni 75

I përfaqësuari mund të shfuqizojë prokurën dhe përfaqësuesi të heqë dorë prej saj në çdo kohë. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Mbarimi i prokurës

Neni 76

Prokura mbaron kur:

a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë;

b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë;

c) kur ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar;

ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar;

d) kur i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës perfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës.

Përfaqësimi pas ndryshimeve ose mbarimit të prokurës

Neni 77

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, pas ndryshimeve të bëra në prokurë ose pas mbarimit të saj, janë të detyrueshme për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e tij, në rast se personat e tretë, me të cilët janë kryer ato veprime juridike, nuk kanë patur dijeni për ndryshimet ose për mbarimin e prokurës.

Përfaqësimi pa tagre

Neni 78

Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e patur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagret që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë.

Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi.

TITULLI III
VEPRIMET JURIDIKE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përkufizimi i veprimit juridik

Neni 79

Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.

Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.

Format e veprimit juridik

Neni 80

Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.

Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial.

Neni 81

Veprimi juridik me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.

Neni 82

Personi që nuk di, ose që për shkak sëmundje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, ngarkon një person tjetër për këtë qëllim.

Nënshkrimi i këtij personi duhet të vërtetohet nga noteri, duke u treguar shkaku për të cilin personi që ka kryer veprimin juridik nuk ka mundur ta nënshkruajë vetë.

Për veprimet që kryhen në bankat dhe në institucionet e tjera të kreditit, në zyrat postare apo doganore, nënshkrimi i këtij personi vërtetohet nga një nëpunës i autorizuar i këtyre nstitucioneve.

Neni 83

Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.

Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë.

Veprimet juridike me kusht

Neni 84

Veprimi juridik është me kusht kur lindja ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në të, varen nga një ngjarje e cila nuk dihet në se do të ndodhë.

Neni 85

Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet lindin po të ndodhë ngjarja. Kushti është zgjidhës kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja.

Neni 86

Kur vërtetimi i kushtit është ndaluar me keqbesim nga pala që do të perfitonte nga mos vërtetimi i tij, kushti quhet se është vërtetuar.

Kur vërtetimi i kushtit është shkaktuar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga vërtetimi i tij, kushti quhet se nuk është vërtetuar.

Neni 87

Kur e drejta që varet nga vërtetimi i kushtit cenohet ose humbet nga veprimet e palës së detyruar me kusht, kjo duhet të shpërblejë dëmin e shkaktuar në rast se kushti vërtetohet.

Neni 88

Pasojat që lidhen me vërtetimin e kushtit fillojnë nga çasti që është vërtetuar kushti, përveç kur nga përmbajtja e veprimit juridik del se këto pasoja duhet të fillojnë në një kohë të mëparshme.

Veprimet juridike me afat

Neni 89

Afati i veprimit juridik është çasti i caktuar, nga i cili fillon ose pushon fuqia juridike ose disa nga efektet e tij.

Neni 90

Afati është pezullues kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij fillojnë nga një kohë e caktuar.

Afati është zgjidhës kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij pushojnë në një kohë të caktuar.

Llogaritja e afateve të veprimeve juridike

Neni 91

Kur afati është caktuar me ditë, nuk llogaritet dita në të cilën ndodh ngjarja ose koha nga e cila ai duhet të fillojë.

Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite, mbaron, me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ai ka filluar. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit.

KREU II
PAVLEFSHMËRIA E VEPRIMEVE JURIDIKE

Veprime juridike të pavlefshme

Neni 92

Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:

a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;

b) kryhen për të mashtruar ligjin;

c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç;

ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara).

Neni 93

Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij.

Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.

Veprime juridike që shpallen të pavlefshme

Neni 94

Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga:

a) të miturit mbi katërmbëdhjetë vjeç, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit;

b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit;

c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar;

ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qënë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe.

Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohet edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar.

Neni 95

Mashtrimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur gënjeshtra e përdorur nga njëra palë, për ta shpënë në gabim palën tjetër, është e tillë që pa atë pala nuk do ta kishte kryer veprimin juridik.

Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërise së veprimit juridik vetëm kur në kohën e kryerjes së tij pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin.

Neni 96

Kanosja mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur është e tillë sa të friksojë personin se ai vetë, bashkëshorti, pasardhësit ose paraardhësit e tij do të pësojnë një dëm fizik ose material të padrejtë dhe të rëndë.

Kanosja mund të kryhet edhe nga një person i tretë që nuk merr pjesë në veprimin juridik.

Neni 97

Lajthimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm vetëm në qoftë se lidhet me cilësinë e sendit, me identitetin ose cilësitë e personit tjetër, apo me rrethana aq thelbësore sa që pa ato, pala nuk do të kishte kryer veprimin juridik.

Neni 98

Lajthimi në llogaritje nuk sjell shpalljen e veprimit juridik si të pavlefshëm, por vetëm korregjimin e tij, përveç kur gabimi në sasi ka qenë përcaktues për marrëveshjen.

Neni 99

Veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm në rastin kur për shkak të nevojës së madhe, detyrimet e marra nga njëra palë janë krejt të papërfillshme në krahasim me përfitimet që nxjerr pala tjetër nga veprimi juridik.

Neni 100

Veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e të përfaqësuarit, kur vullneti i përfaqësuesit është me ves.

Kur vesi ka të bëjë me elemente të përcaktuara nga i përfaqësuari, veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm, vetëm në qoftë se ishte i vesuar vullneti i këtij të fundit.

Neni 101

Kur në veprimin jurdik ka rëndësi përcaktimi i mirëbesimit ose i keqbesimit, i dijenisë ose i mosdijenisë së rrethanave të caktuara, që përbëjnë kushte përcaktuese të vlefshme ose të pavlefshme të veprimit juridik, mbahet parasysh personi i përfaqësuesit, përveç kur bëhet fjalë për rrethana të përcaktuara nga i përfaqësuari.

I përfaqësuari që është në keqbesim nuk mund të përfitojë në asnjë rast nga mosdijenia ose mirëbesimi i përfaqësuesit.

Neni 102

Veprimi juridik i kryer në dëm të të përfaqësuarit për shkak marrëveshjeje me keqbesim midis përfaqësuesit dhe personit të tretë, mund të shpallet i pavlefshëm për të përfaqësuarin.

Afati i parashkrimit të padisë

Neni 103

Padia për të kërkuar që një veprim juridik të shpallet i pavlefshëm, parashkruhet brenda pesë vjetëve.

Neni 104

Afati për ngritjen e padisë fillon:

a) për veprime juridike të kryera nga persona që u është hequr ose kanë patur zotësi juridike të kufizuar për të vepruar, që nga dita që janë bërë madhorë ose që u është kthyer zotësia për të vepruar;

b) për veprime juridike të kryera me mashtrim, kanosje ose lajthim, nga dita që mashtrimi ose lajthimi janë zbuluar, ose kanosja ka pushuar, por në çdo rast, jo më shumë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik;

c) në raste të tjera, që nga dita që është kryer veprimi juridik.

Neni 105

Veprimi jurdik që shpallet i pavlefshëm quhet i tillë që nga çasti kur është kryer.

Pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik

Neni 106

Kur veprimi juridik është i pavlefshëm për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin, ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlefta e saj.

Kur njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet kësaj dhe kur nuk është e mundur kthimi i po kësaj gjëje, i paguhet vlefta e saj.

Neni 107

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është bërë me mashtrim, kanosje, nga nevoja e madhe ose sepse mungon forma e kërkuar nga ligji, secila nga palët duhet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthehet po ajo gjë, t'i paguhet vlefta e saj.

Neni 108

Kur veprimi juridik konstatohet se është i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose shpallet i pavlefshëm se është kryer nga një i mitur që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, por pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e mundur të kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t'i shperblejë të miturit dëmin që ky ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm.

Neni 109

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një person, të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar ose për arsye se është kryer nga një person të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar e pa patur pëlqimin e kujdestarit të tij, ose për arsye se është kryer nga një person i cili në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka patur zotësinë për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që kjo palë ka pësuar për shkak të veprimit juridik që është shpallur i pavlefshëm, në rast se dinte ose duhet të dinte se pala tjetër nuk ka patur zotësi për të vepruar ose nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të saj.

Neni 110

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se njëra nga palët ka qenë në lajthim, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka kërkuar të shpallet i pavlefshëm veprimi juridik detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që ajo ka pësuar për shkak se veprimi juridik është shpallur i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur ajo provon se nuk ka faj që ka rënë në lajthim ose se pala tjetër ka ditur ose duhet të dinte lajthimin.

Neni 111

Kur shkaku i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik.

TITULLI IV
PARASHKRIMI I PADISË DHE DEKADENCA E TË DREJTAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja
Neni 112

E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.

Paditë që nuk parashkruhen
Neni 113

Nuk parashkruhen:
a) padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj;
b) paditë e njohjes;
c) padia e pjestimit midis bashkëpronarëve;
ç) padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë;
d) paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta.
Nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi.

Afatet e parashkrimit
Neni 114

Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.

Neni 115

Parashkruhen brenda afateve prej:
a) gjashtë muaj paditë për pagimin e kushteve penale vlerësuese;
b) një viti paditë e rrjedhura nga kontratat e spedicionit;
c) gjashtë muaj paditë që rrjedhin nga transportimet e drejtpërdrejta të mallrave dhe të udhëtarëve me anë të hekurudhës, automjeteve ose avionëve dhe prej një viti për të njëjtat padi që rrjedhin nga transportimet detare ose të përziera;
ç) dy vjetëve paditë për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit dhe risigurimit, si edhe të shumës përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm;
d) tre vjetëve paditë për pagimin e qirave të banesave, dyqaneve, lokaleve dhe pasurive të tjera të paluajtshme;
dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jo kontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.
Paditë e tjera parashkruhen brenda afateve të posaçme të caktuara në këtë Kod ose në ligje të tjera.

Neni 116

Është e pavlefshme marrëveshja e palëve për ndryshimin e afateve të parashkrimit dhe e çdo dispozite të këtij kreu.

Neni 117

Afati i parashkrimit fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë.

Neni 118

Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat.

Kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon në mënyrë të veçantë.

Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi.

Neni 119

Për kërkimin e sendit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenuesin e së drejtës së tij.

Neni 120

Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.

Neni 121

Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës.

Neni 122

Për kërkimin e trashëgimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita e çeljes së trashëgimisë.

Neni 123

Për paditë e kthimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur paditësi ka paguar vullnetarisht, në bazë të një detyrimi ligjor ose kontraktor, personit të tretë, për fajin e të paditurit, shumën e parave apo sendin që kërkohet me anë të kësaj padie, ose nga dita kur është dhënë vendimi i gjykatës ose arbitrazhit përkatës nga i cili ka lindur padia e regresit.

Neni 124

Parashkrimi i padisë për kërkesën kryesore shkakton që të parashkruhen edhe paditë për kërkesat e rrjedhura prej saj, pavarësisht se për këto nuk është plotësuar ende afati përkatës.

Kërkesa e palës së interesuar
Neni 125

Parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar.

Heqia dorë nga parashkrimi
Neni 126

Heqja dorë nga parashkrimi lejohet vetëm pasi të jetë plotësuar afati i tij.

Neni 127

Pretendimi se afati i parashkrimit është plotësuar mund të ushtrohet edhe nga kreditorët dhe nga kushdo që ka interes, në rastet kur pala përkatëse e ka ushtruar vetë.

Përmbushja e detyrimit pas plotësimit të afatit
Neni 128

Debitori që ka përmbushur detyrimin e tij pas plotësimit të parashkrimit, nuk mund të kërkojë kthimin e shumës së parave ose të sendit, që ka dhënë vullnetarisht, edhe sikur të mos dinte se ishte plotësuar afati i parashkrimit.

KREU II
PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT

A. Pezullimi i parashkrimit
Neni 129

Parashkrimi pezullohet:

a) midis bashkëshortëve deri në ditën kur ka marrë formë të prerë vendimi gjyqësor me të cilin është zgjidhur martesa;

b) midis fëmijëve dhe prindërve gjersa këta ushtrojnë të drejtën prindërore;

c) midis personave që ndodhen nën kujdestari dhe kujdestarëve të tyre gjersa vazhdon kujdestaria;

ç) për paditë e personave, pasuria e të cilëve është vënë në administrim, kundër administruesve përkatës të caktuar nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent shtetëror, gjersa të jetë miratuar raporti përfundimtar i llogarive;

d) për paditë e të miturve dhe personave të tjerë, që nuk kanë zotësi për të vepruar gjersa t'u emërohet përfaqësuesi ose të fitojnë këtë zotësi, si edhe për gjashtë muaj pasi është emëruar përfaqësuesi ose pasi kanë fituar zotësinë për të vepruar;

dh) për paditë e personit juridik kundër administratorëve të vet, gjersa këta vazhdojnë këtë detyrë pranë tij;

e) për paditë me objekt shpërblimin përkatës, të rrjedhura nga dëmtimi i shëndetit ose nga shkaktimi i vdekjes, pezullimi i parashkrimit vazhdon nga dita kur i është paraqitur kërkesa organit të sigurimeve shoqërore shtetërore dhe deri në ditën kur është caktuar pensioni ose është refuzuar ajo kërkesë;

ë) kur ka forcë madhore.

Neni 130

Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatin e parashkrimit. Kur pas zhdukjes së shkakut pezullues, koha që mbetet për t'u plotësuar parashkrimi është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj.

B. Ndërprerja e parashkrimit

Neni 131

Parashkrimi ndërpritet:

a) me çdo veprim të personit fizik ose juridik të detyruar, që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës të kreditorit;

b) me paraqitjen e padisë, të kundërpadisë ose të prapësimit, qoftë edhe në një gjykatë ose arbitrazh që nuk është kompetent nga pikëpamja tokësore ose lëndore për shqyrtimin e çështjes;

c) me çdo veprim që e vë debitorin në vonesë;

ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër.

Neni 132

Parashkrimi i ndërprerë kundër njërit prej debitorëve solidarë ose njërit prej bashkëshortëve të një detyrimi të papjestueshëm, shtrihet edhe ndaj secilit nga këta debitorë të tjerë.

Neni 133

Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzënësit përkatës.

Neni 134

Koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat parashkrimi i ri.

Neni 135

Kur parashkrimi është ndërprerë për shkak të paraqitjes së padisë ose të kundërpadisë, afati i ri i parashkrimit fillon nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi me të cilin është zgjidhur çështja në themel.

Kur është vendosur rrëzimi i padisë pa u zgjidhur çështja në themel, ose pushimi i gjykimit të çështjes, parashkrimi nuk quhet i ndërprerë.

Llogaritja e afateve të parashkrimit

Neni 136

Afati i parashkrimit të padisë, që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit apo të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës në të cilën ka filluar afati dhe, kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e afatit të parashkrimit bie në një ditë pushimi, quhet si e fundit ajo ditë pune që vjen pas asaj të pushimit.

KREU III
PREKLUZIVITETI (DEKADENCA)

Neni 137

Kur një e drejtë duhet të ushtrohet brenda një afati prekluziv, nuk zbatohen dispozitat që rregullojnë ndërprerjen e parashkrimit. Gjithashtu, nuk zbatohen shkaqet pezulluese, përveç rasteve përjashtimore, kur vetë ligji lejon pezullimin e afatit prekluziv.

Neni 138

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën janë caktuar afate prekluzive, që e bëjnë tejet të vështirë për njërën nga palët ushtrimin e së drejtës përkatëse.

Neni 139

Palët nuk mund të ndryshojnë urdhërimet ligjore që rregullojnë prekluzivitetin, dhe as mund të heqin dorë nga afati prekluziv i plotësuar kur ky afat është caktuar me dispozita ligjore të veçanta.

Neni 140

Afati prekluziv i plotësuar merret parasysh nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.

PJESA II
SENDET DHE PRONËSIA

TITULLI I
SENDET

Kuptimi juridik i sendit
Neni 141

Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale.

Llojet e sendeve
Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 143

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për të drejtat reale që kanë si objekt sende të paluajtshme, si dhe për paditë përkatëse, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e luajtshme zbatohen për të gjitha të drejtat e tjera.

Neni 144
Regjistrimi i sendeve

Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme.
Regjistrohen edhe ato sende të luajtshme, për të cilat kërkohet shprehimisht nga ligji.

Frutat e sendit
Neni 145

Frutat natyrore të një sendi janë produktet që nxirren prej tij.
Derisa nuk janë ndarë nga sendi, ato janë pjesë përbërëse e tij.
Frutat civile nxirren nga sendet si rrjedhojë e gëzimit të të drejtave që kanë personat mbi to.
Frutat civile fitohen në bazë të kohëzgjatjes së të drejtave dhe kur këto janë bërë të kërkueshme.

Pjesët përbërëse të sendit
Neni 146

Është pjesë përbërëse e një sendi çdo gjë që është bashkuar me të dhe nuk mund të ndahet prej tij pa iu shkaktuar një dëm thelbësor.

Sendet aksesore
Neni 147

Aksesorë janë ato sende të luajtshme që janë destinuar për t'i shërbyer në mënyrë të vazhdueshme një sendi kryesor ose për ta zbukuruar atë.
Ky destinim bëhet nga pronari i sendit kryesor ose nga personi që ka një të drejtë reale mbi atë.

Neni 148

Çdo disponim i sendit kryesor përfshin edhe aksesorët e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe.
Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë.
Aksesori nuk e humbet këtë cilësi të tij në rastet kur është ndarë përkohësisht nga sendi kryesor.

TITULLI II
PRONËSIA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e pronësisë
Neni 149

Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Pronësia mbi pjesët përbërëse të sendit
Neni 150

Pronarit të sendit i takon pronësia edhe mbi pjesët përbërëse të tij.

Pronësia mbi frutat e sendit
Neni 151

Pronarit të sendit i takojnë frutat natyrore që prodhon sendi, përveç kur pronësia e tyre u është kaluar të tjerëve. Në këtë rast pronësia fitohet pasi frutat të jenë ndarë nga sendi.

Personi që merr frutat duhet që brenda vleftës së tyre të shpërblejë shpenzimet e bëra për prodhimin dhe vjeljen e tyre.

Përkatësia e sendeve
Neni 152

Sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit.

Llojet e pasurisë publike caktohen me ligj.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarit
Neni 153

Askujt nuk mund t'i hiqet tërësisht ose pjesërisht pronësia mbi sendet e tij, përveç kur e kërkojnë interesa publikë të ligjshëm dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të plotë dhe paraprak.

Neni 154

E drejta e pronësisë mbi tokën shtrihet gjer në lartësinë dhe thellësinë që është e dobishme për ushtrimin e saj, në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 155

Pronari i një toke, pasi më parë t'i ketë kërkuar fqinjit që të presë degët e pemëve dhe rrënjët që i futen në tokën e tij, ka të drejtë t'i presë vetë ato, në rast se i sjellin dëm, si dhe të vjelë frutat dhe t'i perdorë ato për vete.

Frutat që bien nga pemët mbi tokë, i përkasin pronarit të tokës ku ato kanë rënë.

Neni 156

Pronari i një toke që ndodhet buzë një rrjedhe uji ose burimi publik, ka të drejtë t'i përdorë ato deri në masën që nuk dëmton interesat e pronarëve të tokave të tjera, përveç kur përdorimi rregullohet me dispozita të veçanta.

Neni 157

Pronari i një toke mund t'i kërkojë në çdo kohë pronarit të tokës fqinje, që me shpenzime të përbashkëta, të vendosen në kufijtë e tokave të tyre shenja të dukshme dallimi ose t'i ndreqin ato kur janë të dëmtuara.

Kur kufiri ndërmjet dy tokave është i paqartë dhe pronarët nuk e përcaktojnë vetë atë, secili prej tyre mund të kërkojë saktësimin e tij nga gjykata.

Neni 158

Kur mbillen drurë e shkurre në kufijtë e pronave, pronarët janë të detyruar të mbajnë largësitë e caktuara me dispozita të veçanta e kur nuk ka të tilla, nga zakonet e vendit, përveç kur pronari fqinjë ka lejuar vetë ose kur kufiri është në një rrugë ose rrjedhë uji publike.

Në mungesë të këtyre rregullave, largësitë janë: tre metra për drurët me trup të lartë dhe dy metra për drurët e tjerë.

Këto largësi nuk zbatohen për drurët e shkurret, lartësia e të cilëve nuk e kalon murin ndarës të pronave.

Neni 159

Pronari është i lirë në përdorimin e sendit, pa dëmtuar të drejtat e personave të tjerë dhe brenda kufijve që caktohen nga ligji ose nga zakonet e mira. Ai nuk mund t'u krijojë fqinjëve shqetësime të tilla si zhurma, dridhje, futje të tymit, nxehtësive, avujve ose përhapje të tjera të ngjashme, të pengojë gëzimin e pronave të tyre, duke ndryshuar rrjedhat, prurjet ose cilësinë e ujërave që rrjedhin në tokën e tij ose të ujërave nëntokësorë, si dhe të përdorë ujërat që komunikojnë lirisht me ato të tokës së tjetrit, përveç kur këto shqetësime nuk kalojnë shkallën e zakonshme të tyre.

Pronari gjatë ushtrimit të të drejtave të tij, detyrohet të marrë masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit për rreth.

Neni 160

Pronarët duhet t'u përmbahen rregullave të caktuara në planet rregulluese ose në dispozita të veçanta, për ngritjen e ndërtesave të reja, për rindërtimin ose ndryshimin e tyre, për largësitë ndërmjet ndërtesave, për çeljen e dritareve, puseve, gropave e të punimeve të tjera të kësaj natyre.

Neni 161

Pronari është i detyruar të mbledhë ujërat që rrjedhin nga strehët e ndërtesave të tij, në mënyrë që ato të mos pikojnë mbi tokën e tjetrit.

Derdhja e tyre në një rrjedhë publike mund të bëhet kur nuk ndalohet nga rregullat që kanë caktuar organet kompetente.

Pronari është i detyruar të kujdeset që ujërat dhe mbeturinat që vijnë nga toka e tij të mos derdhen në kanalin ose në tokën e tjetrit, përveç kur ndërmjet tyre ka marrëveshje të kundërt.

KREU II
FITIMI DHE HUMBJA E PRONËSISË

Kalimi i pronësisë

Neni 162

E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.

Mënyra e fitimit të pronësisë

Neni 163

Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë.

Fitimi i pronësisë me kontratë

Neni 164

Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre.

Fitimi i pronësisë me trashëgim
Neni 165

Fitimi i pronësisë me trashëgim kryhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e pjesës së tretë të këtij Kodi.

Fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme
Neni 166

Personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij.

Megjithatë fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur.

Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë tek prurësi, edhe sikur këto t'i jenë vjedhur ose t'i kenë humbur pronarit ose personit juridik publik.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për sendet e luajtshme që janë të shënuara në regjistrat publike.

Prona fitohet e lirë nga të drejtat e tjetrit mbi sendin, në rast se këto të drejta nuk rrjedhin nga titulli dhe nga mirëbesimi i fituesit.

Neni 167

Në rast se pronësia mbi një send të luajtshëm u kalon me anë kontratash disa personave, bëhet pronar ai që ka fituar posedimin e sendit me mirëbesim, edhe sikur kontrata të jetë e një date të mëvonshme.

Parashkrimi fitues
Neni 168

Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi, pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm.

Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër.

Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme.

Neni 169

Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzetë vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj.

Regjistrimi i sendit të fituar me parashkrim
Neni 170

Personi që ka fituar me parashkrim një send të paluajtshëm ka të drejtë të paraqesë padi kundër personit të mëparshëm ose trashëgimtarëve të tij për njohjen e pronësisë së vet dhe, në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, të kërkojë që të kryhet regjistrimi i sendit nga organi kompetent shtetëror.

Pezullimi e ndërprerja e parashkrimit fitues

Neni 171

Dispozitat për pezullimin dhe ndërprerjen e parashkrimit të padisë zbatohen edhe për parashkrimin fitues.

Parashkrimi fitues ndërpritet me humbjen e posedimit. Nuk quhet ndërprerje kur poseduesi hyn përsëri në posedimin brenda gjashtë muajve ose edhe më vonë me anë padie të ngritur brenda gjashtë muajve.

Sendet pa zot

Neni 172

Sendet pa zot janë ato që nuk kanë pronar ose pronari i të cilave ka hequr dorë nga pronësia.

Sendet që nuk kanë zot i takojnë shtetit. Kalimi i tyre në pronësi të shtetit bëhet me vendim të gjykatës kompetente.

Fitimi i pronësisë me bashkim e përzierje

Neni 173

Mbjelljet, si dhe ndërtesat e çdo vepër tjetër që ndodhen mbi ose nën sipërfaqen e tokës, i përkasin pronarit të saj, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kod e në dispozita të tjera ligjore.

Neni 174

Pronari i tokës që ka bërë ndërtime e vepra të tjera dhe mbjellje me material të huaj, detyrohet të paguajë vleftën e tyre, në rast se nuk kërkohet ndarja e kthimi i tyre dhe kur kjo mund të kryhet pa u shkaktuar një dëm thelbësor ndërtimeve ose mbjelljeve të kryera.

Kur ndarja e materialeve është e mundshme dhe pronari i tokës ka vepruar me keqbesim, duhet t'i shpërblejë pronarit të materialeve dëmin e pësuar.

Neni 175

Kur ndërtesat e veprat e tjera dhe mbjelljet janë bërë nga një person i tretë me materialet e veta në tokën e tjetrit, pronari përkatës ka të drejtë t'i mbajë ato ose të kërkojë detyrimin e atij që i ka bërë t'i heqë ato me shpenzimet e tij, dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin.

Kur pronari i tokës pranon t'i mbajë, detyrohet të paguajë vleftën e matarialeve dhe të krahut të punës ose rritjen e vleftës që i është bërë pronës.

Pronari i tokës nuk mund t'i kërkojë heqjen e ndërtimeve e të mbjelljeve të kryera kur ato janë bërë me dijeninë e tij, ose me mirëbesim nga personi i tretë, si dhe kur kanë kaluar gjashtë muaj që nga dita kur pronari ka marrë njoftim për këto ndërtime e mbjellje.

Kur me mirëbesim është ngritur një ndërtesë në tokën e huaj dhe vlefta e saj është më e madhe se vlefta e tokës, personi që ka ngritur ndërtesën mund të njihet pronar edhe i tokës, me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 176

Kur dy ose më shumë sende të luajtshme që u përkasin pronarëve të ndryshëm janë bashkuar ose përzier në një send të vetëm e që nuk mund të ndahen pa u shkaktuar një dëm thelbësor njëri-tjetrit, ose kur ndarja kërkon punë e shpenzime të tepëruara, pronarët e secilit send bëhen bashkëpronarë të sendit të ri, në përpjestim me vleftën që pjesët e sendit kishin në momentin e bashkimit apo të përzjerjes së tyre.

Kur një send i luajtshëm është bashkuar ose përzier me një tjetër në mënyrë të tillë sa duket se është pjesë aksesore e tij, sendi i ri i përket pronarit të pjesës kryesore, i cili detyrohet të paguajë vleftën përkatëse, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Fitimi i pronësisë me përpunim
Neni 177

Personi që me punën e tij ka krijuar një send të ri të luajtshëm duke përdorur lëndën në pronësi të një personi tjetër, pavarësisht se lënda mund ose jo të marrë formën e saj të parë, bëhet pronar i sendit të ri në rast se vlefta e punës është më e madhe se ajo e lëndës, me kusht që të paguajë vleftën e saj.

Në rast të kundërt sendi i ri fitohet nga pronari i lëndës, duke paguar vleftën e punës. Kur përpunuesi ka vepruar me keqbesim, me vendim të gjykatës sendi i ri i kalon pronarit të lëndës edhe në rast se vlefta e punës është më e madhe se ajo e lëndës, por duke paguar vleftën e kësaj të fundit.

Bashkimet e tokave nga aluvionet
Neni 178

Mbushjet me dhe të tokave e shtesat e tokës që formohen në mënyrë të natyrshme gjatë brigjeve të lumenjve a të përrenjve, i përkasin pronarit të tokës, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Tokat e liruara nga rrjedhat e ujit
Neni 179

Toka që lirohet nga një rrjedhë uji, e cila tërhiqet në mënyrë të natyrshme nga njëri breg dhe shkon në bregun tjetër, i përket pronarit të tokës nga e cila është larguar rrjedha.

Tokat e krijuara në shtratet e lumenjve
Neni 180

Ishujt dhe mbushjet me dhe që krijohen në shtratet e lumenjve janë pronë publike.

Neni 181

Kur një lum ose përrua ndërron shtrat duke e lënë të vjetrin, toka që lirohet është në pronësi të pronarëve kufitarë të dy anëve (buzëve) të lumit apo të përroit, të cilët e ndajnë atë deri në mesin e shtratit të lënë sipas gjatësisë së tij.

SENDET E HUMBURA OSE TË GJETURA

Njoftimi për gjetjen
Neni 182

Personi që ka gjetur një send të humbur, duke përfshirë edhe gjënë e gjallë të shkëputur nga tufa, është i detyruar të lajmërojë menjëherë pronarin ose personin që i ka humbur dhe kur ky nuk njihet, ta dorëzojë atë në bashkinë apo komunën, në territorin e së cilës është gjetur sendi.

Bashkia ose komuna është e detyruar të shpallë menjëherë gjetjen e sendit.

Marrja e sendit dhe pagimi i shpenzimeve
Neni 183

Pronari ose personi, të cilit i ka humbur sendi, ka të drejtë ta kërkojë atë brenda gjashtë muajve nga dita që është shpallur gjetja në bashkinë apo komunën përkatëse, pasi të ketë paguar shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit dhe një shpërblim për personin që ka gjetur sendin në masën 10% të vleftës së sendit, ose të çmimit të marrë, kur sipas rrethanave të paraqitura, shitja e tij ka qenë e domosdoshme.

Kur ka kundërshtime për vleftën e sendit, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Bashkia ose komuna mund të lejojë mbajtjen përkohësisht të sendit nga personi që e ka gjetur, të cilit i paguhen dhe shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit.

Sendet e humbura duhen të ruhen dhe të mirëmbahen me kujdesin e duhur.

Fitimi i pronësisë nga personi që ka gjetur sendin
Neni 184

Kur pronari ose personi që e ka humbur sendin nuk paraqiten për ta marrë atë brenda afatit të caktuar në nenin 183, sendi ose çmimi i shitjes i kalon në pronësi personit që e ka gjetur, i cili paguan shpenzimet e mbajtjes.

Sendet e gjetura në lokal
Neni 185

Sendet e gjetura në lokalet publike e private e në mjetet e transportit, duhen t'i dorëzohen menjëherë administratës së lokalit ku janë gjetur, e cila i ruan ato tri ditë. Kur nuk paraqitet pronari ose personi që i ka humbur, administrata i dorëzon ato në bashki apo në komunën përkatëse.

Thesari
Neni 186

Quhet thesar çdo send i çmueshëm, i cili duket me saktësi se ka qenë në tokë ose i fshehur prej shumë kohësh dhe që nuk mund t'i gjendet pronari.

Thesari i përket pronarit të sendit të luajtshëm apo të paluajtshëm ku është gjetur, përveç rasteve të sendeve me vlerë shkencore, kulturore, arkeologjike etj., të parashikuara nga neni 187 i këtij Kodi.

Personi që zbulon thesarin ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm që nuk duhet të kalojë gjysmën e vlerës së tij.

Pronësia e shtetit mbi një kategori sendesh të luajtshme
Neni 187

Sendet e luajtshme, me vlerë kulturore, historike, arkeologjike, etnografike, si dhe sendet natyrore të rralla me rëndësi shkencore që zbulohen, shkëputen ose nxirren nga toka ose uji, kalojnë në pronësi të shtetit.

Pronari, në pronën e të cilit janë zbuluar sende të tilla, është i detyruar të lejojë kryerjen e gërmimeve, duke u shpërblyer dëmet e pësuara.

Personi që ka zbuluar ose ka gjetur sende të tilla, ka të drejtë të marrë nga shteti një shpërblim të arsyeshëm.

Fitimi i pronësisë me anë pushtimi
Neni 188

Pronësia mbi sendet e luajtshme të abandonuara, si dhe mbi kafshët e egra, shpendët, peshqit, frutat e egra dhe mbi sendet e tjera të luajtshme të natyrës, fitohet me anë pushtimi, në kushte të caktuara me ligj ose në dispozita të veçanta.

Tufa e bletëve
Neni 189

Pronari i një tufe bletësh ka të drejtë ta ndjekë e ta marrë atë në tokën e tjetrit, duke shpërblyer dëmin e shkaktuar.

Kur pronari i bletës së ikur nuk e ka ndjekur atë brenda tri ditëve, ose kur ajo ka hyrë në një zgjua bletësh tjetër, pronësia mbi atë i kalon përkatësisht pronarit të tokës ku ka qëndruar bleta ose pronarit të zgjoit.

Fitimi i pronësisë me anë shpronësimi
Neni 190

Sendet mund të shpronësohen kur e kërkojnë interesa publikë të njohur me ligj dhe kundrejt një shpërblimi të plotë e paraprak. Ato kalojnë në pronësi të shtetit ose të enteve të tjera publike, në favor të të cilave është bërë shpronësimi.

Humbja e pronësisë
Neni 191

Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj.

Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet.

KREU III
REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 192

Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjëndjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtëshme.

Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjestimin vullnetar të tyre;

b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufrukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;

c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;

ç) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit dhe fitohet pasuria e trashëguar;

d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;

h) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjestimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankant të tyre.

Vërtetimi gjyqësor i faktit të pronësisë nuk regjistrohet.

Neni 194

Në kontratën e dhurimit të pasurisë së paluajtshme, regjistrimi merr datën në të cilën regjistrohet pranimi, në rast se ky përmbahet në një akt të veçantë.

Neni 195

Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Neni 196

Gjykatat, noterët, përmbaruesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë.

Neni 197

Duhen të regjistrohen gjithashtu:

a) kontratat e qiradhënies së sendeve të paluajtshme për një kohë mbi nëntë vjet;

b) kërkesë-paditë për fitimin, njohjen, ndryshimin ose pushimin e të drejtave të pronësisë ose të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme;

c) kërkesë-paditë për pjestimin e pasurisë së paluajtshme të përbashkët.

Neni 198

Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrit publik për pasuritë e paluajtshme.

Kushtet, mënyra e regjistrimit dhe e organizimit, si dhe çdo procedurë që ka lidhje me këtë veprimtari, rregullohet me ligj të veçantë.

TITULLI III
BASHKËPRONËSIA

KREU I
BASHKËPRONËSIA NË PJESË

Përkufizimi dhe përmbajtja
Neni 199

Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave.

Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjestim me pjesët përkatëse.

Të drejtat e bashkëpronarëve
Neni 200

Çdo bashkëpronar ka këto të drejta:

a) të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjestim me pjesën e tij;

b) të përdorë sendin e përbashkët sipas qëllimit të përcaktuar dhe në mënyrë që të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë të përdorin atë sipas të drejtave të tyre;

c) të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë sipas nenit 204 të këtij Kodi;

ç) të kërkojë pjestimin e sendit të përbashkët edhe sikur të ketë një marrëveshje të kundërt, përveç kur ky pjestim dëmton së tepërmi qëllimin përkatës ose është ndaluar me ligj;

d) të kërkojë kthimin jo vetëm të pjesës së tij, por të gjithë sendit të përbashkët, me kusht që ky t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Detyrimet e bashkëpronarit
Neni 201

Çdo bashkëpronar është i detyruar që në përpjestim me pjesën e vet, të paguajë shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe gëzimin e sendit të përbashkët.

Neni 202

Kur sendin e përbashkët e përdorin për vete një ose disa bashkëpronarë, këta detyrohen t'u paguajnë bashkëpronarëve të tjerë shpërblimin për përdorimin e pjesëve të tyre nga dita kur u është njoftuar me shkrim kërkesa e këtij shpërblimi ose nga data e paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente.

Administrimi i sendit të përbashkët
Neni 203

Të gjithë bashkëpronarët, pavarësisht nga vlera e pjesës përkatëse, kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e sendit të përbashkët.

Sendi i përbashkët administrohet sipas mënyrës së miratuar me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve dhe kur kjo nuk është arritur, sipas mënyrës së caktuar me vendim të bashkëpronarëve që kanë më shumë se gjysmën e vleftës së tij. Vendimi i shumicës është i detyrueshëm edhe për bashkëpronarët që kanë mbetur në pakicë.

Kjo shumicë mund të vendosë që të vihet hipotekë ose peng mbi sendin e përbashkët, kur kjo është e domosdoshme për të siguruar kthimin e shumave të marra hua për mirëmbajtjen ose rindërtimin e tij.

Kur nuk është arritur kjo shumicë ose kur vendimi i saj është i dëmshëm për sendin e përbashkët, gjykata kompetente, me kërkesën e çdo bashkëpronari, vendos masat që i çmon të nevojshme dhe, sipas rastit, emëron një kujdestar për administrimin e sendit.

E drejta e parablerjes

Neni 204

Bashkëpronari, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda tre muajve se dëshërojnë të blejnë pjesën, bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë.

Ai duhet t'ua bëjë të njohur bashkëpronarëve të tjerë bashkëpronarin e ri.

E drejta e kreditorit mbi pjesën e bashkëpronarit

Neni 205

Çdo kreditor ka të drejtë të realizojë kredinë e vet mbi pjesën që i takon bashkëpronarit debitor në sendin e përbashkët.

Neni 206

Kreditorët dhe trashëgimtarët e ndonjë bashkëpronari mund të ndërhyjnë në pjesëtim, me shpenzimet e tyre, por nuk mund të kundërshtojnë pjesëtimin e bërë më parë, përveç kur kanë njoftuar kundërshtimin e tyre para pjesëtimit.

Në pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, njoftimi për kundër-shtimet e përmendura në paragrafin e mësipërm, duhet të regjistrohet përpara regjistrimit të kërkesës për pjesëtim. Gjithashtu, në një pjesëtim të tillë duhet të thirren të gjithë kreditorët që kanë regjistruar kërkesat e tyre ose që kanë fituar të drejta mbi pasurinë që pjestohet, përpara regjistrimit të aktit të pjesëtimit ose të regjistrimit të kërkesës për pjesëtim.

Pjesëtimi i sendit të përbashkët

Neni 207

Pjesëtimi i sendit të përbashkët kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve. Kur sendi është i paluajtshëm marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial. Kur kjo marrëveshje nuk është arritur, pjesëtimi i sendit kryhet me anë të gjykatës, duke u thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët. Pjesëtimi i sendit të përbashkët bëhet me ndarjen e tij në natyrë sipas pjesëve që kanë bashkëpronarët, në qoftë se kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin përkatës të sendit. Pabarazia e pjesëve, që rezulton nga ndarja në natyrë kompensohet me një shpërblim në para.

Kur sendi i përbashkët nuk mund të ndahet në natyrë gjykata urdhëron që ai të shitet në ankand dhe vlefta e tij të ndahet ndërmjet bashkëpronarëve, sipas pjesëve përkatëse, duke llogaritur edhe shumat që ata duhet t'i paguajnë njëri-tjetrit për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë.

Megjithatë, në vend të shitjes në ankand, gjykata, kur disa nga bashkëpronarët e kërkojnë, mund të urdhërojë që sendi t'u lihet këtyre, duke i detyruar që t'i paguajnë bashkëpronarit, i cili kërkon pjesëtimin, vleftën e pjesës së tij, sipas mënyrës dhe brenda afateve të caktuara në vendimin gjyqësor.

Kur sendi që nuk mund të ndahet në natyrë, është shtëpi banimi, gjykata ia lë në pjesë, në kushtet e sipërtreguara, atij nga bashkëpronarët që banon në atë shtëpi ose ka nevojë më shumë se të tjerët për atë sipërfaqe banimi.

Tjetërsimi i sendit të përbashkët
Neni 208

Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.

KREU II
BASHKËPRONËSIA NË TËRËSI

A. BASHKËPRONËSIA E DETYRUESHME

Objektet e përbashkëta të ndërtesave
Neni 209

Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:

a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;

b) puset, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësive të ndara të kateve.

Neni 210

E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe.

Heqia dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk e liron bashkëpronarin nga detyrimi për të kontribuar në shpenzimet për mbajtjen e tyre.

Pandashmëria e objekteve të përbashkëta
Neni 211

Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Përbërja e asamblesë dhe zgjedhja e kryesisë
Neni 212

Asambleja përbëhet nga pronarët e secilit kat ose njësie të ndarë të çdo kati, të cilët kanë në bashkëpronësi objektet e përbashkëta të ndërtesës.

Në mbledhjen e parë të asamblesë anëtarët e saj zgjedhin, nga gjiri i tyre, kryesinë, e cila ngarkohet të kryejë, në emër e për llogari të tyre të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve të përbashkëta, përveç atyre veprimeve që janë në kompetencë vetëm të asamblesë, si dhe të përfaqësojë në instancat gjyqësore kompetente dhe në arbitrazh.

Mbledhjet e asamblesë dhe vlefshmëria e vendimeve
Neni 213

Pas mbledhjes së parë organizuese, mbledhjet e asamblesë thirren një herë në vit. Mbledhje të tjera të asamblesë mund të thirren nga kryesia e saj ose me nismën e jo më pak se 20% të anëtarëve të saj.

Asambleja mund të çelet dhe të marrë vendime kur janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, të cilët kanë të paktën dy të tretat e tërësisë së kuotave. Kur ky numër nuk është i pranishëm, mbledhja shtyhet dhe mbledhja pasardhëse zhvillohet në rast se merr pjesë shumica e zakonshme e bashkëpronarëve.

Vendimet e asamblesë merren me shumicë të thjeshtë votash të bashkëpronarëve, përveç rasteve kur në dispozitat e këtij kreu ose me dispozita të veçanta kërkohet një shumicë e cilësuar. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Kompetencat kryesore të asamblesë

Neni 214

Asambleja ka edhe këto kompetenca kryesore:

1. Miraton rregulloren për administrimin e banesës, e cila hartohet sipas rregullores tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Krijon fondin rezervë për shpenzimet e përbashkëta, duke caktuar edhe shumën vjetore të tij.

3. Miraton preventivat e shpenzimeve që ka vendosur të kryhen gjatë vitit, si dhe ndarjen e shumës së tyre midis bashkëpronarëve.

Shpenzimet e përbashkëta për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme të këtyre objekteve miratohen nga asambleja me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa shpenzimet për përmirësime të mëdha ose rinësime cilësore vendosen me shumicë të cilësuar të bashkëpronarëve që arrijnë të paktën 75% të kuotave përkatëse.

4. Emëron, kur çmohet e domosdoshme, kujdestarin e ndërtesës, duke caktuar kompetencat dhe pagën e tij.

5. Autorizon kryesinë që të sigurojë, brenda kufijve të arsyeshme, objektet që janë pronë e përbashkët, si dhe të lidhë kontrata të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme, ose, sipas rastit, për përmirësime të mëdha apo rinësime të këtyre objekteve.

Neni 215

Vendimet e marra nga asambleja sipas dispozitave të mësipërme janë të detyrueshme për të gjithë bashkëpronarët.

Padia kundër vendimeve të asamblesë

Neni 216

Kur një vendim i asamblesë është i paligjshëm ose cenon interesat e ndonjërit nga bashkëpronarët e këtyre objekteve, çdo bashkëpronar ka të drejtë të paraqesë në gjykatën kompetente padi për pavlefshmërinë e atij vendimi, brenda tridhjetë ditëve nga data e dhënies së tij. Paraqitja e kërkesë-padisë nuk pezullon zbatimin e vendimit të asamblesë, përveç kur gjykata ka vendosur ndryshe.

Detyrimet e bashkëpronarëve

Neni 217

Çdo bashkëpronar ka këto detyrime:

1. Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve, në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Për sendet që u shërbejnë bashkëpronarëve në masë të ndryshme, shpenzimet përballohen në përpjesëtim me përdorimin që mund t'u bëjë atyre secili.

Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve në përpjesëtim me vleftën e pjesës të secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

2. Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t' u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës.

3. Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimin e tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj, cilitdo objekti të përbashkët.

4. Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të cenojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.

Shtesa të reja mbi katin e fundit

Neni 218

Ndërtimi mbi katin e fundit të një ndërtese, të kateve ose veprave të tjera, mund të realizohet me vendimin e shumicës prej 3/4 të bashkëpronarëve të ndërtesës.

Neni 219

Ndalohet dhënia e lejes për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit në qoftë se kushtet statike të ndërtesës nuk e lejojnë.

Bashkëpronarët mund të kundërshtojnë lejen e dhënë nga organi kompetent shtetëror për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit dhe kur provohet se ato pakësojnë ajrin apo dritën për katet e mëposhtme ose cenojnë pamjen arkitektonike të ndërtesës.

Neni 220

Ata që janë lejuar të bëjnë shtesa ose vepra të tjera në katin e fundit detyrohen të rindërtojnë taracën, të cilën të gjithë ose një pjesë e bashkëpronarëve kishin të drejtë ta përdornin.

Shëmbja tërësore ose pjesore e ndërtesës

Neni 221

Kur ndërtesa shëmbet tërësisht ose në një pjesë që përbën jo më pak se tre të katërtat e vlerës së saj, secili bashkëpronar mund të kërkojë që të shiten në ankand trualli dhe materialet, përveç kur është vendosur ndryshe.

Kur ndërtesa është dëmtuar në një përmasë më të vogël, asambleja vendos për rindërtimin e objekteve të përbashkëta të ndërtesës dhe secili bashkëpronar i tyre detyrohet të kontribuojë në përpjesëtim me të drejtat e tij në ato objekte.

Bashëpronari që nuk dëshiron të marrë pjesë në rindërtimin e ndërtesës, duhet t'u shesë bashkëpronarëve të tjerë ose ndonjërit prej tyre edhe objektet, të cilët janë pronë vetëm e tij, sipas vlerësimit që do të bëhet.

B. BASHKËPRONËSIA MIDIS ANËTARËVE TË FAMILJES BUJQËSORE

Neni 222

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 223

Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martese, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

Neni 224

Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj.

Neni 225

Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim.

Neni 226

Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj.

Neni 227

Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

a) pasurinë që i përket tërë familjes;

b) numrin e anëtarëve të familjes;

c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 228

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në nenin 207 të këtij Kodi.

Kur kërkohet pjesa nga anëtarë të veçantë të saj, ajo vlerësohet dhe i jepet në para.

Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit.

Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore, që është e nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse.

Neni 229

Familja bujqësore përgjigjet për veprimet e paligjshme të kryera nga anëtarët e saj, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore.

Neni 230

Familja bujqësore nuk përgjigjet për detyrimet ekonomike vetjake të anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e saj. Kreditorët kanë të drejtë të paguhen nga pjesa që i takon anëtarit debitor në të ardhurat e familjes bujqësore dhe nga pjesa që i takon atij në pasurinë e familjes bujqësore.

C. BASHKËPRONËSIA NDËRMJET BASHKËSHORTËVE

Neni 231

Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes.

TITULLI IV
UZUFRUKTI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e uzufruktit
Neni 232

Uzufrukti është e drejta e një personi (uzufruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.

Mënyra e krijimit të uzufruktit
Neni 233

Uzufrukti krijohet me ligj ose me një veprim juridik. Ai mund të fitohet edhe me parashkrimin fitues.

Kohëzgjatja e uzufruktit
Neni 234

Uzufrukti mund të jetë me ose pa afat, por në çdo rast nuk mund të kalojë jetën e uzufruktarit.

Kur e drejta e uzufruktit gëzohet nga një person juridik, nuk mund të zgjasë më shumë se tridhjetë vjet.

Mënyra e krijimit
Neni 235

Uzufrukti që krijohet me veprim juridik duhet të bëhet me akt noterial, ndërsa kur fitohet me testament veprohet sipas dispozitave përkatëse.

Uzufrukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Bashkuzufrukti
Neni 236

Uzufrukti mund të jetë në favor të më shumë se një personi. Kur e drejta e njërit prej tyre shuhet, ajo u kalon uzufruktarëve që mbeten, në përpjesëtim me pjesët. Në këtë mënyrë veprohet deri në shuarjen e së drejtës së uzufruktarit të fundit që mbetet.

KREU II
TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI

Kufijtë e gëzimit të sendit në uzufrukt
Neni 237

Uzufruktari gëzon sendin e vënë në uzufrukt, por nuk mund të ndryshojë destinimin ekonomik që ka patur ai në fillim të uzufruktit, pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, kur pronari dhe uzufruktari nuk merren vesh.

Gjatë vazhdimit të uzufruktit ose në mbarimin e tij, uzufruktari mund të heqë shtesat që i janë bërë sendit, në kushtet e paragrafit të parë të këtij neni, që mund të shkëputen pa e dëmtuar atë, duke e kthyer në gjendjen e tij fillestare, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Përmirësimet e sendit në uzufrukt
Neni 238

Uzufruktari në mbarim të uzufruktit nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për përmirësimet e bëra në send gjatë përdorimit edhe sikur të jetë shtuar vlefta e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të uzufruktit.

Shtesa e vleftës mund të kompensohet me dëmet që mund t'i jenë shkaktuar sendit pa fajin e uzufruktarit.

Kur nuk ka vend për kompensim, uzufruktari mund të heqë shtesat e bëra, pa u dëmtuar sendi, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre, si të ishin të ndara nga sendi.

Përkatësia e frutave
Neni 239

Uzufruktarit i takojnë frutat natyrore dhe ato civile që prodhon sendi gjatë kohëvazhdimit të uzufruktit.

Frutat natyrore që nuk janë ndarë nga sendi në kohën e fillimit të uzufruktit, i përkasin uzufruktarit dhe anasjelltas, kur ato nuk janë ndarë nga sendi kur mbaron uzufrukti, i përkasin pronarit.

Kalimi i së drejtës së uzufruktit
Neni 240

Uzufruktari mund t'ia kalojë një tjetri këtë të drejtë për një kohë ose për gjithë kohën e qënies së saj, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Kalimi duhet t'i njoftohet me shkrim pronarit, përndryshe uzufruktari i mëparshëm dhe personi që ka fituar një të drejtë të tillë përgjigjen solidarisht ndaj pronarit.

E drejta e tjetërsimit
Neni 241

Uzufruktari ka të drejtë të tjetërsojë sendet objekt uzufrukti në masën që ato destinohen të tjetërsohen dhe në përputhje me natyrën e tyre.

Në raste të tjera uzufruktari nuk mund të tjetërsojë sendet në uzufrukt pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Autorizimi nuk duhet të jepet kur preken interesat e pronarit, uzufruktarit ose të personave të tretë.

Zëvendësimi i sendit në uzufrukt
Neni 242

Kur sendet në uzufrukt janë tjetërsuar ose janë zëvendësuar me sende të tjera, këto i përkasin pronarit dhe njëkohësisht janë objekt i uzufruktit.

Rregulli i mësipërm vlen për gjithçka që sigurohet nga vjelja e detyrimeve objekt uzufrukti, nga kompensimi për shpërblimin e dëmeve ose nga zhvleftësimi i pasurisë, kur zëvendësojnë ose përmirësojnë sendet objekt uzufrukti.

Janë gjithashtu objekt uzufrukti, sendet që vilen nga përfitimet e tjera që jep uzufrukti, por që nuk janë fruta.

Investimet
Neni 243

Pronari dhe uzufruktari duhet të merren vesh që paratë objekt uzufrukti të investohen në mënyrë frutdhënëse ose të shpenzohen në interes të pasurisë tjetër në uzufrukt.

Dhënia me qira
Neni 244

Uzufruktari ka të drejtë të japë me qira sendet në uzufrukt përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të tij.

Kur mbaron uzufrukti, pronari duhet të respektojë qiranë e filluar normalisht më parë, përveç kur zgjatja e afatit të saj është bërë pa pëlqimin e tij. Kur uzufruktari ose qiramarrësi i kanë kërkuar pëlqimin pronarit për qiradhënien dhe ky nuk është përgjigjur në afatin e caktuar, quhet se pëlqimi është dhënë.

Kur pushon uzufrukti, qiradhëniet për një afat mbi pesë vjet, kanë vlerë vetëm për pesë vjet nga dita që ka filluar qiradhënia.

Gëzimi i servituteve
Neni 245

Uzufruktari gëzon të drejtat e servituteve të lidhura me pronën mbi të cilën ka uzufruktin dhe të drejtat e tjera reale që do t'i gëzonte vetë pronari, përveç kufizimeve të parashikuara në aktin e krijimit apo në ligj.

KREU III
DETYRIME QË RRJEDHIN NGA UZUFRUKTI

Zëvendësimi i dëmeve
Neni 246

Uzufruktari detyrohet të shpërblejë vleftën e sendit të humbur ose të dëmtimit të tij, përveç kur provon se nuk janë shkaktuar për fajin e tij.

Ai detyrohet të zëvendësojë sendet që, sipas uzufruktit, nuk kishte të drejtë t'i konsumonte.

Inventaret
Neni 247

Uzufruktari merr në dorëzim sendet në gjëndjen që ndodhen para fillimit të uzufruktit.

Sendet në uzufrukt merren në dorëzim me inventar të bërë me akt noterial, në prani të pronarit, pasi

të jetë njoftuar në një afat të përshtatshëm. është e drejtë e palëve që në inventar të shënohen të gjitha hollësitë që kanë lidhje me përcaktimin dhe gjëndjen e sendeve që merren në uzufrukt.

Inventari mund të kryhet edhe me akt privat, kur bien në marrëveshje të dy palët, që janë të pranishëm gjatë kryerjes së tij. Shpenzimet për kryerjen e inventarit janë në ngarkim të uzufruktarit, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Njoftimet periodike

Neni 248

Uzufruktari detyrohet t'i dërgojë pronarit në fund të çdo viti një njoftim të hollësishëm me shkrim të nënshkruar prej tij, për sendet që nuk ekzistojnë më ose për sendet që i kanë zëvendësuar ato, si dhe përfitimet e tjera nga sendet në uzufrukt, që nuk hyjnë në kategorinë e frutave.

Shpenzimet për kryerjen e detës vjetore, janë në ngarkim të uzufruktarit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Dhënia e garancisë

Neni 249

Uzufruktari detyrohet t'i japë pronarit një garanci me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga uzufrukti, përveç kur në aktin e krijimit është shkarkuar nga një detyrim i tillë ose kur interesat e pronarit mbi sendet në uzufrukt janë siguruar në mënyrë të mjaftueshme nga një institut i ngarkuar me këtë punë.

Prindërit që kanë uzufruktin ligjor mbi sendet në pronësi të fëmijëve të tyre, përjashtohen nga dhënia e një garancie të tillë.

Kur uzufruktari është shkarkuar nga detyrimi për dhënien e garancisë, pronarit i lind e drejta të kërkojë prej tij që t'i tregohen çdo vit sendet që i janë dhënë në uzufrukt ose të njihet me njoftimin e një institucioni krediti për paratë apo letrat me vlerë të depozituara.

Uzufruktari nuk mund të fitojë posedimin e sendeve të vëna në uzufrukt, pa plotësuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen.

Pasojat e mosdhënies së garancisë

Neni 250

Kur uzufruktari nuk jep garanci, merren masa për administrimin e sendeve në uzufrukt. Sendet e paluajtshme jepen me qira ose i besohen një administratori të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet pronarit e administratorit dhe kur nuk arrihet një marrëveshje e tillë, administratori caktohet nga gjykata e rrethit.

Uzufruktari ka të drejtë të mbajë për banim të tij dhe të familjes së tij, një banesë që përfshihet në uzufrukt.

Paratë që përfshihen në uzufrukt investohen me kamatë.

Sendet e luajtshme që vjetërohen ose dëmtohen nga përdorimi ose sendet ushqimore që rrezikohen të prishen, shiten dhe vlefta e tyre jepet me kamatë ose përdoret për sendet në uzufrukt.

Uzufruktari mund të kërkojë t'i lihen sende të luajtshme të mjaftueshme për përdorim vetjak.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

Neni 251

Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sendit janë në ngarkim të uzufruktarit. Janë gjithashtu në ngarkim të tij edhe shpenzimet për ndreqjet jo të zakonshme, kur ato janë rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të tij ndaj sendit në uzufrukt.

Riparimet e jashtëzakonshme janë në ngarkim të pronarit. Kur pronari refuzon t'i kryejë ato ose të tjerat që i janë ngarkuar atij, ose vonon pa arsye kryerjen e tyre, uzufruktari i kryen vetë me shpenzimet e tij, të cilat shlyhen deri në përfundimin e uzufruktit. Uzufruktari ka të drejtë të mbajë sendin e ndrequr deri në shlyerjen e shpenzimeve.

Sigurimi i uzufruktit
Neni 252

Uzufruktari duhet të sigurojë sendet në uzufrukt në favor të pronarit për rreziqet që zakonisht ato duhet të sigurohen ose që janë të detyrueshme nga ligji. Në rast dëmtimi uzufrukti shtrihet mbi shpërblimin e paguar.

Kur uzufrukti nuk përmbush një detyrim të tillë, pronari ka të drejtë të bëjë vetë sigurimin e pronës dhe uzufruktari detyrohet t'i paguajë shpenzimet përkatëse.

Shpronësimi i sendeve në uzufrukt
Neni 253

Kur sendi shpronësohet për interesa publike, uzufrukti kalon mbi shpërblimin përkatës.

Pagimi i taksave dhe i detyrimeve të tjera
Neni 254

Tatimet, taksat, shpëblimet, rentat tokësore dhe detyrimet e tjera vjetore që kanë lidhje me të ardhurat gjatë uzufruktit janë në ngarkim të uzufruktarit.

Tatimet, taksat e detyrimet e tjera në ngarkim të pronës gjatë uzufruktit, janë në ngarkim të pronarit.

KREU IV
MBARIMI I UZUFRUKTIT

Neni 255

Uzufrukti mbaron:
- me vdekjen e uzufruktarit ose me mbarimin e personit juridik uzufruktar;
- me mbarimin e afatit të caktuar në aktin e krijimit;
- me bashkimin e cilësive të pronarit e të uzufruktarit në një person të vetëm;
- me shkatërrimin tërësisht ose humbjen e sendit të dhënë në uzufrukt;
- me mospërdorimin e uzufruktit radhazi për njëzetë vjet.

Pushimi i uzufruktit
Neni 256

Uzufrukti mund të pushojë kur uzufruktari shpërdoron të drejtat ose nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzufrukti.

Megjithatë gjykata, sipas rrethanave që do të rezultojnë mund të urdhërojë që uzufruktari t'i japë garanci, në rast se ka qënë shkarkuar nga një detyrim i tillë, ose me kërkesën e pronarit t'i lihet atij administrimi i sendit në uzufrukt ose një personi tjetër ose dhe dhënia me qira e sendit.

Heqja dorë nga uzufrukti
Neni 257

Uzufruktari mund të kërkojë që, me shpenzimet e tij, të heqë dorë nga uzufrukti për shkak të barrëve e detyrimeve që rrjedhin prej tij.

Kthimi i sendeve në uzufrukt
Neni 258

Kur mbaron uzufrukti, uzufruktari ose trashëgimtarët e tij detyrohen të vënë në dispozicion të pronarit sendet e vëna në uzufrukt.

TITULLI V
PËRDORIMI E BANIMI

Neni 259

Personi që ka një të drejtë thjesht përdorimi mbi një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij.

Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë.

Neni 260

Dispozitat që kanë lidhje me uzufruktin zbatohen dhe për të drejtën e përdorimit dhe të banimit, për aq sa përputhen me këto të drejta.

TITULLI VI
SERVITUTET

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 261

Servituti është barra që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një prone të një pronari tjetër.

Neni 262

Servituti vendoset me ligj ose me vullnetin e njeriut.

Neni 263

Pronari i pronës shërbyese nuk është i detyruar të kryejë ndonjë veprim për të bërë të mundur ushtrimin e servitutit, përveç kur në ligj ose nga titulli, parashikohet ndryshe.

Neni 264

Pronari, në favor të të cilit është vënë servituti, detyrohet t'i shpërblejë pronarit të pronës shërbyese dëmin që i shkaktohet nga krijimi i servitutit.

KREU II
SERVITUTET DETYRUESE

Neni 265

Pronari i një prone që, në bazë të ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga pronari i një prone tjetër krijimin e një servituti, në mungesë të një marrëveshjeje, mund t'i drejtohet gjykatës.

Servituti detyrues mund të krijohet edhe me akt të organit shtetëror, në rastet e parashikuara me ligj.

Vendimi duhet të përcaktojë rregullat e ushtrimit të servitutit dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Rrjedhja e ujërave

Neni 266

Pronari është i detyruar të pranojë në tokën e tij ujërat e shiut, të borës ose të burimeve të pashfrytëzuara, që rrjedhin natyrshëm nga një tokë me nivel më të lartë. Pronari nuk mund të ndryshojë këtë rrjedhë natyrore në dëm të një tjetri.

Uji që rrjedh mbi një tokë të mëposhtme mund të mbahet nga pronari i tokës së mësipërme, vetëm në masën që është e domosdoshme për atë tokë.

Neni 267

Në rastet kur anëbrigjet dhe shpatet e një prone që shërbenin për të ndaluar ujërat, janë shkatërruar ose dëmtuar, si dhe kur del e nevojshme që nga shkaku i ujërave të ndërtohen mbrojtësa dhe pronari i asaj prone nuk pranon t'i ndërtojë ose t'i riparojë, pronarët e dëmtuar ose që rrezikohen të dëmtohen, mundet që me shpenzimet e tyre t'i ndërtojnë ose t'i riparojnë ato.

Këto ndërtime e riparime duhet të kryhen pa iu shkaktuar pronarit të pronës shërbyese ndonjë dëm, duke respektuar rregullat e posaçme, kur ka të tilla. Kur pronari i pronës shërbyese ka kundërshtime, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Neni 268

Dispozitat e nenit të mësipërm zbatohen edhe kur del e nevojshme të hiqet një pengesë lëndësh të formuara në një pronë tjetër ose në një hendek, rrjedhë uji ose vijë kulluese, të cilat dëmtojnë pronat fqinje.

Neni 269

Pronari që ka një burim uji në pronën e vet është i lirë në përdorimin e tij, por pa cenuar të drejtat që mund të ketë fituar pronari i pronës më të ulët në bazë të një titulli ose me parashkrim.

Neni 270

Në rast se një rrjedhë uji u ndalon pronarëve të pronave ngjitur, hyrjen në këto ose vazhdimin e vaditjes apo të kullimit të ujërave, ata që përdorin këtë rrjedhë, detyrohen që në proporcion me përfitimin që nxirret prej tij (ujit) të ndërtojnë e të mirëmbajnë urat e mjetet e tjera të kalimit, në mënyrë

të volitshme e të sigurt, si dhe gypat e nëndheshëm ose vepra të tjera të kësaj natyre për vazhdimin e ujitjes e të kullimit.

Neni 271

Pronari i një toke detyrohet të pranojë pa shpërblim ujërat që vijnë nga drenazhimi i një toke të mësipërme, kur ato rrjedhin natyrshëm në tokën e tij.

Kur nga kjo rrjedhë i shkaktohet dëm, ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe marrjen e masave për mënjanimin në të ardhmen.

Servitutet që rrjedhin nga ndërtimet

Neni 272

Rregullat për ndërtimin e banesave e të ndërtimeve të tjera, largësia ndërmjet tyre, marrja e dritës dhe e pamjes, nxjerrja e ballkoneve e ndërtime të tjera të kësaj natyre, rregullohen me ligj të veçantë duke respektuar të drejtat e pronarit të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Servitutet që rrjedhin nga marrja e ujit

Neni 273

Kalimi i ujërave nëpër pronën e tjetrit duhet të kryhet në mënyrën më të volitshme e më të përshtatshme me më pak dëme, por pa penguar ushtrimin normal të servitutit.

Neni 274

Kur kalimi i ujërave kërkohet për një kohë jo më të gjatë se nëntë vjet, pagimi i vleftës dhe i shpërblimit të dëmeve të përmendura në dispozitën e mësipërme bëhet në gjysmën e kësaj vlefte, me detyrimin që me mbarimin e afatit të rivihet gjithçka në gjendjen e mëparshme.

Ky servitut mund të bëhet i përhershëm kur kjo kërkohet para mbarimit të afatit, nëpërmjet pagimit të gjysmës tjetër, të vleftës së bashku me kamatat ligjore, nga data që ka filluar kalimi.

Kur kërkesa bëhet pas mbarimit të afatit, nuk merren parasysh pagesat për dhënien përkohësisht të kësaj të drejte.

Neni 275

Kur kalimi i ujërave duhet të kryhet duke përshkuar rrugë publike ose lumenj e ndërtime të tjera publike, zbatohen rregullat e parashikuara në dispozita të veçanta.

Neni 276

Kur në një shtëpi ose në mjediset e tjera të saj mungon uji i nevojshëm për jetesën e njerëzve ose të kafshëve dhe nuk mund të sigurohet ndryshe, ose nevojiten shpenzime të mëdha, pronari i tokës fqinje duhet të lejojë që një sasi uji tepricë të përdoret në masën e domosdoshme për nevojat e mësipërme, duke përballuar pala tjetër vleftën e ujit që kërkohet dhe shpenzimet që duhet të kryhen për këtë qëllim, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin që mund të shkaktohet.

Servituti i kalimit

Neni 277

Pronari që nuk ka dalje në rrugën publike dhe nuk mund ta sigurojë atë përveç se me shpenzime të mëdha e me vështirësi, ka të drejtë të ketë rrugë kalimi nga toka fqinje, për përdorimin e përshtatshëm të pronës së vet.

Kalimi duhet të përbëjë rrugën më të shkurtër për në rrugën publike dhe me më pak dëme për pronën shërbyese.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur pronari, që i është njohur e drejta e kalimit në pronën e tjetrit, kërkon zgjerimin e arsyeshëm të rrugë-kalimit për mjete, duke përfshirë edhe kalimin e mjeteve mekanike.

Neni 278

Pronari duhet të lejojë fqinjin të hyjë e të kalojë në tokën e tij sa herë ka nevojë të ndërtojë ose të ndreqë një mur apo një vepër tjetër. Ai duhet të lejojë personin që të kërkojë e të marrë gjënë e gjallë e çdo send tjetër të tij, që ndodhen aty rastësisht ose si rrjedhim i erës, ujit, orteqeve dhe forcave të tjera madhore, ndodhen në tokën e tij apo janë bashkuar me sende të tij.

Pronari mund të mos lejojë hyrjen kur merr përsipër të dorëzojë vetë sendin e ndodhur në tokën e tij. Kur është rasti pronari i tokës shpërblehet për dëmin e shkaktuar.

Neni 279

Personi që do të kalojë në tokën e tjetrit, duhet të paguajë vleftën e tokës që zihet, pa zbritur tatimet e barrët e tjera që lidhen me tokën, si dhe shpërblimin për dëmin që shkaktohet duke përfshirë edhe dëmin që vjen nga ndërprerja e tokës, nga mospërdorimi i saj, nga depozitimi i lëndëve të nxjerra e hedhja e mbeturinave. Pronari i tokës shërbyese ka të drejtë të largojë këto të fundit dhe ta përdorë sipërfaqen e tokës, por gjithnjë pa dëmtuar ushtrimin normal të servitutit.

Servituti për vendosjen e gypave, kabllove e telave

Neni 280

Pronari duhet të lejojë persona të tjerë që të ndërtojnë në pronën e tij të paluajtshme kanale ose të vendosin gypa për kalimin e ujit ose të gazit, si dhe kabllo e tela telegrafikë ose elektrikë dhe instalime të tjera të kësaj natyre, por vetëm kur këto vepra nuk kanë mundësi të kryhen ndryshe ose pa u bërë shpenzime të mëdha. Pronari, kur i shkaktohet dëm, ka të drejtë të shpërblehet.

KREU III
SERVITUTET VULLNETARE

Neni 281

Pronari mund të krijojë mbi pronat e veta ose në dobi të tyre, çdo lloj servituti, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik.

Servitutet vullnetare krijohen me kontratë ose me testament.

Neni 282

Servitutet janë vijuese kur ushtrimi i tyre bëhet pa qenë nevoja për veprime të herëpasherëshme të njeriut, siç janë vijat e ujit, pikat e strehëve e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet janë jo vijuese, kur në ushtrimin e tyre kërkohet kryerja e veprimeve të tashme të njeriut, siç janë e drejta për të marrë ujë, për kullotjen e bagëtive e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet mund të jenë të dukshme e të padukshme.

Të padukshme janë servitutet për të cilat nuk nevojiten punime të dukshme ose të përhershme, që janë të nevojshme për ushtrimin e tyre.

Neni 283

Servitutet vijuese e të dukshme krijohen me titull ose me parashkrimin dhjetë vjeçar. Servitutet vijuese të padukshme dhe servitutet jo vijuese, të dukshme ose jo, nuk mund të krijohen veçse me titull.

Neni 284

Kur dy prona pushojnë së qëni në pronësinë e një personi, servituti konsiderohet se ekziston në mënyrë aktive apo pasive në dobi ose kundër secilës nga pronat e veçuara, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

KREU IV
MËNYRAT E USHTRIMIT TË SERVITUTEVE

Neni 285

E drejta e servitutit përfshin çdo gjë që është e nevojshme për ta përdorur atë.

Neni 286

Pronari, pa pëlqimin e uzufruktarit, nuk mund të ngarkojë pronën me servitute që cenojnë të drejtat e uzufruktarit.

Neni 287

Servituti mbi një pronë që u përket disa personave në bashkëpronësi mund të krijohet vetëm me miratimin e gjithë bashkëpronarëve. Servituti i krijuar nga vetëm një ose disa bashkëpronarë, hyn në fuqi kur bashkëpronarët e tjerë bashkarisht apo veçmas, kanë dhënë miratimin për krijimin e tij.

Neni 288

Personi që ka një të drejtë servituti, duhet ta përdorë atë sipas titullit të tij ose të posedimit të tij. Kur ka dyshime rreth shtrirjes dhe mënyrës së ushtrimit të tij, quhet se servituti është krijuar në mënyrë të tillë që të plotësojë nevojat e pronës dominuese, duke rënduar sa më pak pronën shërbyese.

Neni 289

E drejta e servitutit duhet të ushtrohet në kohën dhe në mënyrën që sjell më pak vështirësi e shqetësime për pronarin e pronës shërbyese.

Neni 290

Kur prona në dobi të së cilës është krijuar një servitut pjestohet, servituti do t'i shërbejë secilës pjesë, me kusht që barra e pronës shërbyese të mos rëndohet.

Neni 291

Pronari nuk duhet që me veprimet ose mosveprimet e tij të pakësojë përdorimin e servitutit ose ta bëjë atë më të vështirë.

Megjithë këtë, në qoftë se kanë ndryshuar kushtet dhe pronari i pronës shërbyese rëndohet ose pengohet në ushtrimin e të drejtave të pronësisë, mund t'i kërkojë pronarit, në dobi të të cilit është vënë servituti, ndërrimin e vendit të servitutit.

Këtë të drejtë e ka edhe pronari i pronës tjetër, kur provohet se ky ndërrim sjell dobi dhe nuk dëmton pronën shërbyese.

Mbrojtja e servitutit

Neni 292

Personi që ushtron një servitut, ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht nga kushdo që kundërshton këtë të drejtë, duke kërkuar sipas rastit rivendosjen e plotë të saj, pushimin e cenimit që i bëhet si edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

KREU V
SHUARJA E SERVITUTEVE

Neni 293

Servitutet shuhen:

a) Kur në një person të vetëm bashkohet pronësia e pronës mbizotëruese me atë të pronës shërbyese.

b) Kur nuk përdoret për më shumë se dhjetë vjet.

Afati i parashkrimit për servitutet jo vijuese fillon të ecë nga dita kur servituti ka pushuar së përdoruri, ndërsa për servitutet vijuese nga dita kur është kryer një vepër ose është vërtetuar një fakt që pengon ushtrimin e servitutit. Për efekt të shuarjes së servitutit, llogaritet edhe koha që ai është ushtruar nga titullari i mëparshëm.

c) Kur sendet dëmtohen ose konsumohen deri në një shkallë sa nuk mund të përdoren për qëllimin e tyre.

Rikthimi në një gjendje që mund të përdoren sjell si rrjedhim edhe rivendosjen e servituteve, përveç kur kjo e drejtë është parashkruar.

Neni 294

Kur prona mbizotëruese është në bashkëpronësi, përdorimi i servitutit nga njëri prej bashkëpronarëve, ndërpret parashkrimin edhe ndaj bashkëpronarëve të tjerë.

Neni 295

Pezullimi ose ndërprerja e parashkrimit në favor të njërit nga bashkëpronarët, ka efekt edhe në favor të të tjerëve.

TITULLI VII
MBROJTJA E PRONËSISË

Padia për kërkimin e sendit

Neni 296

Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Të drejtat e poseduesit për të ardhurat

Neni 297

Poseduesit me mirëbesim i takojnë frutat natyrore të veçuara dhe frutat civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dijeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ai nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelur, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij.

Neni 298

Poseduesi me keqbesim për gjithë kohën e posedimit të tij, detyrohet t'i kthejë pronarit bashkë me sendin edhe frutat natyrore të veçuara e frutat civile të vjela ose që janë bërë të kërkueshme, dhe të ardhurat e tjera që duhej të vilte, si dhe të shpërblejë pronarin për përdorimin e sendit dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit qoftë dhe pa fajin e tij.

Ai shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se dëmi do të shkaktohej edhe sikur të kishte dorëzuar sendin në kohën e duhur, përveç kur ai është marrë me anë vepre penale.

E drejta e poseduesit për shpenzimet

Neni 299

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të nevojshme që kanë bërë për sendin dhe shpenzimet e dobishme, në masën që këto i kanë shtuar vleftën, në qoftë se kjo vazhdon të jetë në kohën e kthimit të sendit.

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të zbresë nga të ardhurat e sendit, shpenzimet që i njihen sipas kësaj dispozite. Ai ka të drejtë të mbajë sendin, gjersa t'i paguhen shpenzimet e nevojshme të dobishme.

Neni 300

Poseduesi me keqbesim ka të drejtë të kërkojë vetëm pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.

Neni 301

Poseduesi me mirëbesim dhe ai me keqbesim, përveç shpenzimeve që u njihen sipas neneve të këtij Kodi, nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagimin e shpenzimeve të tjera të bëra për sendin, por vetëm kanë të drejtë të heqin nga sendi atë që kanë bashkuar dhe që mund të ndahet pa dëm, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre.

Padia mohuese

Neni 302

Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar.

Kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm
Neni 303

Pronari, personi që gëzon një të drejtë tjetër reale ose poseduesi, të cilët kanë arsye të shqetësohen se nga një punim i ri i filluar prej të tjerëve në tokën e tyre ose të tjetërkujt, mund t'i vijë dëm sendit në pronësi ose në posedimin e tij, mund t'i drejtohet gjykatës me kusht që ky punim të mos ketë përfunduar ose të mos ketë kaluar një vit nga fillimi i tij.

Gjykata sipas rastit vendos ndalimin e punimit, shëmbjen ose pakësimin e tij dhe kur është rasti edhe shpërblimin e dëmit ose rrëzon padinë duke urdhëruar shpërblimin e dëmit kur rezulton se punimi ka qënë ndaluar padrejtësisht.

TITULLI VIII
POSEDIMI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i posedimit
Neni 304

Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.

Llojet e posedimit
Neni 305

Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm. Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.

Në të gjitha rastet e tjera posedimi është i paligjshëm.

Neni 306

Posedimi i paligjshëm mund të jetë me mirëbesim ose me keqbesim.

Posedimi është me mirëbesim kur poseduesi nuk ka ditur ose nuk ishte i detyruar të dinte se posedimi i tij është i paligjshëm.

Mirëbesimi prezumohet dhe mjafton të ketë qënë në kohën e fitimit të posedimit.

Prezumime mbi posedimin
Neni 307

Poseduesi i tanishëm që ka poseduar në një kohë të mëparshme, prezumohet se ka poseduar edhe në kohën e ndërmjetme.

Neni 308

Posedimi i tanishëm nuk prezumon posedimin e mëparshëm, përveç kur poseduesi ka një titull që përbën bazën e posedimit të tij.

Në këtë rast poseduesi prezumohet që të ketë qënë poseduar që nga data e titullit.

Mënyrat e fitimit të posedimit
Neni 309

Posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim. Ai që ka fituar posedimin me mirëbesim, mund të bashkojë në posedimin e vet, edhe kohën e posedimit me mirëbesim të personit nga i cili ka fituar sendin.

KREU II
MBROJTJA E POSEDIMIT DHE E MBAJTJES

Mbrojtja e atëçastme
Neni 310

Poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër, por duke evituar veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes.

Neni 311

E drejta për të mbrojtur posedimin i njihet edhe mbajtësit të sendit, kundër çdo personi tjetër, përveç ndaj atij nga i cili i vijnë këto të drejta.

Pushimi i cenimit të posedimit
Neni 312

Personi, që cenohet në posedimin e një sendi, mund të kërkojë brenda gjashtë muajve, pushimin e cenimit të posedimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen.

Kur posedimi është fituar me dhunë ose fshehurazi, padia mund të ngrihet brenda gjashtë muajve nga dita kur dhuna ose fshehtësia kanë pushuar.

Pushimi i cenimit të posedimit nuk mund të kërkohet nga personi që ka fituar posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Rivendosja në posedim
Neni 313

Poseduesi, që në mënyrë të paligjshme është zhveshur nga posedimi, ka të drejtë të kërkojë brenda gjashtë muajve, rivendosjen e tij në posedim.

Këtë të drejtë nuk e ka poseduesi që ka marrë posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Kur zhveshja është e fshehtë, afati për të kërkuar rivendosjen e posedimit fillon nga dita e zbulimit të zhveshjes.

Neni 314

Rivendosja mund të kërkohet edhe kundër atij që e ka fituar posedimin nëpërmjet një titulli, por që ka patur dijeni për zhveshjen e ndodhur.

Neni 315

Gjatë gjykimit të padisë për pushimin e cenimit ose rivendosjen në posedim, i padituri nuk mund të pretendojë se është vetë pronar ose ka një të drejtë më të fortë se ajo e poseduesit.

PJESA III

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i trashëgimit
Neni 316

Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 317

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Koha dhe vendi i çeljes së trashëgimit
Neni 318

Trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlënësi dhe në vendin ku ai ka patur banimin e tij të fundit. Kur ky nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj. Ajo rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur.

Neni 319

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën disponohen ose përdorohen të drejta që rrjedhin nga një trashëgim ende i paçelur.

Zotësia për të trashëguar
Neni 320

Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë.

Prezumohet se ka qënë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.

Neni 321

Kur dy ose më shumë persona thirren për të trashëguar njëri tjetrin dhe nuk vërtetohet se cili prej tyre ka vdekur më parë, prezumohet se të gjithë kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe nuk kalon ndonjë e drejtë nga njëri tek tjetri.

Padenjësia
Neni 322

Nuk mund të trashëgojë si i padenjë:

- ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
- ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal;

- ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
- ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.

Neni 323

Padenjësia e prindit ose e të paralindurit, nuk përjashton fëmijët ose të paslindurit e këtij, si kur trashëgojnë vetë, ashtu dhe kur vijnë në trashëgim me zëvendësim. Në një rast të tillë, prindi i padenjë, në pjesën trashëgimore që u vjen fëmijëve të tij nuk mund të gëzojë të drejtat e uzufruktit dhe të administrimit, që ligji u njeh prindërve mbi pasuritë e fëmijëve të tyre.

Falja e padenjësisë

Neni 324

Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me akt noterial ose me testament, ose kur falja, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë e megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.

Detyrimet e trashëgimtarit të padenjë

Neni 325

Personi i përjashtuar nga trashëgimi si i padenjë detyrohet të kthejë frutat dhe çdo të ardhur tjetër që ka marrë nga pasuria në trashëgim pas çeljes së trashëgimisë.

Zëvendësimi

Neni 326

Zëvendësimi lejon vënien e zëvendësuesve në vendin, shkallën dhe në të drejtat e atij që zëvendësojnë.

Neni 327

Zëvendësimi në vijë të drejtë i të paslindurve, bëhet pa kufi dhe në të gjitha rastet, qoftë kur fëmija e trashëgimlënësit të konkurrojë me të paslindurit e një fëmije tjetër të paravdekur, qoftë dhe kur fëmijët e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij dhe të paslindurit e këtyre janë ose jo në shkallë të njëjta, ose të numrit të tyre sipas barqeve.

Neni 328

Për të paralindurit në vijë të drejtë nuk ka zëvendësim; më i afërti përjashton të tjerët.

Neni 329

Në vijë të tërthortë, zëvendësimi pranohet në favor të fëmijëve e të paslindurve, të vëllezërve e motrave të trashëgimlënësit, edhe sikur këta të konkurrojnë me ungjët apo emtat e tyre apo me të paslindurit e tyre në shkallë të njëjtë ose jo.

Fitimi i trashëgimit

Neni 330

Trashëgimi fitohet me vdekjen e trashëgimlënësit.

Neni 331

Me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë.

Neni 332

Trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar apo një të drejtë tjetër pasurore.

Heqja dorë nga trashëgimi

Neni 333

Heqja dorë nga trashëgimi duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet në gjykatën e rrethit të vendit ku është çelur trashëgimi, ose me gojë në një procesverbal gjyqësor.

Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 334

Ai që ka hequr dorë nga trashëgimi, quhet se nuk është thirrur ndonjëherë në trashëgim. Heqja dorë nga trashëgimi nuk përjashton trashëgimtarin nga e drejta për të kërkuar legët.

Neni 335

Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.

Për trashëgimtarin që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati i heqjes dorë nga trashëgimi fillon nga dita e lindjes.

Afati i heqjes dorë nga trashëgimi pezullohet për shkaqet që vlejnë për parashkrimin e padies.

Neni 336

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë, ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ta, gjykata e rrethit ku është çelur trashëgimia, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, cakton një afat, jo më pak se gjashtë muaj nga çelja e trashëgimisë, brenda të cilit ata duhet të deklarojnë në se heqin dorë nga trashëgimi. Në qoftë se brenda këtij afati nuk bëhet ndonjë deklarim i tillë, prezumohet se trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë.

Neni 337

Heqja dorë nga trashëgimi, e bërë para çeljes së trashëgimisë, ose kur bëhet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit, apo në dobi të njërit nga trashëgimtarët e tjerë, është e pavlefshme.

Neni 338

Nuk mund të hiqet dorë nga trashëgimi, kur gjatë afatit tremujor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar.

Veprimet që kryhen vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, nuk konsiderohen si sjellje prej trashëgimtari.

Trashëgimtarët që kanë hequr ose fshehur sende nga trashëgimi, humbasin të drejtën e heqjes dorë dhe mbeten trashëgimtarë edhe sikur të kenë deklaruar heqjen dorë nga trashëgimi.

Neni 339

Trashëgimtari që ka deklaruar rregullisht heqjen dorë ose jo nga trashëgimi, nuk mund ta shfuqizojë më pas këtë deklarim.

Neni 340

Kur trashëgimtari vdes para se të kalojë afati për heqjen dorë nga trashëgimi, e drejta për heqjen dorë u kalon trashëgimtarëve të tij.

Pagimi i detyrimeve

Neni 341

Trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë.

Quhen detyrime që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ato të trashëgimlënësit, shpenzimet e varrimit të tij dhe shpenzimet që nevojiten për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë trashgimore, deri sa ajo t'u kalojë trashëgimtarëve përkatës.

Neni 342

Kur në një trashëgim, një ose disa prona të paluajtshme janë të rënduara me hipotekë, secili trashëgimtar ka të drejtë të kërkojë që këto prona të lirohen nga hipoteka para se të bëhet formimi i pjesëve trashëgimore.

Megjithëkëtë, trashëgimtari që e ka shlyer detyrimin që rrjedh nga hipoteka e vënë mbi një send të paluajtshëm në pjesën trashëgimore të tij, ka të drejtën e kthimit ndaj trashëgimtarëve të tjerë, në proporcion me pjesët e tyre.

Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Neni 343

Kur shihet e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, të personave që mund të përfitojnë nga disponimet me testament, të kreditorëve të trashëgimlënësit ose të shtetit, gjykata e rrethit ku është çelur trashëgimia, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, urdhëron përmbaruesin gjyqësor osa një noter për të bërë inventarin e pasurisë trashëgimore.

Përmbaruesi gjyqësor ose noteri që bën inventarin mund të caktojë një person si ruajtës i pasurisë trashëgimore.

Derisa të mos jenë hequr masat e mësipërme, trashëgimtari që mund të ketë filluar nga administrimi i pasurisë trashëgimore, nuk mund ta tjetërsojë atë veçse me lejen e gjykatës.

Neni 344

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ata ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentorë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre, gjykata e rrethit ku është çelur trashëgimi, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit.

Shkurtimi i vendimit të emërimit të kujdestarit, shpallet në Fletoren Zyrtare.

Neni 345

Kujdestari kërkon kryerjen e inventarit të pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe u përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgim ose që rrjedhin prej tij, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit.

Neni 346

Me miratimin e gjykatës kujdestari paguan detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ekzekuton detyrimet në lidhje me leget dhe barrët dhe, kur shihet e nevojshme tjetërson edhe pasuri trashëgimore.

Neni 347

Detyra e kujdestarit pushon me paraqitjen e treshëgimtarit.

Dëshmia e trashëgimisë

Neni 348

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga gjykata, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Padia për kërkimin e trashëgimit

Neni 349

Trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon tërësisht ose pjesërisht pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, sipas rregullave mbi posedimin me mirëbesim dhe me keqbesim.

Neni 350

Padia për kërkimin e trashëgimit mund të ngrihet edhe kundër personit që mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi, qoftë dhe kur ky është shteti. Personi që ka fituar me mirëbesim ndonjë send të pasurisë trashëgimore nga një trashëgimtar i tillë, nuk është i detyruar të kthejë sendin edhe sikur të jetë fituar me kundërshpërblim.

Poseduesi me mirëbesim që ka tjetërsuar po në mirëbesim sende nga pasuria trashëgimore, është vetëm i detyruar që t'i kthejë trashëgimtarit paditës çmimin e sendit të shoqëruar me faturën përkatëse. Kur këto të fundit nuk janë shlyer, këtij i kalon e drejta për të kërkuar shlyerjen e tyre.

Neni 351

Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara.

Neni 352

Dispozitat që kanë lidhje me posedimin, zbatohen edhe për posedimin e sendeve në trashëgim, përsa i përket kërkimit të frutave, të shpenzimeve të kryera ose për përmirësimet dhe shtesat e bëra.

Pjesëtimi i trashëgimit

Neni 353

Cilido nga bashkëtrashëgimtarët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e pasurisë trashëgimore edhe sikur trashëgimlënësi të ketë urdhëruar ndryshe.

Neni 354

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore mund të bëhet me marrëveshje të vetë trashëgimtarëve dhe, kur këta nuk merren vesh, nga gjykata kompetente për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia.

Neni 355

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 207 të këtij Kodi dhe në dispozitat e tjera të këtij kreu.

Neni 356

Në formimin e pjesëve takuese duhet që, sa të jetë e mundur, në secilën prej tyre të bëjnë pjesë nga po ajo sasi sendesh të luajtshme ose të paluajtshme, të drejtash reale ose kredish, që kanë natyrë e vleftë të njëjtë.

Neni 357

Kur kreditorët kanë vënë sekuestro mbi sendet e luajtshme të pasurisë trashëgimore, ose kanë kundërshtuar pjesëtimin sipas nenit 206 të këtij Kodi, ose shumica e bashkëtrashëgimtarëve e shohin të nevojshme pagimin e detyrimeve që rëndojnë mbi trashëgimin, sendet e luajtshme shiten në ankand.

Neni 358

Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës.

Bashkëtrashëgimtarët, që me punën ose të ardhurat e tyre kanë ndihmuar në shtimin e pasurisë së lënë në trashëgim, kanë të drejtë të kërkojnë pjesën e tyre në pasurinë e sipërme të shtuar, sipas kontributit të dhënë.

Neni 359

Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore.

Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

TITULLI II
TRASHËGIMIA ME LIGJ

Neni 360

Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod.

Neni 361

Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.

Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjne me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.

Kur përveç bashkëshortit nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë, në trashëgim thirren ata të radhës pasardhëse të parashikuar në nenin 362 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse të parashkruara prej nenit 363 të këtij Kodi.

Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit.

Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve te sipërme, trashëgimi i mbetet bashkëshortit pasjetues.

Neni 362

Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia është njohur rregullisht si dhe fëmijët e birësuar, barazohen me fëmijët legjitimë.

I birësuari nuk trashëgon ne familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

Neni 363

Në radhë te dytë thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij.

Neni 364

Në radhë të tretë thirren në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit që përmenden në nenin 363 të këtij Kodi, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë, gjyshi e gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur. Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve e motrave të një ati ose vetëm të një nëne, ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana a babës ose e nënës.

Neni 365

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmve më të afërt të tij, pa bërë dallim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e gjashtë.

Neni 366

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

Neni 367

Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e trashëgimlënësit tej vleftës së pasurisë të fituar.

E drejta e shtimit për sendet shtëpiake

Neni 368

Trashëgimtarët që bashkëjetonin me trashëgimlënësin në kohën e vdekjes së tij, kur thirren në trashëgim, marrin tej pjesës që u takon në pasurinë trashëgimore sendet shtëpiake të përdorimit të zakonshëm, përveç kur trashëgimlënësi ka disponuar ndryshe në testament.

Trashëgimia sipas radhëve

Neni 369

Trashëgimtarët e një radhe të mëpasme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparëshme ose kur këta të gjithë janë bërë të padenjë ose kanë hequr dorë nga trashëgimi ose janë përjashtuar nga trashëgimi, përveç kur nga trashëgimtarët e radhës së dytë mbetet trashëgimtari i paaftë për punë dhe ka trashëgimtarë të radhës së tretë.

E drejta e shtimit

Neni 370

Kur një nga bashkëtrashëgimtarët që thirret në trashëgim ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është përjashtuar nga trashëgimi dhe nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të asaj radhe.

Trashëgimtari i paaftë për punë

Neni 371

Trashëgimtarë të paaftë për punë janë ata që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç si dhe, pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë.

TITULLI III
TRASHËGIMIA ME TESTAMENT

Kuptimi i testamentit
Neni 372

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes.

Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke.

Zotësia për të disponuar me testament
Neni 373

Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar.

I mituri nga 14 gjer në 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij.

Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e bërjes së testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Zotësia për të fituar me testament
Neni 374

Janë të pazotë për të fituar me testament ata që janë të pazotë për të trashëguar me ligj me përjashtim të fëmijëve të pandërmjetshëm të një personi të caktuar dhe të gjallë në kohën e vdekjes së testatorit edhe sikur ata fëmijë të mos jenë zënë ende.

Neni 375

Kujdestari nuk mundet në asnjë rast të përfitojë nga disponimet testamentare të personit në kujdestari kur ato janë bërë para miratimit të llogarisë përfundimtare, edhe sikur testatori të ketë vdekur pas miratimit të llogarisë.

Janë të vlefshme disponimet e bëra në favorin e kujdestarit, kur ky është i paralindur, i paslindur, vëlla, motër ose, bashkëshorti i testatorit.

Neni 376

Disponimi testamentar në favor të personave të pazotë që përmenden në nenet 374 e 375 të këtij Kodi, është i pavlefshëm edhe sikur të jetë fshehur nën formën e një kontrate me shpërblim ose të jetë bërë nën emrin e një personi të ndërvënë.

Quhen persona të ndërvënë: i ati, e ëma, të paslindurit dhe bashkëshorti i personit të pazot.

Caktimi i trashëgimtarit
Neni 377

Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik.

Përjashtimi nga trashëgimia
Neni 378

Trashëgimlënësi edhe pa caktuar trashëgimtarë në testament mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore një ose më shumë trashëgimtarë të tij.

Rezervë ligjore
Neni 379

Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

Neni 380

Kur testatori disponon me testament një uzufrukt ose një rentë jetësore, të ardhurat e të cilave kalojnë ato të pjesës së disponueshme, trashëgimtarët që kanë të drejtë në rezervën ligjore munden të ekzekutojnë këtë disponim ose të heqin dorë nga të drejtat mbi pjesën e disponueshme.

Po këtë të drejtë zgjedhjeje e kanë edhe personat që përfitojnë nga rezerva ligjore në rast se testatori ka disponuar pronësinë e zhveshur të një pjese që kalon masën e disponueshme.

Zëvendësimi
Neni 381

Trashëgimlënësi mund të caktojë në testament që në rast se trashëgimtari vdes para tij ose bëhet i padenjë, ose heq dorë nga trashëgimi, ta marrë trashëgimin një nga trashëgimtarët e tjerë që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, dhe kur nuk ka asnjë nga këta, ta marrë një njeri tjetër.

Por trashëgimlënësi nuk mund të detyrojë trashëgimtarin që të ruajë dhe, pas vdekjes së tij t'ia dorëzojë një personi tjetër të gjithë ose një pjesë të trashëgimit që ka marrë.

E drejta e shtimit
Neni 382

Kur trashëgimlënësi ua ka lënë të gjithë pasurinë e tij trashëgimtarëve të caktuar në testament dhe një nga këta trashëgimtarë ka vdekur para tij, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar për këto raste një trashëgimtar tjetër në vend të tij, si dhe kur një trashëgimtar është përjashtuar nga trashëgimi, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të tjerë të caktuar në testament në përpjestim me pjesët e tyre trashëgimore.

Në qoftë se disa nga trashëgimtarët janë caktuar së bashku në një pjesë të pasurisë, shtimi bëhet vetëm midis këtyre bashkëtrashë-gimtarëve.

Neni 383

Kur trashëgimlënësi ka lënë me testament vetëm një pjesë të pasurisë së tij, edhe sikur në këtë pjesë të ketë caktuar së bashku shumë trashëgimtarë, pjesa e atij që për shkaqet e treguara në nenin e sipërm nuk mund ose nuk do të jetë trashëgimtar, u kalon trashëgimtarëve ligjore të trashëgimlënësit.

Legu dhe barra

Neni 384

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament, nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, që t'u japin një ose më shumë trashëgimtarëve ligjorë një përfitim pasuror nga trashëgimi, pa i bërë këta trashëgimtarë (legu).

Kur trashëgimlënësi, që nuk ka trashëgimtarë nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364, ka caktuar në testament si trashëgimtarë persona të tjerë, mund t'i ngarkojë këta me lege në dobi të çdo njeriu.

Dispozitat e zotësisë për të trashëguar vlejnë edhe për personin që i është lënë legu.

Neni 385

Legatari ka të drejtë të kërkojë frutat ose kamatat që rrjedhin nga legu, nga dita që i është caktuar dorëzimi i legut dhe në mungesë të saj, nga dita e njoftimit të kërkesë-padisë.

Ato mund të kërkohen nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kur trashëgimlënësi ka disponuar shprehimisht ose kur legu është një depozitë në para.

Neni 386

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që të kryejnë ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë ose ndonjë veprim tjetër, pa i dhënë të drejtë një personi të caktuar mbi këtë veprim (barrë).

Kur trashëgimlënësi i lë me testament pasurinë shtetit, organeve të tij, ose enteve të ndryshëm, ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

Neni 387

Kur trashëgimtari i ngarkuar me legun ose barrën ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një trashëgimtar tjetër në vend të tij, për ekzekutimin e detyrimeve në lidhje me legun ose me barrën ngarkohen bashkëtrashëgimtarët ose trashëgimtarët ligjorë, të cilëve u shtohet ose u kalon pjesa e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar.

Në qoftë se ekzekutimi i detyrimeve në lidhje me legun ose barrën është lidhur ngushtë me personin e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar, legu ose barra mbetet pa fuqi.

Neni 388

Në rast se ndërmjet trashëgimtarëve, asnjëri prej tyre nuk është ngarkuar nga trashëgimlënësi testamentar për të shlyer legun, secili trashëgimtar detyrohet të kontribuojë për shlyerjen e tij sipas pjesës takuese.

Neni 389

Kur sendi i dhënë në leg është treguar vetëm si lloj ose si masë, e drejta e zgjedhjes i takon trashëgimtarit, por sendi nuk mund të jetë nën kualitetin mesatar.

Neni 390

Kur personi, të cilit i është lënë legu, ka vdekur para trashëgimlënësit ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga legu dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një person tjetër në vend të tij, legu shkon në dobi të trashëgimtarit të ngarkuar me atë leg.

Por në qoftë se legu u është lënë shumë personave së bashku, pjesa e atij që nuk mund ose nuk do të marrë legun u shtohet bashkëpjesëtarëve të tij në përpjesëtim me pjesët e tyre.

Neni 391

Personi, të cilit i është lënë legu, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtari i ngarkuar ekzekutimin e detyrimit në lidhje me legun.

Ekzekutimi i detyrimit të trashëgimtarit në lidhje me barrën mund të kërkohet nga ekzekutori i testamentit, nga bashkëtrashëgimtarët, nga organizatat përkatëse shtetërore ose private.

Detyrimet në lidhje me legun dhe barrën ekzekutohen pas detyrimeve që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore.

Format e testamentit

Neni 392

Testamenti bëhet në dy forma: ollograf dhe me akt noterial.

Testamenti ollograf

Neni 393

Testamenti ollograf shkruhet tërësisht me dorën e testatorit duke vënë datën dhe nënshkrimin e vet.

Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin.

Nënshkrimi vihet në fund të disponimeve.

Neni 394

Personi që nuk është i zoti të lexojë dorëshkrimin e vet nuk mund të bëjë testament ollograf.

Neni 395

Personat që nuk dëgjojnë (shurdhë) ose që nuk dëgjojnë e nuk flasin (shurdhëmemecë), mund të disponojnë me testament ollograf ose me testament të marrë nga noteri, sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për noterinë".

Neni 396

Testamenti ollograf mund të depozitohet tek noteri për ruajtje sipas dispozitave për depozitimin e dokumenteve në noteri.

Testamenti me akt noterial

Neni 397

Testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit.

Kur trashëgimlënësi nuk di, ose për shkak sëmundjeje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, testamenti nënshkruhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për noterinë".

Testamente të posaçme

Neni 398

Në vendet ku nuk ka noter, testamenti mund të vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkisë ose i komunës.

Neni 399

Testamenti i një personi që ndodhet në shërbim ushtarak, mund të vërtetohet nga komandanti i njësisë ushtarake në të cilën ai bën pjesë dhe kur është shtruar në spital për mjekim nga drejtori i spitalit.

Neni 400

Testamenti i një personi që ndodhet në një anije shqiptare në lundrim ose që ka qëndruar në një liman të huaj, mund të vërtetohet nga kapiteni i anijes.

Neni 401

Disponimi me testament i bërë me kusht pezullues, mbetet pa efekt kur personi në favor të cilit është bërë, vdes para trashëgimlënësit.

Revokimi i testamentit

Neni 402

Testamenti me një datë të mëvonshme lë pa fuqi atë me datë të mëparëshme në tërësi ose vetëm për pjesën që nuk pajtohet me testamentin e ri.

Testamenti mbetet pa fuqi edhe me anë të një deklarate të bërë nga trashëgimlënësi në noteri.

Pavlefshmëria e testamentit

Neni 403

Testamenti është i pavlefshëm kur bëhet nga një person që nuk mund të bëjë testament (neni 373).

Neni 404

Testamenti është i pavlefshëm kur nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 405

Testamenti është i pavlefshëm kur disponohet me testament në dobi të personave që nuk mund të trashëgojnë (nenet 374, 375).

Neni 406

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është në kundërshtim me nenet 377 e 384 të këtij Kodi.

Neni 407

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament i trashëgimlënësit, i përjashton nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore.

Neni 408

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë në kundërshtim me ligjin ose në mashtrim të ligjit.

Neni 409

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë me ndikimin e mashtrimit, kanosjes ose dhunës, ose për shkak të një lajthimi, pa të cilën trashëgimlënësi nuk do kishte bërë këtë disponim.

Neni 410

Kur testamenti deklarohet nga gjykata i pavlefshëm, në trashëgim thirren trashëgimtarët ligjorë, përveç kur është rasti i shtimit në dobi të trashëgimtarëve të caktuar në testament sipas nenit 381.

Kur deklarohen të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, disponimet e tjera mbeten në fuqi.

Neni 411

Padia për pavlefshmërinë e testamentit ose të disponimit me testament mund të ngrihet nga trashëgimtari dhe nga çdo tjetër person i interesuar brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë.

Neni 412

Kur disponimi me testament është i pavlefshëm për shkak se disponimi nga trashëgimlënësi ka përjashtuar nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore (neni 407), trashëgimtari, i përjashtuar nga trashëgimi ose të cilit i është cenuar pjesa ligjore, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtarët e tjerë, sipas rastit, dorëzimin ose plotësimin e pjesës që i takon atij në bazë të trashëgimisë ligjore.

Neni 413

Për caktimin e kësaj pjese bashkohet e gjithë pasuria që kishte trashëgimlënësi në kohën e vdekjes së tij, duke u zbritur detyrimet që rëndojnë mbi trashëgiminë dhe pjesëtohet me numrin e trashëgimtarëve që do të thirreshin në trashëgim në qoftë se trashëgimlënësi nuk do kishte bërë testament.

Ekzekutori i testamentit

Neni 414

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë një ose më shumë persona për të ekzekutuar testamentin.

Caktimi si ekzekutor duhet të pranohet prej këtij në vetë testamentin ose me një deklaratë të veçantë që i bashkohet testamentit.

Në qoftë se trashëgimlënësi nuk cakton ekzekutor të testamentit, ekzekutimi i këtij u ngarkohet trashëgimtarëve të caktuar në të.

Neni 415

Ekzekutori i testamentit duhet të bëjë inventarin e pasurisë trashëgimore, duke ftuar të marrin pjesë trashëgimtarët dhe personat e tjerë që përfitojnë nga testamenti.

Ekzekutori i testamentit administron pasurinë trashëgimore, duke kryer veprimet që janë të nevojshme për ekzekutimin e disponimeve të testamentit, por nuk mund të tjetërsojë pasurinë trashëgimore, përveç kur shfaqet nevoja dhe me lejen e gjykatës, e cila vendos pasi më parë të dëgjojë trashëgimtarët.

Neni 416

Gjykata e rrethit, me kërkesën e trashëgimtarëve ose të personave që kanë interes, mund të shkarkojë nga detyra ekzekutorin e testamentit për shkelje të rënda të detyrës së tij ose për pazotësi në administrimin e pasurisë trashëgimore.

Neni 417

Tagret e ekzekutorit testamentar nuk transmetohen në trashëgimtarët e tij.

Neni 418

Kur janë shumë ekzekutorë testamentarë, në mungesën e të tjerëve mund të veprojë edhe njëri prej tyre, por të gjithë ata janë përgjegjës solidarë për sendet që u janë besuar, përveç kur testatori u ka ndarë detyrat.

PJESA IV
DETYRIMET

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHME

KREU I
KUPTIMI DHE LINDJA E DETYRIMEVE

Kuptimi i detyrimit
Neni 419

Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditori), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

Lindja e detyrimeve
Neni 420

Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji.

Natyra ekonomike e detyrimit
Neni 421

Objekt i detyrimit duhet të ketë një vlerësim ekonomik dhe t'i përgjigjet interesave qoftë dhe jopasurore të kreditorit.

Korrektesa e pjesëmarrësve në detyrim
Neni 422

Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes.

KREU II
DETYRIMET SOLIDARE

Neni 423

Detyrimi është solidar kur kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e të njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu dhe nga secili prej tyre veç e veç.

Neni 424

Detyrimi është solidar kur del nga vullneti i palëve ose është parashikuar me ligj.

Neni 425

Detyrimi është solidar edhe kur debitorët të jenë detyruar secili në mënyrë të ndryshme ose dhe kur debitori i përbashkët të jetë detyruar në mënyrë të ndryshme ndaj secilit kreditor.

Neni 426

Ekzekutimi i detyrimit nga njëri prej debitorëve solidarë i shkarkon të gjithë debitorët e tjerë.

Debitorët solidarë shkarkohen nga detyrimi edhe nëpërmjet dhënies së një sendi në ekzekutim të detyrimit apo të kompensimit të kredisë nga njëri prej debitorëve solidarë ndaj kreditorit.

Neni 427

Qenia në vonesë e kreditorit ndaj njërit nga debitorët solidarë e shtrin efektin ndaj të gjithë debitorëve të tjerë.

Debitori solidar nuk mund të kompensojë detyrimin e tij me kreditë që kanë debitorët e tjerë ndaj kreditorit.

Debitori solidar nuk mund t'i kundrejtojë kreditorit prapsimet personale të debitorëve të tjerë.

Çdo njëri nga debitorët solidarë nuk duhet që me veprimet e tij të rëndojë pozitën e të tjerëve, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 428

Debitori ka të drejtë të zgjedhë për të paguar njërin apo tjetrin kreditor solidar, përveç kur është penguar më parë me anë të një njoftimi me shkrim prej ndonjërit prej tyre.

Kreditorët janë solidarë kur secili prej tyre ka të drejtën të kërkojë pagimin e gjithë detyrimit dhe pagimi i bërë njërit prej tyre, liron debitorin ndaj gjithë kreditorëve.

Neni 429

Përtëritja e detyrimit që bën debitori me njërin nga kreditorët, shkarkon të gjithë debitorët e tjerë, përveç kur kreditori i ka ruajtur të drejtat ndaj tyre.

Falja e detyrimit të bërë njërit prej debitorëve solidarë,shkarkon të gjithë debitorët e tjerë. Kur falet vetëm pjesa e një debitori, detyrimi i debitorëve të tjerë pakësohet për aq sa është pjesa e falur.

Bashkimi i cilësive të kreditorit me atë të debitorit solidar në një person të vetëm, shuan detyrimin e debitorëve të tjerë, për pjesën e këtij debitori.

Neni 430

Në marrëdhëniet ndërmjet tyre debitorët solidarë marrin pjesë në shlyerjen e detyrimit secili sipas pjesës së vet.

Debitori që ka ekzekutuar një detyrim solidar, ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë pagimin në pjesë të barabarta të detyrimit të ekzekutuar prej tij, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe.

Kur debitori solidar, që ka ekzekutuar detyrimin, nuk ka mundur të nxjerrë nga një debitor pjesën e tij të detyrimit, ajo ndahet sipas rastit në pjesë të barabarta ose proporcionalisht ndërmjet debitorëve të tjerë, duke përfshirë edhe atë.

Neni 431

Debitorët solidarë janë të detyruar të përballojnë në proporcion me pjesët e tyre të gjitha shpenzimet që vërtetohen se kanë qenë të nevojshme të kryhen nga debitorët që kanë ekzekutuar detyrimin.

Neni 432

Debitori solidar që ekzekuton detyrimin duhet t'i kundrejtojë kreditorit prapsimet e përbashkëta për të gjithë debitorët, përndryshe i humb e drejta të kërkojë nga debitorët e tjerë pjesën që atyre u takon për shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu, ai e humbet këtë të drejtë edhe kur nuk ka njoftuar debitorët e tjerë se ka ekzekutuar detyrimin dhe, si rrjedhim njëri nga debitorët e tjerë ka ekzekutuar veçmas atë.

Neni 433

Ndërprerja e parashkrimit me veprimet e kreditorit ndaj njërit prej debitorëve solidarë, si dhe ndërprerja e parashkrimit nga njëri prej kreditorëve solidarë ndaj debitorit të përbashkët, ka efekt si ndaj debitorëve të tjerë ashtu edhe ndaj kreditorëve të tjerë.

Pezullimi i parashkrimit ndaj njërit debitor ose ndaj njërit kreditor solidar, nuk ka efekt ndaj të tjerëve.

Heqja dorë nga parashkrimi në përputhje me nenin 126 të këtij Kodi e bërë nga njëri prej debitorëve solidarë, nuk ka efekt ndaj të tjerëve, ndërsa heqja dorë nga parashkrimi nga njëri prej kreditorëve solidarë, ka efekt ndaj të tjerëve.

Neni 434

Debitori solidar të cilit i kërkohet pagimi i pjesës së tij nga detyrimi, nuk mund t'i kundrejtojë debitorit, që ka paguar atë, parashkrimin e padisë së kreditorit, përveç kur ai vetë dhe debitori që kërkon pjesën kanë patur mundësinë që t'i kundrejtonin parashkrimin e plotësuar.

Ky paragraf nuk zbatohet kur me marrëveshje debitorët solidarë kanë vendosur ndryshe.

Neni 435

Në rast se ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur, për fajin ose gjatë vazhdimit të vonesës së njërit ose disa debitorëve solidarë, debitorë të tjerë nuk shkarkohen nga detyrimi për plotësimin e tij.

Kreditori mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar për një shkak të tillë, vetëm nga debitorët solidarë ose nga secili prej tyre, për fajin e të cilëve është bërë i pamundur ekzekutimi i detyrimit ose që kanë qenë me vonesë. Debitorët e tjerë mbetën solidarë vetëm për detyrimin e parë.

Vonesa e njërit nga debitorët solidarë nuk sjell ndonjë pasojë juridike për debitorët e tjerë.

KREU III
DETYRIMET ALTERNATIVE

Neni 436

Detyrimi është alternativ kur debitori shkarkohet prej tij, duke përmbushur njërin nga llojet e tij të përmendura veç e veç sipas dëshirës së tij, ose të kreditorit apo të një të treti. Debitori nuk mund të kërkojë nga kreditori të pranojë përmbushjen e detyrimit pjesërisht nga njëri lloj e pjesërisht nga lloji tjetër i tij.

Neni 437

E drejta e zgjedhjes i takon debitorit, përveç kur është parashikuar nga ligji apo nga kontrata që t'i lihet kreditorit apo një të treti.

Zgjedhja bëhet e parevokueshme me përmbushjen e njërit nga llojet e detyrimit, ose me njoftimin e deklaratës së zgjedhjes palës tjetër ose të dy palëve, kur e drejta e zgjedhjes i takon një të treti.

Kur e drejta e zgjedhjes u takon shumë personave dhe ata nuk merren vesh, gjykata u cakton atyre një afat. Kur zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, atë e bën gjykata.

Neni 438

Kur në një detyrim alternativ, debitori nuk ekzekuton ndonjërin nga llojet e detyrimeve në afatin e caktuar, e drejta e zgjedhjes i kalon kreditorit.

Në rast se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit dhe ky nuk e ka ushtruar në afatin e caktuar në marrëveshje ose të caktuar nga debitori, zgjedhja i kalon këtij të fundit.

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë një të treti dhe ai nuk e ushtron në afatin e caktuar, zgjedhja bëhet nga gjykata.

Kur kjo e drejtë u është lënë disa personave, gjykata u cakton atyre një afat. Në rast se zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, ajo bëhet nga gjykata.

Neni 439

Detyrimi alternativ është i thjeshtë kur njëri nga të dy llojet e detyrimit nuk mund të bëhet objekt detyrimi, ose kur përmbushja e tij është bërë e pamundur pa fajin e asnjërës palë.

Neni 440

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë debitorit, detyrimi alternativ bëhet i thjeshtë në rast se njëri nga të dy llojet e detyrimit bëhet i pamundur dhe për fajin e tij. Në rast se kjo pamundësi ndodh për fajin e kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur ai nuk pranon të zbatohet detyrimi tjetër dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Kur zgjedhja i është lënë kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur pamundësia e përmbushjes së njërit nga të dy llojet e detyrimit ka ndodhur për faj të kreditorit dhe ky nuk pranon të ekzekutohet lloji tjetër i detyrimit dhe të kërkojë të shpërblehet dëmi. Në rast se zgjedhja i është lënë kreditorit dhe pamundësia i ngarkohet debitorit, kreditori mund të zgjedhë detyrimin tjetër ose të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 441

Kur të dy llojet e detyrimit janë bërë të pamundura dhe debitori duhet të përgjigjet për njërin prej tyre, ai duhet të paguajë vleftën e detyrimit që është bërë i pamundur i fundit, në qoftë se zgjedhja i është lënë atij.

Në qoftë se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit, ky ka të drejtë të kërkojë vleftën e njërit ose tjetrit lloj detyrimi.

KREU IV
DETYRIME TË PJESËTUESHME E TË PAPJESËTUESHME

Detyrime të pjesëtueshme
Neni 442

Kur shumë debitorë ose kreditorë marrin pjesë në të njëjtin detyrim dhe ky është i pjesëtueshëm, secili debitor është i detyruar të ekzekutojë dhe secili kreditor ka të drejtë të kërkojë një pjesë të barabartë të detyrimit, përveç kur në kontratë ose në ligj është parashikuar ndryshe.

Detyrime të papjesëtueshme
Neni 443

Kur janë shumë debitorë në të njëjtin detyrim, që është i papjesëtueshëm, të gjithë debitorët quhen debitorë solidarë.

Detyrimi është i papjesëtueshëm nga vetë natyra e tij si i tillë dhe nga qëllimi i palëve në kontratë. Në të tilla raste detyrimi mbetet i papjesëtueshëm edhe për trashëgimtarët e debitorëve.

Neni 444

Detyrimet e papjesëtueshme rregullohen nga dispozita që kanë lidhje me detyrimet solidare, përveç sa parashikohet në këtë kre.

KREU V
DETYRIMET MONETARE

Neni 445

Detyrimi për të paguar një shumë parash shlyhet me vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

Neni 446

Detyrimi monetar përmbushet me monedhën që është në qarkullim në shtetin ku bëhet pagimi ose me monedhën e pranuar në kontratë.

Neni 447

Kur kreditori ka një llogari rrjedhëse në shtetin ku duhet ose mund të bëhet pagesa, debitori mund të përmbushë detyrimin duke kredituar në këtë llogari shumën përkatëse, përveç kur kreditori e ka përjashtuar pagesën në këtë llogari.

Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari.

Neni 448

Pagesa kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit.

Neni 449

Në rast se pagimi duhet të kryhet në një vend tjetër nga vendbanimi i kreditorit në kohën e lindjes së detyrimit dhe përmbushja e këtij detyrimi do të vështirësohej së tepërmi debitori mund të pezullojë pagimin derisa kreditori të ketë caktuar një vend tjetër i cili do të mënjanonte shpenzimet e tepërta.

Neni 450

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, me monedhën zyrtare të vendit ku bëhet pagimi. Përqindja e kamatës caktohet me ligj.

Në mbarim të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës së detyruar mbi bazën e të cilës është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori të provojë ndonjë dëm. Kur kreditori provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori detyrohet t'i paguajë atij pjesën tjetër të dëmit.

Neni 451

Kur detyrimi lidhet me pagesen e një shume parash në monedhë që nuk ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin në monedhën që ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, përveç kur në ligj ose në kontratë parashikohet ndryshe.

Neni 452

Kur detyrimi lidhet me pagesën e një shume parash në monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku duhet të kryhet pagesa dhe debitori pretendon se nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin në këtë monedhë, kreditori mund të pranojë shlyerjen në monedhën e vendit të kryerjes së pagesës.

Rregulli i mësipërm zbatohet edhe kur debitori detyrohet të bëjë pagesën me monedhën e pranuar në fillim.

Neni 453

Kur detyrimi duhet të ekzekutohet me një monedhë të ndryshme nga ajo e pranuar në fillim, konvertimi duhet të bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të ditës së pagimit.

Neni 454

Neni 450 i këtij Kodi nuk i heq të drejtën kreditorit që të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga fakti që nga dita e vënies në vonesë të debitorit ka pësuar ndryshime kursi i këmbimit të monedhës që përcaktohet në detyrim.

TITULLI II
EKZEKUTIMI DHE SHUARJA E DETYRIMEVE

KREU I
EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE

Neni 455

Debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij.

Neni 456

Detyrimi për dorëzimin e një sendi të caktuar përmban edhe kujdesin që duhet të tregohet për ruajtjen e tij në dorëzim.

Neni 457

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i sendeve të përcaktuara vetëm në lloj, ato nuk mund të jenë me cilësi më të dobët se sa cilësia mesatare.

Neni 458

Dorëzimi i sendeve bëhet sipas mënyrës së caktuar në kontratë dhe kur kjo nuk është caktuar bëhet:

a) me dhënien e tyre në dorë personit që ka fituar pronësinë e tyre ose personit që heq të drejta prej tij;

b) me dhënien transportuesit ose postës për t'ia dorëzuar fituesit, në vendin e treguar prej tij;

c) me dhënien fituesit në dorë ose me dërgim nëpërmjet postës të dokumenteve (fletë ngarkese, dëshmi depozitimi) që i japin atij të drejtën e disponimit të mallit.

Neni 459

Debitori nuk mund të ekzekutojë detyrimin pjesë-pjesë edhe sikur ai të jetë i pjesëtueshëm, pa pëlqimin e kreditorit.

Neni 460

Detyrimi mund të ekzekutohet edhe nga një person i tretë, që nuk është debitor, përveç kur kreditori është i interesuar që ekzekutimi të bëhet nga debitori, ose kur kreditorit i është njoftuar kundërshtimi i debitorit.

Vendi i ekzekutimit të detyruar

Neni 461

Në rast se vendi ku duhet të ekzekutohet detyrimi nuk caktohet në kontratë, nga ligji ose nuk kuptohet nga vetë natyra e detyrimit, ekzekutimi bëhet:

a) për dorëzimin e një sendi të paluajtshëm, në vendin ku ndodhet ai;

b) për sendet që janë të përcaktuara në mënyrë individuale, në vendin ku ndodheshin kur lindi detyrimi;

c) për dorëzimin e një sendi të përcaktuar në lloj dhe në sasi, në vendin ku debitori ushtron veprimtarinë e tij profesionale ose në vendbanimin e tij;

ç) për detyrimet në para, sipas rregullave të përcaktuara në kreun V të pjesës IV të këtij Kodi.

Neni 462

Kreditori nuk mund të detyrohet të pranojë një gjë të ndryshme nga sa është përcaktuar në objektin e detyrimit edhe sikur vlefta e gjësë së ofruar të jetë më e madhe.

Afati i ekzekutimit të detyrimit

Neni 463

Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërkimit.

Neni 464

Afati i caktuar në kontratë prezumohet se është caktuar në dobi të debitorit, përveç kur nga vullneti i palëve ose natyra e detyrimit del ndryshe.

Ekzekutimi i detyrimit para mbarimit të afatit nuk quhet i pavlefshëm, përveç kur afati është caktuar në dobi të kreditorit.

Neni 465

Debitori nuk mund të pretendojë të drejtën e afatit kur:

a) ka falimentuar;

b) nuk ka dhënë garancitë e premtuara;

c) garancitë që sigurojnë kredinë janë pakësuar për fajin e tij, përveç kur ato mbeten, përbëjnë ende një siguri të mjaftueshme për ekzekutimin e detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit

Neni 466

Ekzekutimi i detyrimit duhet t'i bëhet vetë kreditorit ose përfaqësuesit të vet, ose një personi të autorizuar nga kreditori, nga ligji ose nga gjykata.

Ekzekutimi i detyrimit që i bëhet një personi që nuk është autorizuar për ta pranuar, e shkarkon debitorin vetëm në rast se kreditori ka pranuar më vonë ekzekutimin, ose vërtetohet se ka përfituar prej tij.

Ekzekutimi ndaj një të treti

Neni 467

Debitori që ekzekuton një detyrim ndaj një personi, i cili sipas rrethanave të padyshimta duket se është i autorizuar ta pranojë atë, shkarkohet nga detyrimi në qoftë se provon se ka qënë në mirëbesim.

Personi që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, është i detyruar t'i kthejë kreditorit të vërtetë, atë që ka marrë nga ekzekutimi i detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit të pazotë për të vepruar

Neni 468

Kur ekzekutimi i detyrimit i është bërë një kreditori që nuk ka zotësi për të vepruar, shkarkon debitorin po aq sa ka vajtur në dobi të këtij kreditori, ose të përfaqësuesit të tij ligjor.

Ekzekutimi për llogari të shumë detyrimeve

Neni 469

Kur ekzekutimi kryhet për llogari të shumë detyrimeve dhe ndaj të njëjtit kreditor, debitori mund të përcaktojë në kohën e ekzekutimit se cilin detyrim po ekzekuton.

Kur nuk ekziston një përcaktim i debitorit për rradhën e ekzekutimit, në fillim ekzekutohet detyrimi që i ka kaluar afati, nëse ekzistojnë më shumë të tillë, ekzekutimi fillon nga detyrimi me vlerë dhe në rast se janë disa të tillë, fillon nga më i vjetri dhe kur këta kanë të njëjtën vjetërsi, ekzekutimi bëhet proporcionalisht.

Neni 470

Ekzekutimi në para për llogari të një detyrimi të caktuar, përmban në fillim shlyerjen e shpenzimeve, pastaj atë të kamatave të arrira dhe pastaj të vetë detyrimit e të kamatave të zakonshme ndaj tij.

Kreditori mund të refuzojë pagesën, në rast se debitori gjatë ekzekutimit cakton një renditje tjetër ose mund të mos pranojë shlyerjen e plotë të vleftës së detyrimit; pa marrë edhe kamatat e arrira, ato në vazhdimësi si dhe shpenzimet përkatëse.

Neni 471

Kreditori mund të mos pranojë ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të ndryshëm nga ai që është përcaktuar në kontratë edhe sikur vlefta e sendit të ofruar të jetë e barabartë apo më e madhe.

Shpenzimet e ekzekutimit, dëftesat përkatëse

Neni 472

Shpenzimet janë në ngarkim të atij që ekzekuton detyrimin, ndërsa shpenzimet e dëftesës janë në ngarkim të atij, në favor të të cilit ajo është lëshuar.

Neni 473

Për çdo pagesë të kryer në ekzekutim të detyrimit kreditori jep një dëftesë, përveç kur rezulton ndryshe nga kontrata.

Në rast se kreditori disponon një dokument nga përmbajtja e të cilit rezulton detyrimi, debitori që e ka ekzekutuar atë mund të kërkojë kthimin ose prishjen e dokumentit, përveç kur kreditori ka interesa të arsyeshme për ruajtjen e tij dhe me kusht që ai të shënojë në dokument ekzekutimin e detyrimit.

Kur kreditori refuzon të zbatojë detyrimin sipas paragrafit të mësipërm, debitori mund të pezullojë ekzekutimin e detyrimit. Kur kreditori pretendon se ka humbur dokumnetin detyrohet t'i japë debitorit një deklaratë me shkrim ku të pranohet ekzekutimi i detyrimit. Deklarata duhet të jetë noteriale kur kërkohet nga ligji.

Neni 474

Kur pagesat e njëllojta për shlyerjen e detyrimit duhet të bëhen në mënyrë periodike, dëftesat e lëshuara për dy pagesa rradhazi prezumojnë kryerjen edhe të pagesave të mëparëshme.

Dëftesa e lëshuar nga kreditori për detyrimin kryesor, prezumon se janë shlyer gjithashtu edhe kamatat e shpenzimet e këtij detyrimi.

Lirimi i sendeve nga garancitë

Neni 475

Kreditori që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, duhet të lirojë sendet nga garancitë reale që janë dhënë për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit edhe nga çdo ndalim tjetër që mund të kufizojë përdorimin e pasurisë.

KREU II
EFEKTET E MOSEKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 476

Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveç kur ai provon se mospërmbushja nuk ka ndodhur për fajin e tij.

Në këtë rast kreditori ka të drejtë:

a) të kërkojë ekzekutimin në natyrë të detyrimit, veçanërisht dorëzimin e sendit ose kryerjen e punimeve, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit; ose

b) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit.

Neni 477

Debitori që në ekzekutimin e detyrimit përdor punën e të tretëve përgjigjet për veprimet e tyre, të kryera me faj, si të ishin të vetat.

Neni 478

Kur detyrimi ka lidhje me veprime që mund të kryhen edhe nga persona të tjerë dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin, kreditori ka të drejtë të kërkojë t'i kryejë ai vetë për llogari të debitorit.

Neni 479

Çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon palët nga përgjegjësia për mosekzekutimin e detyrimeve është e pavlefshme.

Neni 480

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur për fajin e debitorit, kreditori ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Debitori është me faj kur, me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që e kanë bërë të pamundur ekzekutimin ose kur nuk ka marrë masa për ta ndaluar atë.

Vonesa e debitorit

Neni 481

Debitori që nuk përmbush një detyrim të kërkueshëm në afatin e caktuar, quhet se është në vonesë (morë), përveç kur mosekzekutimi është rrjedhim i rrethanave që nuk kanë lidhje me fajin e debitorit.

Debitori vihet në vonesë me anë të një njoftimi me shkrim.

Nuk është e nevojshme vënia në vonesë kur:

a) debitori ka deklaruar me shkrim se nuk dëshiron të ekzekutojë detyrimin;

b) ka kaluar afati brenda të cilit do të ekzekutohej detyrimi.

Kur debitori vdes dhe afati i caktuar për ekzekutimin e detyrimit mbaron pas vdekjes së tij, trashëgimtarët e tij quhen se janë në vonesë me mbarimin e 15 ditëve nga dita e njoftimit me shkrim nga kreditori.

c) kur detyrimi rrjedh nga një akt i paligjshëm.

Neni 482

Debitori që është në vonesë nuk çlirohet nga pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit, edhe sikur kjo të jetë shkaktuar pa fajin e tij e të kreditorit, përveç kur provon se objekti i detyrimit do të ishte shkatëruar apo dëmtuar edhe sikur të ishte nën kujdesin e kreditorit.

Humbja ose dëmtimi i një sendi të marrë në menyrë të paligjshme, nuk e shkarkon personin që e ka marrë atë nga detyrimi për të rikthyer vleftën e tij.

Neni 483

Dispozitat mbi vonesën nuk zbatohen për detyrimet që përmbajnë mosveprime. Çdo veprim i kundërt përbën mospërmbushje të detyrimit.

Neni 484

Kreditori mund të mos pranojë ofertën e debitorit që është me vonesë për ekzekutimin e detyrimit, në rast se ajo nuk përmban edhe shpërblimin e dëmit të pësuar dhe shpenzimet e bëra gjatë vonesës, ose kur kreditori për shkak të vonesës së debitorit nuk ka interes për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 485

Debitori që ka një kredi të kërkueshme ndaj kreditorit të tij, mund të pezullojë zbatimin e detyrimit deri në pagesën e kredisë, me kusht që ndërmjet kredisë dhe detyrimit të ketë lidhje të mjaftueshme, siç mund të jetë ndër të tjera, qënia e një raporti të vetëm juridik ose të marrëdhënieve që palët kanë patur rregullisht.

Pezullimi i ekzekutimit të detyrimit nuk mund të kërkohet kur:

a) ekzekutimi i detyrimit nga pala tjetër bëhet i pamundur për shkak të vonesës së kreditorit, ose është i pamundur në mënyrë të përherëshme;

b) kredia e palës tjetër është e pasekuestrueshme.

Neni 486

Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për mosekzekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuara nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi që mund të nxirrej në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar). Bëjnë pjesë në shpërblimin për riparimin e dëmit edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, që kanë lidhje me rrethanat mbi të cilat bazohet përgjegjësia e palës, shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të përcaktuar dëmin dhe përgjegjësinë, si dhe ato që janë nevojitur për të gjetur një zgjidhje jashtë gjyqësore të përmbushjes së detyrimit.

Neni 487

Në kontratë me detyrime të dyanshme, palët duhet të ekzekutojnë detyrimin e tyre në të njëjtën kohë, përveç kur nga kontrata ose nga natyra e detyrimit del se njëra palë duhet të ekzekutojë detyrimin e saj më parë se tjetra.

Neni 488

Kur në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të një pale është bërë i pamundur pa fajin e asnjërës palë, secila prej tyre nuk ka të drejtë të kërkojë nga tjetra ekzekutimin e

detyrimit ose shpërblimin e dëmit, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që t'i kthejë atë që është dhënë për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 489

Në qoftë se në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të njërës palë është bërë i pamundur, për shkak se pala tjetër ka rënë në paaftësi paguese, ose ka falimentuar ose për ndonjë rrethanë tjetër të ndodhur për faj të saj, pala tjetër ka të drejtë të mos zbatojë detyrimet e veta, derisa t'i garantohet ekzekutimi i detyrimit në dobi të saj, ose të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës.

Neni 490

Kur është vendosur që kreditorit t'i paguhet shpërblimi për mosekzekutimin e detyrimit ose për ekzekutimin me vonesë të tij, gjykata duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit, mund të caktojë një afat tjetër për pagimin e këtij shpërblimi, ose të lejojë që të paguhet me këste.

Vonesa e kreditorit

Neni 491

Kreditori është në vonesë kur pa ndonjë shkak të ligjshëm nuk pranon ekzekutimin e detyrimit nga ana e debitorit, ose që për shkak të rrethanave të krijuara me faj prej tij, nuk përmbush detyrimin ndaj debitorit, pa të cilin ky nuk mund të ekzekutojë detyrimin e tij.

Neni 492

Kur kreditori është në vonesë, debitori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar prej saj dhe lirohet nga përgjegjësia në rast se më vonë ekzekutimi i detyrimit të tij bëhet i pamundur, përveç kur pamundësia e ekzekutimit ndodh për fajin e tij.

Në detyrimet në para, kur kreditori është në vonesë, debitori nuk paguan kamatë.

Neni 493

Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.

Neni 494

Kreditori gjatë vonesës së tij nuk mund të kërkojë marrjen e masave për një ekzekutim të detyruar.

Neni 495

Kur kreditori është në vonesë ose nuk gjendet, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin duke e depozituar sendin në një person që ushtron veprimtari depozitimi ose në një vend që caktohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit të detyrimit. Kur objekt i detyrimit janë para, letra ose dokumente me vleftë ose sende të çmueshme, depozitohen në bankë.

Me depozitimin ndërpritet kamata.

Në rastet kur depozitimi kërkon shpenzime të mëdha, bëhet me vështirësi ose sendi që vihet në depozitë prishet shpejt ose për vetë natyrën e tij, nuk mund të lihet në depozitë, debitori, pasi të ketë lajmëruar kreditorin, kërkon nga gjykata që të lejohet të shesë sendin e mësipërm dhe vleftën e nxjerrë nga shitja ta depozitojë në bankën e shtetit në emër të kreditorit.

Kur debitori tërheq sendin e depozituar para se të jetë pranuar nga kreditori, depozitimi quhet se nuk është bërë.

Depozituesi i dorëzon sendin kreditorit vetëm pasi ky të ketë shlyer të gjitha shpenzimet për ekzekutimin e detyrimit.

KREU III
ZËVENDËSIMI DHE KALIMI I KREDISË

Zëvendësimi i debitorit
Neni 496

Zëvëndësimi i debitorit me një person tjetër, i cili merr përsipër detyrimin, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit. Debitori i zëvendësuar shkarkohet nga detyrimi i tij ndaj kreditorit.

Garancitë e dhëna nga persona të tretë për detyrimin shuhen, në rast se këta nuk kanë dhënë pëlqimin që ato të mbeten edhe për debitorin e ri. Pengu ose hipoteka e dhënë nga debitori i mëparshëm mbeten në fuqi.

Neni 497

Kreditorit mund t'i kundrejtohen nga debitori i ri të gjitha prapsimet që rrjedhin nga detyrimi që ai ka marrë përsipër dhe që mund t'i kundrejtonte edhe debitori i mëparshëm, përveç atyre që lidhen me personin e këtij të fundit.

Neni 498

Marrëvështja sipas të cilës debitori dhe një person i tretë bëhen bashkëdebitorë në një detyrim, kur është marrë pëlqimi i kreditorit, nuk mund të prishet ose të ndryshohet, pa pëlqimin e kreditorit. Të dy bashkëdebitorët përgjigjen ndaj tij solidarisht.

Kalimi i kredive
Neni 499

Kreditori mund t'ia kalojë kredinë e vet një personi tjetër edhe pa miratimin e debitorit, me kusht që kredia të mos ketë karakter të ngushtë personal dhe kalimi të mos jetë ndalur nga ligji. Veçanërisht nuk lejohet kalimi i kredisë një personi tjetër, kur rrjedh nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit, si dhe i kredive që nuk mund të sekuestrohen.

Palët në një marrëveshje mund të përjashtojnë kalimin e kredisë, por marrëveshja nuk mund t'i kundrejtohet atij që i kalon kredia po të mos provohet se ai e njihte atë në momentin e kalimit.

Neni 500

Kredia kalon së bashku me privilegjet, garancitë dhe aksesorët e tjerë, duke përfshirë edhe kamatat për kohën e kaluar, përveç kur në kontratë parashikohet ndryshe. Personi që bën kalimin e kredisë nuk mund t'i kalojë personit tjetër posedimin e sendit të marrë peng pa miratimin e palës tjetër (pengdhënësit). Në të kundërtën kreditori mbetet ruajtës i pengut.

Neni 501

Kalimi i kredisë duhet të bëhet me shkresë, ndryshe nuk është i vlefshëm.

Neni 502

Kalimi kredisë ka efekt ndaj debitorit dhe ndaj personave të tretë, nga dita që debitori e ka pranuar ose i është njoftuar nga kreditori i mëparshëm ose nga kreditori i ri.

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin e tij, përpara se të ishte njoftuar për kalimin e kredisë, shkarkohet nga detyrimi.

Neni 503

Kur kredia u është kaluar disa personave të veçantë, preferohet në shlyerje kalimi që i është njoftuar më përpara debitorit, ose që është pranuar më parë nga debitori, me një dokument (shkresë) me datë të saktë edhe sikur data të jetë e mëvonshme.

Neni 504

Kalimi i kredisë nuk cenon mjetet mbrojtëse të debitorit.

Debitori mund t'i kundrejtojë kreditorit të ri prapësimet që mund t'i drejtonte kreditorit të mëparshëm, në kohën që i është njoftuar kalimi i kredisë.

Ai mund të kërkojë t'i bëhet kompensimi i një kredie ndaj kreditorit të parë, qoftë dhe ende e pa kërkueshme në atë kohë, me kusht që të mos jetë bërë e kërkueshme mbas cedimit të kredisë.

Neni 505

Kur kalimi i kredisë bëhet me titull barësor kreditori është garant për ekzistencën e kredisë në kohën e kalimit të saj.

Kur kalimi bëhet falas, kreditori nuk është garant për ekzistencën e kredisë.

Neni 506

Kreditori që kalon kredinë nuk përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, përveç kur ka marrë përsipër garancinë.

Në këtë rast përgjigjet për aq sa ka marrë. Veç kësaj duhet të përgjigjet për kamatat, për shpenzimet e kalimit, dhe ato që personi që i ka kaluar kredia ka bërë për ndjekjet ligjore ndaj debitorit dhe të shpërblejë dëmin.

Marrëveshja që synon të rëndojë përgjegjësinë e personit që kalon kredinë, është e pavlefshme. Kur kreditori që kalon kredinë ka garantuar aftësinë paguese të debitorit, garancia pushon, në qoftë se mosekzekutimi i kredisë për paaftësi paguese të debitorit ka ardhur nga pakujdesia e kreditorit të ri për të ndjekur çështjen ndaj debitorit.

Neni 507

Kreditori që bën kalimin e kredisë duhet t'i dorëzojë kreditorit tjetër dokumentet që provojnë kredinë, të cilat janë në posedimin e tij.

Kur është kaluar vetëm një pjesë e kredisë, kreditori detyrohet t'i dorëzojë kreditorit tjetër një kopje autentike të dokumenteve.

KREU IV
SHUARJA E DETYRIMEVE

Përtëritja
Neni 508

Detyrimet shuhen me përtëritje, kur palët me marrëveshje zëvendësojnë detyrimin fillestar, me një detyrim tjetër të ndryshëm nga i pari.

Neni 509

Dorëzania, pengu dhe hipoteka e kredisë fillestare shuhen përveç kur palët janë marrë vesh shprehimisht që ato të ruhen edhe për kredinë e re.

Neni 510

Përtëritja është e pavlefshme në rast se detyrimi fillestar është i pavlefshëm.

Kur detyrimi fillestar rrjedh nga një titull i anulueshëm, përtëritja është e vlefshme në rast se debitori ka marrë përsipër detyrimin e ri, duke njohur vesin e titullit fillestar.

Falja e detyrimit
Neni 511

Deklarata me shkrim e kreditorit për faljen e detyrimit, e shuan atë kur i njoftohet debitorit, përveç kur ky i fundit deklaron brenda një afati të caktuar se nuk dëshiron të përfitojë nga falja.

Neni 512

Kur debitori ka në dorë dokumentin privat që provon detyrimin, prezumohet se ky është shuar me falje, përveç kur provohet se dokumenti nuk i është kthyer nga kreditori me dashje.

Neni 513

Heqja e garancisë ndaj detyrimit, nuk prezumon faljen e tij.

Kompensimi
Neni 514

Kur dy persona i detyrohen njëri tjetrit në para ose në sende të një lloji e të zëvendësueshme dhe detyrimet e tyre janë të kërkueshme, të sakta e të caktuara në shumë ose në sasi, detyrimet e të dy palëve shuhen, duke bërë kompensimin ndërmjet tyre. Detyrimet shuhen deri në shumën ose sasinë e detyrimit më të vogël.

Neni 515

Kompensimi shuan të dy detyrimet nga data e bashkimit të tyre.

Kur për njërën nga kreditë ose mbi të dyja janë paguar kamata, kompensimi bëhet deri në afatin e fundit në të cilën janë paguar kamatat.

Parashkrimi nuk e ndalon kompensimin, në rast se nuk është plotësuar në ditën kur është bërë bashkimi i të dy detyrimeve.

Neni 516

Kompensimi bëhet me anë të një deklarate që njëra palë i dërgon palës tjetër.

Deklarata nuk mund të bëhet me afat ose me kusht.

Kur kompensimi nuk mbulon gjithë kredinë ose kur kreditori ka nevojë të mbajë titullin e kredisë për të ushtruar të drejtat e tjera të tij, mund ta mbajë atë me kusht që të shënojë në titull përmbajtjen e deklaratës dhe t'i japë palës tjetër një kopje të titullit të kredisë.

Neni 517

Kur deklarata për kompensimin e dhënë nga njëra palë, nuk pranohet nga pala tjetër, ajo detyrohet të njoftojë menjëherë palën që ka dërguar deklaratën, duke parashtruar shkaqet e mospranimit.

Neni 518

Nuk mund të kompensohen pa pëlqimin e kreditorit:

a) kreditë që rrjedhin nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit;

b) kreditë që nuk mund të sekuestrohen;

c) kreditë që rrjedhin nga tatimet dhe taksat.

Neni 519

Kompensimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufrukti ose pengu mbi kredinë.

Neni 520

Dorëzanësi mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj debitorit kryesor. Debitori kryesor nuk mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj dorëzënësit.

Neni 521

Kur dy detyrime nuk janë të pagueshme në një vend, nuk mund të bëhet kompensimi i tyre, veçse duke llogaritur shpenzimet e nevojshme për transferimin e tyre në vendin e ekzekutimit.

Neni 522

Kur kreditë dhe detyrimet monetare përfshihen në një llogari të vetme, ato kompensohen menjëherë, sipas renditjes që palët kanë pranuar në marrëveshje dhe në mungesë të saj sipas rregullave të parashikuara në nenet 469 dhe 470 të këtij Kodi.

Pala që administron llogarinë, pasi e mbyll atë me kompensimin e bërë, i njofton palës tjetër se cila është mbetja, datën e saktë të llogaritjes, si dhe zërat që përbëjnë llogarinë dhe që nuk i janë komunikuar ende palës tjetër.

Në qoftë se pala tjetër nuk kundërshton atë në një afat të arsyeshëm, mbetja e njoftuar konsiderohet si e pranuar nga palët.

Neni 523

Kur në një deklaratë kompensimi nuk tregohen në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e përfshira në kompensim, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 470 të këtij Kodi.

Secila palë mund të kundërshtojë menjëherë kompensimin e bërë, në rast se llogaritja e detyrimit, e shpenzimeve dhe e interesave nuk është kryer sipas rregullave të sipërpërmendura.

Bashkimi i cilësive të kreditorit dhe debitorit në një të vetëm

Neni 524

Detyrimi shuhet kur cilësitë e kreditorit dhe të debitorit bashkohen në një person të vetëm.

Kur ky bashkim merr fund, detyrimi lind përsëri.

Neni 525

Bashkimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufrukti ose pengu mbi kredinë.

Shuarja për shkak pamundësie ekzekutimi

Neni 526

Detyrimi shuhet kur ekzekutimi i tij bëhet i pamundur pa fajin e debitorit dhe para se ky të jetë vënë në vonesë.

Detyrimi shuhet edhe kur debitori ndonëse është në vonesë, provon se pamundësia do të ekzistonte edhe sikur të ishte kreditori në vendin e tij.

Në këto raste, debitori duhet t'i kthejë kreditorit atë që ka fituar pa shkak.

Neni 527

Kur pamundësia për ekzekutimin e detyrimit është e përkohshme, debitori nuk është përgjegjës për vonesën e ekzekutimit për kohën që ajo zgjat.

Por, detyrimi shuhet edhe kur pamundësia zgjat për aq kohe sa sipas titullit të detyrimit dhe natyrës së tij, debitori nuk mund të detyrohet më ta kryejë atë ose kreditori nuk ka më interes.

Neni 528

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur vetëm pjesërisht, detyrimi ekzekutohet në pjesën që mund të ekzekutohet.

Neni 529

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i një sendi dhe ky dëmtohet tërësisht, ose humbet pa fajin e debitorit dhe para se ky të vihet në vonesë, kreditori hyn në të drejtat e debitorit lidhur me këtë send, në varësi të faktit që ka shkaktuar pamundësinë e ekzekutimit të detyrimit. Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë ç'ka ka marrë si rrjedhojë e shpërblimit të dëmeve.

TITULLI III
MJETET PËR TË SIGURUAR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 530

Kreditori mund të shpërblehet me të gjithë pasurinë e tashme dhe të ardhshme të debitorit të tij, përveç rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe.

Një pronë mund të rëndohet nga pronari i saj, me qëllim që të sigurohet pagimi i një detyrimi.

Neni 531

Kreditorët kanë të drejta të barabarta për t'u shpërblyer me pasurinë e debitorit, përveç shkaqeve të ligjshme të preferimit.

Janë shkaqe të ligjshme të preferimit privilegjet, pengu dhe hipoteka.

Neni 532

Pengu dhe hipoteka mund të vihen vetëm për një detyrim efektiv.

Pengu dhe hipoteka mund të vihen si për një detyrim të pronarit të sendit të lënë peng ose hipotekë, ashtu dhe për një detyrim të një personi tjetër.

Neni 533

Pengu ose hipoteka mund të garantojë një kredi ekzistuese ose një kredi të ardhshme. Kredia për të cilën jepet garancia duhet të jetë e përcaktuar qartë.

Pengu ose hipoteka mund të vihet edhe për një detyrim me kusht.

Neni 534

Pengu ose hipoteka shtrihen përkatësisht mbi të gjitha punimet që përmirësojnë vleftën e pronës, kreditë dhe shpërblimet që u shtohen ose që zëvendësojnë pasurinë e rënduar, duke përfshirë edhe atë që kompensohet nga zhvleftësimi.

Neni 535

Në qoftë se sendet e lëna peng ose hipotekë humbasin ose zhvleftësohen, pagesa e shumave, për të cilat detyrohen siguruesit ose të tretët që përgjigjen për zhdëmtimin, nxirren nga pagesa e kredive që lidhen me pengun ose hipotekën, përveç rastit kur ato përdoren për të ndrequr humbjen ose zhvleftësimin e sendeve.

Neni 536

Në qoftë se sendi i dhënë në peng ose i lëshuar në hipotekë humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast fator, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e kreditorit, ky i fundit mund të kërkojë që t'i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të kredisë së tij.

Neni 537

Pengu dhe hipoteka janë të papjesëtueshme edhe sikur detyrimi të jetë i pjesëtueshëm.

Neni 538

Kur pengu ose hipoteka janë vënë për të siguruar një detyrim të një personi tjetër, pronari i sendit të lënë peng ose hipotekë mund t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapsimet që mund t'i kundrejtonte debitori dhe të kërkojë kompensimin e detyrimit me kreditë që ka debitori ndaj kreditorit.

Neni 539

Kur kreditori nuk paguhet tërësisht nga sendi i lënë peng ose hipotekë, ka të drejtë që pjesën e kredisë së papaguar ta nxjerrë nga çdo pasuri tjetër e debitorit, por pa patur të drejtën e preferimit ndaj kreditorëve të tjerë, siç e kishte për sendin e lënë peng, ose hipotekë.

Neni 540

është e pavlefshme marrëveshja sipas së cilës përcaktohet se në mungesë të pagesës së kredisë në afatin e caktuar, pronësia mbi sendin e hipotekuar ose të dhënë peng i kalon kreditorit.

KREU II
KUSHTI PENAL

Neni 541

Për mosekzekutimin ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimeve, palët mund të parashikojnë në kontratë pagimin e një shume të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër, për riparimin e dëmit ose për të nxitur ekzekutimin e detyrimit.

Neni 542

Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit.

Neni 543

Kur kushti penal është caktuar për rastin e mosekzekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Neni 544

Kur kushti penal është tepër i madh në krahasim me dëmin e pësuar nga kreditori, gjykata me kërkesën e debitorit mund të pakësojë kushtin disiplinor deri në nivelin e dëmit të pësuar.

Neni 545

Marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkresë, pavarësisht nga madhësia e tij dhe nga forma që kërkohet për kontratën kryesore.

KREU III
PENGU

Përkufizimi
Neni 546

Pengu vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufruktin e kësaj pasurie ose të drejte. Pengu krijohet duke vendosur pasurinë ose titullin në posedim të kreditorit ose të një të treti të caktuar me marrëveshje midis palëve.

Forma e kontratës
Neni 547

Kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose tek noteri, ndryshe është e pavlefshme. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu një përshkrim të pronës së lënë peng. Në rastin e pengut të pjesëve, pengu duhet të regjistrohet në librin e anëtarëve të shoqërisë. Në rastin e pengut të aksioneve, pengu duhet të regjistrohet në librin e aksionerëve, në aksionet e lëna peng.

Mund të lihet peng e gjitha ose një pjesë e pronave të përdorura në një ndërmarrje që vepron si një koncern veprues. Në një rast të tillë pengu është efektiv kur pronat i besohen një pale të tretë ose një kreditori, i cili nga ana e tij, do t'i menaxhojë ato si një koncern veprues i pandashëm.

Mbrojtja e kreditorit
Neni 548

Kreditori që ka humbur posedimin e sendit të marrë peng, përveç padisë posedimore mund të ushtrojë edhe padinë e rivendikimit, në qoftë se kjo i takon pengdhënësit.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 549

Kreditori detyrohet ta ruajë sendin e marrë në peng dhe përgjigjet, sipas rregullave të përgjithshme, për humbjen dhe dëmtimin e tij.

Personi që ka dhënë pengun detyrohet të paguajë shpenzimet e kryera për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sendit.

Neni 550

Në qoftë se sendi i dhënë peng sjell fryte ose të ardhura, kreditori ka të drejtë t'i bëjë ato të vetat, duke i përdorur së pari për shpenzimet dhe kamatat dhe pastaj për kredinë, përveç kur është parashikuar ndryshe në kontratë.

Neni 551

Kreditori nuk mund të përdorë sendin e dhënë peng pa patur pëlqimin e pengdhënësit, përveç kur përdorimi është i nevojshëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

Ai nuk mund ta japë sendin në peng ose t'ua lërë të tjerëve në përdorim.

Neni 552

Në qoftë se kreditori shpërdoron sendin e dhënë në peng, pengdhënësi mund të kërkojë vënien e sendit në sekuestro.

Neni 553

Personi që ka dhënë pengun nuk mund të kërkojë kthimin e sendit, në qoftë se nuk janë paguar tërësisht kredia, kamatat, si dhe shpenzimet që kanë lidhje me detyrimin dhe me pengun.

Në qoftë se pengu është dhënë nga një debitor, i cili ka ndaj të njëjtit kreditor një detyrim tjetër të lindur pas vënies së pengut dhe që është bërë i kërkueshëm përpara detyrimit të mëparshëm, kreditori ka vetëm të drejtën të mbajë sendin deri sa të paguhen plotësisht të dy kreditë.

Neni 554

Në rast se sendi i dhënë në peng cenohet ose i pakësohet vlefta në mënyrë të tillë që dyshohet nëse do të jetë i mjaftueshëm për sigurimin e kreditorit, ky i fundit, pasi të njoftojë pengdhënësin, mund të kërkojë prej gjykatës autorizimin për të shitur sendin.

Gjykata kur jep autorizim për shitje vendos edhe për depozitimin e çmimit të blerjes për të garantuar kredinë.

Pengdhënësi mund të shmangë shitjen dhe të kërkojë prej gjykatës kthimin e pengut, duke ofruar një garanci tjetër reale, të cilën gjykata e çmon të mjaftueshme.

Në rast cenimi ose pakësimi të vleftës së sendit të dhënë peng, pengdhënësi mund të kërkojë prej gjykatës autorizim për të shitur sendin, në qoftë se atij i paraqitet një rast i favorshëm.

Gjykata, kur jep autorizimin për shitje, vendos edhe për kushtet e shitjes dhe të depozitimit të çmimit të blerjes.

Neni 555

Kur sendet e lëna peng prishen, dëmtohen ose shpronësohen për interesa publike, kreditorët që janë të siguruar me peng, kanë të drejtë të paguhen me preferim, sipas rradhës së preferimit që kanë patur kreditë e tyre, nga shuma e shpërblimit të sendit ose nga çmimi i shpronësimit të tij.

Procedura e shitjes

Neni 556

Përpara se të procedohet për shitjen kreditori, me anë të gjykatës, i paraqet debitorit kërkesën për të paguar detyrimin dhe aksesorët e tij duke e paralajmëruar atë se në rast të kundërt do të kryhet shitja. Ky njoftim i duhet bërë edhe palës së tretë që ka dhënë pengun, në rastet kur kjo palë ekziston.

Në qoftë se kërkesa nuk kundërshtohet brenda pesë ditësh, kreditori mund ta shesë sendin në ankand ose, po qe se sendi ka një çmim tregu, mund ta shesë atë edhe me këtë çmim, me anë të një personi të autorizuar për shitje të tilla.

Kur pengu përfshin shumë sende, gjykata, e mbështetur në kundërshtimin e pengdhënësit, kufizon shitjen vetëm për sendin, vlefta e të cilit në lidhje me sendet e tjera, mjafton për të paguar debinë.

Për shitjen e sendit të dhënë peng palët mund të merren vesh për të përdorur edhe forma të tjera.

Neni 557

Kreditori pengmarrës, në mbarim të afatit detyrohet të vjelë të drejtat që rrjedhin nga kredia e marrë peng dhe kur kjo ka për objekt para ose sende të tjera të barazvlershme, vetë ose me kërkesën e debitorit duhet t'i depozitojë ato në vendin e caktuar në marrëveshje dhe, në mungesë të saj, në vendin e caktuar nga gjykata. Kur afati i kredisë i garantuar me pengun ka mbaruar, kreditori mban nga shuma e marrë aq sa nevojiten për përmbushjen e të drejtave të tij dhe mbetjen ia kthen pengdhënësit.

Neni 558

Kreditori mund të kërkojë nga gjykata që sendi t'i lihet atij me pagesë deri në shlyerjen e detyrimit, sipas vlerësimit të bërë nga ekspertë ose sipas çmimit të tregut, në qoftë se sendi ka një çmim tregu.

Neni 559

Në qoftë se kredia e dhënë në peng rezulton nga një dokument, pengdhënësi detyrohet t'ia japë këtë dokument kreditorit.

KREU IV
HIPOTEKA

Përkufizimi i hipotekës
Neni 560

Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi.

Sendet e hipotekueshme
Neni 561

Janë të hipotekueshme:
1. Sendet e paluajtshme.
2. Uzufruktet e këtyre sendeve përveç uzufruktit ligjor të prindërve, si dhe të drejtat enfiteotike mbi këto sende.

Llojet e hipotekave
Neni 562

Hipoteka vihet në bazë të kontratës ose të ligjit dhe me regjistrimin e saj. Kontrata duhet të bëhet me akt noterial.

Hipoteka ligjore
Neni 563

Kanë hipotekë në bazë të ligjit:
a) shitësi e çdo tjetërsues tjetër mbi sendet e paluajtshme të tjetërsuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga tjetërsimi;
b) bashkëtrashëgimtarët, anëtarët e shoqërive me aktivitet ekonomik e bashkëpjesëtarët e tjerë mbi sendet e paluajtshme të përbashkëta, në pjesët që u kanë takuar atyre për pagimin e shumave të caktuara për barazimin dhe plotësimin e pjesëve.

Neni 564

Servitutet që janë regjistruar pas regjistrimit të një hipoteke, nuk mund t'i kundrejtohen kreditorit hipotekar.
Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe për të drejtën e uzufruktit, të përdorimit dhe të banimit.

Hipoteka gjyqësore
Neni 565

Vendimi i gjykatës për pagimin e një shume parash, për përmbushjen e detyrimeve të vlerësuara apo për shpërblimin e dëmeve që do të rrjedhin më pas, përbën titull për vënien e hipotekës tek pasuria e debitorit.
Hipotekë mund të vihet edhe në bazë të një vendimi arbitrazhi që përbën titull ekzekutiv.

Neni 566

Kur hipoteka jepet nga një person që nuk është pronar i sendit, regjistrimi i saj quhet i vlefshëm vetëm kur sendi fitohet prej tij.

Hipoteka mbi sendet e ardhshme
Neni 567

Hipoteka mbi një send të ardhshëm, mund të regjistrohet vetëm kur të ekzistojë sendi.

Shtrirja e hipotekës
Neni 568

Hipoteka siguron kredinë për aq sa kjo do të jetë në kohën e shlyerjes së saj, duke përfshirë edhe kamatat, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e bëra për nxjerrjen e kredisë.

Neni 569

Hipoteka e vënë mbi pjesën e vet nga njëri prej pjesëtarëve në bashkëpronësi sjell efekt në lidhje me atë send ose me atë pjesë të sendit që do t'i jepet atij pas ndarjes.

Në qoftë se gjatë ndarjes njërit pjesëtar i jepet një send tjetër dhe i pahipotekuar prej tij, hipoteka kalon mbi këtë send me të njëjtën shkallë regjistrimi sikurse origjinali dhe brenda kufijve të vleftës së sendit të hipotekuar më përpara, me kusht që hipoteka të regjistrohet përsëri brenda 90 ditëve nga regjistrimi i së njëjtës ndarje.

Vendi i regjistrimit
Neni 570

Hipoteka regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme të vendit ku ndodhet kjo pasuri.

Neni 571

Detyrimet që rrjedhin nga titujt me urdhër ose tek prurësi mund të garantohen me hipotekë.

Efektet e pasaktësive të aktit
Neni 572

Hipoteka është e pavlefshme, kur në kontratën e hipotekës, ose në aktin bazë për vënien e hipotekës, apo në kërkesën për vënien e saj, në bazë të ligjit, ka pasaktësi për personin e kreditorit, të debitorit, të pronarit të sendit të lënë në hipotekë, për vetë sendin ose për shumën e kredisë të siguruar me hipotekë.

Shpenzimet e regjistrimit
Neni 573

Shpenzimet e regjistrimit të hipotekës janë në ngarkim të debitorit, përveç kur është parashikuar ndryshe, por ato duhet të parapaguhen nga kërkuesi.

Radha e hipotekave
Neni 574

Hipoteka sjell efekt dhe zë radhë nga data e regjistrimit të saj edhe kur titulli është për një kredi të ardhshme ose të kushtëzuar.

Neni 575

Numri rendor i regjistrimeve përcakton rradhën e tyre.

Kur në të njëjtën kohë shumë persona paraqesin kërkesë për të regjistruar në hipotekë ndaj të njëjtit person dhe po mbi ato prona, regjistrimi bëhet me të njëjtin numur dhe ky fakt shënohet në dëftesën që regjistruesi i jep secilit prej kërkuesve.

Neni 576

Hipotekat e regjistruara me të njëjtin numër dhe po mbi ato prona, konkurrojnë me njëra-tjetrën, në përpjesëtim me vleftën e tyre përkatëse.

Neni 577

Regjistrimi i një kredie shërben për të vënë në po atë radhë shpenzimet e aktit, të regjistrimit e të përtëritjes, si dhe shpenzime të tjera që nevojiten për procedurat ekzekutive.

Regjistrimi i një kredie në para që sjell kamatë, bën që kamata të qëndrojë në të njëjtën radhë përparësie me atë, me kusht që kamata të jetë përcaktuar në regjistrim.

Kamata në këtë rast kufizohet në dy vitet parardhëse, si dhe në vitin në vazhdim në ditën që është vënë dorë e deri në ditën e mbylljes së procedimit të zbatimit forcërisht.

Efektet e hipotekës

Neni 578

Regjistrimi i hipotekës ka efekt për një periudhë prej 20 vjetësh nga data e kryerjes së tij. Efekti pushon në qoftë se nuk përtërihet përpara mbarimit të këtij afati. Pas mbarimit të afatit të treguar më sipër, kreditori mund të kryejë një regjistrim të ri, por në këtë rast hipoteka zë radhë dhe ka efekt kundrejt palëve të treta sipas datës së regjistrimit të ri.

Neni 579

Kalimi i kredisë së siguruar me hipotekë një personi tjetër dhe vënia e sekuestros mbi këtë kredi ka efekt pasi të jetë bërë shënimi përkatës në regjistrimin e hipotekës.

Neni 580

Në qoftë se kreditori që ka hipotekë mbi një ose më shumë prona del i dëmtuar për shkak se me çmimin e tyre është paguar tërësisht ose pjesërisht një kreditor i mëparshëm, hipoteka e të cilit shtrihej mbi prona të tjera të të njëjtit debitor, mund të nënvendësohet në hipotekën e regjistruar në favor të kreditorit të paguar, me qëllim që të ushtrojë padinë hipotekore mbi ato prona, duke u parapëlqyer ndaj kreditorëve të tjerë që vijnë pas tij në regjistrim. Po këtë të drejtë kanë edhe kreditorët që dëmtohen për shkak të nënvendësimit të sipërpërmendur.

Zbritja e hipotekës

Neni 581

Zbritja e hipotekave bëhet duke e kufizuar vetëm në një pjesë të pasurisë së treguar në regjistrim ose duke pakësuar shumën për të cilën është vënë regjistrimi.

Neni 582

Kërkesa për zbritjen e hipotekave sipas nenit të mësipërm nuk pranohet, në qoftë se sasia e pasurisë apo shuma ka qenë caktuar me marrëveshje ose me vendim gjykate.

Megjithatë, kur janë bërë pagesa të pjesshme, që shuajnë të paktën një të pestën e detyrimit fillestar, mund të kërkohet një pakësim përpjesëtimor i shumës.

Kur është vënë hipotekë mbi një ndërtesë, hipotekuesi që pas regjistrimit ka bërë mbindërtime, mund të kërkojë që hipoteka të pakësohet, në mënyrë që mbindërtimet të përjashtohen.

Shuarja e hipotekës

Neni 583

Hipoteka shuhet:

a) me shuarjen e detyrimit;

b) me humbjen e sendit të lënë në hipotekë, duke respektuar të drejtat e parashikuara prej nenit 536 të këtij Kodi;

c) me heqjen dorë të kreditorit;

ç) me pagimin e çmimit të shitjes me anë të ekzekutimit të detyrueshëm, kreditorëve të siguruar me hipotekë, sipas radhës së regjistrimit të tyre;

d) me kalimin e afatit për të cilin ishte kufizuar hipoteka.

Fshirja e regjistrimit të hipotekës

Neni 584

Regjistrimi i hipotekës fshihet:

a) me pëlqimin e kreditorit të dhënë me akt-noterial;

b) me vendim të formës së prerë të gjykatës që urdhëron fshirjen.

Fshirja e regjistrimit shuan hipotekën. Kur shkaku i shuarjes së detyrimit deklarohet i pavlefshëm, hipoteka lind dhe regjistrohet përsëri, por regjistrimi merr numër rendor të ri.

KREU V
DORËZANIA

Përmbajtja

Neni 585

Dorëzania është një veprim juridik me të cilën një person (dorëzënësi), detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor).

Dorëzania është e vlefshme edhe kur debitori nuk ka dijeni për atë.

Neni 586

Dorëzania qëndron vetëm për një detyrim efektiv.

Dorëzania mund të jepet si për një detyrim të ardhshëm, ashtu dhe për një detyrim me kusht.

Forma dhe vlefshmëria

Neni 587

Dorëzania duhet të bëhet me shkresë.

Neni 588

Dorëzania nuk është e vlefshme në qoftë se nuk është i vlefshëm detyrimi kryesor. Ajo mund të jepet si për debitorin kryesor, ashtu dhe për dorëzanësin e tij.

Efektet e dorëzanisë dhe detyrimet e palëve

Neni 589

Dorëzanësi përgjigjet për aq sa detyrohet debitori kryesor, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera që ka bërë kontraktori për të nxjerrë kredinë e tij, përveç kur në marrëveshje pranohet që dorëzania të jepet edhe për një pjesë të detyrimit, ose me kushte më të lehta ose më të pakta se detyrimi kryesor.

Dorëzania që kalon detyrimin ose që jepet në kushte më të rënda se detyrimi kryesor, është e vlefshme vetëm deri në kufijtë e këtij të fundit.

Neni 590

Dorëzanësi është i detyruar solidarisht mbi debitorin kryesor për ekzekutimin e detyrimit, përveç kur është parashikuar ndryshe me marrëveshje.

Palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos jetë i detyruar të paguajë para kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme,që detyrojnë debitorin të paguajë detyrimin. Në rast se dorëzanësi paditet dhe kërkon të përdorë një të drejtë të tillë, ai duhet të tregojë pasurinë e debitorit kryesor që do t'i nënshtrohet ekzekutimit. Dorëzanësi është i detyruar të parapaguajë shpenzimet e nevojshme, në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

Neni 591

Kur disa persona janë bërë dorëzanës për të njëjtin debitor, për të siguruar të njëjtin detyrim, secili prej tyre përgjigjet për të gjithë detyrimin, përveç kur ka marrëveshje për ndarjen e tij.

Neni 592

Dorëzanësi ka të drejtë t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundrejtonte këtij debitori dhe të kërkojë kompensimin e asaj që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur ky të ketë hequr dorë nga këto të drejta ose të ketë pranuar detyrimin.

Neni 593

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin në vend të debitorit, zë vendin e kreditorit në të gjitha të drejtat e tij ndaj debitorit.

Neni 594

Kur janë shumë debitorë kryesorë të detyruar solidarisht për të njëjtin detyrim, dorëzanësi që ka dhënë garanci për të gjithë ata, ka të drejtën e padisë së kthimit nga secili prej tyre për të marrë shumën që ka paguar.

Neni 595

Kur dorëzanësi ka ekzekutuar detyrimin e debitorit pa u paditur në gjyq dhe pa lajmëruar debitorin kryesor, ky mund t'i kundrejtojë dorëzanësit të gjitha prapsimet që do të mund t'i kundrejtonte kreditorit në kohën e ekzekutimit të detyrimit.

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit nuk ka të drejtë të kërkojë me padi nga debitori atë që ka ekzekutuar për të, në rast se edhe debitori ka ekzekutuar detyrimin e tij për shkak se dorëzanësi nuk e ka lajmëruar për ekzekutimin e detyrimit që ka bërë ai vetë.

Në të dy rastet, dorëzanësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër kreditorit dhe të kërkojë atë që ka ekzekutuar për debitorin kryesor.

Neni 596

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin duhet të lajmërojë menjëherë dorëzanësin. Në rast të kundërt, dorëzanësi, që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit, nuk e humbet të drejtën që të kërkojë nga debitori atë që ka ekzekutuar për të. Debitori, në këtë rast, është i detyruar të ekzekutojë për të dytën herë detyrimin, por ka të drejtë që të ngrejë padi kundër kreditorit për atë që ky ka fituar pa shkak.

Shuarja e dorëzanisë

Neni 597

Dorëzania shuhet me shuarjen e detyrimit kryesor.

Neni 598

Dorëzanësi shkarkohet nga detyrimi i tij në rast se kreditori ka hequr dorë nga privilegjet, pengu dhe hipoteka që i siguronin kredinë dhe për këtë shkak dorëzanësi nuk mund të zerë vendin e tij në këto të drejta.

Neni 599

Kur kreditori pranon vullnetarisht një pasuri, ose çdo gjë tjetër për pagimin e detyrimit kryesor, dorëzanësi lirohet nga detyrimi i tij edhe sikur kreditorit t'i rezultojë më pas një shkak evinksioni.

Neni 600

Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit.

Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë, as në një marrëveshje tjetër, dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.

KREU VI
KAPARI DHE PRIVILEGJET

A. KAPARI

Përmbajtja

Neni 601

Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.

Efektet juridike

Neni 602

Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kapar, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për mosekzekutimin e kontratës është e detyruar t'i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

B. Preferimet (privilegjet)

Neni 603

Preferimi është një e drejtë, të cilën ligji e jep duke patur parasysh shkakun e kredisë. Kreditë që caktohen si të preferuara, kanë përparësi nga gjithë kreditë e tjera. Midis shumë kredive të preferuara, përparësia në ekzekutim përcaktohet nga ligji, sipas llojit të preferimit.

Neni 604

Kreditë që janë një lloj të preferuara, konkurrojnë ndërmjet tyre në proporcion me shumën e secilës kredi.

Radha e preferimit

Neni 605

Paguhen me preferim sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:

a) kreditë e punëtorëve dhe nëpunësve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës;

b) kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësuara nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;

c) kreditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;

ç) kreditë e autorëve dhe trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale, për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;

d) kreditë e shtetit që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme të përcaktuara me ligj;

e) shpërblimi i ndërmjetësimit, që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të fundit të shërbimit;

ë) kreditë e siguruara me peng ose me hipotekë, nga vlefta esendeve të lëna peng ose hipotekë;

f) kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vlefta e shitjes së sendeve;

dh) kreditë e dhëna nga bankat dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;

g) kreditë për furnizimin me farëra, plehëra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frytet) bujqësore të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kreditë që përmenden në shkronjat "a", "b", "c" dhe "dh" paguhen me preferim nga e gjithë pasuria e debitorit.

Neni 606

Kreditori mund ta mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mund ta shesë atë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit
Neni 607

Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik.

Kur veprimi juridik është bërë me kundërshpërblim, duhet që edhe personi, me të cilin debitori ka kryer këtë veprim, të ketë patur dijeni për qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por kur ky person është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë e fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit prezumohet, gjersa të provohet e kundërta.

Me deklarimin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk cënohen të drejtat që kanë fituar me kundërshpërblim personat e tretë me mirëbesim para ngritjes së padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik.

TITULLI IV
DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit
Neni 608

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

Neni 610

Është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj.

Neni 611

Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti.

Neni 612

Personi që ka shkaktuar dëmin duke qënë i shtrënguar nga nevoja për të shpetuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qënë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit.

Dëmi nga të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar

Neni 613

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.

Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijve nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 614

I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.

Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Dëmi nga personat nën mbikëqyrje

Neni 615

Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qënë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 616

Për dëmin përgjjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij.

Gjykata, mund të ulë masën e dëmshpërblimit, duke marrë parasysh moshën, shkallën e ndërgjegjes për veprimet e kryera, si dhe kushtet ekonomike të palëve, përveç kur për fajin e tij ka sjellë veten në këtë gjendje.

Publikimet mashtruese ose të pasakta

Neni 617

Kur vërtetohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota ose mashtruese, gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin tjetër që të publikojë një përgënjeshtrim, në mënyrën që ajo do ta quante të përshtatshme.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e përgënjeshtrimit edhe kur vërtetohet se publikimi i të dhënave nuk është i paligjshëm dhe i kryer me faj, se autori i tyre nuk kishte dijeni për karakterin e pasaktë ose të paplotë të këtyre të dhënave.

Përgjegjësia e punëdhënësit

Neni 618

Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij.

Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 619

Në qoftë se një person që ushtron veprimtari në kuadrin e detyrës të një tjetri dhe sipas udhëzimeve të tij, pa qenë punonjës i tij, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar gjatë kësaj veprimtaria ndaj të tretit.

Personi tjetër është gjithashtu përgjegjës ndaj të tretit.

Përgjegjësia e përfaqësuesit

Neni 620

Në qoftë se veprimtaria e përfaqësuesit në ushtrimin e pushteteve që i janë caktuar, sjell një përgjegjësi me faj ndaj një të treti, i përfaqësuari është gjithashtu përgjegjës ndaj këtij personi.

Përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve

Neni 621

Pronari i një kafshe ose ai që e përdor atë është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç kur provon se ka patur kontrollin e sjelljes së kafshës nga e cila është shkaktuar dëmi dhe nuk ka mundur ta mënjanonte atë.

Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme

Neni 622

Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.

Neni 623

Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre.

Por pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t'u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar.

Përgjegjësia për mjedisin

Neni 624

Personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Përgjegjësia për dëmin jopasuror

Neni 625

Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;

b) është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.

E drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm është e patrashëgueshme.

Përgjegjësia solidare
Neni 626

Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht.

Padia e kthimit
Neni 627

Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë.

Prindërit ose kujdestarët që kanë paguar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të miturit ose nga personat të cilëve u është hequr krejt zotësia për të vepruar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga këta kthimin e shpërblimit të dëmit që kanë paguar.

KREU II
PËRGJEGJËSIA QË RRJEDH NGA PRODUKTET

A. PËRGJEGJËSIA E PRODHUESIT

Neni 628

Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e produkteve të tij, përveç kur:

a) prodhuesi nuk ka vënë në qarkullim produktet;

b) sipas rrethanave të vërtetuara, vlerësohet se të metat që kanë shkaktuar dëmin nuk ekzistonin në kohën e vënies në qarkullim të produktit, ose ato kanë lindur më vonë;

c) produkti nuk ka qenë prodhuar për shitje ose ndonjë formë tjetër shpërndarje, me qëllim të caktuar ekonomik të prodhuesit, as edhe i prodhuar ose i shpërndarë në kuadrin e një ndërmarrjeje ose veprimtarie profesionale;

d) të metat janë rrjedhim i faktit se produkti ka qenë nëpërputhje me rregullat e vëna nga organet publike;

e) njohuritë shkencore e teknike nuk kanë mundur të zbulojnë të metat në kohën e vënies në qarkullim të produktit;

ë) është fjala për prodhimin e një lënde të parë ose fabrikimin e një pjese përbërëse të produktit, të cilat në formimin e produktit rezultojnë me të meta, ose si rrjedhojë e udhëzimeve të gabuara të dhëna nga prodhuesi i produktit.

Neni 629

Përgjegjësia e prodhuesit pakësohet ose hiqet kur, sipas rrethanave, dëmi është shkaktuar si nga të metat e produktit, ashtu edhe nga faji i personit të dëmtuar ose të një personi, për të cilin personi i dëmtuar është përgjegjës.

Përgjegjësia e prodhuesit nuk pakësohet kur dëmi është rrjedhim i përbashkët i të metave të produktit dhe sjelljes së një të treti.

Neni 630

Një send quhet se është me të meta kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke patur parasysh gjithë rrethanat e në veçanti:

a) paraqitjen e produktit;
b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;
c) kohën e vënies në qarkullim të produktit.

Produkti nuk mund të quhet se është me të meta duke u nisur nga fakti se një produkt më i perfeksionuar është vënë në qarkullim me vonë se ai.

Neni 631

"Produkt" në kuptim të këtij Kodi quhet një send i luajtshëm edhe sikur ai të jetë trupëzuar në një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, si dhe elektriciteti, duke përjashtuar produktet bujqësore dhe produktet e rrjedhura nga gjuetia.

Me produkte bujqësore kuptohen prodhimet e tokës, të blegtorisë dhe të peshkimit, përveç kur këto kanë pësuar një përpunim të parë.

"Prodhues" në kuptimin e këtij Kodi quhet prodhuesi i një produkti të përfunduar, të një lënde të parë ose fabrikuesi i një pjese përbërëse të produktit, si dhe çdo person tjetër që paraqitet si i tillë (prodhues), duke vënë mbi produktin emrin e tij, markën ose një shënjë tjetër dalluese.

Pa mënjanuar përgjegjësinë e prodhuesit, quhet si "prodhues" çdo person që importon një produkt me qëllim shitjeje, dhënieje me qira, leasingu, ose një formë tjetër shpërndarjeje, në kuadrin e veprimtarisë së tij tregtare. Në këtë rast, përgjegjësia e tij është e njëjtë me atë të prodhuesit.

Neni 632

Kur prodhuesi nuk mund të identifikohet, çdo furnizues do të konsiderohet si prodhues, përveç kur brenda një afati të arsyeshëm, ai i tregon personit të dëmtuar identitetin e prodhuesit ose të personit që ka furnizuar produktin.

Neni 633

Kur, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shumë persona janë përgjegjës për të njëjtin dëm, secili prej tyre është përgjegjës për të gjithë dëmin.

Neni 634

Padia për shpërblimin e dëmit e ngritur kundër prodhuesit, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, parashkruhet me kalimin e tre vjetëve duke filluar nga dita që personi i dëmtuar ka patur ose duhej të kishte patur dijeni për dëmin, të metat dhe identitetin e prodhuesit.

E drejta e personit të dëmtuar kundër prodhuesit për shpërblimin e dëmit, sipas paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shuhet me kalimin e dhjetë vjetëve, nga dita që prodhuesi ka vënë në qarkullim produktin që ka shkaktuar dëmin.

B. PUBLIKIMI MASHTRUES

Neni 635

Personi që publikon ose shkakton bërjen publike të një njoftimi lidhur me produktet ose shërbimet, që ofron vetë në rastin e një veprimtarie profesionale, ose të një ndërmarrjeje, ose të një personi për të cilin ai vepron, kryen një veprim të paligjshëm në qoftë se njoftimi është mashtrues në një ose disa drejtime të mëposhtme:

a) natyra, përbërja, sasia, cilësia, karakteristikat ose përdorimet e mundshme;
b) origjina, mënyra ose data e prodhimit;

c) madhësia e prodhimit stok të tij;
ç) çmimi ose metoda e llogaritjes së tij;
d) arsyeja ose qëllimi i ofertës speciale;
dh) cilësitë e atribuara, dëshmitë ose vlerësime të tjera të bëra nga të tretët, ose deklarata të lëshuara prej tyre, terminologjia shkencore ose profesionale e përdorur, të dhënat teknike ose statistikore;
e) kushtet e livrimit të produkteve, të ushtrimit të shërbimeve ose të kryerjes së pagesës;
f) shtrirja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e garancisë;
g) identiteti, cilësitë, kompetencat ose tagret e atij që fabrikon ose ka fabrikuar produktet, që ofron ato ose të atij që kryen shërbim, që drejton, mbikëqyr ose ndihmon në këto veprimtari;
gj) krahason me produkte dhe shërbime të tjera.

Neni 636

Personi që ka vepruar në mënyrë të paligjshme sipas dispozitës së sipërme, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se nuk ka faj për ardhjen e tij.

Neni 637

Kur publikimi mashtrues, i parashikuar prej nenit 635 të këtij Kodi, i ka shkaktuar ose rrezikon t'i shkaktojë dëm një tjetri, me kërkesën e tij, gjykata urdhëron ndalimin e menjëhershëm të tij dhe detyrimin e personit përgjegjës për të kryer një përgënjeshtrim publik, në mënyrën që gjykata do ta gjejë të përshtatshme.

C. KONKURRENCA E PANDERSHME
Neni 638

Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:
l. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;
2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;
3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Neni 639

Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.
Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

KREU III
SHPËRBLIMI I DËMIT

Neni 640

Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.
Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Neni 641

Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Neni 642

Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo rëndimit të shëndetit ose të shtimit apo pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit, në krahasim me kohën e caktimit të shpërblimit dhe të ndryshimeve që mund të ketë pësuar paga e të dëmtuarit.

Neni 643

Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga:

a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;

b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.

Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundrejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundrejtonte të vdekurit.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.

Neni 644

Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin.

Neni 645

Kur shkaktohet vdekja ose dëmtimi i shëndetit të një personi që fiton nga sigurimet shoqërore, dëmi shpërblehet në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 646

Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, caktohet nga gjykata në bazë të pagës që merr një punonjës i asaj kategorie me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari.

Neni 647

I mituri i dëmtuar, kur mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kritereve të nenit 646 të këtij Kodi.

Me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.

TITULLI V
GJERIMI I PUNËVE TË TË TJERËVE

Neni 648

Personi që, pa qënë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë.

Neni 649

Personi i interesuar duhet të përmbushë detyrimet që gjeruesi ka marrë përsipër në emër të tij, të përjashtojë gjeruesin nga detyrimet që ka marrë në emër të vet dhe t'i paguajë atij shpenzimet e nevojshme e të dobishme që nga dita që janë bërë dhe, kur është rasti, t'i shpërblejë edhe dëmin që mund të ketë pësuar si rrjedhim i gjerimit, por me kusht që veprimet e kryera nga gjeruesi, të mos kenë qenë ndaluar nga personi i interesuar.

Kur gjeruesit, përveç gjerimit të punëve, i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion, ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifat e caktuara për aktivitete të tilla.

Neni 650

Gjeruesi ka të drejtë të kryejë veprime juridike në emër të personit të interesuar, në masën që interesi i këtij të fundi plotësohet në mënyrë të përshtatshme.

Neni 651

Gjeruesi u nënshtrohet detyrimeve të njëjta që rrjedhin nga një kontratë porosie.

Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar tek gjeruesi për të marrë përsipër gjerimin, mund të pakësojë dëmshpërblimin për dëmin që është shkaktuar për faj të tij.

Neni 652

Personi i interesuar, me anë miratimi të veprimtarisë të gjeruesit, mund të tërheqë të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblim nga gjeruesi, sipas dispozitës së mësipërme. Për këtë qëllim personit të interesuar duhet t'i jepet një afat i arsyeshëm.

TITULLI VI
PAGIMI I PADETYRUAR

Neni 653

Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim.

Neni 654

Personit që ka paguar detyrimin e një tjetri duke besuar se ishte debitor, në bazë të një lajthitjeje të kryer pa faj, mund t'i kthehet ajo që ka paguar, me kusht që kreditori të mos jetë privuar në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë.

Kthimi i pagesës duhet të shoqërohet me frytet dhe kamatat, në kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme.

TITULLI VII
BEGATIMI PA SHKAK

Neni 655

Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit.

Neni 656

Kur begatimi pa ndonjë shkak të ligjshëm ka për objekt një send të caktuar, personi që e ka marrë atë, duhet ta kthejë në natyrë, së bashku me të ardhurat që ka nxjerrë ose duhet të nxirrte dhe ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë, sipas dispozitave për kërkimin e sendit nga poseduesi i paligjshëm.

Neni 657

Nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që personi ka dhënë vullnetarisht për ekzekutimin e një detyrimi, i cili, megjithëse i pakërkueshëm, nuk është i pavlefshëm.

Neni 658

Padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.

PJESA V
KONTRATAT

TITULLI I
KONTRATAT NË PËRGJITHËSI

KREU I
DISPOZITA PARAPRAKE

Përmbajtja e kontratës
Neni 659

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Neni 660

Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.

Kontrata me detyrime të njëanshme e të dyanshme

Neni 661

Kontrata është me detyrim të njëanshëm, kur njëra palë merr përsipër detyrime ndaj palës tjetër pa patur kjo e fundit ndonjë detyrim ndaj saj.

Neni 662

Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës.

Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës

Neni 663

Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Lidhja e kontratës

Neni 664

Kur kontrata përmban vetëm detyrimin e propozuesit, pritësi mund ta refuzojë propozimin brenda afatit të caktuar, ose që rrjedh nga natyra e marrëveshjes. Në mungesë të një refuzimi të tillë, kontrata quhet e lidhur.

Neni 665

Personi që propozon përfundimin e një kontrate është i lidhur me propozimin, përveç kur kjo lidhje është përjashtuar. Kur propozimi refuzohet ose nuk pranohet në afatin e caktuar, quhet i rënë.

Kur nuk është caktuar afat, propozuesi është i lidhur me propozimin e bërë, gjer në kohën që zakonisht apo sipas rrethanave, është e nevojshme që këtij t'i arrijë përgjigjja e palës tjetër.

Neni 666

Propozimi për të lidhur një kontratë, që i bëhet një personi të pranishëm, pa iu caktuar një afat për pranimin, e humbet fuqinë e tij, në qoftë se personi i pranishëm nuk e pranon propozimin menjëherë.

Neni 667

Kur propozuesi ka caktuar një afat për pranimin, është e nevojshme që përgjigjja të vijë brenda afatit.

Propozuesi mund ta quajë të vlefshëm pranimin e vonuar, por duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër.

Kur pranimi është dërguar në kohë, por i ka mbrritur propozuesit me vonesë dhe ky nuk dëshiron të jetë i lidhur me atë, duhet të njoftojë në çast pranuesin.

Neni 668

Propozimi për të lidhur një kontratë e humbet fuqinë e tij, në qoftë se propozuesi njofton palën tjetër, para se asaj t'i ketë arritur propozimi, se e ka tërhequr atë.

Ky rregull vlen edhe për tërheqjen e pranimit nga pala tjetër.

Neni 669

Kur me kërkesën e propozuesit, ose duke marrë parasysh natyrën e marrëveshjes e rrethanat që kanë lidhje me atë, rezulton që nuk ish e nevojshme pritja e pranimit të shprehur të propozimit, ose detyrimi do të kryhej pa marrë një përgjigje paraprake, kontrata quhet e lidhur, në kohën e në vendin ku ka filluar zbatimi i saj.

Pala që zbaton detyrimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër për fillimin e ekzekutimit të kontratës, përndryshe detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 670

Pranimi i propozimit që nuk përputhet me përmbajtjen e tij, quhet mospranim dhe njëkohësisht si një propozim i ri.

Neni 671

Oferta vlen si propozim, kur përmban elementet thelbësore të kontratës, që kërkohet të përfundohet, përveç kur rezulton ndryshe nga rrethanat e çështjes.

Neni 672

Pala kontraktuese mund të heqë dorë nga kontrata, brenda shtatë ditëve nga përfundimi i saj, pa treguar arsyet, kur:

- kontrata është përfunduar në vendin e punës ose të banimit të njërës palë, gjatë një eskursioni të organizuar në një mjedis publik, ose në kushte të tilla, që nuk i korrespondon një situate normale bisedimesh;
- në kontratën që ka për objekt dhënien e një kredie për të blerë një send konsumi, shitësi duhet të njoftojë me shkrim blerësin për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata e lidhur në kushtet e sipërme, për ndryshe afati i heqjes dorë është një vit.

Neni 673

Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontraktojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare.

Përfundimi i një kontrate, nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme.

Neni 674

Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës.

Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës.

Neni 675

Në rast se një palë kontraktuese disponon njohuri profesionale dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, e para ka detyrim t'i japë asaj me mirëbesim, informata e udhëzime.

Neni 676

Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.

Shkaku i paligjshëm

Neni 677

Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme.

Objekti i kontratës

Neni 678

Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet.

Neni 679

Kontrata e bërë me kusht pezullues ose me afat, është e vlefshme në rast se detyrimi, që fillimisht është i pamundur, bëhet i mundshëm përpara përmbushjes së kushtit ose mbarimit të afatit.

Neni 680

Kontrata mund të përmbajë kryerjen e veprimeve për sende në të ardhmen, përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji.

KREU II
INTERPRETIMI I KONTRATËS

Neni 681

Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

Neni 682

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit.

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

Neni 683

Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Neni 684

Kushtet e kontratës, që mund të merren me dy kuptime, interpretohen sipas praktikës së vendit ku është përfunduar kontrata.

Kur njëra nga palët është sipërmarrëse, kushtet me dy kuptime interpretohen sipas praktikës së vendit ku ndodhet selia e ndërmarrjes.

Neni 685

Fjalët dhe shprehjet që mund të kenë dy kuptime, duhet të merren në kuptimin më të përshtatshëm me natyrën e kontratës.

Kushtet e përgjithshme

Neni 686

Kushtet e përgjithshme të kontratës, të përgatitura prej njërës palë kontraktuese, kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t'i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme.

Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.

Nuk krijojnë efekte juridike ato kushte të cilat vendosin në dobi të atij që i ka përgatitur ato më përpara, kufizime për përgjegjësinë, mundësinë për t'u tërhequr nga kontrata, për të pezulluar zbatimin e saj, ose që caktojnë ndaj palës tjetër afate dekadence, ose kufizime ndaj së drejtës për të bërë prapësime, ndaj lirisë kontraktore, në marrëdhenie me të tretët, kushteve të arbitrazhit ose shmangies nga kompetencat e organeve gjyqësore, përveç kur janë miratuar veçmas me shkrim nga pala tjetër.

Neni 687

Në kontratat e përfunduara duke nënshkruar modularë ose formularë, që synojnë të disiplinojnë në mënyrë uniforme marrëdhënie kontraktore të caktuara, kushtet e shtuara tek këta modularë ose formularë kanë përparësi ndaj kushteve fillestare të modularëve e formularëve të sipërpërmendur, sa kohë që nuk përputhen me ato, edhe pse nuk kanë qënë shfuqizuar.

Neni 688

Në çdo rast, kushtet e përfshira në kushtet e përgjithshme të kontratës apo në modularë e formularë, që kanë qenë dhënë prej njërës nga palët kontraktuese, kur ka dyshim, interpretohet në dobi të palës tjetër.

Neni 689

Kur, me gjithë zbatimin e normave të parashikuara në këtë kre, kontrata mbetet e errët, kjo duhet të merret në kuptimin më pak të rënduar për të detyruarin, po qe se është pa shpërblim, dhe në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, po qe se është me shpërblim.

KREU III
EFEKTET E KONTRATAVE

Neni 690

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Neni 691

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 692

Efektet juridike të kontratës shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 693

Kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Kontrata në dobi të një të treti
Neni 694

Kontrata në dobi të një personi të tretë është e vlefshme kur personi që e lidh ka interes për atë.

Personi që ka pranuar premtimin në dobi të të tretit ose ky i fundit, apo personat që heqin të drejta prej tij, kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e kontratës, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Kontrata nuk mund të prishet ose të ndryshohet pas momentit që personi i tretë ka deklaruar se pranon të përfitojë nga lidhja e saj, përveç kur propozuesi e ka rezervuar këtë të drejtë.

Në rast revokimi të lidhjes së kontratës, ose të refuzimit të personit të tretë për të përfituar prej saj, detyrimi mbetet në dobi të propozuesit, përveç kur rezulton ndryshe nga vullneti i palëve ose nga natyra e kontratës.

Neni 695

Pala që ka bërë premtimin në dobi të personit të tretë, mund t'i kundrejtojë këtij prapsimet që rrjedhin nga kontrata, por jo ato që rrjedhin nga marrëdheniet me palën tjetër.

E drejta për t'u tërhequr nga kontrata
Neni 696

Në rast se njërës nga palët i është dhënë e drejta për t'u tërhequr nga kontrata, kjo e drejtë mund të ushtrohet për sa kohë që kontrata nuk ka filluar të zbatohet.

Në kontratat me zbatim të vazhdueshëm ose periodik, kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe më tej, por tërheqja nuk ka efekte për ekzekutimet e kryera ose që janë në kryerje e sipër.

Kur në kontratë është parashikuar pagimi i një kompensimi për tërheqjen, kjo ka efekt kur është kryer pagimi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Premtimi për kryerjen e një detyrimi
Neni 697

Personi që i ka premtuar një tjetri se një person i tretë do të ekzekutojë një detyrim, ose do të kryejë një veprim në dobi të tij, është i detyruar të shpërblejë palën tjetër, në qoftë se personi i tretë nuk pranon të ekzekutojë detyrimin ose të kryejë veprimin e premtuar.

Zgjidhja e kontratës
Neni 698

Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 699

Kontrata nuk mund të zgjidhet në qoftë se mospërmbushja e detyrimit prej njërës nga palët ka rëndësi të pakët për interesat e palës tjetër.

Neni 700

Pala kontraktuese mund të njoftojë me shkrim palën tjetër që nuk ka përmbushur detyrimin, që ta përmbushë atë në një afat të përshtatshëm, duke deklaruar se, po qe se pas këtij afati kontrata nuk ekzekutohet, ajo do të quhet patjetër e zgjidhur.

Neni 701

Në qoftë se afati i caktuar për kryerjen e detyrimit të njërës nga palët duhet quajtur thelbësor për interesin e palës tjetër, kjo e fundit kur dëshiron të kërkojë zbatimin pavarësisht nga mbarimi i afatit, duhet t'i bëjë njoftimin palës tjetër brenda tri ditëve, përveç marrëveshjes së kundërt.

Neni 702

Palët mund të parashikojnë në kontratë që ajo të zgjidhet kur një detyrim i caktuar nuk përmbushet sipas kushteve të parashikuara.

Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës.

Neni 703

Zgjidhja e kontratës për mospërmbushje të detyrimeve ka efekt prapaveprues midis palëve, përveç kontratave me ekzekutim të vazhduar ose periodik për të cilat efekti i zgjidhjes nuk shtrihet në veprimet e kryera më parë.

Zgjidhja e kontratës, qoftë edhe me marrëveshje të palëve, nuk paragjykon të drejtat e fituara nga të tretët, me përjashtim të efekteve të regjistrimit të kërkesës për zgjidhjen e kontratës.

Neni 704

Për zgjidhjen e kontratës zbatohen edhe dispozitat e pjesës së përgjithëshme të detyrimeve përveç dispozitave që rregullojnë kontratat e veçanta.

TITULLI II
KONTRATAT E VEÇANTA

KREU I
SHITJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 705

Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.

Neni 706

Në shitjen që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, fitimi i pronësisë bëhet sapo sendi ose e drejta pranohet se ekzistojnë.

Përveç kur palët kanë dashur të përfundojnë një kontratë me kusht pezullues, shitja është e paefektshme në qoftë se sendi nuk pranohet se ekziston.

Neni 707

Në qoftë se palët nuk e kanë caktuar çmimin, as nuk janë marrë vesh për mënyrën e caktimit të tij, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente publike, prezumohet se palët kanë dashur t'i referohen çmimit të zbatuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Kur është fjala për sende që kanë çmim burse apo tregu, çmimi caktohet në bazë të listave të tregut të vendit ku do të bëhet dorëzimi, ose nga ato të vendit që është më afër tij.

Në qoftë se çmimi është caktuar mbi bazën e peshës së sendeve, në rast dyshimi ai duhet të caktohet në bazë të peshës neto.

Palët mund t'ia besojnë caktimin e çmimit një të treti, të emëruar në kontratë ose që mund të emërohet më vonë.

Neni 708

Shpenzimet e kontratës së shitjes dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të blerësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Ndalime të veçanta të blerjes
Neni 709

Nuk mund të blejnë drejtpërdrejt, me anë të një tjetri, ose në ankand:

a) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, sendet që administrojnë ose ruajnë;

b) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, sendet që këta shesin;

c) gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi ato.

Detyrime të shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme

Neni 710

Detyrimet kryesore të shitësit janë:

1. t'i dorëzojë sendin blerësit;

2. kur fitimi i pronësisë mbi sendin, ose i të drejtave reale mbi të, nuk është pasojë e menjëhershme e kontratës, duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet përkatëse për fitimin e pronësisë së tyre, sipas kushteve të parashikuara nga kontrata apo nga ligji;

3. të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën.

Neni 711

Sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës. Sendet duhet të dorëzohen së bashku me aksesorët, shtesat dhe frytat që nga dita e përfundimit të kontratës, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.

Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.

Në rast se kontrata nuk përfshin transportin e sendeve dhe u referohet sendeve të caktuara individualisht, ose në lloj apo sasi, që duhen tërhequr nga një sasi e caktuar ose që duhet të fabrikohen ose të prodhohen dhe në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës, palët e dinin që sendet ndodheshin ose duhet të fabrikoheshin apo të prodhoheshin në një vend të caktuar, shitësi detyrohet t'i verë sendet në dispozicion të blerësit në atë vend.

Në rastet e tjera, shitësi është i detyruar që t'i verë sendet në dispozicion të blerësit, në vendin ku sendet ndodheshin në kohën e shitjes ose, kur një vend i tillë nuk mund të përcaktohet, në vendin ku shitësi kishte banimin e tij ose qendrën e veprimtarisë se vet.

Neni 712

Shitësi duhet të dorëzojë sendet:

1. në datën e caktuar në kontratë ose që është e përcaktueshme në bazë të kontratës;

2. në çdo moment të periudhës së kohës që është caktuar ose që është e caktueshme sipas kontratës, përveç kur del nga rrethanat se i është lënë blerësit të zgjedhë datën;

3. në çdo rast tjetër brenda një afati të arsyeshëm që nga përfundimi i kontratës.

Neni 713

Kur shitësi detyrohet të lëshojë dokumentet lidhur me sendet, ato lëshohen në kohën, në vendin dhe në formën e parashikuar në kontratë. Në qoftë se dokumentet i ka lëshuar përpara këtij momenti, ai mund të rregullojë çdo defekt të tyre deri në momentin e parashikuar për lëshimin e tyre, në qoftë se ushtrimi i një të drejte të tillë nuk i sjell blerësit shqetësime ose një shpenzim të paarsyeshëm. Në këto raste ai ruan të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 714

Në shitjen me dokumente, shitësi shkarkohet nga detyrimi i dorëzimit të sendeve të shitura, duke i dhënë blerësit dokumentin e shitjes dhe dokumentet e tjera të caktuara në kontratë ose në ligj.

Neni 715

Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.

Quhet se sendet nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm, të përcaktuar nga kontrata, përveç kur ka marrëveshje të kundërt. Kur një përcaktim i tillë nuk është i mundur, sendet quhet se nuk janë në përputhje me kontratën, në qoftë se nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sende të të njëjtit lloj.

Në qoftë se shitja është bërë mbi bazën e një modeli ose kampioni, shitësi duhet të dorëzojë sende që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose të kampionit.

Në qoftë se kontrata nuk përmend rregullat e vendosjes apo të ambalazhimit të sendeve, quhet se këto sende nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të vendosura ose të ambalazhuara sipas mënyrës së zakonshme për sende të të njëjtit lloj ose, në mungesë të një mënyre të tillë të zakonshme, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për të ruajtur dhe për të mbrojtur sendet.

Shitësi nuk është përgjegjës për të metat e sendeve të cilat, në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë dijeni për fajin e vet, përveç kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet të kishin pasur sipas kontratës ose sipas njoftimit të shitësit.

Neni 716

Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërputhje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut tek blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti.

Shitësi është përgjegjës edhe për mospërputhjen që vërtetohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm e që vjen nga mospërmbushja e një detyrimi çfarëdo të tij, duke përfshirë edhe garancinë sipas së cilës, për një periudhë të caktuar kohe sendet do të mbeten të përshtatshme për përdorimin e tyre normal ose për ndonjë përdorim të posaçëm, ose do të ruajnë cilësinë dhe karakteristikat e caktuara.

Neni 717

Blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk denoncon tek shitësi, duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi, përveç kur palët ose ligji kanë caktuar një afat tjetër.

Në çdo rast blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në qoftë se nuk e ushtron këtë të drejtë brenda dy vjetëve nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk është në kundërshtim me kohëzgjatjen e një garancie kontraktore.

Neni 718

Shitësi nuk mund të përfitojë nga rregullat e parashikuara në nenin e mësipërm, në qoftë se të metat kanë të bëjnë me fakte për të cilat ka dijeni ose që nuk mund të mos i dinte dhe nuk ia ka bërë të ditur blerësit.

Neni 719

Shitësi duhet të dorëzojë sendet, të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 720

Blerësi duhet t'i bëjë të ditur shitësit të drejtat apo pretendimin e të tretëve mbi sendin duke specifikuar natyrën e tyre, brenda një afati të arsyeshëm nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të merrte dijeni për to, ndryshe humb të drejtat e parashikuara nga neni i mësipërm.

Shitësi gjithashtu nuk mund të përdorë dispozitat e paragrafit të mësipërm po qe se ishte në dijeni të të drejtave apo të pretendimeve të të tretëve, apo të natyrës së tyre.

Neni 721

Blerësi mund të pezullojë pagimin e çmimit kur ka arsye të druhet se sendi ose një pjesë e tij mund të rivendikohen nga të tretë, përveç kur shitësi jep garancinë përkatëse.

Pagesa nuk mund të pezullohet në qoftë se rreziku njihej nga blerësi në momentin e shitjes.

Neni 722

Në rastin kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën nje mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore, blerësi ka të drejtë të kerkojë:

1. në momentin e denoncimit, të parashikuar në nenin 717 të këtij Kodi ose brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ai denoncim, dorëzimin e sendeve si shtesë apo zëvendësim;
2. eliminimin e të metave me anë të ndreqjes, kur kjo është e arsyeshme të merret parasysh në gjithë rrethanat konkrete. Kërkesa për ndreqjen duhet të bëhet në momentin e denoncimit të parashikuar në nenin 717 apo brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ky denoncim;
3. të kërkojë uljen e çmimit;
4. të deklarojë zgjidhjen e kontratës.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit blerësi nuk mund të përdorë asnjë mjet juridik për mospërmbushjen, përveç kur është njoftuar nga shitësi se ky i fundit nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Në çdo rast blerësi nuk humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 723

Kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën një mospërmbushje të parëndësishme të kontratës, blerësi mund të kërkojë:

1. heqjen ose ndreqjen e të metave të sendeve të dorëzuara, ose
2. uljen e çmimit.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit, blerësi nuk mund të shfrytëzojë asnjë mjet juridik për këtë mospërmbushje, përveç rastit kur është njoftuar nga shitësi se ky nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Kur shitësi nuk plotëson kërkesën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni brenda afatit të caktuar nga blerësi, ky i fundit mund të kërkojë uljen e çmimit të sendeve të sipërme.

Në çdo rast blerësi nuk e humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 724

Përveç zgjidhjes nga ligji të kontratës si rrjedhim i qenies të afatit si kusht thelbësor, kur nuk është bërë dorëzimi i sendit, blerësi mund ta deklarojë të zgjidhur kontratën në qoftë se shitësi nuk i dorëzon sendet brenda afatit shtesë të caktuar nga blerësi ose në qoftë se deklaron se nuk do të bëjë dorëzimin brenda këtij afati.

Neni 725

Në qoftë se shitësi i ka dorëzuar sendet, blerësi e humb të drejtën të shpallë të zgjidhur kontratën kur:

1. në rastin e dorëzimit të vonuar blerësi nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë nga momenti kur ka marrë dijeni se dorëzimi është kryer;

2. në rast mospërmbushje të ndryshme nga dorëzimi i vonuar, brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë:

a) nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të kishte dijeni për mospërmbushje;

b) pas mbarimit të afatit shtesë eventualisht të caktuar prej tij sipas nenit 717 të këtij Kodi.

Neni 726

Në qoftë se shitësi dorëzon vetëm një pjesë të sendeve, apo në qoftë se vetëm një pjesë e sendeve të dorëzuara është në përputhje me kontratën, zbatohen nenet 717, 720 lidhur me pjesën që mungon ose nuk përputhet.

Blerësi mund të shpallë kontratën tërësisht të zgjidhur vetëm në qoftë se dorëzimi i pjesshëm ose jo në përputhje me kushtet e saj, përbën një mospërmbushje të rëndësisë së veçantë ose thelbësore.

Neni 727

Në rastin kur blerësit i është marrë sendi si pasojë e të drejtave që një i tretë ka paraqitur mbi të, shitësi është i detyruar të shpërblejë dëmin sipas nenit 744.

Në rastin kur blerësit i është marrë pjesërisht sendi dhe se në bazë të rrethanave ai nuk do të përfundonte kontratën, zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 728

Blerësi, i paditur nga një i tretë që pretendon se ka të drejta mbi sendin e shitur, duhet ta thërasë shitësin në çështje. Kur nuk e bën këtë dhe në dëm të tij është dhënë një vendim i formës së prerë, humbet të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se shitësi provon se ekzistonin arsye të mjaftueshme për të refuzuar kërkesën.

Blerësi që ka njohur vullnetarisht të drejtën e të tretit, e humb të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se nuk provon se nuk ekzistonin arsye të mjaftueshme për të penguar marrjen e sendit.

Neni 729

Në qoftë se blerësi ka shmangur marrjen e sendit me anën e pagimit të një shume parash, shitësi mund të shkarkohet duke kthyer shumën e paguar, interesat e saj, si dhe të gjitha shpenzimet.

DETYRIMET E BLERËSIT NË SHITJEN E PASURISË SË LUAJTSHME

Neni 730

Detyrimi i blerësit për të paguar çmimin përfshin marrjen e masave dhe respektimin e formaliteteve të kërkuara nga kontrata ose nga dispozita të veçanta për kryerjen e pagimit.

Neni 731

Në rast se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një vend tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë në vendbanimin ose qendrën zyrtare të shitësit ose, kur pagimi duhet të bëhet në kohën e dorëzimit të sendeve ose dokumenteve, në vendin e dorëzimit.

Neni 732

Në qoftë se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një moment tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë kur shitësi vë në dispozicion të tij sendet apo dokumentet që i përfaqësojnë. Në qoflë se kontrata përfshin transportin e sendeve, shitësi mund të kryejë spedicionin me kusht që sendet ose dokumentet, që i përfaqësojnë ata, t'i dorëzohen blerësit para pagimit të çmimit.

Neni 733

Blerësi duhet të paguajë çmimin në datën e caktuar ose të përcaktueshme në bazë të kontratës ose ligjit, pa qenë nevojë e kërkesës së shitësit.

Neni 734

Detyrimi i blerësit për marrjen në dorëzim është kryerja e çdo veprimi që mund të pritet prej tij në mënyrë të arsyeshme, për t'i lejuar shitësit të bëjë dorëzimin dhe blerësi të tërheqë sendet.

Neni 735

Në qoftë se në kontratë parashikohet se blerësi duhet të përcaktojë formën, madhësinë ose karakteristika të tjera të sendeve, dhe në qoftë se ky nuk e bën këtë përcaktim në datën e caktuar ose brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së kërkesës së shitësit, ky mund ta kryejë vetë këtë përcaktim në përputhje me kërkesat e blerësit, për të cilat mund të jetë në dijeni.

Në qoftë se shitësi e bën vetë përcaktimin, duhet të njoftojë blerësin për rregullat e këtij përcaktimi dhe të vendosë një afat të arsyeshëm brenda të cilit blerësi mund të kryejë një përcaktim tjetër. Në qoftë se pasi të ketë marrë këtë njoftim, blerësi nuk e përdor këtë mundësi brenda afatit të vendosur, përcaktimi i bërë nga shitësi është i detyrueshëm.

Neni 736

Shitësi mund t'i caktojë blerësit një afat shtesë të arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve të veta. Me përjashtim të rastit kur shitësi nuk ka marrë njoftim nga blerësi se ky nuk do ta përmbushë detyrimin brenda afatit të caktuar, gjatë kësaj periudhe, shitësi nuk mund të përdorë asnjë mjet ligjor për përmbushjen e detyrimeve. Gjithsesi shitësi nuk humbet të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit për vonesën në përmbushje.

Neni 737

Shitësi mund ta deklarojë kontratën të zgjidhur:

1. në qoftë se mospërmbushja nga ana e blerësit e një detyrimi që rrjedh nga kontrata ose nga ligji përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë ose thelbësore;

2. në qoftë se blerësi nuk përmbush detyrimet e tij për të paguar çmimin ose për të marrë në dorëzim sendet në afatin shtesë të caktuar nga shitësi, ose deklaron se nuk do ta bëjë brenda këtij afati.

Në qoftë se blerësi ka paguar çmimin, shitësi humb të drejtën të shpallë kontratën të zgjidhur po qe se këtë nuk e kërkon:

1. në rastin e përmbushjes së vonuar të detyrimeve të blerësit, para se të marrë dijeni për ekzekutimin e detyrimit;

2. në rastin e një mospërmbushjeje tjetër të ndryshme nga mospërmbushja e vonuar, brenda një kohe të arsyeshme:

a) që nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për një mospërmbushje të tillë;

b) pas mbarimit të afatit shtesë të caktuar prej tij, ose pasi blerësi të ketë deklaruar se nuk do të përmbushë detyrimet e veta brenda këtij afati shtesë.

Neni 738

Përveç marrëveshjeve ose zakoneve tregtare të kundërta, në qoftë se sendet e shitura duhet të transportohen nga një vend në tjetrin, dhe shitësi nuk është i detyruar të bëjë dorëzimin në një vend të caktuar në kontratë, rreziku i kalon blerësit kur sendi i dorëzohet transportuesit të parë për t'ia dërguar blerësit, edhe sikur sendet të jenë të ngarkuara në mënyrë të paambalazhuar.

Në qoftë se shitësi detyrohet t'ia dorëzojë sendet transportuesit në një vend të caktuar në kontratë, rreziku kalon tek blerësi vetëm kur sendet i dorëzohen transportuesit në vendin e përmendur. Fakti që shitësi është i autorizuar të mbajë dokumentet përfaqësuese të sendeve, nuk ndikon në kalimin e rrezikut.

Neni 739

Në qoftë se shitësi ka kryer një mospërmbushje thelbësore të kontratës, dispozitat e nenit të mëparshëm nuk privojnë mjetet juridike që blerësi ka në dorë ndaj mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Dispozita të përbashkëta për detyrimet e shitësit dhe të blerësit

Neni 740

Njëra palë mund të pezullojë përmbushjen e detyrimeve të veta në qoftë se, pas përfundimit të kontratës, del qartë se pala tjetër nuk do të përmbushë pjesën thelbësore të detyrimeve të saj si rrjedhim:

1. të një pamundësie të rëndë në aftësinë e vet për ta përmbushur ose në aftësinë e vet paguese;

2. të mënyrës në të cilën përgatitet për të filluar ose vazhduar zbatimin e kontratës. Në qoftë se shitësi i ka shitur sendet, para se të shfaqeshin kushtet e përmendura në paragrafin e mësipërm, ai mund të kundërshtojë dorëzimin e sendeve blerësit edhe sikur ky të zotërojë një dokument që e legjitimon atë për t'i marrë.

Një kundërshtim i tillë ka efekt ekskluzivisht në marrëdhëniet midis blerësit dhe shitësit.

Pala që pezullon zbatimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe duhet të vazhdojë përmbushjen në qoftë se pala tjetër jep garanci të përshtatshme lidhur me përmbushjen e detyrimeve të saj.

Neni 741

Në rastin e një kontrate shitjeje me dorëzime të pjesshme, kur mospërmbushja nga ana e njërës palë kontraktuese ndaj njërit prej detyrimeve të saj lidhur me një dorëzim, përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë të kontratës që lidhet me këtë dorëzim, pala tjetër mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për sa i takon këtij dorëzimi.

Në qoftë se mospërmbushja nga ana e njërës palë kontraktuese e detyrimeve të veta lidhur me një dorëzim, i jep palës tjetër arsye të bazuara për të gjykuar se do të ndodhë një mospërmbushje thelbësore lidhur me dorëzimet e ardhshme, kjo mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për të ardhmen, mjafton që këtë ta bëjë brenda një kohe të arsyeshme.

Blerësi që e shpall kontratën të zgjidhur për sa i takon një dorëzimi mundet, në të njëjtën kohë, të shpallë zgjidhjen për dorëzimet e bëra më parë ose për dorëzimet e ardhshme në qoftë se për shkak të

ndërvarësisë së tyre këto dorëzime nuk do të mund të përdoreshin për qëllimin e caktuar nga palët në kontratë.

Neni 742

Në rastin e zgjidhjes së kontratës, shitësi duhet të kthejë çmimin dhe t'i paguajë blerësit shpenzimet dhe pagimet e bëra ligjërisht.

Blerësi duhet të kthejë sendin, në qoftë se ky nuk ka humbur ose është shkatërruar si rrjedhim i veseve të tij.

Neni 743

Në qoftë se njëra palë vonon të paguajë çmimin ose çdo shumë tjetër, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë kamatat për këto shuma pa cenuar shpërblimin e dëmit.

Neni 744

Shitësi duhet t'i kthejë blerësit çmimin e paguar, edhe sikur sendit t'i jetë pakësuar vlefta ose të jetë dëmtuar. Në qoftë se ulja e vleftës ose dëmtimi vijnë si pasojë e një veprimi të blerësit, nga shuma e mësipërme duhet zbritur përfitimi që ka nxjerrë blerësi, përveç sa parashikohet në nenin 640.

Neni 745

Në qoftë se kontrata është zgjidhur dhe po qe se, në mënyrë të arsyeshme dhe brenda një afati të arsyeshëm pas zgjidhjes, blerësi ka kryer një blerje për të zëvendësuar ose shitësi i ka rishitur sendet, pala që kërkon dëmshpërblimin mund të marrë diferencën midis çmimit të parashikuar në kontratë dhe çmimit të shitblerjes zëvendësuese, si dhe çdo shpërblim tjetër që mund të kërkohet në bazë të nenit të mësipërm.

Shitja me rezervë e pronës

Neni 746

Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë.

Neni 747

Kalimi i pronësisë sipas dispozitës së mësipërme, mund t'u kundrejtohet kreditorëve të blerësit, kur rrjedh nga një akt i shkruar në datë të saktë përpara masës për sigurimin e kredisë.

Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin.

Neni 748

Mospagimi vetëm i një kësti, që nuk kalon një të tetën e çmimit, nuk sjell zgjidhjen e kontratës, dhe blerësi ruan të drejtën e afatit lidhur me këstet e mëvonëshme, pavarësisht nga ndonjë marrëveshje e kundërt.

Neni 749

Kur zgjidhja e kontratës është rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të blerësit, shitësi duhet të kthejë pagesat e bëra, përpos të drejtës për një shpërblim për përdorimin e sendit, apo shpërblimit të dëmit.

Kur në kontratë është parashikuar që pagesat e bëra t'i mbetë, shitësit me titull dëmshpërblimi, gjykata sipas rrethanave të çështjes mund të pakësojë këtë dëmshpërblim.

Shitja e sendeve të paluajtshme

Neni 750

Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 751

Shitja me kusht e sendeve të paluajtshme regjistrohet në regjistrat e pasurisë së paluajtshme pasi të jetë vërtetuar kushti.

Neni 752

Kur një send i paluajtshëm i caktuar shitet, duke treguar përmasat dhe me një çmim të vendosur mbi bazën e një pagese për çdo njësi matëse, blerësi ka të drejtë për një zbritje të çmimit, në qoftë se madhësia efektive e sendit të paluajtshëm është më e vogël se ajo e treguar në kontratë.

Në qoftë se përmasat e sendit rezultojnë më të mëdha se ato që tregohen në kontratë, blerësi duhet të paguajë shtesën e çmimit, por ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata kur teprica tejkalon një të njëzetën pjesë të madhësisë së deklaruar.

Neni 753

Në rastin kur çmimi përcaktohet në lidhje me vetë sendin e paluajtshëm dhe jo me madhësinë e tij, edhe pse kjo është dhënë, nuk bëhet ulje ose ngritje çmimi, përveç kur madhësia reale është më e vogël ose më e madhe se një e njëzeta pjesë e asaj të treguar në kontratë.

Në rastin kur duhet paguar një çmim shtesë, blerësi mund të zgjedhë ose heqjen dorë nga kontrata ose nga pagimi i shtesës.

Neni 754

Në qoftë se dy ose më shumë sende të paluajtshme janë shitur me të njëjtën kontratë për një çmim të vetëm dhe të njëjtë, duke treguar madhësinë e secilit prej tyre, dhe del se sasia është më e vogël tek njëri dhe më e madhe tek tjetri, bëhet kompensimi deri në sasinë e duhur; e drejta për shtesën ose për pakësimin e çmimeve bëhet në përputhje me dispozitat e caktuara më sipër.

Neni 755

E drejta e shitësit për shtesën dhe e blerësit për pakësimin e çmimit ose për heqjen dorë nga kontrata parashkruhet dy vjet pas dorëzimit të sendit të paluajtshëm.

Neni 756

E drejta e blerësit për të kundërshtuar të metat e sendit të paluajtshëm, parashkruhet me kalimin e pesë vjetëve nga momenti i dorëzimit të sendit.

KREU II
SHKËMBIMI

Neni 757

Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri.

Neni 758

Shkëmbyesi, në rast se ka pësuar marrjen e sendit dhe nuk ka ndërmend ta rimarrë atë, ka të drejtë të marrë vleftën e tij, sipas dispozitave të caktuara për shitjen, si dhe shpërblimin e dëmit.

Neni 759

Shpenzimet e shkëmbimit dhe shpenzime të tjera shtesë janë në ngarkim të të dy palëve në pjesë të barabarta, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 760

Rregullat e caktuara për kontratën e shitjes zbatohen edhe për kontratën e shkëmbimit, për aq sa janë në pajtim me atë.

KREU III
DHURIMI

Neni 761

Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon.

Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi.

Neni 762

Dhurimi nuk mund të përmbajë veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm përsa i takon kësaj.

Neni 763

Dhurimi, që ka për objekt detyrimet periodike, shuhet me vdekjen e dhuruesit, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 764

Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.

Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm. Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimit i është njoftuar dhuruesit.

Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit.

Kontrata quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit.

Përpara se kontrata të jetë lidhur, dhuruesi ose pranuesi i dhurimit mund të revokojnë deklaratën e tyre.

Neni 765

Dhurimi mund të kundërshtohet për lajthitje të shkakut, kur ky lidhet me faktin ose me të drejtën, po qe se shkaku rrjedh nga akti dhe ka shtyrë dhuruesin të bëjë dhurimin.

Neni 766

Dhuruesi për mospërmbushjen ose vonesën në dhurim, është përgjegjës vetëm për qëndrime të kryera me dashje ose me pakujdesi të rëndë.

Neni 767

Dhuruesi mund të vërë si kusht kthimin e sendeve të dhuruara, si për shkak të vdekjes së përparshme të pranuesit të dhurimit, ashtu edhe të vdekjes së përparshme të pasardhësve të tij.

Kthimi mund të ndodhë vetëm në favor të dhuruesit.

Marrëveshja në favor të të tjerëve konsiderohet si e palidhur.

Neni 768

Dhurimi mund të rëndohet me kusht ose me barrë. Dhuruesi është i detyruar të përmbushë barrën brenda kufijve të vleftës së sendit të dhuruar.

Për të përmbushur barrën mund të veprojë, përveç dhuruesit dhe çdokush i interesuar. Zgjidhja e kontratës së dhurimit për mospërmbushje të barrës mund të kërkohet nga dhuruesi ose trashëgimtarët e tij, në qoftë se është parashikuar në aktin e dhurimit.

Barra e paligjshme ose e pamundur quhet e paqenë, ajo gjithsesi e bën të paqenë dhurimin në qoftë se ka përbërë të vetmin shkak përcaktues të kontratës.

Neni 769

Dhuruesi detyrohet t'i japë garanci pranuesit të dhurimit për përkatësinë e sendit të dhuruar dhe zhveshjen që mund të pësojë nga të tjerët për sendet e dhuruara, në këto raste:

1. në qoftë se ka premtuar shprehimisht garancinë;
2. në qoftë se marrja e sendit varet nga mashtrimi e nga qëndrime personale të tij;
3. në qoftë se dhurimi i ngarkon barrë pranuesit të dhurimit ose dhurimi është për shkak shpërblimi, raste në të cilat garancia vihet deri në vleftën e barrës ose të tërësisë së premtimeve të marra nga dhuruesi.

Neni 770

Garancia e dhuruesit nuk shtrihet në të metat e asaj çka është dhuruar, përveç kur dhuruesi ka vepruar me mashtrim, si dhe kur ka marrëveshje të posaçme.

Neni 771

Dhuruesi, për dhurimet që nuk janë të zakonshme ose që nuk janë bërë për shpërblim, mund të kërkojë revokimin e dhurimit kur ai që ka marrë dhurimin:

a) me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët, ose prindërit e tij;

b) pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim kur është i detyruar sipas ligjit.

Padia për revokimin e dhurimit duhet të ngrihet brenda një viti nga dita që dhuruesi ka marrë njoftim për shkaqet që i japin të drejtë që të kërkojë revokimin e dhurimit.

Padia e filluar mund të vazhdohet edhe nga trashëgimtarët e dhuruesit ose mund të ngrihet nga vetë këta, në rast se dhuruesi ka vdekur brenda vitit, nga dita që ka lindur shkaku për të ngritur padinë.

Heqja dorë që më parë nga padia është e pavlefshme.

Revokimi i dhurimit nuk cenon të drejtat që kanë fituar të tretët mbi sendin e dhuruar para se të ngrihet padia.

KREU IV
FURNIZIMI

Neni 772

Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve.

Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti.

Neni 773

Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës.

Në qoftë se palët kanë vendosur vetëm kufirin maksimal dhe minimal për furnizimin ose për shërbimet e veçanta, i takon atij që ka të drejtën e furnizimit të vendosë brenda kufijve të mësipërm për sasinë e duhur.

Në qoftë se sasia e furnizimit duhet të përcaktohet sipas nevojave mbi një sasi minimale të caktuar në kontratë, pala që furnizohet përgjigjet për sasinë përkatëse sipas nevojave në rast se tejkalohet sasia minimale.

Neni 774

Në furnizimin me karakter periodik, në qoftë se çmimi do të përcaktohet sipas nenit 707 të këtij Kodi, merret parasysh koha e mbarimit të furnizimeve të veçanta dhe vendi ku këto duhet të kryhen.

Neni 775

Në furnizimin me karakter periodik, çmimi përkon me dokumentin e furnizimeve të veçanta.

Në furnizimin me karakter të vazhdueshëm çmimi paguhet sipas afateve të zakonshme.

Neni 776

Afati i caktuar në kontratë për furnizime të veçanta prezumohet si i vendosur në dobi të dy palëve.

Në qoftë se palës që furnizohet i është dhënë e drejta të caktojë afatin e furnizimeve të veçanta, ajo duhet t'i njoftojë datën furnizuesit me anë të një paralajmërimi në një kohë të arsyeshme.

Neni 777

Në rast mospërmbushjeje prej njërës nga palët të detyrimeve të veçanta, pala tjetër mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se mospërmbushja ka një rëndësi të veçantë dhe është e tillë sa që dëmton besimin në sigurinë e përmbushjeve të mëpasshme.

Neni 778

Në qoftë se pala që ka të drejtë për t'u furnizuar nuk e ka përmbushur detyrimin dhe mospërmbushja është me pak rëndësi, furnizuesi nuk mund të pezullojë zbatimin e kontratës pa bërë më parë një paralajmërim të arsyeshëm.

Neni 779

Në rast se në kontratë është vendosur kushti i ekskluzivitetit në favor të furnizuesit, pala tjetër nuk mund të përfitojë furnizime të të njëjtit lloj nga të tretët dhe as mund të realizojë, me mjetet e veta, prodhimin e sendeve që formojnë objektin e kontratës, në qoftë se për këtë nuk ka marrëveshje të kundërt ose kur në ligj disponohet ndryshe.

Neni 780

Në qoftë se kushti i ekskluzivitetit është vendosur në dobi të palës që ka të drejtë për t'u furnizuar, furnizuesi nuk mund të bëjë as drejtpërdrejt dhe as tërthorazi furnizime të të njëjtit lloj e që formojnë objektin e kontratës, në zonën për të cilën është dhënë ekskluziviteti dhe brenda afatit të kontratës.

Kushti i ekskluzivitetit, që përmbahet në një kontratë furnizimi, përbën një kusht barrësor që kërkon miratim të posaçëm me shkrim.

Neni 781

Pala që ka të drejtën për t'u furnizuar, kur merr përsipër detyrimin për të shtuar shitjen e sendeve për të cilat ka ekskluzivitet, në zonën që i është caktuar, përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga mospërmbushja e këtij detyrimi, edhe në qoftë se kontratën e ka zbatuar për sasinë minimale që është caktuar.

Neni 782

Në qoftë se kohëzgjatja e furnizimit nuk është vendosur, secila nga palët mund të tërhiqet nga kontrata, duke njoftuar paraprakisht furnizuesin brenda afatit të vendosur prej tyre dhe, në mungesë të tij, brenda një afati të arsyeshëm, duke marrë parasysh edhe natyrën e furnizimit.

Neni 783

Në kontratën e furnizimit zbatohen edhe dispozitat që rregullojnë kontratën për furnizimet e veçanta, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat e mësipërme.

KREU V
ENFITEOZA

Kuptimi i enfiteozës
Neni 784

Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorojë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë.

Neni 785

Kohëzgjatja e enfiteozës caktohet në kontratë.

Neni 786

Kontrata e enfiteozës duhet të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Të drejtat e detyrimet e pronarit dhe të enfiteozëmarrësit
Neni 787

Enfiteozëmarrësi e gëzon sendin sikurse dhe pronari, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në kontratën për krijimin e enfiteozës.

Megjithatë ai nuk mundet që, pa pëlqimin e pronarit, të përdorë sendin në një destinacion tjetër.

Neni 788

Enfiteozëmarrësit i përkasin frytet natyrore të ndara, frytet civile që janë bërë të kërkueshme gjatë enfiteozës dhe të drejtat e përdorimit të nëntokës në kufijtë e parashikuar me ligj, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 789

Kur prona në enfiteozë humbet tërësisht, enfiteoza shuhet dhe enfiteozëmarrësi shkarkohet nga detyrimi përkatës për të ardhmen.

Kur prona humbet ose dëmtohet në pjesë të dukshme e të rëndësishme të saj, aq sa nuk mund të sigurohen të ardhura sa të shlyhet shpërblimi i caktuar në kontratë, mund të kërkohet një ulje e tij ose prishja e kontratës, duke shlyer palët detyrimet reciproke.

Kërkesa duhet të bëhet brenda një viti nga dita që ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës në enfiteozë.

Enfiteozëmarrësi nuk mund të kërkojë shkarkimin nga detyrimi për pagimin e shpërblimit ose uljen e tij, për shkak mosprodhimi ose humbje të fryteve, qoftë edhe për rast fator.

Neni 790

Dhënia e pronës në nënenfiteozë nuk lejohet.

Neni 791

Enfiteozëmarrësi mund të kërkojë në çdo kohë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Enfiteozëdhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, kur enfiteozëmarrësi nuk ka shlyer detyrimin përkatës për dy periudha rresht, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson pronën e nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Neni 792

Tatimet dhe detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pronën janë në ngarkim të enfiteozëmarrësit, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Kur në kontratë këto detyrime janë lënë në ngarkim të pronarit, ato nuk mund të kalojnë shpërblimin e caktuar për enfiteozën.

Neni 793

Në rast tjetërsimi të enfiteozës, enfiteozëmarrësi i ri dhe ai përpara tij, detyrohen solidarisht për shpërblimin e papaguar të enfiteozës, përveç kur enfiteozëmarrësit të mëparshëm i është njoftuar akti i tjetërsimit prej enfiteozëdhënësit.

Në rast tjetërsimi të një të drejte të tillë prej pronarit, fituesi nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve nga enfiteozëmarrësi përpara se atij t'i njoftohet akti i tjetërsimit.

Neni 794

Kur në kontratë nuk parashikohet ndryshe, enfiteozëmarrësi gjatë vazhdimit të enfiteozës ose kur ajo pushon, ka të drejtë t'i heqë ndërtimet, punimet e tjera e mbjelljet e kryera jashtë kushteve të enfiteozës ose që i janë blerë pronarit, por gjithnjë pa dëmtuar pronën e duke kthyer atë në gjendjen e mëparshme.

Neni 795

Kur zgjidhet kontrata, enfiteozëmarrësit i takon vlefta e përmirësimeve të kryera në masën që është rritur vlefta e pronës, kur ajo ekziston në kohën e kthimit të saj.

Neni 796

Enfiteozëmarrësi ka të drejtë të mbajë sendin e dhënë në enfiteozë, deri në shlyerjen e kredive që rrjedhin prej saj. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Pronari ka të drejtë të mbajë sendet që i takojnë enfiteozëmarrësit deri në shlyerjen e detyrimeve ndaj tij.

Neni 797

Kur lind nevoja të bëhen ndreqje të jashtëzakonshme në pronën e dhënë në enfiteozë, enfiteozëmarrësi është i detyruar të njoftojë pronarin dhe t'i japë atij mundësi për t'i kryer ato.

Enfiteozëdhënësi nuk është i detyruar të kryejë ndonjë riparimt ë zakonshëm.

Neni 798

Personat që gëzojnë bashkërisht një të drejtë enfiteotike përgjigjen solidarisht për pagimin e shpërblimit për enfiteozën.

Kur prona e dhënë në enfiteozë ndahet dhe ata gëzojnë pjesë të saj, secili përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga enfiteoza, proporcionalisht me vleftën e pjesës që gëzon.

Neni 799

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe kur enfiteoza gëzohet nga një ose disa persona juridikë, përveç kur ajo ndalohet nga ligji.

Neni 800

Enfiteozëmarrësi mund të fitojë në dobi të pronës servitute aktive dhe ta ngarkojë atë me servitute pasive, për një kohë sa parashikohet në kontratë, gjithnjë duke njoftuar enfiteozëdhënësin me shkresë.

KREU VI
QIRAJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, nëgëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 802

Qiradhënësi duhet:

1. t'i dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh;
2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje;
3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

Neni 803

Qiraja nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se tridhjetë vjet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji. Në qoftë se ajo është lidhur për një periudhë kohe më të gjatë ose pa afat, ka fuqi vetëm për afatin e sipërm.

Për ndërtesat që përdoren për banim, kontrata e qirasë nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet.

Për sende të luajtshme të dhëna për pajisjen e një sendi të paluajtshëm, afati është baraz me kohëzgjatjen e qirasë së këtij të fundit.

Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

Neni 804

Qiramarrësi, që ka ekzekutuar në rregull detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata, ka të drejtën që të preferohet ndaj personave të tjerë në rast se, me mbarimin e kohës së qerasë, do të lidhet kontrata e re.

Të drejta e detyrime të qiradhënësit

Neni 805

Qiradhënësi duhet të kryejë, gjatë periudhës së qirasë, të gjitha riparimet, me përjashtim të punimeve për mirëmbajtjen e përditshme që janë në ngarkim të qiramarrësit.

Për sende të luajtshme, shpenzimet për ruajtjen e për mirëmbajtjen e zakonshme janë në ngarkim të qiramarrësit, përveçse kur me marrëveshje parashikohet ndryshe.

Kur sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime, që nuk janë në ngarkim të qiramarrësit, ky është i detyruar të njoftojë qiradhënësin.

Në rast riparimesh urgjente qiramarrësi mund t'i kryejë ato drejtpërdrejt, kundrejt kthimit të shpenzimeve, me kushte që të njoftojë menjëherë qiramarrësin.

Neni 806

Në qoftë se në kohën e dorëzimit, sendi i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ose zbritjen e çmimit të qerasë, përveç kur ai ka patur dijeni për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme.

Qiradhënësi është i detyruar t'i paguajë qiramarrësit dëmet e ardhura nga veset e sendit, në qoftë se nuk provon se, pa patur faj, nuk ka patur dijeni për këto vese në momentin e dorëzimit.

Në qoftë se veset e sendit vënë para një rreziku të madh shëndetin e qiramarrësit ose të familjes apo të vartësve të tij, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës edhe po qe se veset njiheshin prej tij.

Neni 807

Marrëveshja, me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e qiradhënësit për veset e sendit, nuk ka efekt në qoftë se qiradhënësi ia ka fshehur me keqbesim qiramarrësit ato, ose kur veset janë të tilla që të pengojnë gëzimin e sendit.

Neni 808

Dispozitat e neneve të mësipërme janë të zbatueshme edhe në rastet e veseve të sendit të ndodhura gjatë qirasë.

Neni 809

Në qoftë se gjatë qirasë sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime urgjente, qiramarrësi duhet të lejojë kryerjen e tyre. Në qoftë se sendi nuk riparohet brenda një kohe të arsyeshme, qiramarrësi ka të drejtë për një ulje përpjesëtimore të qirasë.

Neni 810

Qiradhënësi detyrohet të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet që pakësojnë vlerën e përdorimit dhe të gëzimit të sendit, të shkaktuara nga të tretët që pretendojnë se kanë të drejta mbi të njëjtin send.

Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi sendin. Në këtë rast qiramarrësi ruan të drejtën të ngrejë padi kundër të tretëve në emrin e tij.

Neni 811

Në qoftë se të tretët që krijojnë shqetësime pretendojnë se kanë të drejta mbi sendin e dhënë me qira, qiramarrësi është i detyruar ta njoftojë menjëherë qiradhënësin, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Në qoftë se të tretët veprojnë në rrugë gjyqësore, qirradhënësi është i detyruar të marrë pjesë në proces, po qe se thirret.

Të drejta e detyrime të qiramarrësit

Neni 812

Qiramarrësi duhet:

1. të marrë në dorëzim sendin dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë dhe, kur nuk është parashikuar, sipas qëllimit që del nga natyra e sendit;
2. të kryejë pagesën në afatet e caktuara.

Neni 813

Qiramarrësi përgjigjet për humbjen dhe dëmtimin e sendit të cilat ndodhin gjatë kontratës së qirasë.

Neni 814

Qiramarrësi duhet t'ia kthejë qiradhënësit sendin në të njëjtën gjendje që e ka marrë, në përputhje me përshkrimin e bërë nga palët në kontratë, përveç dëmtimit ose konsumimit të zakonshëm nga përdorimi i sendit në përputhje me kontratën.

Në mungesë të përshkrimit në kontratë prezumohet se qiramarrësi e ka marrë sendin në gjëndje të mirë përdorimi.

Qiramarrësi nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar si pasojë e vjetërsisë.

Sendet e luajtshme duhet të kthehen në vendin ku janë marrë në dorëzim.

Neni 815

Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t'i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës.

Neni 816

Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, qiramarrësi nuk ka të drejtë të shpërblehet për përmirësimet e bëra sendit të marrë me qira. Por në qoftë se ka patur pëlqimin e qiradhënësit, ky është i detyruar t'i paguajë një kompensim që i korrespondon shumës më të vogël midis shumës së shpenzimeve dhe vleftës së rezultatit të dobishëm në kohën e dorëzimit. Kur qiramarrësi nuk ka të drejtë kompensimi, vlefta e përmirësimeve mund të kompensojë dëmtimet që kanë ndodhur për pakujdesinë e rëndë të qiramarrësit.

Neni 817

Qiramarrësi që ka bërë shtesa në sendin e marrë me qira, ka të drejtë t'i heqë ato në mbarim të qirasë, kur kjo mund të kryhet pa dëmtuar sendin, përveç kur pronari pranon t'i mbajë vetë shtesat. Në këtë rast ky duhet t'i paguajë qiramarrësit një kompensim të barabartë me shumën më të vogël midis shpenzimeve dhe vleftës të shtesave në kohën e ridorëzimit.

Në qoftë se shtesat nuk mund të ndahen pa dëmtuar sendin dhe përbëjnë një përmirësim të tij, zbatohen rregullat e parashikuara nga neni 810.

Neni 818

Qiramarrësi, veç marrëveshjes së kundërt, ka të drejtë të japë me nënqira sendin që ka marrë me qira, por nuk mund t'ia kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit.

Për sende të luajtshme dhënia me nënqira bëhet me pëlqimin e qiradhënësit.

Neni 819

Qiradhënësi, pa cenuar të drejtat e tij ndaj qiramarrësit, mund të ngrejë padi kundër nënqiramarrësit për të kërkuar çmimin e nënqirasë për të cilën ky i fundit është ende debitor në momentin e ngritjes së padisë dhe për ta detyruar atë të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e nënqirasë.

Shpallja e pavlefshme e kontratës së qirasë ose zgjidhja e saj ka efekt edhe ndaj nënqiramarrësit, dhe vendimi i marrë midis qiradhënësit dhe qiramarrësit ka efekt edhe ndaj tij.

Mbarimi i kontratës së qirasë

Neni 820

Qiraja me afat të caktuar nga palët, pushon me mbarimin e afatit, pa qënë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.

Qiraja në të cilën nuk caktohet afat nuk pushon, në qoftë se përpara afatit të vendosur sipas nenit 803 të këtij Kodi njëra nga palët njofton palën tjetër se heq dorë nga qiraja.

Përsëritja e kontratës së qirasë

Neni 821

Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit.

Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.

Marrëdhëniet me të tretët

Neni 822

Kontrata e qirasë mund t'i kundrejtohet të tretit që ka fituar sendin e dhënë me qira, me kusht që kontrata të ketë një datë të saktë para tjetërsimit të sendit.

Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen për qiranë e sendeve të luajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, në qoftë se fituesi ka siguruar posedimin me mirëbesim.

Qiraja e sendeve të paluajtshme të paregjistruara nuk i kundrejtohet fituesit të tretë, veç brenda afatit të 9 vjetëve nga fillimi qirasë.

Fituesi duhet të respektojë qiranë në çdo rast në qoftë se ka marrë përsipër detyrimin ndaj tjetërsuesit.

Neni 823

Në qoftë se qiraja nuk ka datë të saktë, por mbajtja e saj prej qiramarrësit si datë është përpara kalimit të pronësisë, fituesi nuk është i detyruar të respektojë qiranë, veçse për kohëzgjatjen që përkon me atë të vendosur për qiratë me afat të pacaktuar.

Neni 824

Në qoftë se qiramarrësi është përjashtuar nga fituesi, sepse kontrata e qirasë nuk kishte një datë të saktë përpara kalimit të pronësisë, qiradhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 825

Fituesi është i detyruar të respektojë kontratën e qirasë qysh nga dita e fitimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qirasë.

A. QIRAJA PËR PASURITË E PALUAJTSHME ME NATYRË BUJQËSORE
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 826

Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Neni 827

Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. E drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu.

Neni 828

Qiradhënësi përballon detyrimet dhe taksat financiare që rëndojnë mbi pasurinë e paluajtshme.

Neni 829

Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.

Neni 830

Qiramarrësi shlyen çmimin e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë. Çmimi i qirasë mund të jetë në natyrë dhe në të holla.

E drejta e kultivimit

Neni 831

E drejta e kultivimit nënkupton të drejtën e njërës nga palët kontraktuese që të vendosë se çfarë do të kultivohet nga një periudhë në tjetrën. Kjo e drejtë rregullohet me marrëveshje të palëve.

Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose kryesisht me prodhime bujqësore nga produktet që kultivohen në pasurinë e paluajtshme të dhënë me qira, e drejta e kultivimit i takon qiradhënësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonit të vendit, nuk parashikohet ndryshe.

Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose pjesërisht nga një shumë parash që i jepet qiradhënësit, e drejta e kultivimit i takon qiramarrësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonit të vendit, nuk parashikohet ndryshe.

Neni 832

Pala që ka të drejtën e kultivimit, kur nuk i njofton palës tjetër planin e kultivimit në kohën e duhur dhe kur pritja e mëtejshme e këtij njoftimi mund të sjellë pasoja serioze në kultivimin bujqësor, kjo e drejtë i kalon palës tjetër.

Koha dhe shpenzimet e kultivimit

Neni 833

Qiramarrësi vendos me përgjegjësinë e tij për kohën kur do të kryejë veprimet e kultivimit dhe për mënyrat dhe të rejat agroteknike që do të zbatojë. Qiramarrësi në këtë drejtim mund të bëjë vetëm rekomandime.

Neni 834

Shpenzimet që nevojiten për kultivimin përballohen nga qiramarrësi. Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht apo kryesisht nga produkti që kultivohet, qiradhënësi i parapaguan pa kamatë qiramarrësit ato shpenzime që mund të kërkohen për kultivimin, në rast se ky i fundit nuk mundet t'i përballojë vetë.

Parapagimi i dhënë i kthehet qiradhënësit nga prodhimi i të korrave të ardhshme

Shlyerja e çmimit të qirasë

Neni 835

Çmimi i qirasë shlyhet sipas afateve të caktuara në kontratë. Në mungesë të një caktimi të tillë, shlyhet në fund të çdo viti të kontratës, kur çmimi është caktuar në para.

Viti i kontratës së qirasë fillon ditën kur qiramarrësit i dorëzohet pasuria e marrë me qira.

Neni 836

Kur çmimi i qirasë përbëhet nga një pjesë e prodhimit bujqësor ose në raport me atë, qiradhënësit i dorëzohet pjesa që i takon sipas kërkesës së tij, pasi të jenë mbledhur të korrat.

Në mungesë të marrëveshjes respektohet zakoni i vendit.

Neni 837

Qiramarrësi mund të kërkojë uljen e çmimit të qirasë ose shtyrjen e pagimit të saj, kur rrethana të paparashikuara ose ngjarje të jashtëzakonshme e kanë ulur prodhimtarinë e një viti në të paktën gjysmën në krahasim me prodhimtarinë normale.

Neni 838

Qiramarrësi mund të kërkojë që të rishikohet çmimi i qirasë në favorin e tij, duke patur parasysh prodhimtarinë e zakonshme, rëndësinë e humbjes së pësuar, fitimet që ka patur ai vitet e mëparshme dhe ato që mund të sigurojë gjatë kohës që kontrata është në fuqi.

Neni 839

Në rast zgjidhje të kontratës, qiramarrësi nuk është i detyruar të lërë farërat për të mbjellat e ardhshme, përveç kur në kontratë ose nga zakoni i vendit parashikohet ndryshe.

Neni 840

Qiramarrësi nuk gëzon të drejtën e marrjes së frutave, të cilat në kohën e përfundimit të kontratës, ende nuk ishin vjelë. Por gjykata mund të pranojë që qiramarrësit t'i paguhen shpenzimet që mund të ketë bërë për kultivimin e frutave. Gjithësesi ky shpërblim nuk mund të kalojë vlerën e frutave që përfiton qiramarrësi.

B. QIRAJA E SENDEVE PRODHUESE

Neni 841

Kur qiraja ka për objekt gëzimin e një sendi prodhues, të luajtshëm ose të paluajtshëm, qiramarrësi duhet të përkujdeset për administrimin e tij në përputhje me destinimin ekonomik të sendit.

Neni 842

Në qoftë se palët nuk e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qirasë, secila prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata duke e njoftuar tjetrën qysh më përpara në një kohë të përshtatshme.

Neni 843

Qiradhënësi duhet:

1. të dorëzojë sendin me aksesorët e vet në gjendje të përshtatshme për përdorimin dhe prodhimin për të cilin është destinuar;
2. të kryejë me shpenzimet e veta riparimet e jashtëzakonshme për të cilat sendi ka nevojë gjatë kohës së qirasë.

Neni 844

Qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se qiramarrësi nuk vë në shërbim të sendit mjetet e nevojshme për administrimin e tij, në qoftë se nuk zbaton rregullat teknike dhe në qoftë se ndryshon në mënyrë të qëndrueshme destinimin ekonomik të sendit.

Neni 845

Qiramarrësi mund të ndërmarrë nisma për rritjen e prodhimtarisë së sendit të marrë me qira, mjafton që ato të mos sjellin detyrime për qiradhënësin, ose të mos i shkaktojnë cenime të të drejtave të tij.

Neni 846

Në qoftë se si pasojë e një ligji ose e një vendimi të detyrueshëm për administrimin prodhues të sendit, raporti kontraktor rezulton i ndryshuar dukshëm, në mënyrë të tillë që njëra palë të humbasë dhe tjetra të fitojë, mund të kërkohet një shtesë apo një zbritje e çmimit të qirasë, ose sipas rrethanave, zgjidhja e kontratës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 847

Qiramarrësi nuk mund ta lëshojë sendin me nënqira pa lejen e qiradhënësit.

Kur qiramarrësi shkel një detyrim të tillë, qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

E drejta për të kaluar kontratën e qirasë një tjetri përfshin dhe nënqiranë, përveç kur palët kanë disponuar ndryshe në kontratë.

Neni 848

Dispozitat e kontratës së qirasë zbatohen edhe për qiranë e sendeve prodhuese, në masën që pajtohen me to.

C. QIRAJA FINANCIARE (LEASING)

Neni 849

Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve.

Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshkrimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar.

Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit, si dhe për të metat e sendit.

Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.

KREU VII
SIPËRMARRJA

Përmbajtja
Neni 850

Sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.

Caktimi i çmimit
Neni 851

Kur palët nuk e kanë caktuar çmimin e sipërmarrjes dhe as nuk kanë vendosur mënyrën për ta përcaktuar atë, ai llogaritet në bazë të tarifave ekzistuese ose në bazë të zakonit të vendit. Në rast mosmarrëveshjeje, caktohet nga gjykata.

Sigurimi i materialeve
Neni 852

Materialet e nevojshme për kryerjen e veprës duhet të sigurohen nga sipërmarrësi, në qoftë se marrëveshja nuk parashikon ndryshe.

Të drejta e detyrime të sipërmarrësit
Neni 853

Sipërmarrësi duhet të paralajmërojë në kohën e duhur porositësin:

a) kur materiali i dhënë nga porositësi për veprën është me cilësi jo të mirë, kur kjo zbulohet gjatë punimeve dhe dëmton cilësinë e veprës;

b) kur udhëzimet e porositësit nuk mund të zbatohen ose kur zbatimi i tyre bën që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme;

c) kur ka rrethana, që nuk varen nga sipërmarrësi, të cilat ndikojnë që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme.

Sipërmarrësi përgjigjet për dëmin që pëson porositësi, po qe se nuk e paralajmëron atë përsa më sipër.

Neni 854

Sipërmarrësi ka të drejtë që të heqë dorë nga zbatimi i kontratës dhe të kërkojë që të shpërblehet për dëmin që ka pësuar kur porositësi nuk zëvendëson materialin me cilësi jo të mirë ose të papërshtatshëm, ose kur nuk ndryshon udhëzimet për kryerjen e veprës, megjithëse është paralajmëruar në kohën e duhur prej tij.

Neni 855

Sipërmarrësi përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e materialit që i është dhënë nga porositësi, përveç kur provohet se humbja ose dëmtimi i tij ka ndodhur për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 856

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë t'i paguhet puna e kryer prej tij, kur vepra, para se t'i dorëzohet porositësit, humbet ose dëmtohet për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 857

Sipërmarrësi nuk mund të japë me nënsipërmarrje kryerjen e veprës ose kryerjen e shërbimeve, pa u marrë pëlqimi nga porositësi.

Neni 858

Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë mënyrat e caktuara në kontratë për kryerjen e veprës, pa pëlqimin me shkrim të porositësit.

Edhe kur është dhënë pëlqimi, sipërmarrësi, po qe se çmimi i plotë i veprës është caktuar në total, nuk ka të drejtë të kompensohet për ndryshimet ose për shtesat, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 859

Në qoftë se për kryerjen e veprës sipas standardeve është e nevojshme që projekti të ndryshohet dhe për këtë gjë palët nuk merren vesh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Në qoftë se ndryshimet në çmimet tejkalojnë një të gjashtën e madhësisë së çmimit të caktuar, sipërmarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe sipas rrethanave, një shpërblim të përshtatshëm të dëmeve.

Në qoftë se ndryshimet janë të konsiderueshme, porositësi mund të tërhiqet nga kontrata duke paguar një dëmshpërblim të përshtatshëm.

Të drejta e detyrime të porositësit

Neni 860

Porositësi mund të bëje ndryshime në projekt, me kusht që madhësia e tyre të mos kalojë një të gjashtën e çmimit të përgjithshëm të caktuar. Sipërmarrësi ka të drejtë të kompensohet për punimet kryesore të kryera, edhe pse çmimi i veprës është caktuar në total.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për ndryshimet në projekt që, megjithëse u përmbahen caqeve të lartpërmendura, sjellin ndryshime të konsiderueshme në natyrën e veprës ose në anën sasiore të kategorive të veçanta të punimeve të parashikuara në kontratë për kryerjen e së njëjtës vepër.

Neni 861

Porositësi ka të drejtë të kontrollojë kryerjen e punimeve dhe gjendjen e tyre me shpenzimet e veta.

Kur, gjatë punimeve, zbulohet se kryerja e tyre nuk vazhdon sipas kushteve të caktuara në kontratë dhe sipas standardeve, porositësi mund të caktojë një afat të arsyeshëm brenda të cilit sipërmarrësi duhet të pajtohet me ato kushte. Kur afati i caktuar ka kaluar pa sjellë ndonjë dobi, kontrata zgjidhet, pa cenuar të drejtën e porositësit për shpërblimin e dëmeve.

Neni 862

Në qoftë se si rrjedhim i rrethanave të paparashikuara, kanë ndodhur rritje ose ulje të kostos së materialeve ose të krahut të punës, që përcaktojnë një rritje ose një zbritje në një masë më të madhe se një e dhjeta e çmimit të përgjithshëm të caktuar, sipërmarrësi ose porositësi mund të kërkojnë rishikimin e çmimit. Ky rishikim mund të caktohet vetëm për masën e diferencës që tejkalon një të dhjetën. Kur gjatë punimeve hasen vështirësi të karakterit gjeologjik, hidrik dhe të tjera të ngjashme me to, të paparashikuara nga palët, të cilat e bëjnë mjaft më të vështirë detyrën e sipërmarrësit, ky ka të drejtë për një kompensim të përshtatshëm.

Neni 863

Porositësi, përpara se të marrë në dorëzim veprën e mbaruar, ka të drejtë ta kontrollojë atë.

Kontrolli duhet të kryhet nga porositësi, sapo sipërmarrësi të krijojë kushtet e duhura për kontrollin. Në qoftë se, megjithë ftesën e bërë prej sipërmarrësit, porositësi nuk e kryen kontrollin pa patur arsye të bazuara, ose kur nuk njofton rezultatin e kontrollit brenda një afati të shkurtër, vepra konsiderohet e pranuar.

Në qoftë se porositësi merr në dorëzim veprën pa paraqitur ndonjë rezervë, ajo konsiderohet e pranuar edhe pse nuk është kryer kontrolli.

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë të paguhet me vleftën e caktuar kur vepra pranohet nga porositësi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Garancia dhe denoncimi i të metave të veprës

Neni 864

Sipërmarrësi detyrohet të japë garanci për deformimet dhe veset e veprës. Garancia nuk kërkohet kur porositësi e ka pranuar veprën dhe deformimet ose veset njiheshin prej tij ose ishin të dallueshme, përveç kur ato janë fshehur me keqbesim nga sipërmarrësi.

Porositësi duhet t'i njoftojë sipërmarrësit deformimet ose veset brenda 60 ditëve nga zbulimi i tyre me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte. Njoftimi nuk është i domosdoshëm kur sipërmarrësi i ka njohur e pranuar deformimet dhe veset ose kur i ka fshehur ato.

Padia kundër sipërmarrësit parashkruhet brenda dy vjetëve nga data e dorëzimit të veprës. Porositësi i paditur për pagim mund të zbatojë gjithmonë garancinë, me kusht që deformimet dhe veset të njoftohen brenda 60 ditëve nga data e zbulimit dhe para se të kenë kaluar dy vjet nga data e dorëzimit.

Neni 865

Porositësi mund të kërkojë që deformimet ose veset të eliminohen me shpenzimet e sipërmarrësit, ose që çmimi të zbritet përpjesëtimisht, duke ruajtur të drejtën e shpërblimit të dëmit në rast se sipërmarrësi ka faj.

Por, në qoftë se deformimi ose cenet e veprës janë të tilla sa e bëjnë atë krejt të papërshtatshme për destinimin e saj, porositësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 866

Kur sipërmarrja ka për objekt ndërtesa ose sende të tjera të paluajtshme të cilat, për nga natyra e tyre, kanë destinim afatgjatë, po qe se, gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh nga përfundimi, vepra, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, shëmbet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shëmbjeje ose defekte të tjera të rënda, sipërmarrësi përgjegjet kundrejt porositësit dhe palëve që fitojnë të drejta prej tij, me kusht që denoncimi i tyre të bëhet brenda një viti nga zbulimi.

E drejta e porositësit parashkruhet brenda një viti nga kallëzimi.

Neni 867

Sipërmarrësi, për të ushtruar të drejtën e padisë së kthimit kundrejt nënsipërmarrësve, duhet që t'i njoftojë ata për denoncimin brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja dijeni me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte.

Zgjidhja e kontratës dhe pasojat juridike

Neni 868

Porositësi mund të tërhiqet nga kontrata, edhe kur ka filluar zbatimi i veprës ose kryerja e shërbimit, me kusht që ta kompensojë sipërmarrësin për shpenzimet e kryera, për punimet e bëra dhe për fitimin e munguar.

Neni 869

Kur kontrata zgjidhet sepse zbatimi i veprës është bërë i pamundur si pasojë i një shkaku që nuk mund t'i atribuohet asnjërës palë, porositësi paguan pjesën e veprës së kryer në kufijtë brenda të cilëve është e dobishme për të, në përpjesëtim me çmimin e caktuar për të gjithë veprën.

Neni 870

Kur materiali që i është dhënë sipërmarrësit nga porositësi, ose kur vepra e përgatitur me këtë material humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i veprës bëhet i pamundshëm pa fajin e asnjërit prej tyre, por në çdo rast pasi sipërmarrësi të jetë në vonesë për dorëzimin e veprës, ky është i detyruar t'i shpërblejë porositësit vleftën e materialit dhe nuk ka të drejtë të kërkojë prej tij që t'i paguajë punën e kryer.

Neni 871

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm para se të ketë mbaruar afati për dorëzimin e veprës, por në çdo rast pa fajin e asnjërit prej tyre, sipërmarrësi nuk ka të drejtë t'i kërkojë porositësit që t'i paguajë vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 872

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm pa fajin e sipërmarrësit ose të porositësit, por pasi porositësi është në vonesë për marrjen e veprës në dorëzim, ky detyrohet t'i paguajë sipërmarrësit vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 873

Kontrata e sipërmarrjes nuk zgjidhet me vdekjen e sipërmarrësit, përveç kur personi i sipërmarrësit konsiderohej i domosdoshëm për kryerjen e veprës. Porositësi mundet gjithmonë të tërhiqet nga kontrata, po qe se trashëgimtarëve të sipërmarrësit, nuk mund t'u besohet për kryerjen e mirë të veprës ose të shërbimit.

Neni 874

Në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkak të vdekjes së sipërmarrësit, porositësi detyrohet t'u paguajë trashëgimtarëve vleftën e veprës së kryer, duke u mbështetur në çmimin e caktuar, si dhe shpenzimet e kryera për ekzekutimin e pjesës së mbetur, por vetëm brenda kufijve në të cilët vepra e kryer dhe shpenzimet e bëra janë të dobishme për të. Porositësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin, kundrejt një kompensimi të përshtatshëm, të vleftës së materialeve të përgatitura dhe planeve në zbatim e sipër, për aq sa lejojnë normat për mbrojtjen e shpikjeve dhe të pronësisë intelektuale.

Neni 875

Personat të cilët, duke qënë në varësi të sipërmarrësit, kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për zbatimin e veprës ose kryerjen e shërbimit, mund të ngrejnë padi drejtpërdrejt kundër porositësit për të marrë atë çka u takon deri në plotësimin e detyrës që porositësi ka ndaj sipërmarrësit në kohën kur ata ngrejnë padinë.

Dispozitë referuese

Neni 876

Kur sipërmarrja ka për objekt kryerje shërbimesh të vazhdueshme ose periodike, zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, normat e këtij titulli dhe ato lidhur me kontratën e furnizimit.

KREU VIII
TRANSPORTI

A. TRANSPORTI I PERSONAVE

Neni 877

Me kontratën e transportit të personave, transportuesi merr përsipër të transportojë persona nga njëri vend në një vend tjetër.

Neni 878

Përveç përgjegjësisë për vonesën dhe për mospërmbushjen në kryerjen e transportit, transportuesi përgjigjet për fatkeqesitë që godasin personin udhëtar gjatë udhëtimit dhe për humbjen ose për dëmtimin e sendeve që udhëtari merr me vete, në qoftë se nuk provon se ka marrë të gjitha masat e përshtatshme për shmangien e dëmit, dhe në lidhje me rethanat e posaçme të rastit.

Janë të pavlefshme kushtet që kufizojnë përgjegjësinë e transportuesit për rreziqet që godasin udhëtarin.

Kjo dispozitë zbatohet edhe në kontratat e transportit falas.

Neni 879

Në transportin me itinerare që lidhen njëri me tjetrin, çdo transportues përgjigjet për udhëtimin e vet.

Megjithatë, dëmi për vonesën ose për ndërprerjen e udhëtimit llogaritet duke pasur parasysh të gjithë rrugën.

B. TRANSPORTI I SENDEVE

Neni 880

Me kontratën e transportit të sendeve, transportuesi merr përsipër të transportojë sende nga një vend në një vend tjetër.

Neni 881

Transportuesi duhet t'i vërë sendet e transportuara në dispozicion të marrësit në vendin, në afatin dhe nëpërmjet mënyrave të treguara në kontratë.

Në qoftë se dorëzimi nuk duhet të kryhet pranë marrësit, transportuesi duhet ta njoftojë atë menjëherë për mbërritjen e sendeve të transportuara.

Në qoftë se nga dërguesi është lëshuar një fletë shoqërimi, transportuesi duhet t'ia tregojë atë marrësit.

Neni 882

Dërguesi duhet t'i tregojë transportuesit me saktësi emrin e marrësit dhe vendin e destinimit, llojin, peshën, sasinë dhe numrin e sendeve për t'u transportuar dhe të dhëna të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit.

Në qoftë se për kryerjen e transportit nevojiten dokumente të posaçme, dërguesi duhet t'ia japë ato transportuesit në momentin kur dorëzon sendet per t'u transportuar.

Janë në ngarkim të dërguesit dëmet që rrjedhin nga mungesa ose pasaktësia e të dhënave ose nga mosdorëzimi apo parregullsia e dokumenteve.

Neni 883

Me kërkesën e transportuesit, dorëzuesi lëshon një fletë shoqërimi me nënshkrimin e vet, e cila përmban emrin e vet, vendqëndrimin ose qendrën e punës, vendin dhe datën e lëshimit, të dhënat e paraqitura në nenin e mësipërm dhe kushtet e caktuara për transportin.

Kur fletëshoqërimi jepet në disa kopje, numri i kopjeve duhet të tregohet në çdo ekzemplar. Kopjet e mbetura humbasin vlerën pasi sendet i dorëzohen mbajtësit të titullit.

Këto të dhëna janë të besueshme, derisa të mos jetë provuar e kundërta kundrejt transportuesit, i cili ka për detyrë t'i verifikojë ato, duke zbatuar përkujdesjen profesionale.

Me kërkesën e dërguesit, transportuesi lëshon një dublikatë të fletës të shoqërimit me nënshkrimin e vet ose, në qoftë se nuk i është lëshuar fleta e shoqërimit, një fletë marrje në dorëzim, që të përmbajë të njëjtat të dhëna.

Neni 884

Kontrata e transportit quhet e lidhur nga çasti që është bërë dokumenti i transportimit dhe dërguesi i mallrave ka bërë pagesën e transportimit, përveç kur në kontratë ose në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 885

Në qoftë se fillimi ose vazhdimi i transportit pengohen ose vonohen së tepërmi për shkaqe që nuk mund t'i ngarkohen transportuesit, ky menjëherë duhet t'i kërkojë udhëzime dërguesit, duke marrë masa për ruajtjen e sendeve që i janë dorëzuar atij.

Transportuesi ruan të drejtën e ripagimit të shpenzimeve.

Në qofte se transporti ka filluar, ai ka të drejta edhe për pagimin e çmimit në përpjestim me rrugën që ka kryer, përveç rastit kur ndërprerja e transportit ka ndodhur për shkak të humbjes së plotë të sendeve si pasojë e rastit fator.

Po qe se rrethanat e bëjnë të pamundur marrjen e udhëzimeve nga dërguesi, ose në qoftë se udhëzimet nuk janë të zbatueshme, transportuesi mund t'i depozitojë sendet ose, po qe se rrezikohen të dëmtohen, ose përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e vendeve ku janë ruajtur, ai mund të marrë masa për shitjen e tyre me çmimin më të mirë.

Transportuesi duhet të njoftojë menjëherë dërguesin për depozitimin ose shitjen.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe në rastin kur pritësi nuk gjendet ose refuzon apo vonon të kërkojë marrjen në dorëzim të sendeve, edhe në rastin kur lind mosmarrëveshje midis disa marrësve ose për të drejtën e marrësit për marrjen në dorëzim apo për ekzekutimin e saj.

Neni 886

Dërguesi mund të pezullojë transportimin dhe të kërkojë kthimin e sendeve, ose të urdhërojë dorëzimin tek një marrës tjetër i ndryshëm nga ai i treguar në fillim ose mund të vendosë ndryshe, gjithmonë duke ruajtur detyrimin për të riparuar shpenzimet dhe për të shpërblyer dëmet që rrjedhin nga urdhri i dytë.

Kur nga ana e transportuesit i është lëshuar dërguesit një dublikatë e fletës së shoqërimit ose e fletë ngarkesës, dorëzuesi nuk mund të disponojë sendet e dorëzuara për transport po qe se nuk i paraqet transportuesit dublikatën ose faturën për të treguar të dhënat e reja. Këto duhet të nënshkruhen edhe nga transportuesi.

Dërguesi nuk mund të disponojë sende të transportuara qysh prej momentit kur ato kanë kaluar në dispozicion të pritësit.

Neni 887

Të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit ndaj transportuesit i kalojnë pritësit nga momenti kur, pasi sendet kanë mbërritur në destinacion ose ka skaduar afati në të cilin duhet të kishin mbërritur. Pritësi kërkon marrjen në dorëzim nga transportuesi, pritësi nuk mund të ushtrojë të drejtat që lindin nga kontrata, përveç se duke i paguar transportuesit kreditë që rrjedhin nga transporti dhe faturat që shoqërojnë sendet e transportuara. Kur ka mosmarrëveshje për shumën e detyruar, marrësi duhet të depozitojë diferencën e vënë në dyshim pranë një të treti.

Neni 888

Transportuesi që i dorëzon pritësit sendet pa mbledhur kreditë e veta ose faturat që shoqërojnë sendet e transportuara, ose pa kërkuar depozitimin e shumës së diskutueshme, është përgjegjës ndaj dërguesit për vleftën që i detyrohet atij dhe nuk mund t'i kërkojë këtij të fundit pagimin e kredive të veta. Megjithatë e drejta për të paditur pritësin nuk cenohet.

Përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin e sendeve gjatë transportimit

Neni 889

Transportuesi është përgjegjës për humbjen dhe dëmtimin e sendeve të dorëzuara atij qysh nga momenti kur i merr, deri në momentin kur ia dorëzon pritësit, po qe se nuk provon që humbja ose dëmtimi janë pasojë e rastit fator, e veprimit të dërguesit, të pritësit ose të pronarit të sendeve të dërguara, nga firot ose nga lloji e nga veset e vetë sendeve.

Në qoftë se transportuesi i pranon sendet për transportim pa rezervë, prezumohet se sendet nuk paraqesin të meta të dukshme ambalazhi.

Transportuesi, me kërkesën e pritësit, detyrohet të mbajë procesverbal për humbjen ose dëmtimin e sendeve të dorëzuara për transportim.

Neni 890

Transportuesi duhet të njoftojë pritësin pa vonesë dhe përpara dorëzimit të sendeve, për dëmet që sendet mund të kenë pësuar.

Neni 891

Në qoftë se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar, dëmi llogaritet, përveç marrëveshjes së kundërt, sipas çmimit të tyre në kohën e ngarkimit nga ana e transportuesit. Po qe se sendet dëmtohen, transportuesi duhet të shpërblejë dëmin në masën e diferencës midis vleftës së sendeve në momentin e ngarkimit dhe vleftës në momentin e dorëzimit.

Neni 892

Pritësi ka të drejtë të sigurohet, me shpenzimet e veta, përpara marrjes në dorëzim, për identitetin dhe gjendjen e sendeve të transportuara.

Neni 893

Marrja në dorëzim pa rezervë e sendeve të transportuara duke paguar transportuesin për aq sa i takon, heq mundësinë për ngritje të padisë që rrjedh nga kontrata, përveç rastit të mashtrimit ose të pakujdesisë së rëndë të transportuesit. Nuk cenohen të drejtat për të kërkuar humbjen e pjesshme ose për dëmtime të tilla që nuk mund të dallohen në momentin e marrjes në dorëzim, me kusht që transportuesi të njoftohet menjëherë sa të zbulohet dëmi dhe jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes në dorëzim.

Neni 894

Kur transportuesi detyrohet t'i përcjellë sendet e transportuara përtej linjave të tij, nëpërmjet transportuesish të tjerë, pa marrë nga dorëzuesi një fletë shoqërimi të drejtpërdrejtë për në vendin e destinimit, prezumohet që ai merr, për transportin përtej linjave të veta, detyrimet e një spedicioneri.

Transportimi i kryer nga disa transportues
Neni 895

Në transportin e sendeve që kryhet bashkërisht nga disa transportues të njëpasnjëshëm me një kontratë të vetme, transportuesit përgjigjen solidarisht për përmbushjen e kontratës nga vendi fillestar i nisjes deri në vendin e destinimit.

Transportuesi që paditet për një veprim për të cilin nuk ka përgjegjësi, ka të drejtën e padisë kundrejt transportuesve të tjerë, qoftë veç e veç, qoftë bashkërisht. Po qe se del se veprimi që ka sjellë dëmtimin ka ndodhur në rrugën e njërit prej transportuesve, ky detyrohet të bëjë shpërblimin e plotë të dëmit; në rast të kundërt, detyrohen të shpërblejnë transportuesit përpjestimisht me rrugët e tyre, duke përjashtuar ata transportues që provojnë se dëmi nuk ka ndodhur në rrugën e vet.

Neni 896

Transportuesit e njëpasnjëshëm kanë të drejtë të deklarojnë, në fletëshoqërimin ose në një akt të veçantë, gjendjen e sendeve për t'u transportuar në momentin kur u janë dorëzuar atyre. Në mungesë të deklaratës, prezumohet se i kanë marrë në gjendje të mirë dhe në përputhje me fletë shoqërimin.

Përgjegjësia e dërguesit dhe e transportuesit për vonesën
Neni 897

Kur dorëzimi i sendeve për transportim ose dorëzimi i sendeve pritësit nuk bëhet në afatet e caktuara në kontratë, pala që është në vonesë shpërblen dëmin përkatës.

Neni 898

Kreditë që rrjedhin nga transporti kanë prvilegj mbi sendet e transportuara deri sa këto të mbeten pranë transportuesit. Transportuesi mund të mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit deri sa të shpërblehet kredia e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Përgjegjësia e transportuesit të fundit
Neni 899

Transportuesi i fundit përfaqëson transportuesit e mëparshëm për mbledhjen e kredive përkatëse që lindin nga kontrata e transportit dhe për ushtrimin e privilegjit mbi sendet e transportuara. Në qoftë se ai nuk i mbledh kreditë ose nuk ushtron privilegjin, përgjigjet para kreditorëve paraardhës për shumat e detyruara, përveç të drejtës së padisë kundrejt pritësit.

Dispozitë referuese
Neni 900

Për transportimet me rrugë ujore, ajrore dhe për ato hekurudhore e postare, kur mungon legjislacioni i posaçëm, zbatohen dispozitat e kësaj kontrate.

KREU IX
HUAPËRDORJA

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë

send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Neni 903

Huamarrësi detyrohet ta mbajë dhe ta ruajë sendin me përkujdesje. Ai nuk mund ta përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në kontratë ose nga natyra e sendit. Huamarrësi nuk mund t'ia japë një të treti sendin për përdorim pa pëlqimin e huadhënësit.

Kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 904

Huamarrësi është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e sendit, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se do të ishte dhënë në huapërdorje.

Neni 905

Në qoftë se huamarrësi e përdor sendin ndryshe nga sa është caktuar në kontratë ose nga natyra e tij dhe për një kohë më të gjatë se sa duhej, përgjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti fator, përveç kur provon se sendi do të humbiste njëlloj, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në kontratë.

Neni 906

Huamarrësi nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.

Neni 907

Në qoftë se gjatë afatit të caktuar, ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin sipas kontratës, huadhënësi ndodhet përpara një nevoje të ngutshme dhe të paparashikuar të sendit, ai mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 908

Në rast vdekjeje të huamarrësit, huadhënësi, edhe po të jetë caktuar një afat, mund të kërkojë nga trashëgimtarët kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 909

Huamarrësi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të sendit të dhënë në huapërdorje, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe, ndërsa ndreqjet e tjera bëhen nga huadhënësi.

Neni 910

Po qe se gjatë huapërdorjes huamarrësi është detyruar, për të ruajtur sendin, që të kryejë shpenzime të jashtëzakonshme, të nevojshme dhe të ngutshme dhe se për këto nuk ka patur mundësi të njoftonte huadhënësin, ky duhet t'ia paguajë huamarrësit.

Neni 911

Po qe se sendi i huapërdorur ka patur të meta të tilla që dëmtojnë atë që e përdor, huadhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin sa kohë që, duke i ditur të metat e sendit, nuk ka njoftuar huamarrësin.

Neni 912

Kur mbaron afati i kontratës së huapërdorjes, ose kur kontrata zgjidhet para këtij afati, huamarrësi është i detyruar t'i kthejë huadhënësit sendin po në atë gjendje në të cilën e mori me ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tij, ose në gjendjen e parashikuar në kontratë. Gjersa nuk provohet e kundërta prezumohet se sendi është marrë në gjendje të mirë.

KREU X
POROSIA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 913

Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër.

Neni 914

Në qoftë se të porosituri i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin.

Neni 915

I porosituri që vepron në emrin e vet fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet e kryera me të tretët, edhe po qe se këta kanë patur dijeni për porosinë.

Të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Megjithatë porositësi, duke zënë vendin e të porosituri, mund të ushtrojë të drejtat e kredisë që rrjedhin nga zbatimi i porosisë, përveç kur mund të cenojë të drejtat që gëzon i porosituri në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Neni 916

I porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositësit. Ai mund të largohet nga këto udhëzime vetëm kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesat e porositësit dhe nuk ka mundësi që të merret vesh më parë me të.

Neni 917

Porosia përfshin jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre.

Porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës, po qe se nuk cilësohen shprehimisht.

Neni 918

Porositësi mund të rivendikojë sendet e luajtshme të fituara për llogari të vet nga i porosituri që ka vepruar në emrin e vet, pa cenuar të drejtat e fituara nga të tretët për efektet e posedimit me mirëbesim.

Po qe se sendet e fituara nga i porosituri janë pasuri e paluajtshme ose pasuri e luajtshme të regjistruara në regjistrat publike, i porosituri është i detyruar t'ia rikthejë porositësit.

Neni 919

Kreditorët e palës së porositur nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre mbi sendet që gjatë ekzekutimit të porosisë, i porosituri i ka vetësuar me emrin e vet, me kusht që kur është fjala për pasuri të luajtshme ose për kredi, porosia të vërtetohet nga një provë me shkrim që përmban datë të saktë përpara vënies dorë ose, kur është fjala për pasuri të paluajtshme ose për pasuri të luajtshme të regjistruara në regjistrat publike, regjistrimi i aktit të rikthimit ose i kërkesës gjyqësore që synon të përfitojë kthimin e përmendur të përmbajë një datë përpara vehtësimit.

Neni 920

Porosia prezumohet se është me shpërblim. Masa e shpërblimit, kur nuk caktohet nga palët, përcaktohet në bazë të tarifave profesionale ose zakonit dhe në mungesë të tyre nga gjykata.

Neni 921

I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj.

I porosituri detyrohet gjithashtu që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është autorizuar t'ia kalojë një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit.

Neni 922

I porosituri duhet të marrë masa për ruajtjen e sendeve që janë dërguar për llogari të porositësit dhe të mbrojë të drejtat e këtij të fundit kundrejt transportuesit, po qe se sendet paraqesin shenja dëmtimi ose kur kanë mbërritur me vonesë.

Neni 923

Porositësi, përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, detyrohet të furnizojë të porosituri me mjetet e nevojshme për kryerjen e porosisë dhe për përmbushjen e detyrimeve që me atë synim i porosituri i ka marrë përsipër në emrin e vet.

Neni 924

I porosituri është i detyruar t'i japë porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.

Neni 925

Porositësi duhet të paguajë të porositurin për parapagesat, së bashku me kamatat ligjore qysh nga dita kur janë kryer si dhe t'i paguajë shpërblimin që i takon.

Porositësi duhet gjithashtu të shpërblejë dëmet që i porosituri ka pësuar për shkak tee detyrës.

Neni 926

Kreditë në para të rrjedhura nga punët e veprimet që i porosituri ka kryer, kanë përparësi ndaj porositësit dhe ndaj kreditorëve të tij.

Shuarja e porosisë

Neni 927

Porosia shuhet me vdekjen, pazotësinë për të vepruar ose falimentimin e porositësit ose të të porositurit, përveç marrëveshjes tjetër ose kur rezulton ndryshe nga natyra e rrethanave të krijuara.

Megjithatë, kur shuarja e porosisë mund të cenojë interesat e porositësit, i porosituri, trashëgimtarët ose përfaqësuesit detyrohen të vazhdojnë administrimin deri kur porositësi, trashëgimtarët e tij ose përfaqësuesit e vet, të jenë në gjëndje të merren vetë drejtpërdrejt me çështjen.

Heqja dorë nga porosia dhe efektet juridike

Neni 928

I porosituri mund të heqë dorë nga kontrata por, po qe se në marrëveshje është parashikuar e kundërta, ai përgjigjet për dëmet, përveç kur heqja dorë bëhet për një shkak të drejtë.

Porosia e dhënë në interes të të porositurit ose të tretëve nuk shuhet me revokim nga ana e porositësit, përveç kur është vendosur ndryshe në kontratë ose ajo bëhet për një shkak të drejtë, por nuk shuhet për shkak të vdekjes ose për pazotësinë për të vepruar që i ndodh porositësit.

Neni 929

Emërimi i një të porosituri të ri për të njëjtën marrëveshje ose kryerja e kësaj nga ana e porositësit sjell heqjen e porosisë, dhe ka efekt qysh nga dita kur i janë njoftuar të porositurit.

Neni 930

Heqja dorë nga porosia me shpërblim dhe për një kohë të caktuar ose për një punë të caktuar, detyron porositësin të shpërblejë dëmet, po qe se është bërë përpara mbarimit të afatit apo të kryerjes së punës, përveç kur ekziston një shkak i drejtë.

Kur porosia është me afat të pacaktuar, heqja dorë detyron porositësin për shpërblimin e dëmit, po qe se nuk është bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për revokim.

Neni 931

I porosituri që heq dorë nga porosia pa ndonjë shkak të drejtë duhet t'i shpërblejë dëmet porositësit. Kur porosia është me afat të pacaktuar, i porosituri që heq dorë pa ndonjë shkak të drejtë detyrohet të shpërblejë dëmin po qe se nuk ka bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme.

Në çdo rast, heqja dorë duhet bërë në një mënyrë dhe në një kohë të tillë që porositësi të marrë masa për të vepruar ndryshe, përveç rastit të një vështirësie të madhe nga ana e të porositurit.

Neni 932

Në qoftë se porosia është dhënë nga disa persona me një akt të vetëm dhe për një çështje me interes të përbashkët, heqja dorë nuk ka efekt kur nuk është bërë nga të gjithë të porositurit, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për heqjen dorë.

Neni 933

Aktet që i porosituri ka kryer përpara se të marrë vesh shuarjen e porosisë janë të vlefshme kundrejt porositësit dhe trashëgimtarëve të tij.

Neni 934

Porosia e dhënë disa personave që mendohet të punojnë bashkërisht shuhet edhe po qe se shkaku i shuarjes ka të bëjë vetëm me njërin prej të porositurve, përveç kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe.

KREU XI
KOMISIONI

Përmbajtja
Neni 935

Kontrata e komisionit është një porosi që ka për objekt blerjen dhe shitjen e sendeve për llogari të porositësit dhe në emër të komisionerit.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 936

Porositësi është i detyruar t'i paguajë komisionerit të gjitha shpenzimet që ka bërë për kryerjen e porosisë dhe shpërblimin që parashikohet në kontratën e komisionit, si dhe ta shkarkojë nga çdo detyrim që komisioneri ka marrë ndaj të tjerëve për kryerjen e komisionit.

Neni 937

Komisioneri prezumohet se është i autorizuar që të lejojë vonesa në pagim, në përputhje me zakonin e vendit ku kryen veprimin, në qoftë se kur porositësi nuk ka vendosur ndryshe.

Në qoftë se i porosituri lejon vonesa në pagim, pavarësisht nga ndalimi i porositësit ose nga zakoni i vendit, porositësi mund të kërkojë nga ai pagimin e menjëhershëm, përveç të drejtës së komisionerit për të përfituar avantazhet e ardhura nga vonesa në pagim.

Komisioneri që ka lejuar vonesën në pagim duhet t'i tregojë porositësit se cila ishte pala e kontraktuar dhe afati i dhënë, përndryshe veprimi quhet se është kryer pa u lejuar vonesë dhe zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 938

Komisioneri nuk përgjigjet për ekzekutimin nga ana e personit të tretë të kontratës së lidhur nga komisioneri me të, për llogari të porositësit, përveç kur në kontratën e komisionit parashikohet ndryshe.

Neni 939

Kur komisioneri ka kryer veprimin juridik në kushte më të dobishme nga ato të udhëzimeve që i kishte dhënë porositësi, gjithçka që komisioneri ka fituar në këtë rast kalon në dobi të porositësit.

Neni 940

Komisioneri ka të drejtë të largohet nga udhëzimet që i ka dhënë porositësi vetëm kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, një largim i tillë bëhet i nevojshëm për interesat e porositësit, dhe komisioneri nuk mund të merret vesh më parë me porositësin ose, kur, megjithëse e ka pyetur, nuk ka marrë përgjigje në kohën e duhur.

Neni 941

Komisioneri është i detyruar të lidhë kontratë sigurimi për sendet e porositësit që ndodhen pranë tij, vetëm po të jetë parashikuar në kontratën e komisionit, ose po të jetë sigurimi i detyrueshëm në bazë të ligjit.

Neni 942

Porositësi mund të ndryshojë rradhën e përfundimit të marrëveshjes sa kohë që komisioneri nuk e ka përfunduar. Në këtë rast i takon komisionerit një pjesë e shpërblimit për ndërmjetësim që përcaktohet duke u mbajtur parasysh shpenzimet e kryera dhe puna e bërë.

Neni 943

Në komisionin për shitjen dhe blerjen e mallrave, titujve, valutave dhe vlerave të tjera që kanë një çmim liste ose një çmim të caktuar nga organet shtetërore, po qe se porositësi nuk ka vendosur ndryshe, komisioneri mund të përfshijë në të njëjtin çmim, të fiksuar në momentin e ekzekutimit të porosisë, sendet që duhet të blejë, ose të blejë për vetë sendet që duhet të shesë, duke ruajtur të drejtën për shpërblimin për ndërmjetësim.

Dispozitë referuese

Neni 944

Dispozitat mbi porosinë zbatohen edhe për komisionin gjersa nuk parashikohen ndryshe në këtë kre.

KREU XII
SPEDICIONI (DËRGESA)

Përmbajtja

Neni 945

Kontrata e spedicionit (dërgesës) është një porosi me të cilën spedicioneri merr përsipër detyrimin për të lidhur në emër dhe për llogari të porositësit, një kontratë transporti dhe për të kryer të gjitha veprimet ndihmëse.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 946

Deri sa spedicioneri nuk ka lidhur kontratën e transportit me transportuesin, dërguesi mund të revokojë urdhërin e dërgesës, duke i paguar spedicionerit shpenzimet e kryera dhe duke i dhënë atij një shpërblim të përshtatshëm për shërbimin e kryer.

Neni 947

Në zgjedhjen e rrugës, mjetit dhe mënyrave të transportit të mallit, spedicioneri detyrohet të zbatojë udhëzimet e porositësit dhe, në mungesë të tyre, të veprojë sipas interesit më të mirë të tij.

Shpërblimet, zbritjet nga çmimi dhe përfitimet tarifore të realizuara nga spedicioneri duhet t'i kreditohen porositësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 948

Masa e shpërblimit që i takon spedicionerit për kryerjen e detyrës përcaktohet, kur nuk ka marrëveshje për të, sipas tarifave profesionale ose, kur këto mungojnë, sipas zakoneve të vendit ku kryhet dërgesa.

Parapagesat dhe kompensimet për shërbimet ndihmëse të kryera nga spedicioneri, likuidohen në bazë të dokumenteve justifikuese, veç në qoftë se ripagimi dhe kompensimet janë përcaktuar paraprakisht me një shumë të përgjithshme totale.

Neni 949

Spedicioneri, i cili me mjetet e veta ose të tjetërkujt, merr përsipër kryerjen e transportit tërësisht ose pjesërisht, ka të drejtat dhe detyrimet e transportuesit.

KREU XIII
AGJENCIA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 950

Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.

Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.

Neni 951

Pala porositëse nuk mund të pajtojë njëkohësisht më shumë se dy agjentë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë, dhe po ashtu, as agjenti nuk mund të marrë përsipër të trajtojë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtën fushë, marrëveshjet e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952

Agjenti nuk ka të drejtë të vjelë kreditë e palës porositëse.

Në qoftë se kjo e drejtë i është dhënë, ai nuk mund të bëjë zbritje ose të lejojë vonesa pa patur autorizim të posaçëm.

Neni 953

Agjentit mund t'i drejtohen kundërshtimet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e kontratës të lidhur nëpërmjet tij dhe reklamimet lidhur me mospërmbushjen e kësaj kontrate.

Agjenti mund të kërkojë marrjen e masave mbrojtëse në interes të palës porositëse dhe të paraqesë reklamimet që janë të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave që i takojnë kësaj të fundit.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 954

Agjenti duhet të përmbushë detyrën e ngarkuar në përputhje me udhëzimet e marra dhe t'i japë palës porositëse informacionet që kanë të bëjnë me kushtet e tregut në zonën që është caktuar, gjendjen pasurore të klientëve të mundshëm dhe çdo informacion tjetër të dobishëm për të vlerësuar leverdinë e marrëveshjeve të veçanta.

Ai gjithashtu duhet të zbatojë detyrimet që i takojnë komisionerit deri sa ato nuk përjashtohen nga natyra e kontratës së agjencisë. Përveç marrëveshjes së kundërt, agjenti nuk mund të depozitojë ose të regjistrojë shenjat dalluese që identifikojnë veprimtarinë e palës porositëse.

Neni 955

Agjenti i cili nuk është në gjendje të kryejë detyrën e besuar duhet të njoftojë menjëherë palën porositëse, përndryshe detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 956

Agjenti ka të drejtë të shpërblehet për ndërmjetësim vetëm për marrëveshjet që janë zbatuar rregullisht. Në qoftë se marrëveshja është zbatuar në mënyrë të pjesshme, shpërblimi që i takon agjentit është në përpjesëtim me pjesën e kryer të saj.

Shpërblimi paguhet edhe për marrëveshjet e përfunduara drejtpërdrejt nga pala porositëse, të cilat duhet të ekzekutohen në zonën e rezervuar për agjentin, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Agjenti ka të drejtë për shpërblim mbi marrëveshjet e përfunduara edhe pas zgjidhjes së kontratës, po qe se përfundimi është sidomos rrjedhim i veprimtarisë së kryer prej tij.

Agjenti nuk ka të drejtë të ripaguhet për shpenzimet e agjencisë.

Pala porositëse duhet të vërë në dispozicion të agjentit dokumentet e nevojshme për pasurinë ose shërbimet e trajtuara dhe t'i japë agjentit informacionet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sidomos ajo duhet të njoftojë agjentin, brenda një afati të arsyeshëm, sapo të parashikojë se vëllimi i operacioneve tregtare do të jetë mjaft më i ulët nga vëllimi që agjenti do të priste normalisht. Pala porositëse duhet gjithashtu të informojë agjentët brenda një afati të arsyeshëm për pranimin ose refuzimin dhe moskryerjen e një marrëveshjeje që e ka siguruar agjenti. Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të shpërblimit që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, gjatë të cilit ai është fituar. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elemente thelbësore në bazë të të cilave është kryer llogaria e shpërblimit.

Brenda të njëjtit afati shpërblimet e likuiduara duhet t'i paguhen efektivisht agjentit. Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave të llogarive të nevojshme për verifikimin e madhësisë së shpërblimeve të likuiduara.

Neni 957

Shpërblimi i takon agjentit edhe për marrëveshjet që nuk janë zbatuar për shkaqe që i përkasin palës porositëse. Në qoftë se pala porositëse dhe pala e tretë merren vesh për të mos zbatuar kontratën

pjesërisht ose tërësisht, agjenti ka të drejtë që, për pjesën e pazbatuar, të përfitojë një shpërblim të zvogëluar në masën e caktuar me marrëveshje, sipas zakonit dhe në mungesë të tyre nga gjykata.

Neni 958

Kontrata e agjencisë me afat të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të afatit, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Po qe se kontrata e agjencisë është me afat të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati.

Afati i njoftimit paraprak nuk mundet, sidoqoftë të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, katër muaj për vitin e katërt, pesë muaj për vitin e pestë dhe gjashtë muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjithë vitet në vazhdim.

Palët mund të merren vesh për afatin e njoftimit paraprak të kohëzgjatjes më të madhe, por pala porositëse nuk mund të zbatojë një afat më të shkurtër se sa ai i caktuar për agjentin.

Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të njoftimit paraprak duhet të përkojë me ditën e fundit të muajit kalendarik.

Neni 959

Në mbarim të marrëveshjes së agjencisë, pala porositëse detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe kur:

- agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm marrëveshjet me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga marrëveshjet me këta klientë;

- pagimi i këtij shpërblimi quhet i përshtatshëm, kur janë patur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht shpërblimi që agjenti humbet nga marrëveshjet me këta klientë.

Nuk paguhet shpërblim kur:

- pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila për shkak të përmasave të saj, nuk lejon vazhdimin qoftë edhe të përkohshëm të marrëveshjes;

- agjenti tërhiqet nga kontrata përveç rastit kur tërheqja justifikohet nga rrethanat që mund t'i përkasin agjentit, siç janë mosha, paaftësia e përkohëshme ose sëmundjet, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;

- lidhur me një marrëveshje që ka me palën porositëse, agjenti i lëshon një pale të tretë të drejtat dhe detyrimet që ai ka nga kontrata e agjencisë.

Madhësia e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një shifër të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur mbi bazën e mesatares vjetore të shpërblimeve të përfituara nga agjenti në pesë vjetët e fundit dhe po qe se kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, mbi mesataren e periudhës në fjalë.

Dhënia e shpërblimit nuk privon agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti e humb të drejtën e shpërblimit të parashikuar në këtë nen po qe se brenda një viti nga ndërprerja e marrëdhënies nuk i njofton palës porositëse kërkesat e tij.

Neni 960

Marrëveshja që kufizon konkurrencën nga ana e agjentit pas zgjidhjes së kontratës duhet të bëhet me shkrim. Kjo duhet të trajtojë të njëjtën zonë klientele dhe sende, pasuri ose shërbime për të cilat ishte lidhur kontrata e agjencisë dhe kohëzgjatja e saj nuk mund të tejkalojnë dy vitet e mëpasme nga zgjidhja e kontratës.

Dispozitë referuese
Neni 961

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe kur pala porositëse i jep agjentit të drejtën e përfaqësimit për lidhjen e kontratave.

KREU XIV
KALIMI I PASURISË KREDITORËVE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 962

Kalimi i pasurisë është kontrata me të cilën debitori ngarkon kreditorët e vet ose disa prej tyre për të likuiduar të gjitha ose disa veprimtari të tij për t'i shpërndarë midis tyre fitimet e nxjerra në përmbushje të kredive të tyre.

Neni 963

Kalimi i pasurisë duhet bërë me shkrim, ndryshe është i pavlefshëm.
Në qoftë se midis pasurive të ceduara ka edhe kredi, atëherë zbatohen dispozitat e neneve 502 e 503 të këtij Kodi.

Neni 964

Administrimi i pasurisë së kaluar u takon kreditorëve përkatës. Ata mund të ngrejnë padi për të gjitha çështjet pasurore që lidhen me atë pasuri, përfshirë edhe paditë për mbrojtjen e posedimit.

Neni 965

Debitori nuk mund të disponojë sendet e kaluara kreditorëve.
Kreditorët, kreditë e të cilëve ekzistonin përpara kalimit të pasurisë dhe që nuk kanë ndërhyrë, mund të kërkojnë ekzekutimin mbi gjithë këtë pasuri.
Kreditorëve, që u ka kaluar pasuria, në rast se kalimi ka për objekt vetëm disa veprimtari të debitorit, nuk mund të kërkojnë ekzekutimin për veprimtari të tjera, para shlyerjes së atyre që janë lidhur me kalimin e pasurisë.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 966

Kreditorët që kanë lidhur kontratën ose kanë aderuar në të, duhet të parapaguajnë shpenzimet e nevojshme për likuidimin dhe kanë të drejtë të marrin shumën nga të ardhurat prej likuidimit.

Neni 967

Kreditorët duhet t'i ndajnë midis tyre shumat e nxjerra në përpjesëtim me kreditë përkatëse, përveç rasteve të preferimeve. Mbetja i takon debitorit.

Neni 968

Debitori ka të drejtë të kontrollojë administrimin dhe të marrë një raportim mbi gjendjen financiare në fund të likuidimit, ose në fund të çdo viti po qe se administrimi zgjat më shumë se një vit.

Po qe se është emëruar një likuidues, ai duhet t'ia japë raportimin edhe debitorit.

Neni 969

Debitori shkarkohet ndaj kreditorëve vetëm nga dita kur ata marrin pjesën që u takon nga të ardhurat prej likuidimit dhe vetëm në kufijtë e shumës që kanë marrë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 970

Debitori mund të tërhiqet nga kontrata duke ofruar t'u paguajë detyrimet dhe interesat atyre me të cilët ka kontraktuar ose që janë bashkuar në këtë kontratë. Tërheqja ka efekt nga dita e pagimit.

Debitori detyrohet të paguajë shpenzimet e gjërimit.

Zgjidhja e kontratës

Neni 971

Kontrata mund të zgjidhet po qe se debitori, pasi ka deklaruar se e kalon të gjithë pasurinë e vet, ka fshehur një pjesë të konsiderueshme të saj, ose po që se ka fshehur humbjet apo ka paraqitur humbje që nuk ekzistonin.

Neni 972

Kontrata mund të zgjidhet për shkak mospërmbushjeje sipas rregullave të përgjithshme.

KREU XV
NDËRMJETËSIMI

Përmbajtja

Neni 973

Ndërmjetës është ai që vë në lidhje dy ose më shumë palë për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi.

Shpërblimi

Neni 974

Kur nuk ka marrëveshje, ose kur tarifat profesionale, ose zakonet nuk japin ndonjë përcaktim, madhësia e shpërblimit dhe përpjesëtimi në të cilin ky rëndon mbi secilën nga palët, caktohet nga gjykata.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 975

E drejta e ndërmjetësit për shpërblim lind kur kontrata e ndërmjetësimit i sjell efektet e veta dhe pavarësisht nga ndodhitë e mëvonshme të saj.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet kur kontrata e ndërmjetësimit mund të shpallet e pavlefshme, nga që ndërmjetësi kishte dijeni për arësyen e pavlefshmërisë.

Neni 976

Ndërmjetësi ka të drejtë të paguhet për shpenzimet prej personit për të cilin janë kryer shpenzimet edhe kur marrëveshja nuk është përfunduar, përveç kur është zgjidhur ndryshe me marrëveshje ose nga zakonet.

Neni 977

Në qoftë se marrëveshja është përfunduar me ndërhyrjen e disa ndërmjetësve, secili prej tyre ka të drejtë për një kuotë shpërblimi.

Neni 978

Ndërmjetësi duhet t'u njoftojë palëve rrethanat për të cilat ai ka dijeni e që kanë të bëjnë me vleresimin dhe me sigurinë e marrëveshjes, të cilat mund të ndikojnë në përfundimin e saj.

Ndërmjetësi përgjigjet për vërtetësinë e nënshkrimit në dokumentet dhe për xhirimet e fundit të titujve të transmetuara nëpërmjet tij.

Neni 979

Detyrat e ndërmjetësuesit profesionist në marrëveshje për mallra ose për tituj janë:

1. të ruajë kampionet e mallrave të shitura me anë kampionesh, derisa të ekzistojë mundësia e mosmarrëveshjeve për identitetin e mallit;
2. t'i japë blerësit një listë të nënshkruar të titujve për të cilët është biseduar duke treguar serinë dhe numrin;
3. të shënojë në librin përkatës të dhënat kryesore të kontratës që lidhet me ndërhyrjen e tij dhe t'u japë palëve kopjen e çdo shënimi të tillë të nënshkruar prej tij.

Neni 980

Ndërmjetësi mund të ngarkohet nga njëra prej palëve për ta përfaqësuar në veprimet lidhur me zbatimin e kontratës së lidhur me ndërhyrjen e tij.

Neni 981

Ndërmjetësi, që nuk i tregon njërit kontraktues emrin e kontraktuesit tjetër, përgjigjet për zbatimin e kontratës dhe, kur e ka zbatuar atë, merr të drejtat ndaj kontraktuesit të patreguar.

Në qoftë se, pas lidhjes së kontratës, kontraktuesi i patreguar shfaqet para palës tjetër ose tregohet nga ndërmjetësi, secili nga kontraktuesit mund të ngrejë padi drejtpërdrejt kundër tjetrit, por pa cenuar përgjegjësinë e ndërmjetësit.

KREU XVI
DEPOZITA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 982

Depozita është kontrata me të cilën njëra palë merr nga tjetra një send të luajtshëm me detyrimin për ta ruajtur dhe për ta kthyer në natyrë.

Neni 983

Kontrata e depozitës quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi për ruajtje.

Neni 984

Depozita prezumohet se është me shpërblim, përveç kur nga cilësia profesionale e depozitarit ose nga rrethanat e tjera kuptohet një vullnet i ndryshëm i palëve.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 985

Depozitari duhet të ruajë sendin me kujdes. Ai nuk mund ta përdorë atë vetë dhe as t'ua japë në depozitë të tjerëve, pa pëlqimin e depozituesit. Në qoftë se sendin e përdor pa pëlqimin e depozituesit, depozitari është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e tij deri në shkakun fator.

Po ta kërkojnë rrethanat e ngutshme, depozitari mund të ushtrojë ruajtjen në një mënyrë të ndryshme nga marrëveshja, duke njoftuar depozituesin menjëherë sapo të jetë krijuar mundësia.

Neni 986

Depozitari është i detyruar të kthejë sendin e lënë depozitë në çdo kohë që e kërkon depozituesi edhe sikur të jetë caktuar një afat për kthimin e tij, përveç kur afati është caktuar në interes të depozitarit.

Kthimi i sendit të lënë depozitë bëhet në vendin ku sendi duhej të ruhej, përveç përmbushjes së palëve kthimi bëhet me shpenzimet e depozituesit.

Neni 987

Në qoftë se depozita është pa shpërblim, gjykata mund të ulë masën e shpërblimit të dëmit.

Neni 988

Depozituesi është i detyruar t'i paguajë depozitarit shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit, në qoftë se nuk janë përfshirë në shpërblim.

Neni 989

Kur nuk është caktuar një afat për kthimin e sendit të lënë depozitë, depozitari ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë që të shkarkohet nga detyrimi i tij për ruajtjen e sendit, duke lajmëruar depozituesin që të marrë prapë sendin brenda një afati të mjaftueshëm që i cakton vetë.

Neni 990

Depozituesi është i detyruar të shpërblejë dëmin që i është shkaktuar depozitarit nga të metat e fshehta të sendit, në qoftë se, duke i ditur këto, nuk ia ka njoftuar depozitarit.

Neni 991

Kur depozituesit e një sendi janë më shumë se një dhe ata nuk merren vesh lidhur me kthimin e tij, vendos gjykata.

Kështu veprohet edhe kur një depozitues i vetëm ka lënë disa trashëgimtarë, po qe se sendi nuk është i ndashëm.

Kur depozitëmarrësit janë më shumë se një, depozituesi ka të drejtë të kërkojë kthimin nga personi që mban sendin, i cili duhet të njoftojë menjëherë të tjerët.

Neni 992

Në qoftë se sendi është depozituar edhe në interes të një të treti dhe ky i fundit u ka njoftuar depozituesit dhe depozitëmarrësit pranimin e tij, depozitëmarrësi nuk mund të shkarkohet duke ia kthyer sendin depozituesit, pa miratimin e të tretit.

Neni 993

Depozitëmarrësi është i detyruar të kthejë frytet e sendit të cilat ai i ka vjelë.

Neni 994

Trashëgimtari i depozitëmarrësit që ka tjetërsuar sendin në mirëbesim, duke mos ditur se mbahej në depozitë, detyrohet vetëm të kthejë shpërblimin e marrë.

Në qoftë se ky nuk është paguar ende, depozituesi merr të drejtat e tjetërsuesit.

Neni 995

Depozitëmarrësi duhet t'i kthejë sendin depozituesit ose personit të caktuar për ta marrë, pa qenë nevoja që depozituesi të provojë se është pronar.

Në qoftë se depozitëmarrësi paditet nga një person që rivendikon pronësinë e sendit ose pretendon se ka të drejta mbi të, depozitëmarrësi duhet të denoncojë mosmarrëveshjen tek depozituesi dhe të kërkojë të përjashtohet nga gjykimi duke treguar vetë personin, përndryshe duhet të shpërblejë dëmet. Në këtë rast ai mund të shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, duke e depozituar atë sipas mënyrave të caktuara nga gjykata, me shpenzimet e depozituesit.

Neni 996

Në qoftë se ruajtja e sendit i hiqet depozitarit si rrjedhim i një fakti për të cilin ai nuk është fajtor, ai shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, por duhet t'i njoftojë menjëherë depozitarit faktin për të cilin ka humbur mbajtjen e sendit, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Depozituesi ka të drejtë të marrë atë që, si pasojë e vetë faktit, depozitari ka siguruar dhe merr të drejtat që i takojnë këtij të fundit.

Neni 997

Kreditë që rrjedhin nga depozita në dobi të depozitarit kanë privilegj mbi sendin e dhënë në depozitë. Depozitari mund të mbajë sendin që është në privilegj derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas dispozitave për pengun.

Neni 998

Kur sendi i lënë depozitë nuk është tërhequr në afatin e caktuar në kontratë ose pas lajmërimit që i ka bërë depozitari, ky nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit që ngjan pas kalimit të afatit, përveç kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e tij.

Në rastet e sipërme, depozitari ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që të lejojë shitjen e sendit të lënë në depozitë sipas rregullave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Shumat e nxjerra nga shitja e sendit, pasi të zbriten shumat që ka për të marrë depozitari, i jepen depozituesit ose depozitohen në bankë në emër të tij.

Dispozitë referuese

Neni 999

Në qoftë se depozita ka për objekt një sasi të hollash ose sendesh të tjera të barasndërrueshme, dhe depozitari ka të drejtën t'i përdorë, ky fiton pronësinë dhe detyrohet të kthejë po të njëjtën sasi nga i njëjti lloj dhe me të njëjtën cilësi.

Në raste të tilla zbatohen dispozitat lidhur me huanë, kur nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë depozitën.

A. DEPOZITA NË MAGAZINAT E PËRGJITHSHME

Neni 1000

Magazinat (depot) e përgjithshme që veprojnë si depozitare janë përgjegjëse për ruajtjen e sendeve të depozituara, përveç kur provohet se dëmi ka ardhur nga rasti fator, nga natyra e sendeve ose nga defekte të sendeve ose të ambalazhit.

Depozitari duhet në çdo rast të ushtrojë veprimtaritë e nevojshme për të kufizuar dëmin.

Neni 1001

Magazinat depozitare duhet të ruajnë sendet e depozituara veçmas njëra nga tjetra, gjithashtu duhet t'i pajisin me shenja dalluese që të tregojnë përkatësinë e sendit ndaj depozituesit.

Përveç pëlqimit të shprehur të depozituesit, ata nuk mund të përziejnë midis tyre sende të barasndërrueshme të të njëjtit lloj e cilësi.

Depozituesi ka të drejtë të inspektojë sendet e depozituara dhe të tërheqë kampionet e përdorimit.

Neni 1002

Kur depot e përgjithshme kanë lëshuar një titull përfaqësimi të sendeve të depozituara, depozitari duhet t'ia kthejë sendet vetëm kreditorit që është legjitimuar nga titulli.

Neni 1003

Depot e përgjithshme pasi njoftojnë depozituesin, mund të fillojnë shitjen me çmim më të lartë të sendeve kur, në mbarim të kontratës sendet nuk janë tërhequr, ose depozita nuk është përtërirë, dhe në

çdo rast, kur sendet rrezikohen të humbasin ose përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë e vendeve ku janë depozituar.

Të ardhurat nga shitja, pasi zbritet kostoja dhe shpenzimet e mbetura të depozitës, duhet t'i dorëzohen depozituesit pa vonesë.

B. DEPOZITA NË HOTEL

Neni 1004

Hotelierët janë përgjegjës për dëmtimin, shkatërrimin ose humbjen e sendeve që klientët kanë sjellë në hotel.

Konsiderohen të sjella në hotel:

1. sendet që ndodhen gjatë kohës në të cilën klienti strehohet aty;

2. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë, jashtë hotelit, gjatë periudhës së kohës në të cilën klienti ndodhet i strehuar;

3. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë qoftë në hotel, qoftë jashtë tij, për një kohë të arsyeshme, para ose pasi klienti të ketë bujtur.

Përgjegjësia që përmend ky nen kufizohet në vleftën e asaj që është vjedhur, dëmtuar ose humbur deri në ekuivalentin e njëqindfshit të çmimit të qirasë së banimit për një ditë.

Neni 1005

Përgjegjësia e hotelierit është e pakufizuar:

1. kur sendet janë dorëzuar për ruajtje;

2. kur ka refuzuar të marrë në ruajtje sende të cilat kishte detyrë t'i pranonte. Hotelieri ka për detyrë të pranojë letrat me vlerë, paratë dhe sendet me vlerë; ai mund të mos pranojë t'i marrë kur bëhet fjalë për objekte të rrezikshme ose që, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kushtet e administrimit të hotelit, kanë vlerë të rëndësishme ose përmasa shumë të mëdha.

Hotelieri mund të kërkojë që sendi i dorëzuar të jetë i vendosur në një mbështjellje të mbyllur ose të vulosur.

Neni l006

Hotelieri nuk është përgjegjës kur vjedhja, dëmtimi ose humbja vijnë:

1. nga klienti, nga personat që e shoqërojnë, që janë në shërbim të tij, ose që e vizitojnë;

2. nga forca madhore;

3. nga natyra e sendeve.

Neni 1007

Hotelieri është përgjegjës, pa mundur të invokojë kufijtë e parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 1004, kur vjedhja, dëmtimi ose humbja e sendeve të sjella nga klienti në hotel janë shkaktuar për faj të tij, të anëtarëve të familjes së tij ose të ndihmësave të tij.

Neni 1008

Përveç rastit të parashikuar në nenin 985, klienti nuk mund të përdorë dispozitat e mësipërme po qe se, pasi të ketë konstatuar vjedhjen, dëmtimin ose humbjen, denoncon faktin tek hotelieri me një vonesë të pajustifikueshme.

Neni 1009

Janë të pavlefshme marrëveshjet ose deklaratat që synojnë të përjashtojnë ose të kufizojnë paraprakisht përgjegjësinë e hotelierit.

Neni 1010

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për automjetet, për sendet e lëna në to dhe as për kafshët e gjalla.

Neni 1011

Për vlerësimin e përgjegjësisë, ose për të caktuar kufirin e shpërblimit, dispozitat për depozitat në hotel zbatohen edhe ndaj sipërmarrësve të klinikave shëndetësore publike dhe private, institucioneve për shfaqje publike, shtëpive të pushimit, hotel- pensioneve, restoranteve dhe për të gjitha rastet në të cilat, nga vetë veprimtaria e posaçme e zhvilluar nga sipërmarrësi, klienti nuk mund të kujdeset personalisht për ruajtjen e sendeve.

Neni 1012

Kreditë e hotelierit, për shpërblimet e kryera ndaj personave bujtës, kanë privilegj mbi sendet e sjella prej tyre në hotel e nëvartësitë e tij dhe që vazhdojnë të ndodhen aty.

Privilegji ka efekt edhe në dëm të të tretëve, që kanë të drejta mbi vetë këto sende, me kusht që hotelieri të jetë në dijeni për këto të drejta në kohën kur sendet janë sjellë në hotel.

KREU XVII
LLOGARIA RRJEDHËSE

Neni 1013

Llogaria rrjedhëse është një kontratë me të cilën palët detyrohen të regjistrojnë në një llogari kreditimet reciproke, duke e konsideruar të padisponueshme dhe të pakthyeshme deri në mbylljen e llogarisë.

Teprica e llogarisë është e kthyeshme me mbarimin e afatit. Në qoftë se nuk është kërkuar pagimi, teprica konsiderohet e rinovuar për një kohë të pacaktuar.

Neni 1014

Përjashtohen nga llogaria rrjedhëse, kreditë që nuk mund të kompensohen.

Kur kontrata vepron ndërmjet sipërmarrësve, përjashtohen nga llogaria kreditë e huaja për ndërmarrjet përkatëse.

Neni 1015

Mbi gjendjen përfitohet kamata në masën e vendosur në kontratë dhe në mungesë të këtyre nga ligji, por gjithnjë brenda kufijve të caktuara prej tij.

Neni 1016

Për llogarinë rrjedhëse paguhet komisioni si dhe shpenzimet që janë dashur për veprimet që kanë lidhje me derdhjet. Këto të drejta nuk bëjnë pjesë në llogari, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 1017

Përfshirja e një kredie në llogarinë rrjedhëse, nuk përjashton ushtrimin e të drejtës së padisë dhe e të drejtave të tjera, lidhur me aktin nga i cili rrjedh kredia.

Kur akti i mësipërm është i pavlefshëm, ose shpallet si i tillë, ose i zgjidhur, pjesa përkatëse e parave përjashtohet nga llogaria rrjedhëse.

Neni 1018

Kur kredia e përfshirë në llogari është e siguruar me një garanci reale ose personale, klienti ka të drejtë të përdorë këtë garanci për tepricën ekzistuese në favor të tij nga mbyllja e llogarisë e deri në arkëtimin e kredisë së garantuar.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe në qoftë se për kredinë ekziston një bashkëdetyrim solidar.

Neni 1019

Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë, përfshirja në llogarinë rrjedhëse e një kredie ndaj një të treti, prezumohet si e bërë me kushtin që të paguhet. Në rastin kur kredia nuk përmbushet, marrësi ka të drejtën të veprojë për mbledhjen, marrjen e shumës së parave nga llogaria, duke riintegruar atë që ka bërë derdhjen. Mund të merret kjo shumë parash nga llogaria edhe pasi ushtron pa rezultat të drejtat e tij kundrejt debitorit.

Neni 1020

Në rast se kreditori i një klienti ka sekuestruar mbetjen eventuale të llogarisë që i takon debitorit të tij, klienti tjetër nuk mundet, me derdhje të reja të cenojë të drejtat e kreditorit. Nuk konsiderohen si derdhje të reja ato që janë bërë në vartësi nga të drejtat e rrjedhura para sekuestrimit.

Klienti ndaj të cilit është bërë sekuestrimi ose është vënë pengu duhet të njoftojë anën tjetër. Secili prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata.

Neni 1021

Mbyllja e llogarisë me likudimin e tepricës bëhet me mbarimin e afateve të përcaktuara në kontratë dhe në mungesë të tyre, në përfundim të çdo 6/mujori të llogaritur që nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 1022

Kalimi i veprimeve në llogari nga një klient në një tjetër nënkuptohet i pranuar në qoftë se nuk është kundërshtuar në afatin e caktuar prej palëve ose në afatin që mund të konsiderohet i përshtatshëm sipas rrethanave.

Pranimi i veprimit nuk përfshin të drejtën për ta kundërshtuar për gabime shkrimi ose llogaritjeje, për mosveprim ose dublime.

Kundërshtimi duhet të bëhet brenda 6 muajve nga data e kalimit të llogarisë, lidhur me likuidimin e mbylljen, e cila duhet të dërgohet rekomande. Rivendosje në afat nuk lejohet.

Neni 1023

Kur kontrata është lidhur për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata në çdo mbyllje të llogarisë, duke njoftuar të paktën 10 ditë përpara.

Në rastin e një ndalimi të ushtrimit të këtij aktiviteti, të paaftësisë për të vepruar, të paaftësisë paguese ose vdekjes së njërës prej palëve, secila prej tyre, ose trashëgimtarët e tyre, kanë të drejtën të tërhiqen nga kontrata.

Zgjidhja e kontratës ndalon përfshirjen në llogari të shumave të reja, por pagimi i mbetjes nuk mund të kërkohet vetëm pas skadimit të periudhës së përcaktuar në nenin 1021.

KREU XVIII
KONTRATAT BANKARE

A. DEPOZITAT BANKARE

Neni 1024

Kur depozitohet një shumë parash pranë një banke, kjo fiton pronësinë dhe është e detyruar t'i kthejë në të njëjtën lloj monedhe, me skadimin e afatit të përcaktuar ose me kërkesën e depozituesit, duke patur parasysh periudhën e lajmërimit të përcaktuar nga palët ose nga zakoni bankar.

Neni 1025

Në rast se banka lëshon një librezë depozite kursimi, derdhjet dhe tërheqjet duhet të shënohen në librezë.

Shënimet mbi librezë të firmosura nga nëpunësi i bankës, që është i caktuar për këtë shërbim, përbëjnë provë të plotë midis bankës dhe depozituesit.

është e pavlefshme çdo marrëveshje e kundërt.

Neni 1026

Në qoftë se libreza e kursimit është e pagueshme tek prurësi, banka që padashje dhe pa faj të rëndë kryen shërbimin përballë poseduesit, nuk përgjigjet edhe në qoftë se ky nuk është depozituesi.

E njëjta dispozitë zbatohet në rastin kur libreza e depozitës e pagueshme tek prurësi të jetë lëshuar në emër të një personi të caktuar.

Janë të përjashtuara dispozitat e ligjeve të veçanta.

Neni 1027

Banka që merr dhe pranon depozitat e titujve në administrim duhet t'i ruajë titujt duke marrë interesat ose dividentet, të verifikojë tregtimin për çmimin ose për ripagimin e kapitalit, duke treguar kujdes për grumbullimin e të ardhurave për llogarinë e depozituesit, dhe në përgjithësi të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave që kanë të bëjnë me titullin. Shumat e grumbulluara duhet të jenë të krediturara në llogarinë e depozituesit.

Në qoftë se për titujt e depozituar duhet të ushtrohet një e drejtë zgjedhjeje, banka duhet të kërkojë në kohë udhëzimet e nevojshme nga depozituesit dhe t'i realizojë ato, në qoftë se në rast nevoje ka marrë fonde të nevojshme. Në mungesë të këtyre udhëzimeve, të drejtat e zgjedhjeve duhet të shiten për llogari të depozituesit nëpërmjet agjentëve të këmbimit.

Bankës i takon një kompensim në masën e përcaktuar nga marrëveshja e palëve ose ajo që përdoret zakonisht, përveç pagimit të shpenzimeve të bëra prej saj.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën përjashtohet banka nga ruajtja dhe administrimi i titujve me një kujdesje të zakonshme.

B. SHËRBIMI BANKAR DHE KASETAT E SIGURIMIT

Neni 1028

Banka, për shërbimin e kasetave të sigurimit, përgjigjet kundrejt përdoruesit për aftësinë paguese, ruajtjen e lokalit dhe për paprekshmërinë e kasetës, përveç ndonjë rasti fator.

Neni 1029

Kur kaseta është në emër të disa personave, hapja e saj i njihet secilit prej tyre, përveç ndonjë marrëveshjeje të kundërt.

Në rast vdekje të mbajtësit të vetëm ose të njërit të këtyre mbajtësve, banka që ka marrë njoftimin mund të lejojë hapjen e kasetës me marrëveshjen e të gjithë atyre që e kanë të drejtë, ose sipas mënyrës së përcaktuar nga gjykata.

Neni 1030

Kur afati i kontratës ka mbaruar, banka mbas një lajmërimi të mbajtësit ose me kalimin e gjashtë muajve nga data e mbarimit, mund t'i kërkojë gjykatës autorizimin për hapjen e kasetës. Lajmërimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës rekomande të konfirmuar.

Hapja kryhet në praninë e një noteri duke patur parasysh edhe masat që gjykata i quan të nevojshme. Gjykata mund të urdhërojë marrjen e masave të nevojshme për ruajtjen e objekteve të gjetura duke përfshirë edhe shitjen e një pjese të tyre, që është e nevojshme për të plotësuar shpenzimet e bëra nga banka.

C. HAPJA (ÇELJA) E KREDISË BANKARE

Përkufizimi

Neni 1031

Hapja e kredisë bankare është një kontratë me të cilën banka detyrohet të mbajë në dispozicion të palës tjetër një shumë parash, për një periudhë të caktuar kohe ose për një kohë të pacaktuar.

Neni 1032

Përveç kur ka marrëveshje tjetër, në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe, kredimarrësi mund ta përdorë disa herë kredinë, sipas formave të përdorimit, dhe mundet që me derdhjet e mëtejshme të rivendosë disponibilitetin e tij.

Derdhjet dhe tërheqjet realizohen pranë bankës ku ka lindur kjo marrëdhënie, përveç kur është parashikuar ndryshe nga palët.

Neni 1033

Në qoftë se për hapjen e kredisë është dhënë një garanci reale ose personale, kjo nuk shuhet për faktin se kredimarrësi, në momentin e mbarimit të kësaj marrëdhënieje, pushon së qëni debitor i bankës. Kur garancia bëhet e pamjaftueshme, banka mund të kërkojë një garanci suplementare ose zëvendësimin e garantit.

Kur kredimarrësi nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka pakëson kredinë në mënyrë proporcionale me pakësimin e vlerës së garancisë ose mund të heqë dorë nga kontrata.

Neni 1034

Banka nuk mund të tërhiqet nga kontrata përpara mbarimit të afatit të kontratës, përveç rasteve të arsyeshme, ose kur ka marrëveshje tjetër. Heqja dorë ndërpret menjëherë përdorimin e kredisë, por banka duhet të caktojë një afat të paktën prej pesëmbëdhjetë ditësh për kthimin e shumave të përdorura dhe ato plotësuese.

Kur dhënia e kredisë është në një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata nëpërmjet lajmërimit në afatin e caktuar në kontratë, që përdoret zakonisht ose, në mungesë të tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Ç. PARADHËNIA BANKARE

Disponim i sendeve të dhëna peng

Neni 1035

Në paradhënien bankare me pengun mbi titujt ose mbi mallrat, banka nuk mund të disponojë mbi sendet për të cilat është vënë pengu, në qoftë se ka lëshuar një dokument në të cilin këto sende janë individualizuar.

Marrëveshja e kundërt duhet të provohet me shkresë.

Neni 1036

Banka duhet të kujdeset për llogari të kontraktuesit për sigurimin e mallrave të lëna peng nëqoftëse, për nga vetë natyra, vlera dhe vendndodhja e tyre sigurimi i përgjigjet përkujdesjeve të zakonshme.

Neni 1037

Banka, përveç detyrimeve që i takojnë, ka të drejtën që t'i paguhen shpenzimet që ka bërë për ruajtjen e mallrave dhe të titujve, përveç kur e ka marrë përsipër një gjë të tillë.

Neni 1038

Kontraktuesi, edhe përpara mbarimit të afatit të kontratës, mund të tërheqë titujt ose mallrat e lëna peng, duke bërë më parë një pagesë proporcionale ndërmjet shumave të marra paradhënie dhe të shumave të tjera që i përkasin bankës sipas nenit të mësipërm, në qoftë se teprica e kredisë rezulton e pagarantuar në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 1039

Në qoftë se vlera e garancisë pakësohet të paktën në një të dhjetën në krahasim me vlerën e saj në kohën e lidhjes së kontratës, banka mund t'i kërkojë debitorit një garanci plotësuese, me paralajmërimin se në mungesë të saj do të veprohet për shitjen e këtyre mallrave ose titujve të dhëna peng. Në qoftë se debitori nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka mund të veprojë për shitjen e tyre në bazë të dispozitave për pengun.

Banka ka të drejtën e pagimit të menjëhershëm të tepricës të llogarisë që nuk është përmbushur plotësisht nga shumat e rezultuara nga shitja

Neni 1040

Në qoftë se me garancitë e një ose më shumë kredive janë bllokuar depozita në para, mallra ose tituj që nuk kanë qenë të individualizuar ose për të cilat i është lënë bankës mundësia për t'i disponuar,

banka duhet të kthejë vetëm shumën ose një pjesë të mallrave ose të titujve që tejkalojnë shumën e kredive të garantuara. Ky tejkalim përcaktohet në lidhje me vlerën e mallrave ose të titujve në kohën e mbarimit të kredive.

D. VEPRIMET BANKARE ME LLOGARI RRJEDHËSE

Neni 1041

Kur depozita, çelja e kredisë ose veprimet e tjera bankare janë rregulluar në llogarinë rrjedhëse, klienti mund të disponojë në çdo kohë shumat që rezultojnë në kredinë e tij, përveç kur rezerva e afatit, është parashikuar në marrëveshje.

Neni 1042

Në rast se midis bankës dhe klientit ekzistojnë disa marrëdhënie ose disa llogari, edhe në monedha të ndryshme, teprica aktive dhe pasive kompensohen në mënyrë reciproke, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1043

Në rastin kur llogaria likujduese është në emër të disa personave, me të drejtën për të kryer veprime edhe në mënyrë individuale, këta persona quhen kreditorë ose debitorë solidarë të tepricave të llogarisë.

Neni 1044

Në rast se veprimet në llogarinë rrjedhëse janë për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata, duke lajmëruar palën tjetër brenda afatit të caktuar në kontratë ose në mungesë të tij, brenda 15 ditëve.

Neni 1045

Banka përgjigjet sipas dispozitave që rregullojnë kontratën e porosisë për ekzekutimin e detyrimeve të marra nga depozituesi ose nga një klient tjetër.

Në qoftë se ky detyrim duhet të kryhet aty ku nuk ekzistojnë degë të bankës, kjo mund të ngarkojë për ekzekutim një bankë tjetër.

Neni 1046

Për llogarinë rrjedhëse zbatohen edhe nenet 1016,1019,1022.

E. SKONTOJA BANKARE

Përkufizimi

Neni 1047

Skontoja është kontrata me anë të së cilës banka, duke zbatuar kamatën i jep klientit vleftën e një kredie ndaj të tretëve, që nuk ka mbaruar akoma, nëpërmjet cedimit.

Skontoja e kambialeve

Neni 1048

Në qoftë se skontoja bëhet nëpërmjet xhirimit të kambialit ose të çekut bankar, banka në rast se nuk kryhet pagimi, përveç të drejtave të rrjedhura nga titulli, gëzon edhe të drejtën e kthimit të paradhënies.

Ruhen dispozitat e ligjeve të veçanta lidhur me çekun dhe kambialin.

Neni 1049

Banka që ka skontuar kambialet e dokumentuara, gëzon mbi mallin të njëjtin privilegj qe ka edhe i porosituri, deri sa titulli përfaqësues është në posedimin e tij.

KREU XIX
HUAJA

Neni 1050

Me kontratën e huasë njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit.

Neni 1051

Përveç kur me marrëveshje të palëve është parashkuar ndryshe, huamarrësi duhet t'i paguajë huadhënësit kamatat.

Kamatat, për të cilat është rënë dakord, paguhen çdo vit, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe.

Mospagimi i kamatave përbën mospërmbushje thelbësore të detyrimit.

Neni 1052

Në rast se palët janë marrë vesh për kthimin me këste të parave ose të sendeve dhe huamarrësi nuk përmbush detyrimin e pagimit të dy kësteve ose nuk përmbush, me një vonesë prej më shumë se tre muaj, pagimin e vetëm një kësti, huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të parave ose të sendeve të dhënë hua.

Neni 1053

Kur kthimi i sendeve të dhëna hua është bërë i pamundur ose tepër i vështirë pa fajin e debitorit, ky është i detyruar të paguajë vleftën e tyre, duke marrë parasysh kohën dhe vendin në të cilën do të bëhej kthimi.

Neni 1054

Huadhënësi është përgjegjës për dëmin që i ka shkaktuar huamarrësit, për të metat e sendeve të dhëna hua, në qoftë se nuk provon se nuk ishte faji i tij që nuk kishte dijeni për ato.

Në qoftë se huaja është pa shpërblim, huamarrësi është përgjegjës vetëm në rastin kur, duke i ditur cenet, nuk e ka njoftuar huadhënësin për to.

Neni 1055

Kush ka premtuar të japë hua, mund të refuzojë të përmbushë detyrimin, po qe se kushtet pasurore të palës tjetër janë në gjëndje të tillë sa e bëjnë tepër të vështirë kthimin dhe huadhënësit nuk i janë ofruar garanci të përshtatshme.

KREU XX
FRANCHISING

Përkufizimi
Neni 1056

Kontrata franchising përmban një raport detyrimesh të vazhdueshme me të cilin ndërmarrje të pavarura detyrohen ndërmjet njëra-tjetrës që të nxisin e të zhvillojnë bashkërisht tregtinë dhe kryerjen e shërbimeve, në zbatim të detyrimeve të veçanta.

Detyrimet e franchisor-it
Neni 1057

Franchisor-i (franshizdhënësi) ka detyrimin të vërë në dispozicion të franchizee-së (franshizmarrësit) një tërësi të standardizuar të drejtash jo materiale, modelesh, skicash, idesh fitimi, tregtimi dhe organizimi e njohuri të tjera të përshtatshme për zhvillimin e tregtisë.

Ndërkaq ai është i detyruar të ruajë gjithë këtë program detyrimesh nga cenimi prej të tretëve, ta zhvillojë atë vazhdimisht dhe të mbështesë zbatimin e tij nga franshizmarrësi me udhëzime, informacione e perfeksionime.

Marrëdhëniet parakontraktore
Neni 1058

Në bisedimet për përfundimin e kontratës palët duhet t'i tregojnë njëra-tjetrës gjendjen e punëve tregtare që kanë të bëjnë me kontratën franchise dhe veçanërisht programin e detyrimeve franchise, si dhe të informojnë njëri-tjetrin sipas parimeve të mirëbesimit. Ata janë të detyruar të ruajnë sekretin e informatave konfidenciale, edhe po të mos përfundohet kontrata.

Kush shkel këtë detyrim, detyrohet të shpërblejë dëmin. Kjo e drejtë parashkruhet me kalimin e tre vjetëve nga dita e pushimit të bisedimeve.

Pala që ka marrë pjesë në bisedime mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve të bëra me besim të ligjshëm në përfundimin e kontratës, e cila nuk u përfundua për shkak të një sjelljeje të qëllimshme të palës tjetër.

Forma e kontratës
Neni 1059

Kontrata franchising duhet të bëhet me shkresë duke përcaktuar ndër të tjera një përkufizim të njëzëshëm të detyrimeve të ndërsjella të palëve, kohëzgjatjen e kontratës dhe të elementeve të tjera thelbësore të saj. Teksti i kontratës duhet të përmbajë një përshkrim të plotë të programit e të detyrimeve franchising.

Heqja dorë nga kontrata
Neni 1060

Kohëzgjatja e kontratës vendoset me marrëveshje të palëve, duke respektuar kërkesat e diktuara nga tregtia dhe shërbimet përkatëse.

Kur në kontratë nuk është përcaktuar afat, ose afati është më tepër se dhjetë vjet, secila palë ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar palën tjetër një vit më parë.

Në rast pushimi të kontratës si rrjedhim i plotësimit të afatit ose heqjes dorë prej saj dhe përpara paraqitjes aktuale të raportit të punëve, palët, të udhëhequra nga parimet e mirëbesimit, bëjnë një përpjekje për të rënë dakord për ripërtëritjen e kontratës në kushte të njëjta ose të ndryshuara.

Ndalimi i konkurrencës
Neni 1061

Edhe pas pushimit të marrëdhënieve kontraktore palët kanë reciprokisht detyrimin për një konkurencë të ndershme.

Mbi këtë bazë, franchismarrësit mund t'i imponohet një ndalim i konkurencës lokale për një kohë deri në një vit.

Në qoftë se nga ndalimi i konkurrencës rezulton një pakësim i veprimtarisë së tij profesionale, franchismarrësit i jepet një kompensim financiar i barasvlershëm, pa marrë parasysh pushimin e kontratës.

Përgjegjësia e franchismarrësit
Neni 1062

Franchisdhënësi përgjigjet për qenien e të drejtave dhe të njohurive të programit të detyrimeve franchise. Në rast se të drejtat nuk do të ekzistonin ose në qoftë se franchisdhënësi do të shkelte të tjera detyrime kontraktore me mënyrë të fajshme, franchismarrësi ka të drejtë të pakësojë shpërblimin. Shuma e pakësuar duhet të vendoset me kompetencë me anën e një eksperti të paanshëm. Franchismarrësi mund të kërkojë shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga mosqënia e elementeve të programit të detyrimeve ose nga shkelja me faj e kontratës nga ana e franchisdhënësit.

Neni 1063

Franchisdhënësi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelja me faj e kontratës, në veçanti nga zbatimi i pamjaftueshëm i programit të detyrimeve franchise, nga ana e franchismarrësit.

Heqja dorë
Neni 1064

Në rast shkelje detyrimesh kontraktore që vënë seriozisht në rrezik qëllimin për zhvillimin e tregtisë, pala kontraktuese ka të drejtën të heqë dorë nga kontrata, pa iu referuar afatit.

KREU XXI
RENTA JETORE

Neni 1065

Renta jetore mund të krijohet kundrejt shpërblimit (me titull barrësor) nëpërmjet tjetërsimit të një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose të një shume parash.

Renta jetore mund të krijohet edhe me anë dhurimi ose me testament, duke respektuar kërkesat e ligjit për veprime juridike të tilla.

Neni 1066

Renta jetore mund të jepet për të gjithë jetën e përfituesit ose të një personi tjetër. Ajo mund të formohet edhe për gjithë jetën e një ose disa personave.

Neni 1067

Kur renta është formuar në favor të shumë personave, pjesa e një përfituesi të vdekur më parë, rritet në favor të të tjerëve, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1068

Kontrata e rentës jetore e krijuar në favorin e një personi, i cili në kohën e kontratës kishte vdekur, është e pavlefshme.

Efektet e kontratës së rentës jetore

Neni 1069

Personi në dobi të të cilit është krijuar renta jetore, me titull barrësor, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se personi që jep rentën nuk jep garancitë ose ul garancitë e dhëna në marrëveshje.

Neni 1070

Mospagimi i kësteve të arrira të rentës jetore nuk i jep të drejtën personit, në favor të të cilit është krijuar renta, që të kërkojë zgjidhjen e kontratës; por vetëm mund të kërkojë që të sekuestrohen e të shiten pasuritë e debitorit të tij dhe nga të ardhurat e shitjes të përdoret një shumë e mjaftueshme për të siguruar pagimin e rentës.

Neni 1071

Debitori i rentës nuk mund të shkarkohet nga detyrimi për pagimin e saj edhe sikur të ofrojë pagimin e shumës së parave ose të gjësë së marrë, qoftë dhe duke hequr dorë nga pagimi i kësteve të shlyera.

I sipërmi është i detyruar të paguajë rentën për të gjithë kohën që është krijuar, sado i rëndë që të jetë bërë detyrimi i rentës, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1072

Renta jetore i jepet personit, në favor të të cilit është krijuar, në proporcion me numrin e ditëve që ka jetuar. Në rast se në marrëveshje është parashikuar që të parapaguhet me këste, secili prej tyre fitohet nga dita që plotësohet afati i pagimit.

Neni 1073

Në rast se renta jetore është krijuar mbi bazën e një titulli pa shpërblim, mund të parashikohet (ose të vendoset) që kjo të jetë e pasekuestrueshme.

KREU XXII
SHOQËRIA E THJESHTË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1074

Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime.

Neni 1075

Në shoqërinë e thjeshtë kontrata nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, përveç kur kërkohet nga natyra e sendeve të bashkuara.

Shoqëria është e thjeshtë, kur nuk paraqet cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare të rregulluara në Kodin Tregtar.

Marrëdhëniet midis anëtarëve

Neni 1076

Anëtari është i detyruar të paguajë kontributet e caktuara në kontratën e shoqërisë.

Prezumohet se anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë, në pjesë të barabarta midis tyre, sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1077

Kontrata e shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të gjithë ortakëve, në qoftë se në marrëveshje nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 1078

Për sendet e dhëna në pronësi, garancia e kërkuar nga anëtari dhe kalimi i rreziqeve rregullohen nga dispozitat mbi shitjen.

Neni 1079

Anëtari që ka kontribuar në kredi, përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, brenda caqeve të treguara në nenin 506 të këtij Kodi për rastin e marrjes me marrëveshje të garancisë.

Neni 1080

Përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, administrimi i shoqërisë i takon secilit prej anëtarëve veçmas nga të tjerët.

Po qe se administrimi u takon veçmas disa anëtarëve, secili prej tyre ka të drejtë të kundërshtojë veprimin që dëshiron të kryejë një tjetër, përpara se ky të kryhet.

Shumica e anëtarëve, e përcaktuar sipas pjesës së çdo anëtari në fitim, zgjidh mosmarrëveshjen.

Neni 1081

Në qoftë se administrimi u takon në mënyrë të përbashkët disa anëtarëve, është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë ortakëve administratorë për kryerjen e veprimeve të shoqërisë.

Në qoftë se është vendosur që për administrimin ose për veprime të caktuara të jetë i nevojshëm miratimi i shumicës, kjo përcaktohet sipas paragrafit të fundit të nenit 1080 të këtij Kodi.

Në rastet e parashikuara në këtë nen, administratorët e veçantë nuk mund të kryejnë të vetëm ndonjë veprim, veç në raste të ngutshme, kur duhet shmangur një dëm që i kanoset shoqërisë.

Neni 1082

Heqja e administratorit të emëruar në kontratën e shoqërisë mund të bëhet për një shkak të drejtë.

Administratori i emëruar me një akt të veçantë mund të hiqet sipas dispozitave të kontratës së porosisë. Në një rast të tillë heqja e tij mund të kërkohet edhe në rrugë gjyqësore nga çdo anëtar.

Neni 1083

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve rregullohen me dispozitat mbi porosinë. Administratorët janë përgjegjës solidarisht ndaj shoqërisë për përmbushjen e detyrimeve që u janë ngarkuar me ligj ose nga kontrata e shoqërisë, përveç kur provojnë se nuk kanë faj.

Neni 1084

Anëtarët që nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë që të marrin njoftim nga administratorët për ecurinë e punëve të shoqërisë, të konsultohen me dokumentet që lidhen me administrimin dhe të marrin një raport kur të jenë kryer punët për të cilat është krijuar shoqëria.

Në qoftë se kryerja e punëve të shoqërisë zgjat më shumë se një vit, anëtarët kanë të drejtë të marrin raportin e administratës në fund të çdo viti, përveç rastit kur kontrata parashikon një afat tjetër.

Neni 1085

Përveç marrëveshjes së kundërt, çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të fitimeve pas miratimit të raportit.

Neni 1086

Pjesët që u takojnë anëtarëve në fitimet ose në humbjet prezumohen në përpjesëtim me kuotat e kontribuara. Në qoftë se vlera e kontributeve nuk përcaktohet nga kontrata, caktohet nga gjykata. Në qoftë se kontrata përcakton vetëm pjesën e çdo anëtari në fitimet, në të njëjtën masë prezumohet se duhet të përcaktohet edhe pjesëmarrja në humbjet.

Neni 1087

Çdo marrëveshje që përjashton një ose më shumë anëtarë nga pjesëmarrja në fitimet ose humbjet, është e pavlefshme.

Marrëdhënie me të tretët

Neni 1088

Shoqëria fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime me anë të anëtarëve që kanë të drejtën për ta përfaqësuar.

Në mungesë të dispozitave të tjera në kontratë, përfaqësimi i takon çdo anëtari administrator dhe shtrihet për të gjitha aktet që përfshihen në objektin e shoqërisë. Ndryshimet dhe shuarja e tagrave të përfaqësimit rregullohen me dispozitat për përfaqësimin.

Neni 1089

Kreditorët e shoqërisë mund të kërkojnë të drejtat e tyre mbi pasurinë e shoqërisë. Për detyrimet e shoqërisë gjithashtu përgjigjen personalisht ose solidarisht anëtarët që kanë vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe, po të ketë marrëveshje tjetër, edhe anëtarët e tjerë.

Marrëveshja duhet t'u bëhet e ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, në mungesë të marrjes dijeni, kufizimi i përgjegjësisë ose përjashtimi nga përgjegjësia solidare nuk mund t'u kundrejtohet atyre që nuk kanë patur dijeni për të.

Neni 1090

Anëtari, të cilit i kërkohet pagimi i detyrimeve të shoqërisë, mund të kërkojë, edhe kur shoqëria është në likuidim, ekzekutimin paraprak ndaj pasurisë së shoqërisë, duke treguar sendet mbi të cilat kreditori mund të shpërblehet më së miri.

Neni 1091

Ai që bëhet anëtar në një shoqëri të krijuar më parë, përgjigjet së bashku me anëtarët e tjerë për detyrimet e shoqërisë përpara se ta ketë fituar cilësinë e anëtarit.

Neni 1092

Kreditori i veçantë i anëtarit, deri sa zgjat shoqëria, mund të kërkojë të drejtat e tij mbi fitimet që i takojnë debitorit, si dhe marrjen e masave ruajtëse (konservative) mbi kuotën që i takon këtij të fundit në likuidim.

Në qoftë se sende të tjera të debitorit janë të pamjaftueshme për të shpërblyer kreditë e tij, kreditori i veçantë i anëtarit mund të kërkojë, veç kësaj, në çdo kohë likuidimin e kuotës së debitorit të tij. Kuota duhet të likuidohet brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, përveç kur është vendosur shpërndarja e shoqërisë.

Neni 1093

Nuk pranohet kompensimi midis detyrimit që një i tretë ka ndaj shoqërisë dhe kredisë që ky ka ndaj një anëtari.

Shpërndarja e shoqërisë

Neni 1094

Shoqëria shpërndahet:

1. me mbarimin e afatit;
2. me realizimin e objektit të shoqërisë ose për pamundësinë e realizimit të tij;
3. me vullnetin e të gjithë anëtarëve;
4. për shkaqe të tjera të parashikuara në kontratën e shoqërisë.

Neni 1095

Kontrata e shoqërisë zgjatet në heshtje për një kohë të pacaktuar kur, sadoqë ka kaluar afati i parashikuar në kontratë, anëtarët vazhdojnë të kryejnë veprime të shoqërisë.

Neni 1096

Pas shpërndarjes së shoqërisë anëtarët administrues ruajnë pushtetin e administrimit vetëm për çështjet e ngutshme, derisa të ndërmerren veprimet e nevojshme për likuidimin.

Neni 1097

Në qoftë se kontrata nuk parashikon mënyrën e likuidimit të pasurisë dhe anëtarët nuk janë në një mendje për ta përcaktuar atë, likuidimi bëhet nga një ose disa likuidues, të emëruar me pëlqimin e të gjithë ortakëve ose, në rast mosmarrëveshjeje, nga gjykata.

Likuiduesit mund të revokohen me vullnetin e të gjithë ortakëve dhe në çdo rast nga gjykata me kërkesën e arsyetuar të njërit ose të disa anëtarëve.

Neni 1098

Detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesve rregullohen sipas rregullave të vendosura nga administratorët, përderisa nuk parashikohet ndryshe nga dispozitat e mëposhtme ose nga kontrata e shoqërisë.

Neni 1099

Administratorët duhet t'u dorëzojnë likuiduesve sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe t'u paraqesin atyre llogarinë e administrimit për periudhën pas raportimit të fundit.

Likuiduesit duhet të marrin në dorëzim sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe të hartojnë, së bashku me administratorët, inventarin nga ku të rezultojë gjendja aktive dhe pasive e pasurisë së shoqërisë. Inventari duhet të nënshkruhet nga administratorët dhe nga likuiduesit.

Neni 1100

Likuiduesit mund të kryejnë aktet e nevojshme për likuidim dhe, po qe se anëtarët nuk kanë parashikuar ndryshe, mund të shesin edhe në bllok pasurinë e shoqërisë dhe të bëjnë marrëveshje e kompromise.

Ata përfaqësojnë shoqërinë edhe në gjykim.

Neni 1101

Likuiduesit nuk mund të ndërmarrin veprime të reja. Në rast të kundërt ata përgjigjen personalisht dhe solidarisht për punët e filluara.

Neni 1102

Likuiduesit nuk mund të ndajnë midis anëtarëve, qoftë edhe pjesërisht, pasurinë e shoqërisë, derisa të mos jenë paguar kreditorët e shoqërisë, ose të mos jenë vënë mënjanë shumat e nevojshme për të paguar ata.

Në qoftë se fondet në dispozicion janë të pamjaftueshme për pagimin e detyrimeve të shoqërisë, likuiduesit mund t'u kërkojnë anëtarëve derdhjet për të cilat ata ende detyrohen në kuotat përkatëse dhe, po të jetë nevoja, shumat e nevojshme në kufijtë e përgjegjësisë përkatëse dhe në përpjesëtim me pjesën e secilit në humbjet. Në të njëjtin përpjesëtim pjesëtohet midis anëtarëve detyrimi i anëtarit me paaftësi për të paguar.

Neni 1103

Anëtarët që kanë kontribuar me pasuri për t'u përdorur, kanë të drejtë ta marrin atë përsëri në gjendjen në të cilën ndodhet. Po qe se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar për shkaqe që mund t'u ngarkohen administratorëve, anëtarët kanë të drejtë për shpërblimin e dëmit në ngarkim të pasurisë së shoqërisë, përveç rastit kur mund të ngrihet padi kundër administratorëve.

Neni 1104

Pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, aktivi i mbetur destinohet për pagimin e kuotave të kontributeve. Teprica e mundshme ndahet midis anëtarëve në përpjesëtim me pjesën e secilit në fitim.

Vlefta e kuotave të kontributeve që nuk kanë për objekt shuma parash, përcaktohet sipas vlerësimit që është bërë në kontratë ose, në mungesë të tij, sipas vleftës që ata kanë patur në momentin kur janë dhënë.

Neni 1105

Në qoftë se në marrëveshje është parashkuar që ndarja e sendeve të bëhet në natyrë, zbatohen dispozitat mbi ndarjen e sendeve të përbashkëta.

Zgjidhja e marrëdhënies së një anëtari me shoqërinë

Neni 1106

Çdo anëtar mund të tërhiqet nga shoqëria kur ajo është formuar për një kohë të pacaktuar ose për gjithë jetën e njërit prej anëtarëve.

Veç kësaj mund të tërhiqet në rastet e parashikuara në kontratën e shoqërisë ose kur ekziston një shkak i drejtë.

Në rastet e parashikuara në paragrafin e parë, tërheqja duhet t'u komunikohet anëtarëve të tjerë të paktën tre muaj përpara.

Neni 1107

Përveç kur në kontratën e shoqërisë është parashikuar ndryshe, në rast vdekjeje të njërit prej anëtarëve, të tjerët duhet të likuidojnë kuotën në favor të trashëgimtarëve, veç kur preferojnë të shpërndajnë shoqërinë ose ta vazhdojnë më vete trashëgimtarët, dhe këta japin pëlqimin.

Neni 1108

Përjashtimi i një anëtari mund të ndodhë për shkak mospërmbushjeje të rëndësishme të detyrimeve që rrjedhin nga ligji ose nga kontrata e shoqërisë, si dhe për ndalimin, pazotësinë ose për dënimin e tij me një masë që përfshin edhe ndalimin, qoftë edhe të përkohshëm, nga detyrat zyrtare.

Anëtari që ka dhënë si kontribut në shoqëri veprën e vet ose gëzimin e një sendi, mundet gjithashtu të përjashtohet për shkak të papërshtatshmërisë së menjëhershme për të kryer veprën e dhënë ose për humbjen e sendit, që ka ndodhur për shkaqe që nuk mund t'u ngarkohen administratorëve.

Gjithashtu, mund të përjashtohet anëtari që ka kontribuar me anë të transferimit të pronësisë së një sendi, në qoftë se ky humbet përpara se sendi të fitohet nga shoqëria.

Neni 1109

Përjashtimi vendoset nga shumica e anëtarëve, duke mos përfshirë në numrin e tyre anëtarin për t'u përjashtuar dhe ka efekt pas 30 ditëve nga data kur i është bërë njoftimi anëtarit të përjashtuar.

Brenda këtij afati ortaku i përjashtuar mund të paraqesë kundërshtim përpara gjykatës, e cila mund të pezullojë zbatimin e vendimit.

Po qe se shoqëria përbëhet nga dy anëtarë, përjashtimi i njërit bëhet nga gjykata me kërkesën e tjetrit.

Neni 1110

Përjashtohen nga shoqëria edhe:

a) anëtari që është deklaruar i falimentuar;

b) anëtari ndaj të cilit një kreditor i tij i caktuar ka arritur të ketë të drejtën e likuidimit të kuotës sipas nenit 1092 të këtij Kodi.

Përjashtimi i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni nuk zbatohet në rastet kur falimentimi i anëtarit është pasojë e falimentimit të shoqërisë.

Neni 1111

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky dhe trashëgimtarët e tij kanë të drejtë vetëm për një shumë të hollash që përfaqësojnë vlerën e kuotës.

Likuidimi i kuotës bëhet në bazë të gjendjes pasurore të shoqërisë ditën kur ndodh largimi i anëtarit.

Në qoftë se ka aktivitete në vazhdim, anëtari dhe trashëgimtarët e tij kanë pjesë në fitimet dhe humbjet që kanë të bëjnë me këto aktivitete. Përveç sa parashikohet në nenin 1092, pagimi kuotës që i takon ortakut duhet bërë brenda 6 muajve nga dita e largimit të tij.

Neni 1112

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky ose trashëgimtarët e tij janë përgjegjës ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë deri në ditën kur ai është larguar.

Largimi duhet t'u bëhet i ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, përndryshe, ajo nuk mund t'u kundrejtohet të tretëve që, jo për fajin e tyre, nuk e kanë ditur.

KREU XXIII
SIGURIMI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1113

Me kontratën e sigurimit, njëra palë (siguruesi), në qoftë se vërtetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet:

a) në rastin e sigurimit të pasurisë t'i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë;

b) në rastin e sigurimit të personit t'i paguajë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, shumën e sigurimit që është parashikuar në kontratë.

I siguruari detyrohet të paguajë primin (çmimin e sigurimit) të caktuar në kontratë.

Siguruesi mund të jetë person publik ose privat.

Neni 1114

Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që siguruesi i lëshon të siguruarit, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 1115

Në dëshminë e sigurimit të tregohen sidomos:

a) emri i siguruesit;

b) emri i personit të siguruar, në rastin e sigurimit të personit, pasuria e siguruar dhe vendi ku ndodhet kjo pasuri në rastin e sigurimit të pasurisë;

c) ngjarja me vërtetimin e së cilës siguruesi të përmbushë detyrimin që ka marrë në kontratë;

ç) fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit (afati i sigurimit);

d) koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguruesit;

e) vlerësimi i pasurisë në ato raste që kjo gjë kërkohet për një lloj të caktuar sigurimi;

ë) primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre.

Kur sipas ligjit ose sipas kontratës shpërblimi i sigurimit ose shumat e sigurimit duhet t'i paguhen jo vetëm të siguruarit, por edhe një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, ky kusht duhet të tregohet në dëshminë e sigurimit.

Neni 1116

Kur humbet dëshmia e sigurimit, siguruesi, me kërkesën dhe shpenzimet e të siguruarit, duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

Neni 1117

I siguruari duhet t'i njoftojë siguruesit, me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut.

Quhet se kanë rëndësi thelbësore të gjitha rrethanat për të cilat siguruesi ka pyetur me shkresë të siguruarin.

Kontrata e sigurimit e lidhur pa u marrë përgjigja në ndonjë nga këto pyetje, nuk mund të jetë, për këtë shkak, e pavlefshme.

Neni 1118

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i siguruari duke ditur ka dhënë informata jo të sakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura prej tij dhe në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, siguruesi brenda tre muajve nga marrja dijeni ka të drejtë:

a) të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit;

b) të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla, që po t'i dinte siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën. Në këtë rast, primet e sigurimit deri në kohën që kërkohet prishja e kontratës, e në çdo rast primi i sigurimit për t'u paguar në vitin e parë të kontratës, nuk i kthehen të siguruarit.

Në qoftë se vërtetohet ngjarja e sigurimit përpara se të fillojë afati i treguar në paragrafin e mësipërm, siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shumën e sigurimit.

Kur kontrata e sigurimit është lidhur për më shumë se një person ose sende, ajo mbetet e vlefshme për ata persona ose sende, të cilëve nuk u referohen deklarimet e pasakta apo heshtja.

Neni 1119

Dhënia e informatave të pasakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura, në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, ose lënia në harresë e informatave kur vërtetohet se nuk janë bërë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, por siguruesi mund të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar të siguruarin me shkrim, brenda 3 muajve nga marrja dijeni e tyre.

Në qoftë se ngjarja e sigurimit vërtetohet përpara se pasaktësitë e informatave ose lënia në harresë e tyre, të njihen nga siguruesi, ose përpara se të jetë deklaruar heqja dorë nga kontrata, shuma e detyruar ulet në proporcion me diferencën midis shumës së caktuar në kontratë dhe asaj që do të ishte zbatuar, në se do të njihej gjendja e vërtetë e fakteve.

Neni 1120

Kur kontrata e sigurimit lidhet në emër e për llogari të të tretëve dhe këta janë në dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose të harresave në lidhje me rrezikun (rastin e sigurimit), në favor të siguruesit zbatohen dispozitat e neneve 1118, 1119 të këtij Kodi.

Neni 1121

Kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar asnjëherë ose ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës.

Neni 1122

Kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së qeni pas përfundimit të kontratës, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primeve, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit t'i jetë njoftuar ose t'i jetë bërë e ditur në një mënyrë tjetër.

Neni 1123

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi detyrohet t'i njoftojë siguruesit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijeni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që mund të influencojë mbi shtimin e rrezikut.

Në qoftë se i siguruari nuk bën njoftimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë, që nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit ose të zgjidhë kontratën.

Kur i siguruari nuk pranon ndryshimin ose zgjidhjen e kontratës, ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës.

Neni 1124

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përfundimit të kontratës dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të kohëzgjatjes së kontratës.

Kur afati i kontratës është mbi 10 vjet, palët me kalimin e këtij afati dhe në rast se nuk kanë ndonjë marrëveshje të kundërt, kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata, duke bërë një paralajmërim 6 muaj më parë.

Kontrata mund të zgjatet heshtazi një ose disa herë, por në çdo rast jo më shumë se për dy vjet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për kontratën e sigurimit të jetës.

Neni 1125

Kontraktuesi detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet.

Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 1126

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të njoftojë siguruesin brenda afatit të parashikuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk bën këtë njoftim, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1127

I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në sigurimin e pasurisë të provojë edhe sasinë e dëmit, si dhe t'i njoftojë siguruesit, sipas kërkesës së këtij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vërtetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor.

Kur nuk përmbushen detyrimet e sipërme, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1128

Shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguruarit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet për borxhet e të siguruarit.

Siguruesi ka të drejtë të ndalojë nga shpërblimi i sigurimit ose nga shuma e sigurimit atë që ka për të marrë i siguruari nga e njëjta kontratë e sigurimit (primin etj.).

Neni 1129

Siguruesi mund t'i kundrejtojë personit, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, të gjitha prapësimet që ai mund t'i kundrejtojë të siguruarit nga e njëjta kontratë sigurimi.

Neni 1130

Kur një person lidh një kontratë sigurimi në emër të një tjetri, pa patur një tagër të tillë prej tij, ky i fundit mund të pranojë kontratën e lidhur edhe pas vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.

Personi që ka lidhur kontratën është i detyruar të zbatojë vetë detyrimet që rrjedhin nga kontrata, deri në momentin kur siguruesi ka marrë njoftim për pranimin ose jo të saj, nga personi në emër të të cilit është lidhur kontrata.

Çmimi i sigurimit i paguhet siguruesit nga kontraktuesi i mësipërm, për të gjithë periudhën deri në momentin kur siguruesi ka marrë dijeni për mospranimin e kontratës.

Neni 1131

Siguruesi nuk është përgjegjës kur vdekja ose humbja e aftësisë për punë të të siguruarit, si dhe kur humbja ose dëmtimi i pasurisë janë shkaktuar drejt për drejt nga veprime lufte, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Neni 1132

Kushtet për llojet e ndryshme të sigurimit vullnetar të pasurisë dhe të personit caktohen në kontratë.

Neni 1133

Dispozitat e këtij kreu nuk shtrihen mbi sigurimin e detyrueshëm, i cili rregullohet nga dispozita të veçanta.

Sigurimi në lundrimin detar rregullohet nga Kodi i Lundrimit Detar.

Sigurimi i pasurisë

Neni 1134

Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme.

Neni 1135

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit pushon interesi pasuror i të siguruarit, ose i personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, kjo quhet e zgjidhur.

Neni 1136

Shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefta e pasurisë. Kjo vleftë, për disa lloje sigurimi, mund të jetë e përcaktuar në kontratën e sigurimit edhe me anë vleftësimi të pasurisë.

Me vleftë duhet të kuptohet vlera më e madhe që ka patur pasuria në kohën e vërtetimit të rastit fator.

Në sigurimin e prodhimeve të tokës, dëmi përcaktohet në raport me vlerën që do të kishin prodhimet në kohën e pjekjes së tyre, ose kur mblidheshin zakonisht.

Kur është siguruar vetëm një pjesë e vleftës së pasurisë, shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefta e pjesës së pasurisë të siguruar.

Kur shkelen kushtet e sipërme, kontrata e sigurimit është e vlefshme, sipas rastit, për një shumë të barabartë me vleftën ose me pjesën e vleftës së pasurisë të siguruar.

Neni 1137

Kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet, shpërblehet, sipas rastit, vlefta e saj brenda kufijve të shumës së sigurimit ose pakësimi i vleftës së pasurisë, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Siguruesi përgjigjet për fitimin e munguar, vetëm në qoftë se është parashikuar shprehimisht në kontratë.

Neni 1138

Kur pasuria e siguruar ka humbur pjesërisht ose është dëmtuar dhe për këtë është paguar shuma jo e plotë e sigurimit, pasuria që ka mbetur quhet e siguruar gjer në fund të afatit të caktuar në kontratë për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe shpërblimit që është paguar.

Neni 1139

Kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vlefta e pasurisë së siguruar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjesëtim me raportin midis shumës së sigurimit dhe vleftës së pasurisë të siguruar, përveç kur në kontratë parashikohen ndryshe.

Neni 1140

I siguruari detyrohet të ruajë me kujdes pasurinë e siguruar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe veterinare. Siguruesi ka të drejtë të kontrollojë pasurinë e siguruar dhe të kërkojë nga i siguruari që të marrë masa për ruajtjen e mirë të pasurisë dhe për zhdukjen e çrregullimeve që janë konstatuar. Kur i siguruari shkel detyrimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit.

Neni 1141

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të marrë të gjitha masat që varen nga ai për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar me qëllim që të ndalohet ose pakësohet dëmi.

Siguruesi nuk detyrohet të paguajë shpërblim për atë pjesë të dëmit që u shkaktua nga mosmarrja prej të siguruarit të masave që mund të merreshin prej tij për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar.

Siguruesi detyrohet të paguajë shpenzimet për masat e nevojshme që janë marrë për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar, pavarësisht nëse është arritur ose jo qëllimi, përveç kur siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra, janë përdorur ose janë bërë pa kujdes. Siguruesi përgjigjet për dëmet materiale të shkaktuara mbi sendet e siguruara nga mjetet e përdorura nga i siguruari për të shmangur ose zvogëluar dëmet e ndodhura në ngjarjen e sigurimit, përveç kur provon që mjetet e tilla janë përdorur pa kujdes dhe pa qenë të domosdoshme.

Neni 1142

Siguruesi që ka paguar shpërblimin e sigurimit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Neni 1143

Siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose e personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit.

Në sigurimin e pasurisë së personave, siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të siguruarit.

Neni 1144

Kur pasuria e siguruar kalon në pronësinë e një personi tjetër, kontrata e sigurimt quhet e zgjidhur. Në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjesëtim me kohën që mbetet gjer në mbarimin e afatit të kontratës së sigurimit.

Neni 1145

Kur për të njëjtin rrezik sigurimi janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigurues të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigurues, për të gjitha sigurimet.

Kur i siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, siguruesit nuk janë të detyruar të paguajnë shpërblimin e dëmit.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë të gjithë siguruesit, duke i treguar secilit emërtimin e të tjerëvesigurues.

I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga secili sigurues shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, por gjithsesi shumat e shlyera së bashku nuk duhet të kalojnë shumën e dëmit.

Neni 1146

Siguruesi që ka paguar shumën e dëmit ka të drejtën e regresit ndaj siguruesve të tjerë për ndarjen e shumës së detyruar sipas kontratave përkatëse.

Kur një sigurues është me paaftësi paguese, pjesa e tij ndahet ndërmjet siguruesve të tjerë.

Neni 1147

Sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportimit tokësor, ujor të brendshëm dhe ajror përfshin të gjitha dëmet që mund të pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, përveç kur është caktuar ndryshe nga ligji.

Neni 1148

Kontrata e sigurimit të mallrave kundër rreziqeve të transportimit hyn në fuqi që nga çasti që mallrat i janë dorëzuar transportuesit dhe vazhdon gjer sa këto t'i dorëzohen pritësit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1149

Kur mallrat e transportuara merren në dorëzim nga pritësit pa u mbajtur në këtë rast procesverbal, siguruesi nuk përgjigjet për dëmtimin ose mungesën e mallrave, përveç kur është parashikuar ndryshe me ligj.

Sigurimi i personit

Neni 1150

Kontrata e sigurimit të personit mund të lidhet për rastin e vërtetimit të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguruarit.

Neni 1151

Në kontratën e sigurimit të personit shuma e sigurimit caktohet me marrëveshje të palëve dhe sipas dispozitave të tjera mbi sigurimet.

Neni 1152

Kontrata e sigurimit është e vlefshme edhe kur sigurohet jeta e një të treti. Caktimi i personit bëhet në kontratën e sigurimit, ose me deklaratë me shkrim të mëvonshme, që i njoftohet siguruesit, ose me testament.

Neni 1153

I siguruari mund të caktojë në kontratën e sigurimit që, në rast se ai vdes, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtari të familjes së tij, një personi tjetër, shtetit, ose një personi tjetër juridik publik.

Neni 1154

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, ka të drejtë që të zëvendësojë me një tjetër personin që ka caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Për këtë i siguruari detyrohet të njoftojë me shkresë siguruesin dhe të paraqesë dëshminë e sigurimit për të bërë në të shënimet e nevojshme.

Neni 1155

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi mund të revokohet nga kontraktuesi në formën dhe mënyrën që përdoret për caktimin e tij.

Revokimi nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët pas vdekjes së kontraktuesit, pasi të jetë vërtetuar ngjarja e sigurimit e personi ka deklaruar se e dëshiron këtë përfitim.

Heqja dorë e kontraktuesit dhe deklarata e përfituesit duhet t'i njoftohen me shkrim siguruesit.

Neni 1156

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi, dhe pse mund të jetë i parevokueshëm, nuk ka efekt kur është rasti i parashikuar në shkronjën "a" të nenit 771 të këtij Kodi.

Neni 1157

Kur në dëshminë e sigurimit nuk është treguar personi që mund të marrë shumën e sigurimit, si dhe kur personi i treguar ka vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar me një person tjetër, ose kur ai me dashje ka vrarë, ose ka tentuar të vrasë të siguruarin, shuma e sigurimit i paguhet të siguruarit, dhe në qoftë se ky ka vdekur, trashëgimtarëve të tij ligjorë ose me testament.

Neni 1158

Kur për të marrë shumën e sigurimit janë caktuar më shumë persona dhe disa prej tyre kanë vdekur para të siguruarit, ose disa prej tyre me dashje kanë vrarë ose kanë tentuar të vrasin të siguruarin, pjesët që u takojnë këtyre ndahen midis personave të tjerë të caktuar për të marrë shumën e sigurimit në përpjesëtim me pjesën që i është caktuar secilit prej tyre.

Në rast se në kontratë nuk përmenden pjesët e personave të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, prezumohet se ato janë të barabarta

Neni 1159

Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit kur sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato nuk rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur atë.

Në rast se ndryshimet janë të një natyre të tillë që, gjendja e re edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë, pagimi i shumës së sigurimit pakësohet në përpjesëtim me çmimin më të ulët, të caktuar në raport me atë çmim që ka qenë përcaktuar në fillim.

Në qoftë se i siguruari njofton për ndryshimet e mësipërme siguruesin, ky, brenda 15 ditëve, duhet të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën apo të pakësojë shumën e sigurimit ose të ngrejë çmimin.

I siguruari, brenda 15 ditëve duhet të deklarojë nëse pranon ndryshimet e sipërme në kontratë.

Në qoftë se i siguruari deklaron se nuk i pranon ato, kontrata zgjidhet.

Neni 1160

Shuma e sigurimit, që pas vdekjes së të siguruarit është caktuar t'i paguhet personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, nuk përfshihet në pasurinë trashëgimore të të siguruarit.

Neni 1161

Shumat e sigurimit që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të personit, paguhen pavarësisht nga shumat që mund të paguhen nga sigurimet shoqërore.

TITULLI III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 1162

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1163

Për parashkrimin e padisë dhe parashkrimin fitues, që kanë filluar të ecin para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mëparshme, do të zbatohen këto të fundit.

Neni 1164

Dispozitat e këtij Kodi lidhur me posedimin, zbatohen edhe për posedimet që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1165

Rregullimi juridik i afatit dhe i çmimit të qirasë në kontratën e qirasë së banesave, do të vazhdojë të bëhet sipas dispozitave të mëparëshme, deri në liberalizimin e plotë të kësaj kontrate me dispozita të veçanta.

Neni 1166

Kontratat e veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të tij dhe që vazhdojnë të zbatohen, do të rregullohen sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 1167

Ligji nr.6340, datë 26.6.1981 "Për Kodin Civil", përveç dispozitave për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, ligji nr. 2362, datë 16.11.1956 "Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike", ligji nr.7688, datë 13.3.1993 "Për bashkëpronësinë në banesa", ligji nr. 7695, datë 7.4.1993 "Për fondacionet" nenet 1-15, dekreti nr.600, datë 22.7.1993 "Për pengun dhe hipotekën", miratuar me ndryshime me ligjin nr.7753, datë 30.9.1993, shfuqizohen.

Neni 1168

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë hyn në fuqi më 1 nëntor 1994.

Tirazhi: 4150 *Formati 60x88/8*

Shtypshkronja e Kuvendit Popullor
Tiranë, 1994

Çmimi: 100 lekë

FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BOTIM I KUVENDIT

Nr.29 1999 Nëntor

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr.8535 datë 18.10.1999	Për një shtesë në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.....	1113
Ligj nr.8536 datë 18.10.1999	Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.....	1114
Ligj nr. 8537 datë 18.10.1999	Për barrët siguruese	1116
Ligj nr.8538 datë 21.10.1999	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Danimarkës për asistencën në periudhën e tranzicionit".	1138

LIGJ
Nr.8536, datë 18.10.1999

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 499 shtohet paragrafi i tretë, me këtë përmbajtje:
"Dispozitat për kalimin e kredisë nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë."

Neni 2

Në nenin 546 shtohet një paragraf i dytë, me këtë përmbajtje:
"Dispozitat për pengun nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë."

Neni 3

Neni 605 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 605
Radha e preferimit

Paguhen me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:
a. kreditë që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguruese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë;
b. kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj;
c. kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësuara nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;
ç. kreditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;
d. kreditë e autorëve dhe të trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;
dh. kreditë e shtetit, që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme, të përcaktuara me ligj;
e. kreditë, që rrjedhin nga transaksionet financiare, të siguruara me barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj;

ë. kreditë, që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim tej kufirit të caktuar në shkronjën "b" të këtij neni;

f. shpërblimi i ndërmjetësimit që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të fundit të shpërblimit;

g. kreditë e siguruara me hipotekë ose me peng që nuk krijojnë barrë siguruese, sipas ligjit, nga vlefta e sendeve në hipotekë ose të lëna peng;

gj. kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vlefta e shitjes së sendeve;

h. kreditë e dhëna nga bankat, të cilat nuk përfshihen në shkronjën "e" dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;

i. kreditë për furnizimin me farëra, plehëra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frutet) bujqësor të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kur ka disa kredi sipas shkronjës "a" dhe shkronjës "e" të këtij neni, rradha e preferimit përcaktohet sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredie sipas shkronjës "a" preferim mbi kreditë sipas shkronjës "e", kredia sipas shkronjës "a" do të preferohet sipas shkronjës "e".

Përjashtohen nga radha e preferimit sipas këtij neni kreditë sipas shkronjës "e", që janë dhënë aktualisht, të cilat do të preferohen përpara kredive sipas shkronjës "dh" në rastet që vijojnë:

- kredia sipas shkronjës "e" është regjistruar sipas ligjit, ndërsa kredia sipas shkronjës "dh" nuk është regjistruar,
- kredia sipas shkronjës "e" është regjistruar sipas ligjit, përpara regjistrimit të kredisë sipas shkronjës "dh"."

Neni 4

Pas nenit 749 shtohet neni 749/a me këtë përmbajtje:

"Rregullat e parashikuara nga nenet 746, 747, 748 dhe 749 nuk zbatohen për shitjet me rezervë të pronës, lidhur me transaksione financiare me barrë siguruese, për të cilat zbatohen rregullat e përcaktuara me ligj të veçantë."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2467, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

U dorëzua për shtyp më 6.11.1999
Doli nga shtypi më 6.11.1999

Tirazhi: 3315 copë Formati 60x88/8

Shtypshkronja e Kuvendit
Tiranë, 1999 Çmimi: 20 lekë

FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 24	2001	Maj

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr.8776 datë 26.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, datë 2.9.1998 dhe nr.8575, datë 3.2.2000.	733
Ligj nr.8777 datë 26.4.2001	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin teknik, financiar dhe asistencën humanitare".....	737
Ligj nr. 8778 datë 26.4.2001	Për ratifikimin e "Konventës penale për korrupsionin".....	742
Ligj nr.8779 datë 26.4.2001	Për një shtesë në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8166, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999 dhe nr.8714, datë 15.12.2000.....	756

Ligj nr.8781 datë 3.5.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".....	757
Dekret nr.3018 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	761
Dekret nr.3019 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	762
Dekret nr.3020 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	762
Vendim nr.291 datë 12.5.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.514, datë 3.7.1995 të Këshillit të Ministrave "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore, qendrore dhe organeve të pushtetit vendor".....	763
Vendim nr.297 datë 12.5.2001	Për regjistrimin hipotekor të pasurive të shoqërive huamarrëse në administrim, kur u mungon leja e ndërtimit ose kur objekti nuk ka përfunduar.....	763
Vendim nr.298 datë 12.5.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për mbylljen e llogarisë së ish-fondacionit "Demokracia Popullore Xhaferri" dhe kalimin e fondeve të mbetura për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale".....	764
Vendim nr.299 datë 12.5.2001	Për regjistrimin për shitje të sipërfaqeve të trojeve të objekteve në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim.....	765
Vendim nr.300 datë 12.5.2001	Për pagesën e vlerës së truallit të shoqërive huamarrëse për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale.....	766
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dhimitër Vasil Avrami.....	768
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetases Shaqe Ramaj.....	768

LIGJ
Nr.8781, datë 3.5.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7850, DATË 29.7.1994, "KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 81 pika 2 shkronja "d" dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 39 ndryshohet si vijon:
"Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj."

Neni 2

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:
"Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe me qëllimin e objektin e veprimtarisë së shoqatës, të parashikuar në statutin e saj.
Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj.
Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse."

Neni 3

- Në nenin 40, para paragrafit të parë, shtohet ky paragraf:
"Akti për krijimin e shoqatës, me kërkesë të themeluesve të saj, regjistrohet në gjykatë".
- Fjalia e parë e nenit 40 ndryshohet si vijon:
"Rregullat për organizimin e funksionimin e shoqatës përcaktohen në statutin e saj, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:"

Neni 4

Në nenin 41, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:
"Shoqata themelohet nga mbledhja e themeluesve, në të cilën miratohet statuti dhe zgjidhen organet drejtuese të saj. Shoqata, me kërkesën e saj, regjistrohet në gjykatë sipas mënyrës së parashikuar në ligj."

Neni 5

Neni 42 ndryshohet si vijon:

"Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj."

Neni 6

Neni 43 ndryshohet si vijon:

"Shoqata ka të drejtë të themelojë degë të saj kudo ku ajo e çmon të arsyeshme, për të realizuar qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqatës."

Neni 7

Pas nenit 43 shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

"Rastet dhe mënyrat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqatave nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj."

Neni 8

Në nenin 46, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Anëtari i shoqatës nuk merr pjesë në diskutim dhe votim në rastet kur vetë ose bashkëshorti, fëmijët, gjinia a krushqia e tij janë në konflikt interesash me shoqatën, lidhur me një çështje të rendit të ditës.

Miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të shoqatës vendimet për ndryshimin e statutit dhe për shpërndarjen e shoqatës, përveç kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë votimi."

Neni 9

Në nenin 50, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Anëtari, që largohet ose përjashtohet nga shoqata, përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve deri në çastin e largimit të tij dhe nuk ka të drejta mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj."

Neni 10

Neni 52 riformulohet si vijon:

"Shpërndarja e shoqatës bëhet:

a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;

b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në këtë Kod ose në statut;

c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;

ç) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;

d) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e shoqatës, me kërkesë të çdo anëtari të shoqatës, të organeve vendimmarrëse të saj, si dhe të organeve kompetente shtetërore."

Neni 11

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe çregjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj."

Neni 12

Pas nenit 53 shtohet neni 53/1 si vijon:

"Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e shoqatës, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar shoqata."

Neni 13

Neni 54 ndryshohet si vijon:

"Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut."

Neni 14

Neni 55 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt noterial ose me testament.

Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë."

Neni 15

Neni 56 ndryshohet si vijon:

"Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e fondacionit ose ekzekutori i testamentit mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e tij."

Neni 16

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

"Fondacioni ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektin e veprimtarive të parashikuara në statutin e fondacionit.

Të ardhurat e realizuara nga fondacioni duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e tij.

Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse."

Neni 17

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"Rastet dhe mënyra e mbikëqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj."

Neni 18

Neni 69 shfuqizohet.

Neni 19

Neni 62 ndryshohet si vijon:

"Shpërndarja e fondacionit bëhet:

a) me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;

b) kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;

c) kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;

ç) në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Gjykata, në rastet e parashikuara me ligj, mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të shoqatës, si dhe të organeve kompetente shtetërore."

Neni 20

Neni 63 ndryshohet si vijon:

"Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e fondacionit, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së tij, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar fondacioni."

Neni 21

Neni 153 ndryshohet si vijon:

"Të drejtat dhe detyrimet e pronarit

Askush nuk mund të shpronësohet ose t'i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publikë dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë."

Neni 22

Në nenin 190, fjalia e parë ndryshohet si vijon:

"Sendet mund të shpronësohen vetëm për interesa publikë të njohur me ligj dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë."

Neni 23

Në nenin 361, paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

"Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi."

Neni 24

Në nenin 362, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa."

Neni 25

Në nenin 398 fjalët "ose sekretari" shfuqizohen.

Neni 26

Në të gjithë Kodin, fjalët "Gjykata e Kasacionit" dhe "gjykata e rrethit" zëvendësohen me fjalët "Gjykata e Lartë" dhe "gjykata e shkallës së parë".

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3003, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Rexhep Meidani

.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 16.5.2001
Doli nga shtypi më 20.5.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "At Gjergj Fishta"
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.18 14 mars 2012

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 12/2012 datë 16.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Sllovenisë.....	735
Ligj nr. 13/2012 datë 16.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe e Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, për të drejtat dhe imunitetet e ONAK-ut	738
Ligj nr. 14/2012 datë 16.2.2012	Për një ndryshim dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.....	746
Ligj nr. 15/2012 datë 16.2.2012	Për një ndryshim dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.....	747
Ligj nr. 16/2012 datë 16.2.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar.....	748
Ligj nr. 17/2012 datë 16.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	749
Ligj nr. 18/2012 datë 23.2.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve.....	751
Ligj nr. 19/2012 datë 23.2.2012	Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve.....	753

LIGJ
Nr. 17/2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994 "KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 81 pika 2 shkronja "d" dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 115, pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:
"e) një vit paditë për shpërblimin e dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit.".

Neni 2

Neni 625 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 625

Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:
a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
c) është cenuar e drejta e emrit;
ç) është cenuar respektimi i jetës private;
d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.".

Neni 3

Pas nenit 647 shtohet neni 647/a me këtë përmbajtje:

"Neni 647/a
Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror

Shpërblimi i dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të personit, synon rivendosjen e të drejtës së shkelur, në mënyrë proporcionale me dëmin e pësuar dhe caktohet në bazë të rrethanave të çështjes. Për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata mban parasysh edhe:
a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;
b) shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;
c) format dhe shkallën e fajësisë;

ç) faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;

d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;

dh) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;

e) faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;

ë) faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje;

f) kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtrimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;

g) faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;

gj) faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit.".

Neni 4

Për çështjet civile me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror ndaj reputacionit, që janë ende në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohet legjislacioni civil në fuqi, në kohën e ngritjes së padive për shpërblimin e dëmit jopasuror.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7308, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.3.2012
Doli nga shtypi më 14.3.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 67 3 maj 2013

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 118/2013 datë 18.4.2013	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës Për Patentat Europiane	2975
Ligj nr. 119/2013 datë 18.4.2013	Për dhënien në përdorim të truallit institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore	2978
Ligj nr. 120/2013 datë 18.4.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar	2980
Ligj nr. 121/2013 datë 18.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	2982
Ligj nr. 122/2013 datë 18.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	2989
Vendim i Kuvendit nr. 20/2013, datë 25.4.2013	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)	3000
Vendim i Kuvendit nr. 21/2013, datë 25.4.2013	Për zgjedhjen e zotit Lulzim Lelçaj anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë	3001
Vendim i Kuvendit nr. 22/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Admir Thanza anëtar i Gjykatës së Lartë	3001
Vendim i Kuvendit nr. 23/2013, datë 25.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Tom Ndreca anëtar i Gjykatës së Lartë	3002

LIGJ
Nr. 121/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994 "KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 318 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 318
Koha e çeljes së trashëgimisë

Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi.
Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur.".

Neni 2

Pas nenit 318 shtohen nenet 318/1 dhe 318/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 318/1
Vendi i çeljes së trashëgimisë

Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Neni 318/2
Ligji i zbatueshëm

Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur.".

Neni 3

Neni 333 ndryshohet si më poshtë:

[1] *Përafruar plotësisht me direktivën e Këshillit nr. 86/653/EEC të datës 18 dhjetor 1986 "Për koordinimin e ligjeve të shteteve anëtare që kanë të bëjnë me agjentët tregtarë të vetëpunësuar", Nr. CELEX 31988L0653.*

"Neni 333
Heqja dorë nga trashëgimia

Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri.

Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme.

Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.".

Neni 4

Në nenin 336, fjalët "gjykata e rrethit ku" zëvendësohen me fjalët "noteri i njësisë vendore".

Neni 5

Neni 343 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 343
Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Kur shihet e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, të personave që mund të përfitojnë nga disponimet me testament, të kreditorëve të trashëgimlënësit ose të shtetit, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht, ose me kërkesën e çdo të interesuari, bën inventarin e pasurisë trashëgimore.

Noteri që bën inventarin mund të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore.

Derisa të mos jenë hequr masat e mësipërme, trashëgimtari që mund të ketë filluar nga administrimi i pasurisë trashëgimore, nuk mund ta tjetërsojë atë veçse me lejen e gjykatës.".

Neni 6

Në nenin 344 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) fjalët "gjykata e rrethit ku" zëvendësohen me fjalët "noteri i njësisë vendore ku";

b) paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Shkurtimi i aktit noterial të emërimit të kujdestarit shpallet në Fletoren Zyrtare.".

Neni 7

Neni 348 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 348
Dëshmia e trashëgimisë

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm. Në rast se i njëjti trashëgimlënës ka lënë më shumë se një testament, dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar apo depozituar për ruajtje testamenti i fundit.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë redaktohet në numër të barabartë me trashëgimtarët e përcaktuar në të. Noteri, në momentin e redaktimit, lëshon dëshminë e trashëgimisë në numër të barabartë me kërkuesit, ndërsa kopjet e tjera të redaktuara ruhen nga noteri dhe mund të tërhiqen nga trashëgimtarët e tjerë, sipas kërkesës së tyre.

Rregullat e hollësishme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe për regjistrimin e testamenteve përcaktohen nga ligji për noterinë.".

Neni 8

Neni 354 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 354

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet me marrëveshje midis trashëgimtarëve, e cila miratohet me akt noterial.

Nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, noteri, mbi bazën e parimit të paanësisë, si dhe duke mbajtur në konsideratë rregullat e pjesëtimit të pasurisë, sipas këtij Kodi, i ofron trashëgimtarëve mundësitë ligjore për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore dhe arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Në këtë rast noteri i sqaron ata për të drejtat dhe detyrat, si dhe i paralajmëron për pasojat që vijnë nga nënshkrimi i marrëveshjes, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenia e ligjit.

Kur trashëgimtarët nuk bien dakord edhe me zgjidhjet e ofruara nga noteri, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet nga gjykata kompetente për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia.".

Neni 9

Në nenin 546, në fund të paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Dispozitat për pengun nuk zbatohen edhe në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.".

Neni 10

Kreu XIII i titullit II të pjesës V ndryshohet si më poshtë:

"KREU XIII
AGJENCIA

Neni 950
Dispozita të përgjithshme

Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.

Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.

Neni 951
Ekskluziviteti

Pala porositëse nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një agjent në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë.

Gjithashtu, agjenti nuk mund të trajtojë njëkohësisht, në të njëjtën zonë apo për të njëjtën grup klientësh dhe për të njëjtën fushë, kontratat e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Agjenti tregtar, në ushtrimin e aktiviteteve të tij, duhet të kujdeset për interesat e porositësit dhe të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Agjenti tregtar duhet në veçanti:

a) të përpiqet për të negociuar dhe, kur është rasti, të lidhë kontratat për të cilat është ngarkuar;

b) t'i njoftojë porositësit çdo informacion të nevojshëm që ai disponon;

c) të zbatojë udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga porositësi.

Porositësi, në marrëdhëniet e tij me agjentin tregtar, duhet të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Porositësi duhet në veçanti:

a) të vërë në dispozicion të agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me kontratat në fjalë;

b) t'i sigurojë agjentit tregtar informacionet e nevojshme për përmbushjen e kontratës së agjencisë, veçanërisht të njoftojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, sapo ai parashikon që volumi i kontratave do të jetë në mënyrë të dukshme më i ulët se ai, të cilin agjenti tregtar do të priste normalisht.

Porositësi, gjithashtu, duhet të informojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, për pranimin, refuzimin ose mosekzekutimin e një kontrate që agjenti tregtar ka siguruar për porositësin.

Palët nuk mund të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 953
Shpërblimi i agjentit tregtar

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë, të caktuar për kontratat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, përfitojnë zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e kontratës.

Konsiderohen si shpërblim i agjentit të gjitha elementet e pagesës që përfiton ai dhe që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare.

Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm, që merr parasysh të gjitha elementet që kanë të bëjnë me veprimin.

Neni 954

Agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit për kontratat e përfunduara gjatë periudhës së kontratës së agjencisë:

a) nëse kontrata është përfunduar si rezultat i veprimit të tij;

b) nëse kontrata është përfunduar me një të tretë, të cilin ai kishte fituar më parë si klient për kontrata të të njëjtit lloj;

c) nëse ai ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike të caktuar ose një grupi klientësh dhe kontrata është kryer me një klient që i përket kësaj zone dhe/ose këtij grupi.

Për një kontratë të përfunduar pas përfundimit të kontratës së agjencisë, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit:

a) nëse kontrata i detyrohet kryesisht përpjekjeve të tij të kryera gjatë kontratës së agjencisë, pavarësisht se kontratat janë përfunduar në një afat kohor të arsyeshëm, pas mbarimit të kontratës së agjencisë; ose

b) nëse porosia e një të treti ka qenë marrë nga porositësi ose nga agjenti tregtar para mbarimit të kontratës së agjencisë.

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e shpërblimit nëse ai i detyrohet agjentit tregtar paraardhës, përveç kur nuk rezulton nga rrethanat që është e drejtë që shpërblimi të ndahet mes agjentëve tregtarë.

Shpërblimi bëhet i pagueshëm në momentin dhe në masën kur paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) pala porositëse ka ekzekutuar kontratën;

b) pala porositëse duhej të kishte ekzekutuar kontratën, në përputhje me marrëveshjen e lidhur me palën e tretë;

c) pala e tretë ka ekzekutuar kontratën.

Shpërblimi merret më vonë kur një i tretë ka ekzekutuar pjesën e tij të kontratës apo do të duhej ta kishte ekzekutuar, nëse pala porositëse do të kishte ekzekutuar pjesën e tij të kontratës.

Shpërblimi paguhet jo më vonë se dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i kërkueshëm.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 955

E drejta për shpërblim mund të shuhet vetëm në qoftë se dhe në masën në të cilën:

a) vendoset se kontrata ndërmjet të tretit dhe porositësit nuk do të ekzekutohet; dhe

b) mosekzekutimi nuk i detyrohet rrethanave që i ngarkohen porositësit.

Agjenti tregtar duhet të rikthejë shpërblimin që ka marrë nëse e drejta për marrjen e tij nuk ekziston më.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 956

Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të shpërblimeve që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i pagueshëm. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elementet thelbësore, në bazë të të cilave është kryer përllogaritja e shpërblimeve.

Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave kontabël, që janë në dispozicion të porositësit, të nevojshme për të verifikuar shumën e shpërblimeve të paguara.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 957

Mbarimi dhe zgjidhja e kontratës së agjencisë

Kontrata e agjencisë me kohë të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të kohës, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Nëse kontrata e agjencisë është me kohë të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati të caktuar.

Afati i njoftimit paraprak nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, 4 muaj për vitin e katërt, 5 muaj për vitin e pestë dhe 6 muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjitha vitet në vazhdim. Nëse palët merren vesh për afate paralajmërimi më të gjata, afati i paralajmërimit që duhet të respektojë pala porositëse nuk duhet të jetë më i shkurtër se afati që duhet të respektojë agjenti. Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të paralajmërimit duhet të përkojë me ditën e fundit të muajit kalendarik. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe për kontratën e agjencisë me kohë të përcaktuar, të shndërruar në kontratë me kohë të papërcaktuar, me kushtin që në llogaritjen e afatit të paralajmërimit duhet të mbahet parasysh afati i mëparshëm.

Në mbarim të kontratës së agjencisë, porositësi detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe nëse:

a) agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm kontratat me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga kontratat me këta klientë;

b) pagesa e këtij shpërblimi është e drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sidomos shpërblimin që agjenti tregtar humbet dhe që rezultojnë nga veprimet me këta klientë, si dhe nga kufizimi i aktiviteteve të tij profesionale që i detyrohen ekzistencës së një klauzole të moskonkurrencës.

Shuma e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një vlerë të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur nga mesatarja vjetore e shpërblimeve të marra nga agjenti tregtar gjatë pesë viteve të fundit. Nëse kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e periudhës së kontratës. Përfitimi i shpërblimit nuk e përjashton agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti tregtar ka të drejtë për shpërblimin e dëmit që ka pësuar si rezultat i përfundimit të marrëdhënieve me palën porositëse.

Ky dëm rezulton veçanërisht kur mbarimi i kontratës ka ndodhur në kushte:

a) të cilat shmangin agjentin tregtar nga shpërblimi që mund të kishte fituar me përmbushjen në mënyrën e duhur të kontratës, duke i siguruar në të njëjtën kohë porositësit përfitime të konsiderueshme të lidhura me veprimtarinë e agjentit tregtar; dhe/ose

b) të cilat nuk i kanë mundësuar agjentit që të rimbursojë kostot dhe shpenzimet që ka bërë për përmbushjen e kontratës, sipas udhëzimeve të porositësit.

E drejta për shpërblim lind, gjithashtu, edhe kur kontrata e agjencisë përfundon si rezultat i vdekjes së agjentit tregtar dhe mund të kërkohet nga trashëgimtarët e tij. Agjenti tregtar humbet të drejtën për shpërblim nëse, brenda një viti nga mbarimi i kontratës, nuk i komunikon porositësit qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tij.

Neni 958

Nuk paguhet shpërblim kur:

a) pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila justifikon një zgjidhje të menjëhershme të kontratës;

b) agjenti zgjidh kontratën, përveç rastit kur përfundimi justifikohet nga rrethanat që i atribuohen porositësit, ose për shkak të moshës, paaftësisë ose sëmundjes së agjentit tregtar, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;

c) agjenti nuk përmbush personalisht të drejtat dhe detyrimet që ai ka në bazë të kontratës së agjencisë, por ia kalon ato një pale të tretë.

Neni 959

Palët nuk mund të shmangin, para mbarimit të kontratës, zbatimin e neneve 957 dhe 958 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 960

Marrëveshja që parashikon një kufizim të aktiviteteve profesionale të agjentit tregtar pas përfundimit të kontratës quhet klauzolë e moskonkurrencës.

Marrëveshja e moskonkurrencës është e vlefshme kur bëhet me shkrim. Ajo duhet t'i përkasë një zone gjeografike ose grupi të klientëve, të besuar agjentit tregtar, si dhe llojin e kontratave, për të cilat agjenti tregtar kishte përfaqësimin, sipas kontratës së agjencisë.

Klauzola e moskonkurrencës është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 2 vjet nga dita e përfundimit të kontratës.

Neni 961
Marrëveshja e garancisë së nënshkruar nga agjenti

Një marrëveshje, me anë të së cilës agjenti garanton që një klient do të paguajë çmimin e mallrave që përbëjnë objektin e kontratës, të cilën e ka negociuar apo përfunduar ai, është e vlefshme vetëm nëse dhe për aq sa ajo është bërë me shkrim, mbulon vetëm kontratat e specifikuara shprehimisht në marrëveshje dhe është e arsyeshme për sa i përket interesave të palëve, sidomos për sa i përket shumës së shpërblimit që përfiton agjenti. Në çdo rast shuma e vendosur si garanci nuk mund të jetë më e madhe se shpërblimi që agjenti do të përfitonte prej kësaj kontrate.".

Neni 11
Dispozitë kalimtare

Dispozitat për trashëgiminë janë të zbatueshme vetëm për kërkesat për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, të bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çështjet gjyqësore me objekt "kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë" do të vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata kompetente, sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesës.

Dispozitat mbi agjencinë janë të zbatueshme për kontratat e agjencisë, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8130, datë 30.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 3.5.2013
Doli nga shtypi më 3.5.2013

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë